International Criminal Tribunal
for the former Yugoslavia

Manuali i TPNJ-së mbi Praktikat e Zhvilluara

Përgatitur së bashku me

unicri
United Nations
Interregional Crime and Justice
Research Institute

si pjesë e një projekti
për të ruajtur trashëgiminë e TPNJ-së

Manuali i TPNJ-së
mbi Praktikat e Zhvilluara

Përgatitur së bashku me UNICRI-në
si pjesë e një projekti për të ruajtur trashëgiminë e TPNJ-së

Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialit në këtë publikim nuk nënkupton shprehjen e asnjë opinioni nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, TPNJ-së apo UNICRI-së në lidhje me statusin ligjor të asnjë vendi, territori, qyteti ose zone ose të autoriteteve të tyre, ose në lidhje me caktimin e kufijve të tyre.

E drejta e autorit © TPNJ - UNICRI 2009

Botues UNICRI

Përmbajtja

Parathënie **1**

I. Hyrje **3**

II. Metodologjia **5**

III. Tiparet e Veçanta të Lëndëve Gjyqësore me Krime Lufte, Krime Kundër Njerëzimit dhe Gjenocid **7**

IV. Hetimet **11**

A. Konsideratat paraprake **12**
A.1 Një qasje shumë-disiplinore 12
A.2 Mbikëqyrja juridike e hetimeve 12
A.3 Hetimet financiare 13
A.4 Përgjegjësia komanduese 13
B. Hapja e një hetimi **14**
B.1 Ditari i hetimeve 14
C. Zgjedhja e objekteve të hetimit **14**
D. Mbledhja e informacionit **16**
D.1 Hetimet modulare 16
D.2 Misionet hetuese 16
D.3 Zhvarrosja dhe identifikimi i mbetjeve njerëzore 17
D.4 Grumbullimi i dëshmive (bastisja dhe sekuestrimi) 18
D.5 Kërkesa për ndihmë juridike 18
D.6 Burimet e ndjeshme 19
D.7 Viktimat/dëshmitarët e rrezikuar 20
D.8 Dëshmitarët 21
D.8.1 Kontaktet e para nga hetuesit e Prokurorisë 21
D.8.2 Mbrojtja e burimeve të ndjeshme dhe dëshmitarëve të rrezikuar 22
D.8.3 Përgatitja për intervistën e dëshmitarit 22
D.8.4 Intervistimi i dëshmitarëve 23
D.8.5 Regjistrimi i kontakteve me dëshmitarët 24
D.9 Intervistimi i viktimave të sulmeve seksuale 25
D.10 Intervistimi i dëshmitarëve ekspertë 26
D.11 Intervistimi i të dyshuarve 26
E. Menaxhimi i informacionit **27**
E.1 Mbrojtja e informacionit të ndjeshëm 27
E.2 Përdorimi, përpunimi dhe ruajtja e provave 28
E.3 Zinxhiri i ruajtjes 28
E.4 Analizimi i dëshmive 28
F. Rëndësia e dëshmive demografike **30**
IV. Shtojca 1: Plani i hetimit *31*
IV. Shtojca 2: Parimet udhëzuese për zhvarrosjet *34*
IV. Shtojca 3: Parimet udhëzuese për intervistimin e viktimave të sulmeve seksuale *35*

V. Aktakuza **37**

A. Gatishmëria për ngritjen e lëndës **37**
B. Mbingarkimi i aktakuzave **38**
C. Koncepti i "njoftimit adekuat" **38**

C.1 Faktet me rëndësi....38
C.2 Mënyrat e përgjegjësisë....39
D. Standardizimi i formave të aktakuzave....41
E. Aprovimi gjyqësor i aktakuzës....41
E.1 Procedura e konfirmimit të aktakuzës....41
E.2 Procesi i konfirmimit, si pikë kontrolli....42
F. Kundërshtimi i aktakuzës....42
G. Gjykimi i bashkuar i të pandehurve....42
H. Gjykimi i bashkuar i krimeve....43
I. Aktakuzat "nën vulë"....44
J. Ndryshimet e aktakuzës....45
V. Shtojca 4: Standardet e shqyrtimit të aktakuzës përpara procesit gjyqësor....46

VI. Fletarrestimet....49

A. Publikimi i aktakuzës dhe fletarrestimet....49
A.1 Shqyrtimi dhe depozitimi i aktakuzës....49
A.2 Transmetimi i fletarrestimeve....50
B. Fletarrestimet dhe mosekzekutimi i tyre....50
C. Bashkëpunimi i Shteteve dhe dorëzimi vullnetar....51
C.1 Bashkëpunimi i Shteteve....51
C.2 Bashkëpunimi i Shtetit pritës....53

VII. Faza paragjyqësore....55

A. Procesi paragjyqësor....56
B. Instrumentet e administrimit të lëndëve....58
B.1 Konferencat për statusin dhe mbledhjet sipas Rregullës 65ter....59
B.2 Plani i punës....59
B.3 Dosja paragjyqësore dhe lista e dëshmitarëve e Prokurorisë dhe dosja paragjyqësore e Mbrojtjes....60
B.4 Mbledhja për administrimin e gjykimit....61
B.5 Konferenca paragjyqësore....63
C. Roli i gjyqtarit....63
D. Dhënia e informacioneve....64
E. Komunikimi ndërmjet palëve....66
F. Mocionet paragjyqësore....67
F.1 Mocionet paraprake....67
F.1.1 Mocionet e tjera....67
F.1.2 Mocioni për lirim të përkohshëm....68
F.1.3 Masat mbrojtëse....68
F.1.4 Mocioni për bashkimin apo ndarjen e lëndëve....69
F.1.5 Mocioni i Prokurorisë për ndryshimin e aktakuzës....69
F.1.6 Mocionet për shikimin e materialeve konfidenciale të lëndëve të tjera....69
G. Zvogëlimi i objektit të aktakuzës....70
H. Ngushtimi i çështjeve kontestuese....71
H.1 Faktet e pranuara....71
H.2 Shënimi gjyqësor....71
I. Vetëdeklarimi i fajësisë....73
VII. Shtojca 5: Afatet e fazës paragjyqësore....75
VII. Shtojca 6: Shembull praktik: parashikimi i kohëzgjatjes së gjykimit gjatë fazës paragjyqësore....77

VIII. Administrimi i gjykimit....81

A. Shmangia e vonesave - mbajtja e orarit....82
B. Paraqitja e provave....83
B.1 Përdorimi i deklaratave me shkrim....84
B.2 Të burgosurit, si dëshmitarë....86

C. Përgatitja e dëshmitarit **88**
D. Përdorimi i urdhërparaqitjeve **89**
D.1 Urdhërparaqitjet për dëshmimin me detyrim sipas Rregullës 54 89
E. Dëshmia e dëshmitarëve të Dhomës sipas Rregullës 98 ..... **91**
F. Provat që dalin pas mbylljes së paraqitjes së lëndës nga prokuroria **91**
G. Kërkesa për dhënie të pafajësisë **92**
H. Materialet konfidenciale të Shteteve dhe organizatave të tjera **94**
I. Vetëpërfaqësimi **95**
J. Mungesa e të akuzuarit **99**
K. Instrumentet e administrimit të lëndëve **101**
K.1 E-court – Sistemet Elektronike të Administrimit të Dokumenteve 101
K.2 "E-court" – sistemi i administrimit të procesverbalit gjyqësor 103
L. Lëndët me disa të akuzuar **104**
L.1 Shqyrtimi i kujdesshëm i aktakuzës 105
L.2 Trajtimi i deklaratave të personave të dyshuar 105
L.3 Paraqitja e provave dhe dëshmive nga Mbrojtja 106
L.4 Marrja në pyetje e dëshmitarit 106
M. Vizitat në terren dhe seancat jashtë selisë së Tribunalit **107**
M.1 Vizitat në terren 107
M.1.1 Hapat që duhen marrë përpara vizitës 108
M.1.2 Pjesëmarrësit 109
M.1.3 Organizimi gjatë vizitës 109
M.1.4 Raportimi pas vizitës, në selinë e Tribunalit 109
M.2 Seancat jashtë selisë së Tribunalit 109
M.2.1 Kontakti i parë me gjykatën e huaj 110
M.2.2 Mbledhja e aktorëve të Sekretarisë 110
M.2.3 Mbledhja përpara nisjes 110
M.2.4 Telekonferenca e përbashkët ndërmjet Sekretarisë dhe gjykatës së huaj 111
M.2.5 Shkëmbimi i letrave dhe përgatitjet përfundimtare 111
M.2.6 Hapat përpara nisjes 111
VIII. Shtojca 7: Rekomandimet e SVD-së për përgatitjen e dëshmitarëve *112*
VIII. Shtojca 8: Shënim shpjegues për dëshmitarët për urdhërparaqitjet *113*
VIII. Shtojca 9: Formulari për regjistrimin e heqjes dorë nga të drejtat *114*

IX. Hartimi i Aktgjykimeve **115**

A. Skica e aktgjykimit **115**
B. Konsiderata paraprake **121**
C. Përmbledhje të deponimeve të dëshmitarëve dhe të provave materiale **122**
C.1 Metoda tradicionale 122
C.2 Metoda e sistemit elektronik të gjykatës 123
D. Ligji i zbatueshëm **125**
E. Konstatimet faktike **126**
F. Ndjekja e historisë procedurale **127**
G. Mocionet për pafajësi **127**
H. Implikimet e gjyqeve me shumë të akuzuar **128**
I. Konsiderata të përgjithshme **129**
J. Rishikimi i draftit të aktgjykimit **130**
K. Konsideratat përfundimtare **132**
IX. Shtojca 10: Kërkesat Chapeau *133*
IX. Shtojca 11: Modeli elektronik i aktgjykimit *134*

X. Apelet **135**

A. Standardi i rishikimit në apel **135**
A.1 Kërkesa të zbatueshme për të gjitha apelet 135

A.2 Standardi i zbatueshëm në rastet e gabimeve ligjore....137
A.3 Standardi i zbatueshëm në rastet e gabimeve të faktit....140
B. Vetëpërfaqësimi në apel....142
C. Para-apeli....144
C.1 Rolet përkatëse të gjykatësit para-apelues dhe seancës paradëgjimore të Dhomës së apelit....144
C.2 Përgatitja e dosjes brenda një kohe të arsyeshme....145
C.3 Provat plotësuese në apel....145
D. Përgatitja për seancën apelit....147
E. Seanca e apelit....148
F. Këshillimi dhe përpilimi i aktgjykimeve të apelit....149
G. Administrimi i apeleve të ndërkohshëm dhe apeleve të tjerë....150
H. Procedura e apelit të përshpejtuar....152

XI. Rishikim....153

A. Konturat ligjore të rishikimit....154
B. Çështje praktike që i përkasin Rishikimit....156
B.1 Dhoma kompetente....156
B.2 Para-rishikimi....157
B.3 Praktikat dhe Prirjet....159

XII. Zbatimi i Dënimeve....161

A. Puna paraprake e Sekretarisë Gjyqësore....162
A.1 Negocimi i marrëveshjeve për zbatimin e vendimeve me Shtetet....162
A.2 Hetimi paraprak me shtetet....164
A.3 Mbledhja e informacionit për caktimin e Shteteve....165
B. Caktimi i Shtetit....166
B.1 Përshtatshmëria e preferencave të shprehura nga personat e dënuar....166
B.1.1 Kufijtë gjeografikë për zbatimin e dënimeve të TPNJ-së....166
B.1.2 A është caktimi i shtetit një çështje që mund të negociohet....168
B.2 Transferimi i personit të dënuar në shtetin e caktuar....169
B.2.1 Kërkesa për rishikim dhe transferimi i të dënuarit në shtetin e zbatimit të dënimit....169
C. Mbikëqyrja e zbatimit të dënimit....170
C.1 Procedura e inspektimit....170
C.2 Kontakti i personave të dënuar me mediat....171
D. Falja dhe ulja e dënimit....171
D.1 Njoftimi nga shtetet....171
D.2 Përjashtimi nga procedura....172
D.3 Marrja e vendimit nga Kryetari....172
D.4 Faktorët përkatës për faljen, uljen e dënimit ose lirimin e parakohshëm....172
D.4.1 Pesha e krimeve....173
D.4.2 Demonstrimi i rehabilitimit nga ana e të dënuarit....173
D.4.3 Bashkëpunimi thelbësor me Prokurorinë....173
D.4.4 Trajtimi i të burgosurve që ndodhen në pozicion të ngjashëm....173
D.4.5 Pragu vendor i kualifikimit....174
D.4.6 Reduktimi automatik i vuajtjes së dënimit....174
D.5 Lirimi dhe transferimi....175
D.6 Çështje që lindin nga transferimi/deportimi....176

XIII. Referimi i Çështjeve te Juridiksionet Vendore....177

A. Kriteret për Referim....178
A.1 Zgjedhja e Shtetit....178
A.2 Niveli i të akuzuarit dhe pasha e krimeve....178
A.3 Gjykimi i Drejtë dhe i Paanshëm dhe mosdënimi me vdekje....179
A.4 Gatishmëria e shtetit dhe përgatitja e mjaftueshme e tij....180

B. Monitorimi dhe çështje të tjera të periudhës pas referimit....181
C. Transferimi i çështjeve: aspekte të administrimit....182
C.1 Transferimi fizik i të akuzuarit....182
C.1.1 Rruga dhe mënyra e transferimit....182
C.1.2 Udhëtimi dhe dokumentet identifikuese të të akuzuarit....183
C.1.3 Dosja e paraburgimit....183
C.1.4 Sendet personale....184
C.1.5 Ruajtja e të akuzuarit....184
C.2 Shfrytëzimi i kopjeve të certifikuara të materialeve të gjykatës....185
C.2.1 Certifikimi....185
C.2.2 Përkthimet....185
C.2.3 Baza e të dhënave gjyqësore....185
C.3 Ndihma ligjore dhe transferimi i materialit të çështjes te Mbrojtja....186
C.3.1 Përfaqësimi ligjor para Gjykatës kombëtare....186
C.3.2 Transferimi i dosjeve të Mbrojtjes....186
C.3.3 Ndihma ligjore gjatë periudhës kalimtare....186
C.4 Kërkesat për ndihmë dhe për ndryshimin e materialit të mbrojtur....187

XIV. Shërbimet e Ndihmës Gjyqësore....189

A. Njësia e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara....190
A.1 Informimi i personelit të Njësisë së Paraburgimit mbi njerëzit e ndaluar....190
A.1.1 Shëndeti i të ndaluarve....191
A.1.2 Pacientët mjekësorë dhe çështjet e besimit tek personeli....191
A.2 Mungesa në Gjykatë për arsye mjekësore....192
A.3 Punësimi i personelit dhe financimi i NjPKB-së....192
A.4 Marrëdhënia e NjPKB-së me procesin gjyqësor....193
A.4.1 Problemet mjekësore....193
A.4.2 Kushtet për të ndaluarit në NjPKB....193
A.4.3 Veçimi dhe izolimi i të ndaluarve....194
A.4.4 Planifikimi i lirimeve të përkohshme dhe kthimeve në NjPKB....194
A.5 Burimet dhe siguria e Teknologjisë së Informacionit....194
A.6 Politikat që synojnë normalizimin e jetës së të paraburgosurve....195
A.6.1 Regjimi ditor....195
A.6.2 Komunikimi dhe vizitat....195
A.6.3 Ushtrimi fizik dhe dalja në ajër të pastër....195
A.6.4 Komfortet kulturore....195
A.7 Shpërndarja e të ndaluarve....196
B. Shërbimet e përkthimit dhe interpretimit....196
B.1 Menaxhimi i përkthimit dhe interpretimit në gjyqet ndërkombëtare penale....196
B.1.1 Sfidat e interpretimit....196
B.1.2 Sfidat e përkthimit me shkrim....197
B.2 Referencat dhe terminologjia....199
B.3 Zyra e Menaxhimit të Dokumenteve....199
B.4 Raportimi gjyqësor....199
C. Bashkëpunimi me Shtetin Pritës....200
C.1 Akomodimi i tribunaleve penale ndërkombëtare....200
C.2 Dispozitat e posaçme të marrëveshjeve me Shtetin Pritës - juridiksioni dhe hyrja në Shtetin Pritës....200
C.3 Mjediset e paraburgimit....201
C.4 Hapësirat e punës....201
C.5 Zbatimi i dënimeve dhe lirimi i personave të shpallur të pafajshëm....201
C.6 Rivendosja e dëshmitarëve....202
C.7 Parrezikshmëria dhe siguria....202
C.8 Menaxhimi i marrëdhënieve me Shtetin Pritës....202
D. Komunikimi....203

D.1 Konsideratat hyrëse....203
D.2 Komunikimi me masmediat dhe bazën....204
D.3 Personeli i komunikimit....205
D.4 Kanalet e komunikimit....205
D.5 Komunikimi dhe ndërgjegjësimi....206
D.5.1 Sfidat që dalin nga një Program Komunikimi dhe Ndërgjegjësimi....207
E. Seksioni i Viktimave dhe Dëshmitarëve....208
E.1 Njësia operacionale....208
E.1.1 Vizat për të udhëtuar për në Holandë....209
E.1.2 Ndihma për dëshmitarët në terren....209
E.1.3 Strehimi në Hagë....210
E.1.4 Kohëzgjatja e qëndrimit të dëshmitarëve në Hagë....210
E.1.5 Pagesat....211
E.2 Njësia e Ndihmës....211
E.2.1 Ndihma profesionale psikosociale dhe vlerësimi i nevojave të dëshmitarëve....211
E.2.2 Përshtatja e dëshmitarit mjedisit të ri dhe takimet e para ndërmjet dëshmitarit dhe avokatëve të tyre....212
E.2.3 Monitorimi i vazhdueshëm i mirëqenies së dëshmitarit....212
E.2.4 Simptomat e pas-traumës....213
E.2.5 Vijimi i kontakteve me dëshmitarët pas dhënies së dëshmisë....213
E.3 Njësia e Mbrojtjes....214
E.3.1 Mbrojtja e dëshmitarëve në gjykatë....214
E.3.2 Mbrojtja e dëshmitarëve jashtë sallës së gjykimit....215
E.4 Konsideratat përfundimtare....217

XV. Ndihma Juridike dhe Çështjet e Avokatit të Mbrojtjes....219
A. Kualifikimet e kërkuara për avokatët mbrojtës....219
A.1 Rregulla 44: Kërkesat e përgjithshme për kualifikimet e të gjithë avokatëve të mbrojtjes....220
A.2 Rregulla 45: Kërkesat për kualifikimin e avokatëve mbrojtës të emëruar....221
A.3 Lista e avokatëve kujdestarë....222
A.4 Pranimi në Listën e Rregullës 45....222
A.5 Caktimi për të përfaqësuar një të akuzuar dhe tërheqja e avokatit mbrojtës....222
A.6 Kërkesa e të akuzuarit për avokat të caktuar....223
A.7 Caktimi i pjesëtarëve të tjerë të ekipit të mbrojtjes....225
A.8 Ndihma për Mbrojtjen....225
B. Politikat e pagesës....226
B.1 Politika e ndihmës juridike përpara gjyqit....227
B.2 Skema e pagesës gjyqësore....228
B.3 Skema e pagesës së apeleve....229
B.4 Caktimi i ekspertëve....230
B.5 Të akuzuarit që përfaqësohen vetë....230
B.6 Organizime të tjera....231
C. Sjellja Profesionale e Avokatit....231
C.1 Kodi i sjelljes....232
C.2 Shoqata e Avokatëve të Mbrojtjes....232
C.2.1 Roli i Shoqatës së Avokatëve të Mbrojtjes....232
C.2.2 Këshilli Disiplinor i ShAM-së....233

Përmbajtja e CD-ROM-it

- **MARRËVESHJET MBI ZBATIMIN E DËNIMEVE**
  - MARRËVESHJA NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE DHE KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZBATIMIN E DËNIMEVE TË TRIBUNALIT PENAL NDËRKOMBËTAR TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ISH-JUGOSLLAVINË
  - MARRËVESHJA NDËRMJET QEVERISË SË MBRETËRISË SË SPANJËS DHE KOMBEVE TË BASHKUARA MBI ZBATIMIN E DËNIMEVE TË TRIBUNALIT PENAL NDËRKOMBËTAR PENAL TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ISH-JUGOSLLAVINË
- **ÇËSHTJET**
  - ÇËSHTJET
- **DHOMAT**
  - **GJYKIMET**
    - PASQYRA E TERMAVE TË AKTGJYKIMIT TË APELIT TË MARTIC-IT
    - AKTGJYKIMI I DËNIMIT TË OBRENOVIC-IT
  - PROKURORI kundër MOMCILO KRAJISNIK-ut PROCEDURA E PËRFUNDIMTARE MBI DËSHMITARËT E DHOMËS - VENDIMET DHE URDHRAT PËR DISA NGA ÇËSHTJET E PROVAVE DHE PROCEDURAVE
- **STATUTI I AKTUALIZUAR I TRIBUNALIT PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË**
  - **SHQIP**
    - RAPORT I SEKRETARIT TË PËRGJTITHSHËM NË BAZË TË PARAGRAFIT 2 TË REZOLUTËS 808 (1993) TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT
    - REZOLUTA 1166 (1998)
    - REZOLUTA 1329 (2000)
    - REZOLUTA 1411 (2002)
    - REZOLUTA 1431 (2002)
    - REZOLUTA 1481 (2003)
    - REZOLUTA 1503 (2003)
    - REZOLUTA 1504 (2003)
    - REZOLUTA 1534 (2004)
    - REZOLUTA 1597 (2005)
    - REZOLUTA 1613 (2005)
    - REZOLUTA 1629 (2005)
    - REZOLUTA 1660 (2006)
    - REZOLUTA 1668 (2006)
    - REZOLUTA 808 (1993)
    - REZOLUTA 827 (1993)
    - STATUTI I PËRDITËSUAR I TRIBUNALIT PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË_SHTATOR 2009
  - **ANGLISHT**
    - REPORT OF THE SECRETARY-GENERAL PURSUANT TO PARAGRAPH 2 OF SECURITY COUNCIL – PRESENTED 3 MAY 1993
    - RESOLUTION 1166 (1998)
    - RESOLUTION 1329 (2000)
    - RESOLUTION 1411 (2002)
    - RESOLUTION 1431 (2002)
    - RESOLUTION 1481 (2003)
    - RESOLUTION 1503 (2003)
    - RESOLUTION 1504 (2003)
    - RESOLUTION 1534 (2004)
    - RESOLUTION 1597 (2005)

- RESOLUTION 1613 (2005)
- RESOLUTION 1629 (2005)
- RESOLUTION 1660 (2006)
- RESOLUTION 1668 (2006)
- RESOLUTION 808 (1993)
- RESOLUTION 827 (1993)
- UPDATED STATUTE OF THE INTERNATIONAL CRIMINAL TRIBUNAL FOR THE FORMER YUGOSLAVIA - SEPTEMBER 2009

- **FRËNGJISHT**
  - RAPPORT DU SECRÉTAIRE GÉNÉRAL ÉTABLI CONFORMÉMENT AU PARAGRAPHE 2 DE LA RÉSOLUTION 808 (1993) DU CONSEIL DE SÉCURITÉ PRÉSENTÉ LE 3 MAI 1993
  - RÉSOLUTION 808 (1993)
  - RÉSOLUTION 1166 (1998)
  - RÉSOLUTION 1411 (2002)
  - RÉSOLUTION 1431 (2002)
  - RÉSOLUTION 1481 (2003)
  - RÉSOLUTION 1503 (2003)
  - RÉSOLUTION 1504 (2003)
  - RÉSOLUTION 1534 (2004)
  - RÉSOLUTION 1597 (2005)
  - RÉSOLUTION 1613 (2005)
  - RÉSOLUTION 1629 (2005)
  - RÉSOLUTION 1660 (2006)
  - RÉSOLUTION 1668 (2006)
  - RÉSOLUTION 827 (1993)
  - RÉSOLUTION 1329 (2000)
  - STATUT ACTUALISÉ DU TRIBUNAL PÉNAL INTERNATIONAL POUR L'EX YOUGOSLAVIE - SEPTEMBRE 2009

- **ZYRA E PRESIDENTIT**
  - **UDHËZIMET E PUNËS**
    - **SHQIP**
      - DIREKTIVA E PRAKTIKËS MBI PROCEDURËN PËR PROPOZIMIN, SHQYRTIMIN DHE BOTIMIN E NDRYSHIMEVE TË RREGULLORES SË PROCEDURËS DHE TË PROVAVE TË TRIBUNALIT NDËRKOMBËTAR
      - DIREKTIVA E PRAKTIKËS MBI PROCEDURËN PËR DORËZIMIN E PARAQITJEVE ME SHKRIM NË PROCEDURAT E APELIT PARA TRIBUNALIT NDËRKOMBËTAR
      - DIREKTIVA MBI PROCEDURËN PËR HETIMIN DHE NDJEKJEN PENALE TË PËRBUZJES PARA TRIBUNALIT NDËRKOMBËTAR
      - DIREKTIVA E PRAKTIKËS MBI KËRKESAT FORMALE PËR APELE NDAJ GJYKIMEVE
      - DIREKTIVA E PRAKTIKËS PËR GJATËSINE E DOSJEVE DHE MOCIONEVE
      - UDHËZIM PRAKTIK NË LIDHJE ME PROCEDURËN E VENDIMEVE PËR KËRKESAT PËR FALJE, ULJE TË DËNIMIT, DHE LIRIM TË PARAKOHSHËM TË INDIVIDËVE TË DËNUAR PREJ TRIBUNALIT NDËRKOMBËTAR
      - UDHËZIMI I PUNËS MBI PROCEDURËN PËR RISHIKIMIN E PARASHTRIMEVE ME SHKRIM TË CILAT PËRMBAJNË GJUHË TË TURPSHME OSE FYESE
      - UDHËZIM PRAKTIK PËR PROCEDURËN E TRIBUNALIT NDËRKOMBËTAR NË LIDHJE ME CAKTIMIN E SHTETIT KU NJË PERSON I SHPALLUR FAJTOR DO TË VUAJË DËNIMIN ME BURGIM.
    - **ANGLISHT**
      - PRACTICE DIRECTION ON PROCEDURE FOR THE PROPOSAL, CONSIDERATION OF AND PUBLICATION OF AMENDMENTS TO THE RULES OF PROCEDURE AND EVIDENCE OF THE INTERNATIONAL TRIBUNAL
      - PRACTICE DIRECTION ON PROCEDURE FOR THE FILING OF WRITTEN SUBMISSIONS IN APPEAL PROCEEDINGS BEFORE THE INTERNATIONAL TRIBUNAL
      - PRACTICE DIRECTION ON PROCEDURE FOR THE INVESTIGATION AND PROSECUTION OF CONTEMPT BEFORE THE INTERNATIONAL TRIBUNAL

- PRACTICE DIRECTION ON FORMAL REQUIREMENTS FOR APPEALS FROM JUDGEMENT
- PRACTICE DIRECTION ON THE LENGTH OF BRIEFS AND MOTIONS
- PRACTICE DIRECTION ON THE PROCEDURE FOR THE DETERMINATION OF APPLICATIONS FOR PARDON, COMMUTATION OF SENTENCE AND EARLY RELEASE OF PERSONS CONVICTED BY THE INTERNATIONAL TRIBUNAL
- PRACTICE DIRECTION ON THE PROCEDURE FOR THE REVIEW OF WRITTEN SUBMISSIONS WHICH CONTAIN OBSCENE OR OTHERWISE OFFENSIVE LANGUAGE
- PRACTICE DIRECTION ON THE PROCEDURE FOR THE INTERNATIONAL TRIBUNAL'S DESIGNATION OF THE STATE IN WHICH A CONVICTED PERSON IS TO SERVE HIS/HER SENTENCE OF IMPRISONMENT

- **FRËNGJISHT**
  - DIRECTIVE PRATIQUE RELATIVE À L'APPRÉCIATION DES DEMANDES DE GRÂCE, DE COMMUTATION DE LA PEINE ET DE LIBÉRATION ANTICIPÉE DES PERSONNES CONDAMNÉES PAR LE TRIBUNAL INTERNATIONAL
  - DIRECTIVE PRATIQUE RELATIVE AUX CONDITIONS FORMELLES APPLICABLES AU RECOURS EN APPEL CONTRE UN JUGEMENT
  - DIRECTIVE PRATIQUE ÉTABLISSANT LA PROCÉDURE À SUIVRE POUR L'EXAMEN DES ÉCRITURES QUI CONTIENNENT DES PROPOS CHOQUANTS OU INSULTANTS
  - DIRECTIVE PRATIQUE RELATIVE À LA LONGUEUR DES MÉMOIRES ET DES REQUÊTES
  - DIRECTIVE PRATIQUE RELATIVE AUX MODALITÉS DE PROPOSITION, D'EXAMEN ET DE PUBLICATION DES MODIFICATIONS APPORTÉES AU RÉGLEMENT DE PROCÉDURE ET DE PREUVE DU TRIBUNAL PÉNAL INTERNATIONAL POUR L'EX-YOUGOSLAVIE
  - DIRECTIVE PRATIQUE RELATIVE À LA PROCÉDURE DE DÉPÔT DES ÉCRITURES EN APPEL DEVANT LE TRIBUNAL INTERNATIONAL
  - DIRECTIVE PRATIQUE DÉFINISSANT LA PROCÉDURE À SUIVRE POUR ENQUÊTER SUR LES OUTRAGES AU TRIBUNAL INTERNATIONAL ET EN POURSUIVRE LES AUTEURS
  - DIRECTIVE PRATIQUE RELATIVE À LA PROCÉDURE QUE DOIT SUIVRE LE TRIBUNAL INTERNATIONAL POUR DÉSIGNER L'ÉTAT DANS LEQUEL UN CONDAMNÉ PURGERA SA PEINE D'EMPRISONNEMENT
- **ZYRA E PROKURORIT**
  - SHEMBULL I NJË AKTPADIE TË TPNJ-së DRAGOMIR MILOSEVIC
- **ORGANIGRAMA E ORGANIZATËS**
  - DIAGRAMI I ORGANIZATËS
- **PAGESAT PËR PROCESIN PARAGJYQËSOR**
  - SKEMA E PAGESËS PËR FAZËN PARAGJYQËSORE
  - SKEMA E PAGESËS PËR FAZËN E GJYKIMIT
- **MARRËVESHJET E PRANIMIT TË FAJËSISË**
  - MARRËVESHJA E PRANIMIT TË FAJËSISË SË OBRENOVIC-it
- **SEKRETARIA**
  - **SSHKGJ**
    - KODI I ETIKËS PËR PËRKTHYESIT ME GOJË DHE ME SHKRIM TË PUNËSUAR PREJ TRIBUNALIT PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË
  - **SMGjSh**
    - DIREKTIVË PËR SEKSIONIN E ADMINISTRIMIT DHE NDIHMËS GJYQËSORE TË SHËRBIMIT PËR NDIHMË GJYQËSORE TË SEKRETARISË
  - **DOKUMENTET PËRKATËSE TË AVOKATIT MBROJTËS**
    - KODI I SJELLJES PROFESIONALE PËR AVOKATË TË MBROJTJES QË PARAQITEN NË TRIBUNALIN NDËRKOMBËTAR_KORRIK 2009
    - POLITIKA PËR UDHËTIMET DHE DIETAT E MBROJTJES – JANAR 2007
    - DIREKTIVA PËR EMËRIMIN E AVOKATËVE TË MBROJTJES_QERSHOR 2006
  - **UDHËZIMET E PUNËS**
    - DIRECTIVE PRATIQUE RELATIVE A LA PROCEDURE DE MODIFICATION DES REGLEMENTS ETABLIS PAR LE GREFFIER
    - DIRECTIVE PRATIQUE RELATIVE A LA MISE EN OEUVRE DE L'ARTICLE 92 bis (B) DU REGLEMENT DE PROCEDURE ET DE PREUVE (IT19)
    - DIREKTIVA E PRAKTIKËS PËR PROCEDURËN E ZBATIMIT TË RREGULLËS 92bis(B) TË RREGULLORËS SË PROCEDURAVE DHE TË PROVAVE
    - DIREKTIVA E PRAKTIKËS PËR PROCEDURËN E NDRYSHIMIT TË RREGULLAVE TË NXJERRA PREJ SEKRETARIT

- **SVD /SEKSIONI I VIKTIMAVE DHE DËSHMITARËVE/**
  - DIREKTIVA MBI DIETAT PËR DËSHMITARËT DHE DËSHMITARËT EKSPERTË
- **RREGULLORJA E PROCEDURËS DHE PROVAVE**
  - RREGULLORJA E PROCEDURËS DHE PROVAVE
- **NJPKB /NJËSIA E PARABURGIMIT E KOMBEVE TË BASHKUARA/**
  - MARRËVESHJA PËR SIGURINË DHE RREGULLIN (NËNSHKRUAR MË 14 KORRIK 1994)
  - APLIKIM PËR LEJE PËR TË VIZITUAR NJË TË PARABURGOSUR Ë NJËSINË E PARABURGIMIT TË TPNJ
  - CAKTIMI I AUTORITETIT TË INSPEKTIMIT PËR NJËSINË E PARABURGIMIT - 1995
  - URDHRI PËR SEKRETARIN QË TË NDAJË TË NDALUARIT E DËNUAR DHE TË PADËNUAR QË MBAHEN NË NJËSINË E PARABURGIMIT
  - REGULLAT PËR CAKTIMIN E NJË PROCEDURE ANKESASH PËR TË
  - RREGULLAT PËR CAKTIMIN E NJË PROCEDURE DISIPLINORE PËR.
  - RREGULLORE PËR MBIKËQYRJEN E VIZITAVE DHE KOMUNIKIMEVE ME TË PARABURGOSURIT
  - RREGULLORJA E PARABURGIMIT TË PERSONAVE NË PRITJE TË GJYKIMIT OSE APELIT NË TRIBUNAL OSE TË ARRESTUAR NË EMËR TË TRIBUNALIT
  - RREGULLAT E BRENDSHME PËR TË PARABURGOSURIT

Parathënie

Ky Manual është produkt i bashkëpunimit midis Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë (TPNJ-ICTY) dhe Institutit Kërkimor Ndër-rajonal të Kombeve të Bashkuara për Krime dhe Drejtësi (UNICRI). Një nga veçoritë dalluese të Kryesisë së Tribunalit nga Gjykatësi Pocar ka qenë theksi që i ka vënë trashëgimisë së TPNJ-së si një pjesë e rëndësishme e Strategjisë Përmbyllëse të tij. Në këtë drejtim, Kryetari Pocar e parashikoi përfundimin e mandatit të TPNJ-së si vazhdim të punës së tij nga juridiksione të tjera vendore dhe si një partneritet afatgjatë me autoritetet vendore. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me UNICRI-në, i cili mori përsipër kryerjen e këtij aktiviteti në kuadër të programit të tij, Kontrolli i Sigurisë në Zonat pas Konfliktit, dhe nën kryesinë e Kryetarit Pocar, ky Manual synon të ruajë trashëgiminë e TPNJ-së në formën e një modeli të praktikave të tij për t'u përdorur nga gjykata të tjera ndërkombëtare dhe të vendore. Ky manual u përgatit me ndihmën dhe kontributin e një numri pjesëtarësh të stafit të TPNJ-së nga të gjitha organet e Tribunalit. Materiali u mblodh dhe përgatit për UNICRI-në nga një Komitet Shqyrtimi i TPNJ-së, i përbërë nga Jon Hocking, Zëvendëssekretar, Catherine Marchi-Uhel, Kryetare e Dhomave, Gavin Ruxton, Shef i Prokurorisë dhe Gabrielle McIntyre, Shefe Kabineti. Komiteti i Shqyrtimit i TPNJ-së punoi ngushtësisht me UNICRI-në, e cila ndihmoi në hartimin e Manualit në bazë të informacioneve të dhëna nga TPNJ-ja. Ekipi i UNICRI-së përbëhej nga anëtarët e Laboratorit të tij të Kundër-terrorizmit dhe Kontrollit të Sigurisë: që janë, Massimiliano Montanari, Menaxher programi, i cili bashkërendoi iniciativën në emër të UNICRI-së, Gjykatësi Roberto Bellelli dhe Prokurori Jesus Santos, Këshilltarët shkencorë të UNICRI-së, Alma Pintol, Francesco Miorin dhe Madhawa Tennakoon, konsulentë dhe bashkëpunëtorë të UNICRI-së. Redaktimi i Manualit u ndërmor nga Z. Russel Weaver, Profesor i të drejtës, me mbështetjen e Mariamah Crona, Jessica Peake, dhe Alice Burani, konsulentë të UNICRI-së. Matteo Di Pane punoi për kompozimin dhe anën grafike të tij. Përveç sa më sipër, disa anëtarë të shquar të botës akademike kontribuuan në të, përmes dhënies së mendimeve rreth metodologjisë së përdorur për paraqitjen e Manualit.

Anëtarë të stafit që dhanë ndihmesë në përmbajtjen e këtij Manuali përfshijnë Ken Roberts, Guido Acquaviva, Evelyn Anoya, Tilman Blumenstock, Valeria Bolici, Augustus De Witt, Joakim Dungel, Sabrina Fofana, Linda Murnane, Matthew Gillett, Martin Petrov, Wayde Pittman, Thilan Legierse, Nerma Jelačić, dhe Liam McDowall.

Trashëgimia e TPNJ-së duhet ruajtur përmes vazhdimit të ndjekjes penale të krimeve të luftës nga juridiksionet vendore të ish-Jugosllavisë. Në këtë drejtim, ky Manual synon posaçërisht të ndajë me këto juridiksione praktikat e Tribunalit, me shpresën se ato mund të jenë të dobishme në procedimet e tyre penale. Por, ky Manual ka gjithashtu edhe një qëllim shumë më të gjerë, që është dhënia e informacionit nga ata që janë ngushtësisht të përfshirë në proces për të gjitha juridiksionet vendore dhe ndërkombëtare që përballen me detyrën e procedimit të krimeve të kryera gjatë konfliktit të armatosur me shpresën se ato gjithashtu mund të ndihmohen në detyrën e tyre nga praktikat dhe mësimet e nxjerra nga TPNJ-ja. Në atë drejtim, ky Manual thekson rolin kyç të UNICRI-së si një Institut Ndërrajonal i KB-së në rajonin e Ballkanit dhe në vende të tjera në mbarë botën që janë të prekur nga konfliktet.

Shpresojmë se ky Manual jep udhëzime dhe ide të vyera për të gjitha ata që merren me procedimin penal të kriminelëve të pretenduar të luftës.

Hagë, 16/11/2008

Fausto Pocar
Kryetar, TPNJ

Sandro Calvani
Drejtor, UNICRI

I. Hyrje

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) u krijua nga rezoluta 827 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 25 maj 1993, si një masë e përkohshme për të kontribuar në restaurimin e ruajtjes së paqes në ish-Jugosllavi, pasi Këshilli i Sigurimit përcaktoi se situata në ish-Jugosllavi përbënte një kërcënim ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Si organ vartës i Kombeve të Bashkuara, TPNJ-ja u ngarkua me detyrën e vështirë të ndjekjes penale të personave të akuzuar për shkelje të rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare (DNH) të kryera në territorin e Ish-Jugosllavisë që nga 1991-shi. Individëve nuk ju është dashur të përballen me një gjykatë ndërkombëtare për kryerjen e barbarizmave në masë që nga Tribunalet Ushtarakë Ndërkombëtarë të Nurembergut dhe Tokios, të krijuar pas Luftës së Dytë Botërore. Për herë të parë në histori komuniteti ndërkombëtar, dhe jo vetëm fitimtarët e kohës së luftës, veproi për të krijuar një tribunal për ndjekjen penale të personave në mënyrë që të frenohej kryerja e krimeve të tjera, që të silleshin fajtorët përpara drejtësisë, dhe të kontribuohej në restaurimin e ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Pak kohë pas kësaj, një tribunal tjetër i përkohshëm, Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën (TPNR), u krijua në vitin 1994 për të ndjekur penalisht personat e akuzuar që kishin kryer gjenocid dhe shkelje të tjera të rënda të DNH-së në Ruandë. Procesi me anë të të cilit u krijuan të dyja institucionet, nëpërmjet një rezolute të Këshillit të Sigurimit, ishte krejtësisht i ri dhe për disa i diskutueshëm; por pranohet gjerësisht se vendimi i Këshillit të Sigurimit për të krijuar Tribunalet e përkohshëm përbën një arritje në luftën kundër mosndëshkimit dhe një përparim të madh në të drejtën ndërkombëtare.

Krijimi i TPNJ-së ishte një katalizator për një tendencë në rritje të gjykimit të individëve për thyerje të DNH-së, veçanërisht në arenat e konflikteve të armatosura. Nuk mund të nënvlerësohet ndikimi i punës së TPNJ-së, që në kohën e krijimit ishte ende një besim i paprovuar në idenë se e drejta ndërkombëtare humanitare jo vetëm që është e zbatueshme, por mundet të kontribuojë në rivendosjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Në hapat e para të krijimit të TPNJ-së ka pasur një interes në rritje brenda komunitetit global në administrimin e drejtësisë penale ndërkombëtare që individët të përgjigjen për krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin, siç është provuar gjatë viteve të fundit nga përhapja e shpejtë e gjykatave dhe tribunaleve ndërkombëtare e tribunaleve të përbëra penale në vende të ndryshme të botës. Nuk ka dyshim se tribunalet e përkohshme të ish-Jugosllavisë dhe Ruandës kanë përshpejtuar zhvillimin e statutit të gjykatës kriminale universale, që arriti pikën më të lartë me adoptimin e Statutit të Romës në vitin 1998. Po ashtu është e pamohueshme se zhvillimi i organeve gjyqësore të mbështetura nga komuniteti ndërkombëtar nuk përfundoi me krijimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GJPN), siç u tregua nga krijimi i paneleve të përziera nga administrimi i Kombeve të Bashkuara (KB) në Kosovë në vitin 2000, Gjykata e Posaçme për Siera Leonen në vitin 2002, Panelet e Posaçme për Krimet e Rënda në Timorin Lindor në vitin 2002 si dhe Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias në vitin 2003. Fenomeni i shumimit të shpejtë mundet që të vazhdojë edhe pasi GJPN-ja të ketë zgjeruar numrin e çështjeve, pjesërisht për shkak të nevojave për të sjellë fajtorët përpara drejtësisë për krime të kryera përpara se Statuti i Romës të hynte në fuqi.

Përveç vënies përpara përgjegjësisë të individëve, krijimi i TPNJ-së shënoi një hap të fuqishëm në kuptimin se Shtetet duhet t'i ndjekin penalisht individët për shkelje të DNH-së në zbatim të ligjit të tyre vendor në pajtim me standardet ndërkombëtare. TPNJ-ja u krijua pasi institucionet vendase në rajon nuk ishin në gjendje të ndiqnin penalisht çështje të tilla në atë kohë. Prandaj Statuti ofroi mënyra që TPNJ-ja të mbronte epërsinë e saj ndaj gjykatave kombëtare. Megjithatë, Gjykatës nuk mund t'i jepej juridiksioni ekskluziv mbi të gjitha shkeljet e DNH-së

të kryera në territorin e Ish-Jugosllavisë. Prandaj nuk pati kurrë si synim të vepronte si një zëvendësim i plotë i gjykatave kombëtare në rajon, të cilat padyshim luajnë një rol thelbësor për t'u siguruar se drejtësia funksionon, se është promovuar pajtimi dhe ju është sjellë përmbyllje familjeve dhe viktimave të luftës.

Në vitin 2003, duke pranuar se kapaciteti vendas ishte rritur, Këshilli i Sigurimit të KB-së miratoi rezolutën 1503 (2003), duke udhëzuar TPNJ-në që të transferonte të gjitha akuzat e nivelit të ulët e të mesëm në rajon që të gjykoheshin nga gjykatat vendase. Në të njëjtën kohë, Këshilli i Sigurimit i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar të ndihmonte juridiksionet kombëtare në përmirësimin e kapaciteteve të tyre që të ndiqnin penalisht çështjet e krimeve të luftës. Në mënyrë të ngjashme, sipas parimit plotësues në Statutin e Romës, GJPN-ja ka juridiksion bashkëveprues me Shtetet mbi individët e akuzuar për kryerjen e këtyre krimeve. GJPN-ja ushtron juridiksionin e saj vetëm në çështjet kur një gjykatë kombëtare nuk mundet ose nuk dëshiron të ndjekë penalisht krimet. Kjo dispozitë ligjore e GJPN-së, demonstron qartë se komuniteti ndërkombëtar ka një interes të pakushtëzuar që të sigurohet se gjykatat e Shteteve kanë përgjegjësi për kryerjen e gjykimeve ndaj autorëve të krimit që kanë kryer krimet ndërkombëtare më të rënda në pajtim të plotë me standardet përkatëse të procesit.

Në kuadër të funksionit të saj plotësues, TPNJ-ja ka punuar aktivisht për të forcuar kapacitetin e sistemeve juridike kombëtare në ish-Jugosllavi për të ndjekur penalisht shkeljet e DNH-së në pajtim me standardet ndërkombëtare më të larta. Kjo është një detyrë e përshkruar si tejet e rëndësishme nga Këshilli i Sigurimit për të zbatuar strategjinë e përmbylljes së TPNJ-së, e cila ofron një përmbyllje në faza dhe të bashkërenduar të mandatit historik të Tribunalit deri në fund të vitit 2011 dhe vazhdimin e punës së Tribunalit nga institucionet vendase.

Në pajtim me politikën e bashkëpunimit të TPNJ-së me juridiksionet vendase në ish-Jugosllavi, TPNJ-ja ka dërguar një numër të akuzuarish në nivel të ulët dhe të mesëm që të gjykohen në rajon. Për më tepër, që nga viti 1996 deri 2004, nëpërmjet procesit të Rregullave Rrugore të përcaktuara nga Marrëveshja e Romës në shkurt të 1996-s, TPNJ-ja ka rishikuar mbi një mijë dosje çështjesh vendore në Bosnje dhe Hercegovinë, që çuan në arrestimin e 848 personave që do të gjykohen në gjykatat vendore për akuza të krimeve të luftës. Në vitin 2004, ky proces u transferua në Zyrën e Prokurorit të Bosnje Hercegovinës, gjë e cila po siguron aktualisht se çështjet më të ndjeshme të krimeve të luftës po dëgjohen në nivel Shteti.

Ndërkohë që proceset e TPNJ-së po i afrohen fundit, është bërë gjithnjë e më e rëndësishme të theksohet përgjegjësia e përbashkët e juridiksioneve ndërkombëtare dhe kombëtare në ndjekjen penale dhe parandalimin e krimeve të luftës, si dhe krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet gjykatave ndërkombëtare dhe vendase është thelbësor për të ruajtur largimin radikal nga një kulturë e mosndëshkimit dhe adoptimin e një kulture të përgjegjësisë. Nga kjo pikëpamje, përfundimi i mandatit të TPNJ-së duhet parë si një strategji e krijuar për të lejuar vazhdimin nga aktorët vendas të aktiviteteve që janë nisur nga TPNJ-ja. Roli nismëtar i TPNJ-së, dhe puna e pashembullt e vendimet juridike do të jenë arritja më e rëndësishme, dhe vazhdimi i punës nëpërmjet ndjekjeve penale vendore të krimeve të luftës nga gjykatat në rajon do të jetë trashëgimia e vërtetë.

Megjithatë proceset penale për shkelje të DNH-së në nivel vendas do të dalin me sukses vetëm nëse institucionet vendase kanë burime të mjaftueshme dhe kapacitet të duhur për të kryer gjyqe penale komplekse të kësaj natyre. Qëllimi i këtij Manuali është që të kontribuojë në këtë proces të ngritjes së kapaciteteve nga shkëmbimi i eksperiencës së TPNJ-së dhe vendosja e praktikave në ndjekjen penale dhe gjykimin e çështjeve komplekse. Juridiksionet e tjera ndërkombëtare dhe të përziera po ashtu do të përfitojnë nga kjo punë, në mënyrë që njohuritë e zhvilluara nga TPNJ-ja të mund të ofrojnë udhëzim në sfidat e vënies së drejtësisë.

II. Metodologjia

Përpilimi i një Manuali që ofron një pamje të përgjithshme të përvojës dhe praktikave të vendosura nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë (TPNJ) është një përpjekje ambicioze, e cila paraqet dy sfida të konsiderueshme. Së pari, është e vështirë të përçohet një sasi kaq e madhe informacioni duke mbajtur një nivel të lartë "përpikërie shkencore". Së dyti, është po aq e vështirë të organizohet informacioni dhe përmbajtja në mënyrë të tillë që të sigurohet përdorimi nga një gamë e gjerë e grupeve të synuara.

Manuali është përgatitur mbi bazat e informacionit zyrtar dhënë ekskluzivisht nga TPNJ-ja dhe përpilimi, organizimi dhe paraqitja e tij janë lehtësuar nga UNICRI. Edhe pse Zyra e Presidentit, Dhomat, Prokuroria dhe Sekretaria kanë funksione të ndryshme brenda TPNJ-së, personel me përvojë nga secila prej këtyre degëve ka kontribuar në hartimin e Manualit, duke promovuar një gjuhë të përbashkët që mund të kuptohet nga një numër i gjerë përdoruesish. Për më tepër, janë përdorur metodologji të ndryshme për ta bërë këtë publikim një mjet referimi të lehtë për t'u përdorur.

Ndërkohë që disa nga kapitujt janë organizuar në pajtim me kronologjinë e proceseve në TPNJ, disa të tjerë janë vendosur veças për të lejuar shpjegimin e detajuar të koncepteve kritike që janë të përbashkëta në disa ose në të gjithë kapitujt e mësipërm.

Edhe pse TPNJ-ja, që nga fillimi i saj, ka zhvilluar një mori praktikash, ato më të efektshmet janë përzgjedhur mbi bazat e kritereve të mëposhtme:

- zbatueshmëria e gjerë (pavarësisht kontekstit rajonal dhe institucional);
- qasja novatore;
- përfitimet (për një numër më të madh shtetesh/gjykatash);
- ndihma e jurisprudencës;
- mundësia për të promovuar kursime (si kur bëhet fjalë për kursim të kohës ashtu dhe të burimeve).

Manuali thekson faktorët praktik në dy mënyra. Së pari, Manuali përdor kuti shembujsh të cilat lidhin diskutimin ligjor direkt me jurisprudencën e Gjykatës. Së dyti, Manuali përfshin ushtrime praktike që e ndihmojnë lexuesin të formojë koncepte mbi procedura dhe ide komplekse.

Kjo pamje e përgjithshme e praktikave të TPNJ-së synon të shërbejë si mjet referimi për politik-bërësit në nivel global dhe kombëtar, për ata që punojnë me ligjin dhe gjykata të tjera ndërkombëtare, të ndërkombëtarizuara ose hibride. Për më tepër, ky Manual i ofron UNICRI-së, si një entitet i plotë i KB-së, një metodë për të promovuar trashëgiminë e gjykatave penale ndërkombëtare.

III. Tiparet e Veçanta të Lëndëve Gjyqësore me Krime Lufte, Krime Kundër Njerëzimit dhe Gjenocid

1. Edhe pse përvoja e TPNJ-së ishte unike, cilitdo sistem që merret me ndjekjen penale të shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare (DHN) i duhet të rreket me shumë prej të njëjtave sfida. Këto lëndë gjyqësore dallojnë thellësisht nga proceset e zakonshme penale të brendshme, ngaqë kanë të bëjnë me krime të kryera në fushën e konfliktit të armatosur. Mirëpo, edhe pse, në TPNJ, të gjitha krimet e gjykuara kanë ndodhur brenda fushës së konfliktit të armatosur, janë vetëm krimet e luftës ato që kërkojnë lidhjen me të drejtën ndërkombëtare. Krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidi janë krime të cilat mund të kryhen si në kohë paqeje, edhe në kohë lufte.

2. Luftërat në të cilat ndodhin shkeljet e DHN-së shpesh përfshijnë zona shumë të mëdha gjeografike, zgjasin disa vjet dhe përfshijnë një larmi vepruesish, duke përfshirë edhe forcat ushtarake dhe paraushtarake si edhe mercenarët. Krimet e kryera shpesh shkaktojnë me qindra, në mos me mijëra viktima, dhe baza e provave të mundshme është masive. Për pasojë, siç e dëshmon edhe përvoja e TPNJ-së, përgatitja e një procesi të vetëm gjyqësor mund të zgjasë me vite. Gjithashtu, për shkak të kompleksitetit dhe madhësisë së çështjeve dhe për shkak të vëllimit të provave të mundshme, hetimet shpesh vazhdojnë edhe pasi ka filluar procesi gjyqësor, duke qenë se prokuroria zbulon boshllëqe në bazën e provave të lëndës dhe përpiqet t'u përgjigjet këtyre boshllëqeve.

3. Me fillimin e proceseve gjyqësore, mund të lindin shumë probleme të tjera të cilat e vështirësojnë menaxhimin e procesit, mbrojtjen e duhur të dëshmitarëve dhe viktimave dhe kundërpërgjigjen ndaj tentativave për ndërhyrje. Madje, kompleksiteti i lëndëve gjyqësore kërkon nga gjyqtarët që të ndjekin qasje të ndryshme për pranimin dhe vlerësimin e dëshmisë së dëshmitarëve, kundrejt atyre që mund të përdornin në një proces të zakonshëm penal të brendshëm. Krimet janë kryer në periudha kaosi dhe stresi të pamasë dhe, në përgjithësi, shumë vjet përpara seancës dëgjimore. Si rezultat, nga lënda në lëndë, dëshmitarët mund të japin nivele të ndryshme informacioni të hollësishëm lidhur me identitetin e kryesit dhe kohën e vendin e incidentit. Për këtë arsye, dhomat gjyqësore në përgjithësi nuk i trajtojnë si zhvlerësim të dëshmisë këto mungesa të informacioneve të hollësishme apo këto mospërputhje të vogla në dëshmitë e dëshmitarëve të ndryshëm, sa kohë që dëshmitari e rrëfen thelbin e incidentit në fjalë me hollësi të mjaftueshme.

4. Në shumicën e rasteve, të paktën disa viktima dhe dëshmitarë nuk janë të gatshëm të dëshmojnë nëse TPNJ-ja nuk u ofron garanci për mbrojtje vetjake. Megjithëse identiteti i dëshmitarit mund të mbrohet në mënyrë të mjaftueshme nga publiku i gjerë, përmes pseudonimeve dhe shtrembërimit të zërit, mbrojtja e plotë mund të garantohet vetëm nëse gjykata e merr dëshminë e dëshmitarit në fjalë në seancë me dyer të mbyllura. Në disa raste, natyra e dëshmisë ia nxjerr identitetin dëshmitarit ose ia vë jetën në rrezik.

5. Meqë i pandehuri ka të drejtën themelore ta dijë identitetin e akuzuesve, ekipit të mbrojtjes i jepet gjithmonë identiteti i dëshmitarit. Por, kur identiteti i dëshmitarit është delikat, atëherë ai mund të bëhet i ditur më afër kohës së parashikuar për dhënien e dëshmisë përpara gjykatës nga ky dëshmitar. Në të gjitha rastet kur identiteti i dëshmitari i bëhet i ditur mbrojtjes, mbrojtja ka detyrimin ligjor të mos e bëjë të ditur identitetin më shumë nga sa është rreptësishtë e nevojshme për përgatitjen e pistës mbrojtëse. Shkelja e kërkesës për informim të kufizuar ka shkaktuar çeljen e proceseve gjyqësore për mosbindje ndaj gjykatës, përpara TPNJ-së. Në disa raste, dëshmitarët kanë qenë objekt frikësimi të vazhdueshëm përpara fillimit të procesit gjyqësor, çka ka bërë që dëshmitarët të mos ishin të gatshëm për të dëshmuar përpara TPNJ-së. Në

rrethana të tilla, gjyqtarët kanë lëshuar urdhër-paraqitje për dëshmitarët, të cilat jo të gjitha kanë qenë të suksesshme, në varësi të mundësisë dhe dëshirës së shteteve për të bashkëpunuar në zbatimin me forcë të këtyre urdhrave.

6. Në disa raste, rreziku i vlerësuar që i kanoset dëshmitarit lidhur me dhënien e dëshmisë në gjykatë kërkon zhvendosjen e tij në një vend tjetër pas dhënies së dëshmisë. Rrjedhimisht, TPNJ-së i duhet të identifikojë një vend që të jetë i gatshëm për ta pranuar dëshmitarin dhe për të organizuar bashkimin e tij me familjen. Kur dëshmitari i "ka lyer duart me gjak", TPNJ-ja mund ta ketë të vështirë të gjejë një shtet të gatshëm për ta pranuar, dhe kalimi në një shtëpi të re mund të jetë tejet i vështirë për të gjithë personat e përfshirë. Në shumë raste, dëshmitari i zhvendosur nuk e flet gjuhën e vendit ku e kanë çuar dhe nuk është në gjendje të gjejë një punë që t'ia vlejë. Këto vështirësi komplikohen edhe më shumë, shpesh ngaqë dëshmitari largohet nga të afërmit dhe miqtë e tij, e shkon në një shoqëri të huaj nga aspekti kulturor. Pas zhvendosjes, çdo tentativë që bën dëshmitari për t'u lidhur me të afërmit dhe miqtë që ka lënë pas mund t'ia vërë jetën në rrezik.

7. Mund të lindin edhe një tërësi problemesh lidhur me mundësinë e TPNJ-së për të marrë prova që kanë lidhje me çështjen, për të vendosur zinxhirin e marrjes në shoqërim të provave në fjalë dhe për të siguruar që provat e mara të jenë të pranueshme si për prokurorinë ashtu edhe për mbrojtjen. Për shembull, një aspekt i rëndësishëm i procedurave të TPNJ-së ka qenë strategjia e prokurorisë për t'i marrë të gjitha provat përmes përdorimit të urdhër-bastisjeve dhe urdhër-sekuestrove me objekt të gjerë të cilët i lejonin Prokurorisë të merrte shënimet ushtarake dhe arkivat shtetërore, shumë prej të cilave lidhen me ngjarjet që kanë ndodhur me vite përpara fillimit të konfliktit. Për prokurorinë, kjo qasje ka qenë e domosdoshme për shkak të nevojës për të ruajtur integritetin e provave që, përndryshe mund të ishin shkatërruar në funksion të shmangies së dhënies llogari. Mirëpo, për shkak të metodave të saj, prokuroria shtiu në dorë rreth pesë milion dokumente, për të cilat doli nevoja të arkivoheshin në atë mënyrë që të arriheshin me lehtësi. Meqë të pandehurit në një proces penal ndërkombëtar i jepen të gjitha garancitë që u ofrojnë të pandehurve gjykatat e brendshme kur e zbatojnë plotësisht sundimin e ligjit, prokuroria ndodhet gjithmonë nën detyrimin për ta ndihmuar mbrojtjen duke i bërë të ditur provat përkatëse, përfshirë këtu edhe provat shfajësuese. Prokurorisë i është dashur të përballet me vështirësi të konsiderueshme gjatë përmbushjes së detyrimeve të saj përpara gjykatës. Edhe pse mbrojtja e mbështet punën e saj te fakti nëse i përmbush apo jo prokuroria detyrimet, ajo, nga ana e vet, e ka të kufizuar detyrimin për t'i bërë të ditura argumentet e veta mbrojtëse. Kjo marrëdhënie detyrimi dhe varësie, midis prokurorisë dhe mbrojtjes, ka qenë e vështirë të gjejë pajtim me të drejtat e të pandehurit dhe sidomos me të drejtën për të qëndruar i heshtur.

8. Edhe varësia e prokurorisë te bashkëpunimi nga ana e shteteve për hetimet dhe mbledhjen e provave paraqet vështirësi të cilat nuk ekzistojnë në proceset penale të brendshme. Për pasojë, gjyqtarët e TPNJ-së shumë herët kanë mbajtur qëndrimin se kyç për suksesin e Tribunalit është bashkëpunimi me Shtetet dhe jo sjellja shtrënguese ndaj tyre. Kështu, ai u ka kërkuar palëve të përdorin të gjitha mjetet e mundshme për marrjen e provave, përmes marrëveshjeve, përpara se të kërkojë ndërhyrjen gjyqësore për të arritur me forcë bashkëpunimin. Disa Shtete në rajon nuk kanë qenë gjithmonë të gatshme për sigurimin e provave ose kanë qenë të gatshme vetëm në bazë të kushteve të diktuara prej tyre. Për të shmangur ndërhyrjen e gjyqësorit, Shtetet shpesh shfaqin qëndrim bashkëpunues, ndërsa, në të vërtetë, nuk i përmbushin plotësisht detyrimet e tyre. Në vend që të bashkëpunojnë me Tribunalin, Shtetet e ish-Jugosllavisë vazhdimisht e kanë penguar punën e Tribunalit në aspekte të rëndësishme. Por, Shtete të tjera Anëtare të OKB-së shpesh zotërojnë sasi të mëdha materiali të rëndësishëm ose mund të japin dëshmi të rëndësishme për Tribunalin. Prokuroria dhe Mbrojtja mund të hasin në vështirësi sa i takon qasjes në këto prova sepse Shteti tjetër mund të druajë se mos

dhënia e informacionit mund të zbulojë praktikat e tij në lidhje me informatat apo përzierjen e tij në mbështetje të një pale të caktuar të konfliktit. Në funksion të bashkëpunimin me Shtetet, Tribunali ka hartuar një procedurë ku parashikohet dorëzimi i provave në mënyrë konfidenciale, dhe ku parashikohet që provat të mos bëhen të ditura pa pëlqimin e atij që i ka siguruar. Kjo, nga ana e vet, krijon një mori problemesh sa i takon drejtësisë dhe transparencës së proceseve, ku duhet arritur një drejtpeshim midis interesave kundërshtuese.

9. Në fillim, Prokurorisë i ishte dhënë një shkallë e madhe fleksibiliteti në parashtrimin e aktakuzave dhe i ishte lejuar ta kishte sa më të gjerë objektin e aktakuzës. Sipas procedurës së Tribunalit, një gjyqtar i vetëm shqyrtues merrte në shqyrtim aktakuzën e Prokurorisë dhe vendoste nëse kishte apo jo Prokuroria argumente *prima facie* në lidhje me secilën prej pikave të aktakuzës. Standardi i zbatuar ishte i ulët dhe, në praktikë, kërkonte paraqitjen në njëfarë shkalle të disa provave, pavarësisht cilësisë së provave. Nëse përmbushej kjo, aktakuza konfirmohej dhe Prokurorisë i jepej leja të vazhdonte procedurën me të. Me dhënien e këtij fleksibiliteti për prokurorinë, sa i takon paraqitjes së aktakuzës dhe shqyrtimit të aktakuzave, Gjyqtarët tregonin mirëkuptim lidhur me vështirësitë që haste prokuroria në paraqitjen e lëndëve me një kompleksitet të tillë. Mirëpo, Gjyqtarët filluan të tregojnë më pak fleksibilitet kur filluan të jenë më të ndjeshëm ndaj vështirësive në të cilat hasnin të pandehurit gjatë përgatitjes së mbrojtjes së tyre kundër këtyre aktakuzave kaq të gjera. Me kalimin e kohës, Gjyqtarët filluan të kuptojnë edhe se si këto aktakuza të gjera ndikonin negativisht në cilësinë e lëndëve gjyqësore. E parë nga sot, mbase standardi *prima facie* i përdorur nga Gjyqtarët në konfirmimin e aktakuzës ishte tepër i ulët. Me kundërpërgjigjen ndaj kësaj situate, TPNJ-ja ka krijuar një sasi të konsiderueshme jurisprudence lidhur me praktikat e paraqitjes së çështjes, çka ka nisur një proces kontrolli më të madh gjyqësor mbi cilësinë dhe objektin e aktakuzave në Tribunal.

10. Krahas përpunimit të formës së parashtresave të Prokurorisë, Gjyqtarët kanë hartuar edhe metoda që synojnë ta zvogëlojnë sasinë e dëshmisë gojore përpara trupit gjykues, përmes përdorimit të dëshmive me shkrim, për të pasur mundësi të shfrytëzojnë vëllimin e stërmadh të provave me të cilat kishin të bënin. U hartuan rregulla për të mundësuar pranimin e fakteve të gjykuara nga lëndë të tjera gjyqësore dhe përdorimin e deklaratave me shkrim në vend të marrjes në pyetje në sallë nga pala që e thërret dëshmitarin. Me kalimin e kohës, u zhvilluan metoda të tjera shtesë, për të siguruar që këto procese komplekse të gjykoheshin sa më shpejt dhe në mënyrë sa më efikase. Forca shtytëse në themel të këtyre reformave ka qenë synimi për të respektuar të drejtën e të pandehurve për një gjykim të drejtë dhe të përshpejtuar.

11. Procesi gjyqësor i TPNJ-së është ndërlikuar më tej nga e drejta e pandehurve për ta mbrojtur vetë veten (e drejta e vetëpërfaqësimit). Në shumë raste, duket se të pandehurit kanë vendosur të mbrohen vetë jo sepse janë të bindur se janë më të zotë se avokatët, por për shkak të dëshirës për ta përdorur sallën e gjyqit si podium politik. Kjo situatë i ka shtyrë gjyqtarët ta kufizojnë sasinë dhe objektin e provave të paraqitura, për të përfshirë vetëm ato që janë të lidhura me çështjen, për të parandaluar që salla e gjyqit e TPNJ-së të përdoret si foltore politike. Kjo situatë ka krijuar vështirësi edhe për prokurorinë sa i takon dhënies së informacionit për provat, sidomos në lidhje me identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur. Probleme kanë lindur edhe sa i takon objektit të burimeve që i takojnë të pandehurit të vetë-përfaqësuar të marrë nga Zyra e Mbrojtjes Ligjore dhe Çështjeve të Burgimit dhe nga Njësia e Burgimit e OKB-së, për të paraqitur mbrojtjen e vet. Probleme të tjera kanë lindur edhe lidhur me të drejtën për të kërkuar dokumente në gjuhë të tjera (veç anglishtes dhe frëngjishtes, të cilat janë gjuhët punuese të TPNJ-së). Duke pasur parasysh vëllimin e materialeve të përfshira, këto probleme kanë paraqitur pengesa të konsiderueshme për zhvillimin e përshpejtuar të proceseve.

12. Në shkallën e apelit, kanë lindur probleme lidhur me përkthimin e aktgjykimit të shkallës së parë në një gjuhë të cilën e kupton apeluesi. Në disa raste, TPNJ-ja ka qenë e shtrënguar ta pezullojë tërësisht seancën e informimit paragjyqësor, në pritje të përkthimit të aktgjykimit, çka ka sjellë vonesa disamujore. Sikurse edhe në procesin gjyqësor të shkallës së parë, TPNJ-ja ka hasur probleme në proceset me të pandehur të vetë-përfaqësuar. Krahas kësaj, procesi i apelit ndërlikohet nga fakti se mund të dalin prova të reja gjatë apelit (për shembull, mund të gjendet informacion nga arkivat e rajonit), dhe palët mund të kërkojnë në apel futjen e mijëra faqeve prova të cilat nuk gjendeshin në procesin e shkallës së parë.

13. Kohëzgjatja e procesit dhe vëllimi i provave të përfshira mund të përbëjnë sfidë për gjyqtarët, kur ata vlerësojnë provat dhe hartojnë aktgjykimet e formës së prerë. Në shumicën e rasteve, gjyqtarët duhet të lexojnë tekstin e zbardhur, i cili përfshin një vëllim të madh provash shkresore, me qindra dëshmitarë dhe kohën e kaluar prej çeljes së procesit gjyqësor. Parë në këtë kontekst, rëndësi të madhe ka organizimi i procesverbalit të gjyqit gjatë përgatitjes për debatin gjyqësor dhe hartimi i aktgjykimit final.

14. Për shkak të faktit se TPNJ-ja ndodhet gjeografikisht larg prej komuniteteve të prekura, ajo përballet me vështirësi të konsiderueshme në punën e saj që proceset dhe aktgjykimet të jenë të arritshme nga këto komunitete. Këto vështirësi janë trajtuar, pjesërisht, përmes transmetimit në rajon të proceseve. Mirëpo, transparenca e proceseve të TPNJ-së vështirësohet nga detyrimi ligjor për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve dhe nga domosdoshmëria për ta mbajtur informacionin delikat jashtë syve të publikut. Gjyqet janë të gjata dhe shpesh dominohen nga çështjet e vështira juridike dhe procedurale të provave dhe, duke qenë gjykatë, shumë shpesh është jo e përshtatshme që TPNJ-ja të merret me shtrembërimet e mediave lokale lidhur me proceset gjyqësore në zhvillim. Edhe pse gjyqet kanë për qëllim të jenë një prej mjeteve të arritjes së paqes dhe pajtimit, detyra gjyqësore e TPNJ-së është, në fakt, disi e ngushtë në objektin e vet. Megjithëse TPNJ-ja e pranon se reputacioni i tij ka pësuar rënie në komunitetet e prekura, ajo ka bërë shumë punë për të shpjeguar punën e saj përmes veprimtarive komunikimit dhe ndërgjegjësimit të cilat synojnë eliminimin e miteve të orkestruara nga autoritetet politike të vendeve të rajonit.

IV. Hetimet

A. Konsideratat paraprake.....12
A.1 Një qasje shumë-disiplinore.....12
A.2 Mbikëqyrja juridike e hetimeve.....12
A.3 Hetimet financiare.....13
A.4 Përgjegjësia komanduese.....13
B. Hapja e një hetimi.....14
B.1 Ditari i hetimeve.....14
C. Zgjedhja e objekteve të hetimit.....14
D. Mbledhja e informacionit.....16
D.1 Hetimet modulare.....16
D.2 Misionet hetuese.....16
D.3 Zhvarrosja dhe identifikimi i mbetjeve njerëzore.....17
D.4 Grumbullimi i dëshmive (bastisja dhe sekuestrimi).....18
D.5 Kërkesa për ndihmë juridike.....18
D.6 Burimet e ndjeshme.....19
D.7 Viktimat/dëshmitarët e rrezikuar.....20
D.8 Dëshmitarët.....21
D.8.1 Kontaktet e para nga hetuesit e Prokurorisë.....21
D.8.2 Mbrojtja e burimeve të ndjeshme dhe dëshmitarëve të rrezikuar.....22
D.8.3 Përgatitja për intervistën e dëshmitarit.....22
D.8.4 Intervistimi i dëshmitarëve.....23
D.8.5 Regjistrimi i kontakteve me dëshmitarët.....24
D.9 Intervistimi i viktimave të sulmeve seksuale.....25
D.10 Intervistimi i dëshmitarëve ekspertë.....26
D.11 Intervistimi i të dyshuarve.....26
E. Menaxhimi i informacionit 27
E.1 Mbrojtja e informacionit të ndjeshëm.....27
E.2 Përdorimi, përpunimi dhe ruajtja e provave.....28
E.3 Zinxhiri i ruajtjes.....28
E.4 Analizimi i dëshmive.....28
F. Rëndësia e dëshmive demografike.....30
IV. Shtojca 1: Plani i hetimit.....31
IV. Shtojca 2: Parimet udhëzuese për zhvarrosjet.....34
IV. Shtojca 3: Parimet udhëzuese për intervistimin e viktimave të sulmeve seksuale.....35

1. Fytyra publike e TPNJ-së është procesi i saj gjyqësor. Ajo që shikon bota është aktiviteti në sallën e gjyqit, që përfshin paraqitjet fillestare të të akuzuarve, gjyqet dhe apelet. Megjithatë, procesi gjyqësor varet fillimisht nga zbulimi dhe hetimi i krimeve. Detyrimisht, hetimet nuk kryhen në sferën publike: ato kryhen me aq fshehtësi sa mund të arrihet. Për këtë arsye është e lehtë të nënvleftësohet shtrirja e aktivitetit hetues të TPNJ-së, veçanërisht në rastet që përfshijnë krime famëkeqe e në shkallë të gjerë që mbulohen gjerësisht nga media. Në fazat e hershme të procedime të tribunalit të krimeve të luftës, hetimi përbën pjesën kryesore, në mos tërësinë e punës operacionale dhe mund të përfshijë një detyrë tejet të madhe.

2. Sipas statutit të TPNJ-së, detyra e hetimit i takon Prokurorit, të cilit i jepet fuqia për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe pa kërkuar autorizim të mëtejshëm. Neni 18 përcakton:

> *Prokurori fillon hetimet ex officio ose në bazë të informacionit të marrë nga çfarëdo burimi, veçanërisht nga Qeveritë, organet e Kombeve të Bashkuara, organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare. Prokuroi do të shqyrtojë informacionin e marrë ose të gjetur dhe do të vendosë nëse ka baza të konsiderueshme për të vazhduar.*

3. Statuti po ashtu i jep Prokurorit fuqinë të marrë në pyetje të dyshuarit, viktimat dhe dëshmitarët dhe të grumbullojë dëshmi e të bëjë hetime në vendngjarje. Në fazën fillestare të aktivitetit hetues të TPNJ-së, ishte politika e Prokurorit të shpjegonte në publik se si po kryheshin hetimet, por të mbante detajet operacionale të hetimeve të veçanta rreptësisht të fshehta. Po ashtu politika ishte që hetuesit e Gjykatës të shkonin tek burimi origjinal i informacionit, dhe jo të mbështeteshin thjeshtë tek informacioni dhënë nga të tjerët.

4. Në fazat fillestare të hetimit, veçanërisht në mes të një konflikti të armatosur, mund të jetë e vështirë të dërgohen hetues në terren. Kur u krijua TPNJ-ja konflikti ishte ende i ndezur në ish-Jugosllavi dhe ishte shumë e rrezikshme të bëheshin hetime në vendngjarje. Megjithatë, disa hetime fillestare dhe misione të kufizuara

në terren ishin të mundura pasi shumë persona të shpërngulur dhe refugjatë nga zonat e prekura ishin në dispozicion si dëshmitarë. Në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe më vonë në Kosovë, hetuesit u dërguan në terren sapo u paraqit mundësia pas forcave ndërkombëtare të IFOR-it [1] dhe KFOR-it.[2] Në javët dhe muajt që ndoqën u kryen hetime në vendngjarje, që përfshinë edhe një program të konsiderueshëm zhvarrosjesh. Aktivitetet e tjera të grumbullimit të dëshmive përfshinë ekzaminimin e vendeve të krimeve, operacione të kërkimit dhe sekuestrimit të dokumenteve, si dhe intervistime të dëshmitarëve. Rreth 10,000 dëshmitarë janë intervistuan nga Zyra e Prokurorit që nga viti 1994, dhe koleksioni total i dëshmive tani përmban 8 milion faqe dokumentesh. TPNJ-ja është depozita më vete më e madhe e informacionit rreth krimeve të kryera në ish-Jugosllavi gjatë konfliktit.

5. Edhe pse hetimet paraprijnë dhe përforcojnë procedimet gjyqësore, është e rëndësishme të kuptohet se hetimet nuk ndërpriten kur fillojnë gjykimet. Përkundrazi, mundet që ato edhe të intensifikohen. Dëshmi të reja mund të dalin në pah në fazën e apelit ose shumë kohë pas shpalljes së fajësisë. Për këtë arsye të gjitha parashikimet për preventivat e buxhetit duhen bërë duke kuptuar se do të ketë nevojë për një komponent hetimi në të gjitha fazat e ekzistencës së tribunalit.

A. Konsideratat paraprake

A.1 Një qasje shumë-disiplinore

6. Hetimi i shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare kërkon një qasje shumë-disiplinore, dhe kërkon ekipe pune specialistësh të cilët ofrojnë një gamë aftësish dhe mundësish. Eksperienca ka treguar se përveç hetuesve me një të kaluar tradicionale në polici, ekipeve ju deshëm shërbimet e ushtarakëve, analistëve të krimeve dhe të politikës, historianëve, demografëve, specialistëve mjeko-ligjorë dhe linguistëve. Të gjitha grupet e hetuesve mund të mësojnë nga njëri-tjetri, dhe është thelbësore që të gjithë të kuptojnë strukturën ligjore të çështjeve dhe kërkesat ligjore për të grumbulluar dëshmi.

7. Ndërkohë që paraqitet nevoja për të punësuar hetues me aftësi tradicionale policore në punën me dëshmitarë dhe prova, shpesh eksperienca në polici në punën me hetimet mbi mashtrimet e rënda, hetimet financiare ose krimin e organizuar është veçanërisht e dobishme për çështjet komplekse e me shumë dokumente të krimeve të luftës. Hetuesit duhet të kenë mëndje kureshtare dhe dëshirë që të lexojnë shumë për t'u familjarizuar me të gjitha rrethanat e çështjes.

8. Në stade të ndryshme të hetimit, theksi mund të ndryshojë në vartësi të aftësive të kërkuara në ekipin hetues. Disa pjesë të një hetimi, për shembull, mund të përfshijnë zhvarrosjen nga varret masive, ose mund të jenë përqendruar më intensivisht në grumbullimin e dëshmive, kurse ekzaminimi i arkivave mund të jetë një ushtrim shumë më analitik. Eksperienca po ashtu ka treguar se është thelbësore për ekipin e hetimit të ketë udhëzime të forta ligjore që në fillim.

A.2 Mbikëqyrja juridike e hetimeve

9. Puna hetuese duhet t'i paraprijë të gjitha aktiviteteve të tjera operacionale. Fillimisht në TPNJ u krijua një Sektor Hetimesh nën komandimin menaxhues të një ish-oficeri të lartë të policisë. Natyra e punës për të gjetur faktet që herët, dhe aftësitë që duheshin në atë kohë, kërkuan që ekipet hetuese të organizoheshin

1 'Forca e Implementimit' të NATO-s në Bosnje dhe Hercegovinë
2 'Forca në Kosovë' e NATO-s

nën udhëheqjen e oficerëve policorë me eksperiencë. Ekipet kishin për detyrë të kryenin hetime të fshehta mbi krimet që dihej se ishin kryer në zona të ndryshme nga grupe të ndryshme autorësh të krimeve. Prokurorët punonin bashkë me ekipet hetuese si këshilltarë. Më vonë, kur të akuzuarit u ndaluan dhe filluan gjykimet, Avokatët e Lartë Gjyqësor u përfshinë gjithnjë e më shumë në drejtimin e hetimeve, dhe puna e hetuese u përqendrua gjithnjë e më shumë në mbështetjen e gjykimeve. Në fund, ndërkohë që përfunduan hetimet e fundit të rasteve të reja dhe u lëshuan paditë e fundit nga Gjykata, Seksioni i Hetimeve u bashkua me Seksionin e Prokurorisë, duke reflektuar faktin se puna e hetuesve dhe prokurorëve ishte bërë e pandashme deri në kohën e fazës së gjykimit. Në çfarëdo mënyre që ndahet puna ndërmjet hetuesve dhe avokatëve, është një praktikë e mirë të kihet informacion juridik i konsiderueshëm në hetime sa më herët që të jetë e mundur. Vendimet që merren në fillim, për shembull se si do të regjistrohen deklaratat e dëshmitarëve, mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në një fazë të mëvonshme në një çështje. Zyra e Prokurorit të TPNJ-së ka lëshuar udhëzime të brendshme që përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e Avokatëve Gjyqësor. Udhëzimet theksojnë *inter alia*:

- nevojën për të pasur një kuadër ligjor për hetime;
- rëndësinë për të qenë të mirinformuar me zhvillimet juridike;
- përfitimin nga konsultimi me specialistë të ligjit mbi konfliktet e armatosura;
- nevojën për një plan hetimi me udhëzim ligjor.

A.3 Hetimet financiare

10. Mundësitë që dalin nga hetimet në çështjet financiare nuk duhet të shpërfillen. Edhe pse forcat e armatosura duhet t'i mbajnë të dhënat financiare, veçanërisht në lidhje me burimin e fondeve (p.sh., shpërndarja e grupeve paraushtarake dhe grupeve të tjera jo të rregullta jo gjithnjë mund të reflektohet në shifrat e buxhetit), ekziston gjithnjë mundësia e lidhjeve ndërmjet ndërluftuesve dhe krimit të organizuar. Për këtë arsye, një hetim financiar i bërë nga specialistë të trajnuar në praktikat e kontabilitetit dhe veprimet bankare mund të japë rezultate më të mira.

A.4 Përgjegjësia komanduese

11. Një kujdes i veçantë i duhet kushtuar çdo hetimi i cili eksploron përgjegjësinë komanduese të një eprori për aktet e vartësve të tij. Është gabim, dhe një kurth i mundshëm, që akuzat e përgjegjësisë komanduese të trajtohen si një opsion i lehtë, ose si një pozicion i sigurt kur nuk mund të merret dëshmia e drejtpërdrejtë për përfshirjen më të drejtpërdrejtë të komandantit në kryerjen e një krimi nga vartësit e tij. Ndërkohë që u zhvillua jurisprudenca e TPNJ-së, u bë gjithnjë e më e qartë se mund të jetë e vështirë të provohet përgjegjësia eprore (p.sh., të provuarit se i akuzuari zotëronte *kontroll të efektshëm* mbi vartësit e tij). Provimi i sjelljes negative, si mosparandalimi ose mosdënimi i një krimi të kryer nga vartësit, po ashtu mund të kërkojë përpjekje të konsiderueshme nga ana e prokurorisë. Së fundi, do të jetë e nevojshme të ekzaminohen strukturat dhe mekanizmat juridike për të raportuar dhe dënuar sjelljet kriminale që kanë qenë në dispozicion në kohën përkatëse. Kjo mund të bëjë të nevojshme identifikimin e dëshmitarëve që njohin procedurat ushtarake ose procesverbalet e gjykimit si një mënyrë për të treguar mundësinë e eprorit për të marrë masa, si edhe mosveprimin e tij ose neglizhime të tjera. Ekspertë ushtarakë ose dëshmitarë të tjerë mund të duhet të shpjegojnë sistemin e komandimit dhe të japin një opinion mbi përgjegjësitë dhe neglizhimet e komanduesit nën hetim. Duhet treguar kujdes edhe për të ruajtur një teori koherente të çështjes së prokurorisë. Për shembull, një komandant i cili urdhëron ose është përndryshe përfshirë në një krim është ndryshe nga një komandant i cili merr njoftim rreth krimit dhe nuk merr masa. Ekziston një rrezik i

vërtetë që një hetim të ngatërrojë dy skenarët e veçantë, për shembull, kur dëshmitë rrethanore mund të mbështesin të dyja rastet.

B. Hapja e një hetimi

12. Vendimi për të hapur një hetim duhet të dokumentohet siç duhet, dhe procesi duhet të ndjekë kriteret e caktuara. Këto kritere nuk është e nevojshme të bëhen publike, por duhet të ofrojnë një kuadër për aktivitetet e hetuesve, përfshi përcaktimin e një plani hetimi, përcaktimin e fokusit të hetimit, dhe përvijimin e fazave të ndryshme të operacioneve. Plani duhet të përfshijë një vlerësim nëse pista të veçanta të hetimit kanë gjasa të prodhojnë rezultate të shëndosha provash, dhe duhet të përcaktojë qartë kuadrin ligjor në të cilit duhet të futet prova. Plani duhet po ashtu të përfshijë përllogaritje të burimeve, duhet të përvijojë nevojën për shërbime të specializuara dhe caktimin e detyrave, si the të krijojë një afat kohor për përfundimin e hetimit. Një plan i detajuar i kësaj natyre, aprovuar nga një nivel i lartë ofron qartësinë e nevojshme dhe kuptimin nga të gjithë të përfshirët në hetim (shiko Shtojcën 1: *Plani i hetimeve*).

13. Udhëzimet për Hapjen e Hetimeve të Reja të lëshuara nga Zyra e Prokurorit theksojnë nevojën për një propozim me shkrim për të diskutuar çështjet e mëposhtme:

- rrethanat e krimeve dhe autorët e akuzuar të krimeve;
- faktorët strategjik;
- teoria e padisë dhe karakterizimi i krimeve;
- roli, pozicioni, autoriteti dhe njohuritë të autorit të akuzuar për krime;
- statusi i informacionit dhe provave;
- koha dhe burimet e kërkuara.

B.1 Ditari i hetimeve

14. Për shkak se hetimet e mëdha komplekse shpesh përfshijnë dhjetëra persona që punojnë në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të mbahet një ditar kronologjik i të gjitha aktiviteteve hetuese të bëra në çështje. Ditari duhet të përmbajë emrin e hetuesit, përshkrimin e llojit të aktivitetit hetues, datën e aktivitetit, dhe një referencë me rezultatin e punës së gjeneruar nga hetimi. Ditari nuk duhet të regjistrojë vetëm aktivitetet hetuese që japin rezultate pozitive, por edhe ato që japin rezultate negative. Në disa raste fakti se ka pasur rezultate negative do të jetë i rëndësishëm për hetime në të ardhmen.

C. Zgjedhja e objekteve të hetimit

15. Çdo konflikt i armatosur që përfshin aktivitete kriminale të rënda ka të ngjarë të përfshijë një numër të madh viktimash, dëshmitarësh dhe autorësh të krimeve, dhe nuk do të jetë e mundur ose praktike për të hetuar të gjitha krimet ose çdo të akuzuar të mundshëm. Duhen bërë zgjedhje se kush duhet ndjekur penalisht, dhe këto zgjedhje ka shumë të ngjarë që të udhëhiqen nga dy faktorë: mandati i autoritetit gjyqësor dhe mundësia e sigurimit të provave. Një mandat i qartë do të lejojë zhvillimin e hershëm të një strategjie hetimi, e kjo nga ana tjetër do të lejojë që të grumbullohen dëshmitë në mënyrë të organizuar për çështje të veçanta të prokurorisë.

16. Megjithatë, nuk duhet të pritet që çështjet më komplekse ose të nivelit të lartë të përgatiten në fillim. Një Gjykatë apo Njësi e Krimeve të Luftës e sapokrijuar nuk do t'i kuptojë mirë kompleksitetet e ngjarjeve me të cilat përballet, dhe një kuptim më i plotë do të zhvillohet vetëm kur të grumbullohen njohuri të specializuara, të bëhen hetime dhe ekspertiza të brendshme. Ndërkohë që një përshtypje e përgjithshme e krimeve të më rënda mund të krijohet që në hapat e parë të një hetimi, ka gjasa që do të duhen shumë muaj kërkimesh të vështira që hetuesit të krijojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të strukturës së komandimit dhe roleve të udhëheqësve individualë.

17. Për shkak se të gjitha ndjekjet penale kërkojnë që të provohet përgjegjësia penale individuale, prokurorët dhe hetuesit duhet të bëjnë kujdes të mos supozojnë fajësi kolektive për grupe të tëra. Megjithatë, mund të ketë situata në të cilat është e arsyeshme të hetohet një udhëheqës i veçantë, dhe të përqendrohen burimet në strukturat e komandimit që e lidhin atë individ me krime të veçanta. Gjithsesi, rezultati më i mirë ka gjasa të arrihet duke kombinuar një qasje "nga lartë poshtë" dhe "nga poshtë lartë". Veçanërisht në fazat fillestare të një hetimi, prokurorët dhe hetuesit duhet të mos e paragjykojnë përgjegjësinë e individëve, e duhet të jenë të përgatitur të marrin parasysh prova kontradiktore, të ndryshojnë drejtimin e hetimit, dhe të shmangin përqendrimin thjesht në përpjekjen për të krijuar një çështje selektive ndaj një individi të caktuar për shkak të zbulimit të hershëm të ndonjë prove që duket se e ngarkojnë me faj atë individ.

18. Për të vendosur se çfarë dhe kush duhet të hetohet, hetuesit duhet të bëjnë zgjedhje. Udhëzimet për hetimet të Zyrës së Hetuesit të TPNJ-së në lidhje me fillimin e hetimeve dhe zgjedhjen e objekteve të hetimeve kanë theksuar *inter alia* faktorët e mëposhtëm:
    - rëndësinë e krimeve, numrin e viktimave, kohëzgjatjen e shkeljes dhe shkallën e shkatërrimit;
    - rolin e personit nën hetim, veçanërisht pozicionin e tij në hierarkinë politike ose ushtarake, shtrirjen e autoritetit të tij, dhe pjesëmarrjen e tij të pretenduar në krimet nën hetim;
    - nëse personat dhe krimet që hetohen kanë qenë veçanërisht famëkeqe, edhe pse personi nuk kishte një pozicion hierarkik zyrtar.

19. Udhëzimet po ashtu sugjerojnë se duhen marrë parasysh faktorët praktikë kur vendoset nëse duhet filluar një hetim. Këto gjëra përfshijnë faktorë të tillë si mundësinë për arrestim, dhe mundësinë për të siguruar provat e nevojshme. Në përgjithësi, personat nuk janë hetuar nëse nuk mbanin rangje të larta, dhe krimet të cilat përbëheshin nga një incident i vetëm nuk justifikonin hetimin e izoluar dhe ato u lanë të shqyrtoheshin nga gjykatat vendore.

20. Së fundi Këshilli i Sigurimit konfirmoi parimin se Gjykata duhet të përqendrohet në ndjekjen penale të udhëheqësve më të lartë të cilët dyshoheshin të ishin më përgjegjësit për krimet brenda juridiksionit të TPNJ-së. Gjykata pritej t'i transferonte çështjet e tjera - ato që përfshinin individë me një nivel të ulët përgjegjësie - tek juridiksionet kompetente kombëtare.

21. Strategjia e përgjithshme e hetimit (dhe ndjekjes penale) e gjykatës duhet rishikuar vazhdimisht, dhe mund të ketë situata ku strategjia duhet rishikuar rrënjësisht. Në TPNJ kjo gjë ndodhi në dy raste: së pari për të hequr një numër çështjesh të nivelit të ulët nga lista e aktakuzave pasi Zyra kishte ngritur padi të suksesshme ndaj figurave më të larta; dhe së dyti kur kërkesat e strategjisë së përmbylljes së Gjykatës kërkuan të merrej vendim se cilat prej objektivave duheshin ndjekur në kohën e mbetur. Duhet theksuar edhe se çështjet e caktuara për transferim nga forumi ndërkombëtar në juridiksionin kombëtar duhet të hetohen mirë dhe duhet të përgatiten në mënyrë që transferimet të mos konsiderohen si zgjidhje pa harxhime.

D. Mbledhja e informacionit

22. Hetimi i krimeve mund të duhet të fillojë gjatë një konflikti të armatosur, edhe pse mund të mos ketë kushte të sigurta për të kryer hetime në vend dhe identiteti i autorëve të krimeve mund të dihet. Edhe kur hetuesit kanë mundësi të kufizuara për të punuar në vendngjarjen e krimit dhe me dëshmitarët, është e rëndësishme të fillojë procesi i mbledhjes së dëshmive sa më parë që të jetë e mundur. Në këtë stad të hershëm, hetuesit do të kenë mundësi unike për të mbledhur dhe ruajtur provat në vendngjarjen e krimit, dhe këto mundësi duhen shfrytëzuar kurdo që është e mundur.

23. Shumë institucione humanitare, dhe agjenci të tjera, po ashtu mund të punojnë në terren gjatë ose menjëherë pas konfliktit të armatosur, dhe personeli i tyre mund të ofrojë sugjerime ose këshilla se kush janë përgjegjësit për krime dhe kush duhet të ndiqet penalisht. Palët në një konflikt të armatosur mund të denoncojnë edhe krime të kryera nga armiqtë e tyre. Shumica e këtij informacioni kërkon verifikim të kujdesshëm, dhe nuk duhet mbështetur në të pa rezerva gjatë përzgjedhjes së çështjeve që të ndiqen penalisht. Është më mirë që institucionet dhe agjencitë, të nxiten të regjistrojnë të dhënat e dëshmitarëve potencialë, përfshi sidomos informacionin se ku mund të kontaktohen në të ardhmen, por nuk duhet të nxiten që të përpiqen të marrin deklarata të hollësishme të dëshmitarëve. Ata duhet që thjesht të regjistrojnë në një mënyrë të përgjithshme deklaratat e dëshmitarëve potencialë mbi eksperiencat e tyre të drejtpërdrejta, dhe duhet të kuptojnë se marrja e deklaratave është një proces profesional që është më mirë t'i lihet sistemit të drejtësisë penale dhe hetuesve të trajnuar. Është një praktikë e mirë t'ju lëshohen udhëzime agjencive të jashtme në lidhje me praktikat e duhura.

D.1 Hetimet modulare

24. Gjatë punës së një prokurori ndërkombëtar ka të ngjarë që disa hetime t'ju përkasin ngjarjeve të njëjta apo të ngjashme. Për shembull, për krime të kryera në një qytet të veçantë, një hetim mund të ekzaminojë përgjegjësinë e udhëheqësve politikë vendas ndërkohë që një hetim tjetër mund të ekzaminojë rolin e një figure ushtarake të lartë nga një shtet i tretë. Kurdo që të jetë e mundur, këto fusha të përbashkëta të hetimit dhe prova duhet të identifikohen dhe hetohen duke plotësuar në mënyrë efikase kërkesat e të gjitha hetimeve me të cilat janë të lidhura. Megjithatë, hetuesit duhet të pranojnë faktin se hetimi i një ngjarjeje të vetme që është e lidhur me dy hetime të ndryshme mund të kompromet ojë që të dyja hetimet duke prodhuar konkluzione kontradiktore. Një hetim i vetëm i krijuar për të formuar një pamje të besueshme dhe të saktë të ngjarjeve duhet ndërmarrë në mënyrë të tillë që të grumbullojë dhe të ruajë të gjitha provat e nevojshme për hetimet e mëtejshme përkatëse. Në mënyrë që kjo të ndodhë, hetimet duhet të jenë modulare, d.m.th., të jenë të përgatitura dhe të organizuara në mënyrë uniforme, dhe metodat e arkivimit të dosjeve dhe mbledhjes së provave duhet të jenë të standardizuara në mënyrë që ato të përfshihen lehtë dhe të bëhen pjesë e dosjeve të çështjeve të tjera.

D.2 Misionet hetuese

25. Meqenëse qendra e TPNJ-së ishte në Hagë, domethënë jashtë territorit të ish-Jugosllavisë, Zyra e Prokurorëve u detyrua të dërgonte personel në rajon, dhe këto ekipe të personelit në terren që kryenin hetimet thuhej se ishin “me mision”. Edhe pse Zyrat në Terren u krijuan në secilin prej shteteve të ish-Jugosllavisë për të lehtësuar punën hetuese, u preferua që hetuesit të qëndronin në zyrën kryesore të Prokurorit në Hagë, dhe jo të punonin gjithnjë larg Gjykatës. Pas kalimit të një farë kohe në terren, veçanërisht nëse hetuesit punonin në kushte ose klima të vështira, atyre ju duhej të kthehesin në zyrën qendrore për të analizuar dhe përpunuar

informacionin e grumbulluar. Në mënyrë që të lehtësohej puna në terren, Zyra e Prokurorit të TPNJ-së hartoi udhëzime të detajuara për procedurat e misionit, duke detajuar në veçanti procedurat për dërgimin e ekipeve në rajon për të kryer hetimet.

D.3 Zhvarrosja dhe identifikimi i mbetjeve njerëzore

26. Zyra e Prokurorit së TPNJ-së ndërmori një punë të madhe për zhvarrosjen e eshtrave në një përpjekje për të përmbushur disa objektiva: të merreshin prova në lidhje me identitetin e viktimave të vrara gjatë konfliktit; të përcaktoheshin rrethanat dhe shkaqet e vdekjes; të lidheshin varret masive parësore dhe dytësore; dhe të zbuloheshin përpjekjet për të mbuluar krimet. Për shembull, në Kosovë rreth 2000 trupa u zhvarrosën nga ekipet që punonin për Zyrën e Prokurorit - që përbënte rreth 50% të gjithë 4000 trupave të zhvarrosur në Kosovë në një periudhë dyvjeçare. Në disa ndjekje penale provat mjekoligjore luajtën një rol kritik në gjykatë, por zhvarrosje të tjera nuk zbuluan ndonjë provë të përshtatshme për çështjet e TPNJ-së. Edhe pse e gjithë puna mjekoligjore në fillim ishte kryer si pjesë e hetimit penal, shumë vendvarrime të raportuara nuk përmbanin mbetje njerëzore, ose nuk kishin lidhje me ndjekjet penale aktuale. Përsëri, zhvarrosjet i shërbyen një qëllimi të vlefshëm sepse ato ndihmuan për të informuar të afërmit se të dashurit e tyre nuk ishin në vendet që ata mendonin se ishin. Ndërkohë që rezultatet e hetimeve penale duhet të shkëmbehen me agjencitë e tjera që merren me personat e humbur, zhvarrimet dhe punët e tjera shkencore nuk duhen ndërmarrë nga gjykata përveçse kur qëllimi i tyre ka të bëjë me një hetim penal.

27. Zhvarrosja e varreve masive është një punë komplekse dhe e shtrenjtë që përfshin disa disiplina shkencore dhe kërkon ndihmë të specializuar nga burime të jashtme. Zhvarrosjet me kosto më efikase janë ato që bëhen nga agjencitë e jashtme me ndihmën e personelit të gjykatës. Zyra e Prokurorisë në TPNJ eksperimentoi me një numër organizimesh që përfshinë OJQ-të dhe specialistët e ofruar nga disa shtete pa kosto përpara se të vendoste përfundimisht një sistem ku mori kontrollin parësor mbi të gjitha veprimet. Organizimet më të thjeshta përfshinë autopsi që bëheshin në vendndodhjen e zhvarrosjeve në një morg fushor. Kur kjo gjë nuk ishte e mundur, për shembull për shkak të furnizimit të pamjaftueshëm të ujit, u deshën organizime më të ndërlikuara dhe të kushtueshme që përfshinin transportin deri tek një morg. Organizimi më i mirë ishte që autoritetet kombëtare të caktonin një ekip të plotë policie të kriminalistikës në një projekt për zhvarrimet e gjykatës, dhe jo të ofroheshin hetues individual të specializuar, veçanërisht kur këto vende kishin edhe kontingjente trupash në vend që mund të mbështesnin operacionin.

28. Është jetike që stadet e ndryshme të një hetimi të ecin me të njëjtin ritëm dhe në mënyrë të koordinuar. Nëse kufomat zhvarrosen më shpejt se sa mund të bëhen autopsitë, do të dalin probleme, veçanërisht nëse kufomat nuk janë skeletizuar ende, dhe janë ruajtur në qese biologjikisht të degradueshme. Probleme të ngjashme do të krijohen nëse agjencitë që organizojnë kthimin e trupave familjeve nuk kanë burime të mjaftueshme për të ecur me ritmin e punës së morgut.

29. Komandimi dhe kontrolli i kontribuuesve të jashtëm është një çështje tejet e rëndësishme. Këto ekipe duhet të zbatojnë urdhrat dhe standardet minimale të Gjykatës. Prandaj është një praktikë e mirë që të kihet një strukturë e qartë e komandimit për një projekt zhvarrimi me një anëtar të vetëm të personelit të Gjykatës përgjegjës që kontrollon operacionin që nga zhvarrosja deri tek ri-varrosja. Një ekspert mjekoligjor arkeolog ose antropolog i lartë duhet të drejtojë zhvarrosjet aktuale dhe një patolog me eksperiencë duhet të drejtojë morgun dhe autopsitë. Një nga këta të dy duhet të caktohet si shkencëtari udhëheqës i tërë projektit. Gjithashtu duhet të ketë një shef të punimeve në terren për të drejtuar hollësitë logjistike. Do të ishte më mirë nëse shef është një person me përvojë logjistike, me një të kaluar ushtarake. Në vendndodhjet e

zhvarrosjeve nevojitet personel i sigurisë me eksperiencë dhe i pjekur, për të ruajtur morgjet dhe për t'u kujdesur për sigurinë dhe disiplinën.

30. Pasi puna më e madhe e zhvarrimeve të prokurorisë u përfundua, Zyra e Prokurorit nuk mund të justifikonte më tej mbajtjen e kapacitetit të zhvarrimeve në nivelin e mëparshëm. Kur më vonë u raportuan varre masive, iu kërkua autoriteteve vendore dhe agjencive të tjera të bënin zhvarrimet dhe të ekzaminonin trupat për Gjykatën duke përdorur metoda të përpiluara që të plotësonin kërkesat e saja për provat. Në përgjithësi, kjo praktikë ka qenë efikase dhe e efektshme. (Shikon Shtojcën 2: *Parimet Udhëzuese për Zhvarrosjet*)

D.4 Grumbullimi i dëshmive (bastisja dhe sekuestrimi)

31. Është e rëndësishme që të ketë procedura të detajuara për grumbullimin e dëshmive. Ato të përdorura nga Zyra e Prokurorit të TPNJ-së theksonin ndjekjen e procedurave të përgjithshme të grumbullimit.
   - mirëmbajtja dhe zinxhiri i zotërimit (zinxhiri i kujdestarisë);
   - paketimi i duhur i sendeve;
   - etiketimi dhe regjistrimi i saktë i sendeve;
   - ruajtja e origjinaleve duke i përdorur dhe ruajtur siç duhet.
32. Nganjëherë, duhet të organizohen misione të veçanta për të sekuestruar në vend dëshmitë. Dëshmitë e duhura shpesh gjenden në godina zyrtare në zona të mbrojtura nga autoritetet vendore që nuk duan të bashkëpunojnë dhe mund të merren vetëm duke ekzekutuar një urdhër bastisjeje. Misione të tilla kërkojnë planifikim të kujdesshëm operacional, bashkërendim dhe fshehtësi që të arrijnë objektivat e tyre. Zyra e Prokurorit të TPNJ-së u lëshoi hetueseve udhëzime të brendshme mbi bastisjet dhe sekuestrimet e provave që përfshinin:
   - procedurat ligjore për kërkesat mbi urdhrat e bastisjes;
   - ekzekutimin e urdhrave të bastisjes, përfshi udhëzimet mbi bashkëpunimin me organet ndërkombëtare dhe përdorimin e forcës së arsyeshme;
   - nevojën për siguri të veçantë (mbi baza të informimit të nevojshëm) dhe planifikim të përpiktë;
   - llojet e shënimeve dhe dokumenteve që duhet kërkuar.

D.5 Kërkesa për ndihmë juridike

33. Në mënyrë që të zbatohet me efikasitet detyra për të hetuar dhe ndjekur penalisht personat e akuzuar që kanë kryer shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare, Zyrës së Prokurorit ju dha kompetenca për të kërkuar (ose në disa raste për të urdhëruar) bashkëpunimin dhe ndihmën juridike të Shteteve ose organeve Ndërkombëtare.

34. Prokurorët kërkuan ndihmën e Shtetërore ndër të tjera për:
   - identifikimin edhe vendndodhjen e personave;
   - marrjen e dëshmive nga dëshmitarët;
   - dorëzimin e provave;
   - dhënien e dokumenteve;
   - arrestimin ose ndalimin e personave;
   - arrestimin e një të dyshuari apo të akuzuari;
   - dorëzimin ose transferimin e të akuzuarit;
   - thirrjen e detyrueshme ose intervistimin e dëshmitarëve dhe të dyshuarve;
   - grumbullimin e provave;
   - grumbullimin e informacionit;

- kryerjen e hetimeve në vendngjarje;
- sekuestrimin e provave fizike.

35. Hetuesit mund të kërkojnë bashkëpunim zyrtar nga organet e ndjekëse dhe juridike të Shtetit nëpërmjet Kërkesave për Ndihmë (KPN). Përveç kërkesave që dërgohen, një gjykatë e specializuar ose një njësi e krimeve të luftës do të marrë kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellët nga Shtete dhe organe të tjera ndërkombëtare në lidhje me hetimet dhe ndjekjet penale të krimeve të luftës në çështjet e brendshme. Zyra e Prokurorit duhet të caktojë personel dhe kohë të mjaftueshme që të jetë në gjendje t'i përgjigjet siç duhet Kërkesave për Ndihmë që vijnë dhe t'u japë Shteteve kërkuese informacionin që kërkojnë.

36. Në mënyrë që Zyra e Prokurorit të marrë ndihmë efektive ligjore dhe që Shtetet t'i japin ndihmë ligjore efikase Zyrës së Prokurorit, duhen vendosur procedura të rrepta të brendshme për shqyrtimin e Kërkesave për Ndihmë. Nëse kjo ndodh, do të jetë shumë më e lehtë për të verifikuar dëshirën e shteteve për të bashkëpunuar. Procedurat e dobëta e bëjnë të vështirë që Shtetet me dëshirën e mirë të bashkëpunojnë, dhe do ta bëjnë më të lehtë që Shtetet pa dëshirën e mirë të zvarrisin dhe të ankohen. Ankesat tek TPNJ-ja nxorën në pah kërkesa që ishin shumë të paqarta ose të hartuara shumë gjerësisht, ose që përmbanin afate të pamundshme. Ankesat nxorën në pah acarimin dhe mungesën e komunikimit ndërmjet Zyrës së Prokurorit dhe Shteteve individuale ose Organeve Ndërkombëtare. Për këtë arsye ishte e rëndësishme që Zyra e Prokurorit të krijonte dhe mbante marrëdhënie të mira me diplomatët e punonjësit civilë të Shteteve dhe organet ndërkombëtare për të përmirësuar komunikimin mbi bashkëpunimin dhe kërkesat për ndihmë.

37. Refuzimi i kërkesave për ndihmë mundet që në fund të çojë në paraqitjen e mocioneve për urdhra detyrues nga gjykata. Për të krijuar një bazë të dokumentuar mirë për argumentimin në gjykatë, është e domosdoshme që të gjitha Kërkesat për Ndihmë të plotësojnë kërkesat ligjore të nevojshme dhe që "historia" e Kërkesave për Ndihmë të dokumentohet siç duhet.

38. Mosbashkëpunimi ka edhe ndërlikime politike. Mosbindja i raportohet Sekretarit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Sigurimit, dhe mund të çojë në presion politik dhe ndoshta në vendosjen e sanksioneve.

D.6 Burimet e ndjeshme

39. Lufta dhe krimet e luftës kanë aftësinë të ndikojnë mbi njerëzit me të kaluara të ndryshme në shumë mënyra të ndryshme: viktimat e drejtpërdrejta të cilat kanë vuajtur pasojat e dhunës ose shkatërrimit dhe humbjes së pronës; ushtarët dhe paraushtarakët nga të gjitha nivelet e hierarkisë komanduese; dhe forcat ndërkombëtare paqeruajtëse. Do të ketë një interes dhe pjesëmarrje të madhe në hetimet nga qeveritë dhe agjencitë qeveritare, jo vetëm në rang vendor por edhe rajonal dhe në arenën më të gjerë ndërkombëtare, dhe nga agjencitë jo-qeveritare (OJQ). Për shkak të pranisë së një numri kaq të ndryshëm pjesëmarrësish si drejtpërdrejt ashtu dhe tërthorazi në konfliktet e armatosura, hetimet dhe ndjekjet penale do të përfshijnë një gamë të shumëllojshme dëshmitarësh dhe burime provash të mundshme. Shumë nga këta dëshmitarë dhe burime do të shprehin shqetësimin në lidhje me sigurinë e tyre personale ose nevojën për të ruajtur fshehtësinë e informacionit të ndjeshëm ose të sigurisë kombëtare. Disa nga materialet që mund të jenë kyçe për një çështje të krimeve të luftës, për shembull informatat e zbulimit dhe dokumentet operacionale, janë llojet e materialeve të cilat gjykatat civile kanë i kanë në dispozicion të kufizuar. Do të nevojiten procedura të posaçme në nivel kombëtar për të ekuilibruar interesat e kundërta të përfshira.

40. TPNJ-ja i ka zgjidhur këto probleme duke vendosur rregulla drejtuese që në fillim për përdorimin e informacioneve jashtëzakonisht të ndjeshme. Rregullat reflektojnë filozofinë themelore se është më mirë që Prokurori ta shikojë informacionin e fshehtë të zbulimit (edhe nëse nuk mund të përdoret si provë) se sa t'i

mohohet kjo mundësi. Një informacion i tillë mund të ndihmojë të drejtojë prokurorin gjatë fazave të hershme të një hetimi, por prokurori mund të mos e marrë atë nëse ofruesit nuk sigurohen se nuk do t'i jepet të tjerëve dhe se publikimi i tij nuk do urdhërohet nga procesi gjyqësor.

41. Është e rëndësishme që në fillim të identifikohen dhe kategorizohen burimet e ndjeshme, për të vlerësuar rrezikun ndaj atyre burimeve, dhe që të mbrohet siguria dhe fshehtësia personale e burimeve.

D.7 Viktimat/dëshmitarët e rrezikuar

42. Viktimat dhe dëshmitarët okularë të krimeve të luftës shpesh thirren për të dëshmuar kundër individëve që mbajnë pozita në pushtet ose kanë influencë të madhe në shtetin e tyre. Të akuzuarit mundet që ende gëzojnë mbështetje të gjerë nga disa pjesë të publikut të cilët nga ana tjetër mund të jenë një kërcënim për çdokënd që dëshmon ndaj atij të akuzuari. Si i tillë, rreziku ndaj sigurisë personale të dëshmitarit ose të pjesëtarëve të familjes së tij mund të jetë i madh, edhe shumë vite pasi ka ndodhur ngjarja në fjalë. TPNJ-ja njeh raste të shumta ku dëshmitarët janë kërcënuar, sulmuar ose edhe vrarë. Çdo gjykatë hetuese duhet t'i marrë seriozisht kërcënimet e mundshme ndaj dëshmitarëve dhe të marrë masa për t'i minimizuar këto kërcënime.

Dëshmitarët e brendshëm

43. Dëshmitarët e brendshëm (p.sh., ata brenda të njëjtës organizatë sikurse edhe i akuzuari të tillë si një shok ushtar brenda të njëjtës njësi, ose një shok politikan, ose një punonjës civil brenda të njëjtës parti, ose strukturë qeveritare) shpesh janë veçanërisht në rrezik nga frikësimet ose reprezaljet dhe duhet bërë kujdes i madh për të siguruar sigurinë e tyre.

Informatorët

44. Informatori është një individ i cili ofron informacion të fshehtë por që nuk pritet të thirret si dëshmitar. Ndonjëherë ndodh që informatorët ofrojnë informacion kundrejt shpërblimeve monetare ose përfitimeve pa para. Përveç mbrojtjes së sigurisë së burimit, një kujdes i madh duhet bërë për të vlerësuar vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që po jepet në rrethana ku burimi mund të motivohet nga fitimi personal. Shënime të veçanta të llogarive duhen mbajtur për të gjitha pagesat që ju bëhen informatorëve për të siguruar mbrojtjen e hetueseve dhe informatorëve dhe për të shmangur akuzat për veprime të pandershme ose korrupsion.

Dëshmitarët ndërkombëtarë

45. Termi "dëshmitar ndërkombëtar" i referohet atyre dëshmitarëve nga komuniteti ndërkombëtar të cilët shpesh kanë një profil politik të lartë dhe kanë qenë të përfshirë në konflikt në një kapacitet profesional të tillë si diplomat, negociator ose përfaqësues të një OJQ-je. Mund të jetë e nevojshme që dëshmitarët ndërkombëtarë të marrin leje me shkrim nga shteti ose organizata e tyre që t'i lejojë të japin informacion dhe të dëshmojnë. Një leje e tillë mund të ketë kushte të bashkëngjitura, që kërkojnë masa mbrojtëse ose kufizimin e publikimit të disa informacioneve. Personelit të Kombeve të Bashkuara në përgjithësi duhet t'i hiqet imuniteti përpara se të japin dëshmi.

Materialet e fshehta të "Rregullës 70"

46. TPNJ-ja ka krijuar një praktikë të veçantë në zbatim të Rregullës 70 të Rregullores së Procedurave dhe Provave. Kjo i ka lejuar agjencitë qeveritare dhe disa OJQ dhe organizata të tjera të japin informacion të

ndjeshëm dhe të fshehtë për përdorim, në shkallën e parë, vetëm për qëllime orientuese. Një informacion i tillë jepet me kufizime për çdo përdorim të mëtejshëm. Përpara se informacioni t'i jepet mbrojtjes, një Gjykatësi ose të përdoret si provë në gjyq, duhet marrë miratimi i ofruesit, zakonisht për secilin dëshmitar ose secilin dokument. Shpesh ndodh që ofruesi të vendosë kufizime të tjera mbi përdorimin e informacionit, zakonisht në formën e redaktimeve në dokumente. Informacioni shpesh është tejet sekret ose i ndjeshëm dhe shumë shpesh emri i ofruesit ose emrat e pjesëtarëve individualë të personelit të ofruesit trajtohen si tejet të fshehtë. Miratimi i ofruesit për të publikuar dëshminë mund të jetë i kushtëzuar në dhënien e masave mbrojtëse në gjyq.

47. Rregullat e TPNJ-së janë krijuar për të ofruar mbrojtje të rreptë për materialet e Rregullës 70. Megjithatë, mund të krijohet një konflikt nëse informacioni i Rregullës 70 është fajësues dhe e bën prokurorinë t'ia japë atë mbrojtjes. Rregullat e Gjykatës e kanë zgjidhur këtë konflikt duke e përjashtuar nga publikimi informacionin nën Rregullën 70. Megjithatë, në këtë situatë është praktikë e mirë që Prokurori të përpiqet të zgjidhë dilemën fillimisht duke zbuluar të gjitha pistat me ofruesin për të gjetur mundësi që informacioni fajësues të publikohet në një lloj forme së bashku me masa të përshtatshme mbrojtëse. Pas kësaj, nëse nuk mund të merret miratimi i ofruesit, për të qenë i drejtë, prokurorit mund t'i duhet të bëjë përshtatje në paraqitjen e dëshmive të tjera, dhe në raste ekstreme mund t'i duhet të bëjë ndryshime në paditë ndaj të akuzuarit.

D.8 Dëshmitarët

D.8.1 Kontaktet e para nga hetuesit e Prokurorisë

48. Kontakti i parë me një dëshmitar potencial ka të ngjarë të bëhet nga një hetues ose një anëtar tjetër i Zyrës së Prokurorit. Në një zonë konflikti ose pas konflikti, vetë veprimi i kontaktimit të dëshmitarëve potencialë mund ta vërë atë person në rrezik. Mbrojtja e dëshmitarëve është një fushë komplekse e cila krijon shumë çështje logjistike dhe personale. Përpara se të caktohen burime të konsiderueshme për të mbrojtur një dëshmitar, duhet marrë një vendim në lidhje me faktin nëse dëshmitari është thelbësor për procesin gjyqësor. Nëse ky vendim është pozitiv, hetuesi duhet më pas të adresojë shqetësimet e mundshme mbi sigurinë.

49. Kuptohet që dëshmitarët janë të shqetësuar që të mos duket sikur bashkëpunojnë me autoritetet kundër individëve të fuqishëm ose të dhunshëm. Dëshmitarët e brendshëm – dëshmitarët që punojnë me prokurorinë nga brenda një organizate ku janë vënë nën objektiv individët - mund të jenë të rrezik të veçantë. Në çdo rast, të gjithë dëshmitarët duhet të kontaktohen pa rënë në sy duke tërhequr vëmendjen sa më pak që të jetë e mundur. Nëse kontakti i parë bëhet me telefon nëpërmjet një përkthyesi, është e rëndësishme që hetuesit të marrin masa të mos alarmohet dëshmitari (p.sh., përkthyesi flet me theks të gabuar).

50. Në kontekstin e hetimeve të TPNJ-së, shumë dëshmitarë menjëherë ngrenë shqetësime rreth sigurisë së tyre. Jo të gjitha shqetësimet janë të bazuara. Vetëm duke bërë një intervistë hetuesit mundet të përcaktojnë nëse shqetësimet për sigurinë të dëshmitarit janë të vërteta ose thjesht të perceptuara. Shumë dëshmitarë besojnë sinqerisht, për shkak të rrethanave me të cilat përballen, se kanë shqetësime legjitime sigurie dhe ju nevojitet ndihmë. Megjithatë, në shumë raste, pas intervistave të kujdesshme dhe konstruktive, bëhet e qartë se nuk ka baza kriminalistike për të konkluduar se nevojiten masa mbrojtëse.

51. Nëse dëshmitari është kyç për një ndjekje penale, dhe shqetësimet mbi sigurinë janë legjitime, hetuesi atëherë duhet t'i shpjegojë dëshmitarit masat mbrojtëse në dispozicion të cilat mund të përfshijnë forma të thjeshta të mbrojtjes (p.sh., dhënien e dëshmisë në seanca të mbyllura, shtrembërime të zërit dhe fytyrës,

dhënien e një pseudonimi) deri në masa më drastike (p.sh., largimin e menjëhershëm nga zona, rivendosjen në një vend të tretë, ndryshimin e identitetit).

52. Hetuesit nuk duhet të bëjnë premtime në lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë e dëshmitarëve përpara se të konsultohen me eprorët e duhur për vlerën e dëshmisë së dëshmitarit. Seksioni i Viktimave dhe Dëshmitarëve (SVD) të Gjykatës ose autoriteti ekuivalent duhet të pyetet sa më parë për të lejuar një dialog dhe veprime konstruktive. Hetuesit duhet të dinë se çdo premtim për mbrojtje mund të mos pëlqehet nga Gjykatësit të cilët mund të mendojnë se është detyra e tyre të vendosin për masat e duhura mbrojtëse. Masat e marra për të ndihmuar dëshmitarët, duke përfshirë masat mbrojtëse, mundet që më vonë të interpretohen nga mbrojtja si një shtytje për dëshmitarin që të japë dëshmi të favorshme. Për këtë arsye hetuesit duhet të mbajnë shënime të hollësishme të të gjitha marrëveshjeve me dëshmitarët.

53. Në varësi të nivelit të rrezikut varet edhe niveli i ndryshëm i mbrojtjes. Masat duhet të jenë proporcionale: sa më serioz rreziku, aq më drastik kompensimi. Në fund, vendimi për të ofruar masa mbrojtëse do të merret nga SVD-ja jashtë gjykimit ose nga Gjykatësit, por vendimi do të varet shumë nga puna parapërgatitore e bërë nga hetuesit, të cilët duhet të ofrojnë dëshmi të besueshme të kërkuar për të justifikuar kompensimin e duhur.

54. Nëse një dëshmitar kërcënohet, mund të duhet të merren masa të shpejta. Është e rëndësishme që dëshmitarët të dinë se si ta kontaktojnë Tribunalin ose autoritetet vendore në rast emergjence. Është po aq e rëndësishme që personeli hetues të vendosë procedura të përshtatshme për të mundësuar përgjigjen e shpejtë.

D.8.2 Mbrojtja e burimeve të ndjeshme dhe dëshmitarëve të rrezikuar

55. Shpesh, dëshmitarët ose burimet e ndjeshme ofrojnë informacion dhe dëshmi në Gjykatë duke rrezikuar së tepërmi veten e tyre, familjet e tyre ose, në disa raste, organizatat e tyre. Duke pranuar një ndihmë të tillë nga individët nën rrethana të tilla, autoritetet kanë një detyrë morale t'i mbrojnë individët nga çdo rrezik që mund të rezultojë nga dhënia e një informacioni të tillë.

D.8.3 Përgatitja për intervistën e dëshmitarit

56. Përpara se të hynë në terren dhe të marrin intervista, hetuesit duhet të bien dakord mbi një strategji për të identifikuar objektivat e hetimit. Strategjia duhet të fillohet nga prokurori i ngarkuar për të koordinuar hetimet dhe analizat. Është po ashtu e rëndësishme për ekipet e ndryshme hetuese që të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në lidhje me faktin se cilin autor krimi po ndjek secili. Në praktikë, vështirësitë janë shkaktuar nëse një ekip interviston një dëshmitar të cilin e ka intervistuar një ekip tjetër si të dyshuar.

57. Deklaratat e shumëfishta duhen shmangur. Për këtë arsye është praktikë e mirë që një person që ka pasqyrë të përgjithshme të hetimeve dhe ndjekjeve penale aktuale të bashkërendojë marrjen e deklaratave të dëshmitarëve. Nëse kjo nuk mund të arrihet për shkak të vëllimit të punës hetuese, bëhet edhe më e rëndësishme që të ketë sisteme të mira menaxhimi të dëshmitarëve.

58. Përgatitja përpara intervistës është thelbësore. Për këtë arsye i gjithë personeli duhet të jetë informuar mirë përpara se të shkojë në terren, dhe ky informacion duhet të përfshijë një analizë të materialeve të brendshme dhe një pasqyrë të përgjithshme të të gjitha materialeve dhe rëndësisë së tyre për çështjen. Informimet duhet të përfshijnë edhe një përcaktim të elementëve të krimeve të kryera, faktet që duhen nga dëshmitarët, dhe strukturat e krimeve. Përgatitja e mirë kërkon që pjesëtarëve të personelit t'iu jepet kohë e mjaftueshme për të lexuar të gjitha materialet në dispozicion. Leximi duhet të përqendrohet në më shumë se

thjesht çështjet specifike, dhe duhet të ndihmojë në familjarizimin e intervistuesit me vendngjarjen e krimit. Më e mira është që intervistuesi të dërgohet në vendngjarje që të familjarizohet me krimet e kryera, shtetin, kulturat etj.

59. Sistemi hetimor duhet të përfshijë një program këshillues në mënyrë që personelit të ri t'i caktohen këshillues që t'i mësojnë se si t'i bëjnë intervistat me dëshmitarët. Personeli i ri duhet të fillojë duke vrojtuar këshilluesit e tyre gjatë intervistave përpara se të lejohen të bëjnë intervista nën mbikëqyrjen e këshilluesve. Pjesëtarët e personelit duhen trajnuar jo vetëm si të trajtojnë viktimat që janë përdhunuar seksualisht por edhe si të trajtojnë dëshmitarët që kanë vuajtur nga forma të tjera traumash. Pjesëtarët e personelit duhet të trajnohen edhe se si të shkruajnë deklarata të qarta, të logjikshme dhe koncize.

60. Pjesëtarëve të personelit po ashtu duhet t'iu mësohet se si të përdorin dhe të punojnë me përkthyesit. Për shembull hetuesit / prokurorët / analistët duhet të punojnë me përkthyesit përpara për të përcaktuar parametrat dhe objektivat e intervistës.

61. Përpara se të fillohet intervistimi, një dëshmitari i duhet kërkuar identifikimi. Duke konfirmuar identitetin e dëshmitarit, hetuesi ndihmon shmangien e konfuzionit në lidhje me identitetin e dëshmitarit.

D.8.4 Intervistimi i dëshmitarëve

62. Mënyra e të bërit të intervistave me dëshmitarët dhe përmbajtja e deklaratave që jepen ka rëndësi kyçe për trajtimin e suksesshëm të çështjes. Çdo sistem ligjor ka kërkesat dhe rregullat e tij për procedurat dhe dëshmitë që rregullojnë marrjen e deklaratave, të cilat mund të përfshijnë masa mbrojtjeje të veçanta për marrjen në pyetje të personave të dyshuar dhe të akuzuar. Duhet bërë kujdes i veçantë kur intervistohen dëshmitarët e traumatizuar, shumica e të cilëve jo vetëm që mund të kenë humbur miq e të afërm, por e gjithë jeta e tyre mund të jetë shkatërruar nga konflikti. Përveç kësaj, hetuesit duhet të kenë kujdes faktin se viktimat e sulmeve seksuale, si meshkujt dhe femrat, mund të ndeshen me paragjykime shoqërore e kulturore.

63. Në TPNJ, deklaratat e dëshmitarëve zakonisht merren nga një hetues ose prokuror që punon nëpërmjet një përkthyesi. Është praktikë e mirë që hetuesit dhe jo prokurorët të marrin deklarata nga dëshmitarët në mënyrë që ata të dëshmojnë në lidhje me rrethanat në të cilat është marrë deklarata. Përpjekje duhen bërë që të shmanget vendosja e përkthyesve në një pozicion ku ata duhet të thirren si dëshmitarë.

64. Zakonisht nuk është e nevojshme që dëshmitaret femra të intervistohen nga personel femër dhe dëshmitarët meshkuj të intervistohen nga personel mashkull. Megjithatë brenda mundësive, një dëshmitar mund të lejohet të bëjë një zgjedhje për gjininë e hetuesit intervistues, dhe kjo preferencë duhet konsideruar me seriozitet.

65. Është e rëndësishme që informacioni nga dëshmitari të merret në rend kronologjik nëse intervista është më shumë se tematike. Megjithatë, nëse një dëshmitari nuk i kujtohen datat, hetuesi nuk duhet të përpiqet që t'i japë ato. Më tej, intervistuesi duhet të fillojë me paragrafin paraprak që përcakton të dhënat personale, kualifikimet, eksperiencat dhe ekspertizat e dëshmitarit. Pjesës tjetër të paragrafëve duhet t'ju vihen numra në mënyrë që deklaratës t'i referohet me lehtësi.

66. Deklarata duhet të jetë me fjalët e vetë viktimës; përdorimi i parafrazimit duhet shmangur kurdo që është e mundur.

67. Për më tepër, deklarata duhet të regjistrohet dhe nënshkruhet në një gjuhë që dëshmitari e kupton. Nëse kjo nuk është e mundur, deklarata duhet t'i lexohet dëshmitarit nga një përkthyes e hollësitë e procesit të rishikimit dhe nënshkrimit duhet të shënohen në vetë deklaratën.

68. Është shumë e rëndësishme që hetuesi të shmangë ekzaminimin e dëshmitarit gjatë intervistës. Kjo detyrë duhet të bërë vetëm nga një avokat në gjyq. Megjithatë, hetuesit e kanë për detyrë të testojnë tregimet e dëshmitarëve që duken të pabesueshme ose që janë në kundërshtim me informacione të ditura nga burime të tjera. Gjithsesi, përpara se t'i paraqitet dëshmitarit një version i ngjarjeve, është e rëndësishme që dëshmitari të lejohet që në fillim të tregojë historinë e tij për atë që ka ndodhur.

69. Është e rëndësishme të kuptohet se nëse merren shënime nga hetuesit, ato mund të publikohen në një fazë të mëvonshme edhe pse kjo gjë mund të mos jetë një kërkesë ligjore në të gjitha sistemet kombëtare.

70. Procesi i intervistimit të dëshmitarit është domosdoshmërisht një përpjekje e gjithë ekipit. Për më tepër, ekipi duhet të jetë mjaft fleksibil për të zgjedhur personin më të mirë që të udhëheqë intervistën. Kur krijohet ekipi, është e rëndësishme që të vlerësohen pikat e forta e të dobëta të pjesëtarëve të ekipit si dhe statusi i dëshmitarit (p.sh., a është dëshmitari një dëshmitar direkt i krimeve, një politikan i rangut të lartë apo një ekspert), dhe të pranohet se nuk është e nevojshme që i njëjti intervistues të merret me të gjitha pikat e intervistës. Është e rëndësishme që intervista të çmohet dhe vlerësohet më pas.

71. Incizimi në kaseta i intervistave me dëshmitarë të rëndomtë ka përparësitë dhe mangësitë e veta, dhe nuk është e mundur që të bëhet një rekomandim përgjithësues në lidhje me incizimin. Në të vërtetë, vendimi nëse duhet përdorur ose jo incizimi varet nga situata individuale. Përparësitë e incizimit janë se incizimi ndihmon në mbrojtjen e integritetit të procesit të intervistimit, redukton efektin e sfidave të ardhshme, dhe mundëson publikimin e shpejtë të tij mbrojtjes nëse alternativa është që të pritet përfundimi i shkrimit dhe përkthimit të deklaratës. Mangësia e kësaj është se shumë dëshmitarë ngurojnë të flasin nëse incizohen, intervistat e gjata të incizuara nuk janë të papërshtatshme që të dëgjohen, dhe puna e transkriptimit është një pengesë serioze që mund të krijojë punë të shtesë. Megjithatë, Rregullorja e Tribunalit kërkon që marrja në pyetje e të gjithë të dyshuarve të regjistrohet me audio ose me video.

72. Gjatë intervistës së dëshmitarit mund të jetë e nevojshme të përcaktohet identiteti i të akuzuarit duke përdorur një procedurë me tabelë me fotografi ku dëshmitarit i paraqiten një numër fotografish të personave të ndryshëm. Një procedurë e tillë nuk kërkohet normalisht ose nuk është e nevojshme nëse i akuzuari njihet mirë nga dëshmitari. Në çdo rast, nëse dëshmitari ka vështirësi në bërjen e identifikimit, këto vështirësi duhet të regjistrohen në deklaratën e dëshmitarit. Nëse është e mundur, preferohet që të regjistrohet me kasetë video procesi i identifikimit për të shmangur çdo lloj keqkuptimi në lidhje me atë që ka ndodhur. Zyra e Prokurorit të TPNJ-së ka përcaktuar procedura të hollësishme të brendshme që rregullojnë identifikimet në terren. Këto procedura bëjnë dallim ndërmjet identifikimeve të zakonshme dhe njohjes së individëve që njihen nga dëshmitari. Për identifikimet e zakonshme, hetuesit pritet të përgatisin një tabelë me shumë fotografi dhe t'ua tregojnë dëshmitarëve në një mënyrë të kontrolluar dhe të standardizuar për të shmangur që hetuesi ose përkthyesi të ndikojnë mbi dëshmitarin me fjalë ose gjeste.

73. Nuk do të jetë gjithnjë e mundur të bëhen intervista ballë për ballë me dëshmitarin. Në disa raste intervistat me telefon janë të nevojshme dhe në disa raste të tjera mund të përdoren lidhjet me video.

D.8.5 Regjistrimi i kontakteve me dëshmitarët

74. Në mënyrë që të ndiqen praktikat më të mira për të bërë intervistat me dëshmitarët, është shumë e rëndësishme të krijohet një Sistem Menaxhimi i Dëshmitarëve (SMD) i mirë që regjistron informacionin e dëshmitarëve dhe të dhënat e hetuesit që i kontakton ata. Një sistem i tillë duhet të krijohet përpara se të fillojnë intervistat me dëshmitarët. Është thelbësore të përfshihen protokolle të regjistrimit të të dhënave,

krijuar për t'u siguruar që të dhënat të regjistrohen në format standard në SMD. Në lidhje me dëshmitarët/dëshmitarët e mundshëm, SMD-ja duhet të përfshijë të dhënat e mëposhtme:

- informacion biografik;
- të dhënat e kontaktit (telefoni/faksi/emaili - adresa);
- personi i kontaktit (në mënyrë që të tjerët që duan të kontaktojnë një dëshmitar të dinë se si ta bëjnë këtë);
- një regjistrim të të gjitha kontakteve me një dëshmitar si dhe subjektin e kontaktit;
- çështjet/hetimet me të cilat është e lidhur deklarata e dëshmitarit dhe nëse dëshmitari është dakord të dëshmojë;
- të gjitha shqetësimet e veçanta/të sigurisë që kanë të bëjnë me dëshmitarin;
- të dhënat e pasaportës për përdorim më vonë nga Seksioni i Viktimave dhe Dëshmitarëve;
- klasifikimi i dëshmitarëve, d.m.th të përgjithshëm ose të ndjeshëm (këta të fundit janë ata që mund të jenë në rrezik nëse lidhja e tyre me Gjykatën bëhet e ditur).

75. SMD-ja është krijuar të ndihmojë që nga ana organizative të gjithë dëshmitarët e Gjykatës të identifikohen dhe të mund të kërkohen. Përpara kontaktit me një dëshmitar, hetuesit duhet të konsultohen me SMD-në për t'u siguruar nëse personi është kontaktuar më parë dhe nga kush.

76. Në Zyrën e Prokurorit të TPNJ-së, informacioni i SMD-së është i lidhur në mënyrë elektronike me informacionin e mbajtur nga Sekretaria që përfshin, *inter alia*, dëshmi të dëshmitarëve, prova të paraqitura në gjyq, dhe dokumente (deklarata) të dëshmitarëve. Ka përparësi në grumbullimin së bashku të të dhënave të mbajtura nga prokuroria, gjykata dhe Sekretaria, edhe pse këto forma të ndryshme të dëshmive janë marrë për qëllime të ndryshme. Ndarja e këtyre regjistrimeve mund të krijojë dyfishime, gabime dhe joefikasitet. Shkëmbimi i informacionit (që i nënshtrohet disa kufizimeve të nevojshme) ka provuar të jetë një praktikë shumë më e mirë.

77. Për më tepër, mbajtja e bazës së të dhënave të krijuar për të treguar Dëshmi të Mëparshme të Dëshmitarit është një praktikë e mirë. Zyra e Prokurorit në TPNJ ka tani një tregues që përmban emrat e të gjithë dëshmitarëve që kanë dëshmuar në TPNJ, çështjet për të cilat kanë dëshmuar, masat mbrojtëse të përdorura dhe datat e dëshmisë. Treguesi aktualisht identifikon 6,483 dëshmi individuale, dhe është përpiluar nga lista të ndryshme gjyqi (Prokuroria/Mbrojtja) dhe përfshin informacion në lidhje me dëshmitarët e Dhomave. E mira e këtij sistemi është se një ekip gjyqësor mundet me lehtësi dhe shpejtësi të përcaktojë nëse një dëshmitar i propozuar ka dëshmuar më parë. Përfitimet nga efikasiteti mund të jenë të konsiderueshme. Për shembull, pa një tregues, një çështje e madhe mund të kërkojë kërkime manuale për 300 dëshmitarë të prokurorisë, gjë e cila mund të kërkojë shumë orë punë. Këto 300 kërkime mund të bëhen nga një indeks qendror në pak minuta. Përveç kësaj, indeksi lejon marrjen me lehtësi të transkriptimeve/provave për qëllime publikimi. Aktualisht indeksi përditësohet çdo ditë duke monitoruar gjyqet e ndryshme në vijim, dhe duke regjistruar informacionin e nevojshëm që ka të bëjë me dëshmitë, datat dhe masat mbrojtëse. Një përfitim tjetër është se indeksi lejon prokurorinë të klasifikojë dhe vlerësojë me shpejtësi të gjithë dëshmitarët në një çështje të caktuar.

D.9 Intervistimi i viktimave të sulmeve seksuale

78. Konfliktet e armatosura shpesh përfshijnë krime të dhunës seksuale ndaj grave dhe burrave.

79. Grumbullimi i provave të krimeve të dhunës seksuale sipas të drejtës penale ndërkombëtare është një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen hetuesit. Ekzistojnë pengesa të shumta – të sigurisë, politike, kulturore, psikologjike dhe profesionale - që ndikojnë në mundësinë e hetuesit t'i ketë në dispozicion provat e krimit të dhunës seksuale. Një kuptim i qartë i sfidave i mundëson hetuesit për të zhvilluar strategji për t'i

paraprirë atyre, dhe për të përgatitur një plan hetues të përshtatur për kontekstin e caktuar (shiko Shtojcën 3 – *Parimet udhëzuese për intervistimin e viktimave që janë dhunuar seksualisht*).

D.10 Intervistimi i dëshmitarëve ekspertë

80. Dëshmitarët ekspertë duhet të përdoren për të ofruar prova, përfshi prova opinioni, në fusha që kërkojnë aftësi ose njohuri të specializuara që gjykata nuk i zotëron. Një ekip i prokurorisë brenda një gjykate të specializuar të krimeve të luftës, që përdor një qasje shumë-disiplinore për hetimet, duhet të krijojë ekspertizë të madhe të veten. Megjithatë, prokuroria duhet të bëjë kujdes që ekspertët e brendshëm të mbajnë shkallën e duhur të distancimit nëse japin dëshmi. Analistët e brendshëm po ashtu mund të përdoren për të përpiluar dokumentacion për ekspertët e jashtëm. Në kontekstin e TPNJ-së, ka ndodhur rëndom që analistët e brendshëm ushtarakë të përpilojnë grumbullimin e dokumenteve ushtarake për ekspertë të lartë ushtarakë të jashtëm të cilët janë thirrur për të dhënë dëshmi opinioni (p.sh., në lidhje me çështjet e komandimit dhe kontrollit). Politika dhe procedurat e brendshme të Zyrës së Prokurorit në lidhje me trajtimin e ekspertëve theksojnë se:

- Ekspertët duhet të jenë plotësisht të kualifikuar për të adresuar çështjen në fjalë për të cilën ata do të dëshmojnë;
- Ekspertët duhet të japin opinionet e tyre të paanshme dhe duhet të veprojnë për kauzën e drejtësisë;
- Si ekspertët e brendshëm ashtu dhe ata të jashtëm mund të punësohen nga një palë për të ndihmuar Gjykatësit nëse ata zotërojnë njohuri, aftësi ose trajnim përkatës të specializuar për një çështje në diskutim;
- Ekspertët duhet të japin opinionin e tyre në mënyrë transparente, duke shpjeguar faktet mbi të cilat mbështeten dhe metodat që kanë përdorur për të arritur në konkluzionet e tyre;
- Ekspertët duhet të jenë plotësisht të informuar për çështjet në fjalë.

81. Atje ku ekspertët e jashtëm punojnë nga afër me analistët e brendshëm, është praktikë e mirë të përgatiten dy raporte, në mënyrë që puna e analistit (zakonisht në grumbullimin dhe përgatitjen e materialeve për ekspertët e jashtëm) të përputhet me opinion e ekspertëve të jashtëm. Megjithatë, është e rëndësishme që analisti të mos përpiqet të ndikojë përmbajtjen e materialit të raportit të ekspertit të jashtëm.

D.11 Intervistimi i të dyshuarve

82. TPNJ-ja ka krijuar rregulla të posaçme për intervistimin e të dyshuarve, d.m.th. personat përkatës për të cilët Prokurori zotëron informacion të besueshëm që sugjeron se ata kanë kryer një krim mbi të cilin Tribunali ka juridiksion.

83. Praktikat e përcaktuara më lartë në lidhje me intervistimin e dëshmitarëve, përgatitjen e intervistave, punën me përkthyesit dhe adresimin e përmbajtjes së deklaratës zbatohen edhe në intervistat me të dyshuarit. Megjithatë për shkak të statusit të veçantë të të dyshuarve, Zyra e Prokurorisë së TPNJ-së ka krijuar rregulla të veçanta për intervistimin e të dyshuarve. Udhëzimet theksojnë *inter alia* pikat e mëposhtme:

- përpara intervistës, hetuesi duhet të përcaktojë nëse personi që do të intervistohet duhet konsideruar si i dyshuar siç është përcaktuar me Rregullore;
- vendimit për të intervistuar një të dyshuar i duhet autorizimi paraprak nga menaxhimi i lartë;
- në fillim të intervistës me të dyshuarin, hetuesi duhet të sigurohet se i dyshuari i njeh mirë dhe i kupton të drejtat e tij sipas Rregullave të TPNJ-së. Nëse gjatë intervistës me një dëshmitar të zakonshëm, statusi i personit ndryshon nga dëshmitar në të dyshuar, personi duhet të njoftohet menjëherë për të drejtat e tij sipas Rregullores;

- kur një avokat i mbrojtjes merr pjesë në intervistë, avokati duhet informuar përpara se si do të bëhet procesi i intervistimit;
- intervista e të dyshuarit duhet të regjistrohet në një sistem audio/video;
- të dyshuarit duhet t'i jepet pa vonesë një kopje e kasetave dhe një transkriptim i printuar.

84. Në raste të rralla, deklaratat fajësuese të bëra nga i dyshuari mund të nevojiten në një çështje kundër një të akuzuari tjetër. Në situatat të tilla, prokuroria iu jep të dyshuarve imunitet të plotë si një metodë për të marrë bashkëpunimin e tyre. Megjithatë, një imunitet i tillë është dhënë rrallë, dhe vetëm me autoritetin e mëparshëm të Prokurorit.

E. Menaxhimi i informacionit

85. Hetimet prodhojnë një sasi të madhe informacioni dhe dëshmish. Pavarësisht faktit se hetuesit e TPNJ-së fillimisht nuk pritën të gjenin një sasi të madhe dokumentacioni të përpiktë që përfshinte krimet që ata hetonin, grumbullimi i dëshmive nga Zyra e Prokurorisë u rrit ndër vite në pothuaj tetë milion faqe. Përdorimi i këtij volumi materialesh u bë edhe më sfidues sepse TPNJ-ja u krijua në fillim të periudhës së automatizimit të zyrave dhe kompjuterizimit modern. Frika për sigurinë e informacioneve të ndjeshme gjithashtu çoi në zhvillimin e ishujve të informacionit te ekipet. U deshëm shumë vite për të krijuar një kulturë të shkëmbimit të informacionit dhe për të krijuar sisteme kompjuterike që mundësonin hetuesit dhe prokurorët të regjistronin dhe të merrnin informacion. Për të shmangur krijimin e grumbullimit të copëzuar dhe ruajtjes së shkëputur të të dhënave, është e nevojshme që prokuroria dhe ekipet e hetimit të menaxhojnë siç duhet çdo dokument të marrë. Për shembull, edhe pse është shumë e lehtë të grumbullohen kopje të dyfishta dokumentesh, ekzistenca e dublikatave mund të krijojë ngatërresa, të vendosë kërkesa të panevojshme për përkthim, dhe është tejet e vështirë që të hiqen nga sistemi. menaxhimi i mirë i dokumenteve është shumë i rëndësishëm. Një gjykatë e re duhet të ketë parasysh standardin e industrisë së automatizimit të zyrave dhe përpunimin e informacionit.

E.1 Mbrojtja e informacionit të ndjeshëm

86. Informacioni dhe provat nga dëshmitarët e rrezikuar dhe burimet e ndjeshme mund të jenë në shumë forma: deklarata dëshmitarësh, prova dokumentare, raporte ekspertësh, raporte të zbulimit, përgjime, fotografi, etj.

87. Një kujdes i madh duhet treguar për të mbajtur informacione të tilla në vende të sigurta. Materialet me ndjeshmëri më të lartë duhen mbajtur në një kasafortë të kyçur me përdorim të kufizuar nga një numër i vogël pjesëtarësh të personelit kryesor dhe të caktuar me emra. Vëmendje i duhet kushtuar edhe mbajtjes së materialeve të tjera të ndjeshme në skedarë kompjuterësh të mbrojtur me fjalëkalime, sërish me përdorim të kufizuar.

88. Atje ku informacioni i fshehtë është dhënë nga një organ qeveritar ose OJQ sipas dispozitave të Rregullës 70 ose një rregulli ekuivalent, është më mirë nëse caktohet një punonjës ndërlidhës që të merret me këtë burim individualisht për secilën çështje. Mund të jetë me dobi që të kihet një marrëveshje e shkruar me ofruesin e informacionit të ndjeshëm.

89. Është e rëndësishme që të mbahen shënime të të gjitha informacioneve të ndjeshme të ruajtura. Duhet të ketë shënime të ndara për secilin burim sipas Rregullës 70, që detajon çdo dokument të marrë, pavarësisht

nëse është miratuar apo jo që të përdoret në gjyq, i është dhënë mbrojtjes apo është përdorur si dëshmi. Është e qartë se këto shënime duhet të trajtohen me të njëjtin kujdes sikurse vetë informacioni i ndjeshëm.

E.2 Përdorimi, përpunimi dhe ruajtja e provave

90. Një çështje e krimeve të luftës ka sukses ose dështon varësisht nga provat që paraqiten në gjyq. Është e domosdoshme që Zyra e Prokurorisë të krijojë procedura sistematike dhe efikase për grumbullimin, përpunimin, ruajtjen dhe marrjen e materialeve të identifikuara si prova.

91. Burimet e provave mund të jenë shumë të gjera dhe të shumëllojshme. Së pari, janë provat nga dokumente që tregojnë një regjistrim historik të asaj që është thënë, është bërë, është urdhëruar dhe është raportuar në atë kohë. Burimet e këtyre provave mund të gjenden në arkiva, ditarë, revista dhe libra, raporte ushtarake, raporte të situatës, njoftime, procesverbale të seancave qeveritare, dokumente të komandimit dhe kontrollit, raporte të brendshme, fotografi dhe video, përgjime dhe burime të hapura. Format e tjera të provave përfshijnë pajisjet kompjuterike, veshjet, balistika, gjurmët e metaleve dhe armët e zjarrit të gjendura në vendngjarjen e krimit dhe në vende të tjera.

92. Njësia e Dëshmive (NJD) në Zyrën e Prokurorit u krijua për të siguruar kontroll qendror dhe trajtim e duhur të të gjitha provave të marra nga Zyra e Prokurorit. NJD-ja ishte përgjegjëse për standardizimin e procedurave të grumbullimit të dëshmive. Përpara dorëzimit të provave në NJD, krijohet dhe i bashkëngjitet provës një MIF elektronik (Formulari i Informacionit të Mini-Indeksit). Kur dëshmia merret, ajo vuloset, i jepet një Numër Reference të Provave (NRP) dhe vendoset në një bazë të dhënash. Çka ngjan si një proces në dukje i thjeshtë, në praktikë është një ndërmarrje komplekse me efekte të gjera mbi procedurat dhe burimet. Menaxhimi i dobët i dokumenteve do të rezultojë në joefikasitet dhe humbje të besimit në aftësinë e sistemit për të gjetur informacionin. Në rastin më të keq, të mos dish se çfarë dëshmish ekzistojnë, ose se si janë përdorur dokumentet në të kaluarën, mund të ndikojë në procesin gjyqësor.

93. Praktikat më të mira dhe mësimet e mësuara për përpunimin dhe ruajtjen e provave të krijuara nga ZP-ja e TPNJ-së janë si më poshtë.

E.3 Zinxhiri i ruajtjes

94. Për shkak se gjatë procedimeve të mëtejshme juridike mund të dalin sfida rreth asaj se si janë grumbulluar provat , është praktikë e mirë që të përcaktohen procedura të hollësishme për të ruajtur një regjistrim të vijueshëm që detajon përdorimin e një prove. Udhëzimet e krijuara në Zyrën e Prokurorisë theksojnë:
   - zinxhiri i ruajtjes fillon në momentin që merret prova, dhe vazhdon gjatë dhe pas paraqitjes në gjykatë;
   - zinxhiri i ruajtjes nuk duhet të këputet, dhe prova duhet të mbetet e sigurt gjatë gjithë kohës;
   - të gjitha lëvizjet e provave duhet të regjistrohen dhe dokumenti i zinxhirit të ruajtjes duhet të jetë gati për qëllime të përdorimit të gjyq.

E.4 Analizimi i dëshmive

95. Ekzistojnë tre funksione analitike parësore, që janë thelbësore në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës, dhe që të gjitha mund të klasifikohen gjerësisht nën termin “Analiza zbulimore”. Këto janë:
   - Analiza ushtarake;
   - Analiza politike;
   - Analiza kriminale.

96. Analiza ushtarake ofron hetim dhe mund të rezultojë në ndjekjen e çështjeve që kanë të bëjnë me dimensionin ushtarak, dhe mund të përfshijnë shqyrtim të ngjarjeve integrale, personaliteteve, organizatave dhe krimeve. Analisti ushtarak ekzaminon *de jure* dhe *de facto* çështje që kanë të bëjnë me krimet, objektivat e prokurorisë dhe ngjarjet, dhe analizon fazat më të hershme të një hetimi ose vlerësimi deri tek parashtrimet në gjykatë të analizave për prokurorinë. Analisti ushtarak ofron edhe ndihmë në monitorimin, kërkimin, dhe këshillimin e prokurorisë në fazën e mbrojtjes në gjykim.

97. Analiza politike funksionon në të njëjtën mënyrë, por përqendrohet në çështje të natyrës politike/udhëheqëse.

98. Analiza kriminale i ofron ekipeve të hetimit dhe prokurorisë njohuri të hollësishme dhe të thella të çështjes, veçanërisht në lidhje me sjelljen e të akuzuarit, rolin dhe pozicionin e të akuzuarit në lidhje me krimin për të cilin është akuzuar, bazuar në kronologjinë e ngjarjeve. Analisti kriminal ofron analiza të strukturës së krimit, lidhjet e të akuzuarit me bazën e krimit dhe individë të tjerë, si dhe analiza kontekstuale të ngjarjeve të pretenduara në padi.

99. Për secilën nga këto disiplina, përqendrimi i punës së analistit varet nga faza e çështjes, d.m.th. hetimi/faza paragjyqësore, ndjekja në gjykim, mbrojtja në gjykim, dhe apeli.

100. Gjatë fazës së hetimit/paragjyqësore, përqendrimi analitik është tek vlerësimi i informacionit, identifikimi i boshllëqeve të provave, identifikimi i burimeve, vlerësimi i dëshmitarëve, ndihma në intervista, dhe në disa raste përgatitja e raporteve të "ekspertit". Pasi identifikohen boshllëqet dhe burimet informacionit, analistët ofrojnë mbështetje në grumbullimin e materialeve të reja, p.sh. misione kërkimi dhe sekuestrimi. Në këtë aspekt, duhet gjetur një ekuilibër në punën e analistit ndërmjet punës në zyrë dhe në terren. Një sasi e madhe e punës përfshin hulumtimin e provave dokumentare për të përforcuar çështjen(t) ndërkohë që kihet parasysh detyrimi për të publikuar dëshmi shfajësuese.

101. Gjatë fazës së gjykimit, përqendrimi i analistit është të vëzhgojë gjykimin, të ndihmojë në sprovimin e dëshmitarëve, në disa raste të dëshmojë, dhe më e rëndësishmja, të vëzhgojë fazën e mbrojtjes në gjykim në mënyrë që të ndihmojë Avokatin e Lartë të Gjyqit duke ofruar përgjigje për çështje që dalin në sallën e gjykimit. Njohuritë e gjera mbi çështjen dhe provat e prokurorisë kanë rëndësi të jashtëzakonshme në këtë fazë të procesit.

102. Roli i analistit gjatë fazës së apelit është më shumë *ad hoc*, e zakonisht i ofron seksionit të apeleve njohuri gjithëpërfshirëse të çështjes dhe identifikim të dokumenteve.

103. Shkurt, një pamje e përgjithshme e funksionit të analistit është që: të thjeshtojë ose reduktojë dokumentet komplekse ose voluminoze, të identifikojë detajet kryesore, të identifikojë mospërputhjet dhe boshllëqet e informacionit, dhe të ndihmojë ekipet e hetimit dhe të gjykimit. Nëse analisti e kryen detyrën e tij mirë, ai mund të japë vlerësime të çmueshme në lidhje me përshtatshmërinë e informacionit (p.sh. provave) dhe mund të ndihmojë që ta paraqesë atë analizë në një mënyrë të kuptueshme.

104. Aktivitetet e përgjithshme të kryera nga një analist përfshijnë:
- vlerësimin e dokumenteve;
- menaxhimin e dokumenteve;
- planifikimin dhe menaxhimin e grumbullimit;
- intervistat (dëshmitarë, të dyshuar, ekspertë);
- dhënien e ndihmës teknike të shumëllojshme për çështjet (bazuar në fusha të veçanta ekspertize).

F. Rëndësia e dëshmive demografike

105. Përveç detyrimit për të provuar se shumë civilë të pafajshëm janë vrarë në një konflikt të armatosur, Prokurorisë mund t'i duhet të tregojë se ka ndodhur dëbimi ose transferimi me forcë i një numri të madh civilësh. Kjo detyrë do të lehtësohet shumë duke pasur një njësi të specializuar demografike brenda Zyrës së Prokurorisë. Detyrat e demografëve në Zyrën e Prokurorit të TPNJ-së përfshijnë:
    - grumbullimin, organizimin dhe mirëmbajtjen e materialeve demografike për përdorim nga Zyra e Prokurorisë;
    - kryerjen e analizave statistikore të këtij materiali;
    - përllogaritjen e pasojave demografike të konflikteve të viteve 1990-ta;
    - përgatitjen e raporteve të ekspertëve dhe hulumtuese;
    - dhënien e dëshmive nga dëshmitarë ekspertë;
    - vlerësimin e provave demografike të paraqitura nga mbrojtja;
    - ndërveprimin me njësitë e ZP-së në lidhje me statistikat e popullsisë;
    - detyra të tjera.
106. Gjatë kohës që ka ekzistuar Njësia Demografike (NJD) ka krijuar disa metoda që janë provuar të vlefshme në punën e Zyrës së Prokurorit dhe për këtë arsye mund t'ju rekomandohen të tjerëve që punojnë për ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

IV. Shtojca 1: Plani i hetimit

- *Përpara se të fillohet çdo aktivitet hetues i rëndësishëm, duhet të krijohet një plan hetimi i hollësishëm dhe gjithëpërfshirës, e të diskutohet dhe aprovohet nga drejtuesit e lartë. Qëllimi i planit të hetimit është të sqarojë objektivat hetuese dhe metodat e grumbullimit të dëshmive. Pasi të miratohet, ai duhet të jetë një udhëzues praktik dhe i dobishëm për hetuesit, analistët dhe avokatët e angazhuar aktivisht në aktivitetet hetuese.*
- *Plani hetues duhet të përfshijë komponentët e mëposhtëm:*
  - *Përmbledhjen e Hetimit të Propozuar*
  - *Pyetjet thelbësore*
  - *Kuadrin ligjor të planit hetues*
    - *Teoritë e përgjegjësisë*
    - *Krimet e mundshme që janë kryer dhe elementët e tyre ligjorë*
  - *Pistat e hetimit (d.m.th. përdorimi i paraushtarakëve nga politikanë të lartë)*
    - *Përmbledhjen e objektivave hetuese*
    - *Përmbledhjen e asaj që njihet aktualisht*
    - *Personat aktivitetet e të cilëve do të ekzaminohen*
    - *Provat e mundshme*
    - *Provat fizike*
    - *Provat e mundshme dokumentare*
  - *Përmbledhjen e detyrave hetuese që duhen ndërmarrë*
  - *Burimet që duhen shpërndarë për të kryer hetimet*
  - *Zbatimin e planit*
  - *Komentet e revizorëve*
  - *Miratimin e drejtuesve të lartë*
  - *Revizionet periodike të rezultateve të hetimit*
- *<u>Përmbledhja e hetimit të propozuar</u>: Çdo hetim do të jetë një nga të shumtët që do të ndërmerret nga një Prokuror, i cili ka përgjegjësi të kryejë hetime të drejta dhe gjithëpërfshirëse mbi të gjitha akuzat për shkelje që dalin brenda mandatit të tij. Pjesa e përmbledhjes identifikon parametrat dhe lëndën e çështjeve të hetimeve të veçanta për të ndihmuar menaxherët e lartë në bashkërendimin e disa hetimeve që ndërmerren.*
- *<u>Pyetjet thelbësore</u>: Çdo hetim ngreh disa pyetje thelbësore të cilave shpresohet që hetimi do të jetë në gjendje t'ju japë përgjigje nëpërmjet grumbullimit të provave të besueshme dhe serioze. Pyetjet thelbësore duhet të artikulohen qartë dhe të shpjegohen nëse është e nevojshme. Pa një deklaratë të qartë të pyetjeve për të cilat kërkohen përgjigje ka shumë gjasa që përpjekjeve do t'ju mungojë fokusi i nevojshëm për të identifikuar dhe grumbulluar me efikasitet dhe efikasitet provat e nevojshme për t'ju përgjigjur atyre.*
- *<u>Kuadri ligjor i planit hetues</u>: Çdo hetim duhet të identifikojë ndalesat ligjore në fuqi që mund t'i nënshtrohen çdo ndjekjeje penale. Përcaktimi i krimeve ndërkombëtare ende po zhvillohet dhe çdo gjykim i ri kontribuon rëndësishëm në kuptimin e asaj që kërkohet për t'i provuar këto krime. Duke marrë parasysh se këto kërkesa ligjore janë shpesh objekt i mosmarrëveshjeve ndërmjet vetë gjyqtarëve dhe avokatëve që punojnë para tyre,*

është e domosdoshme që plani hetues t'i ofrojë personelit hetues përcaktime të përshtatshme të elementëve si dhe listat e renditura të llojeve të dëshmive që ka të ngjarë të kenë lidhje me secilin prej këtyre elementëve. Për shembull, në përcaktimin e qëllimit të përbashkët të shumë personave të përfshirë në një ndërmarrje kriminale të përbashkët plani duhet të përcaktojë llojet e dëshmive që hetuesit do të kërkojnë të tilla si komunikimet e përgjuara, korrespondencat, deklaratat publike e private që tregojnë qëllimin e përbashkët, etj.

- *<u>Pistat e hetimit</u>: Shumë nga hetimet e mëdha do të përfshijnë disa pista parësore hetimi. Për shembull në vlerësimin e fajësisë së mundshme të figurave politike të larta në krime mund të jetë e nevojshme të ekzaminohen veçmas krimet e kryera nga policia, ushtria dhe para-ushtarakët. Secila pistë parësore e hetimit mund të jetë e mjaftueshme sa t'i duhet një plan hetimi. Secili prej këtyre "nën-hetimeve" duhet të jetë subjekt i një pjesë të veçantë me qëllime dhe metoda të shprehura qartë siç përcaktohet më poshtë.*
- *<u>Përmbledhja e objektivave</u>: Kjo pjesë përmbledh objektivat e një piste të caktuar hetimi. Është e lidhur ngushtë me pyetjet thelbësore të dala nga hetimi dhe shërben për të përcaktuar më konkretisht qëllimet e këtij aspekti të veçantë të gjithë ndërmarrjes.*
- *<u>Përmbledhja e asaj që dihet aktualisht</u>: Nëse një prokurori i është dhënë mandati për të kryer hetime ka të ngjarë që ekziston një sasi e madhe informacioni në dispozicion nga burime të ndryshme, të tilla si: raportet e OKB-së, raportet e medias dhe dokumentet e lëshuara nga organizatat joqeveritare. Raportuesit e vendosin veten e tyre gjithnjë e më shumë në rrezik në një përpjekje për të sjellë informacion të besueshëm rreth një konflikti në ndërgjegjen publike. Ky seksion thelbësor grumbullon atë që dihet aktualisht rreth ngjarjeve në fjalë. Hetimi duhet të formohet nga ajo që dihet me siguri rreth ngjarjeve. Ndërkohë që në shumicën e rasteve ky informacion së fundi provon të jetë asgjë më shumë se një drejtim dhe informacion rrethanat paraprijëse. Grumbullimi i informacionit dhe vlerësimi i tij lejojnë që hetimet të hartohen në mënyrë të informuar. Gjatë mandatit të një prokurori kryhen disa hetime. Sa herë që planifikohet një hetim, duhen bërë përpjekje për të identifikuar dhe vlerësuar dëshmitë përkatëse të mbledhura gjatë punës mbi hetimet e tjera.*
- *<u>Personat aktivitetet e të cilëve do të ekzaminohen</u>: Plani i hetimit duhet të përshkruajë në vija të përgjithshme aktivitetet e personave të cilët do të ekzaminohen. Një hetim i plotë dhe i drejtë duhet të ketë "objektiva" specifike hetimi. Thirrja për një hetim ndërkombëtar shpesh shoqërohet nga deklaratat publike të njerëzve që besohet të jenë përgjegjësit. Është e papranueshme për një prokuror të paanshëm të fillojë një hetim mbi këta ose persona të tjerë të zgjedhur posaçërisht pavarësisht masës së mendimit të publikut që i dënon ata tashmë. Një hetim duhet të identifikojë klasën e gjerë të njerëzve sjellja e të cilëve do të hetohet dhe duhet të ngushtohet vetëm në personat specifikë siç diktohet nga rezultatet e hetimit. Për shembull, një hetim mund të identifikojë "autorët e drejtpërdrejtë fizikë të krimeve të kryera më 1/1/2008 në qytetin "X" ose "oficerë të lartë ushtarakë me autoritet mbi Korpusin e 42-të". Ngushtimi i parakohshëm i një hetimi në subjekte specifike rrezikon sfida paanshmërie dhe krijon një të metë të madhe në integritetin e hetimit.*
- *<u>Dëshmitarët e mundshëm që do të intervistohen</u>: Duke pasur parasysh sa më sipër, duhet përpiluar një listë të dëshmitarëve të mundshëm. Lista nuk duhet të identifikojë vetëm emrat e njerëzve dhe grupin e njerëzve që do të intervistohen (p.sh., "viktima të përdhunimit nga qyteti X", ose "oficer i prapavijës nga Korpusi i 42-të.") por duhet të shpjegojë edhe se çfarë informacioni kanë ata. Ky informacion mund të jetë për shkak të pozitës që personi ka pasur, nga deklaratat publike që ka bërë, ose nga ato kanë thënë për këtë person dëshmitarët e tjerë.*
- *<u>Provat fizike</u>: Provat fizike shpesh janë provat më të besueshme që ekzistojnë. Nëse grumbullohen, përpunohen dhe analizohen siç duhet, në shumicën e rasteve ofrojnë një bazë solide mbi të cilën mund të nxirren konkluzione. Kjo pjesë duhet të identifikojë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha burimet e mundshme të provave fizike. Për shkak të mundësisë së shkatërrimit, veçanërisht gjatë kohës së konfliktit, grumbullimi i provave fizike duhet që gjithnjë të jetë një shqetësim shumë i madh për hetimin. Kjo pjesë duhet të përcaktojë, të paktën në terma të përgjithshme, metodat që do të përdoren për të grumbulluar këto prova.*

- *Provat dokumentare: Përvoja ka treguar qartë se dokumentet janë pjesë thelbësore e provave në këto gjykime. Shumica e krimeve që janë nën hetime janë komplekse dhe janë rezultat i përpjekjeve të mëdha kolektive. Organizimi dhe zbatimi i krimeve të tilla pa dyshim që kërkon krijimin e dokumenteve. Ky seksion duhet të përpiqet që të radhis të gjitha burimeve të mundshme të këtij dokumentacioni si dhe identifikimin e pengesave për marrjen e tyre. Gjatë kohës së luftës mund të jetë e vështirë të identifikohen dhe hulumtohen arkivat e këtyre dokumenteve. Disa mbrohen nga ligjet kombëtare të sigurisë e kërkojnë proces gjyqësor të gjatë për t'u marrë.*
- *Burimet për t'u angazhuar: Pasi të jetë krijuar lista, burimet e nevojshme për të plotësuar këto detyra duhet të identifikohen sa më konkretisht që të jetë e mundur. Ndërkohë që parashikimi i burimeve aktuale të kërkuara për një hetim është një ndërmarrje e vështirë dhe e paparashikueshme, duhen bërë përpjekje për të identifikuar të paktën përafërsisht burimet që do të përdoren. Një prokuror që detyrohet të angazhojë burime të kufizuara në disa hetime duhet të ketë informacionin e nevojshëm për të marrë vendime të informuara. Një hetim po ashtu mund të kërkojë burime që nuk ekzistojnë brenda Zyrës së Prokurorit. Burime të tilla si ekspertët e jashtëm dhe analizat laboratorike mund të identifikohen dhe të përcaktohet vëllimi i tyre nëse është e mundur në fillim të hetimit.*
- *Zbatimi i planit: Është e rëndësishme të mendohet për zbatimin e planit hetues. Në përgjithësi, të gjitha detyrat duhet të përmbushen sipas orarit. Disa pista hetimi mund të bazohen në rezultatet e një piste tjetër. Ky seksion duhet të identifikojë këto marrëdhënie të përkohshme dhe të caktojë periudhën gjatë së cilët duhet plotësuar një aktivitet hetues.*
- *Komentet e revizorëve: Përpara zbatimit të një plani hetues duhet bërë një revizion i kujdesshëm dhe gjithëpërfshirës i planit. Kjo duhet bërë nga kolegët e të njëjti rang si dhe nga udhëheqësit më të lartë. Në nivelin e kolegëve duhet të ketë një konsensus që objektivat dhe metodat e hetimit të jenë të vlefshme dhe të kenë gjasa të mjaftueshme të jenë të suksesshme. Në nivelin e udhëheqësve të lartë, rishqyrtimi duhet të marrë parasysh jo vetëm objektivat dhe metodat e një plani individual por edhe ngjashmëritë dhe fushat e mundshme të konfliktit ndërmjet hetimeve të ndryshme të ndërmarra. Atje ku është e mundshme, hetime të ndryshme që ekzaminojnë shqetësimet përkatëse duhet të identifikohen dhe kombinohen për të rritur efikasitetin e punës së përgjithshme. Në rast të ndonjë konflikti ndërmjet hetueseve (një hetues identifikon X si dëshmitar ndërsa një tjetër identifikon X si objekt të mundshëm hetimi) drejtuesit e lartë duhet t'i zgjidhin këto çështje nëse është e mundur ose duhet të ndërtojnë një mekanizëm i cili do të monitorojë konfliktin potencial ndërsa përparojnë të dyja hetimet. Ky proces i rishikimit duhet të rezultojë në një plan hetimi të përpiluar me kujdes që më pas mund të miratohet.*
- *Miratimet: Plani i hetimit duhet të miratohet zyrtarisht në nivel të kolegëve, në nivelin e drejtuesve të lartë dhe në nivel prokurori. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre hetimeve është e domosdoshme që hetimet të fillohen vetëm pas miratimit nga një personel i lartë i Zyrës së Prokurorit.*
- *Rishikimet periodike: Pasi të ketë filluar hetimi, ai duhet rishikuar çdo tre muaj për të vlerësuar ecurinë drejt objektivave të tij dhe për të vlerësuar se si njohuritë kolektive të një ngjarjeje të veçantë kanë evoluar. Gjatë këtyre rishikimeve, këto prova të grumbulluara së fundi duhet të rezultojë në ndryshime të planit të hetimit. Për shembull, grupi i personave për t'u hetuar duhet që me kohë të ngushtohet pasi provat e fundit fajësojnë disa dhe shfajësojnë të tjerë. Teoritë se si krimet janë kryer do të evoluojnë në më mënyrë të ngjashme dhe pista të tëra hetimesh mund të mbyllen me sukses dhe të hapen pista të reja më precize.*
- *Përmbledhjet e detyrave hetuese që duhen ndërmarrë: Për të formuar planin e hetimit duhet krijuar një listë e detyrave që i ndahet pjesëtarëve të ndryshëm të ekipit. Secila detyrë duhet të jetë specifike në kërkesat e saj, në kuadrin kohor për përmbushje, dhe në rezultatin e pritshëm të punës.*

IV. Shtojca 2: Parimet udhëzuese për zhvarrosjet

- *Furnizimet logjistike (p.sh. tavolinat e morgut, aparatet radiografike, dhe thasët e kufomave) duhet të koordinohen në mënyrë që të arrijnë përpara ose në të njëjtën kohë me burimet njerëzore;*
- *Një paketë bazë (për shembull një kontejner transporti me pajisjet e nevojshme) duhet mirëmbajtur që të lejojë ndërmarrjen e punës në terren pas njoftimeve afatshkurtra;*
- *Përpara se të fillojë punën, ekipi duhet të planifikojë punën dhe të përcaktojë furnizimet e duhura;*
- *Duhet për përcaktohen procedura standarde në formën e protokolleve të shkruara për zhvarrimet dhe autopsitë. Këto procedura gjithashtu duhet të mbulojnë procedurat e ruajtjes, të kontrollit dhe trajtimit për grumbullimin e provave;*
- *Ekspertët (p.sh. radiologët) ka të ngjarë që të jenë në dispozicion vetëm për periudha të shkurtra. Gjetja dhe rotacioni i tyre do të jetë një detyrë e mundimshme dhe e vështirë. Më e mira është që në fillim të krijohet një regjistër i ekspertëve të kualifikuar dhe të gatshëm për punë, së bashku me një sistem të thirrjes që do t'i lejojë ata të sillen në vendngjarje menjëherë pas njoftimit;*
- *Organizime të duhura duhen bërë për të pastruar vendet e zhvarrosjeve nga minat dhe grackat me eksplozivë. Vetë kufomat mund të kenë gracka me eksploziv, dhe ekipet duhet të jenë vigjilente gjatë gjithë kohës;*
- *Është më mirë që identifikimi i eshtrave të bëhet nga një kombinim i metodave tradicionale e mostrave të ADN-së;*
- *Varrezat ekzistuese duhet të konsiderohen si vende mbajtjeje për kufomat e paidentifikuara dhe po ashtu për ruajtjen higjienike të trupave përpara ekzaminimit;*
- *Pajisjet duhet t'i përshtaten kushteve dhe të plotësojnë kërkesat minimale. Thasët dhe arkivolet duhet të shënohen me shënjues të përhershëm. Arkivolet e bëra me tallash të presuar mund të jenë të mjaftueshëm në morg, por shpërbëhen nëse përdoren për të transportuar kufomat në shi;*
- *Kufomat duhet që në fund t'iu kthehen të afërmve dhe komunitetit vendor që të varrosen sipas dëshirave të tyre;*
- *Pjesëtarët e ekipit, disa prej të cilëve mund të jenë ndihmës të rinj dhe pa përvojë, duhet të këshillohen rregullisht mbi stresin.*

IV. Shtojca 3: Parimet udhëzuese për intervistimin e viktimave të sulmeve seksuale

- ***Njihe situatën e sigurisë**: Grumbullo sa më shumë informacion që të jetë e mundur paraprakisht rreth sigurisë fizike dhe psikologjike të të mbijetuarit, përfshi palët në konflikt, statusin e konfliktit, vendndodhjen e grupit të autorëve të krimit në afërsi të dëshmitarit, marrëdhënien ndërmjet aktorëve përkatës përfshi luftëtarët, zyrtarët, udhëheqësit e komunitetit, familjen dëshmitarit , strukturën e komunitetit dhe rolet brenda konfliktit.*
- ***Njihe kontekstin politik**: Mëso më parë sa më shumë që të jetë e mundur për rrethanat politike, konfliktin dhe gjeografinë, dhe motivimet të palëve të përfshira, përkatësisht, dhe strukturat vendore dhe rajonale të pushtetit.*
- ***Njihe kontekstin kulturor**: Ji i përgatitur me njohuri për strukturën sociale, besimet dhe praktikat fetare, përshëndetjet tradicionale, mënyrën e duhur të sjelljes, metodat e thyerjes së barrierave në ndjeshme nga ana kulturore. Mëso rreth indikatorëve kohorë, dhe rreth traditave të tregimtarisë. Zhvillo një ndërgjegjësim në thellësi të tabuve që rrethojnë dhunën seksuale në komunitetin e të mbijetuarit, dhe pasojat sociale të dhënies së dëshmive të tilla.*
- ***Mos dëmto**: Vëre dëshmitarin mbi dëshminë. Fuqizoje dëshmitarin nëpërmjet respektit dhe konfirmimit, duke përdorur fjalët e tij dhe jo duke i zëvendësuar me fjalët e tua. Bëhu i duruar. Mos supozo asgjë. Dhe mos e nxito as dëshmitarin as veten. Mëso kur duhet të ndalosh.*
- ***Sigurohu që ke marrë miratimin e informuar**: Fuqizoje dëshmitarin duke i dhënë një zgjedhje nëse do të flasë dhe si do të flasë me ju. Dobësimi i viktimës së dhunës seksuale mund të shkaktojë një traumë tjetër. Ke parasysh se hetuesit padyshim kanë fuqi, e cila mund të përdoret për mirë ose për keq. Përpiqu të mos bësh premtime të asnjë lloji, dhe bëhu i kujdesshëm dhe përpiqu të shmangësh presionin e butë.*
- ***Njihe ligjin**: Kjo e përgatitë hetuesin me një skicë të elementëve të krimeve që duhet të provohet me prova. Rrite integritetin e produktit përfundimtar të prodhuar nëpërmjet intervistimit të dëshmitarit, dhe iki intervistave të panevojshme shtesë me dëshmitarë për të cilët vetë procesi i tregimit të historisë së tyre do të thotë përjetimi sërish i ngjarjeve. Më e mira është që hetuesit të shkojnë në terren me një "aide memoire" të shkurtët të elementëve të krimeve dhe llojeve të dëshmive që mund të shërbejnë për të provuar këto krime. Në pushimet gjatë një interviste, hetuesi mund të shikojë "aide memoire-in" dhe mund të përkujtohet menjëherë për aspekte që duhen sqaruar menjëherë.*

V. Aktakuza

A. Gatishmëria për ngritjen e lëndës.....37
B. Mbingarkimi i aktakuzave.....38
C. Koncepti i "njoftimit adekuat".....38
C.1 Faktet me rëndësi.....38
C.2 Mënyrat e përgjegjësisë.....39
D. Standardizimi i formave të aktakuzave.....41
E. Aprovimi gjyqësor i aktakuzës.....41
E.1 Procedura e konfirmimit të aktakuzës.....41
E.2 Procesi i konfirmimit, si pikë kontrolli.....42
F. Kundërshtimi i aktakuzës.....42
G. Gjykimi i bashkuar i të pandehurve.....42
H. Gjykimi i bashkuar i krimeve.....43
I. Aktakuzat "nën vulë".....44
J. Ndryshimet e aktakuzës.....45
V. Shtojca 4: Standardet e shqyrtimit të aktakuzës përpara procesit gjyqësor 46

1. Siç e ka praktika e shumë sistemeve të brendshme, TPNJ-ja i ngre akuzat kundër të pandehurit në një aktakuzë. Aktakuza është instrumenti kryesor që garanton të drejtën e pandehurit *"të informohet në kohë dhe me hollësi, në një gjuhë që ai e kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij"* (Neni 21 pika 4 germa "a" e Statutit të TPNJ-së). Prokuroria ka detyrimin t'i vërtetojë faktet dhe akuzat që përmban aktakuza.

2. Aktakuza shërben për tre qëllime kryesore:
   - ofron bazën për arrestimin e të pandehurit, pas konfirmimit të saj;
   - e njofton të pandehurin me akuzat që ngrihen kundër tij;
   - siguron bazën për parashtrimin e çështjes nga prokuroria, pra bazën për vetë procesin gjyqësor, pasi të jenë gjykuar kundërshtimet mbi formën e saj dhe/ose kërkesat për ndryshimet e saj.

3. Aktakuza është dokumenti parësor, mbi të cilin mbështetet prokuroria për t'i dhënë njoftim të pandehurit në lidhje me lëndën që ngrihet kundër tij. Është e rëndësishme të evitohet situata në të cilën akuzat ndryshojnë në vazhdimësi, sepse kështu i pandehuri e ka të vështirë t'i kundërshtojë ato.

A. Gatishmëria për ngritjen e lëndës

4. Në një rast ideal, lënda duhet të jetë gati për gjykim përpara nxjerrjes së aktakuzës dhe të përbëjë objektin e hetimit nga prokuroria për t'i mbledhur të gjitha provat përpara ngritjes së akuzave. Mirëpo, përvoja e TPNJ-së ka treguar se, në lëndët e mëdha e komplekse të krimeve të luftës, hetimet vazhdojnë edhe shumë kohë pas fazës në të cilën është përpiluar materiali i mjaftueshëm për përligjjen e ngritjes së akuzës kundër të pandehurit. Në praktikë, nuk është e mundur që aktakuza përfundimtare të jetë gati që në fillim të lëndës. Për më tepër, nëse pritet gjersa të jetë "i plotë" hetimi, mund të ndodhë që të humbasë shansi i papërsëritshëm për arrestimin e të pandehurit. Rrjedhimisht, koha e marrjes së vendimit për nxjerrjen e aktakuzës duhet të jetë rezultat i vendosjes në baraspeshim të nevojës për ta arrestuar të pandehurin dhe të dëshirës për thellimin më tej të hetimeve.

5. Megjithëse këqyrja e hollësishme mund të bëhet më vonë, nëse mbrojtja e kundërshton formën e aktakuzës, parapëlqehet të merret konfirmimi nga gjykata që në fazën më të hershme. Një shqyrtim i pavarur dhe i hollësishëm i aktakuzës siguron që krimet të përshkruhen siç duhet dhe që çdo pikë e aktakuzës të jetë e mbështetur në prova.

B. Mbingarkimi i aktakuzave

6. Një prej mësimeve më të rëndësishme që del nga përvoja e TPNJ-së, është se, duke pasur parasysh natyrën komplekse të gjykatave për krimet e luftës, ekziston prirja që aktakuzat të mbingarkohen me akuza, duke ia bërë të vështirë procesit penal përballimin e shkallës së çështjeve që duhen provuar. Ky problem bëhet sidomos i mprehtë në ato lëndë ku gjykohen udhëheqësit apo në ato lëndë ky gjykohen gjenocidi dhe krimet kundër njerëzimit, të cilat medoemos kërkojnë ndjekjen penale të grupeve të mëdha të të pandehurve. Sjellja kriminale e një të pandehuri, në një lëndë të tillë, ka të ngjarë të mbulojë një periudhë të gjatë kohore dhe në disa zona të tjera gjeografike, me shumë viktima dhe kryestë krimeve. Në lëndët ku gjykohen udhëheqësit, mund të jetë e vështirë të vendosjet lidhja midis komandantëve, sidomos udhëheqësve politikë, dhe incidenteve që kanë ndodhur në terren. Në proceset penale të nivelit të lartë, mund të ekzistojë edhe dëshira për t'u siguruar që akuzat ta pasqyrojnë si duhet kriminalitetin e të pandehurit, në mënyrë të atillë që ta mbajë mend historia. Ndonjëherë, këta faktorë i nxisin prokurorët të ngrenë aktakuza që janë aq të rënduara saqë i bëjnë gjykimet të pamenaxhueshme brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, është praktikë e mirë që kur të hartohet një aktakuzë, të bëhet një çmuarje se sa kohë ka të ngjarë të marrë gjykimi i çështjes, duke mbajtur parasysh të drejtën e të pandehurit për gjykim të përshpejtuar.

7. Për shkak të gamës së krimeve të mundshme dhe mbivendosjes mes tyre, në shumicën e rasteve të njëjtat fakte bazë mund të mbështetin konkluzionet e ndryshme juridike për përgjegjësinë e një të pandehuri. Të njëjtat fakte, për shembull të njëjtat vrasje, mund të përbëjnë bazën për një numër krimesh si gjenocidi, shfarosja apo vrasja. Është mirë të shmanget paraqitja dyfishe e panevojshme e pikave të akuzës. Në varësi të forcës së provave, pikat e akuzës mund të duhet të paraqiten në formë alternative, por duhet treguar kujdes të shmanget renditja e teorive të shumëfishta të përgjegjësisë në atë mënyrë që errësojnë teorinë kryesore të prokurorisë.

8. Në TPNJ është zhvilluar një jurisprudencë e konsiderueshme lidhur me formën e aktakuzës, çka ka krijuar një prag të nevojshëm për nivelin e hollësisë në brendinë e aktakuzës. Neni 18 i Statutit të TPNJ-së kërkon një përshkrim konciz të fakteve dhe të krimit ose krimeve për të cilat akuzohet i akuzuari. Nuk është nevoja që prokuroria të përfshijë prova në aktakuzë (domethënë, përshkrim se si do të provohen faktet) (shih Shtojcën në CD ROM: *Shembull aktakuze: Dragomir Milošević*).

C. Koncepti i "njoftimit adekuat"

C.1 Faktet me rëndësi

9. Faktet që duhen parashtruar në aktakuzë, faktet me rëndësi, janë faktet mbi të cilat bazohet secila prej pikave të aktakuzës.[3] Me fjalë të tjera, aktakuza duhet të përfshijë faktet mbi të cilat bazohet secili prej elementeve të krimeve që kërkohet të gjykohen, si edhe format e përgjegjësisë së pandehur, domethënë mënyrën me të cilën ka marrë pjesë në krim i pandehuri. Ideja është që nëse pala mbrojtëse nuk njoftohet si duhet për faktet me rëndësi të krimit që kërkohet të gjykohet gjersa prokuroria ta depozitojë dosjen paragjyqësore, apo gjersa të fillojë vetë gjykimi, do të jetë e vështirë, për të mos thënë e pamundur, që i pandehuri ta planifikojë dhe përgatisë mbrojtjen e vet përpara fillimit të gjykimit.[4] Për më tepër, aktakuza që

3 *Kvoçka dhe të tjerë*, Aktgjykimi i Apelit, para. 27.
4 *Kvoçka dhe të tjerë*, Aktgjykimi i Apelit, para. 28.

thjesht sa i rendit akuzat e ngritura ndaj të pandehurit, pa dhënë hollësi të mjaftueshme për faktet me rëndësi, nuk quhet njoftim adekuat, meqenëse i mungon "niveli i nevojshëm i hollësive për ta informuar të pandehurin me qartësi lidhur me akuzat e ngritura kundër tij, në mënyrë që të ketë mundësi ta përgatisë mbrojtjen e vet".[5] Me fjalë të tjera, një aktakuzë e tillë është e mangët.[6]

10. Niveli i hollësive të fakteve me rëndësi, që duhen përfshirë në aktakuzë, varet nga natyra e dosjes së prokurorisë. Karakterizimi i sjelljes së pandehur kriminale nga prokuroria dhe afërsia e të pandehurit me krimin bazë janë faktorë vendimtarë në përcaktimin e shkallës së informacionit specifik që kërkon dispozita për njoftim adekuat. Kur një aktakuzë pretendon se i pandehuri i ka kryer personalisht krimet, faktet me rëndësi (për shembull, identiteti i viktimës, koha dhe vendi i ngjarjeve dhe mjetet me të cilat janë kryer veprat objekt i gjykimit) duhet të parashtrohen me hollësi.[7] Por, në raste të tjera, prokuroria mund të mos e ketë një informacion kaq të hollësishëm, ose vetë shkalla e krimeve objekt i gjykimit është e tillë që e bën jopraktike kërkimin e hollësive specifike, si identiteti i viktimave apo datat e sakta të kryerjes së krimeve.[8] Në çdo rast, aktakuza duhet të përmbajë informacion të mjaftueshëm për t'i dhënë mundësi të pandehurit t'i kuptojë akuzat dhe të mbrohet në mënyrë të efektshme (shih "*Lënda Galić - "Njoftimi adekuat""*).

> ***Lënda Galić – "Njoftimi adekuat"***
>
> *Kërkesa që Prokuroria të parashtrojë në aktakuzë, të paktën, faktet përfaqësuese me rëndësi, tregohet në lëndën Galić. Stanislav Galić-i ishte komandant i trupave "Romanija" të Sarajevës dhe komandant de jure i personalit ushtarak serb të Bosnjes, të pranishëm në Sarajevë. Aktakuza kundër Galić-it e akuzonte për: kryerjen e një fushate granatimi dhe gjuajtje me snajperë me objektiv zonat civile të Sarajevës nga data 10 shtator 1992 deri më 10 gusht 1994, e cila shkaktoi terror tek popullsia civile, duke vrarë dhe plagosur një numër të madh personash. Pikat e aktakuzës mbështeteshin me një numër përfaqësues ngjarjesh të veçanta, të renditura në një aneks, për të përmbushur kërkesën e Tribunalit që i pandehuri të njoftohet për akuzat kundër tij (hollësia konkrete e parashtrimit), si edhe në prova të tjera shtesë për goditjen me snajperë, granatimin dhe aspektet e tjera të situatës në Sarajevë.* Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se aktakuza, në tërësi, i jepte njoftim adekuat Galić-it për akuzat kundër tij.*
>
> _____
>
> * Galić, Aktgjykimi i Apelit, para. 3.

C.2 Mënyrat e përgjegjësisë

11. Neni 7 i Statutit të TPNJ-së identifikon këto forma të përgjegjësisë: planifikimi, nxitja, urdhërimi, kryerja, ndihma dhe inkurajimi,[9] si edhe përgjegjësia si epror.[10] Aktakuza duhet të parashtrojë vetëm mënyrën ose mënyrat e përgjegjësisë mbi të cilat synon të mbështetet prokuroria[11] dhe, për të shmangur keqkuptimet, duhet të identifikojë me saktësi formën ose format e përgjegjësisë penale për krimet që janë objekt i akuzave të ngritura në aktakuzë.[12] Nëse një aktakuzë vetëm sa i citon dispozitat e Nenit 7 pika 1 të Statutit të TPNJ-së, por nuk përcakton mënyrën a mënyrat e përgjegjësisë mbi të cilat ngrihet akuza, atëherë akuzat kundër të pandehurit mund të jenë të paqarta.[13] Me zhvillimin e saj, jurisprudenca e TPNJ-së ka kërkuar një shkallë gjithnjë e më të lartë hollësie në aktakuzat e saj, sidomos në lidhje me specifikimin e pikave të akuzës dhe

5 *Simić,* Aktgjykimi i Apelit, para. 20; *Kupreškić dhe të tjerë,* Aktgjykimi i Apelit, para. 88.
6 *Kupreškić dhe të tjerë,* Aktgjykimi i Apelit, para. 114.
7 *Naletilić dhe Martinović* Aktgjykimi i Apelit, para. 24; *Kupreškić*, Aktgjykimi i Apelit, para. 28; *Krnojelac*, Aktgjykimi i Apelit, para. 132.
8 *Naletilić dhe Martinović* Aktgjykimi i Apelit, para. 25-27; *Kvočka,* Aktgjykimi i Apelit, para. 30-31; *Krnojelac*, Aktgjykimi i Apelit, para. 131-132.
9 Nenet 7(1) dhe 6(1), përkatësisht të Statutit të TPNJ-së dhe Statutit të TPNR-së.
10 Nenet 7(3) dhe 6(3), përkatësisht të Statutit të TPNJ-së dhe Statutit të TPNR-së.
11 *Simić,* Aktgjykimi i Apelit, para. 21 (ku citohet Aktgjykimi i Apelit i lëndës *Kvočka*, para. 29).
12 *Prokurori kundër Prlić-it e të tjerë*, Lënda Nr. IT-04-74-AR72.3, Vendim për Apelin e Petković-it lidhur me juridiksionin, 23 prill 2008, para. 20; *Krnojelac*, Aktgjykimi i Apelit, para. 138-139; *Prokurori kundër Popović-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-88-PT, Vendim për mocionin që kundërshton Aktakuzën sipas rregullës 72 të Rregullores, 31 maj 2006 para. 25.

mënyrave të pjesëmarrjes në krimet që kërkohet të gjykohen.

12. Aktakuza duhet të parashtrojë faktet me rëndësi, të cilat lidhen me secilën prej formave të përgjegjësisë të pretenduar.[14] Për shembull, kur prokuroria paraqet "nxitjen" apo "urdhërimin" si mënyra të përgjegjësisë, ajo duhet të përshkruajë me saktësi veprat nxitëse dhe personat a grupet e nxitura,[15] si edhe faktet me rëndësi të cilat tregojnë se i pandehuri ka urdhëruar kryerjen e një krimi të caktuar në një rast të caktuar.[16] Nëse prokuroria mbështetet te një teori e ndërmarrjes së përbashkët kriminale (NPK) si njëra prej formave të kryerjes së krimit, atëherë prokuroria duhet të parashtrojë qëllimin e ndërmarrjes, kategorinë e saj,[17] identitetin e pjesëmarrësve dhe natyrën e pjesëmarrjes së të pandehurve në ndërmarrje.[18] Përfshirja e këtij informacioni në brendësi të aktakuzës pranohet tani se është jo vetëm një praktikë e mirë, por edhe një element thelbësor i njoftimit të drejtë të të pandehurit me akuzat që ngrihen kundër tij dhe ndaj të cilave pritet të mbrohet ai (shih kutinë "*Lëndët Simić dhe Kupreškić – Kërkesa për njoftimin adekuat*").

> ***Lëndët Simić dhe Kupreškić – Kërkesa për njoftimin adekuat***
>
> *Në lëndën Simić, Dhoma Gjyqësore kishte arritur në përfundimin se, megjithëse versioni përfundimtar i aktakuzës kundër nuk ngrinte në mënyrë specifike akuza për pjesëmarrjen e tij në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, Simić-it i qe dhënë njoftim i mjaftueshëm për akuzat për ndërmarrje të përbashkët kriminale përmes përfshirjes në aktakuzë të fjalëve "duke vepruar në bashkëpunim së bashku". Mirëpo, Dhoma e Apelit i prapësoi konstatimet e Dhomës Gjyqësore dhe u shpreh se asnjëri prej versioneve të aktakuzës nuk i jepte të pandehurit "njoftim adekuat dhe në kohë se akuzohej se ishte pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale". Dhoma e Apelit konstatoi se gjykimi ishte jo i drejtë për shkak të njoftimit të mangët dhe e shfuqizoi shpalljen fajtor të Simić-it për akuzën e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.**
>
> *Në mënyrë të ngjashme, në lëndën Kupreškić, Dhoma e Apelit konstatoi se akuza e përndjekjes e ngritur kundër Zoran dhe Mirjan Kupreškić-it nuk ishte specifike sa duhej, sepse Prokuroria nuk e kishte specifikuar rolin e tyre në sjelljen kriminale nën akuzë. Në rrethanat e lëndës, kjo mungesë e njoftimit specifik e bënin jo të drejtë gjykimin dhe, për shkak të arsyetimit të gabuar të Dhomës Gjyqësore gjatë vlerësimit të provave, ky gjykim kishte çuar në shpalljen të pafajshëm të dy personave të pandehur.***
>
> * shih Simić dhe të tjerë, Aktgjykimi i Apelit, para. 73-74.
> ** shih Kupreškić dhe të tjerë, Aktgjykimi i Apelit, para. 245-246.

13. Aktakuzat që pretendojnë mënyra të përgjegjësisë për të cilat nuk paraqitet asnjë fakt me rëndësi, konsiderohen si të paqarta dhe, për rrjedhojë, të mangëta.[19] Prokurorisë nuk i lejohet të ngrejë akuza për forma të përgjegjësisë në një aktakuzë të cilat nuk identifikohen në Statut ose të cilat nuk përfshihen nga njëra prej formave të përgjegjësisë penale të renditura në Statut.[20]

13 Shih, për shembull, *Aleksovski,* Aktgjykimi i Apelit, shënimi 319 më lart; *Čelebići*, Aktgjykimi i Apelit, para. 350; *Krnojelac*, Aktgjykimi i Apelit, para. 138-144.
14 *Kvočka dhe të tjerë,* Aktgjykimi i Apelit, para. 29.
15 *Blaškić,* Aktgjykimi i Apelit, para. 226.
16 *Kvočka dhe të tjerë,* Aktgjykimi i Apelit, para. 41.
17 Dhoma e Apelit e TPNJ-së ka identifikuar tri forma të ndërmarrjes së përbashkët kriminale (bazë, në sistem dhe të zgjeruar).
18 *Kvočka dhe të tjerë,* Aktgjykimi i Apelit, para. 29.
19 *Kvočka dhe të tjerë,* Aktgjykimi i Apelit, para. 41.
20 Shih, për shembull, *Prokurori kundër Prlić-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-AR72.3, Vendim për Apelin e Petković-it lidhur me juridiksionin, 23 prill 2008, para. 21-22; *Stakić*, Aktgjykimi i Apelit, para. 62; *Prokurori kundër Milutinović-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87-PT, Vendim për mocionin e Ojdanić'-it për kundërshtimin e juridiksionit: Bashkëkryerja e tërthortë, 22 mars 2006, para. 40; *Prokurori kundër Čermak-ut dhe Markač-it*, Lënda Nr. IT-03-73-PT; *Prokurori kundër Gotovina-s*, Lënda Nr. IT-01-45-PT, Vendim i përbashkët për mocionin e konsoliduar të Prokurorisë për ndryshimin e Aktakuzës dhe për bashkimin e gjykimit, 14 korrik 2006, para. 24-26.

D. Standardizimi i formave të aktakuzave

14. Struktura dhe formulimi gjuhësor i një aktakuze mund të ndikohen nga kompleksiteti i lëndës, e cila mund të kërkojë përfshirjen e një sasie të madhe informacioni. Pasojat e një aktakuze të mangët mund të jenë të rënda. Megjithatë, praktika e TPNJ-së ka sjellë një shkallë organizimi dhe standardizimi të formës dhe përmbajtjes së aktakuzave. Këto aktakuza të standardizuara i kanë kapërcyer vështirësitë dhe, i shërbejnë pra qëllimit të dhënies së një shembulli të formave të lejueshme të aktakuzave (shih Shtojcën në CD ROM – *Shembull i një aktakuze të TPNJ-së*).

15. Prokuroria, më në fund miratoi procedura të brendshme për shqyrtimin e aktakuzave përpara finalizimit dhe dërgimit të tyre gjykatësit për konfirmim. Duke përdorur një proces oponence teknike, ekipi i prokurorisë ua paraqiste projektaktakuzën kolegeve nga ekipet e tjera dhe e mbronte versionin e vet kundrejt pyetjeve të kolegëve. Këto shqyrtime të brendshme të aktakuzave kanë ndihmuar në krijimin e një qasjeje të njëtrajtshme dhe shpesh i ka nxjerrë në pah problemet e një aktakuze. Këto shqyrtime shërbejnë edhe për të nënvizuar nevojën për prova më të mira apo për hetime të mëtejshme dhe kanë kontribuar edhe me sugjerime për përmirësime.

E. Aprovimi gjyqësor i aktakuzës

16. Forma, përmbajtja dhe procesi i finalizimit të aktakuzës, ndryshojnë nga një sistem juridik në tjetrin. Sipas praktikës së TPNJ-së, e mishëruar në Statutin dhe Rregulloren e saj, një prokuror i pavarur harton aktakuzën, dhe pastaj këtë aktakuzë e konfirmon një gjyqtar. Kjo praktikë që kërkon këqyrje gjyqësore të aktakuzës, siguron një masë mbrojtëse nga shpërdorimi i prokurorisë. Duke pasur parasysh që lëndët e krimeve të luftës shpesh gjykohen mes turbullirave politike, është praktikë e mirë kjo e vendosjes së ekuilibrave në pushtetin që ka prokuroria për ngritjen e aktakuzave. Por, është po aq e rëndësishme që prokuroria të funksionojë në mënyrë të pavarur dhe në mënyrë të atillë që të shmangë nënshtrimin ndaj trysnive politike për ngritjen e akuzave. Në funksion të kësaj, Neni 16 i Statutit të TPNJ-së parashikon shprehimisht: "Prokurori vepron në mënyrë të pavarur si organ i veçantë i Tribunalit Ndërkombëtar. Ai/ajo nuk kërkon dhe nuk merr udhëzime prej asnjë qeverie ose burimi tjetër."

E.1 Procedura e konfirmimit të aktakuzës

17. Në praktikën e TPNJ-së, aktakuza e propozuar dhe çdo material mbështetës duhet t'i paraqitet një gjyqtari të caktuar për shqyrtimin e aktakuzave (gjykatësi shqyrtues). Gjyqtari shqyrtues duhet të këqyrë çdo pikë të aktakuzës dhe të vendosë nëse, në brendi të aktakuzës, ka argumente *prima facie* kundër personit të dyshuar, në bazë të materialit mbështetës. Nëse gjyqtari shqyrtues bindet se aktakuza e përmbush këtë standard,[21] ai e konfirmon aktakuzën. Krahas kësaj, gjyqtari shqyrtues, me kërkesën e prokurorisë, mund të nxjerrë vendimet e duhura gjyqësore për ndalimin, shoqërimin ose transferimin e personave, ose për çdo qëllim tjetër që e kërkon procesi gjyqësor. Mirëpo, nëse nuk bindet që aktakuza ngre një çështje *prima facie* kundër të pandehurit, gjyqtari shqyrtues mund t'i kërkojë prokurorit të paraqesë prova të tjera shtesë në mbështetje të një ose të gjitha pikave të aktakuzës, duke pushuar një ose disa pika të akuzës ose duke e shtyrë shqyrtimin e aktakuzës për t'i dhënë mundësi prokurorit ta modifikojë atë.[22]

21 *Galić*, Aktgjykimi i Apelit, para. 42; *Čelebići*, Aktgjykimi i Apelit, para. 434.
22 Rregulla 47(F), RrPP e TPNJ-së; Neni 19(2), Statuti i TPNJ-së.

E.2 Procesi i konfirmimit, si pikë kontrolli

18. Në praktikën e TPNJ-së, procesi i konfirmimit nuk shkon përtej një vlerësimi të mjaftueshmërisë *prima facie* të provave që përmbajnë materialet mbështetëse, të cilat i paraqiten gjyqtarit shqyrtues. Në përgjithësi, është zbatuar një test me prag relativisht të ulë, dhe TPNJ-ja nuk kërkon që lënda të jetë "e gatshme për gjykim" në fazën e aktakuzës. Po t'i hedhim sytë nga e shkuara, qasja e TPNJ-së mund të mos ketë qenë e pëlqyeshme dhe një qasje më rigoroze do të kishte qenë më e mirë. Sikur Tribunali ta kishte njohur procesin e konfirmimit si një pikë jetike kontrolli të procesit më të gjerë, apo sikur të kishte zhvilluar një proces akuzimi me dy faza, ku përgatitja e aktakuzës së hollësishme do të ishte në një fazë të mëvonshme, atëherë TPNJ-ja duhet të kishte qenë në gjendje ta menaxhonte procesin paragjyqësor. Mirëpo, cilido Tribunal që do të donte të zhvillonte një rol më të madh gjyqësor në procesin e konfirmimit, duhet të mbrojë me kujdes pavarësinë e prokurorisë.

F. Kundërshtimi i aktakuzës

19. Një garanci thelbësore e një procesi të drejtë gjyqësor është e drejta e të pandehurit për të kundërshtuar, përmes mocionit paragjyqësor, aspekte të ndryshme të lëndës së prokurorisë kundër tij. Përpara TPNJ-së të pandehurit i duhet t'i paraqesë këto kundërshtime brenda 30 ditësh pasi prokuroria bën të ditura materialet mbi të cilat mbështetet për të kërkuar konfirmimin e aktakuzës të konfirmuar nga gjyqtari shqyrtues. I pandehuri mund të paraqesë një mocion paraprak me të cilin e kundërshton juridiksionin e Tribunalit ose pretendon se ka mangësi në formën e një aktakuze.[23] Nëse konstaton se kundërshtimi i të pandehurit është i bazuar, Dhoma Gjyqësore i kërkon prokurorisë të bëjë shtesa e ndryshime në aktakuzë (shih Shtojcën 4 – *Standardet e shqyrtimit të aktakuzës përpara procesit gjyqësor*).

G. Gjykimi i bashkuar i të pandehurve

20. Kur të pandehurit akuzohen se i kanë kryer së bashku krimet, praktika ka treguar se është mirë të gjykohen së bashku, si bashkë-të-pandehur në kuadër të njëjtës aktakuzë. Në praktikën e TPNJ-së, kur ka më shumë se një të pandehur si të akuzuar për të njëjtat krime ose për krime të ndryshme që janë pjesë e të njëjtit veprim (domethënë, një skemë, strategji ose plan i përbashkët i cili mund të përfshijë një ose shumë ngjarje të njëjtin vend dhe kohë ose në vende dhe kohë të ndryshme),[24] kundër tyre mund të ngrihet një proces i përbashkët në kuadër të së njëjtës aktakuzë dhe mund të gjykohen së bashku në të njëjtin proces gjyqësor.[25]

23 Rregulla 72(A)(i) dhe (ii), 66(A)(i), RrPP e TPNJ-së; shih edhe rregullat 72(B) dhe 73, RrPP e TPNJ-së.

24 "Transaksioni" përkufizohet si "një sërë veprimesh ose mosveprimesh, pavarësisht nëse ndodhin si një ngjarje ose si një numër ngjarjesh, në të njëjtat vendndodhje ose në vendndodhje të ndryshme dhe që janë pjesë e një skeme, strategjie a plani". (Regulla 2(A)). Shih edhe *Prokurori kundër Zdravko Tolimir-it*, *Radivoje Miletić-it dhe Milan Gvero-s*, Lënda Nr. IT-04-80-AR73.1, Vendim për apelin e ndërkohshëm të Radivoje Miletić-it kundër Vendimit të Dhomës Gjyqësore për bashkimin e të pandehurve, 27 janar 2006 ("Vendimi "*Miletić*" për bashkimin"), para. 7; *Prokurori kundër Vinko Pandurević-it dhe Milorad Trbić-it*, Lënda Nr. it-05-86-ar73.1, Vendim për apelin e ndërkohshëm të Vinko Pandurević-it kundër Vendimit të Dhomës Gjyqësore për bashkimin e të pandehurve, 24 janar 2006 ("Vendimi "*Pandurević*" për bashkimin"), para. 7; *Prokurori kundër Milošević-it*, Lënda Nr.: IT-99-37-AR73, IT-01-50-AR73, IT-01-51-AR73, Arsyet e vendimit për apelimin e ndërkohshëm të Prokurorisë për refuzimin për të vendosur bashkimin, 18 prill 2002 (Vendimi i Apelit "*Milošević*" për bashkimin), para. 13-17, 21.

25 Rregulla 48, RrPP e TPNJ-së; *Prokurori kundër Ante Gotovina-s* dhe *Prokurori kundër Ivan Čermak-ut dhe Mladen Markač-it*, Lënda Nr. IT-01-45-AR73.1, IT-03-73-AR73.2, Vendim për apelimet e ndërkohshme kundër vendimit të Dhomës Gjyqësore për ndryshimin e Aktakuzës dhe për bashkimin, 25 tetor 2006 (Vendim i ndërkohshëm "*Gotovina*", datë 25 tetor 2006"), para. 16; Vendimi *"Miletić"* për bashkimin, para. 7-8; Vendimi *"Pandurević"* për bashkimin, para. 7-8;

Prokuroria mund të zgjedhë t'i bashkojë të pandehurit qysh në fillim të lëndës, ose të paraqesë kërkesë për bashkim gjatë gjykimit. Numri i të pandehurve që mund të gjykohen në një proces të vetëm varet nga kufizimet objektive që lindin nga kufizimet e hapësirës fizike. Në varësi të fazës së procesit, lejen për bashkimin e të pandehurve në një lëndë duhet ta japë Dhoma Paragjyqësore ose Dhoma Gjyqësore. Gjatë marrjes së vendimit, Dhoma Paragjyqësore ose Dhoma Gjyqësore duhet të sigurohet që secilit të pandehur në gjykimin e bashkuar t'i garantohen të njëjtat të drejta që do të kishte gëzuar sikur të gjykohej më vete. Madje, Dhoma mund të kërkojë zhvillimin e proceseve gjyqësore të veçanta, për të mbrojtur të drejtat e të pandehurve, në mënyrë që të shmangen konfliktet e interesit që mund ta cenojnë një të pandehur ose në mënyrë që të garantohen interesat e drejtësisë.[26]

21. Brenda 30 ditëve pasi prokuroria ia bën me dije të pandehurit materialet ku mbështetet aktakuza, i pandehuri mund të depozitojë një mocion paraprak përmes të cilit kërkon procese gjyqësore të veçanta për personat e akuzuar në mënyrë të bashkuar në aktakuzë.[27] Dhoma e ka lirinë të vendosë për ta dhënë ose jo lejen për depozitimin e një kërkese për apel të ndërkohshëm, për të kundërshtuar vendimin e saj për mocionin më lart.[28]

22. Vendimi për gjykimin e bashkuar të disa të pandehurve duhet të mbështetet në argumente politike dhe praktike. Edhe pse mund të preferohet që të gjykohen njëkohësisht të gjithë ata që akuzohen se janë përzier në një krim, në mënyrë që gjyqtarët të mund ta vlerësojnë një transaksion në tërësinë e tij dhe të mund t'i shfrytëzojnë burimet në mënyrë më efikase, ka disa probleme praktike të cilat e pengojnë zhvillimin e gjykimeve të bashkuara. Për shembull, në TPNJ numri i personave ende në ilegalitet dhe fakti se këta persona ende të paarrestuar mund të ndalohen në momente të ndryshme, e ka vështirësuar ndonjëherë ndjekjen e bashkuar penale të gjithë personave të akuzuar për një vepër penale. Mirëpo, përvoja e TPNJ-së ka treguar se, duke pasur parasysh kohëzgjatjen dhe kompleksitetin e një procesi gjyqësor, kështillohet bashkimi i të pandehurve në një proces, sa herë është e mundshme kjo gjë. Gjykimet e veçanta mund të jenë të vështira sepse kërkojnë burime shtesë dhe krijojnë lodhje tek dëshmitarët, duke i kërkuar një dëshmitari kyç të japë atë, që në thelb është e njëjta dëshmi, disa herë. Kjo dhënie e dëshmisë disa herë mund të krijojë pezmatim mes të pandehurve dhe mund të shkaktojë kundërthënie mes deponimeve të dhëna në momente të ndryshme.

H. Gjykimi i bashkuar i krimeve

23. Dy ose më shumë krime të kryera nga një i njëjti i pandehur, mund të bashkohen në një aktakuzë, nëse vargu i veprave, i marrë në tërësinë e vet, përbën një transaksion të vetëm.[29] Por, Dhoma Gjyqësore ruan të drejtën për të mos lejuar bashkime të tilla.

24. Gjatë ushtrimit të kësaj të drejte, Dhoma Gjyqësore mund të shikojë faktet e mëposhtme:
- cenimi që i bëhet të drejtës së të pandehurit për gjykim të drejtë dhe të shpejtë;
- padrejtësia e shkaktuar nga një gjykim gjatësia e të cilit e bënë atë të pamenaxhueshëm;
- rëndesa e barrës mbi të pandehurin;

26 Rregulla 82, RrPP e TPNJ-së; Vendim i ndërkohshëm *"Gotovina"*, datë 25 tetor 2006, para. 17; Vendimi "*Pandurević*" për bashkimin, para. 8 dhe poshtëshënimi 20; *Shih Prokurori kundër Popović-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr., IT-88-AR73.1, Vendim për apelimet kundër vendimeve për pranimin e materialit të lidhur me marrjen në pyetje të Borovčanin-it, 14 dhjetor 2007, para. 43.

27 Rregulla 72(A)(iii), 66(A)(i), 82(B), RrPP e TPNJ-së;

28 Rregullat 72(B)(ii) dhe 73(B), RrPP e TPNJ-së.

29 Për përkufizimin e "transaksionit", shih më lart poshtëshënimin 24.

- cenimi që i bëhet të pandehurit përmes paraqitjes së provave që lidhen vetëm me një vendndodhje, në një gjykim që mbulon disa vendndodhje.

25. Brenda 30 ditëve pasi prokuroria ia bën me dije të pandehurit materialet ku mbështetet aktakuza, i pandehuri mund të depozitojë një mocion paraprak përmes të cilit kërkon veçimin e pikave të akuzës të bashkuara në një aktakuzë të vetme.[30] Dhoma e ka lirinë të vendosë për ta dhënë ose jo lejen për depozitimin e një kërkese për apel të ndërkohshëm, për të kundërshtuar vendimin e saj për mocionin që kërkon veçimin e pikave të akuzës.[31]

Lënda Nikolić – Çështjet e juridiksionit që lidhen me rrethanat e paqarta të arrestimit

Më 21 prill 2000, Dragan Nikolić-i, i akuzuar për krime të ndryshme kundër njerëzimit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij si komandant i kampit burg "Sušica" pranë qytetit të Vllasenicës (Bosnje-Hercegovina). Ai u arrestua në rrethana të paqarta dhe iu dorëzua Prokurorisë së Tribunalit nga Forca e Stabilizimit në Bosnje-Hercegovinë (SFOR). Nikolić-i ngriti pretendimin se persona të paidentifikuar e kishin rrëmbyer në territor serb dhe e kishin çuar në Bosnje-Hercegovinë kundër vullnetit të tij, ku po këta persona e dorëzuan tek zyrtarët e SFOR-it. Dhoma e Apelit pa nëse, si mjeti ligjor i duhur i rivendosjes në vend të të drejtave të Nikolić-it, mund të ishte apo jo mospranimi i ushtrimit të kompetencës së vet si gjykatë. Mirëpo, Dhoma arriti në përfundimin se është e mundur të ushtrohet juridiksioni mbi personat e ndaluar në mënyrë të paligjshme në lëndën e krimeve të njohura në mënyrë universale, si gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës.***

* Prokurori kundër Dragan Nikolić-it, Lënda Nr. IT-94-2-PT, Aktakuza e tretë e ndryshuar, 31 tetor 2003.

** *Prokurori kundër Dragan Nikolić-it, Lënda Nr. IT-94-2-AR73, Vendim për apelin e ndërkohshëm lidhur me ligjshmërinë e arrestimit, 5 shtator 2003, para. 24.*

I. Aktakuzat "nën vulë"

26. Fillimisht, praktika e TPNJ-së ishte që ta nxirrte publikisht një fletarrestimi, me t'u konfirmuar aktakuza. Mirëpo, TPNJ-ja vuri re se publikimi i aktakuzave dhe tërheqja e vëmendjes përmes mediave e pengonte punën, gjë që ndodhte edhe me shpalljen e aktakuzave në procese të hapura të cilat kishin për qëllim evidentimin e mosarrestimit të personave të dyshuar. Kur të pandehurit mësonin se kishte urdhra arresti për ta, jo rrallë ndodhte që të kalonin në ilegalitet, ndonjëherë në territore ku i mbronin. Më në fund, Prokuroria e TPNJ-së ndoqi një praktikë tjetër, në të cilën aktakuzat viheshin "nën vulë" pas konfirmimit (pra nuk bëheshin publike). Kur ekziston mundësia për ta shoqëruar dhe arrestuar një të pandehur, nuk ka dyshim që aktakuzat e vendosura nën vulë janë më të efektshme se ato publike. Aktakuzat nën vulë i japin kohë TPNJ-së t'i informojë autoritetet për ekzistencën e urdhrave të arrestit dhe ta planifikojë arrestimin e tyre, ashtu siç veprojnë edhe forcat tradicionale të policisë. Tribunali mund të fillonte ndjekjen penale, me t'iu dhënë mundësia të ndalonte personat e dyshuar në zonën e prekur më parë nga konflikti. Nga ana tjetër, kur dihej se një i pandehur ishte në gjendje të lirë në territorin e një shteti sovran, publikimi i aktakuzës dhe presioni diplomatik ka më shumë të ngjarë të arrijë rezultate. Asnjë shtet nuk ka të drejtë strehojë një të pandehur dhe ta mbrojë nga arrestimi, mirëpo mospërfshirja e autoriteteve shtetërore në procesin e arrestimit mund të shkaktojë vështirësi (shih kutinë *"Lënda Nikolić – Çështjet e juridiksionit që lidhen me rrethanat e paqarta të arrestimit"*).

27. Mund të lindin probleme, sikurse ka ndodhur në rastin e TPNJ-së, lidhur me mënyrën se si nxirret përpara gjykatës i pandehuri. Disa sisteme të brendshme nuk pranojnë të kenë kompetencë mbi ata të pandehur të cilët janë ndaluar në mënyrë të paligjshme. Për shkak të natyrës ekstraterritoriale të krimeve që janë në kompetencën e Tribunalit, ky i fundit është i detyruar të mbështetet në autoritete të tjera për t'i shoqëruar ose arrestuar personat e akuzuar. Në disa raste të caktuara, janë ngritur akuza për rrëmbim personi dhe të

30 Rregulla 72(A)(iii), 66(A)(i), dhe 49, RrPP e TPNJ-së;
31 Rregullat 72(B)(ii), 73(B), RrPP e TPNJ-së; *Shih më lart*, rubrikën F "Kundërshtimi i aktakuzës".

pandehurit kanë argumentuar se përmes ushtrimit të juridiksionit Tribunali do të sanksiononte shkeljen e të drejtave të tyre gjatë rrëmbimit. Tribunali nuk ka konstatuar në asnjë rast se një rrëmbim personi mund të ketë ndodhur për shkak të ndjekjes penale të nisur prej tij dhe se pretendimet për rrëmbim personi të kryer nga persona të palidhur me proceset e Tribunalit nuk përbëjnë një bazë të mjaftueshme për të përligjur refuzimin nga Tribunali për ushtrimin e juridiksionit të vet.

J. Ndryshimet e aktakuzës

28. Në praktikë, mund të dalë nevoja të ndryshohet një aktakuzë, me daljen e provave të reja. Prokuroria mund ta ndryshojë aktakuzën në çdo kohë përpara se kjo të konfirmohet nga gjyqtari shqyrtues.[32] Mirëpo, pasi aktakuza konfirmohet nga gjyqtari shqyrtues dhe, pra, merr fuqi ligjore, ajo mund të ndryshohet vetëm me lejen e gjyqtarit që e ka konfirmuar ose me lejen e një gjyqtari tjetër të caktuar nga Kryetari i Tribunalit.[33] Pas caktimit të lëndës një Dhome Gjyqësore, aktakuza mund të ndryshohet vetëm me lejen e asaj Dhome Gjyqësore ose të një gjyqtari të asaj Dhome, dhe vetëm pasi palëve u është dhënë mundësia të parashtrojnë qëndrimin e tyre për shtesat dhe ndryshimet e propozuara.[34] Në një rast të tillë, i pandehuri duhet të paraqitet përpara një Dhome Gjyqësore sa më parë për t’i dhënë atij mundësinë të vetëdeklarohet në lidhje me akuzat e reja,[35] dhe i pandehuri mund të depozitojë një mocion paraprak për të kundërshtuar juridiksionin e Tribunalit ose për të pretenduar për mangësi në aktakuzën e ndryshuar, në lidhje me akuzat e reja.[36] Pra, sistemi është ndërtuar në mënyrë të atillë që t’i jepet njëfarë fleksibiliteti prokurorisë për të bërë ndryshime në aktakuzë, në interes të drejtësisë, por në të njëjtën kohë të parandalohen modifikimet dëmtuese që mund të bëhen pa lejen e një gjyqtari.

29. Dhoma Gjyqësore e lejon ndryshimin nëse ai nuk e dëmton të pandehurin.[37] Pra, kriteri kryesor në marrjen e vendimit për ta lejuar ndryshimin, është drejtësia.[38] Në thelb, drejtësia kërkon që t’i jepet të pandehurit mundësia adekuate për të përgatitur një mbrojtje të efektshme, duke mbajtur në konsideratë shtesat dhe ndryshimet.[39] Për një diskutim të kompetencës së Dhomës Gjyqësore për t’i kërkuar prokurorisë uljen e numrit të pikave të akuzës të ngritura në një aktakuzë, apo për ta urdhëruar prokurorinë të zgjedhë pikat e akuzës mbi të cilat dëshiron ta vazhdojë procesin, shih Kreun VII “Procedura paragjyqësore”, seksionin për zvogëlimin e objektit të aktakuzës).

32 Rregulla 50(A)(i)(a), RrPP e TPNJ-së.
33 Rregulla 50(A)(i)(b), RrPP e TPNJ-së.
34 Rregulla 50(A)(i)(c), RrPP e TPNJ-së; *shih* Vendimi “*Gotovina*”, datë 25 tetor 2006, para. 7.
35 Rregulla 50(B), RrPP e TPNJ-së.
36 Rregulla 72(A)(i) dhe (ii), 66(A)(i), RrPP e TPNJ-së.
37 *Prokurori kundër Vojislav Šešelj-it*, Lënda Nr. IT-03-67-PT, Vendim për mocionin e Prokurorisë për leje për të depozituar një aktakuzë të ndryshuar, 14 shtator 2007, para. 14 (*ku përmendet Prokuroria kundër Radoslav Brđanin-it dhe Momir Talić-it*, Lënda Nr. IT-99-36-PT, Vendim për formën e aktakuzës së ndryshuar më tej dhe për kërkesën e Prokurorisë për ndryshim të aktakuzës, 26 qershor 2001 (Vendimi "*Brđanin dhe Talić*"), para. 50; *Prokurori kundër Mladen Naletilić-it dhe Vinko Martinović-it*, Lënda Nr. IT-98-34-PT, Vendim për kundërshtimin e Vinko Martinović-it ndaj Aktakuzës së Ndryshuar dhe për mocionin paraprak të Mladen Naletilić-it për Aktakuzën e Ndryshuar, 14 shkurt 2001, f. 7); *Prokurori kundër Gotovina-s*, Lënda Nr. IT-01-45-PT, Vendim i përbashkët për mocionin e konsoliduar të Prokurorisë për ndryshimin e Aktakuzës dhe për bashkimin e gjykimit, 14 korrik 2006 (Vendim për Aktakuzën “*Gotovina*”), para. 10 (ku përmendet Vendimi “*Brđanin dhe Talić*”, para. 50; *Prokurori kundër Halilović-it*, Lënda Nr. IT-01-48-PT, Vendim për mocionin e Prokurorisë me të cilin kërkohet leje për ndryshim të Aktakuzës, 17 dhjetor 2004, (Vendimi "*Halilović*"), para. 22; *Prokurori kundër Beara-s*, Lënda Nr. IT-02-58-PT, Vendim për mocionin e Prokurorisë për ndryshim të Aktakuzës, 24 mars 2005, f. 2 (Vendimi "*Beara*")).
38 Vendim i ndërkohshëm “*Gotovina*”, datë 25 tetor 2006, para. 8; Vendim për Aktakuzën *“Gotovina”*, para. 10 (ku përmendet Vendimi “*Brđanin dhe Talić”*, para. 50; *Prokurori kundër Ivan Čermak-ut dhe Mladen Markač-it*, Lënda Nr., IT-03-73, Vendim për mocionin e Prokurorisë ku kërkohet leje për ndryshimin e Aktakuzës, 19 tetor 2005 (Vendimi i Dytë për Aktakuzën "Čermak dhe Markač"), para. 35).
39 Vendimi i Dytë për Aktakuzën "*Čermak dhe Markač*”, para. 35.

V. Shtojca 4: Standardet e shqyrtimit të aktakuzës përpara procesit gjyqësor

- *Janë ngritur aktakuza thuajse identike kundër të pandehurve të ndryshëm, të cilët, ndër të tjera, akuzohen se kanë marrë pjesë në të njëjtën ndërmarrje të përbashkët kriminale përmes së cilës janë kryer krime të ndryshme në Kosovë. Janë paraqitur kundërshtime ndaj aspekteve të ngjashme të aktakuzave në lëndën me të pandehur Milutinović-in, Ojdanić-in dhe Šainović-in, ku ky i fundit e kundërshtoi pa sukses formën e aktakuzës,* dhe diçka më shumë se dy vjet më pas, në lëndën me të pandehur Pavković-in, Đorđević-in, Lukić-in dhe Lazarević-in, ku ky i fundit ngriti argumente pjesërisht të ngjashme me ato të ngritura nga Šainović-i. Dhoma Gjyqësore e disponoi kundërshtimin ndaj formës së aktakuzës, të paraqitur nga Lazarević-i, duke iu përgjigjur një mocioni për t'i bashkuar të dy lëndët.*
- *Gjatë shqyrtimit të kundërshtimit të paraqitur nga Lazarević-i, Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se ky kundërshtim duhej gjykuar në themel, në dritën e zhvillimeve juridike. Në veçanti, Dhoma Gjyqësore vërente standardet e vendosura nga Dhoma e Apelit, lidhur me përcaktimin nëse prokuroria i kishte paraqitur apo jo faktet me rëndësi të lëndës, me hollësi të mjaftueshme, në aktakuzat e lëndëve "Blaškić", "Kordić dhe Čerkez", "Kvočka dhe të tjerë" dhe "Ntakirutimana", në mënyrë që të pandehurit të informohen në mënyrë të qartë për natyrën e akuzave të ngritura kundër tyre dhe të jenë në gjendje për ta përgatitur mbrojtjen në mënyrë të efektshme dhe eficiente.***
- *Duke i zbatuar këto standarde, Dhoma Gjyqësore konstatoi se aktakuza kishte mangësi në disa aspekte dhe vendosi t'i kërkojë Prokurorisë ta ndryshojë aktakuzën, si më poshtë:*
  - *Duhej identifikuar ose a) sjellja specifike që mbështeste pretendimin se i pandehuri kishte vepruar në secilën ose ndonjërën prej mënyrave përmes të cilave mund t'i ngarkohen përgjegjësia individuale penale sipas Nenit 7 pika 1 të Statutit; ose b) prokuroria të deklaronte se nuk synonte të mbështetej në sjelljen specifike, por se propozonte t'i kërkonte Dhomës Gjykuese ta nxirrte vetë konkluzionin se i pandehuri kishte vepruar në njërën ose disa prej mënyrave të parashikuara në Nenin 7 pika 1, nga sjellja e forcave mbi të cilat ushtronte pushtet, nga posti që mbante në hierarkinë ushtarake dhe nga marrëdhënia me të tjerët në hierarkinë ushtarake, policore a politike;*
  - *Duhej specifikuar gjendja mendore, e kërkuar për secilën prej formave të ndryshme të përgjegjësisë, sipas Nenit 7 pika 1 të Statutit, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në format e ndryshme të ndërmarrjeve të përbashkëta kriminale nën gjykim, si edhe mënyra se si duhen konstatuar këto fakte me rëndësi;*
  - *Duhej sqaruar se për kë bënte fjalë shprehja "të tjerë të njohur dhe të panjohur" dhe më tej duhej deklaruar identiteti i atyre pjesëmarrësve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale identiteti i të cilëve dihet. Nëse identiteti i pjesëmarrësve nuk dihet, atëherë duhet specifikuar kategoria së cilës i përkasin;*
  - *Duhej specifikuar kategoria e personave të akuzuar për kryerjen e krimeve nën akuzë, duke treguar se cilat prej forcave dhe njësive në vartësi të personit të pandehur akuzoheshin se qenë përfshirë në ngjarjet në secilën komunë dhe duhej specifikuar nëse prokuroria parashtronte se vetëm këto forca dhe njësi qenë përfshirë në kryerjen e krimeve nën akuzë;*
  - *Duheshin specifikuar, nëse ishte në gjendje ta bënte një gjë të tillë prokuroria, 1) njësitë e bashkëngjitura Korpusit të Prishtinës të Armatës Jugosllave në vartësi të Armatës së Tretë Jugosllave, në zonën e kompetencës së Korpusit, të cilat prokuroria pretendonte se komandoheshin nga i pandehuri dhe 2) njësitë policore të republikës që i qenë kaluar në vartësi të Korpusit të Prishtinës të Armatës së Tretë Jugosllave apo*

të njësive territoriale ushtarake, njësive civile të mbrojtjes dhe grupeve të tjera të armatosura, ose që vepronin në bashkëpunim apo bashkërendim me to, mbi të cilat prokuroria pretendonte se i pandehuri ushtronte pushtet a kontroll komandues;

- *Duheshin identifikuar aspektet e sjelljes së të pandehurit, nga të cilat mund të nxirret konkluzioni për dijeninë dhe mosveprimin, të cilat kërkohen për të konstatuar përgjegjësinë prej eprori lidhur me krimet në gjykim;*
- *Duheshin specifikuar forcat e RFJ-së dhe Serbisë që, sipas akuzës, kanë qenë të përfshira në secilin prej ngjarjeve të vrasjeve;*
- *Duhej specifikuar gjendja mendore, e kërkuar për krimin e përndjekjes.*

- *Të gjendur përballë kundërshtimeve shtesë, të paraqitura nga Lukić-i dhe Pavković-i, Dhoma Gjyqësore kërkoi bërjen e shtesave dhe ndryshimeve të tjera të aktakuzës, për të specifikuar kategorinë e personave të përfshirë në "forcat e RFJ-së dhe Serbisë" të cilat akuzoheshin se kishin kryer krimet në gjykim*** dhe bazën për ngritjen e akuzës që vartësit e të pandehurve "përfshinin, ndër të tjera, anëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të njësive territoriale ushtarake, të njësive civile të mbrojtjes dhe të grupeve të tjera të armatosura."*****
- *Pra, përkundër formulimit gjuhësor shumë të ngjashëm në këto aktakuza, zhvillimi legjislativ nga dy tribunalet e posaçme u dhanë mundësi të pandehurve të kundërshtojnë me sukses pjesë të caktuara të aktakuzës kundër tyre, të cilës u konsiderua se i mungonte qartësia e mjaftueshme për të siguruar njoftim të duhur, edhe pse po i njëjti formulim gjuhësor, jo më larg se përpara dy vjetësh, ishte konsideruar i mjaftueshëm.*

---

* *L28. një gjyqtari.ënda "Milutinović dhe të tjerë", Lënda Nr. IT-99-37-PT, Vendim për mocionin paraprak të Mbrojtjes, depozituar nga ekipi mbrojtës i Nikola Šainović-it, 27 mars 2003.*

** *Lënda "Pavković dhe të tjerë", Lënda Nr. IT-03-70-PT, Vendim për mocionin paraprak të Vladimir Lazarević-it lidhur me formën e Aktakuzës, 8 korrik 2005, para.12, ku përmendet Aktgjykimi i Lëndës "Blaškic", para.226; Kordić dhe Čerkez, Aktgjykim Apeli, para. 144 dhe 147; Kvočka dhe të tjerë, Aktgjykim Apeli, para. 29, 41 dhe 42; Ntakirutimana, Aktgjykimi i Apelit, para. 86 dhe 555.*

*** *Lënda "Pavković dhe të tjerë", Lënda Nr. IT-03-70-PT, Vendim për mocionin paraprak të Nebojša Pavković-it lidhur me formën e Aktakuzës, 15 korrik 2005.*

**** *Lënda "Pavković dhe të tjerë", Lënda Nr. IT-03-70-PT, Vendim për mocionin e Sreten Lukić-it lidhur me formën e Aktakuzës, 15 korrik 2008.*

VI. Fletarrestimet

A. Publikimi i aktakuzës dhe fletarrestimet.....49
A.1 Shqyrtimi dhe depozitimi i aktakuzës.....49
A.2 Transmetimi i fletarrestimeve.....50
B. Fletarrestimet dhe mosekzekutimi i tyre.....50
C. Bashkëpunimi i Shteteve dhe dorëzimi vullnetar.....51
C.1 Bashkëpunimi i Shteteve.....51
C.2 Bashkëpunimi i Shtetit pritës.....53

A. Publikimi i aktakuzës dhe fletarrestimet

A.1 Shqyrtimi dhe depozitimi i aktakuzës

1. Praktika e Sekretarisë së Tribunalit është të hapë një dosje të re të lëndës kur merr një aktakuzë me materialet mbështetëse dhe një kërkesë për shqyrtim/konfirmim të aktakuzës të nënshkruar nga Prokurori apo njëri prej përfaqësuesve të tij. Aktakuza mund të përmbajë akuza kundër disa të pandehurve. Për të shmangur mundësinë e arratisjes së të pandehurve, prokuroria shpesh e depoziton kërkesën për shqyrtim/konfirmim të aktakuzës në mënyrë konfidenciale dhe i kërkon Gjyqtarit Shqyrtues ta nxjerrë fletarrestimin në mënyrë konfidenciale. Sekretaria ia përcjell dosjen e lëndës një gjyqtari të njërës prej dhomave gjyqësore, të caktuar nga Kryetari. Gjyqtari, më pas, e shqyrton aktakuzën. Nëse konfirmohet aktakuza, gjyqtari nxjerr një fletarrestimi për të pandehurin ose të pandehurit e përcaktuar në aktakuzë. Pasi ekzekutohet arrestimi i një ose më shumë të pandehurve, Kryetari ia cakton lëndën njërës prej dhomave gjyqësore.

2. Sekretaria mundëson caktimin e datës së seancës për shqyrtimin e aktakuzës, në të cilën Gjyqtari dëgjon në seancë Prokurorin. Gjatë seancës dëgjimore, Sekretari kryen disa funksione të nevojshme. Seanca dëgjimore për shqyrtimin e aktakuzës mund të regjistrohet dhe mund të përgatitet një procesverbal për të gjithë procedurën. Në çdo rast, shënimet e seancës i mban përfaqësuesi i Sekretarisë apo një person tjetër i autorizuar për këtë qëllim. "Shënimet e seancave për shqyrtimin e aktakuzës" depozitohen më pas në dosjen e lëndës, pas aprovimit nga Gjyqtari Shqyrtues.

3. Prania e një përfaqësuesi të Sekretarisë, gjatë seancës së shqyrtimit të aktakuzës, si praktikë është modifikuar me kalimin e viteve. Më në fund, Gjyqtarit Shqyrtues i është dhënë kompetenca për të vendosur nëse duhet të ketë apo jo një përfaqësues të pranishëm. Shumë gjyqtarë nuk e kanë konsideruar të nevojshme praninë e një përfaqësuesi të administratës gjatë procedurës së shqyrtimit dhe, për pasojë, nuk ka shënime të mbajtura në dosje për të gjitha aktakuzat e konfirmuara. Në çdo rast, Sekretarisë i është kërkuar të kryejë veprime të caktuara pas procesit të konfirmimit, pa i kushtuar rëndësi Gjyqtari Shqyrtues vështirësive operative apo logjistike me të cilat përballet Sekretaria në vënien në zbatim të këtyre udhëzimeve. Sekretaria mund të luajë një rol të dobishëm në mundësimin e një përpunimi dhe depozitimi efikas të aktakuzave në fazën e dorëzimit dhe të shqyrtimit. Çështjet praktike dhe operative mund të trajtohen dhe të zgjidhen në një fazë më të hershme, përmes komunikimit adekuat ndërmjet Gjyqtarit Shqyrtues dhe nëpunësit të Sekretarisë.

A.2 Transmetimi i fletarrestimeve

4. Njoftimi i aktakuzës dhe njoftimi i fletarrestimit, në shumë raste bëhen bashkë. Me konfirmimin e aktakuzës, mund të paraqitet kërkesa për një fletarrestimi dhe fletarrestimin mund ta nxjerrë Gjyqtari konfirmues. Duke qenë se Sekretarisë i kërkohet të punojë me autoritetet kombëtare, për njoftimin e dokumenteve të gjykatave të huaja në Shtetin në fjalë, ekzekutimi i duhur dhe i shpejtë i fletarrestimit kërkon që Gjyqtari t'i japë Sekretarisë udhëzime të qarta lidhur me autoritetin kombëtar kompetent të cilit duhet t'i drejtohet fletarrestimi. Udhëzimet e qarta ndihmojnë në kursimin e kohës dhe të burimeve dhe ndihmojnë në realizimin e duhur të procesit. Mirëpo, në shumë raste, mundësia e gjyqtarit për të identifikuar Shtetin të cilit duhet t'i drejtohet një fletarrestim varet nga pasja e informacionit se ku ndodhet i pandehuri. Në shumë raste, nuk dihet vendndodhja e saktë e të pandehurit.

5. Kur fletarrestimi nxirret në mënyrë konfidenciale, duhen marrë vendime të qarta sa i takon kohës dhe mënyrës së heqjes së konfidencialitetit. Në ato raste kur konfidencialiteti mund të hiqet menjëherë pas transferimit të të pandehurit në Njësinë e Burgimit të OKB-së (NJBOKB) ose menjëherë pas arrestimit, udhëzimet për këtë duhen përfshirë në fletarrestim, për të shmangur kështu nevojën për nxjerrjen e një urdhri tjetër të mëpasshëm. Gjithashtu, kjo mundëson kohën për komunikimin me mediat dhe publikim. Përpara arrestimit, fleksibiliteti i bërjes së ditur të informacionit mund të jetë i dobishëm për arsye operative. Për shembull, nëse një gjykatë e posaçme dëshiron të sigurojë që subjekti ekzekutues i fletarrestimit të mos kërkojë urdhra a sqarime të tjera lidhur me mundësinë për t'ua bërë të ditur të tretëve fletarrestimin, gjykata në fjalë mund të përdorë këtë formulim:

> *"URDHËR që, me përjashtim të personave apo subjekteve të caktuar nga X-i apo nga përfaqësuesit e autorizuar të X-it të cilëve u transmetohet ky Fletarrestim, Fletarrestimi dhe materialet që e shoqërojnë atë nuk bëhen publike në mungesë të një urdhri të dytë".*

B. Fletarrestimet dhe mosekzekutimi i tyre

6. Ka rëndësi jetike që një gjykatë e posaçme të ngrejë një rrjet të besueshëm, për të siguruar që të gjitha autoritetet apo subjektet përkatëse ta marrin aktakuzën dhe fletarrestimin. Vendosja e kontakteve të forta me pikat e kontaktit apo nëpunësit e ndërlidhjes nëpër ambasada, me autoritete të tjera qendrore shtetërore – me autoritetet ndërkombëtare paqeruajtëse apo administrative – dhe mbajtja e lidhjeve të rregullta me ta është me rëndësi për suksesin e këtij procesi. Nevoja për një rrjet të tillë është më e dukshme gjatë arrestimit dhe transferimit të një pandehuri në Selinë e Tribunalit. Sekretaria mund të mbështetet në këtë rrjet edhe për të marrë informacione të mëtejshme, në ato raste kur nuk është ekzekutuar fletarrestimi.[40]

7. Për funksionimin efikas të rrjetit – dhe për të shmangur vonesat e panevojshme në transmetimin dhe ekzekutimin e fletarrestimeve – është e këshillueshme të mbahen dhe përditësohen informatat e kontakteve për të gjitha pikat e kontaktit dhe personat ndërlidhës. Krahas kësaj, rrjeti duhet të përfshijë edhe një listë dezhurni të caktuar për të siguruar që një nëpunës i Sekretarisë, një gjyqtar dhe një jurist i dhomës të jenë në detyrë, për të mbuluar të gjitha çështjet që mund të lindin jashtë orarit zyrtar të punës apo gjatë periudhës së pushimit të gjykatës.

40 Sipas rregullës 59(A), RrPP e TPNJ-së, "kur shteti, të cilit i është përcjellë një fletarrestim apo urdhër transferimi, nuk ka mundur të zbatojë fletarrestimin, ai njofton pa vonesë Sekretarin për këtë pamundësi, duke dhënë arsyet".

8. Kanalet diplomatike, të cilat i kërkohet Sekretarisë t'i përdorë për zbatimin e fletarrestimeve, mund të mos jenë mënyra më efikase për transmetimin e fletarrestimeve. Tribunalet e së ardhmes duhet të shikojnë mundësinë e krijimit të një mekanizmi i cili t'i japë mundësi prokurorisë të përdorë rrjetet e veta të drejtësisë penale/policisë për të bërë ekzekutimin e fletarrestimeve. Për shembull, një procedurë e efektshme është procedura e njoftimit të kuq (red notice) e INTERPOL-it. Shpesh, ekipi i gjurmimit aktiv i Prokurorisë ka informacionin më të fundit për vendndodhjen e një të pandehuri. Meqë koha ka shumë rëndësi për shanset e arrestimit (sepse i pandehuri mund të kalojë nga një shtet në tjetrin) orët, madje edhe minutat, janë jetike. Nëse fletarrestimet mund t'i drejtohen Prokurorit, krahas Shteteve konkrete, mund të ekzistojë mundësia e transmetimit më të shpejtë të një fletarrestimi tek autoritetet policore në territorin në fjalë, pa pasur nevojë për të kërkuar nxjerrjen e një fletarrestimi të ri nga një gjyqtar në detyrë. Hetuesve të Prokurorisë mund t'u duhet të qëndrojnë në gatishmëri për të reaguar me shpejtësi pas paraburgimit të një të pandehuri, në mënyrë që të kryejnë formalitetet e arrestimit dhe të verifikojnë identitetin e personit të shoqëruar.

9. Rregullat e TPNJ-së e lejojnë Prokurorin t'u kërkojë Shteteve arrestimin provizor të një personi të dyshuar apo të pandehur apo marrjen e masave të nevojshme për të parandaluar arratisjen e tij. Këto rregulla janë përdorur në mënyrë të dobishme në kushtet kur aktakuza pritej të dilte shumë shpejt, dhe ndërkohë kërkohej veprim i shpejtë për shfrytëzimin e një mundësie të papërsëritshme arrestimi. Rregullorja e Tribunalit përmban edhe një procedurë të posaçme, për t'u përdorur në ato raste kur nuk ekzekutohet një fletarrestimi. Rregulla 61 parashikon zhvillimin e një seance të hapur përpara një Dhome Gjyqësore, në rrethanat kur Sekretari dhe Prokurori mund të dëshmojnë se janë marrë hapat e arsyeshëm për sigurimin e arrestimit të personit të pandehur dhe se ka kaluar një periudhë e arsyeshme pa u ekzekutuar urdhri i arrestit nga Shteti të cilit i është transmetuar. Kjo procedurë është përdorur në vitin 1996 kundër Radovan Karadžić-it dhe Ratko Mladić-it. Në një seancë publike të mbajtur përpara tre gjyqtarëve të Dhomës Gjyqësore, Prokurori paraqiti aktakuzën dhe materialet mbështetëse në seancë me dyer të hapura, bëri të ditur mosarrestimin e të pandehurve nga Shteti përkatës dhe thirri edhe disa dëshmitarë të caktuar për të dëshmuar botërisht për ngjarjet. Të pandehurve, të cilët ndodheshin në arrati, nuk iu lejua përfaqësimi, megjithëse në seancë u ftua të merrte pjesë një *amicus curiae*. Procedura nuk përbënte gjykim në mungesë dhe nuk kishte për qëllim të dilte me vendim dënimi. Në vend të kësaj, Dhoma nxori një urdhër ndërkombëtar arresti, i cili u drejtohej të gjitha shteteve anëtare të OKB-së. Kështu rregulla 61 shërbeu, në mënyrë të kufizuar, mirëpo më vonë nuk u zbatua më pasi Prokurori filloi të ndjekë praktikën e vendosjes së aktakuzave nën vulë dhe mbajtjen e tyre të fshehta për publikun.

C. Bashkëpunimi i Shteteve dhe dorëzimi vullnetar

10. Tribunali mbështetet në bashkëpunimin e Shteteve për ekzekutimin e arresteve për shkak të mungesës së kompetencës policore jashtë mjediseve të Tribunalit dhe për shkak të mungesës së autoritetit për të njoftuar dokumentet gjyqësore në territorin e Shteteve. Roli i Sekretarisë në arrestim dhe transferim përfshin bashkërendimin mes autoriteteve përkatëse të Shtetit që bën arrestimin dhe të Shtetit Pritës.

C.1 Bashkëpunimi i Shteteve

11. Bashkëpunimi i shteteve parashikohet në Rezolutën Nr. 827 të vitit 1993 të Këshillit të Sigurimit[41]:

41 S/RES/827 (1993), 25 maj 1993.

> *të gjitha Shtetet duhet të bashkëpunojnë me Tribunalin Ndërkombëtar [...] dhe, për rrjedhojë, të gjitha Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme sipas të legjislacionit të brendshëm të tyre për të zbatuar dispozitat e kësaj rezolute dhe të Statutit, duke përfshirë edhe detyrimin që kanë Shtetet për t'i përmbushur kërkesat për asistencë apo urdhrat që nxjerr një Dhomë Gjyqësore sipas Nenit 29 të Statutit.*

12. Edhe pse dispozitat e Statutit janë të ekzekutueshme në vetvete (në kuptimin, që ato e detyrojnë një Shtet të marrë të gjitha masat sipas legjislacionit të vet të brendshëm për t'i zbatuar dispozitat e Statutit), Rregullorja e TPNJ-së parashikon më tej se detyrimi i parashikuar në Nenin 29 të Statutit ka epërsi mbi çdo pengesë juridike ndaj dorëzimit apo transferimit të personit të pandehur te Tribunali, që mund të ekzistojë në legjislacionin e brendshëm apo në traktatet për ekstradimin të Shtetit në fjalë. Kjo rregull përkon me epërsinë që ka Tribunali ndaj gjykatave kombëtare, të parashikuar me Nenin 9 të Statutit. Rregullorja parashikon që transferimi i një të pandehuri në selinë e Tribunalit organizohet mes autoriteteve shtetërore në fjalë, autoriteteve të Holandës dhe Sekretarisë. Kjo e fundit është përgjegjëse për bashkërendimin e procedurave operative për transportimin e të pandehurit nga Shteti transferues në Njësinë e Burgimit të OKB-së, e cila ndodhet në Hagë të Holandës. Procedurat duhet të përfshijnë vëmendje për çështje të tilla të lidhura si mënyra e transportimit, sigurimi dhe nevojat mjekësore (nëse ka) gjatë transportimit. Me bashkëpunimin e Shteteve dhe të organeve të tjera ndërkombëtare, Sekretaria ka bashkërenduar transferime duke përdorur automjete/mjete ajrore ushtarake dhe civile tregtare.

13. Në rastet e arrestimeve apo të dorëzimeve vullnetare në Shtetet e ish-Jugosllavisë, transferimet e të pandehurve në përgjithësi janë bërë pa ndonjë problem apo pa kundërshtime lidhur me bazën ligjore dhe rregullator për transferimet. Roli bashkërendues i Sekretarisë lehtësohet shumë nga prania në rajon e një nëpunësi ndërlidhës të Sekretarisë. Kjo prani ka mundësuar dhe mbështetur ngritjen e një rrjeti komunikimi ndërmjet Tribunalit dhe autoriteteve përkatëse kombëtare dhe subjekteve ndërkombëtare, domethënë SFOR, KFOR, UNMIK, EULEX (të pranishme në ish-Jugosllavi), të cilat, nga ana e tyre, kanë ndihmuar në organizimin dhe logjistikën që ka kërkuar transferimi i të pandehurve në Selinë e Tribunalit.

14. Shtetet jashtë ish-Jugosllavisë,[42] ndonjëherë i kanë kërkuar Sekretarisë sqarime lidhur me bazën ligjore dhe rregullatore për transferimin pas arrestimit. Zakonisht, është kërkuar sqarim sa i takon lidhjes me praktikën kombëtare për ekstradimin, nëse mund të vendosen kushte mbi transferimet apo nëse ka pasur ndonjë nevojë për të lidhur marrëveshje të posaçme ndërmjet Shtetit transferues dhe Tribunalit. Lidhur me dy çështjet e fundit, Sekretaria ka mbajtur vazhdimisht qëndrimin se të gjitha Shtetet janë të detyruara ta kryejnë transferimin sipas Nenit 29 të Statutit. Për më tepër, rregulla 56 e RrPP-së thotë se, "Shtetit të cilit i përcillet një fletarrestim ose urdhër transferimi për një dëshmitar, vepron në kohë dhe me zellin e duhur për të mundësuar zbatimin e duhur dhe të efektshëm të tij në përputhje me Nenin 29 të Statutit."[43] Pra, kur një Shtet e përmbush detyrimin që ka sipas Nenit 29, për t'ia dorëzuar Tribunalit të pandehurin, nuk duhet të vendosë kushte për transferimin. Po kështu, nuk ka nevojë të ketë një marrëveshje ndërmjet TPNJ-së dhe Shtetit si parakusht për transferimin e të pandehurit në Selinë e Tribunalit Ndërkombëtar. Në bazë të Rezolutës Nr. 827 të vitit 1993 të Këshillit të Sigurimit, si edhe në bazë të dispozitave të Statutit dhe të Rregullores, ka bazë ligjore të mjaftueshme për kryerjen e transferimit. Për shembull, rregulla 58 thotë se, "Detyrimet e përcaktuara në Nenin 29 të Statutit kanë përparësi ndaj çdo pengese ligjore që mund të

42 Për shembull, persona kundër të cilëve është ngritur aktakuzë nga Tribunali janë arrestuar dhe transferuar nga Gjermania, Austria, Argjentina dhe Rusia.

43 Në lidhje me këtë, duhet thënë se në Lëndën Nr. IT-94-1, *Prokurori kundër Duško Tadić-it i njohur si "Dule"*, "Vendimi për mocionin e Mbrojtjes për apelin e ndërkohshëm për juridiksionin", 2 tetor 1995, para. 77-93, Dhoma e Apelit e Tribunalit është shprehur se, "parimi i epërsisë së Tribunalit mbi gjykatat e brendshme nuk bie ndesh me sovranitetin e Shteteve sipas të drejtës ndërkombëtare. Krimet brenda juridiksionit të Tribunalit janë universale, për nga natyra, dhe shkojnë përtej interesit të secilit Shtet. E drejta sovrane e Shteteve nuk mund të ketë epërsi mbi të drejtën e bashkësisë ndërkombëtare për të vepruar si duhet".

ekzistojë në legjislacionin shtetëror ose në traktatet e ekstradimit të shtetit përkatës në lidhje me dorëzimin apo transferimin e të akuzuarit [...]në Tribunal." Konfirmimi ligjor dhe rregullator i përparësisë së Tribunalit mbi gjykatat e brendshme është guri themeltar që mundëson aspektet operative të transferimit dhe, madje, bashkërendimin e papenguar dhe të përshpejtuar nga Sekretaria. [44]

C.2 Bashkëpunimi i Shtetit pritës

15. Përveç Rezolutës Nr. 827 të vitit 1993 të Këshillit të Sigurimit dhe Nenit 29 të Statutit, bashkëpunimi me Holandën mbështetet më së pari në "Marrëveshjen me Shtetin pritës".[45] Sa u takon arrestimeve dhe transferimeve të kryera në emër të Tribunalit dhe në bashkëpunim me të, Holanda "nuk mund të ushtrojë kompetenca penale mbi personat në territorin e saj të cilët do të transferohen ose janë transferuar si të dyshuar ose të pandehur në mjediset e Tribunalit me kërkesë ose urdhër të Tribunalit, në lidhje me veprimet, mosveprimet ose dënimet përpara hyrjes së tyre në territorin e vendit pritës."[46] Holanda e ndihmojnë më tej Tribunalin me transportin dhe shoqërimin e të pandehurve nga pika e hyrjes në territorin holandez (për shembull, nga aeroporti) deri në Njësinë e Burgimit të OKB-së. Që ky operacion të kryhet pa probleme, Tribunali duhet të mbajë një sistem për të komunikuar dhe njoftuar autoritetet e ndryshme holandeze të janë të përfshira në operacion. Ky sistem njoftimi i jep mundësi Shtetit Pritës të sigurojë që të jenë kryer vlerësimet e nevojshme të rreziqeve dhe të kushtohen burimet e sigurimit dhe ato operative, për të siguruar transferimin e të pandehurit në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt. Suksesi i rolit të Sekretarisë në bashkërendimin e operacionit ndërmjet autoriteteve të Shtetit Pritës dhe autoritetit/Shtetit transferues varet nga efektiviteti i këtij sistemi komunikimi dhe njoftimi.

16. Për më tepër, sipas Nenit XX të Marrëveshjes me Shtetin Pritës, bashkëpunimi i Shtetit Pritës për të siguruar transferimin pa probleme të personave të pandehur në Njësinë e Burgimit të OKB-së mbështetet së pari në fletarrestimin e lëshuar nga Tribunali, i cili konsiderohet nga Shteti Pritës si baza ligjore për heqjen e lirisë personit të dyshuar ose të pandehur, duke përfshirë edhe masat e kufizimit të lëvizjes gjatë transportimit në territorin holandez. Në rastet kur nuk ka fletarrestimi, siç është rasti i aktakuzës së ngritur për mosbindje ndaj gjykatës, Shteti Pritës mund të ketë shqetësime ligjore me lëvizjen e një personi të pandehur për mosbindje, brenda territorit holandez. Ky shqetësim rritet edhe më shumë në rastin kur personi i pandehur për mosbindje është shtetas i një vendi joanëtar të Bashkimit Evropian, dhe rrjedhimisht ka nevojë për vizë për të hyrë në Holandë. Kërkesa ligjore për pajisje me vizë mund të bëhet objekt shpërdorimi, pra pas hyrjes në Holandë (çka do të thotë, pas hyrjes në Bashkimin Evropian), personi mund të devijojë dhe të mos paraqitet përpara gjykatës për t'iu përgjigjur akuzave për mosbindje. Shteti Pritës ka sugjeruar se mungon faktori nxitës që do t'i mundësonte Shtetit Pritës të ushtronte autoritetin e tij për ta ndihmuar Tribunalin në sigurimin e paraqitjes përpara Tribunalit të personave të akuzuar për mosbindje ndaj gjykatës. Shteti Pritës propozoi një zgjidhje, në formën e një fletarrestimi të pezulluar (si ai që ekziston në legjislacionin e brendshëm të Shtetit Pritës) i cili parashikon kushtet në të cilat hiqet pezullimi dhe, rrjedhimisht, u jep autoriteteve të Shtetit Pritës bazën e nevojshme ligjore për të vepruar. Mirëpo, për arsye të ndryshme ligjore dhe praktike, kjo zgjidhje nuk mund të vihej në zbatim nga TPNJ-ja.

---

44 *Prokurori kundër Milan Lukić-it dhe Sredoje Lukić-it*, Lënda Nr. IT-98-32/1-PT, "Vendim për përcjelljen e Lëndës sipas rregullës 11*bis* me Shtojcën Konfidencial A dhe Shtojcën Konfidencial B", 5 prill 2007, para. 108-122.

45 "Marrëveshje midis Kombeve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, lidhur me selinë e Tribunalit Ndërkombëtar për ndjekjen penale të personave përgjegjës për shkeljet e rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991", 29 korrik 1994 ("Marrëveshja me Shtetin Pritës").

46 Neni XX (1), Marrëveshja me Shtetin Pritës.

17. Një sistem i efektshëm komunikimi dhe njoftimi me autoritete të ndryshme të Shtetit Pritës të përfshira në bashkëpunimin me Tribunalin gjatë arrestimeve dhe transferimeve është me rëndësi kritike. Në rastin e mosbindjes ndaj Tribunalit, kur nuk ekzistojnë rrethanat që do të kërkonin lëshimin e një fletarrestimi, marrja në konsideratë e përfitimeve praktike që vijnë nga fletarrestimi i pezulluar mund ta asistonte Shtetin Pritës në përpjekjet e tij për të bashkëpunuar me Tribunalin për të siguruar që i pandehuri të hyjë në territorin holandez vetëm për qëllimet e gjykimit për mosbindje ndaj gjykatës.

VII. Faza paragjyqësore

A. Procesi paragjyqësor.....56
B. Instrumentet e administrimit të lëndëve.....58
B.1 Konferencat për statusin dhe mbledhjet sipas Rregullës 65ter.....59
B.2 Plani i punës.....59
B.3 Dosja paragjyqësore dhe lista e dëshmitarëve e Prokurorisë dhe dosja paragjyqësore e Mbrojtjes.....60
B.4 Mbledhja për administrimin e gjykimit.....61
B.5 Konferenca paragjyqësore.....63
C. Roli i gjyqtarit.....63
D. Dhënia e informacioneve.....64
E. Komunikimi ndërmjet palëve.....66
F. Mocionet paragjyqësore.....67
F.1 Mocionet paraprake.....67
F.1.1 Mocionet e tjera.....67
F.1.2 Mocioni për lirim të përkohshëm.....68
F.1.3 Masat mbrojtëse.....68
F.1.4 Mocioni për bashkimin apo ndarjen e lëndëve.....69
F.1.5 Mocioni i Prokurorisë për ndryshimin e aktakuzës 69
F.1.6 Mocionet për shikimin e materialeve konfidenciale të lëndëve të tjera.....69
G. Zvogëlimi i objektit të aktakuzës.....70
H. Ngushtimi i çështjeve kontestuese.....71
H.1 Faktet e pranuara.....71
H.2 Shënimi gjyqësor.....71
I. Vetëdeklarimi i fajësisë.....73
VII. Shtojca 5: Afatet e fazës paragjyqësore.....75
VII. Shtojca 6: Shembull praktik: parashikimi i kohëzgjatjes së gjykimit gjatë fazës paragjyqësore.....77

1. Për shkak të shkallës dhe kompleksitetit që kanë proceset gjyqësore për krimet e luftës, del nevoja për një menaxhim aktiv të fazës paragjyqësore. Faza paragjyqësore ofron mundësinë e rëndësishme për të siguruar që procesi të zhvillohet sipas mënyrës më të drejtë dhe të shpejtë, ndërkohë që bashkon prokurorinë dhe mbrojtjen në përpjekje për të zgjidhur ato çështje që mund të zgjidhen përpara fillimit të gjykimit. Pa një menaxhim të mirë paragjyqësor, do të zgjateshin gjyqet në mënyrë të pajustifikuar, do të thirreshin dëshmitarë pa qenë nevoja, do të harxhohej koha e çmuar e gjykatës me çështje procedurale në vend të dëgjimit të dëshmive. Do të kishte shtyrje të seancave, vonesa të kushtueshme dhe ndërprerje dhe do të ishte e vështirë të arrihej që vëmendja e gjykatës të mos largohej nga çështjet me rëndësi për shkak të çështjeve anësore. Për pasojë, pjesëmarrësit nuk do të jenë në gjendje t'i planifikojnë aktivitetet apo ta menaxhojnë siç duhet kohën, dhe mund të shkelet e drejta e të pandehurit për gjykim të shpejtë.

2. Objektivi i fazës paragjyqësore duhet të jetë i dyfishtë: zgjidhja e sa më shumë çështjeve, për të kursyer kohën e vyer të gjykatës; dhe sigurimi i një platforme solide që palët dhe gjykata të vendosin sa kohë është e nevojshme për paraqitjen e provave dhe dëshmive për çështjet që janë objekt diskutimi. Gjyqtari Paragjyqësor, të cilin e cakton Kryetari i Dhomës Gjyqësore menjëherë pasi i pandehuri mbërrin në Tribunal, mban përgjegjësinë e fundme për vënien në zbatim të objektivave planifikuese dhe organizative. Gjyqtarin Paragjyqësor e asiston një nëpunës juridik i lartë, i cili e administron lëndën, që nga menjëherë pas daljes së parë të të pandehurit përpara gjykatës, derisa lënda është gati për të kaluar në gjykim. Gjyqtari Paragjyqësor kryen shumë funksione, duke përfshirë edhe bashkërendimin e komunikimit ndërmjet palëve, marrjen e masave që procesi të mos vonohet në mënyrë të pajustifikueshme dhe marrjen e të gjitha masave gjyqësore të nevojshme për përgatitjen për gjykim të lëndës. Në lëndët komplekse, të cilat rregullisht kërkojnë një numër dëshmitarësh dhe provash materiale, kjo detyrë ka rëndësi kritike për të siguruar administrimin e rrjedhshëm të lëndës në gjykim.

3. Roli i Gjyqtarit Paragjyqësor ka fituar gjithnjë e më shumë rëndësi, ndërkohë që Tribunali është përpjekur të vërë në jetë rekomandimet e Grupit të Punës për Përshpejtimin e Gjyqeve.[47] Këto rekomandime kishin të bënin me një eficiencë më të madhe të fazës paragjyqësore dhe një rol më parapritës të Gjyqtarit Paragjyqësor në shfrytëzimin e plotë të instrumenteve administruese që ka në dispozicion.

A. Procesi paragjyqësor

4. Për shkak të numrit të hapave procedurale që janë të nevojshme për përgatitjen për gjykim të një lënde me krime lufte, është e nevojshme një periudhë prej tetë muajsh gjer në një vit, pasi i pandehuri mbërrin në selinë e Tribunalit, gjersa të fillojë gjykimi. Kjo periudhë kohore mund të ndryshojë, në varësi të shkallës së prioritetit dhe numrit të problemeve të paparashikuara që mund të lindin.

5. Procesi paragjyqësor duhet të fillojë në momentin kur i pandehuri mbërrin në selinë e Tribunalit. Që nga ky moment, gjersa Mbrojtja depoziton një mocion për formën e aktakuzës, Rregullorja përcakton rrjedhën e ngjarjeve që duhet të ndodhin dhe vendos një sërë afatesh. Nëse nuk ka kërkesa për shtyrje të afatit, ose nëse nuk ka kërkesa të tjera që harxhojnë kohë (për shembull, të lidhura me masat mbrojtëse) kjo fazë mund të përfundojë brenda diçka më shumë se dy muajve.

6. Periudha menjëherë pas mbërritjes së të pandehurit në Tribunal, është shumë e ngarkuar. Me të mbërritur i pandehuri, Presidenti ia cakton menjëherë lëndën njërës prej Dhomave. Kryetari i Dhomës në fjalë, nxjerr, normalisht, katër urdhra: 1) urdhrin për caktimin e gjyqtarit përpara të cilit bëhet dalja e parë e të pandehurit; 2) urdhrin për caktimin e datës për daljen e parë të të pandehurit përpara gjykatës; 3) urdhrin për nxjerrjen e regjistrimit zanor dhe pamor dhe për lejimin e fotografive; dhe 4) urdhrin për shoqërimin e të pandehurit në mjediset e Njësisë së Burgimit të OKB-së. Megjithëse Rregullorja lejon që dalja e parë të bëhet përpara një trupi gjykues me tre gjyqtarë, zakonisht këto detyra i kryen një gjyqtar i vetëm.[48] I pandehuri nuk mund të lirohet veçse me urdhër të një Dhome.[49] Për më tepër, edhe pse dalja e para duhet të bëhet "pa vonesë"[50], zakonisht kjo bëhet një ose dy javë pas mbërritjes së të pandehurit, në varësi të faktit nëse i pandehuri ka mbërritur gjatë një fundjave. Kështu sigurohet kohë e mjaftueshme për të përgatitur një agjendë, si edhe urdhrat e ndryshme, dhe për të mësuar nga avokati i mbrojtjes nëse i pandehuri heq apo jo dorë nga e drejta[51] për ta dëgjuar leximin e plotë të aktakuzës gjatë daljes së tij para gjykatës. Sa i takon kësaj të fundit, shumica e të pandehurve heqin dorë nga ushtrimi i kësaj të drejte dhe Gjyqtari thjesht sa jep një përmbledhje të lëndës kundër të pandehurit.

7. Qëllimi kryesor i paraqitjes së parë, është të informohet i pandehuri se prej tij do të kërkohet të deklarojë fajësinë ose pafajësinë për secilën pikë të aktakuzës, brenda 30 ditëve.[52] Në shumicën e lëndëve, vetë-deklarimi bëhet në paraqitjen e parë, por nëse i pandehuri vendos ta shtyjë vetëdeklarimin atëherë duhet të parashikohet një paraqitje tjetër në të ardhmen. Nëse i pandehuri nuk vetëdeklarohet në paraqitjen e parë

47 Grupin e Punës për Shpejtimin e Gjyqeve e krijoi Presidenti i Tribunalit në shkurt 2005. Ky Grup i paraqiti rekomandimet e veta me shkrim, nëpërmjet një raporti të muajit shkurt 2006. Grupi I Punës u riformua në prill 2008, për të bërë një vlerësim të zbatimit të këtyre rekomandimeve. Shumë prej përmirësimeve në fazën paragjyqësore janë rezultat i drejtpërdrejtë i nismës për krijimin e Grupit të Punës.
48 Rregulla 62(F), RrPP e TPNJ-së.
49 Rregulla 65(F), RrPP e TPNJ-së.
50 Rregulla 62(F), RrPP e TPNJ-së.
51 Rregulla 62(A)(ii), RrPP e TPNJ-së.
52 Rregulla 62(A)(iii), RrPP e TPNJ-së.

ose në ndonjë paraqitje të mëvonshme, gjyqtari bën një deklarim të pafajësisë në emër të të pandehurit.[53] Mund të ketë raste, kur vetë-deklarimi mund të mos kërkohet, siç është rasti kur të pandehurit nuk i është caktuar ende avokati i mbrojtjes ose kur i pandehuri nuk ka pasur kohë të mjaftueshme për ta diskutuar aktakuzën dhe materialet mbështetëse me avokatin e mbrojtjes. Përpara paraqitjes së parë, Zyra për Ndihmë Juridike dhe Çështje të Burgimit (ZNJP) duhet të caktojë një avokat kujdestar për të pandehurin,[54] përveç në rastin kur avokati i mbrojtjes refuzohet dhe kur i pandehuri vendos të paraqitet pa asistencën e një avokati të mbrojtjes. Nëse bëhet vetë-deklarimi lidhur me fajësinë, ai mund të pranohet vetëm nga trupa e plotë gjyqësore,[55] pasi bindet që i pandehuri i kupton akuzat për të cilat ka vendosur të pranojë fajësinë dhe arrin në përfundimin se këto akuza mbështeten në dyshime të mjaftueshme faktike. Paraqitja e parë, e cila jo medoemos është momenti në të cilin depozitohet vetë-deklarimi, shërben si fillim i afateve të rëndësishme kohore për procesin paragjyqësor, në lidhje me detyrimet për bërjen të ditur të materialeve dhe në lidhje me depozitimin e mocioneve paraprake. Data e paraqitjes së parë shërben edhe si datë e fillimit për vendosjen e datës së seancës së ardhshme (e cila, në përgjithësi, quhet "konferenca për statusin"). Edhe sikur të jetë e nevojshme një konferencë për statusin, vendosja e datës së paraqitjes së mëvonshme nuk i shtyn afatet për depozitimin e mocioneve paraprake, që varen nga bërja e ditur e materialeve mbi të cilat mbështetet konfirmimi i aktakuzës.

8. Brenda një jave pas paraqitjes së parë të të pandehurit, Kryetari i Dhomës duhet të caktojë një Gjyqtar Paragjyqësor të Dhomës Gjyqësore. Brenda dy-tre javëve pas mbërritjes së të pandehurit, ky duhet të zgjedhë një avokat definitiv të mbrojtjes nga një listë avokatësh të kualifikuar, të cilën e mban Sekretaria, dhe kjo zgjedhje duhet të zyrtarizohet me emërim nga Zëvendëssekretari në bashkërendim me Zyrën për Ndihmë Juridike dhe Çështje të Burgimit. Normalisht, vonesa në caktimin e avokatit definitiv shpjegohet me kohën e nevojshme për të gjetur dikë të jetë në dispozicion dhe i pranueshëm për të pandehurin. Shpesh, të pandehurit zgjedhin avokatë të cilët nuk janë në listën e avokatëve të mbrojtjes dhe Sekretarit i duhet të sigurohet që avokatët e përzgjedhur të kenë kualifikimet e nevojshme dhe zotësitë gjuhësore që janë të nevojshme për t'u vendosur në listën e avokatëve që kanë të drejtë të përfaqësojnë të pandehurit përpara Tribunalit.

9. Brenda 30 ditësh pas paraqitjes së parë, Prokuroria duhet t'i japë të pandehurit kopje të materialeve mbështetëse që kanë shoqëruar aktakuzën gjatë procesit të konfirmimit, si edhe të gjitha deklaratat e mëparshme që ka marrë Prokuroria nga i pandehuri.[56] Normalisht, qysh më parë duhet të jenë marrë masa për dhënien e këtyre materialeve të pandehurit, mirëpo avokati kujdestar parapëlqen që këto materiale t'i jepen drejtpërdrejt avokatit definitiv. Tridhjetë ditë pas marrjes së këtij materiali, Mbrojtja duhet të depozitojë mocionin paraprak lidhur me formën e aktakuzës, nëse ka. Pak kohë përpara kësaj, zhvillohet mbledhja e parë mes palëve dhe nëpunësit të lartë juridik ("mbledhja sipas Rregullës 65 ter") dhe konferenca për statusin dhe diskutohet plani paragjyqësor i punës. Plani i punës, për të cilin flitet më poshtë, është, në thelb, një kalendar i ngjarjeve që duhet të ndodhin në funksion të përgatitjes së lëndës për gjykim. Gjithsej, duhen rreth 70 ditë për ta bërë gati lëndën për mocion paraprak mbi formën e aktakuzës. Sikurse shpjegohet më poshtë, praktika ka treguar se pjesëmarrja e Gjyqtarit Paragjyqësor në mbledhjen e Rregullës 65*ter* mund t'i nxisë shkëmbimet efikase mes palëve dhe përshpejtimin e përgatitjeve paragjyqësore.

10. Ka një sërë vendimet të rëndësishme që duhen marrë gjatë procedurës paragjyqësore, në përgjigje të mocioneve të depozituara nga palët. Këto mocione përfshijnë mocionet paraprake që kundërshtojnë formën e

53 Rregulla 65(A)(iv), RrPP e TPNJ-së.
54 Rregulla 62(B) dhe Rregulla 45(C), RrPP e TPNJ-së.
55 Rregulla 62(A)(Vi), RrPP e TPNJ-së.
56 Rregulla 66(A)(i), RrPP e TPNJ-së.

aktakuzës dhe/ose juridiksionin, si edhe mocionet e tjera të lidhura me lirimin e përkohshëm të të pandehurit, mocionet për bashkimin ose ndarjen e lëndëve, mocionet për masat mbrojtëse, mocionet për shikimin e materialeve konfidenciale të lëndëve të tjera, mocionet e lidhura me faktet për të cilat kanë rënë dakord Prokuroria dhe Mbrojtja, mocionet për pranimin e fakteve që dihen në përgjithësi dhe/ose të fakteve të gjykuara. Ndërkohë, Prokuroria ka detyrimin për t'i dhënë Mbrojtjes kopje të deklaratave të gjithë dëshmitarëve të cilët synon të thërrasë në sallën e gjykimit Prokuroria (dhe këto deklarata duhet të jenë në gjuhën e të pandehurit) dhe kopje të gjithë materialit të zbardhur dhe deklaratave me shkrim të marrë në respektim të Rregullores.[57] Koha e nevojshme për këtë proces varet nga disa faktorë, që përfshijnë kompleksitetin e lëndës, nivelin e përparësisë që i jepet përgatitjes për gjykim të lëndës, nëse Mbrojtja vendos të ndjekë një qasje paragjyqësore aktive, dhe shkallën në të cilën janë të gatshme për gjykim Prokuroria dhe Mbrojtja. Me dhënien e përparësisë së nevojshme, ky proces mund të finalizohet brenda rreth gjashtë muajve, për një lëndë të nivelit të mesëm. Mirëpo, sasia e saktë e kohës së nevojshme varet nga numri i pritur i dëshmitarëve dhe provave materiale të Prokurorisë dhe nëse ka nevojë apo jo për përkthime të deklaratave të dëshmitarëve dhe provave materiale në gjykim. Për lëndët me kompleksitet më të lartë, koha e nevojshme mund të jetë shumë më e gjatë. Gjatë këtij procesi vazhdojnë edhe mbledhjet mes palëve sipas Rregullës 65*ter* dhe konferencat për statusin (këto të fundit duhen zhvilluar çdo 120 ditë).

11. Hapat e fundit të procesit paragjyqësor janë hartuar për të siguruar që lënda të jetë "gati për gjykim" dhe kërkojnë vendosjen e afateve për depozitimin e dosjeve paragjyqësore dhe caktimin e një seance për Konferencën Paragjyqësore, ku kjo e fundit zakonisht parashikohet të mbahet në prag të procesit gjyqësor. Procesi paragjyqësor kërkon të paktën tre muaj. Caktimi i datës për dosjet paragjyqësore bëhet vetëm pasi kanë marrë zgjidhje të gjitha mocionet paraprake[58] dhe, në një situatë ideale, pasi të jenë marrë vendimet për të gjitha mocionet e tjera të rëndësishme dhe për mënyrën e orientimit të dëshmive, pra, se cilët janë ata dëshmitarë që duhet të thirren për të dëshmuar në sallë dhe dëshmia e cilëve dëshmitarë mund të pranohet përmes deklaratave të dëshmitarëve. Ka dy qasje të ndryshme për caktimin e grafikut kohor. Sipas njërës qasje, palët i depozitojnë dosjet paragjyqësore pavarësisht nëse është vendosur apo jo fillimi i menjëhershëm i gjykimit, rast në të cilin palëve u lejohet t'i ndryshojnë më pas dosjet e tyre paragjyqësore deri pak përpara fillimit të gjykimit. Qasja tjetër është të pritet për caktimin e afatit për dosjet paragjyqësore deri në emërimin e trupit gjykues. Zakonisht, parapëlqehet qasja e parë, sepse mundëson që lëndët të jenë gati për gjykim brenda një periudhe sa më të shkurtër. Pasja gati e disa lëndëve njëkohësisht është e dëshirueshme nëse ndërpritet në mënyrë të papritur një gjykim i mëparshëm ose nëse një lëndë e mëparshme vonohet sa i takon kalimit në gjykim. Kjo i jep mundësi TPNJ-së t'i mbajë me kapacitet të plotë sallat e pakta të gjykimit. Nëse prokurorisë i jepet një kohë e arsyeshme për përgatitjen e dosjes së saj (që, në përgjithësi, konsiderohet se duhet të jetë rreth dy muaj), urdhri i caktimit të datës për depozitimin e dosjeve paragjyqësore duhet të dalë rreth tre muaj përpara fillimit të gjykimit. Në Shtojcën 5 "Afatet e fazës paragjyqësore" jepet një përmbledhje e afateve të diskutuara më lart. Afatet që kanë ndikimin më të madh në gjatësinë e procesit paragjyqësor janë paraqitur me shkronja të trasha.

B. Instrumentet e administrimit të lëndëve

12. Instrumentet kryesore të administrimit të lëndëve për praktikën paragjyqësore të TPNJ-së janë konferencat periodike ndërmjet Gjyqtarit Paragjyqësor, Nëpunësit të Lartë Juridik dhe palëve, plani i punës i vendosur nga

57 Rregulla 66(A)(ii), RrPP e TPNJ-së.
58 Rregulla 65*ter*(E), RrPP e TPNJ-së;

Gjyqtari Paragjyqësor, dosjet paragjyqësore të depozituara nga Prokuroria dhe Mbrojtja, si edhe Konferenca Paragjyqësore. Ky proces është gjithashtu objekt i kalendarit të ngjarjeve që kërkon Rregullorja e Procedurës dhe Provave. Aktivitetet paragjyqësore rregullohen nga Rregullorja, e cila kërkon kryerjen e hapave të caktuara në momente specifike. Respektimi i këtyre afateve ka rëndësi kritike për një administrim të suksesshëm të lëndëve në fazën paragjyqësore, si edhe për të siguruar shpejtësinë e zhvillimit të procesit dhe përdorimin më efikas të kohës së gjykatës.

B.1 Konferencat për statusin dhe mbledhjet sipas Rregullës 65*ter*

13. Konferenca për statusin duhet të zhvillohet brenda 120 ditëve pas paraqitjes së parë të të pandehurit ose konferencës së fundit për statusin.[59] Kjo konferencë për statusin drejtohet nga një Gjyqtar Paragjyqësor, në praninë e të pandehurit. Qëllimi i dyfishtë i konferencës për statusin është organizimi i shkëmbimit të materialeve ndërmjet palëve lidhur me përgatitjen e tyre për gjykim dhe dëgjimi i të pandehurit, nëse ky ndodhet në paraburgim, lidhur me mirëqenien e tij mendore dhe fizike. Një i pandehur i cili është në lirim të përkohshëm paragjyqësor nuk është i detyruar të marrë pjesë në konferencën për statusin. Standardi për dhënien e lirimit të përkohshëm paragjyqësor (i cili diskutohet në një rubrikë më vete, më poshtë) rregullohet me jurisprudencën e Tribunalit, por në asnjë rrethanë nuk i lejohet të shkaktojë vonesa për përgatitjen paragjyqësore. Krahas konferencës për statusin, shkëmbimet ndërmjet palëve (mbledhjet sipas Rregullës 65*ter*) historikisht janë organizuar nga Nëpunësi i Lartë Juridik i Dhomës Gjyqësore[60] nën mbikëqyrjen e Gjyqtarit Paragjyqësor. Praktika ka treguar se pjesëmarrja e Gjyqtarit Paragjyqësor në mbledhjen sipas Rregullës 65*ter* mund t'i nxisë palët për shkëmbime më eficiente dhe për përshpejtim të përgatitjeve.

14. Nuk ka asnjë kërkesë që mbledhjet sipas Rregullës 65*ter* të zhvillohen në intervale të rregullta, megjithëse përvoja ka treguar se këto takime janë më të dobishme nëse zhvillohen një ose dy ditë përpara konferencës për statusin (dhe në kuadër të përgatitjes së saj). Nëse i pandehuri ka një avokat mbrojtës, avokati e përfaqëson të pandehurin në këto mbledhje të cilat shërbejnë si një rrugë shkëmbimesh më pak formale ndërmjet palëve, edhe pse për to përgatiten procesverbale jopublike. Nëse i pandehuri përfaqëson vetveten, prania e tij është e detyrueshme, por shumica e rasteve me vetëpërfaqësim përfshin një theks më të madh te trajtimi i çështjeve në një kontekst më formal të konferencës për statusin.

15. Ndryshe nga vetë gjykimi, procesi paragjyqësor zhvillohet kryesisht në bazë shkresore dhe mbledhjet sipas rregullës 65*ter* dhe konferencat për statusin shpesh janë mënyra e vetme për marrëdhënie ballaballas ndërmjet palëve dhe gjyqtarëve. Në varësi të prioritetit që i caktohet lëndës, Tribunali mund të vendosë të mos e mbajë një konferencë për statusin më shpesh se çdo 120 ditë, që është kërkesë e Rregullores, dhe të mos zhvillojë një mbledhje sipas rregullës 65*ter* përpara konferencës për statusin. Për shembull, kjo është e zakonshme nëse ka shumë pak zhvillime të reja që duhen diskutuar. Nga ana tjetër, me hyrjen e lëndës në fazën përfundimtare përpara gjykimit, konferencat për statusin dhe mbledhjet sipas rregullës 65*ter* mund të mbahen aq shpesh sa është e nevojshme për të trajtuar çështjet e përgatitjeve përfundimtare për gjykim.

B.2 Plani i punës

16. Gjyqtari paragjyqësor përcakton një plan pune në të cilin paraqiten detyrimet që duhet të përmbushin palët dhe afatet e përmbushjes së këtyre detyrimeve.[61] Plani parashtron, në vija të përgjithshme, detyrimet që u kërkohen palëve të përmbushin në përputhje me pikën e dytë të germës "D" të rregullës 65*ter* dhe afatet për

59 Rregulla 65*bis*, RrPP e TPNJ-së.
60 Rregulla 65*ter*(D), RrPP e TPNJ-së.
61 Rregulla 65*ter*(D)(ii), RrPP e TPNJ-së.

përmbushje e këtyre detyrimeve. Më konkretisht, plani i punës duhet të marrë në konsideratë mocionet e ndryshme që nuk kanë ende përgjigje dhe prioritetet e vendosura nga Presidenti lidhur me datën e propozuar të gjykimit. Megjithëse në të shkuarën këto plane janë përdorur në mënyrë joefikase, tani ato përbëjnë bazën qendrore mbi të cilën punojnë palët. Planet e punës diskutohen me palët, në mbledhjet e zhvilluara sipas rregullës 65*ter*, për të marrë angazhimin e plotë të tyre për planin. Për çdo problem të pazgjidhur mund të diskutohet në konferencën për statusin dhe mund të merret vendim nga Gjyqtari Paragjyqësor. Planet e punës mund të ndryshohen më vonë, në bazë të vendimeve të Presidentit në lidhje me prioritetin për gjykim të lëndës. Këto vendime zakonisht merren në bazë të kohëzgjatjes së mbajtjes në paraburgim të të pandehurit, së bashku me një vlerësim që bën Gjyqtari Paragjyqësor lidhur me gatishmërinë për gjykim të lëndës.

B.3 Dosja paragjyqësore dhe lista e dëshmitarëve e Prokurorisë dhe dosja paragjyqësore e Mbrojtjes

17. Koha e depozitimit të dosjeve paragjyqësore mund ta rrisë shpejtësinë e lëndës dhe kjo është një çështje mbi të cilën mund të ushtrojë ndikim, madje për të cilën mund të nxjerrë urdhra, Gjyqtari Paragjyqësor. Me t'u zgjidhur mocionet ekzistuese paraprake, nëse ka, Gjyqtari Paragjyqësor duhet t'i japë urdhër Prokurorisë të depozitojë versionin përfundimtar të dosjes paragjyqësore.[62] Dosja paragjyqësore duhet të përfshijë, për secilën pikë të akuzës, një përmbledhje të legjislacionit të zbatueshëm dhe të provave e dëshmive që mendon të paraqesë Prokuroria lidhur me kryerjen e krimit objekt të akuzës, si edhe një përmbledhje të formës së përgjegjësisë për të cilën akuzohet i pandehuri. Dosja paragjyqësore duhet të përfshijë edhe çdo pranim të bërë nga palët, një deklaratë të çështjeve që nuk janë objekt mosmarrëveshjeje si edhe një deklaratë të çështjeve të kundërshtuara lidhur me faktet dhe ligjin. Zakonisht, çështjet ku ka mosmarrëveshje janë pakësuar përmes procesit të arritjes së marrëveshjes ndërmjet Prokurorisë dhe avokatëve të mbrojtjes lidhur me faktet që do të jenë të pranueshme në gjykim, temë kjo e cila trajtohet më poshtë.

18. Gjyqtari Paragjyqësor e urdhëron Prokurorinë të depozitojë edhe listën e dëshmitarëve që ka ndër mend të thërrasë në gjykim, me emrin ose pseudonimin e secilit dëshmitar, një përmbledhje të fakteve për të cilat do të dëshmojë secili dëshmitar, pikat e aktakuzës për të cilat do të dëshmojë secili dëshmitar, numrin gjithsej të dëshmitarëve (dhe numrin e dëshmitarëve që do të dëshmojnë kundër secilit të pandehur dhe për secilën pikë të akuzës). Prokurorisë i kërkohet gjithashtu të bëjë të ditur nëse dëshmitari do të dëshmojë personalisht dhe, nëse po, për sa kohë, apo nëse do të kërkojë të paraqesë dëshmi përmes deklaratave me shkrim apo përmes procesverbalit të një procesi të mëparshëm. Megjithëse nuk përmendet shprehimisht në Rregullore, Gjyqtari Paragjyqësor mund t'i kërkojë Prokurorisë të paraqesë një "grafik të provave", me synim paraqitjen e të gjithë materialit që kërkon Rregullorja në mënyrë sistematike dhe skematike. Një grafik i tillë paraqet, në formë katalogu, provat dhe dëshmitë që do të paraqiten sipas asaj pjese të aktakuzës që pretendohet se mbështet. Grafiku i provave siguron një mënyrë të efektshme për ta ndihmuar Dhomën Gjyqësore në ushtrimin e kompetencave të saj gjatë Konferencës Paragjyqësore. Gjithashtu, kjo i jep mundësi Mbrojtjes të ketë informacion më të mirë për lëndën kundër së cilës do të mbrohet. Për paraqitjen e dosjes paragjyqësore mund të jepet urdhri, pavarësisht nëse gjykimi do të fillojë apo jo në të ardhmen e afërt. Por, dosja paragjyqësore duhet të jetë e disponueshme të paktën gjashtë javë përpara Konferencës Paragjyqësore. Në praktikë, afati i dorëzimit të dosjes paragjyqësore diskutohet me palët gjatë mbledhjeve të zhvilluara sipas rregullës 65-*ter* dhe gjatë konferencave për statusin.

62 Rregulla 65*ter*(E), RrPP e TPNJ-së;

19. Gjyqtari Paragjyqësor urdhëron, më pas, Mbrojtjen që të dorëzojë një dosje paragjyqësore, me t'u depozituar dosja paragjyqësore dhe lista e dëshmitarëve e Prokurorisë.[63] Dosja paragjyqësore e Mbrojtjes trajton çështjet faktike dhe ligjore të ngritura përmes lëndës. Në veçanti, dosja duhet të përmbajë një deklaratë me shkrim që parashtron në vija të përgjithshme bazën për mbrojtjen e të akuzuarit, çështjet në dosjen paragjyqësore të Prokurorisë për të cilat i akuzuari ka kundërshtime dhe arsyen pse i akuzuari ka kundërshtime për secilën nga këto çështje. Ngaqë nuk ka detyrim ta bëjë të ditur pistën e mbrojtjes, nuk është e nevojshme që Mbrojtja të depozitojë një listë të dëshmitarëve që synon të ftojë në gjykim pas mbylljes së argumenteve të Prokurorisë. Gjyqtari Paragjyqësor ka një shkallë fleksibiliteti në marrjen e vendimit se kur duhet depozituar kjo dosje dhe, normalisht për afatin bihet dakord mes palëve gjatë një mbledhjeje të zhvilluar sipas rregullës 65*ter* apo gjatë një konference për statusin. Por, dosja paragjyqësore e Mbrojtjes duhet të paraqitet të paktën tri javë përpara Konferencës Paragjyqësore. Në një situatë ideale, Gjyqtari Paragjyqësor u kërkon palëve t'i depozitojnë dosjet paragjyqësore shumë më parë se afati i fundit që lejon Rregullorja. Sa më herët të depozitohen dosjet, aq më herët në procesin paragjyqësor mund të nxiten palët të kyçen në shkëmbime të cilat çojnë në një ngushtim të mosmarrëveshjeve në gjykim. Duhet thënë se, duke qenë se është barrë e Prokurorisë ta vërtetojë akuzën e saj, për të pandehurin nuk ka asnjë detyrim të bjerë dakord për ngushtimin e çështjeve nën mosmarrëveshje dhe ai, thjesht, mund të mos pranojë asnjë fakt.

B.4 Mbledhja për administrimin e gjykimit

20. Përpara gjykimit, edhe Sekretaria mban një mbledhje për administrimin e gjykimit (MAGJ) për menaxhimin e lëndëve, për të siguruar që ato të jenë të gatshme për gjykim dhe që palët të jenë në dijeni të procedurave që duhet të ndjekin. Nëpunësi gjyqësor i Sekretarisë është përgjegjës për organizimin e mbledhjes përpara zhvillimit të seancës së konferencës paragjyqësore, si edhe për t'u dërguar ftesën këtyre sektorëve të Sekretarisë për të mbajtur prezantime në mbledhjen për administrimin e gjykimit: Sektori i Shërbimeve Konferencore dhe Gjuhësore (duke përfshirë edhe stenografët gjyqësorë, sektorin e viktimave dëshmitarë), Zyra e Ndihmës Juridike dhe Çështjeve të Burgimit, Njësia Audio-Vizuale, Shtypi dhe Informimi, Sigurimi dhe Sektori i Administrimit dhe Shërbimeve Gjyqësore. MAGJ-ja zhvillohet me dyer të mbyllura dhe në të marrin pjesë pjesëmarrës të Prokurorisë, Mbrojtjes dhe Dhomave të Gjykatës. Në mbledhje ftohen edhe gjyqtarë, të cilët mund ta përdorin mbledhjen për t'u kujdesur që palët ta kuptojnë mënyrën me të cilën e zhvillon procesin Dhoma. Teksti i zbardhur i mbledhjes u shpërndahet pjesëmarrësve dhe videoregjistrimi depozitohet pranë njësisë së arkivimit për t'u përdorur më vonë nga punonjësit apo avokatët e emëruar më pas. Pas vënies në zbatim të sistemit elektronik të gjykatës, MAGJ-të kanë fituar një rëndësi më të madhe si një mënyrë e efektshme për të siguruar që të gjitha palët të jenë në dijeni të funksioneve të sallës së gjykimit, të shërbimeve që ofron Sekretaria dhe të detyrimeve të tyre përpara Gjykatës.

21. Për ta planifikuar me kujdes prezantimin e provave nga palët dhe për të siguruar një proces sa më normal të marrjes së dëshmisë nga dëshmitarët në sallën e gjykimit, duke siguruar njëkohësisht që gjykimi të zhvillohet me shpejtësi, Sektori i Viktimave dhe Dëshmitarëve (SVD) hartoi një politikë për planifikimin paragjyqësor. Në fillim të çdo gjykimi apo kur gjykimi kalon nga Prokuroria te Mbrojtja, secilit ekip gjyqësor i kërkohet të vendosë se cilët dëshmitarë do të jenë të nevojshëm, renditjen kohore sipas të cilëve do të përdoren dhe përcaktimin e nevojave të posaçme për udhëtim apo për mbështetje/mbrojtje të cilat duhet t'i paraqiten Sektorit të Viktimave dhe Dëshmitarëve. Ky planifikim paragjyqësor ka rëndësi kritike për mundësinë e SVD-së për të planifikuar udhëtimin e dëshmitarëve për në Hagë dhe për t'u kujdesur për mbështetjen dhe strehimin e tyre.

63 Rregulla 65*ter*(F), RrPP e TPNJ-së.

22. Ka një varg objektivash për proceset e planifikimit paragjyqësor. Këta objektiva kanë të bëjnë kryesisht me shkëmbimin e informacionit ndërmjet SVD-së dhe ekipeve gjyqësore, me qëllimin e fundmë për të siguruar që dëshmitarët të marrin shërbimin më të mirë të mundshëm gjatë qëndrimit të tyre në Hagë. Krahas kësaj, secili prej proceseve të planifikimit i ndihmon personat kryesorë të takohen me njëri tjetrin dhe të njihen me rolet e secilës prej njësive të SVD-së dhe që SVD-ja të krijojë një marrëdhënie pune me ekipet.

23. Në secilën mbledhje paragjyqësore duhet të marrin pjesë:
- Nëpunësi i ndërlidhjes;
- Nëpunësi i mbështetjes;
- Nëpunësi i mbrojtjes;
- Asistenti gjyqësor (i caktuar enkas për lëndën);
- Shefi i SVD-së (nëse është nevoja).

24. Objektivi specifik i procesit të planifikimit është për të kuptuar qartë rolin dhe objektin e shërbimeve të SVD-së. Për rrjedhojë, palët informohen për shërbimet dhe kërkesat operative të SVD-së dhe për sa më poshtë:
- çfarë është e nevojshme për të siguruar një planifikim të efektshëm të lëvizjeve logjistike, udhëtimin dhe strehimin, si për shembull pasaporta, dokumente udhëtimi. Fletët e informimit të dëshmitarëve, grafiku kohor dhe dokumente të tjera;
- programi për Asistimin e Dëshmitarëve dhe shërbimet që u ofrohen dëshmitarëve kur janë në gjykatë;
- çfarë presin dëshmitarët kur udhëtojnë në Hagë;
- shërbimet që mund të ofrojë Njësia e Mbështetjes duke përfshirë një shpjegim të kujdesit për fëmijët, politikës për personat mbështetës, etj.;
- masat mbrojtëse në gjykatë;
- programi i rivendosjes.

25. Krahas dhënies së informacionit për SVD-në, një planifikim i efektshëm gjyqësor duhet të përfshijë marrjen e informacionit nga ekipet e Prokurorisë dhe Mbrojtjes lidhur me gjykimin dhe kohëzgjatjen dhe numrin e dëshmitarëve që do të paraqiten. Planifikimi duhet të përfshijë edhe identifikimin e:
- çdo nevoje për mbrojtje të posaçme, mbështetje, rivendosje;
- origjinës etnike ose rajonale të dëshmitarëve; kushteve të shëndetit të dëshmitarëve;
- afateve kohore, duke përfshirë edhe nevojat e posaçme logjistike të ekipeve gjyqësore.

26. Në këtë mbledhje ekipit gjyqësor i jepet një dosje me këtë përmbajtje:
- një prezantim përmbledhës për SVD-në (operacionet, mbështetjen, mbrojtjen);
- një përmbledhje të politikave dhe udhëzimeve (për shembull, “Parimet e shërbimit efektiv”, “Kujdesin për fëmijët”, “Personi shoqërues mbështetës”, “Politika për standardet e shërbimit dhe ankesat”, udhëzime në lidhje me numrin e kufizuar të ditëve dhe numrin e kufizuar të ndryshimeve të kalendarit të gjykimit, udhëzimet për hetuesit, etj.);
- broshura;
- video dhe informacion për mbrojtjen;
- fletët e informimit të dëshmitarëve.

27. Nëse është nevoja, mund të organizohet një mbledhje me ekipin gjyqësor edhe gjatë zhvillimit të gjykimit. Kjo mbledhje mund të përfshijë një diskutim të çdo problemi apo pengese që hasin dëshmitarët ose çdo nevojë logjistike, mbështetjeje a mbrojtjeje që ka lindur gjatë gjykimit. Këto mbledhje mund të bëhen vazhdimisht, nëse lind nevoja.

28. Kur në një gjykim ka disa të pandehur, përvoja e SVD-së ka treguar se është e preferueshme të zhvillohet një mbledhje paragjyqësore me secilin Ekip të Mbrojtjes pikërisht përpara çeljes së pjesës së tyre mbrojtëse në proces.

B.5 Konferenca paragjyqësore

29. Konferenca Paragjyqësore, normalisht, mbahet brenda një jave përpara fillimit të gjykimit (dhe ndonjëherë edhe në të njëjtën ditë), për t'i dhënë mundësi Dhomës Gjyqësore të zgjidhë ndonjë çështje që mund të dalë në momentet e fundit në prag të gjykimit. Shpesh, zgjidhja e këtyre çështjeve ka ndikim te mënyra e zhvillimit të gjykimit. Një përcaktim i vonët i kohës së Konferencës Paragjyqësore u jep mundësi gjyqtarëve *ad litem* të porsaardhur të marrin pjesë në konferencë.

30. Në një situatë ideale, Gjyqtari Paragjyqësor është edhe kryetari, ose të paktën anëtar, i trupit gjykues në shkallën e parë, duke i dhënë mundësi kështu gjyqtarit të ketë një "rol më udhëheqës" gjatë procesit paragjyqësor dhe, kështu, të marrë vendime të cilat do të ndikonin në mënyrën si do të zhvillohet gjykimi. Përndryshe, shumë vendime të tilla si ato që kanë të bëjnë me pranimin e fakteve të gjykuara shtyhen në kohë për t'u vendosur nga trupi gjykues përpara të cilit paraqitet lënda. Gjyqtari që drejton Konferencën Paragjyqësore ka tagrin t'i kërkojë Prokurorisë ta shkurtojë kohën e dëshmisë së disa dëshmitarëve, të përcaktojë numrin e dëshmitarëve që mund të ftojë në gjykim Prokuroria dhe të rregullojë kohën në dispozicion të Prokurorisë për paraqitjen e provave dhe dëshmive të saj. Procesi i kufizimit të numrit të dëshmitarëve të Prokurorisë dhe i kohëzgjatjes së paraqitjes së lëndës prej saj përfshin një këqyrje të hollësishme të përmbledhjeve të dëshmitarëve të propozuar, parë nën dritën e aktakuzës, si edhe kërkon përjashtimin e provave dhe dëshmive përsëritëse të panevojshme. Përsëri, në praktikë, nëse Gjyqtari Paragjyqësor do të jetë edhe Kryetari i trupit gjykues, trupi paragjyqësor mund t'i marrë këto vendime përpara Konferencës Paragjyqësore ose, të paktën, mund të hedhë themelin për këto vendime. Për shembull, trupi paragjyqësor mund t'i kërkojë Prokurorisë, shumë kohë përpara Konferencës Paragjyqësore, ta zvogëlojë numrin e dëshmitarëve që ka në listën e dëshmitarëve, dhe mund ta zvogëlojë numrin e çmuar të orëve të dëshmisë në sallë, në një numër i cili përkon më saktësisht me kohëzgjatjen e pritur të gjykimit në përgjithësi. Ai mund të marrë edhe vendime për mocionet për faktet e gjykuara apo për futjen e dëshmive shkresore sipas rregullave 92*bis*, 92*ter* dhe 92*quater*, duke e shkurtuar kështu kohëzgjatjen e lëndës qysh më përpara.

C. Roli i gjyqtarit

31. Sikurse thuhet më lart, brenda një jave pas paraqitjes së parë të të pandehurit, Kryetari i Dhomës Gjyqësore cakton Gjyqtarin Paragjyqësor.[64] Gjyqtari Paragjyqësor, nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e Dhomës Gjyqësore në ngarkim të lëndës, bashkërendon komunikimin ndërmjet palëve dhe merr të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e lëndës për gjykim të drejtë dhe të shpejtë. Sipas pikës së dytë të germës "D" të rregullës 65-*ter*, Gjyqtari Paragjyqësor vendos një plan pune, ku parashtrohen, në vija të përgjithshme, detyrimet që u kërkohen palëve të përmbushin dhe afatet për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Gjyqtarin Paragjyqësor mund ta asistojë për kryerjen e detyrave njëri prej nëpunësve të lartë juridikë të Dhomës Gjyqësore.

32. Gjyqtari Paragjyqësor normalisht drejton konferencat për statusin dhe merr vendimet lidhur me afatet apo kërkesat për shtyrje të afateve. Në përgjithësi, Gjyqtari Paragjyqësor mund të marrë vendime për çështje

64 Rregulla 65*ter*(A), RrPP e TPNJ-së.

procedurale, ndërsa për mocionet që kanë të bëjnë me çështje themelore vendimet i merr trupi paragjyqësor. Për këtë qëllim, Gjyqtari Paragjyqësor duhet të bëjë përpjekje t'u dalë përpara çështjeve që kanë të ngjarë të shkaktojnë mosmarrëveshje në gjykim dhe të vendosë autoritetin e tij për t'i mbajtur problemet nën kontroll. Mirëpo, për arsye të shpërndarjes së punës mes gjyqtarëve të Tribunalit, nuk është gjithmonë e mundshme që Gjyqtari paragjyqësor të shërbejë edhe si gjyqtar i Dhomës që gjykon lëndën gjatë procesit gjyqësor. Në këtë rast, gjyqtarët e Dhomës paragjyqësore mund të mos duan të marrin vendime detyruese për kolegët e tyre, të cilët do të gjykojnë lëndën gjatë procesit gjyqësor. TPNJ-ja e ka trajtuar këtë problem duke u përpjekur të sigurojë pjesëmarrjen e Gjyqtarit Paragjyqësor si kryetar ose si anëtar i trupit gjykues (shih Shtojcën 6 *"Shembull praktik: parashikimi i kohëzgjatjes së gjykimit gjatë fazës paragjyqësore"*).

D. Dhënia e informacioneve

33. Në sistemin juridik që ekziston në Tribunal, ku prokuroria dhe mbrojtja parashtrojnë lëndën e tyre në mënyrë të barabartë dhe trupi gjykues qëndron i paanshëm, detyrimi i palës për t'ia bërë të ditur palës tjetër informacionet me rëndësi, përbën një element themelor të përgatitjes së gjykimit. Duke pasur parasysh natyrën komplekse të lëndëve kundër krimeve të luftës, bërja e ditur e informacioneve dhe materialeve është një aktivitet madhor i cili kërkon një sasi të madhe burimesh. Ngaqë Prokuroria e TPNJ-së ka sekuestruar shumë dokumente origjinale nga arkivat shtetërore të ish-Jugosllavisë, Mbrojtja mbështetet sidomos te kjo bërje e ditur e materialeve.

34. Ky proces në këto lëndë masive ndryshon mjaft nga bërja e ditur e materialeve në një proces gjyqësor penal të brendshëm, ku të gjitha dëshmitë përkatëse mund të mblidhen dhe kontrollohen brenda një periudhe të shkurtër. Për pasojë, nëse Prokuroria ka probleme në përmbushjen e detyrimeve të saj për bërjen të ditur të materialeve, këto probleme mund të kenë ndikim të padëshirueshëm në përfundimin e procesit paragjyqësor. Rregullorja përshkruan një numër detyrimesh për bërjen të ditur të materialeve, të cilat bien kryesisht mbi Prokurorinë. Detyrimet më të rëndësishme, krahas materialeve që mbështesin konfirmimin e aktakuzës,[65] përfshijnë bërjen të ditur të deklaratave të dëshmitarëve që synon të ftojë në gjykim Prokuroria,[66] materialet shfajësuese[67] dhe bërjen të ditur elektronikisht të materialeve.[68] Mund të lindin probleme të tjera lidhur me bërjen të ditur të materialeve, nëse Mbrojtja kërkon të verifikojë materiale të tjera që janë nën ruajtjen ose kontrollin e Prokurorit.[69]

35. Gjithashtu, nëse i kërkohet, Mbrojtja lejon Prokurorinë që të shikojë dhe kopjojë materialet të cilat synon t'i përdorë si prova në gjykim.[70] Si detyrim reciprok kundrejt atij të Prokurorisë, Mbrojtja duhet t'i japë Prokurorisë edhe kopjet e deklaratave të të gjithë dëshmitarëve të cilët synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim.[71] Dhënia e materialeve nga Mbrojtja përfshin edhe njoftimin që i jep Prokurorisë në lidhje me synimin e saj për të përdorur pistën mbrojtëse të alibisë apo pista të tjera të veçanta të mbrojtjes.[72]

65 Rregulla 66(A)(i), RrPP e TPNJ-së.
66 Rregulla 66(A)(ii), RrPP e TPNJ-së.
67 Rregulla 68(i), RrPP e TPNJ-së.
68 Rregulla 68(ii), RrPP e TPNJ-së.
69 Rregulla 66(B), RrPP e TPNJ-së.
70 Rregulla 67(A)(i), RrPP e TPNJ-së.
71 Rregulla 67(A)(ii), RrPP e TPNJ-së.
72 Rregulla 67(B), RrPP e TPNJ-së.

36. Gjatë procesit paragjyqësor dhe gjatë mbledhjeve të zhvilluara sipas rregullës 65*ter* dhe konferencave për statusin, normalisht pjesa më e madhe e vëmendjes përqendrohet te fakti nëse po i përmbush apo jo Prokuroria detyrimet e veta. Në përgjithësi, vështirësia kryesore për Prokurorinë është se një lënde në fazë paragjyqësore mund të mos i kushtohet i njëjti prioritet me një lëndë që është në fazë gjykimi, për shkak të burimeve të kufizuara. Për pasojë, vonesat në kërkimet në bazat e të dhënave të Prokurorisë mund të vonojnë dhënien e materialeve. Krahas kësaj, problem janë edhe çështjet e përkthimit, duke qenë se i gjithë materiali që mbështet konfirmimin e aktakuzës duhet t'i jepet të pandehurit në një gjuhë të cilën e kupton. Në mënyrë të ngjashme, niveli i prioritetit që Prokuroria i jep lëndës në fazë paragjyqësore përcakton edhe sasinë e burimeve përkthimore që do të vihen në dispozicion.[73] Dhënia faktike e materialeve bëhet vetëm ndërmjet palëve, sepse këto materiale nuk i jepen Dhomës. Gjatë mbledhjeve të zhvilluara sipas Rregullës 65*ter* dhe gjatë konferencave për statusin, roli i Nëpunësit të Lartë Juridik dhe i Gjyqtarit Paragjyqësor është kryesisht reagues sa i takon bërjes së ditur të materialeve, mirëpo ky rol duhet të jetë edhe paraprijës në disa raste të caktuara (për shembull, kur ngrihen çështje nga palët, sidomos nga Mbrojtja). Urdhrat që nxjerr Gjyqtari Paragjyqësor mund ta ndihmojnë ekipin e prokurorisë të fitojë një prioritet më të madh brendapërbrenda Prokurorisë, në konkurrencën për burime të brendshme dhe përkthim.

37. Siç është thënë më lart, Prokuroria duhet t'i japë të pandehurit të gjithë materialin që mbështetët aktakuzën, duke përfshirë të gjitha deklaratat e mëparshme që ka marrë Prokuroria nga i pandehuri, brenda 30 ditësh pas paraqitjes së parë.[74] Në praktikë, ndonjëherë dalin probleme, në kuptimin që prokuroria nuk është në gjendje të sigurojë përkthimin në kohë të materialit mbështetës. Trupi ose Gjyqtari Paragjyqësor zakonisht i kërkojnë prokurorisë ta njoftojë Dhomën në momentin e përmbushjes së detyrimit. Krahas kësaj, sikurse është përmendur më lart, Prokuroria zakonisht nuk ia jep materialet mbështetëse avokatit kujdestar, por pret deri në caktimin e avokatit të përhershëm. Gjatë periudhës 30-ditore, prokuroria normalisht kërkon masa mbrojtëse për disa pjesë të materialeve mbështetëse. Data më të cilën bëhen të ditura materialet mbështetëse ka rëndësi për të përcaktuar afatin 30-ditor në të cilin Mbrojtja mund të depozitojë mocionet paraprake (për shembull, ngritjen e pretendimeve për formën e aktakuzës).[75] Gjyqtari Paragjyqësor mund të caktojë një afat brenda të cilit Prokuroria duhet të vendosë në dispozicion kopjet e deklaratave të gjithë dëshmitarëve që do të thërrasë.[76] Zakonisht ky afat vendoset kohë përpara datës së fillimit të gjykimit, por Tribunali mund të bëjë shtyrje për bërjen të ditur të dëshmitarëve të veçantë dhe për zbulimin e materialeve të tjera shtesë kur nuk shkelen të drejtat e të pandehurit.

38. Materialet shfajësuese i bëhen të ditura Mbrojtjes sa më shpejt që të jetë e mundur.[77] Materiale shfajësuese përfshijnë ato gjëra të cilat, me sa është në dijeni Prokuroria, (i) mund ta lehtësojnë fajin, (ii) mund të çojnë drejt sugjerimit të pafajësisë ose (iii) mund të ndikojnë në besueshmërinë e provave të Prokurorisë.[78] Ky detyrim kaq i gjerë vazhdon gjer në fund të gjykimit dhe madje shtrihet edhe në procesin e apelimit dhe është bërë objekt mosmarrëveshjesh të konsiderueshme. Për shembull, jurisprudenca e TPNJ-së ka përcaktuar se prokuroria duhet të identifikojë konkretisht atë material që e konsideron se mund të jetë shfajësues kur i jep Mbrojtjes një paketë me dokumente. Në praktikë, meqenëse Prokuroria mund të mos jetë në dijeni të

73 Sidomos ka kërkesë të madhe për burimet e përkthimit në TPNJ. Edhe pse shërbimi gjuhësor i Tribunalit, CLSS, është pjesë e Sekretarisë, në praktikë Zyrës së Prokurorisë i është dashur të angazhojë asistentët e vet gjuhësorë për t'u bërë ballë kërkesave të përgjithshme për përkthim. E megjithatë, përkthimet janë dashur të bëhen mbi bazën e prioriteteve të rrepta, të përcaktuara nga faza në të cilën ndodhen lëndët dhe nga kërkesat e procesit gjyqësor.

74 Rregulla 66(A)(i), RrPP e TPNJ-së.

75 Rregulla 72, RrPP e TPNJ-së.

76 Rregulla 66(A)(ii), RrPP e TPNJ-së.

77 Rregulla 68, RrPP e TPNJ-së.

78 Rregulla 68, RrPP e TPNJ-së.

natyrës së pistës që do të ndjekë Mbrojtja gjer vonë gjatë gjykimit, mund të lindin vështirësi për të përcaktuar nëse disa dokumente janë apo jo shfajësuese.

39. Me rritjen e dëshmive dhe provave të Prokurorisë, me kalimin e kohës, në miliona faqe materiale, Prokurori i TPNJ-së ka ngritur një Sistem të Nxjerrjes Elektronike (EDS) enkas për t'ia lehtësuar Mbrojtjes nxjerrjen e informacioneve që i duhen dhe për ta përmirësuar situatën në krahasim me praktikën e mëparshme të dorëzimit të një numri të madh dokumentesh në formë shkresore avokatëve të mbrojtjes. Edhe pse mbi Prokurorin vazhdon të jetë detyrimi bazë për dhënien e informacioneve shfajësuese brenda dijenisë së tij, sistemi i ri EDS përbën një hap drejt dhënies së informacioneve dhe materialeve në formën e "librit të hapur". Ky sistem u jep tani mundësi ekipeve të mbrojtjes të shohin përmbledhje të dëshmive përmes kompjuterit në internet dhe përfshin deklaratat e dëshmitarëve me përjashtim të materialeve më delikate. Krahas kësaj, sistemi EDS është bërë metoda parësore për dorëzimin e materialeve ekipeve të veçanta të mbrojtjes. Por, siç përmendet më lart sa i takon bërjes së ditur të materialeve shfajësuese, prokuroria nuk quhet se i ka përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj rregulle thjesht duke e vendosur materialin në dispozicion në sistemin EDS, ngaqë aty ka me miliona dokumente.

40. Bërja e ditur e hollësive të dëshmive palës tjetër, shpesh krijon përplasje me interesat për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ruajtjen e fshehtësisë së burimeve delikate. Praktika e TPNJ-së e njeh këtë dilemë dhe e trajton atë në një sërë mënyrash, për shembull duke lejuar bërjen të ditur me vonesë të emrave të dëshmitarëve të mbrojtur, duke lejuar që informacioni delikat të fshihet nga dokumentet dhe duke përjashtuar nga informimi disa kategori të caktuara të informacionit të brendshëm dhe delikat.

E. Komunikimi ndërmjet palëve

41. Suksesi i administrimit të procesit paragjyqësor varet nga shkalla dhe cilësia e komunikimit ndërmjet të gjitha palëve të përfshira: Prokurorisë, Mbrojtjes dhe Dhomës paragjyqësore. Një marrëdhënie e mirë pune dhe një komunikim i efektshëm në këtë fazë, mund të vendosë premisat për të gjithë procesin gjyqësor dhe mund të sjellë kursim të kohës. Nëse i pandehuri mbrohet vetë, komunikimi mund të jetë më i ndërlikuar. Në këto rrethana, është e nevojshme asistenca e Sekretarisë, për të mundësuar komunikimin me të pandehurin që mbrohet pa avokat.

42. Ballafaqimet gjyqësore që marrin kohë mund të shmangen përmes diskutimeve jo zyrtare ndërmjet palëve, si një përpjekje për të zgjidhur çdo vështirësi të perceptuar apo të vërtetë. Për shembull, sa u takon çështjeve të bërjes së ditur të materialeve, gjërat zgjidhen më shpejt dhe më mirë nëse Mbrojtja thjesht ia kërkon Prokurorisë informacionin që, sipas saj, mungon, në vend që të kërkojë një urdhër për dhënien e materialeve të lëshuar nga dhoma paragjyqësore.

43. Ka shumë tema që mund të diskutohen ndërmjet palëve në këtë fazë, ndër të cilat mund të përfshihen:

- çështjet paragjyqësore që mund të prekin datën e fillimit të gjykimit, siç mund të jenë shëndeti i të pandehurit, gatishmëria e dëshmitarëve, gatishmëria e avokatëve të mbrojtjes dhe gatishmëria për gjykim;
- fakti nëse do ta aprovojë apo kundërshtojë mocionin e ardhshëm pala kundërshtare (për shembull, mocionin për lirim të përkohshëm apo masat mbrojtëse për dëshmitarët);
- shkalla e çështjeve të lidhura me gjykimin, për të mos arritur në pikën ku Prokuroria të kërkojë dhe japë materiale pa lidhje; dhe arritja e marrëveshjes për dëshmitë dhe provat për të cilat nuk ka kundërshtim.

44. Është e rëndësishme të regjistrohen në mënyrë të qartë dhe të saktë të gjitha komunikimet e rëndësishme ndërmjet palëve, për të shmangur mosmarrëveshjet apo keqkuptimet e mundshme në një fazë të mëvonshme në procesin gjyqësor. Kjo mund të bëhet duke përdorur një dosje letërkëmbimi, ose elektronike ose në letër, ku të mbahen kopjet e të gjitha letrave, mesazheve elektronike dhe procesverbalet me shkrim të bisedave telefonike.

45. Edhe pse duhen nxitur palët të komunikojnë mes tyre, për të pandehurin nuk ka asnjë detyrim të bashkëpunojë me Prokurorinë dhe, në disa raste i pandehuri mund të marrë një vendim strategjik për të mos komunikuar fare me Prokurorinë.

F. Mocionet paragjyqësore

F.1 Mocionet paraprake

46. Mocionet paraprake janë ato mocione që kundërshtojnë juridiksionin e Tribunalit (domethënë, pretendimi se aktakuza nuk lidhet me asnjërin prej personave, territoreve, periudhën kohore apo shkeljet që rregullojnë nenet përkatëse të Statutit të Tribunalit), që ngrenë pretendimin se ka mangësi në formën e aktakuzës ose që kërkojnë ndarjen e pikave të bashkuara në një aktakuzë. Shumica e mocioneve paraprake ngrenë kundërshtime për juridiksionin ose pretendime për mangësi në formën e aktakuzës. Sipas Rregullores, mocionet paraprake duhet të depozitohen brenda 30 ditëve pas bërjes së ditur nga Prokuroria të të gjitha materialeve në mbështetje të konfirmimit të aktakuzës. Mocioneve paraprake u duhet dhënë zgjidhje përpara nxjerrjes së urdhrit për depozitimin e dosjeve paragjyqësore.

47. Disa Dhoma kanë nxjerrë vendime ku shtjellohen parimet e parashtrimit të qëndrimeve dhe ku mbulohen tema të tilla si kërkesat për konkretësinë dhe parashtrimin e aktakuzave, përkufizimet dhe dallimet ndërmjet konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe jo-ndërkombëtare, dhe zbatueshmëria e përgjegjësisë komanduese. Këto parime mbështeten në jurisprudencën e mëparshme në kuadër të kësaj rregulle, si edhe në aktgjykimet e shkallës së parë dhe apelit, ku është trajtuar çështja e mungesës së qartësisë në aktakuza. Rregullorja parashikon që mocionet paraprake duhet të marrin zgjidhje brenda 60 ditëve. Nëse një mocion ngre kundërshtim kundër juridiksionit të Tribunalit, ekziston e drejta për të bërë apelim të ndërkohshëm. Mocionet që kundërshtojnë formën e aktakuzës nuk bëhen objekt apelimi të ndërkohshëm pa miratimin e trupit gjykues. Nëse ka ndryshim të aktakuzës pas depozitimit të një mocioni që kundërshton formën e aktakuzës, Mbrojtjes i lind e drejta të depozitojë një mocion të ri për të kundërshtuar ato pjesë të aktakuzës që janë ndryshuar. Në praktikë, për shkak të shtesave dhe ndryshimeve të mëtejshme, Mbrojtja mund të depozitojë tre a katër mocione që kundërshtojnë formën e aktakuzës.

F.1.1 Mocionet e tjera

48. Krahas mocioneve paraprake të përmendura më lart, ka një sërë mocionesh të tjera paragjyqësore të zakonshme. Këtu përfshihen mocione të lidhura me lirimin e përkohshëm, masat mbrojtëse për dëshmitarët ose materialet, mocionet për bashkimin ose ndarjen e lëndëve, mocionet e Prokurorisë për të ndryshuar aktakuzën dhe mocionet për të shikuar materialet konfidenciale të lëndëve të tjera.

F.1.2 Mocioni për lirim të përkohshëm

49. I pandehuri mund të kërkojë lirim të përkohshëm, në pritje të përgatitjes së lëndës për gjykim. Lirimi i përkohshëm, është dhënë kryesisht gjatë fazës paragjyqësore, por edhe në gjykim ose në pritje të nxjerrjes së aktgjykimit. Lirimi i përkohshëm mund të jepet vetëm nëse Dhoma Gjyqësore bindet se i pandehuri do të paraqitet për gjykim dhe se nuk përbën rrezik për asnjë viktimë, dëshmitar apo person tjetër.

50. Dhoma Gjyqësore duhet t'i japë mundësinë për t'u shprehur, edhe vendit pritës edhe shtetit në të cilin kërkon të shkojë i pandehuri gjatë lirimit të përkohshëm. Kjo mund të bëhet ose mbi bazën e parashtrimeve me shkrim, ose në një seancë dëgjimore me praninë e përfaqësuesve të shteteve. Vendi pritës nuk merr pjesë, sepse Holana ka një politikë për të mos u shprehur për kërkesat në themel të tyre, por në të njëjtën kohë për të mos i lejuar të pandehurit në lirim të qëndrojnë në Holandë. Në mbështetje të kërkesës për lirim të përkohshëm, Shteti në të cilin kërkon të shkojë i pandehuri gjatë lirimit të përkohshëm, shpesh dorëzon garanci me shkrim lidhur me ndjekjen dhe sigurinë e të pandehurit, si edhe raporte periodike gjatë lirimit të përkohshëm.

51. Çdo vendim që jep lirim të përkohshëm shoqërohet me një sërë parakushtesh që duhen plotësuar nga i pandehuri dhe Shteti ku do të shkojë i pandehuri gjatë lirimit të përkohshëm. Nëse Prokuroria dëshiron të sigurojë që një vendim për lirim të përkohshëm të mos zbatohet në pritje të apelimit nga ana e saj, duhet ta bëjë këtë kërkesë në përgjigje të kërkesës për lirim të përkohshëm, duke shprehur synimin e saj për të apeluar nëse vendimi do të jetë në favor të lirimit. Kur Dhoma Gjyqësore e miraton pezullimin, Prokuroria duhet ta paraqesë apelin jo më vonë se një ditë pas publikimit të vendimit. Në fillimet e Tribunalit, lirimi i përkohshëm jepej në raste të jashtëzakonshme, sepse rregulli e kërkonte që të identifikoheshin rrethana të jashtëzakonshme për lirim. Ky rregull është ndryshuar më vonë, për ta hequr kërkesën e konstatimit të rrethanave të jashtëzakonshme. I pandehuri vazhdon ta ketë barrën për të treguar përmbushjen e kritereve të lirimit të përkohshëm, dhe jurisprudenca identifikon një sërë faktorësh përkatës që lidhen me konstatimin nëse është përmbushur apo jo kjo barrë, siç është rasti i dorëzimit vullnetar të të pandehurit, si edhe me kohëzgjatjen e pritur të paraburgimit. Lirimi i përkohshëm mund të kërkohet jo vetëm gjatë fazës paragjyqësore, por edhe pas fillimit të gjykimit, për periudhat kohore gjatë të cilave nuk do të zhvillohet gjykimi, siç është pushimi gjyqësor apo pas mbylljes së marrjes së dëshmive gjer në dhënien e aktgjykimit.

52. Duke qenë se nuk ka një forcë policore të vetën, Tribunali nuk mund të përdorë sisteme të lirimit të shoqëruar përmes të cilit i pandehuri mund të shoqërohet në një aktivitet jashtë burgut, siç është rasti i varrimit të një të afërmi. Megjithatë, Dhomat i kanë lejuar disa të pandehur të largohen nga burgimi për periudha të shkurtra gjatë gjykimit ose në pritje të apelit, për arsye të forta njerëzore. Mirëpo, një kusht për këtë lloj lirimi të përkohshëm ka qenë që autoritetet kombëtare të Shtetit në të cilin shkon gjatë lirimit i pandehuri të sigurojnë vrojtim dhe mbikëqyrje 24-orë të të pandehurit.

F.1.3 Masat mbrojtëse

53. Ka disa rregulla që lidhen me përdorimin e masave mbrojtëse. Këto rregulla fokusohen kryesisht te mbrojtja e dëshmitarëve, siç është mospublikimi i emrit të dëshmitarit, dhënia me vonesë e emrit Mbrojtjes, përdorimi i pseudonimeve ose i masave të tjera mbrojtëse gjatë procesit paragjyqësor a gjyqësor, mbrojtja e materialit të marrë nga burimeve të caktuara siç janë organizatat humanitare dhe mosdhënia e informacionit për të evituar cenimin e hetimeve të tanishme ose të ardhshme. Në praktikë, çështje të tilla lindin rregullisht në të gjitha lëndët paragjyqësore (dhe gjyqësore). Është e zakonshme që Prokuroria të depozitojë një sërë mocionesh për masa mbrojtëse gjatë procesit paragjyqësor. Dhoma paragjyqësore shpesh i shtyn në kohë vendimet, për trupin gjykues, për çështje të tilla si nevoja për masa mbrojtëse në sallën e gjykimit, duke

përfshirë edhe shtrembërimin e zërit dhe të pamjes dhe zhvillimin e seancave me dyer të mbyllura. Jurisprudenca e Tribunalit parashikon se masat mbrojtëse duhet të mbështeten në diçka më shumë se thjesht shprehja subjektive e shqetësimit nga ana e dëshmitarëve. Në të vërtetë, masat mbrojtëse mund të jepen vetëm nëse tregohet se siguria e dëshmitarit apo e të afërmve të tij do të vihej në rrezik në mungesë të masave të propozuara të sigurimit.

F.1.4 Mocioni për bashkimin apo ndarjen e lëndëve

54. Personat e pandehur për krime të njëjta ose të ndryshme mund të akuzohen dhe gjykohen në mënyrë të bashkuar, me kusht që të akuzohen për vepra të kryera "në të njëjtin transaksion". Nëse kërkohet bashkimi për të pandehur të ndryshëm lëndët e të cilëve u janë caktuar dhomave paragjyqësore të ndryshme, mund të lindin probleme. Në Tribunal, Presidenti, në disa raste, ka ngarkuar një Dhomë të posaçme ("Trup Gjykues pr Bashkim") i përbërë nga gjyqtarë të dhomave gjyqësore të ndryshme, për të vendosur nëse duhet lejuar apo jo bashkimi i lëndëve.

F.1.5 Mocioni i Prokurorisë për ndryshimin e aktakuzës

55. Nëse një lëndë i është caktuar një Dhome, ndryshimi i aktakuzës mund të bëhet vetëm nëse Dhoma Gjyqësore apo Gjyqtari Paragjyqësor të ketë dhënë lejen pasi t'i ketë dëgjuar palët. Për ta justifikuar ndryshimin, Prokuroria duhet të japë materialin mbështetës. Nëse në aktakuzën e ndryshuar ka akuza të reja, do të duhet një paraqitje e re e të pandehurit për të bërë një deklarim të pranimit ose jo të fajësisë për pikat e reja të akuzës. Mbrojtja ka të drejtën, për 30 ditë të tjera, për të depozituar mocione paraprake në lidhje me pikat e reja të akuzës. Në praktikë, Mbrojtja e ka përdorur njëkohësisht rregullin për mocionet paraprake dhe rregullin për ndryshimin e aktakuzës dhe disa gjyqtarë paragjyqësorë i kanë dhënë urdhër Mbrojtjes të depozitojë parashtrime sipas të dyja rregullave njëkohësisht, duke e përshpejtuar më tej procesin e duke shmangur dyfishimin në të njëjtën kohë.

F.1.6 Mocionet për shikimin e materialeve konfidenciale të lëndëve të tjera

56. Ndodh rregullisht në procesin paragjyqësor (dhe gjyqësor) që një palë e njërës lëndë të kërkojë të drejtën e shikimit të materialeve të një lënde tjetër, edhe pse lënda tjetër u është nënshtruar masave mbrojtëse. Nëse lënda tjetër vazhdon të jetë lëndë e ngarkuar një Dhome, këto mocione depozitohen pranë asaj dhome. Nëse lënda që është objekt i masave mbrojtëse nuk është më në ngarkim të asnjë dhome, pala kërkuese mund ta depozitojë mocionin e saj pranë Dhomës në ngarkim të së cilës është lënda e saj.

57. Pala kërkuese nuk duhet "t'i hyjë peshkimit", por duhet të identifikojë në mënyrë të mjaftueshme materialet e kërkuara dhe të dëshmojë ekzistencën e një qëllimi legjitim kriminalistik për shikimin e materialit në fjalë. Gjatë vlerësimit nëse ekziston apo jo një qëllim legjitim, Dhoma shikon natyrën e materialeve që po kërkohen si edhe çdo mbivendosje gjeografike ose kohore ndërmjet lëndës së kërkuesit dhe lëndës që i përkasin dokumentet.

58. Procesi i nevojshëm për dhënien e të drejtës së shikimit të materialeve konfidenciale të lëndëve të tjera, mund të paraqesë vështirësi logjistike për Sekretarinë.[79] Çështja e parë është vështirësia e identifikimit të materialit që është marrë në mënyrë konfidenciale dhe që, për rrjedhojë, nuk mund të jepet pa pëlqimin e dhënësit. Në një rast të tillë, Sekretaria, si një organ i paanshëm i Tribunalit, nuk është në dijeni të asnjë kushti që mund të jetë vendosur mbi dhënien e informacioneve dhe, për rrjedhojë, ka nevojë për asistencë të jashtme për identifikimin e informacionit që duhet të hiqet nga materiali përpara dhënies së tij një të treti[80] (shih kutinë *"Lënda Brđanin - Fshirja e materialit konfidencial"*)

Lënda Brđanin – Fshirja e materialit konfidencial

Në lëndën Brđanin, Dhoma Gjyqësore mori në konsideratë propozimin e Sekretarisë dhe Prokurorisë dhe mori vendim për ndryshimin e dispozitës së saj të parë, në "fshirje nga palët" në vend të tekstit "fshirje nga Sekretaria". Prokuroria e mbështeti parashtrimin e Sekretarisë dhe propozoi që secila palë të jetë përgjegjëse për fshirjen e dëshmive dhe provave konfidenciale.***

* Vendimi për mocionin e mbrojtjes së Milan Martić-it për të shikuar procesverbale dhe dokumente konfidenciale, depozituar në Lëndën Nr.. IT-99-36-T më 26 maj 2004.

** Përgjigja e Prokurorisë për parashtrimin e Sekretarisë lidhur me fshirjen e të dhënave sipas rregullës 33(B),' depozituar në Lëndën Nr. IT-99-36-T më 20 maj 2004.

G. Zvogëlimi i objektit të aktakuzës

59. In Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e proceseve në Tribunal, është marrë një vendim për ta ndryshuar rregulloren në mënyrë që t'i jepej mundësi Dhomës t'i kërkonte Prokurorit zvogëlimin e numrit të pikave të akuzës dhe paracaktojë numrin e vendngjarjeve të krimeve në një aktakuzë. Nëse Prokurori nuk e pranon këtë kërkesë, Dhoma mund ta urdhërojë Prokurorin të përzgjedhë ato pika të akuzës me të cilat duhet të vazhdojë procesi.

60. Pas ndryshimit të rregullës, Dhoma i ka kërkuar Prokurorisë shkurtimin e një gjykimi, në këtë mënyrë, në shumë raste. Për shembull, Prokurorisë i është kërkuar ta ulë numrin e pikave të akuzës për një të tretën apo të mos kërkojë dhënien e dëshmive për ato vendngjarje apo incidente të krimeve për të cilat Dhoma ka qenë e mendimit se nuk ishin përfaqësuese të krimeve objekt i akuzës. Prokuroria vazhdimisht nuk i ka pranuar kërkesat për t'i zvogëluar lëndët, me argumentin se lëndët kundër udhëheqësve shpesh varen nga konstatimi i modelit dhe i kohëzgjatjes së krimeve të vartësve të tyre, dhe se dëshmimi i këtyre veprimeve, në vetvete, kërkon shumë kohë. Në fund, Prokuroria është treguar bashkëpunuese për identifikimin e pjesëve të aktakuzës për t'u lënë jashtë procesit apo të mos paraqiten prova në lidhje me to. Por ndonjëherë, Dhomat ia lejojnë Prokurorisë të përfshijë dëshmi që lidhen me pika të tilla, me qëllimin e kufizuar të konstatimit të një modeli ose konteksti.

79 Për këtë është diskutuar në Parashtrimin e Sekretarisë lidhur me redaktimit sipas rregullës 33(B), *Prokurori kundër Radoslav Brđanin-it*, Lënda Nr. IT-99-36-T, datë 26 prill 2004; shih edhe Parashtrimin e Sekretarisë sipas rregullës 33(B) të Rregullores së Procedurës dhe Provave në lidhje me mocionet e mbrojtjes përmes të cilave kërkohet e liria e shikimit të materialeve konfidenciale të disa lëndëve, depozituar gjithashtu në Lëndën Nr. IT-95-14/2-A, IT-95-14-A, IT-01-47-T, IT-02-54-T, IT-02-60-A, IT-03-68-T, IT-04-74-PT, IT-04-83-PT, dhe IT-05-88-PT më 28 tetor 2005. Dhoma Gjyqësore vendosi që "duke qenë se Prokuroria e njeh materialin, duhet ta redaktojë sipas kërkesës; dhe materialin e redaktuar do t'ia japë Sekretarisë për t'ia bërë të ditur Kërkuesit".

80 Nëse mbyllet lënda, ekipi i mbrojtjes nuk është më aktiv, por avokati kujdestar ruan përgjegjësinë për lëndën deri në pesë vjet pas përfundimit. Shih Direktivën për caktimin e avokatëve të mbrojtjes (e ndryshuar më 11 korrik 2006), IT/073 Rev. 11, Neni 16(I). Po kështu, nëse kërkesa paraqitet brenda këtyre pesë vjetëve, duhet të jetë e mundshme t'i kërkohet avokatit kujdestar të kontaktojë ofruesit e materialit sipas rregullës 70, të redaktojë materialet apo të kryejë funksione të tjera.

H. Ngushtimi i çështjeve kontestuese

61. Ballafaqimet gjyqësore kushtojnë shtrenjtë, marrin kohë dhe janë stresuese për dëshmitarët të cilët duhet të rikujtojnë përjetime tronditëse dhe shqetësuese. Për pasojë, administrimi efikas i të gjitha gjykimeve, si ato kundër krimeve të luftës, ashtu edhe atë kundër krimeve të brendshme apo për konflikte civile, kërkon vërtetimin përmes dëshmisë në sallë të dëshmitarëve vetëm të atyre çështjeve që janë vërtetë kontestuese.

62. Objekti i çështjeve të tilla mund të ngushtohet në dy mënyra: nëse palët bien dakord për faktet që nuk është nevoja të vërtetohen në sallë, ose nëse Tribunali merr njoftim gjyqësor të fakteve të vërtetuara në lëndën e mëparshme. Të dyja këto tema trajtohen më poshtë.

63. Shumë shpesh, ndërhyrja gjyqësore mund të ndihmojë në mbrojtjen e të drejtave të dy palëve. Nuk duhet ushtruar presion mbi Mbrojtjen për të rënë dakord për pranimin e dëshmive të kontestueshme. Në të njëjtën kohë, nuk duhet lejuar Mbrojtja ta pengojë procesin e gjykimit përmes refuzimit për të pranuar ato fakte që nuk mund të kundërshtohen.

H.1 Faktet e pranuara

64. Një problem standard në agjendën e një mbledhjeje paragjyqësore është nëse janë apo jo në gjendje palët të arrijnë në një marrëveshje për një grup faktesh të cilat nuk është nevoja të vërtetohen në gjykim. Forma më e zakonshme e fakteve të pranuara, ka të bëjë me faktet e "bazës së krimeve", me fjalë të tjera, me ato fakte të cilat konstatojnë që ka ndodhur një krim, në dallim nga ato fakte që konstatojnë përgjegjësinë penale për krimin e ndodhur. Në shumicën e rasteve, numri i fakteve të miratuara është i vogël dhe nuk mjafton për t'i ngushtuar çështjet kontestuese.

65. I pandehuri mund të motivohet të bjerë dakord për disa fakte të caktuara të "bazës së krimeve" për të treguar një nivel të përgjithshëm bashkëpunimi, si edhe sepse dëshiron ta ngushtojë objektin e çështjeve të gjykimit për të qenë ato që lidhen me përgjegjësinë e tij dhe që janë më kontestueset. Nga ana tjetër, i pandehuri mund të vendosë të mos bjerë dakord për faktet bazë, për arsye mjaft legjitime dhe të sinqerta.

H.2 Shënimi gjyqësor

66. Në interes të shkurtimit të procesit, Dhoma Gjyqësore nuk kërkon vërtetimin e atyre fakteve që dihen nga të gjithë, por merr shënim gjyqësor të këtyre fakteve.[81] Shënimi gjyqësor i fakteve të gjykuara më parë -- për dallim nga faktet që dihen gjerësisht -- është çështje që mbetet në dorën e Dhomës Gjyqësore dhe e cila është kontestuar shumë në Tribunal.[82]

67. Qëllimi i marrjes së shënimit gjyqësor është arritja e ekonomisë gjyqësore dhe harmonizimi i aktgjykimeve të Tribunalit duke i dhënë Dhomës Gjyqësore të drejtën për të marrë shënim gjyqësor të fakteve apo dokumenteve nga procese të tjera. Kjo kompetencë duhet ushtruar "mbi bazën e marrjes në konsideratë në mënyrë të kujdesshme të së drejtës të të pandehurit për gjykim të drejtë dhe të shpejtë", në përputhje me parimin e gjykimit të drejtë.[83]

68. Dhoma e Apelit ka sugjeruar se kërkesa për pranimin e fakteve të gjykuara më parë "duhet të evidentojë konkretisht paragrafët a pjesët e aktgjykimit nga i cili dëshiron të bëjë marrjen e shënimit gjyqësor dhe t'i

81 Rregulla 94(F), RrPP e TPNJ-së.
82 Paragrafët në vijim janë nxjerrë nga lënda *Prokurori kundër Momčilo Perišić-it*, IT-04-81-PT, Vendim për mocionin e Prokurorisë për shënimin gjyqësor të fakteve të gjykuara që kanë të bëjnë me Sarajevën, 26 qershor 2008, para. 13-17.
83 *Karemera dhe të tjerë*, Vendimi i Apelit, para. 41.

përmendë faktet ashtu siç konstatohen nga dhoma gjyqësore".[84] Sa i takon pasojës së marrjes së shënimit gjyqësor, Dhoma e Apelit ka mbajtur më tej qëndrimin se "përmes marrjes së shënimit gjyqësor të faktit të gjykuar, Dhoma konstaton prezumimin e bazuar të saktësisë së këtij fakti, i cili, për rrjedhojë, nuk ka nevojë të vërtetohet edhe një herë në gjykim, por i cili, varësisht prej këtij hamendësimi, mund të kundërshtohet në gjykim".[85] Pra, "në rastin e shënimit gjyqësor, pasoja është vetëm çlirimi i Prokurorisë nga barra e parë e saj për të dhënë prova në këtë pikë. Pastaj, Mbrojtja mund ta vendosë atë në dyshim përmes sjelljes së provave të besueshme që vërtetojnë të kundërtën".[86] Mirëpo, çka është e rëndësishme, "shënimi gjyqësor i fakteve të gjykuara nuk ia heq barrën e përgjithshme të provës Prokurorisë".[87]

69. Sipas jurisprudencës së vendosur të Tribunalit, gjatë marrjes së vendimit për të marrë apo jo shënim gjyqësor, Dhoma Gjyqësore duhet të shikojë nëse faktet i përmbushin të paktën kërkesat e mëposhtme:

- i dallueshëm, konkret dhe i identifikueshëm;[88]
- aktual dhe i lidhur me lëndën;[89]
- përfshin konstatime a karakterizime të një natyre *në thelb* juridike;[90]
- nuk bazohet në marrëveshje për pranimin e fajit apo në fakte të pranuara në mënyrë vullnetare në një lëndë të mëparshme;[91]
- "i gjykuar vërtetë", pra nëse është kundërshtuar në apel, fakti është vendosur;[92]
- nuk lidhet me veprën, sjelljen apo gjendjen mendore të të pandehurit;[93]
- formulimi i propozuar në mocionin për pranim që paraqet pala kërkuese nuk ndryshon në mënyrë të rëndësishme nga mënyra e shprehjes së faktit gjatë gjykimit në procesin e mëparshëm.[94]

70. Nuk kërkohet që faktet e propozuara të shkojnë përtej kontestimit të arsyeshëm ndërmjet palëve.[95] Mirëpo, duke qenë se vendimi për marrjen e shënimit gjyqësor është në dorën e saj, Dhoma Gjyqësore ruan gjithmonë të drejtën të mos pranojë të marrë shënim gjyqësor të faktit, edhe nëse kërkesat i përmbush të gjithë kriteret, nëse Dhoma nuk beson se marrja e shënimit do t'u shërbente interesave të drejtësisë.[96] Madje Dhoma e Apelit e ka theksuar se vendimi i Dhomës Gjyqësore për të marrë shënim gjyqësor duhet të

---

84 *Shih Prokurori kundër Zoran Kupreškic-it dhe të tjerëve*, IT-95-16-A, Vendim për mocionet e Drago Josipović-it, Zoran Kupreškić-it dhe Vlatko Kupreškić-it për të pranuar prova të tjera shtesë në përputhje me Rregullën 115 dhe për shënimin gjyqësor të marrë në përputhje me Rregullën 94(B), 8 maj 2001, ("Vendimi i Lëndës Kupreškić dhe të tjerë"), para. 12.

85 *Shih Prokurori kundër Slobodan Milošević-it*, IT-02-54-AR73.5, Vendim për apelin e ndërkohshëm të prokurorisë kundër vendimit të datës 10 prill 2003 të Dhomës Gjyqësore lidhur me mocionin e Prokurorisë për shënimin gjyqësor të fakteve të gjykuara, 28 tetor 2003, ("Vendimi i Apelit i Lëndës *Slobodan Milošević*"), f. 4 (poshtëshënimi është hequr); Karemera dhe të tjerë, Vendimi i Apelit, para. 42; *shih edhe Prokurori kundër Popović-it dhe të tjerëve*, IT-05-88-T, Vendim për mocionin e Prokurorisë për shënimin gjyqësor të fakteve të gjykuara me Shtojcën, 26 shtator 2006 ("Vendimi *Popović dhe të tjerë),* para. 20.

86 *Karemera dhe të tjerë,* Vendimi i Apelit, para. 42.

87 *Prokurori kundër Dragomir Milošević-it*, IT-98-29/1- AR73.1, Vendim për apelimet e ndërkohshme kundër vendimit të Dhomës Gjyqësore për mocionin e Prokurorisë për shënimin gjyqësor të fakteve të gjykuara dhe Katalogun e Fakteve të Miratuara të Prokurorisë, 26 qershor 2007, para. 19-22 ("Vendimi i Apelit *Dragomir Milošević*"), para. 16 ku citohet *Karemera dhe të tjerë,* Vendimi i Apelit, para. 42.

88 *Shih, për shembull,* Vendimi *Krajišnik*, para. 14.

89 *Prokurori kundër Momir Nikolić-it*, IT-02-60/1-A, Vendim për mocionin e Apeluesit për shënim gjyqësor, 1 prill 2005 ("Vendimi i Apelit *Nikolić*"), para. 52

90 Vendimi i Apelit *Dragomir Milošević*, para. 19-22.

91 Vendimi *Popović dhe të tjerë*, para. 11.

92 Vendim *Kupreškić dhe të tjerë*, para. 6; Vendimi *Krajišnik*, para. 14. *Prokurori kundër Prlić-it dhe të tjerëve*, IT-04-74-PT, Vendim për mocionin për shënim gjyqësor të fakteve të gjykuara sipas rregullës 94(B), 14 mars 2006, ("Vendimi paragjyqësor *Prlić dhe të tjerë")*, para. 12, 15.

93 *Karemera dhe të tjerë,* Vendimi i Apelit, para. 51.

94 Vendimi *Krajišnik*, para. 14. Vendimi paragjyqësor *Prlić dhe të tjerë*, para. 21.

95 *Karemera dhe të tjerë,* Vendimi i Apelit, para. 40; shih edhe Vendimin e Apelit *Dragomir Milošević*, para. 27; Vendimi *Popović dhe të tjerë*, poshtëshënimi 19.

96 *Karemera dhe të tjerë,* Vendimi i Apelit, para. 41; Vendimi *Popović dhe të tjerë*, para. 16.

mbështetet te fakti nëse vendimi për të marrë shënim gjyqësor të fakteve do ta nxiste apo jo interesin për arritjen e ekonomisë gjyqësore duke ruajtur në të njëjtën kohë të drejtën e të pandehurit për një proces të drejtë, publik dhe të shpejtë.[97]

I. Vetëdeklarimi i fajësisë

71. Prej krijimit të Tribunalit, 18 persona të akuzuar janë dënuar pas paraqitjes dhe pranimit të deklaratës së pranimit të fajit për një apo më shumë pika të aktakuzës. Rregullorja parashikon kushte të rrepta për pranimin e vetëdeklarimit të fajësisë nga Dhoma Gjyqësore, i cili duhet të jetë vullnetar, i bërë në bazë të informimit, i qartë dhe i shoqëruar me prova faktike për krimin dhe pjesëmarrjen e të pandehurit në të.

72. Marrëveshjet për pranimin e fajit përfshijnë një marrëveshje midis Prokurorit dhe Mbrojtjes për faktin që i pandehuri vetëdeklarohet fajtor për një ose disa pika të aktakuzës. Në këmbim të vetëdeklarimit, Prokurori bie dakord ta ndryshojë aktakuzën në përputhje me vetëdeklarimin, të pranojë se një dënim apo diapazon dënimi është i përshtatshëm dhe/ose të mos kundërshtojë kërkesën e të pandehurit për këtë dënim apo diapazon dënimi. Gjyqtarët nuk përzihen në negociatat për pranimin e fajit. Rrjedhimisht, kur këto negociata dështojnë, diskutimet ndërmjet palëve mbeten të fshehta dhe nuk mund të përdoren gjatë gjykimit. Kushtet e marrëveshjes për pranimin e fajit, të arritur ndërmjet Prokurorit dhe Mbrojtjes, nuk janë të detyrueshme për zbatim nga Dhoma Gjyqësore.

73. Vetëdeklarimi i fajësisë dhe marrëveshja për pranimin e fajit pasqyrojnë elementin anglosakson të sistemit juridik hibrid të Tribunalit dhe zhvillimet e mëdha me kalimin e kohës janë bërë në interes të sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të të pandehurve. Tribunali duhet të tregojë sidomos kujdes në pranimin e vetëdeklarimit të fajësisë, duke qenë se i pandehuri bën një pranim gjyqësor të fajësisë dhe kështu shmang nevojën për gjykimin e fajësisë. Pasoja e vetëdeklarimit të fajësisë, lidhur me lëndët e tjera të lidhura që paraqiten përpara TPNJ-së, është disi e kufizuar, në kuptimin që Dhomat Gjyqësore zakonisht nuk pranojnë të marrin shënim gjyqësor të fakteve mbi të cilat ngrihet marrëveshja e pranimit të fajësisë, nisur nga argumentimi se këto fakte nuk janë konstatuar në ballafaqim gjyqësor.

74. Vetëdeklarimi i fajësisë thuajse gjithmonë përfshin një numër më të vogël akuzash që ngre aktakuza. Duke qenë se vetëdeklarimi i fajësisë përfshin pranimin nga i pandehuri të bazës faktike të elementeve juridike të krimit që pranon, kjo e çliron Prokurorin nga detyrimi për të konstatuar provat për këto pika të akuzës.

75. Megjithëse disa mund ta quajnë procesin e vetëdeklarimit të fajësisë dhe arritjes së marrëveshjeve për pranimin e fajësisë si “pranim i negociuar i fajësisë”, ky karakterizim është jo i saktë, për dy arsye. Së pari, vetëdeklarimi i fajësisë mund të bëhet pa ekzistencën e një marrëveshjeje për pranimin e fajit dhe pavarësisht mendimeve të Prokurorit. Së dyti, marrëveshjet që arrihen në bazë të negociatave reciproke nuk kanë fuqi detyruese mbi Dhomën Gjyqësore. Në fakt, natyra jodetyruese e marrëveshjeve për pranimin e fajit krijon një stimul negativ për të mos e pranuar fajësinë dhe ka shumë të ngjarë të jetë arsyeja e vetme më e madhe pse nuk para ka vetëdeklarime të fajësisë, duke qenë se i pandehuri nuk mund të jetë i sigurt nëse dënimi i negociuar me Prokurorin dhe i përfshirë në pretencë si dënimi i përshtatshëm do të pranohet nga Dhoma Gjyqësore. Në praktikë, mjafton vetëm një rast ku një dhomë gjyqësore e tejkalon ndjeshëm dënimin e rekomanduar, që të pandehurit e tjerë të mos marrin fare në konsideratë përfitimet që mund të vijnë nga vetëdeklarimi i fajësisë.

97 Vendimi i Apelit *Nikolić*, para. 11, me referencat e mëtejshme.

76. Vetëdeklarimi i fajësisë shpesh bëhet për një numër më të vogël akuzash që ngre aktakuza. Ai mund të përfshijë një vetëdeklarim të asaj që i pandehuri e percepton si mënyra më e vogël e përgjegjësisë penale (për shembull, nxitje dhe përkrahje, në vend të urdhërimit) dhe një premtim për të bashkëpunuar në hetimin ose ndjekjen penale të personave të tjerë të pandehur përpara Tribunalit. Në kuadër të vetëdeklarimit të fajësisë, normalisht Prokurori bie dakord t'i rekomandojë Dhomës Gjyqësore një dënim specifik si të përshtatshëm për krimet për të cilat e pranon vetë fajësinë i pandehuri. Gjithashtu, Prokurori mund të bjerë dakord të mos i ndjekë pikat e tjera të akuzës që mbeten pas pranimit të vetëdeklarimit të fajësisë dhe madje mund ta ndryshojë aktakuzën që kjo të përputhet me kushtet e vetëdeklarimit të fajësisë. Në praktikën e TPNJ-së marrëveshja zyrtarizohet duke e bërë me shkrim dhe ajo formulohet me një gjuhë e cila pasqyron se i pandehuri e ka kuptuar qartë që është pranuar në mënyrë të informuar dhe vullnetare dhe pa keqkuptime fajësia dhe mbi bazën e mjaftueshme faktike.

77. Krahas kursimit të kohës, pranimit të vetëdeklarimit të fajësisë i atribuohen edhe avantazhe të tjera. Duke qenë se vetëdeklarimi i fajësisë e shmang nevojën që dëshmitarët të dëshmojnë në sallë, pranimi i tij ka përfitime për dëshmitarët, të cilët mund të vendosen nën një mundim të konsiderueshëm fizik, mendor a emocional. Duke qenë se vetëdeklarimi i fajësisë është pranimi vetjak i fajësisë, ai ka një ndikim rimëkëmbës në një shoqëri të plagosur nga lufta e cila po përpiqet të kuptojë dhe pajtohet me të shkuarën e saj. Ky efekt rimëkëmbës mund të jetë sidomos i fuqishëm kur vjen nga politikanë të lartë apo udhëheqës politikë dhe mund ta drejtojë vendin drejt pajtimit. Nga ana tjetër, dënimet e vendosura pas vetëdeklarimit të fajësisë mund të shihen nga viktimat e mbetura gjallë si të pamjaftueshme.

VII. Shtojca 5: Afatet e fazës paragjyqësore

FAZA 1	***Koha***
Mbërritja e të pandehurit	***Dita 0***
Caktimi i lëndës njërës prej Dhomave Gjyqësore nga Presidenti *(Rregulla 62(A))*	*Zakonisht në mbërritje + 1 ditë*
Nxjerrja e urdhrave nga Kryetari i Dhomës Gjyqësore për paraqitjen e parë (caktimi i gjyqtarit për paraqitjen e parë *(Rregulla 62(A))*, caktimin e datës së paraqitjes së parë *(Rregulla 62(A))* regjistrimin audio-vizual dhe fotografimin *(Rregulla 81(D))* paraburgimin *(Rregulla 64)*	*Zakonisht në mbërritje + 1-2 ditë*
Caktimi i "avokatit mbrojtës kujdestar për të pandehurin" *(Rregulla 45(C))*	*Zakonisht në mbërritje + 1-2 ditë*
Paraqitja e parë e të pandehurit *(Rregulla 62)*	*Zakonisht në mbërritje + 1-3 ditë*
Caktimi nga Kryetari i Dhomës Gjyqësor i Gjyqtarit Paragjyqësor *(Rregulla 65ter(A))*	*Paraqitja e parë + brenda 7 ditësh*
Caktimi i avokatit mbrojtës definitiv për të pandehurin (*Rregulla 62(B) dhe Rregulla 45)*	*Paraqitja e parë + brenda 30 ditësh*
Deklarimi vetjak lidhur me fajësinë (nëse nuk është bërë në paraqitjen e parë)	*Paraqitja e parë + brenda 30 ditësh*
Vendosja në dispozicion të të pandehurit e materialit mbështetës që shoqëron aktakuzën dhe e deklaratave të mëparshme që ka marrë Prokuroria nga i pandehuri sipas Rregullës 66(A)(i) *(Rregulla 66(A)(i))*	*Paraqitja e parë + brenda 30 ditësh*
Nëpunësi i lartë juridik zhvillon një mbledhje (Rregulla 65*ter*) me palët për zbatimin e planit të punës të Gjyqtarit Paragjyqësor (*Rregulla 65ter(D)(iii))*	*Zakonisht pas dhënies së materialit sipas Rregullës 66(A)(i) dhe përpara mocioneve paraprake të Mbrojtjes, dhe, pas kësaj, kur të jetë nevoja (Nuk ka ndonjë afat kohor të përcaktuar në Rregullore për zhvillimin e kësaj mbledhjeje, megjithëse zakonisht zhvillohet një muaj pas dhënies së materialit mbështetës të aktakuzës të pandehurit). Në disa raste, (për shembull, kur nuk u dilet përpara gjërave) kjo mbledhje mund të zhvillohet pak kohë përpara konferencës së parë për statusin e cila mund të mbahet edhe 120 ditë pas paraqitjes së parë)*
Depozitimi i mocioneve paraprake të Mbrojtjes *(Rregulla 72(A).)*	*Dhënia e materialeve sipas Rregullës 66(A)(i) + brenda 30 ditësh*

FAZA 2	***Koha***
Vendimi për mocionet paraprake të Mbrojtjes *(Rregulla 72(A))*	*Depozitimi i mocioneve paraprake të Mbrojtjes + 60 ditë*
Konferenca e parë për statusin	*Paraqitja e parë + brenda 120 ditësh*
Vënia në dispozicion të të pandehurit e kopjeve të deklaratave të dëshmitarëve të Prokurorisë sipas Rregullës 66(A)(ii) (Rregulla 65bis(A))	*Sipas afatit të vendosur nga Gjyqtari Paragjyqësor (Ky material, logjikisht, duhet të vihet në dispozicion përpara momentit të depozitimit të dosjes paragjyqësore të Prokurorisë sipas Rregullës 65ter(E).)*
Vënia në dispozicion e materialeve shfajësuese dhe materialeve të tjera sipas Rregullës 68 *(Rregulla 68)*	*Detyrim i vazhdueshëm*
Mbledhjet e mëpasshme sipas Rregullës 65*ter Pas mbledhjes së parë sipas Rregullës 65ter, këto zhvillohen zakonisht menjëherë përpara konferencave për statusin (dhe në përgatitje të tyre)*	*Në varësi të prioritetit të lëndës*
Konferencat e mëpasshme për statusin *(Rregulla 65bis(A))*	*Konferenca e parë për statusin + brenda 120 ditësh*
Vendimet për mocionet e tjera *(Rregulla 73)*	*Sipas afatit të vendosur nga Gjyqtari Paragjyqësor (vendimet që mund të prekin ndjeshëm rrjedhën e procesit gjyqësor zakonisht lihen në pritje të formimit të trupit gjykues, sidomos kur Gjyqtari Paragjyqësor nuk është Kryetari i Trupit Gjykues)*

FAZA 3	***Koha***
Urdhri i caktimit të datës për depozitimit e dosjeve paragjyqësore dhe për Konferencën Paragjyqësore (Rregulla 65*ter*(E))	*Zakonisht urdhri jepet kur lëndës i vendoset prioritet të jetë "e gatshme për gjykimi"*
Dosja paragjyqësore e Prokurorisë (*Rregulla 65ter(E))*	*Jo më pak se 6 javë përpara Konferencës Paragjyqësore*
Dosja paragjyqësore e Mbrojtjes (Rregulla 65ter(F))	*Jo më pak se 3 javë përpara Konferencës Paragjyqësore*
Konferenca paragjyqësore *(Rregulla 73bis)*	*Përpara fillimit të gjykimit (zakonisht brenda 1 jave nga fillimit i gjykimit)*
Fillimi i gjykimit (Fillimi i gjykimit konsiderohet se është koha e deklaratave hapëse përpara paraqitjes së dëshmive nga prokurori)	*Zakonisht jo më pak se një vit pas mbërritjes së të pandehurit, megjithëse edhe brenda 8 muajve*

VII. Shtojca 6: Shembull praktik: parashikimi i kohëzgjatjes së gjykimit gjatë fazës paragjyqësore

- *Mbase vlerësimi më praktik dhe i rëndësishëm i Dhomës gjatë fazës paragjyqësore përfshin një parashikim lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit. Në kuadër të planifikimit të përgjithshëm administrativ gjyqësor, ka shumë rëndësi të bëhet një çmuarje sa më realiste. Nëse çmuarjet llogariten jo mirë apo nëse janë të pasakta, parashikimet mund të sjellin vështirësi të mëdha në vendosjen e prioriteteve mes gjyqeve dhe caktimin e dhomave gjyqësore.*
- *Sigurisht, pikënisja për çdo parashikim të kohëzgjatjes së gjykimit, është çmuarja e propozuar e Prokurorisë lidhur me kohën e nevojshme për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të saj në sallë, sipas listës së depozituar prej saj në bazë të rregullës 65ter.*
- *Nga kjo çmuarje kohore, mund të llogaritet një çmuarje bazë lidhur me kohëzgjatjen e të gjithë gjykimit, duke marrë në konsideratë faktorë të tillë si numri i të pandehurve në gjykim, kompleksiteti i perceptuar i gjykimit (që mund të bazohet në një sërë faktesh dhe vendngjarjesh të krimeve në aktakuzë, si edhe në mënyrën e përgjegjësisë) dhe nëse ka apo jo fakte të gjykuara më parë të cilat mund t'i pranojë Dhoma. Ushtrimi i mëposhtëm ilustron vetëm disa prej faktorëve të shumtë. Për këtë ushtrim, kemi përdorur një çmuarje kohore prej 200 orëve gjyqësore, të cilat i duhen Prokurorisë për të bërë marrjen në pyetje të dëshmitarëve të saj në sallë.*
- *Llogaritja e kohëzgjatjes së gjykimit mbështetet në çmuarjen hipotetike prej 200 orësh gjyqësore për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të Prokurorisë, në një lëndë gjyqësore me një të pandehur të vetëm. Për ta filluar përllogaritjen, duhen bërë disa çmuarje që janë specifike për lëndën. Patjetër që këto supozime janë gjithmonë objekt debati.*

  Supozimet:

  - *<u>Ka 17,5 orë gjyqësore efektive në javë</u> (domethënë, 3,5 orë në ditë për pesë ditë në javë). Për këtë shembull, supozohet se Kryetari i trupit gjykues nuk ua lejon palëve të përdorin shumë kohë gjyqësore për çështje administrative. Orë gjyqësore "efektive" janë orët në të cilat zhvillohet marrja në pyetje në sallë e dëshmitarëve. Shifra prej 3,5 orësh gjyqësore efektive bazohet në sistemin tipik të TPNJ-së me një seancë gjyqësore në ditë, që zgjat nga ora 09:00 deri në orën 13:45 ose nga ora 14:15 deri në orën 19:00.*
  - *<u>Ka 41 javë gjyqësore efektive në vit.</u> Kjo çmuarje merr në konsideratë dy pushime trijavëshe (në verë dhe në dimër), plus dy javë pushim shtesë të cilat i vendos vetë secila dhomë. Shumë rrethana mund ta zvogëlojnë këtë shifër, siç është një i pandehur me sëmundje kronike, sëmurja e paparashikueshme e gjyqtarëve apo e avokatëve të mbrojtjes apo dëshmitarët që nuk mund të paraqiten më datën e caktuar.*
  - *<u>Disa mocione të Prokurorisë aprovohen.</u> Prokuroria vazhdimisht supozon se çmuarja që i bën kohës së nevojshme për marrjen në pyetje nga ana e saj e dëshmitarëve të propozuar mbështetet te fakti se Dhoma do t'ia aprovojë të gjitha mocionet që ka depozituar në lidhje me përdorimin e deklaratave me shkrim në vend të dëshmisë së marrë në sallë. Përfshirja apo jo e këtij supozimi në llogaritjen që i bën Dhoma kohëzgjatjes së parashikuar të gjykimit, varet nga një vlerësim në vija të përgjithshme i themelit të mocioneve.*
  - *<u>Mbrojtjes do t'i duhet një përqindje e caktuar e kohës që kërkon Prokuroria për marrjen në pyetje nga ana e saj të dëshmitarëve të Prokurorisë</u>. Edhe pse disa dhoma gjyqësore supozojnë automatikisht se raporti kohor për marrjen në pyetje të dëshmitarëve nga Prokuroria dhe për kundërpyetjet e Mbrojtjes është 1:1, praktika ka treguar se Mbrojtjes në një gjykim me një të pandehur nuk i duhet më shumë se 60% e kohës së përdorur*

nga Prokuroria, për t'u bërë kundërpyetje dëshmitarëve të Prokurorisë. Më vonë, kur Dhomat po i përdornin më gjerësisht faktet e gjykuara më parë dhe deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve në bazë të rregullës 92ter, kjo përqindje është rritur deri në 150% e shifrës së çmuar nga Prokuroria për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të saj në sallë. Në një gjykim me disa të pandehur, avokatët e mbrojtjes mund të kërkojnë gjithsej 125%-150% të kohës që i duhet Prokurorisë, për kundërpyetjet. Sasia e kohës së nevojshme varet nga mënyra se si bashkohen dhe organizohen pistat mbrojtëse të të pandehurve në bazë të një teorie të caktuar mbrojtjeje.

- *Rimarrja në pyetje dhe marrja në pyetje nga Dhoma Gjyqësore është rreth 20% e numrit gjithsej të orëve të pyetjeve kryesore. Është gjithmonë në dorë të një dhome gjyqësore të lejojë rimarrjen në pyetje nga Prokuroria dhe avokatët e mbrojtjes dhe t'i bëjë pyetje dëshmitarit vetë. Kjo shifër nuk parashikohet dot me lehtësi dhe, ndonjëherë matet më mirë nisur nga fakti nëse shumica e Dhomës pranon metodikën e sistemit anglosakson në të cilën palët lejohen të kenë kontroll mbi drejtimin e dëshmive, apo metodikën e sistemit kontinental evropian ku lejohet një ndërhyrje më e madhe e gjyqësorit në marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Sidoqoftë, 20% është një shifër mjaft e besueshme për çdo lloj përbërje të dhomave.*
- *Mbrojtjes do t'i duhet vetëm rreth 60% e kohës gjithsej që i duhet Prokurorisë për paraqitjen e pistës së saj. Kjo shifër vlen për lëndët me një të pandehur. Mirëpo, ky është supozimi më pak i parashikueshëm, duke qenë se Mbrojtjes nuk i kërkohet ta japë listën e dëshmitarëve të saj përpara mbylljes së argumenteve të Prokurorisë. Ekziston mundësia, dhe madje ka ndodhur që Mbrojtja të mos mbrohet fare pas paraqitjes së dëshmive të Prokurorisë, pa thirrur asnjë dëshmitar. Në një gjykim me disa të pandehur, supozimi më i sigurt është që pistat e Mbrojtjes do të duan të paktën një sasi 1 me 1 me atë të përdorur nga Prokuroria. Disa mund të thonë se një proces i drejtë gjyqësor kërkon që Mbrojtjes t'i caktohet një sasi e barabartë kohe për kundërpyetjet me kohën që përdor Prokuroria për pyetjet e veta dhe po kështu që koha që përdor Mbrojtja për dëshmitarët e vet të jetë e barabartë me atë që ka përdorur Prokuroria për dëshmitarët e saj. Mirëpo, praktika ka treguar se koha e nevojshme për pjesën e Prokurorisë është më e madhe për shkak të barrës së provës që i takon të mbajë për çdo element të çdo pike të aktakuzës.*
- *Prokurorisë do t'i duhet 100% e kohës së Mbrojtjes për kundërpyetjet për çdo dëshmitar të Mbrojtjes. Për një mori arsyesh (të lidhura me rregullat mbi materialet që ia bën të ditur Mbrojtja Prokurorisë, si edhe mbi barrën e provës të Prokurorisë) Prokuroria zakonisht do më shumë kohë për t'u bërë kundërpyetje dëshmitarëve të Mbrojtjes në krahasim me kohën që i duhet Mbrojtjes për t'u bërë kundërpyetje dëshmitarëve të Prokurorisë. Idealja është që Prokurorisë t'i duhet vetëm një e dyta deri një e treta, në përgjithësi, e kohës që ka përdorur Mbrojtja për marrjen në pyetje dëshmitarët e saj. Megjithatë, një raport 1 me 1 është më i miri për qëllim planifikimi.*
- *Dhoma Gjyqësore nuk do të thërrasë asnjë dëshmitar dhe Prokuroria nuk do të bëjë asnjë prapësim. Zakonisht, koha e harxhuar për dëshmitarë të tillë (nëse konsiderohen të nevojshëm) është e papërfillshme në planifikimin e përgjithshëm të kohëzgjatjes së çmuar të një gjykimi. Nëse del nevoja, ata futen në kalendar sipas nevojës.*
- *Koha për gjykimin e argumenteve të Prokurorisë sipas një mocioni për deklarim të pafajshëm të depozituar nga Mbrojtja në mbyllje të pjesës së Prokurorisë nuk kërkon më shumë se dy javë dhe koha nga mbyllja e dëgjimit të dëshmive deri në nxjerrjen e Aktgjykimit nuk është më shumë se 3 muaj. Përvoja ka treguar se, me zhvillimin në kohë të Rregullores së Procedurës dhe Provave dhe sistemeve elektronike të menaxhimit të lëndëve gjyqësore nga TPNJ-ja, këto afate janë të mundshme madje më shumë se të mundshme. Mirëpo, nxjerrja e aktgjykimit merr gjithmonë shtyrje afati për shkak të debateve që kërkon arritja e një vendimi të drejtë.*

Përllogaritjet:

- *Pjesa e Prokurorisë:*
  - *200 orë për marrjen në pyetje të dëshmitarëve*
  - *120 orë për kundërpyetjet (200 x 60% = 120)*
  - *40 orë për rimarrje në pyetje dhe për pyetje nga gjyqtarët (200 x 20% = 40)*
- *Pjesa e Mbrojtjes:*
  - *120 orë për marrjen në pyetje të dëshmitarëve (200 x 60% = 120)*
  - *120 orë për kundërpyetjet (120 x 100% = 120)*
  - *24 orë për rimarrje në pyetje dhe për pyetje nga gjyqtarët (120 x 20% = 24)*
- *Orë gjyqësore gjithsej: 624*
- *Kohë gjyqësore gjithsej, në javë: 35,66 (624 orë gjyqësore pjesëtuar me 17,5 orë gjyqësore në javë)*
- *Kohë gjyqësore gjithsej, në vjet kalendarik/muaj: 10,5 muaj (35,66 javë gjyqësore gjithsej pjesëtuar me 41 javë gjyqësore efektive në vit barabartë me rreth 0,87 vjet, apo rreth 10,5 muaj).*
- *Duhet shtuar kohë shtesë për zgjidhjen e mocionit për shpallje të pafajësisë dhe për hartimin e aktgjykimit. Duke supozuar që duhen dy javë për zgjidhjen e një mocioni të tillë dhe se duhen 2-3 muaj për diskutimet mes gjyqtarëve dhe hartimin e aktgjykimit, gjykimi çmohet se duhet të marrë 13-14 muaj prej deklaratave hapëse gjer në nxjerrjen e aktgjykimit.*

Faktorët shtesë:

- *Ka shumë faktorë që mund të prekin çmuarjen e përgjithshme që kohëzgjatjes së një gjykimi, në fazën paragjyqësore. Më lart, kemi përmendur numrin e të pandehurve dhe kompleksitetin e lëndës. Krahas këtyre, nëse i pandehuri përfaqësohet nga një avokat mbrojtës apo nëse mbrohet vetë është një faktor që mund të ndikojë në kohëzgjatjen e gjykimit, duke qenë se edhe ata të pandehur që janë shkolluar në fushën juridike zakonisht duan më shumë kohë për të mbrojtur veten. Faktorët që mund ta zvogëlojnë kohëzgjatjen e gjykimit zakonisht përfshijnë zvogëlimin e kohës që i lejohet Prokurorisë për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të saj, duke qenë se kjo është pikënisja për të gjitha parashikimet. Sigurisht, zvogëlimi duhet bërë në fazën paragjyqësore dhe mund të përfshijë çdonjërën prej pikave të mëposhtme:*
  - *Dhoma mund t'i kërkojë Prokurorisë të ulë numrin e orëve që duhen për marrjen në pyetje prej saj të dëshmitarëve të saj thjesht përmes rishikimit të listës së dëshmitarëve të saj dhe përmes përpjekjes për të eliminuar paraqitjen e provave në mënyrë të përsëritur.*
  - *Dhoma mund t'i nxisë palët të bien dakord për disa fakte të caktuara, për të cilat nuk ka mosmarrëveshje. Zakonisht, kjo përfshin ato që quhen prova për "bazën e krimit" apo provat që konstatojnë faktin se ka ndodhur një vepër e caktuar penale, në dallim nga fakti se kush është përgjegjës për veprën.*
  - *Dhoma mund të marrë njoftim gjyqësor të fakteve të gjykuara më parë. Natyrisht, kjo është e mundshme vetëm pasi një gjykatë ka njëfarë kohe që funksionon, pasi të ketë konstatuar disa fakte përmes vendimit të bërë nga Dhoma e Apelit.*
  - *Dhoma mund t'i kërkojë Prokurorisë të zvogëlojë aktakuzën apo madje edhe mund të japë urdhër për zvogëlimin e aktakuzës sipas rregullës 73bis(D) ose (E).*
- *Sa i takon mënyrës së parë të zvogëlimit (kërkesa që Prokuroria të eliminojë nga lista dëshmitë e përsëritura) zakonisht Dhoma e bën këtë pasi informohet mirë me argumentet e Prokurorisë duke analizuar listën e saj sipas*

rregullës 65ter, në të cilën zakonisht përfshihen: emri i çdo dëshmitari që propozohet të thirret për të dëshmuar; me cilën pikë apo vendngjarje krimi në aktakuzë lidhet dëshmia; llojin e dëshmisë që propozohet të japë dëshmitari; dhe sasia e kohës që çmohet se duhet për dhënien e një dëshmie të tillë. Mënyra më e mirë për kryerjen e kësaj analize është kategorizimi i numrit të orëve të propozuara sipas:

- *<u>Dëshmitarëve gjithsej sipas dëshmisë që pritet të jepet.</u> Lloji i dëshmisë zakonisht është një prej disa kategorive të ndryshme: dëshmi drejtpërdrejt në sallë; dëshmi drejtpërdrejt sipas rregullës 92ter; dëshmi drejtpërdrejt sipas Rregullës 94bis; Rregullës 92bis; Rregullës 92quater.*
- *<u>Dëshmitarëve gjithsej sipas kategorive.</u> Për shembull, dëshmitarë lidhës, dëshmitarë për bazën e krimit, dëshmitarë ndërkombëtarë, dëshmitarë ekspertë, dëshmitarë të tjerë (për shembull, teknikë përgjimi dhe hetues të Prokurorisë, analistë të shërbimeve sekrete ushtarake dhe asistentë teknikë).*
- *<u>Dëshmitarëve gjithsej sipas pjesëve përbërëse të lëndës</u>: Kjo u përket vendngjarjeve të ndryshme të krimit në një aktakuzë.*

VIII.Administrimi i gjykimit

A. Shmangia e vonesave – mbajtja e orarit.....82
B. Paraqitja e provave.....83
B.1 Përdorimi i deklaratave me shkrim.....84
B.2 Të burgosurit, si dëshmitarë.....86
C. Përgatitja e dëshmitarit.....88
D. Përdorimi i urdhërparaqitjeve.....89
D.1 Urdhërparaqitjet për dëshmimin me detyrim sipas Rregullës 54.....89
E. Dëshmia e dëshmitarëve të Dhomës sipas Rregullës 98...91
F. Provat që dalin pas mbylljes së paraqitjes së lëndës nga prokuroria.....91
G. Kërkesa për dhënie të pafajësisë.....92
H. Materialet konfidenciale të Shteteve dhe organizatave të tjera.....94
I. Vetëpërfaqësimi.....95
J. Mungesa e të akuzuarit.....99
K. Instrumentet e administrimit të lëndëve.....101
K.1 E-court – Sistemet Elektronike të Administrimit të Dokumenteve.....101
K.2 "E-court" – sistemi i administrimit të procesverbalit gjyqësor.....103
L. Lëndët me disa të akuzuar.....104
L.1 Shqyrtimi i kujdesshëm i aktakuzës.....105
L.2 Trajtimi i deklaratave të personave të dyshuar.....105
L.3 Paraqitja e provave dhe dëshmive nga Mbrojtja.....106
L.4 Marrja në pyetje e dëshmitarit.....106
M. Vizitat në terren dhe seancat jashtë selisë së Tribunalit 107
M.1 Vizitat në terren.....107
M.1.1 Hapat që duhen marrë përpara vizitës.....108
M.1.2 Pjesëmarrësit.....109
M.1.3 Organizimi gjatë vizitës.....109
M.1.4 Raportimi pas vizitës, në selinë e Tribunalit.....109
M.2 Seancat jashtë selisë së Tribunalit.....109
M.2.1 Kontakti i parë me gjykatën e huaj.....110
M.2.2 Mbledhja e aktorëve të Sekretarisë.....110
M.2.3 Mbledhja përpara nisjes.....110
M.2.4 Telekonferenca e përbashkët ndërmjet Sekretarisë dhe gjykatës së huaj.....111
M.2.5 Shkëmbimi i letrave dhe përgatitjet përfundimtare 111
M.2.6 Hapat përpara nisjes.....111
VIII. Shtojca 7: Rekomandimet e SVD-së për përgatitjen e dëshmitarëve.....112
VIII. Shtojca 8: Shënim shpjegues për dëshmitarët për urdhërparaqitjet.....113
VIII. Shtojca 9: Formulari për regjistrimin e heqjes dorë nga të drejtat.....114

1. Në TPNJ, gjykimet janë në kontrollin e trupave gjykuese, gjyqtarët e të cilave kanë ndjekur bashkërisht një qasje, e cila përshkruhet si "gjykim me administrim". Në kuadër të kësaj qasjeje, gjyqtarët i rregullojnë veprimtaritë e palëve, duke përdorur atë që në thelb është një procedurë me palë kundërshtare si ai anglosakson. Gjykimet në TPNJ zhvillohen sipas grafikëve kohorë shumë precizë, dhe ndjekja penale mbahet në kontroll përpara Dhomave Gjyqësore në mënyrë më të rreptë nga sa ndodh zakonisht në gjykatat e brendshme të një vendi. Kontrolli gjyqësor mbulon objektin e aktakuzës, numrin e dëshmitarëve që mund të marrë në pyetje njëra palë dhe kohën e saktë që caktohet për marrjen në pyetje dhe kundërpyetjet për secilin dëshmitar.

2. Megjithatë, krimet që e përligjin ndjekjen penale në një forum ndërkombëtar, për nga përkufizimi janë të gjera, si sa i takon kohës, ashtu edhe sa i takon vendit. Shumica syresh përfshijnë:
   - sulme të gjera kundër popullsisë civile, në të cilat janë prekur me mijëra persona të pafajshëm;
   - të akuzuar, të cilët zakonisht kanë pasur poste të larta komanduese ose drejtuese;
   - prova të cilat shpesh përbëhen nga shumë prova rrethanore. Paraqitja e kësaj tërësie provash, për të provuar apo kundërshtuar akuzat që përmbajnë aktakuzat e TPNJ-së, përbën një sipërmarrje të konsiderueshme nga ana e palëve. Dëgjimi i provave me hollësi të mjaftueshme, çka i jep mundësi Dhomës Gjyqësore të vendosë pa asnjë dyshim për fajësinë e të akuzuarit, dhe me të gjitha masat e nevojshme mbrojtëse procedurale, përbën një sfidë madhore për Tribunalin.

A. Shmangia e vonesave – mbajtja e orarit

3. Duke pasur parasysh periudhat kohore që mbulojnë akuzat e ngritura nga TPNJ-ja dhe gamën e gjerë të krimeve nën gjykim, aktakuzat, sipas standardeve të brendshme, janë shumë të mëdha në objektin e tyre kohor dhe lëndor. Për shkak të kësaj, ka dalë nevoja të gjenden mënyra për t'i mbajtur afatet në kontroll. Një instrument që ka përdorur TPNJ-ja, ka qenë vendosja e kufijve kohorë për paraqitjen e provave. Këto afate, qysh në fillim të gjykimit, përcaktojnë numrin maksimal të orëve të cilat mund t'i përdorin palët për të paraqitur provat e tyre. Koha e ka treguar se afatet kohore janë një instrument sidomos i rëndësishëm për administrimin e grafikut kohor në lëndët gjyqësore me gjashtë a më shumë të akuzuar.[98] Në lëndën "Prokurori kundër Milutinović-it dhe të tjerëve" Prokuroria në fillim çmonte se do t'i duheshin 280 orë për paraqitjen e pjesës së saj të lëndës.[99] Pasi prokuroria përdori përafërsisht 40 orë, Dhoma mori një vendim, përmes të cilit e kufizoi paraqitjen e mbetur në 220 orë gjithsej.[100] Më pas, gjatë Konferencës përpara fillimit të paraqitjes së Mbrojtjes, Dhoma Gjyqësore vendosi t'i japë Mbrojtjes jo më shumë se 240 orë, për këtë paraqitje.[101]

4. Duke pasur parasysh materialet voluminoze të paraqitura, periudhën gjatë së cilës qenë kryer krimet e përfshira në aktakuzë dhe problemet e vetvetishme të administrimit të lëndës, të cilat lindin gjatë ballafaqimeve gjyqësore në çështjet penale ndërkombëtare, sidomos në lëndën me disa të akuzuar, paraqitja e provave mund të vazhdonte në pafundësi. Për rrjedhojë, vendosja e kufijve kohorë globalë, shihet si një masë e nevojshme dhe e dobishme. Sipas praktikës së përgjithshme të Tribunalit, vendosen afate kohore globale gjatë fazës përpara fillimit të gjykimit të një lënde, por pasi palët kanë depozituar listat e dëshmitarëve dhe provave që synojnë të përdorin, të cilat në përgjithësi kërkohet të paraqiten në përputhje me rregullën 65 ter (E) për prokurorinë dhe në përputhje me rregullën 65 ter (G) për mbrojtjen. Sa i takon pjesës së Prokurorisë, vendosja e afateve kohore mund të bëhet gjatë fazës paragjyqësore, por në përgjithësi ndodh vetëm pasi lënda t'i jetë caktuar një Dhome Gjyqësore për fazën e gjykimit. Për Mbrojtjen, vendosja e afateve kohore ndodh pas mbylljes së paraqitjes së provave nga Prokuroria, pra gjatë fazës së gjykimit.

98 Për shembull, kufij globalë të numrit të orëve janë vendosur në lëndët "Prokurori kundër Prlić-it dhe të tjerëve" dhe "Prokurori kundër Milutinović-it dhe të tjerëve".

99 Shih *Prokurori kundër Milutinović-it, Šainovic-it, Ojdanić-it, Pavković-it, Lazarević-it dhe Lukić-it*, Lënda Nr. IT-05-87-T ("*Milutinović dhe të tjerë*"), Vendim për përdorimin e kohës, 9 tetor 2006; Milutinović dhe të tjerë, Lënda Nr. IT-05-87-PT, T. 253 (17 maj 2006); shih edhe parashtrimet e Prokurorisë sipas rregullës 65*ter*(E), 10 maj 2006.

100 *Milutinović dhe të tjerë*, Vendim për përdorimin e kohës, 9 tetor 2006.

101 Shih *Milutinović dhe të tjerë*, Konferenca përpara fillimit të parashtrimit të lëndës së Mbrojtjes, T. 12847 urdhër gojor sipas rregullës 73*ter* (22 qershor 2007).

5. Duke kërkuar një nivel të mjaftueshëm hollësie në materialet e depozituara nga palët, Dhomat kanë qenë në gjendje të vlerësojnë gjerësisht kohëzgjatjen e nevojshme për dëgjimin e dëshmive të lëndës. Përmes vendosjes së afateve, Dhomat arrijnë një sërë avantazhesh: i nxisin palët të organizohen në nivel të lartë përpara fillimit të gjykimit; vendosin më shumë rregull në paraqitjen e provave dhe dëshmive, për shembull duke i nxitur palët t'i paraqesin provat dhe dëshmitë me shkrim përmes deklaratave të bëra sipas Rregullës 92*bis* dhe 92*ter* dhe të përzgjedhin për dëshmi në sallë provat dhe dëshmitë më të rëndësishme dhe të vlefshme

Lënda Popović dhe të tjerët – Paraqitja e provave dhe afatet kohore

Në lëndën "Prokurori kundër Popović-it dhe të tjerëve", paraqitja e provave dhe dëshmive nga Prokuroria filloi më 24 gusht 2006 dhe përfundoi më 7 shkurt 2008. Vendimi për mocionin e Mbrojtjes për dhënie të pafajësisë u dha në mënyrë verbale më 3 mars 2008. Paraqitja e Mbrojtjes filloi më 2 qershor 2008.*

Në urdhrin e saj "Në lidhje me udhëzimet për paraqitjen e provave dhe dëshmive dhe për sjelljen e palëve gjatë gjykimit", datë 14 korrik 2006 ("Urdhri i korriku 2006"), Dhoma Gjyqësore vendosi të mos caktojë një afat kohor për kundërpyetjet që Mbrojtja do t'u bënte dëshmitarëve të Prokurorisë.

Gjer atëherë Dhoma Gjyqësore e kishte konsideruar të nevojshme vendosjen e afateve kohore për pyetjet kryesore dhe kundërpyetjet vetëm në një rast.

Kur paraqitja e Prokurorisë po i afrohej fundit, Dhoma Gjyqësore e konsideroi të nevojshme vendosjen e një grafiku kohor për mbylljen e paraqitjes së dëshmive kryesore nga Prokuroria, për dëgjimin e parashtrimeve me kohë dhe për fillimin e paraqitjes së Mbrojtjes. Pas këtij vendimi, Dhoma Gjyqësore vazhdimisht veproi për të nxitur respektimin e kalendarit të vendosur.

*Edhe pse paraqitja e Prokurorisë përfundoi diçka më vonë nga sa pritej,** seanca e parashtrimeve verbale sipas rregullës 98 bis filloi më datën e parashikuar. Datat e vendosura për Konferencën përpara Mbrojtjes dhe për fillimin e paraqitjes së Mbrojtjes nuk ndryshojnë nëse nuk lindin rrethana përjashtuese të paparashikuara.*

*Dhoma Gjyqësore vendosi kohën maksimale për Mbrojtjen, që kjo t'i drejtohej Dhomës në lidhje me mocionin për dhënie pafajësie dhe për Prokurorinë, që kjo të përgjigjej. Këto kufizime për përdorimin e kohës janë zbatuar në mënyrë rigoroze. Më 14 dhe 15 shkurt 2008, secili prej të pandehurve, me përjashtim të Vujadin Popović-it, bëri parashtrime verbale përpara Dhomës për të kërkuar pafajësinë për disa ose për të gjitha pikat e aktakuzës, që ngriheshin kundër tyre. Më 15 dhe 18 shkurt 2008, Prokuroria iu përgjigj parashtrimeve të Mbrojtjes. Vendimi sipas rregullës 98bis u bë publik më 3 mars 2008.****

* Prokurori kundër Popović-it dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-05-88.
** Shih Urdhrin për ndryshimin e datë më të cilën Prokuroria duhet të mbyllë paraqitjen e dëshmive kryesore, 1 shkurt 2008.
*** Urdhër për caktim afati, 25 shkurt 2008, f. 1.

6. Në një rast studimor tregohen përparësitë praktike të përdorimit të afateve kohore, për administrimin e lëndëve përpara Tribunalit (shih kutinë *"Lënda Popović dhe të tjerët – Paraqitja e provave dhe afatet kohore"*)

B. Paraqitja e provave

7. Për nga natyra që kanë, gjyqet janë dinamike. Objekti shumë i gjerë kohor dhe lëndor i aktakuzave të TPNJ-së, mund të kërkojë materiale voluminoze dhe me qindra dëshmitarë, dhe gjyqtarët e TPNJ-së kanë përdorur mekanizma të ndryshme për bërjen të mundur të paraqitjes së provave. Në rubrikat në vijim jepen hollësi për disa prej praktikave që janë zhvilluar gjatë funksionimit të TPNJ-së, të cilat kanë kontribuar në një proces gjyqësor më efikas.

B.1 Përdorimi i deklaratave me shkrim

8. Një prej tipareve të dalluese të TPNJ-së është përzierja e traditës së të drejtës civile me atë anglosaksone. Në lëndët e gjykuara përpara TPNJ-së, përgjegjësinë parësore për paraqitjen e provave dhe të dëshmive e kanë përfaqësuesit e palëve. Përfaqësuesi i prokurorisë shfrytëzon dëshminë e dëshmitarëve, provat shkresore dhe paraqitjen e provave fizike, në përpjekje për të konstatuar provat përtej dyshimit të arsyeshëm. Mbrojtja mund të bëjë të njëjtën gjë, për të krijuar dyshimin e arsyeshëm, nëse vendosë të paraqesë prova.[102]

9. Gjatë viteve të para të funksionimit të TPNJ-së, Dhoma të ndryshme panë se dëgjimi në sallë i dëshmisë së dëshmitarëve hante shumë kohë dhe nuk ishte gjithmonë efikas.[103] Për rrjedhojë, në muajin dhjetor 2000, Gjyqtarët miratuan Rregullën 92*bis*, e cila parashikon pranueshmërinë e deklaratave me shkrim në vend të dëshmisë në sallë të dëshmitarëve, në disa rrethana të caktuara.[104]

10. Rregullorja parashikon dy metoda përmes të cilave një palë mund të zbatojë rregullën 92*bis*: (1) përmes një personi të autorizuar për të qenë i pranishëm si dëshmitar në një deklarim të tillë, në përputhje me dispozitat ligjore dhe procedurale të Shtetit; ose (2) përmes një nëpunësi të caktuar nga Sekretari i Tribunalit me qëllim të qenit i pranishëm si dëshmitar në një deklarim të tillë. Vendimin se cila metodë do të zbatohet e merr Dhoma. Pastaj, Sekretaria duhet ta informojë palën se është e rëndësishme që Shteti përkatës të ketë një sistem funksionues të noterisë dhe e nxit palën të përdorë kanalet diplomatike në Hagë për të siguruar një noter të autorizuar i cili të jetë i pranishëm gjatë procesit.

11. Në vitin 2001, ka dalë një Udhëzim Procedure për vënien në zbatim të rregullës 92*bis* (B), me qëllim parashikimin e procedurës për kryerjen e procesit të deklarimit. Procedura sipas rregullës 92*bis*, zbatohet në të njëjtën mënyrë si për Mbrojtjen ashtu edhe për Prokurorinë. Nëse është e nevojshme, një përkthyes i Sekretarisë mund t'i bëjë një përkthim me gojë dëshmitarit.

12. Përdorimi i dëshmive me shkrim mund të jetë një mënyrë më efikase për paraqitjen e llojeve të caktuara të provave dhe dëshmive, sidomos të provave që kanë të bëjnë me pjesën faktike të lëndës, provave që lidhen me vendndodhjen e krimeve ("prova me bazë krimin") dhe provave historike, sociologjike dhe statistikore. Pranimi i dëshmive me shkrim në vend të dëshmive me gojë, kur përdoren për të vërtetuar një çështje që nuk përfshin veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit, ua ka rritur mundësitë dhomave për të administruar lëndë gjyqësore shumë të mëdha, pa shkelur të drejtat për gjykim të drejtë, me kush që deklaruesi i deklaratës me shkrim të mund të thirret për t'i bërë kundërpyetje.[105] Mirëpo, përdorimi i deklaratave të tilla është

102 Në lëndën "Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve", Lënda Nr. IT-04-84, Mbrojtja nuk paraqiti asnjë dëshmi, provë a dëshmitar dhe u tërhoq menjëherë pas mbylljes së parashtrimit të lëndës nga Prokuroria. Dy nga tre të akuzuarit u shpallën të pafajshëm.

103 Për këto mungesa të efikasitetit flet Gjyqtari O-Gon Kwon, "Gjatë viteve që kam shërbyer në Tribunal, e kam kuptuar se sistemi me palë kundërshtare i traditës anglosaksone ka shumë pika të forta, por mbase dobësia më e madhe e tij është tendenca për të krijuar diskutime të stërzgjatura dhe shpesh pa lidhje me lëndën, ndërmjet palës që bën pyetjet dhe dëshmitarit [...] dhe [...] dëshmitarët shpesh nuk e njohin metodën me palë kundërshtare të marrjes në pyetje dhe të kundërpyetjeve." Judge O-Gon Kwon, *The Challenge of an International Criminal Trial as Seen from the Bench (Sfida e një Procesi Penal Ndërkombëtar, e Parë nga Trupi Gjykues)*, 5 Journal of International Criminal Justice (Buletini i Drejtësisë Penale ndërkombëtare) 360, 364 (2007).

104 Për një trajtim të plotë të temës së paraqitjes së dëshmive dhe provave, shih "The Challenge of an International Criminal Trial as Seen from the Bench", Gjykatësi O-Gon Kwon, shënimi 102 më lart, në faqen 360. Autori thotë më tej: "Rregulla 89(F) është pjesë e dispozitave hyrëse të rregullores së provave, dhe thotë se '[a] Një Dhomë mund të marrë dëshminë gojore prej dëshmitarit ose, kur e lejojnë interesat e drejtësisë, me shkrim.' Rregulla 92*bis* është një dispozitë shumë më e gjerë, sepse lejon që deklaratat me shkrim të dëshmitarëve të pranohen në vend të dëshmisë gojore, nëse nuk flasin për faktet dhe sjelljen e të akuzuarit." Nëse dëshmitari në fjalë ka vdekur ose nuk mund të gjendet edhe përkundër përpjekjeve serioze, çdo deklaratë e pranuar sipas Rregullës 92*bis* duhet të shoqërohet me një deklaratë, të dhënë nën betim nga dëshmitari përpara nëpunësit të Sekretarisë së Tribunalit, se përmbajtja e deklaratës është e vërtetë dhe e saktë. Sipas Rregullës 92*bis* (E), Dhoma Gjyqësore ruan të drejtën të vendosë për ta thirrur dëshmitarin për t'u marrë në pyetje nga pala tjetër, përkundër kësaj deklarate, nëse Dhoma e gjykon këtë gjë si të nevojshme dhe të përshtatshme". *Po aty*, në 364-65.

105 Kwon, shënimi 103 më lart, në 365.

ndërlikuar nga deklaratat e stërzgjatura, si edhe nga problemet që lidhen me statusin provues të dokumenteve të përmendura si burime të këtyre deklaratave (për shembull, deklarim në shënimin poshtë faqes se konkluzionet e nënshkruesit të deklaratës mbështeten në informacione të tjera). Një mangësi tjetër e mbështetjes në provat shkresore është se publiku mund ta ketë më të vështirë ndjekjen e punimeve. Megjithatë, kjo mangësi nuk është aq e madhe sa t'i hedhë poshtë përparësitë e fituara.

13. Në muajin shtator 2006, TPNJ e ndryshoi përsëri procedurën për provat, me shtimin e rregullave 92*ter* dhe 92*quater*. Rregulla 92*ter* kodifikon jurisprudencën sipas së cilës lejohet paraqitja e deklaratave me shkrim apo e procesverbaleve të dëshmisë në sallë të dëshmitarëve nëse dëshmitari është i pranishëm në gjykatë dhe i gatshëm për marrje në pyetje nga pala tjetër dhe nga gjyqtarët. Në shumicën e rasteve, këto rregulla mundësojnë paraqitjen në mënyrë më koncize të dëshmisë në sallë të dëshmitarëve. Ndryshe nga mekanizmi i parashikuar në rregullën 92*bis*, dëshmitarët që paraqesin dëshmi në sallë në këtë mënyrë, mund të japin informacion për veprat dhe sjelljen e të akuzuarit.[106] Ky instrument i provave është përdorur kryesisht nga Prokuroria, për të paraqitur dëshmitë e dëshmitarëve të saj në ato raste kur dëshmia në sallën e gjyqit do të kishte çuar në tejkalimin e kohës së lejuar.

14. Gjatë gjykimeve, rregulla 92*bis* dhe *ter* është zbatuar disi me elasticitetet, për të mos thënë me konfuzion. Për shembull, Dhoma mund ta pranojë një deklaratë pjesërisht duke lejuar, sipas Rregullës 92*ter*, që dëshmitari ta shtojë, shpesh madje edhe ta përditësojë me gojë informacionin. Pas kësaj dëshmie në sallë mund të vijë marrja në pyetje e dëshmitarit nga pala tjetër, për të gjithë dëshminë e tij ose për një pjesë të saj.[107]

15. Rregulla 92*quater* parashikon një mjet për paraqitjen e dëshmisë së një dëshmitari që ka vdekur ose që nuk mund të dëgjohet në sallë për shkak të pamundësisë mendore a fizike apo për shkak se është zhdukur. Ky rregull për provat, është një zhvillim i rëndësishëm duke qenë se ka mundësuar paraqitjen e atyre dëshmive të dëshmitarëve të cilat përndryshe nuk do të ishin pranuar. Mirëpo, ky proces ka shkaktuar shqetësime për shkak të ndërhyrjes në të drejtën e të akuzuarit që të gjykohet në prani të dëshmitarëve kundërshtarë dhe që t'u bëjë kundërpyetje atyre dhe që të arrijë praninë dhe marrjen në ekzaminim të dëshmitarëve në emër të të akuzuarit me të njëjtat kushte me dëshmitarët që paraqiten kundër të akuzuarit.[108] Tensioni i cili lind ndërmjet ruajtjes së dëshmisë së dëshmitarëve të vdekur apo të dëshmitarëve të cilët nuk mund të paraqiten për arsye të tjera dhe të drejtës së të akuzuarit për ta marrë në ekzaminim dhe për t'u përballur me dëshmitarët, është trajtuar nga jurisprudenca e TPNJ-së duke kërkuar që dëshmitë e paraqitura sipas rregullës 92*quater* të jenë të mbështetura.[109]

16. Një mënyrë përmes së cilës TPNJ-ja e ka bërë më shumë të mundur paraqitjen e provave shkresore, është përmes paraqitjes së dokumenteve nga tryeza e dokumenteve, pra drejtpërdrejt në sallën e gjyqit, pa dëgjuar dëshmi nga dëshmitarët për dokumentet. Kjo qasje u jep mundësi palëve të depozitojnë drejtpërdrejt kërkesa me shkrim, me të cilat të kërkojnë pranimin e dokumenteve, në vend të pranimit të të gjitha provave materiale përmes dëshmisë së dëshmitarit në sallë. Rregulla 89 parashtron këto kërkesa bazë, të cilat duhen përmbushur përpara se dokumentet të mund të pranohen në provat e gjykuara:

- të jenë të lidhura me lëndën;
- të kenë vlerë provuese; dhe

106 E drejta për të përfshirë informacion për veprat dhe sjelljen e të akuzuarit në deklaratat e dhëna sipas rregullës 92*ter* justifikohet nëse dëshmitarët mund të paraqiten në gjykatë për t'u marrë në pyetje në sallë nga pala tjetër, në lidhje me deklaratat e tyre.

107 Shih, për shembull, *Prokurori kundër Prlić-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74, T. 13398 - 13442 (1 shkurt 2007), T. 13932 - 13956 (12 shkurt 2007); *Prokurori kundër Milutinović-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87. T. 3823 - 2865 (25 shtator 2006), T. 4229 - 4282 (28 shtator 2006).

108 Neni 14, Statuti i TPNJ-së.

109 Shih, për shembull, *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84, Aktgjykim, para. 10.

- të jenë autentike.[110]

17. Në disa raste të caktuara, palët kanë kërkuar pranimin e një numri shumë të madh dokumentesh përmes Rregullës 89. Në rastin e mëposhtëm studimor, tregohet qasja e njërës Dhomë për trajtimin e mocioneve për pranimin e dokumenteve nga tryeza e dokumenteve në sallë dhe çështjet e ndryshme që lindin gjatë procedurës sipas Rregullës 89 (shih kutinë *"Lënda Milutinović dhe të tjerët* – Zbatimi i kritereve për pranimin e provave shkresore nga tryeza e dokumenteve në sallë")*.

B.2 Të burgosurit, si dëshmitarë

18. Personat në burgim ose paraburgim, mund të dëgjohen si dëshmitarë përpara TPNJ-së. Që të paraqiten, duhet një vendim i Dhomës për transferimin e përkohshëm të dëshmitarëve të burgosur. Për të siguruar paraqitjen si dëshmitar të një personi të dënuar dhe që është duke vuajtur dënimin në një Shtet tjetër, është nevoja për një bashkërendim të ngushtë ndërmjet Sekretarisë dhe Shtetit Pritës, duke qenë se dëshmitari do të duhet të shoqërohet në Njësinë e Paraburgimit të OKB-së. Për ta mundësuar

Lënda Milutinović dhe të tjerët – Zbatimi i kritereve për pranimin e provave shkresore nga tryeza e dokumenteve në sallë*

Dhoma Gjyqësore III e Tribunalit ka pasur gjithmonë kërkesa të shumta për pranimin e provave shkresore nga tryeza e dokumenteve në sallë. Dhoma e bëri të qartë qasjen e saj për pranimin e provave shkresore, që në një fazë të hershme të lëndës, duke thënë se "siç e ka pranuar edhe Dhoma e Apelit, provat janë të pranueshme vetëm nëse lidhen me lëndën dhe provat lidhen me lëndën vetëm nëse kanë vlerë provuese, karakteristikë kjo e cila parashikohet në rregullën 89(C)". Dhoma Gjyqësore është e mendimit se besueshmëria e deklaratës së bazuar në gjëra të dëgjuara nga të tretë është një parakusht i nevojshëm për vlerën provuese të parashikuar në rregullën 89(C). Pala ose palët kundërshtare mund ta kundërshtojnë pranimin e një prove të propozuar nga njëra prej palëve, për arsye të lidhura me aktualitetin ose me vlerën provuese të saj (përfshirë këtu edhe autenticitetin). Nëse për provën e propozuar nuk bëhet asnjë kundërshtim, atëherë ajo pranohet në provat gjyqësore. Nëse njëra palë e kundërshton autenticitetin e një pike të provës së propozuar, duhen dhënë arsyet për këtë. Pasi dëgjon kundërshtimin dhe parashtrimet e tjera të palëve, sipas nevojës, Dhoma vendosë për pranimin ose jo të provës. Pesha që i jepet një prove të pranuar përcaktohet nga Dhoma gjatë diskutimeve përfundimtare të saj, në kuadër të dosjes gjyqësore si e tërë.

Në lidhje me kërkesat për pranimin e dokumenteve nga tryeza e dokumenteve në sallë, Dhoma ka përcaktuar një proces të qartë, kur thotë se:

"Duke pasur parasysh thellësinë dhe gjerësinë e kësaj lënde, Dhoma Gjyqësore në përgjithësi i kupton palët, kur këto paraqesin dokumente të propozuara si prova gjyqësore. Mirëpo, nëse duhet vepruar kështu, atëherë pala që bën propozimin duhet të jetë në gjendje të demonstrojë në mënyrë të qartë dhe konkrete, se ku dhe si lidhet dokumenti në fjalë me lëndën... Sado të jetë numri i dokumenteve që kërkon pala të pranohen në provat gjyqësore, këto dokumenteve duhet të përmbushin kriteret e normave që rregullojnë pranimin e provave dhe dëshmive. Vendimi i mëposhtëm është marrë në përpjekje për të arritur një drejtpeshim të duhur ndërmjet sigurimit të një gjykimi të drejtë, nga njëra anë, dhe mosngarkimit të palëve me barrë të tepruar në lidhje me pranimin e provave, nga ana tjetër".

Në mënyrë që të mbahet nën kontroll numri i dokumenteve që ofrohen si prova shkresore dhe që të sigurohet që i respektojnë standardet e përgjithshme që kërkon pranimi i provave dhe dëshmive, Dhoma mori disa masa. Së pari, Dhoma kërkoi të dinte arsyet e hollësishme që do të mbështetin pranimin e secilit dokument. Së dyti, Dhoma vërejti se rezervonte të drejtën për të vendosur vetë për pranimin ose jo të provave dhe, për rrjedhojë, Dhoma mund ta kufizonte pranimin e provave nëse ky kufizim bëhej për një qëllim legjitim, pra për ekonominë gjyqësore, dhe nëse kufizimi nuk i shkelte të drejtat e palëve për gjykim të drejtë.

* Lënda Nr. IT-05-87-T. Vendim për mocionin e Prokurorisë për pranimin e provave shkresore, 10 tetor 2006, para. 18, 19.

110 Rregulla 89 i RrPP-së së TPNJ-së parashikon që: "(C) Një Dhomë mund të pranojë çfarëdo prove përkatëse të cilën e gjykon me vlerë provuese; (D) Një Dhomë mund të përjashtojë prova në qoftë se vlera e tyre provuese zhvlerësohet ndjeshëm prej nevojës për garantimin e një gjykimi të drejtë; (E) Një Dhomë mund të kërkojë verifikimin e autenticitetit të provave të marra jashtë gjykatës."

procesin, Sekretaria ka miratuar një politikë për t'i udhëzuar ata sektorë të Sekretarisë që janë të përfshirë në transferimin dhe paraqitjen e një të burgosuri dëshmitar. Në politikë përcaktohen përgjegjësitë ndërmjet sektorëve përkatës. Një i burgosur dëshmitar, mund të kërkojë përfaqësim ligjor dhe mund të ketë nevoja të veçanta psikologjike. Është i nevojshëm bashkëpunimi i ngushtë mes viktimave, personelit për mbështetjen e dëshmitarëve dhe Njësisë së Paraburgimit dhe duhet treguar kujdes i veçantë gjatë pauzave mes seancave për të siguruar mirëqenien e të burgosurit dëshmitar. Fakti që një i burgosur do të dëshmojë kundër një të akuzuari, ndërkohë që është duke vuajtur vetë dënimin, mund të krijojë shumë stres, në varësi të rrethanave vetjake të dëshmitarit. Këto vështirësi i ilustron rasti tragjik, kur një person i dënuar nga Tribunali, me emrin Milan Babić, u rikthye nga burgu në vendin ku po vuante dënimin në Njësinë e Paraburgimit të OKB-së, më 7 shkurt 2006 me qëllim që të dëshmonte në favor të Prokurorisë në një lëndë tjetër dhe vrau veten në qeli më 5 mars 2006. Vdekja ndodhi gjatë një fundjave, pasi personi kishte dëshmuar shtatë ditë dhe pritej që dëshmia e tij të vazhdonte të nesërmen. Presidenti i Tribunalit vendosi të bëhet një hetim i rrethanave të vdekjes dhe hetimi evidentoi disa rrethana që mund të kenë ndikuar në vendimin e zotit Babić për të vrarë veten. Në këto rrethana përfshihen vështirësi që lidhen me burgimin, gjendjen e tij familjare dhe procesin e zhvendosjes, si edhe vështirësi që lidhen me dëshminë e tij. Përkundër këtyre rrethanave, hetimi arriti në përfundimin se askush, madje as familja e tij, personeli i Njësisë së Paraburgimit të OKB-së, nëpunësit e mbrojtjes dhe rojat e sigurimit, e as avokati i tij, i cili kishte kaluar me orë të tëra me të gjatë seancave përgatitore si edhe gjatë seancave në sallë, nuk kishin vënë re asnjë shenjë se ai mund të vriste veten. Hetimi konstatoi se nuk kishte arsye për të arritur në përfundimin se bëhej fjalë për pakujdesi nga ana e personelit të Njësisë së Paraburgimit të OKB-së gjatë vlerësimit nëse ekzistonte apo jo risku i vetëvrasjes apo lëndimit të vetes. Por, relacioni hetimor bënte dy rekomandime: (1) në shënimet mjekësore të një personi të mbajtur në burgim në Njësinë e Paraburgimit të OKB-së të cilat duhen vlerësuar dhe trajtuar nga psikiatri i kësaj Njësie, duhet mbajtur shënim çdo mjekim që i burgosuri është duke marrë në momentin e mbërritjes në Njësinë e Paraburgimit të OKB-së, si edhe përdorimi në vazhdimësi i mjekimit nga personi i burgosur. Por, në relacion sqarohej se barnat nuk kishin lidhje me vdekjen e zotit Babić apo me trajtimin dhe mbikëqyrjen e tij; (2) në rastin e një të burgosuri të izoluar, gjendja e të burgosurit duhet marrë në shqyrtim çdo javë dhe një raport javor i duhet dërguar Sekretarit. Më në fund, në relacion thuhej se ngjarjet e këtij rasti theksojnë rëndësinë e masave organizative të marra për të burgosurit që vuajnë dënimin, sidomos në rastet kur është e nevojshme mbrojtja e familjes, si edhe masave organizative për zhvendosjen e familjeve. Sigurisht, zgjidhja e këtyre çështjeve varet nga vendimi i qeverive nëse mund të ofrojnë garanci afatgjata. Duhet treguar kujdes që këto vështirësi t'u shpjegohen plotësisht të burgosurve dhe familjeve të tyre, për të shmangur lindjen e shpresave jorealiste.

19. Masat organizative specifike, për një të burgosur dëshmitar përfshijnë:

- një kërkesë drejtuar Shtetit Zbatues ose autoriteteve të burgjeve, për të dhënë një kartelë mjekësore të personit të zhvendosur;
- dëshmitarit mund t'i jepet ndihmë ligjore e mbuluar nga buxheti i Tribunalit për ndihmë ligjore;
- një përpjekje për të siguruar që i burgosuri dëshmitar të marrë mbështetjen e nevojshme psikologjike dhe emocionale nga nëpunësit e mbështetjes, gjatë dhënies së dëshmisë.

C. Përgatitja e dëshmitarit

20. Praktika e përgatitjes së dëshmitarit ka ekzistuar prej fillimit të Tribunalit.[111] Nuk ekziston asnjë përkufizim për konceptin e "përgatitjes së dëshmitarit",[112] mirëpo, në përgjithësi, ky term përdoret për "takimin e zhvilluar ndërmjet një pale të procesit gjyqësor dhe një dëshmitari, zakonisht pak kohë përpara se dëshmitari të dalë për të dëshmuar përpara gjykatës, qëllimi i të cilit është të përgatitet dhe të njihet dëshmitari me procedurat e sallës së gjyqit dhe të shqyrtohet dëshmia e dëshmitarit".[113]

21. Në disa juridiksione, koncepti i përgatitjes së dëshmitarit përpara gjykimit konsiderohet si një kërkesë themelore bazë e praktikës së mirë të gjykimit[114] dhe nëse kjo nuk bëhet atëherë mund të ngrihen pretendime për ndihmë jo të efektshme nga ana e avokatit,[115] shkelje të praktikës ligjore apo paaftësi të avokatit.[116] Nga ana tjetër, në juridiksionet ku zbatohet e drejta civile, pra në të cilat për lëndën caktohet një gjyqtar hetues, avokatit dhe Prokurorisë nuk u lejohet të kenë kontakt me dëshmitarin përpara dëshmisë së tij në gjykatë.[117]

22. Në TPNJ, prokurorëve e avokatëve nuk u ndalohet t'i përgatisin dëshmitarët përpara paraqitjes në sallën e gjykimit.[118] Vonesat e panevojshme të shkaktuara nga mosgatishmëria e dëshmitarëve për t'u paraqitur apo nga ndryshimi i çështjeve për të cilat janë të gatshëm të dëshmojnë, mund të shmangen përmes zhvillimit të seancave përgatitore, në kohë të mjaftueshme përpara paraqitjes së dëshmitarit në gjykatë. Kur një dëshmitar ka dëshmuar në disa lëndë, mund të mos ketë nevojë për "familjarizim" të mëtejshëm, sidomos nëse dëshmitari do të dëshmojë për prova të ngjashme për bazën e krimit. Mirëpo, gjatë procesit të gjykimit mund të shkaktohen vonesa të konsiderueshme, nga ndryshimet në përmbajtje të deklaratës së një dëshmitari gjatë procesit të përgatitjes së tij. Palët e tjera mund të ankohen për shkak të mungesës së njoftimit në kohë, i cili është detyrim nëse ka pasur ndryshime. Kur dëshmitari e ndryshon deklaratën gjatë përgatitjes së tij dhe më pas tërhiqet si dëshmitar nga pala që dëshironte ta përdorte si dëshmitar, mund të lindin probleme në lidhje me detyrimin për ta bërë të ditur këtë ndryshim, në bazë të detyrimit që ka Prokuroria për bërjen të ditur të informacionit shfajësues sipas Rregullës 68. Megjithëse nuk ekziston detyrimi për t'i regjistruar me zë seancat e përgatitjes së dëshmitarëve, pala që zhvillon përgatitjen, mund t'ia përcjellë shënimet e seancës përgatitore palës tjetër, në përputhje me kërkesat e procesit të drejtë dhe të paanshëm. Shqetësimet në lidhje me mundësinë e instruktimit të dëshmitarit mund të zgjidhen përmes regjistrimit zanor të seancës përgatitore.

---

111 *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve,* Lënda Nr. IT-04-84-T "Vendim për kërkesën e Mbrojtjes për regjistrimin zanor të seancave përgatitëse të dëshmitarëve të Prokurorisë", 23 maj 2007; *Prokurori kundër Limajt dhe të tjerëve*, "Vendim për mocionin e Mbrojtjes për praktikën e Prokurorisë për përgatitjen e dëshmitarëve", 10 dhjetor 2004.

112 *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-5 "Vendim për kërkesën e Mbrojtjes për regjistrimin zanor të seancave përgatitëse të dëshmitarëve të Prokurorisë", 23 maj 2007, para. 8-9.

113 *Po aty*, në para. 8 (ku citohet *Prokurori kundër Milutinović-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87, "Vendim për mocionin e Ojdanić-it për të ndaluar përgatitjen e dëshmitarëve", 12 dhjetor 2006).

114 Shih "Mbretëresha kundër Momodou-t" [2005] Raportet Penale të Gjykatës së Apelit të Anglisë dhe Uellsit 177, para. 62.

115 Në përgjithësi, shih "*Defending Against Claim of Ineffective Assistance of Counsel" (Mbrojtja nga Pretendimi për Asistencë jo të Efektshme të Avokatit Mbrojtës)*, 82 American Jurisprudence Trials 1 (Gjykimet në Jurisprudencën Amerikane 1), Rubrika 46; *shih edhe procesin "Cotton k. Shtetet e Bashkuara të Amerikës"*, 2008 WL 410648 (Distrikti Verior i Misisipit, 12 shkurt 2008); *"Populli kundër Duy Le"*, 2008 W.L. 544383 (Gjykata e Apelit për Distriktin VI të Kalifornisë, 29 shkurt 2008); *"Carr k. Baynham"*, 2008 WL 1696881 (Distrikti Verior i Teksasit, 9 prill 2008).

116 *Shih, për shembull*, "*Lai k. Chamberlain"* [2005] Gjykata e Apelit e Zelandës së Re 37, para. 158 (ku ndalohet imuniteti i avokatit mbrojtës në legjislacionin e Zelandës së Re për çështjet civile. Imuniteti i avokatit mbrojtës është ndaluar edhe në lidhje me çështjet penale me Vendimin e Gjykatës së Lartë për apelimin e vendimit të Gjykatës së Apelit).

117 Shih juridiksionet e renditura në "*Prokurori kundër Thomas Dyilo Lubanga-s"* ICC-01/04-01/06-679, "Vendim për praktikat e njohjes së dëshmitarit dhe përgatitjes së dëshmitarit", para. 37.

118 *Prokurori kundër Thomas Dyilo Lubanga-s* ICC-01/04-01/06-679, "Vendim për praktikat e njohjes së dëshmitarit dhe përgatitjes së dëshmitarit", para. 24-26.

23. Gjithashtu, Sektori i Viktimave dhe Dëshmitarëve rekomandon që prokurorëve, avokatëve të mbrojtjes dhe personave të tjerë të përfshirë në përgatitjen e dëshmitarëve për dëshmim t'u jepet informacion i cili ndihmon në uljen e stresit mbi dëshmitarët të cilëve u kërkohet të rikujtojnë ngjarje tronditëse. Edhe pse nuk mund të shmangen plotësisht reagimet pas tronditjes, të shkaktuara nga procesi i përgatitjes, ekzistojnë disa strategji të cilat i propozon SVD-ja, për të ndihmuar në minimizimin e tronditjes dhe zvogëlimin e reagimeve të tilla (shih Shtojcën 7 "Rekomandimet e Sektorit të Viktimave dhe Dëshmitarëve, për përgatitjen e dëshmitarëve"). Ndër këta faktorë përfshihet informimi i dëshmitarëve lidhur me procesin dhe me përmbajtjen e dëshmisë së tyre, por edhe vëmendja që duhet treguar për të parë sa besim te vetja duket se ka dëshmitari sa i takon pranisë në sallë si i tillë.

24. Përgatitja delikate dhe e duhur gjatë fazës përgatitore, mund të ndihmojë në rritjen e besimit që ka dëshmitari dhe mund të sjellë rezultate pozitive për procesin në sallë. Po kështu, një mbyllje e duhur e marrëdhënies së dëshmitarit me ekipin ligjor mund të ndihmojë në arritjen e besimit te dëshmitari se e ka përfunduar punën për të cilën ka ardhur. Për ekipin ligjor, kjo ndjenjë e përfundimit të punës, mund të ndihmojë gjithashtu edhe në finalizimin e marrëdhënies me dëshmitarët, pa të cilët, nuk do të mund t'i mbështetnin argumentet e tyre.

D. Përdorimi i urdhërparaqitjeve

25. Tribunali është përpjekur t'i përdorë urdhërparaqitjet në disa lëndë, për të realizuar me detyrim paraqitjen e dëshmitarëve dhe të provave. Formulimi gjuhësor përgjithësisht i përgjithshëm i Rregullës 54 i jep mundësi Dhomës "të lëshojë urdhra, thirrje, urdhërparaqitje, autorizime dhe urdhra transferimi që mund të jenë të nevojshme për hetime ose për përgatitjen apo kryerjen e procesit gjyqësor".[119] Rregulla 54 mund të përdoret për paraqitjen me detyrim të dëshmitarit dhe për paraqitjen me detyrim të provave.[120] Urdhërparaqitjet janë përdorur edhe për të marrë dokumente nga një shtet, në përputhje me rregullën 54 bis.

D.1 Urdhërparaqitjet për dëshmimin me detyrim sipas Rregullës 54

26. Rezultatet e përdorimit të urdhërparaqitjeve për dëshmim me detyrim kanë qenë edhe të mira edhe jo të mira. TPNJ-së i duhet të mbështetet te Shteti në të cilin banon dëshmitari, për ta arrestuar dhe dorëzuar dëshmitarin që nuk ka pranuar të paraqitet pas një urdhërparaqitjeje. Ndryshe nga juridiksionet e brendshme, TPNJ-ja nuk ka një forcë policore e cila do të mund të siguronte respektimin me forcë të procesit të saj ligjor.

27. Menjëherë pas depozitimit, urdhërparaqitjen e dorëzon Sekretaria përmes kanaleve përkatëse diplomatike në Hagë. Sekretaria i jep Shtetit një kopje të njehsuar të urdhërparaqitjes në gjuhën e personit të cilit i drejtohet urdhri i paraqitjes dhe duhet t'i dorëzohet drejtpërdrejt personit në fjalë nga një zyrtar i ngarkuar për këtë punë i Shtetit që bën realizimin e procesit. Urdhërparaqitjes i bashkëlidhet një procesverbal i dorëzimit, i cili i kthehet Sekretarisë pasi plotësohet, ku tregohet se është zbatuar urdhri. Ky procesverbal depozitohet më pas në dosjen e lëndës. TPNJ-ja nuk ka kompetencë për ta zbatuar vetë urdhërparaqitjen, kështu që Sekretaria është e detyruar ta dorëzojë kopjen e njehsuar përmes kanalit diplomatik (pra përmes ambasadave të pranishme në Hagë). Kryerja e procesit ndërlikohet kur një shtet nuk ka përfaqësi në Hagë. Në

119 Rregulla 54, RrPP e TPNJ-së.

120 Shumë prej vendimeve gjyqësore përmes të cilave lëshohet urdhërparaqitja, depozitohen në mënyrë konfidenciale dhe, për rrjedhim, nuk përmenden në poshtëshënimet e këtij dokumenti. Por, për të pasur një shembull, shih *Prokurori kundër Vojislav Šešelj-it*, Lënda Nr. IT-03-67.

këto kushte, duhet shfrytëzuar një kanal alternativ, siç është shërbimi postar ekspres apo dërgimi i urdhërparaqitjes personalisht nga një përfaqësues i Tribunalit tek gjykata rajonale.

28. Në lëndën "Haradinaj dhe të tjerët" përpjekja për të marrë dëshmi me detyrim përmes urdhërparaqitjeve nuk doli shumë e kënaqshme. Kjo solli për pasojë çeljen e disa lëndëve për shpërfillje të gjykatës, mirëpo Dhoma Gjyqësore rrëzoi edhe disa kërkesa për urdhërparaqitje[121] dhe kërkoi mënyra alternative për marrjen e dëshmive dhe provave.[122]

29. Përdorimi i urdhërparaqitjeve mund të shkaktojë vonesa procedurale, të cilat mund ta pengojnë procesin gjyqësor. Dëshmitarët mund të kërkojnë lirim nga urdhërparaqitja në disa mënyra.[123] Për shembull, dëshmitari mund të kërkojë shfuqizimin e urdhërparaqitjes[124] ose mund të paraqesë raport mjekësor se nuk mund të paraqitet.[125] Në disa raste, ka pasur edhe mocione për t'i shpallur të pavlefshme urdhërparaqitjet. Disa dëshmitarë kanë marrë urdhër për të dalë përpara një gjyqtari hetues për të dhënë arsyet e tyre për refuzimin për t'u paraqitur sipas urdhërparaqitjes dhe ata kanë thënë se kanë pasur frikë nga reperkusione kundër tyre apo familjeve të tyre.

30. Urdhërparaqitjet në përgjithësi jepen vetëm pasi dhoma i ka përdorur të gjitha instrumentet dhe mjetet e tjera për paraqitjen vullnetare të dëshmitarit. Ndër këto mjete të tjera mund të përfshihet përdorimi i rregullës 92*bis* dhe *ter*, ku lejohet përdorimi i provave shkresore në vend të dëshmisë në sallë të dëshmitarit apo dëgjimi i dëshmisë përmes lidhjes me video.

31. Për të trajtuar vështirësitë që hasi Dhoma në lëndën "Haradinaj", në lidhje me paraqitjen e dëshmitarëve, u morën masa të posaçme organizative nga ana e Sekretarisë (në konsultim me Dhomën) për të siguruar që dëshmitarët të informoheshin mirë për pasojat e mosparaqitjes përpara Tribunalit nëse lëshohet një urdhërparaqitje. Në këtë mënyrë, Sekretaria i shqyrtoi masat organizative për dorëzimin e urdhërparaqitjeve dhe u kërkoi autoriteteve kompetente shtetërore t'u jepnin dëshmitarëve një shënim shpjegues të hartuar nga Sektori i Viktimave dhe Dëshmitarëve.

32. Kur urdhërparaqitja është e vetmja alternativë për marrjen e dëshmisë, është e rëndësishme të përfshihen autoritetet e shtetit në të cilin banon dëshmitari, për të siguruar zbatimin me forcë të urdhërparaqitjes. Në rast të moszbatimit të urdhërparaqitjes, duhet që Shteti të vendosë në lëvizje procesin e nevojshëm për sjelljen e dëshmitarit përpara Tribunalit, si i akuzuar për shpërfillje të gjykatës. Procesi gjykues për shpërfillje harxhon shumë kohë dhe, në fund, mund të mos e sjellë provat që kërkohen. Disa Dhomat nuk kanë dashur t'i ndalojnë proceset gjyqësore për të kryer proces për shpërfillje të gjykatës, sidomos kur ky i fundit nuk ka të ngjarë ta përshpejtojë përfundimin e lëndës.

121 Shih *Prokurori kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt, Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84, "Vendim për mocionin e Prokurorisë për t'i dhënë urdhërparaqitje Dëshmitarit 25 për të dëshmuar përpara Dhomës Gjyqësore", 30 tetor 2007, "Kërkesa e 23-të e Prokurorisë për urdhërparaqitjeje për dëshmitarin", 19 tetor 2007.

122 Shih *Prokurori kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt, Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84, "Vendim për mospranimin e kërkesës për t'i dhënë urdhërparaqitjeje për të dëshmuar në sallë Dëshmitarit 15 dhe për pranimin me kusht të deklaratave të këtij dëshmitari në përputhje me Rregullën 92*bis*," 2 nëntor 2007.

123 *Prokurori kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt, Lahi Brahimajt*, Lënda Nr. IT-04-84, "Vendim për mocionin e Dëshmitarit 28 për shfuqizimin e urdhërparaqitjes ose për dhënien e një alternative", 5 shtator 2007.

124 Po aty.

125 Për shkak të natyrës konfidenciale të depozitimeve të kërkesave të tilla, këtu nuk citohet asnjëra prej tyre. Megjithatë, ka pasur shumë kërkesa të tilla, për të cilat kanë marrë vendim Dhomat e ndryshme.

E. Dëshmia e dëshmitarëve të Dhomës sipas Rregullës 98

33. Pas përfundimit të paraqitjes së argumenteve nga Prokuroria dhe nga Mbrojtja, Dhomat mund të thërrasin dëshmitarë të tjerë të cilët nuk i ka thirrur asnjëra prej palëve. Në përgjithësi, Dhoma e bën këtë vetëm kur beson se dëshmia e një dëshmitari të veçantë do ta ndihmojë në sqarimin e një çështjeje me rëndësi. Janë miratuar disa modalitete logjistike dhe procedurale, për të mundësuar marrjen në pyetje të dëshmitarëve nga Dhoma. Dhoma, ndryshe nga palët, nuk ka burime hetimore të cilat të mund t'i përdorë për të identifikuar dëshmitarët e mundshëm apo për të marrë deklarata prej tyre. Për shembull në lëndën "Krajišnik" dëshmitarët i merrte në pyetje dhe i përgatiste nëpunësi ligjor i Dhomës në Hagë (shih Shtojcën në kompakt disk "Procedura e finalizuar për dëshmitarët e Dhomave; Vendime dhe urdhra për disa çështje të provave dhe procedurave, datë 24 prill 2006, IT-00-39-T")

34. Për të vlerësuar gatishmërinë e një personi për të dëshmuar si dëshmitar i Dhomës, nëpunësi ligjor i Dhomës mund të bëjë një telekonferencë në praninë e një nëpunësi të gjykatës dhe të një përkthyesi. Telekonferenca regjistrohet me zë. Disa dëshmitarë kanë kërkuar praninë e avokatit gjatë këtyre intervistave paraprake dhe Dhomës i është dashur të japë lejen për pjesëmarrjen avokatit.

35. Pasi kandidati për dëshmitar i Dhomës ka rënë dakord të dëshmojë, Sektori i Viktimave dhe Dëshmitarëve organizon transportimin e dëshmitarit për në Hagë, për një intervistë paraprake. Gjatë intervistës paraprake, nëpunësi ligjor i Dhomës i bën disa pyetje dëshmitarit, në praninë e një nëpunësi të gjykatës. Nëpunësi i gjykatës mban procesverbalin, në praninë e një përkthyesi, ndërsa një stenograf mban procesverbalin në gjuhën angleze dhe intervista regjistrohet me zë. Pastaj, nëpunësi ligjor i Dhomës përgatit një deklaratë në bazë të pyetjeve të dëshmitarit, e cila lexohet në praninë e dëshmitarit përmes përkthyesit në praninë e nëpunësit ligjor të Dhomës dhe të nëpunësit të Gjykatës. Pastaj deklaratën e finalizuar e nënshkruan dëshmitari dhe Dhoma i jep dëshmitarit dhe palëve nga një kopje të deklaratës në gjuhën angleze dhe serbokroate.

36. Paraqitjen e dëshmitarit në Hagë, për dëshminë në sallë, e organizon Sektori i Viktimave dhe Dëshmitarëve. Gjatë dëshmisë, nëpunësi ligjor i Dhomës nuk ka asnjë kontakt me dëshmitarin, i cili në përgjithësi e fillon dëshminë duke u mbështetur deklaratën e tij, e cila pranohet në provat gjyqësore. Dëshmitarit i bëjnë pyetje Gjyqtarët dhe palët. Pyetjet nuk mund të dalin jashtë objektit të deklaratës.

F. Provat që dalin pas mbylljes së paraqitjes së lëndës nga prokuroria

37. Njëra prej sfidave të mëdha për gjykimet me objektin dhe natyrën e lëndëve që gjykohen në TPNJ, është se edhe gjatë gjykimit të lëndës vazhdojnë të dalin dhe zhvillohen prova dhe dëshmi. Mundësia për të mbledhur dhe zhvilluar provat zakonisht nuk është ndërmarrë në vendngjarje sterile të krimit apoapo në mjedis të kontrolluar. Përkundrazi, objekti dhe natyra e provave ndryshon vazhdimisht.

38. Gatishmëria e një Shteti për t'i lejuar hetuesit, prokurorët dhe avokatët e mbrojtjes të përdorin dokumente ushtarake dhe politike dhe dëshmitarë të cilët kanë ose kanë pasur poste me përgjegjësi gjatë konfliktit, mund të shkaktojë pengesa të pakalueshme si për Prokurorinë ashtu edhe për Mbrojtjen, në përpjekjet e tyre për të mbledhur prova të mjaftueshme për paraqitjen e pjesëve të tyre të lëndës (shih kutinë "*Lënda Milutinović dhe të tjerët - Provat që dalin pas mbylljes së paraqitjes së lëndës nga prokuroria*").

39. Idealja do të ishte që provat dhe dëshmitë që do të paraqiten të njihen dhe analizohen përpara fillimit të lëndës, mundësisht gjatë fazës paragjyqësore. Mirëpo, klima e ngarkuar politikisht dhe ndonjëherë e paqëndrueshme, e cila lidhet me lëndët e gjykuara në TPNJ, mund ta bëjë të pamundur arritjen e këtij niveli përgatitjeje. Në shumë raste, zbulohen prova dhe dëshmi shtesë gjatë zhvillimit të vetë gjykimit. Për më tepër, për shkak të kohëzgjatjes së procesit, mund të ndryshojnë kushtet politike, kështu që ato materiale të cilat më parë nuk mund të gjendeshin, krejt papritur bëhen të përdorshme.

Lënda Milutinović dhe të tjerët - Provat që dalin pas mbylljes së paraqitjes së lëndës nga prokuroria

Në lëndën "Prokurori kundër Milutinović-it dhe të tjerëve", njëGatishmëria e një Shteti për t'i lejuar hetuesit, prokurorët dhe avokatët e mbrojtjes të përdorin dokumente ushtarake dhe politike dhe dëshmitarë të cilët kanë ose kanë pasur poste me përgjegjësi gjatë konfliktit, mund të shkaktojë pengesa të pakalueshme si për Prokurorinë ashtu edhe për Mbrojtjen, në përpjekjet e tyre për të mbledhur prova të mjaftueshme për paraqitjen e pjesëve të tyre të lëndës (shih kutinë ilustruese: Lënda "Milutinović dhe të tjerë" Provat që dalin pas mbylljes së paraqitjes së lëndës nga prokuroria).ri prej ekipeve të Mbrojtjes depozitoi në muajin korrik 2007 një mocion konfidencial, ku argumentonte se Prokurorisë nuk i duhej lejuar të kishte kontakte me persona të identifikuar si dëshmitarë të mundshëm për Mbrojtjen. Ky mocion u depozitua përsëri si mocion i hapur.** Në mbështetje të mocionit, Mbrojtja argumentonte se, duke e informuar dëshmitarin e mundshëm të Mbrojtjes për të drejtat e veta, sikurse e kërkon Rregulla 42, Prokuroria, nën zë, e kërcënonte dëshmitarin, duke ndërhyrë kështu në të drejtën e pandehurit për gjykim të drejtë dhe për të paraqitur mbrojtjen e vet.*

Në fund, Dhomës Gjyqësore nuk iu desh të vendoste për këtë mocion, duke qenë se Prokuroria bëri të ditur se ishte e gatshme të hiqte dorë nga intervistat e tjera me dëshmitarët e mundshëm të Mbrojtjes, duke e bërë kështu të panevojshëm mocionin.

* Lënda Nr. it-05-87.

** Prokurori kundër Milutinović-it dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-05-87, "Mocioni i ridepozituar i Sreten Lukić-it për dhënien e një urdhri për ndalimin e kontakteve me dëshmitarët e Mbrojtjes ", 8 gusht 2007.

G. Kërkesa për dhënie të pafajësisë

40. Rregulla 98*bis* lejon që, në mbyllje të procedimit të aktakuzës prej Prokurorisë, të bëhen parashtrimet gojore të palëve për të kërkuar dhënien e pafajësisë nga gjykata. Kjo rregull parashikon që Dhoma Gjyqësore jep vendimin e pafajësisë për çdo pikë "në rast se nuk ka prova që vërtetojnë fajësinë". Dhoma e Apelit e përshkruan këtë standard në Vendimin e Apelit për lëndën "Jelisić":[126] "testi nuk është nëse gjykuesi do të arrinte apo jo në vendimin për të dhënë fajësinë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm mbështetur në provat e paraqitura nga prokuroria (nëse këto pranohen) por nëse do të mund të mund arrinte në një vendim të tillë". Në këtë mënyrë, Dhomës Gjyqësore "i kërkohet të supozojë se provat dhe dëshmitarë e prokurorisë duhen besuar nëse nuk ngjallin asnjë dyshim. Pra, Dhomës Gjyqësore i kërkohet t'i konsiderojë provat në maksimum dhe jo të zgjedhë çfarë të dojë nga këto prova".[127]

41. Tribunali e shtoi Rregullën 98 në Rregullore në korrik 1998. Siç ishte hartuar në fillim, rregulla thoshte:

> *Nëse, në mbyllje të procedimit të aktakuzës prej Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore konstaton se provat janë të mjaftueshme për të mbështetur dhënien e fajësisë për një ose më shumë vepra për të cilat ngrihet akuzë në aktakuzë, Dhoma Gjyqësore, me kërkesë të të akuzuarit ose proprio motu, jep vendimin e pafajësisë për atë pikë të aktakuzës.*[128]

42. Kjo rregull është ndryshuar disa herë pas miratimit për herë të parë të saj. Në nëntor 1999, rregulla u ndryshua, për të kërkuar depozitimin e një mocioni me shkrim për dhënie pafajësie në mbyllje të përmbylljes

126 *Prokurori kundër Goran Jelisić-it*, Lënda Nr. IT-95-10-A, Aktgjykim Apeli, para. 55.
127 *Prokurori kundër Goran Jelisić-it*, Lënda Nr. IT-95-10-A, Aktgjykim Apeli, para. 55.
128 Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, Rregullorja e Procedurës dhe Provave, IT/32/Rev. 13, 9 dhe 10 korrik 1998.

së paraqitjes së aktakuzës nga Prokuroria. Ky proces konsiderohet si shumë i pavolitshëm, sepse kërkon shumë burokraci. Për rrjedhojë, në muajin dhjetor 2004, rregulla u ndryshua për të lejuar vetëm parashtrime me gojë, të cilat marrin përgjigje nga një vendim me gojë i trupit gjykues.

43. Përvoja ka treguar se, në funksion të një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë, parapëlqehet të lejohet një mocion me gojë për dhënien e vendimit të pafajësisë në përmbyllje të paraqitjes së lëndës nga Prokuroria dhe t'i jepet përgjigje këtij mocioni përmes një vendimi me gojë. Ky është mekanizmi që parashikohet në Rregulloren e tanishme.

44. Grupi i Parë i Punës për Përshpejtimin e Gjyqeve vërente në raportin e muajit shkurt 2006 se, në përmbyllje të paraqitjes së lëndës nga Prokuroria, "Prokurori është i detyruar t'i shqyrtojë provat për të trajtuar çdo parashtrim të bërë sipas Rregullës 98*bis*".[129] Grupi i punës sugjeronte në vitin 2006 se Dhoma Gjyqësore që merr vendime sipas Rregullës 98*bis* duhet të ndjekë një qasje "të fortë" dhe të hedhë poshtë çdo pikë të akuzës për të cilën nuk janë dhënë prova të mjaftueshme.

45. Ky koncept (i përdorimit të mocionit për dhënie pafajësie në përmbyllje të paraqitjes së lëndës nga Prokuroria, për ta ndryshuar lëndën kundër të akuzuarit) ka avantazhe të qarta. Kur Mbrojtja beson se disa prej pikave të aktakuzës nuk mund të mbështesin dhënien e fajësisë sipas standardit "përtej dyshimit të arsyeshëm", ajo ka avantazhin që mund të depozitojë një mocion për dhënie të pafajësisë. Mbrojtja nuk ka asnjë detyrim për të bërë paraqitjen e vet të lëndës. Mirëpo, nëse nuk e bën këtë paraqitje, mund të ketë rrezik, edhe atëherë kur akuzat duket se janë të dobëta. Nëse Dhoma Gjyqësore vendos se ka prova të pamjaftueshme në lidhje me disa prej pikave të aktakuzës, Mbrojtja mund ta përqendrojë paraqitjen e saj në aspekte të tjera të aktakuzës. Ka gjithashtu një përfitim të qartë, sa i takon ekonomisë gjyqësore.

46. Edhe pse Tribunali lejon apelimin e dënimit, si edhe apelimin e dhënies së pafajësisë, mund të dalin probleme lidhur me apelimin e vendimeve për mocionet për dhënie pafajësie në fund të gjykimit së bashku me apelimin e aktgjykimit. Kjo është sidomos e vërtetë në lidhje me vendimet që e japin pjesërisht pafajësinë. Madje nëse Prokurorisë do t'i jepej mundësia ta kundërshtonte një vendim të tillë vetëm në fund të gjykimit, Dhomës së Apelit do t'i jepeshin mundësi të kufizuara për ndreqjen e një vendimi të gabuar të Dhomës Gjyqësore lidhur me dhënien e pafajësisë për disa prej pikave të aktakuzës. Në to do të përfshihej mundësia për të vendosur për rigjykimin e pikave përkatëse të aktakuzës apo për ta refuzuar kërkesën për ta shfuqizuar vendimin për dhënien e pafajësisë. Në lëndën "Jelisić", Dhoma e Apelit konstatoi rrethana të jashtëzakonshme, por arriti në përfundimin se nuk ishte në interes të drejtësisë të miratohej kërkesa e Prokurorisë për rigjykim, duke cituar këto arsye: Jelisić-i kishte pranuar fajësinë për sjelljen kriminale në bazë të së cilës u gjet fajtor për 31 akuza për shkeljen e ligjeve apo zakoneve të luftës dhe për krime kundër njerëzimit, dhe u dënua me 40 vjet burg. Rigjykimi do të mund të bëhej për një akuzë për gjenocid përmes vrasjes dhe prokuroria nuk kishte ngritur asnjë akuzë tjetër për vrasje në lidhje me këtë pikë të aktakuzës. Rigjykimi do të kufizohej te çështja nëse e kishte ky i akuzuar apo jo synimin për të shkatërruar tërësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racial a fetar. Nuk ishte faji i Jelisić-it që Dhoma Gjyqësore gaboi në vendimin e vet. Kishte që më 22 janar 1998 që Jelisić-i ndodhej në ambientet e paraburgimit të Tribunalit. Dhoma Gjyqësore kishte rekomanduar që atij t'i jepej "trajtim shtesë psikologjik dhe psikiatrik" dhe një trajtim të tillë mund ta jepte më mirë një burg sesa Njësia e Paraburgimit e OKB-së. Dhoma e Apelit mori në konsideratë edhe faktin se kishte kaluar një kohë e konsiderueshme prej datës së kryerjes së krimeve në muajin maj 1992, deri në datën e një rigjykimi të mundshëm. U vu theksi edhe te natyra e përkohshme e Tribunalit Ndërkombëtar, i cili, ndryshe nga një sistem juridik i brendshëm, i ka burimet e kufizuara dhe kohëzgjatjen e pasigurt.

129 Raport i Grupit të Punës për Shpejtimin e Gjykimeve, shkurt 2006, f. 16.

47. Më pas, Tribunali zhvilloi një proces për të trajtuar apelimin e vendimeve sipas Rregullës 98*bis* përpara paraqitjes së lëndës nga Mbrojtja. Kështu, për shembull në lëndën "Brđanin",[130] të akuzuarit iu dha pafajësia për akuzën për gjenocid dhe Prokurorisë iu lejua ta apelonte këtë vendim të dhënë sipas Rregullës 98*bis*. Dhoma e Apelit e mbështeti apelimin e Prokurorisë dhe vendosi për rifutjen në gjykim të akuzës për gjenocid.[131]

48. Përvoja ka treguar se praktika më e mirë është që apelimet e Prokurorisë kundër vendimeve për dhënien e pafajësisë sipas Rregullës 98 të trajtohen si apelim i ndërkohshëm dhe jo si apelim i fundit. Apelimi i ndërkohshëm nga Prokuroria i jep mundësi të akuzuarit të dijë nëse duhet të paraqesë apo jo prova dhe dëshmi në lidhje me pika të caktuara të aktakuzës dhe ndihmon në ruajtjen e të drejtës së të akuzuarit për të heshtur në lidhje me veprën penale në fjalë, sepse prej apelimit del vendimi nëse do të ketë apo jo dhënie të pafajësisë për këtë vepër. Gjithashtu, duke i zgjidhur çështjet e dhënies së pafajësisë në fazën e parashikuar nga Rregulla 98*bis* përmes një apelimi të ndërkohshëm, i akuzuari nuk rrezikon t'i humbasë provat për shkak të vonesës.

H. Materialet konfidenciale të Shteteve dhe organizatave të tjera

49. Rregulla 70 jep disa udhëzime specifike për provat, në lidhje me marrjen dhe përdorimin nga TPNJ-ja të materialeve të dhëna në mënyrë konfidenciale. Kjo rregull është quajtur një "e drejtë përjashtimore por e përcaktuar shumë mirë".[132] Ideja e kësaj rregulle është të nxitet, sipas rastit, përdorimi i materialeve të cilat, në kushte të tjera, Prokuroria nuk do të mund t'i merrte, ose të cilat nuk do të mund të përdoreshin për shkak të natyrës konfidenciale të tyre.[133] Rregulla 70 parashikon që Prokuroria nuk bën të njohur informacionet a materialet e marra në mënyrë konfidenciale dhe i kufizon po kështu kompetencat e Dhomës për të dhënë urdhër për dhënien dhe bërjen të ditur të informacioneve që zotëron Prokuroria ose Mbrojtja të cilat janë marrë në mënyrë konfidenciale. Këto kufizime janë zbatuar për informacionet dhe materialet provuese në shumë prej gjykimeve të Tribunalit Në këtë aspekt, regjimi që rregullon bërjen të njohur të materialeve që mund të jenë shfajësuese, sipas Rregullës 68, kërkon që Prokuroria të marrë hapat e arsyeshëm për të marrë pëlqimin e dhënësit të këtyre materialeve për t'ia bërë t'i bërë ato apo faktin e ekzistencës së tyre të ditura. Mirëpo Rregulla 70 ka epërsi ndaj Rregullës 68, sepse ajo parashikon që Prokuroria nuk është e detyruar t'i bëjë të njohura materialet dhe informacionet shfajësuese të cilat i ka marrë nën kushtin e konfidencialitetit nëse dhënësi i tyre nuk e jep pëlqimin për këtë. Epërsia e Rregullës 70 shpjegohet me faktin se më parë ka pasur pasiguri nëse procesin e kontrollonte Rregulla 68 apo Rregulla 70 dhe kjo pasiguri bënte që Shtetet të mos i jepnin Prokurorisë materiale sipas Rregullës 70 nëse të drejtës së konfidencialitetit nuk i jepej epërsi. Kjo solli ndryshimin e Rregullores, duke e vendosur Rregullën 68 në varësi të dispozitave të Rregullës 70.

50. Normalisht kufizimet e Rregullës 70 zbatohen për informacionin që japin Shtetet dhe organizatat, duke përfshirë edhe organizatat e OKB-së. Kufizime të tilla mund të shkaktojnë vështirësi dhe mangësi në procesverbalin e provave dhe mund të prekin kërkesën për gjykim të drejtë dhe të shpejtë. Rregullorja e Tribunalit nuk ia lejon Dhomës t'i japë urdhër një dhënësi të informacionit sipas Rregullës 70, që të japë

130 *Prokurori kundër Brđanin-it*, Lënda Nr. IT-99-36-T.
131 *Prokurori kundër Brđanin-it*, Lënda Nr. IT-99-36-T, Vendim për apelin e ndërkohshëm, 19 mars 2004.
132 *Prokurori kundër Blaškić-it*, Lënda Nr. IT-95-14-T, Vendim i Dhomës Gjyqësore 1 për mocionin e Prokurorisë për deponimin me video dhe masat mbrojtëse, 11 nëntor 1997, para. 10.
133 *Prokurori kundër Blaškić-it*, Lënda Nr. IT-95-14-T, Vendim i Dhomës Gjyqësore 1 për mocionin e Prokurorisë për deponimin me video dhe masat mbrojtëse, 11 nëntor 1997, para. 10.

informacionin konfidencial të mbrojtur nga kjo rregull. Ka raste kur mund të bëhen kompromise me dhënësit e informacioneve apo, në raste shumë të veçanta, kur mund të merret pëlqimi pasi është ngritur çështja përpara Dhomës, por situata të tilla kanë qenë shumë të pazakonta në TPNJ. Kur ekzistojnë dyshime nëse informacioni është dhënë apo jo sipas Rregullës 70, Dhoma duhet t'i kërkojë dhënësit të informacionit dhe Prokurorisë të bëjnë parashtrime për këtë çështje dhe duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur apo jo kriteret e Rregullës 70(B).

51. Nëse materiali i cili u nënshtrohet kufizimeve u duhet bërë i njohur palëve të tjera të lëndës, rekomandohet që ai të bëhet i njohur siç është dhe jo në formë të përmbledhur, sigurisht në varësi të nevojës për të fshirë a mbuluar ndonjë informacion në të.[134]

52. Në rastet kur dhënësit e materialeve kanë dhënë pëlqimin për bërjen të njohur dhe përdorimin e tyre në proces, duke iu nënshtruar kufizimeve sipas Rregullës 70, janë shfrytëzuar masa të ndryshme për t'i respektuar kërkesat e këtyre dhënësve të materialeve. Në këto masa, të hartuara në përgjithësi për të mbrojtur interesat e sigurimit kombëtar të Shteteve, përfshihen: 1) përshtatja e marrjes kryesore në pyetje për ta përjashtuar informacionin konfidencial, 2) kufizimi i fazës së kundërpyetjeve , tek ato çështje që janë cekur gjatë ekzaminimit kryesor, 3) kufizimi i pyetjeve për besueshmërinë tek ato pyetje përgjigjet e të cilave nuk zbulojnë informacion konfidencial, dhe 4) lejimi i përfaqësuesve të dhënësit të materialit të jenë të pranishëm.

I. Vetëpërfaqësimi

53. Vetëpërfaqësimi ka paraqitur probleme të vështira në një sërë lëndësh të gjykuara përpara Tribunalit. Neni 21 i Statutit të TPNJ-së e parashikon të drejtën e vetëpërfaqësimit si të drejtë themelore,[135] por vetëpërfaqësimi mund të mos jetë i dëshirueshëm në lëndët komplekse me krime që kanë ndodhur në fushën e një konflikti të armatosur. Ka disa arsye për këtë:

- gjykata mund të keqpërdoret si skenë politike;
- i akuzuari mund të mos ketë një mendim objektiv për lëndën që duhet të paraqesë, madje ka të ngjarë "të mos e shohë pyllin ngaqë e pengojnë pemët" dhe për rrjedhojë mund të mos e zhvillojë paraqitjen e mbrojtjes sipas interesave të tij më të mirë ligjorë;
- i akuzuari mund të mos jetë në gjendje t'ia dalë vëllimit të madh të materialeve;
- çdo sanksion i vendosur për shkeljet e vendimeve gjyqësore mund të ketë pasoja anësore të padëshirueshme për zhvillimin e gjykimit.[136]

54. Krahas këtyre shqetësimeve, vështirësitë e tjera shtesë të paraqitura nga i akuzuari që vendos ta mbrojë vetveten, i dëshmojnë lëndët "Šešelj"[137] dhe "Tolimir"[138]. Në të dyja këto lëndë është përdorur e drejta e të akuzuarit për t'i marrë deklaratat në një gjuhë që e kupton. Edhe pse kjo e drejtë mbulon bërjen të njohur të disa materialeve të caktuara të identifikuara në Rregullore, pra materiale mbi të cilat mbështetet konfirmimi

134 Shih, për shembull, *Prokurori kundër Brđanin-it*, Lënda Nr. IT-99-36-T, Vendim për mocionin për lirim nga shkeljet e Rregullës 68 nga Prokurori dhe për vendosjen e sanksioneve sipas Rregullës 68*bis* dhe për mocionin për shtyrjen e seancës gjyqësore derisa të mund të zgjidhen çështjet që prekin drejtësinë dhe gjykimin e drejtë, 30 tetor 2002, para. 26 (ku mbahet qëndrimi se, në kuadër të gjykimit të drejtë, detyrimi për bërjen të njohur të materialeve shfajësuese nënkupton bërjen të ditur të materialit shfajësues siç është dhe jo në formë të përmbledhur).

135 Statuti i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, Neni 21.

136 *"Journal of International Criminal Justice" (Buletini i Drejtësisë Penale Ndërkombëtare)* 5, f. 356.

137 *Prokurori kundër Vojislav Šešelj-it*, Lënda Nr. IT-03-67.

138 *Prokurori kundër Zdravko Tolimir-it*, Lënda Nr. IT-05-88/2.

i aktakuzës dhe të gjitha deklaratat e mëparshme që ka dhënë i akuzuari, ajo nuk mbulon materialet shfajësuese që rregullon Rregulla 68. Vështirësia që doli në të dyja këto lëndë ishte nëse cenohej apo jo i akuzuari që vendoste të vetëmbrohej nga mospasja të drejtë për t'i marrë materialet shfajësuese në një gjuhë që e kupton. Është e qartë se e drejta për të marrë informacionet shfajësuese shfrytëzohet në mënyrë shumë më pak të efektshme nëse këto informacione i jepen të akuzuarit në një gjuhë që nuk e kupton. Këto probleme mund të shmangen në rastin kur i akuzuari mbrohet nëpërmjet një avokati i cili e ka për detyrë të punojë në njërën prej dy gjuhëve zyrtare të Tribunalit (frënge ose angleze). Nëse Tribunalit do t'i duhej t'i përkthente materialet në një gjuhë që e kupton i akuzuari që vetëmbrohet, atëherë ky proces do të vendoste një barrë shumë të madhe mbi burimet e Tribunalit, të cilat, edhe ashtu, janë të kufizuara. Rritja e kërkesës për shërbimet e përkthimit me shkrim mund të jetë e paparashikueshme dhe mund ta bëjë të vështirë planifikimin e duhur institucional sa u takon përkthimeve të kërkuara të informacioneve shfajësuese të dhëna sipas Rregullës 68.

55. Një i akuzuar, i quajtur Zdravko Tolimir, në mënyrë të përsëritur ka ngulur këmbë që parashtrimet e Prokurorisë dhe të Dhomave t'i merrte vetëm me germa cirilike, përdorimi i të cilave e rriste shumë barrën mbi Sektorin e Shërbimeve të Konferencave dhe Gjuhëve (SShKGj). Mirëpo, Dhoma e Apelit e ka lënë në fuqi vendimin e Dhomës Gjyqësore, sipas të cilit "e drejta për t'i marrë materialet përkatëse në këtë Tribunal në një gjuhë që e kupton [i akuzuari], nuk do të thotë që i akuzuari ka të drejtë që, pavarësisht formimit, arsimit a përvojës, të dalë përpara Tribunalit dhe të kërkojë që dokumentet të jepen në cilëndo gjuhë apo alfabet që zgjedh ai a ajo" (*Prokurori kundër Zdravko Tolimir-it*, Vendim i Dhomës së Apelit, datë 28 mars 2008, paragrafi 15). Në mungesë të konstatimit faktik që Tolimir-i vërtetë nuk e kuptonte shkrimin latin, Tribunali nuk ishte i detyruar t'ia plotësonte këtë kërkesë. Për më tepër, vendimi i Tribunalit për t'i caktuar të akuzuarit dy asistentë juristë ndihmoi që të tregohej kujdes që i akuzuari të ishte në gjendje ta përgatiste mbrojtjen e vet.

56. Një problem tjetër i vështirë në lëndët me vetëpërfaqësim, është përpjekja për të përdorur burimet e jashtme për t'i asistuar të akuzuarit. Ndonjëherë Dhoma apo Sekretaria i konsideron këto burime të jashtme, si një përpjekje për t'i kapërcyer pengesat që paraqet vetëpërfaqësimi. Në lëndën "Šešelj",[139] i akuzuari i kërkoi Dhomës Paragjyqësore të lejojë pagimin e disa bashkëpunëtorëve të cilët i akuzuari pretendonte se e ndihmonin për mbrojtjen e tij përpara gjykatës. Meqë i akuzuari nuk dëshironte që këta bashkëpunëtorë të vepronin si avokatë të mbrojtjes, sepse ngulte këmbë të përdorte të drejtën e vetëpërfaqësimit, kjo kërkesë nuk binte tërësisht në objektin e skemës së financimit për burimet e ndihmës ligjore.

57. Vendimi "Šešelj" nënvizon sfidat që shkakton trysnia mbi të akuzuarin, të cilit i kërkohet ta përgatisë paraqitjen e mbrojtjes gjatë kohës që ndodhet në paraburgim. Arsyetimi i vendimit në fjalë, parashtron argumente nga të dyja anët: pro gjetjes së një mënyre për të mundësuar njëfarë mbështetjeje për vetëmbrojtjen e të akuzuarit në formën e financimit të bashkëpunëtorëve, por në të njëjtën kohë pro drejtpeshimit të nevojës së Tribunalit për ta kufizuar në mënyrë të kujdesshme pagesën e shumave duke siguruar që këto fonde po përdoren vetëm për qëllimet e lejuara.

58. Sipas vendimit të Dhomës në lëndën "Šešelj":

- i akuzuari në fillim duhej të vërtetonte mungesën e mjeteve financiare, për të përmbushur kriteret për mbështetje financiare për asistentët e tij;
- i akuzuari duhej të identifikonte njërin prej bashkëpunëtorëve të tij, i cili t'i përmbushte kriteret për emërim si avokat i mbrojtjes sipas kërkesave të Rregullës 44 dhe 45; dhe

139 *Prokurori kundër Vojislav Šešelj-it*, Lënda Nr. IT-03-67.

- Sekretaria, duke marrë në konsideratë kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e përafërt të gjykimit, duhej të përcaktonte shumat e arsyeshme dhe të nevojshme që duhej t'i caktoheshin të akuzuarit për të përgatitur mbrojtjen.[140]

59. Vendimi kërkon:

- që i akuzuari të vërtetojë mungesën e mjeteve financiare, siç kërkohet për çdo të akuzuar që kërkon ndihmë ligjore;[141]
- që të paktën njëri prej asistentëve të të akuzuarit të plotësojë kriteret për emërim si avokat i mbrojtjes sipas Rregullores.[142] Kjo e fundit është e nevojshme për të siguruar që ka një mënyrë për ta rregulluar punën që duhet kryer, në mënyrë që të sigurohet që fondet publike që mund të përdoren për të mbuluar kostot e asistentëve të tillë të përdoren me të vërtetë për përgatitjen e mbrojtjes;
- të autorizohet gjithashtu Zyra e Ndihmës Juridike dhe Çështjeve të Paraburgimit për të monitoruar punën e këtyre asistentëve dhe t'u japë atyre pagesën e autorizuar, pasi këta asistentë t'i përmbushin kriteret sipas Rregullës 44 ose 45. Një kërkesë e tillë ka shumë rëndësi për të siguruar që ka një mekanizëm kontrollues ligjor për çdo shkelje të detyrimit për mbrojtjen e dëshmitarëve të cilët ndodhen nën masa mbrojtëse dhe për të siguruar se informacionet konfidenciale nuk do të bëhen të njohura.

60. Rasti i të akuzuarit të vetëpërfaqësuar (AVP) mund të paraqesë sfida të veçanta për procesin e gjykimit dhe në veçanti për Sekretarinë. Mungesa e një avokati mbrojtës me përvojë mund të shkaktojë huti dhe vonesa, sidomos ngaqë i akuzuari mund t'i shpërfillë procedurat dhe praktikat e Tribunalit.

61. Megjithëse i akuzuari ka të drejtë, sipas Nenit 21 pika 4 germa "b" të Statutit, "të ketë kohë dhe kushte të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes", Tribunali nuk ka asnjë rregull apo nen që të parashikojë shprehimisht procedurat dhe praktikat e vetëpërfaqësimit. Sidoqoftë, pas vendosjes së procedurave *ad hoc* nga shumë zyra gjatë gjykimit të Slobodan Milošević-it, Sekretaria pa se ekzistonte nevoja për një punë më të bashkërenduar për të siguruar njëtrajtshmërinë dhe shpejtësinë e trajtimit të problemeve që dilnin nga vetëpërfaqësimi. Sekretaria krijoi Zyrën *Pro Se*, për t'i dhënë asistencë të specializuar të akuzuarit që vendos të mos përdorë avokatë mbrojtës. Në rezultatet e kërkuara përfshihet bashkërendimi i informacioneve dhe kërkesave midis sektorëve të Sekretarisë dhe të akuzuarit që vendosin të vazhdojnë pa avokat mbrojtës, duke e ulur barrën mbi nëpunësit juristë të caktuar dhe duke e mbajtur më të informuar të akuzuarin që vetëmbrohet dhe ekipin e tij në lidhje me përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre përpara Tribunalit. Kjo strukturë kontribuon në zhvillimin më efikas dhe të drejtë të gjykimit, pa vënë në rrezik asnjanësinë dhe paanshmërinë e Sekretarisë.

62. Krahas kësaj, të gjithë sektorëve të shërbimeve gjyqësore të Sekretarisë u është kërkuar t'u kushtojnë burime të tjera shtesë sfidave që paraqesin lëndët me vetëpërfaqësim. Për shembull, Sektori i Administrimit dhe Shërbimeve të Gjykatës (CMSS) është përgjegjës për marrjen në dorëzim të të gjitha provave materiale të cilat ofrohen për t'u pranuar si pjesë e provave gjyqësore dhe për sigurimin e zhvillimit të shpejtë të punimeve të Tribunalit. Duke qenë se të akuzuarit që vetëmbrohen, zakonisht nuk kanë përvojë si avokatë mbrojtës, nëpunësit gjyqësorë të CMSS-së duhet të luajnë një rol më aktiv në këtë proces. Nëpunësi gjyqësor i Sekretarisë, si ndërmjetësi kryesor për të akuzuarin që vetëmbrohet, asiston në përgatitjen e materialeve të provave, kujdeset që i akuzuari që vetëmbrohet të informohet tërësisht për procedurat e depozitimit të argumenteve të mbrojtjes dhe të paraqitjes së provave. Krahas këtyre, ai e ndihmon të akuzuarin për të

140 *Prokurori kundër Vojislav Šešelj-it*, Lënda Nr. IT-03-67, "Vendim për financimin e mbrojtjes së të akuzuarit", 30 korrik 2007.
141 Në fakt ende nuk i janë paguar asnjë fond asnjërit prej asistentëve, në lëndën "Šešelj", sepse i akuzuari nuk ka pranuar të kryejë procesin e nevojshëm për të dëshmuar mungesën e mjeteve financiare.
142 Rregulla 44 ose Rregulla 45, RrPP e TPNJ-së.

kuptuar udhëzimet në lidhje me kufirin e numrit të faqeve dhe të fjalëve dhe kujdeset që i akuzuari që vetëmbrohet t'i ndjekë këto udhëzime.

63. Gjatë fazës së paraqitjes së mbrojtjes, në lëndën ku ka vetëpërfaqësim, duhet caktuar një nëpunës ligjor ndërlidhës për vetëpërfaqësim, për të siguruar asistencën adekuate për të akuzuarin që vetëmbrohet gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së mbrojtjes. Nëpunësi ndërlidhës administron kërkesat e të akuzuarit që vetëmbrohet dhe luan një rol bashkërendues dhe ndërmjetësues me të gjithë sektorët përkatës të Tribunalit. Asistenca mund të jetë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë. Asistenca e drejtpërdrejtë është atëherë kur nëpunësi ndërlidhës e ndihmon nga afër të akuzuarin që vetëmbrohet në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me paraqitjen e mbrojtjes. Në këtë asistencë mund të përfshihet ndihma që i jepet të akuzuarit në lidhje me dëshmitarët ose për të organizuar marrjen e dëshmisë prej tyre ose përgatitjen e tyre (të gjithë dëshmitarëve, ka të ngjarë, t'u duhet të vijnë dy herë në Tribunal: një herë për përgatitjen dhe një herë për dhënien e dëshmisë në sallë), krijimi i mundësisë për të përdorur bibliotekën juridike dhe materialet e tjera mbështetëse që mund t'i vihen në dispozicion AVP-së, gjetja e një avokati në dispozicion nëse lind nevoja, kërkimi dhe përpilimi i dokumenteve që duhen propozuar për t'u pranuar në provat gjyqësore, kërkimi i përkthimit të dokumenteve të mundshme që duhen propozuar për t'u pranuar në provat gjyqësore, dhënia e udhëzimeve në lidhje me kërkesat ligjore për depozitimin e dokumenteve, ndihma për të identifikuar stafin e përshtatshëm dhe të duhur mbështetës (asistentë juristë, përkthyes, etj.) të cilët mund të paguhen përmes skemës së shpërblimit, nëse i akuzuari që vetëmbrohet e kërkon një asistencë të tillë, si edhe përmbushja e të gjitha urdhrave që jep Presidenti, Dhoma Gjyqësore, Dhoma e Apelit dhe Sekretari.

64. Sa i përket asistencës së tërthortë, nëpunësi ndërlidhës duhet të merret me kërkesat e AVP-së në lidhje me sektorët e ndryshëm të Tribunalit dhe të bashkërendojë përgjigjet ndaj këtyre kërkesave. Detyrat e ndërlidhjes përfshijnë komunikimin me Njësinë e Paraburgimit të OKB-së sa u takon nevojave për hapësirë dhe materiale të AVP-së në paraburgim, komunikimin me SVD-në në lidhje me organizimin e udhëtimit të dëshmitarëve, komunikimin me sektorët e tjerë të Tribunalit dhe me subjektet e jashtme, për llogari të AVP-së dhe bashkërendimin e përgjigjeve të sektorëve dhe subjekteve të lartpërmendura. Si kundërpërgjigja e menjëhershme ashtu edhe roli i thjeshtimit të gjërave, kërkojnë nga nëpunësi ndërlidhës që të mbajë regjistra të brendshëm të kërkesave, dhe të sigurojë, kështu, njëtrajtshmërinë gjatë trajtimit të aspekteve të ndryshme të së njëjtës lëndë gjyqësore me vetëpërfaqësim. Është e rëndësishme që nëpunësi ndërlidhës të ruajë në çdo kohë asnjanësinë e Sekretarisë, duke shmangur çdo konflikt të mundshëm të interesit, duke mos i parashtruar asnjë strategji ligjore të akuzuarit a bashkëpunëtorëve juristë të tije dhe duke i kufizuar shërbimet e veta brenda objektit të misionit të zyrës së vetëmbrojtjes në çdo moment.

65. Apeli në lëndën "Krajišnik",[143] gjithashtu u mor me çështjen e financimit të asistentëve të AVP-së. Në këtë lëndë, i akuzuari zgjodhi të mbrohej vetë gjatë fazës së apelimit të lëndës. Madje, gjatë marrjes së vendimit për detyrimin për të financuar bashkëpunëtorët për ta asistuar të akuzuarin të përgatisë apelimin, Dhoma e Apelit mbajti qëndrimin që, edhe pse Neni 21 pika 1 mund të kërkojë që të akuzuar në rrethana të ngjashme të marrin trajtim pak a shumë të njëjtë, kjo nuk kërkon që i akuzuari i cili zgjedh të mbrohet vetë të marrë të gjitha avantazhet që merr i akuzuari që zgjedh të ketë avokat mbrojtës. Madje, në kuadër të vendimit për t'u mbrojtur vetë, zoti Krajišnik duhet të pranonte përgjegjësinë për mangësitë që mund t'i ketë kjo zgjedhje.[144]

143 *Prokurori kundër Momčilo Krajišnik-ut*, Lënda Nr. IT-00-39-A.

144 *Prokurori kundër Momčilo Krajišnik-ut*, Lënda Nr. IT-00-39-A, "Vendim për kërkesën *Krajišnik* dhe për mocionin e Prokurorisë", 11 shtator 2007 (ku citohet *Prokurori kundër Slobodan Milošević-it*, Lënda Nr. IT-02-54-AR73.6, "Vendim për apelimin e ndërkohshëm të Amici Curiae kundër Vendimit të Dhomës Gjyqësore në lidhje me paraqitjen dhe përgatitjen e Mbrojtjes", 20 janar 2004, para. 19).

66. I akuzuari i cili dënohet për krime lufte, krime kundër njerëzimit apo gjenocid zakonisht ndodhet përpara mundësisë për t'u dënuar me burgim të gjatë. Gjatë vendosjes së praktikave që kanë të bëjnë me vetëpërfaqësimin, duhet bërë çdo përpjekje për të mos e inkurajuar të akuzuarin të mbrohet vetë përballë një rreziku të tillë.

67. Kur i akuzuari ngul këmbë tek e drejta për vetëpërfaqësim, dhe kur kjo e drejtë, paçka se jo në mënyrë absolute, është e mishëruar në statut, siç është rasti i TPNJ-së, duhet të ketë udhëzues të qartë të cilët të rregullojnë procedurën e ushtrimit të së drejtës së vetëpërfaqësimit, si edhe të ndjekjes së vendimit të vet nga ana e të akuzuarit. Rregullorja e TPNJ-së nuk ndryshon thjesht ngaqë i akuzuari ka vendosur të ushtrojë të drejtën për vetëpërfaqësim. Siç u konstatua në lëndën "Krajišnik",[145] i akuzuari vazhdonte të ishte përpara detyrimit për të përmbushur kriteret e vendosura nga Tribunali për asistencë financiare për asistentët e ekipit të të akuzuarit. Krahas kësaj, Dhoma duhet t'ia bëjë të qartë të akuzuarit që, përmes heqjes dorë nga e drejta për të përdorur një avokat të kualifikuar, i akuzuari e merr përsipër vetë përgjegjësinë për çdo cenim si edhe për çdo avantazh që i sjell lëndës vetëpërfaqësimi, së bashku me kufizimet që kjo ka mbi përgatitjen e mbrojtjes së të akuzuarit.

J. Mungesa e të akuzuarit

68. Një prej të drejtave thelbësore të të akuzuarit, e mishëruar në Statutin e TPNJ-së, është e drejta për të qenë i pranishëm në të gjitha seancat e gjykimit.[146] E drejta për të qenë i pranishëm gjendet në shumicën e juridiksioneve të brendshme dhe përfshihet në Nenin 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe në konventat e tjera ndërkombëtare.[147] Ajo konsiderohet si "gur i domosdoshëm themeli i drejtësisë".[148]

69. Edhe pse TPNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se e drejta e të akuzuarit për të qenë fizikisht i pranishëm përpara gjykatës është një prej nocioneve më bazë dhe të nevojshme të një procesi të drejtë penal,[149] dihet mirë se në raste të caktuara një gjykim mund të zhvillohet edhe në mungesë të të akuzuarit.[150] Për shembull, kur i akuzuari e pengon procesin gjyqësor dhe ka marrë paralajmërim më parë për këtë,[151] ai mund të përjashtohet nga procesi gjyqësor.

70. Më tej akoma, edhe pse pjesëmarrja e të akuzuarit në gjykim përbën një "të drejtë", ai mund të heqë dorë nga ushtrimi i kësaj të drejte, pasi të jetë informuar plotësisht për pasojat. Për shembull, kur i akuzuari është i sëmurë për një periudhë të shkurtër, Mbrojtja duhet të paraqesë një formular në të cilin dëshmon se avokati i mbrojtjes e ka informuar të akuzuarin për të drejtat e veta dhe në të cilin bëhet e ditur se i akuzuari është i

145 *Prokurori kundër Momčilo Krajišnik-ut*, Lënda Nr. IT-00-39-A, Vendim për kërkesën e Momčilo Krajišnik-ut për vetëpërfaqësim, për mocionet e avokatit në lidhje me emërimin e *Amicus Curiae*, dhe për mocionin e Prokurorisë datë 16 shkurt 2007, 11 maj 2007.

146 Statuti i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, Neni 21(4)(d).

147 Shih, për shembull, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Neni 6(3)(C); *Lënda "Stoichkov kundër Bullgarisë"*, Kërkesa Nr. 9808/02, Aktgjykim, 24 mars 2005, para. 56; *Lënda "Sejdovic kundër Italisë"*, Kërkesa Nr. 56581/100, Aktgjykim, 1 mars 2006, para. 84; *Lënda "Michael Edward Cooke kundër Austrisë"*, Kërkesa Nr. 25878/94, Aktgjykim, 8 shkurt 2000, para. 35, 42, 43.

148 *"Protais Zigiranyirazo kundër Prokurorit"*, TPNR Lënda Nr. 2001-73-AR73, "Vendim për apelimin e ndërkohshëm", 30 tetor 2006, para. 8; *"Slobodan Milošević kundër Prokurorit"*, Lënda Nr. IT-02-54-AR73.7, "Vendim për apelimin e ndërkohshëm të vendimit të Dhomës Gjyqësore për caktimin e avokatit të mbrojtjes," 1 nëntor 2004, para. 11, 13.

149 *"Protais Zigiranyirazo kundër Prokurorit",* TPNR Lënda Nr. 2001-73-AR73, "Vendim për apelimin e ndërkohshëm", 30 tetor 2006, para. 11.

150 Rregulla 80(B), RrPP e TPNJ-së; Shih, për shembull, *Prokurori kundër Ferdinand Nahimana-s, Jean-Bosco Barayagwiza-s dhe Hassan Ngese-s*, Lënda Nr. TPNR 99-52-A); *Prokurori kundër Stanišić-it dhe Simatović-it*, Lënda Nr. IT 03-69.

151 Rregulla 80(B), RrPP e TPNJ-së.

sëmurë dhe jo në gjendje të ndodhet në sallën e gjyqit. Ky dokument për heqjen dorë nga e drejta duhet dorëzuar për t'u futur në procesverbal. Formulari që përdoret për të regjistruar heqjen dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në sallë jepet në Shtojcën 9 *"Formulari i përdorur për të regjistruar heqjen dorë nga një e drejtë"*.

71. Sekretaria e mban shënim mungesën e të akuzuarit në sallë, në procesverbalin e seancës. Në vitin 2006, Sekretaria miratoi një protokoll në të cilin parashikoheshin procedurat që duhen ndjekur kur një i akuzuar në paraburgim deklaron se sëmundja e pengon të ndodhet në sallën e gjyqit. Në rastin kur i akuzuari heq dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit, ai duhet të paraqesë një letër të nënshkruar përmes së cilës heq dorë nga kjo e drejtë dhe i jep leje avokatit të tij të jetë i pranishëm në emër të tij. Formulari ose letra depozitohet në dosjen e lëndës.

72. Kur i akuzuari nuk dëshiron të marrë pjesë në punimet e gjykatës për arsye të tjera, veç sëmundjes, praktika më e mirë është të kërkohet që avokati i mbrojtjes t'i parashtrojë në mënyrë afirmative gjykatës se i akuzuari është informuar më parë për të drejtën e tij për të qenë i pranishëm, por se ka vendosur në mënyrë vullnetare të mos jetë i pranishëm. Dhoma e Apelit e ka trajtuar drejtpërdrejt këtë çështje në lëndën "Prokurori kundër Ferdinand Nahimana-s, Jean-Bosco Barayagwiza-s dhe Hassan Ngese-s".[152] Njëri prej të akuzuarve të kësaj lënde, Barayagwiza, nuk pranoi të merrte pjesë në gjykim prej ditës së parë të tij, më 23 tetor 2000, deri në ditën e fundit më 22 gusht 2003.[153] Dhoma e Apelit arriti në përfundimin se, nëse ky ishte vendimi i vetë të akuzuarit, për të mos e ushtruar të drejtën e tij për të qenë i pranishëm, kjo heqje dorë nga një e drejtë nuk mund të konsiderohej si shkelje nga forumi gjyqësor, e të drejtës së të akuzuarit për të qenë i pranishëm në gjykim. Synimi i qartë i kësaj të drejte është mbrojtja e të akuzuarit nga çdo ndërhyrje e jashtme e cila nuk do ta lejonte të merrte pjesë në mënyrë të efektshme në gjykimin e atij vetë, por nuk mund të konsiderohet se kjo e drejtë është shkelur, nëse vetë i akuzuari ka vendosur në mënyrë vullnetare të mos e ushtrojë.[154]

73. Lindin vështirësi të veçanta nëse ka dy a më shumë të akuzuar të cilët gjykohen bashkërisht, dhe njëri prej të akuzuarve nuk është në gjendje të marrë pjesë në gjykim për shkak të sëmundjes. Në lëndën "Prokurori kundër Stanišić-it dhe Simatović-it",[155] njëri prej të akuzuarve vuante nga një problem me shëndetin, por vendosi të mos heqë dorë nga e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, ndërkohë që paraqiti dëshmi se sëmundja e pengonte të paraqitej përpara trupit gjykues. Në këtë rast, Dhoma Gjyqësore mori vendim ta vazhdojë gjykimin, por duke i dhënë mundësi të akuzuarit ta ndjekë seancën përmes lidhjes me video dhe të jetë në lidhje me telefon me avokatin e tij. Në përgjigje të një apelimi nga ekipi i Mbrojtjes kundër këtij vendimi, Dhoma e Apelit mbajti qëndrimin se "shtyrja e gjykimit mbetet zgjidhja më e mirë nëse do ta respektonte më plotësisht të drejtën themelore të të akuzuarit për të qenë i pranishëm në gjykim".[156] Dhoma e Apelit theksonte se duheshin menduar sa duhet të gjitha alternativat e mundshme. Në këtë rast, kjo përfshinte mundësinë e mbajtjes së lëndës në fazën paragjyqësore edhe tre deri gjashtë muaj të tjerë, për t'i dhënë mundësi të akuzuarit ta merrte veten dhe për të pasur mundësi për të marrë raporte të tjera mjekësore.[157] Po kështu, Dhoma e Apelit e miratoi kërkesën e Mbrojtjes së Jovica Stanišić-it për ta shtyrë

152 *Nahimana e të tjerë kundër Prokurorit*, Lënda Nr. TPNR 99-52-A.
153 *Nahimana e të tjerë kundër Prokurorit*, Lënda Nr. TPNR 99-52-A, para. 95.
154 *Po aty*, para. 107.
155 *Prokurori kundër Stanišić-it dhe Simatović-it*, Lënda Nr. IT 03-69.
156 *Prokurori kundër Stanišić-it dhe Simatović-it*, IT-03-69AR73.2, Vendim për apelimin nga Mbrojtja të vendimin për zhvillimin e ardhshëm të procesit, 16 maj 2008, para. 21.
157 *Prokurori kundër Stanišić-it dhe Simatović-it*, IT-03-69AR73.2, Vendim për apelimin nga Mbrojtja të vendimin për zhvillimin e ardhshëm të procesit, 16 maj 2008, para. 19.

gjykimin për të paktën tre muaj dhe për ta rivlerësuar gjendjen shëndetësore të të akuzuarit përpara se të merrej një vendim për ta filluar apo jo gjykimin.[158]

74. Rastet kur i akuzuari heq dorë nga e drejta e vet apo kur mungon përkohësisht nga gjykimi, nuk duhen ngatërruar me gjykimin në mungesë, në të cilin gjykimi zhvillohet ndërkohë që i akuzuari mungon plotësisht nga të gjitha proceset ose nga një pjesë e tyre. Gjykimet në mungesë nuk parashikohen në regjimin e TPNJ-së, edhe pse njihen në të drejtën ndërkombëtare[159] dhe janë në përputhje me të drejtën për të drejtat e njeriut nëse ndiqen në mënyrë të përpiktë kushtet.[160]

75. Praktika e TPNJ-së ka nënvizuar qartë se e drejta e të akuzuarit për të qenë i pranishëm gjatë procesit gjyqësor është e drejtë themelore dhe se Dhomat duhet të përpiqen ta respektojnë këtë të drejtë duke i konsideruar të gjitha alternativat e arsyeshme. Kjo e drejtë, duhet të drejtpeshohet me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të shpejtë, çka kërkon një baraspeshim të mirë të interesave të përfshira dhe konsideratë të hollësishme të të gjitha alternativave të ndryshme të mundshme.

K. Instrumentet e administrimit të lëndëve

K.1 E-court – Sistemet Elektronike të Administrimit të Dokumenteve

76. Në lëndët e para të saj, TPNJ-ja pa se vështirësitë e hasura në administrimin e vëllimeve të mëdha shkresore, të cilat lindin gjatë proceseve gjyqësore, shkaktonin vonesa dhe joefikasitet në përdorimin e kohës në sallën e gjyqit. Gjykimet e zhvilluara përpara tribunaleve ndërkombëtare kërkojnë, medoemos, vëllime shumë të mëdha dokumentesh, ku përfshihen jo vetëm deklaratat e dëshmitarëve, por edhe shënime të nxjerra nga arkivat e vendeve të përfshira në konflikt. Madje, një lëndë e vetme mund të kërkojë të paktën 10.000 dokumente, në varësi të nevojës për të përdorur prova për kontekstin historik dhe politik të krimeve që mbulon akuza.[161]

77. Aplikacioni në e-court i jep mundësi TPNJ-së të ruajë kopje elektronike të dokumenteve dhe t'ua shpërndajë me lehtësi palëve të nevojshme.[162] Dokumentet e provave të ngarkuara në sistemin elektronik të gjykatës ("e-court"), shpërndahen më pas nga pala që i ngarkon tek palët e tjera dhe Dhoma, përmes "njoftimit" elektronik të dokumenteve. Përpara fillimit të gjykimit, Prokuroria ka detyrimin për t'i ngarkuar të gjitha

158 *Prokurori kundër Stanišić-it dhe Simatović-it, IT-03-69AR73.2, Vendim për apelimin nga Mbrojtja të vendimin për zhvillimin e ardhshëm të procesit, 16 maj 2008, para. 22. Në lëndën "Prokurori kundër Prlić e të tjerë"*, lindi një problem i ngjashëm në lidhje me të akuzuarin Pusić, i cili nuk mori pjesë në seancë për disa javë në vitin 2008. Mirëpo, në këtë rast, ishte vetë i akuzuari i cili hoqi dorë nga e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim.

159 Neni 61(2) i Statutit të Romës për GJPN-në e lejon gjykimin në mungesë në fazën paragjyqësore ndërsa Neni 22 i Statutit të Gjykatës së Posaçme për Libanin e lejon gjykimin në mungesë në çdo fazë, sipas kushteve që rrjedhin nga Gjykatat përkatëse për të Drejtat e Njeriut.

160 Gjykimi në mungesë mund të bjerë ndesh me të drejtat e të akuzuarit për t'u mbrojtur vetë apo përmes një avokati që e zgjedh vetë dhe të drejtën për t'u bërë pyetje dëshmitarëve që dëshmojnë kundër tij, siç e parashikon Neni 14(3)(d) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 8(2)(f) i Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut dhe Neni 6(4)(c) dhe (d) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mirëpo, sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, gjykimet në mungesë janë të pranueshme kur zhvillohen në respektim të të drejtave të të akuzuarit, kur mosparaqitja bëhet përmes heqjes dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim, me kusht që të akuzuarit t'i jenë dhënë garanci të mjaftueshme, duke përfshirë edhe njoftimin e efektshëm për procesin që pritet të zhvillohet dhe për mundësinë e rigjykimit nëse i akuzuari paraqitet pasi është shpallur fajtor (për shembull, "*Krombach kundër Francës*", Aktgjykim, 13 shkurt 2001; *"Sejdovic kundër Italiisë"*, Aktgjykim, 1 mars.2000).

161 Dhomat e kanë zvogëluar disi numrin e madh të dokumenteve në gjykim, përmes teknikës së marrjes së shënimit gjyqësor të fakteve të vendosura në proceset e mëparshme, sikurse trajtohet më lart në rubrikën "Shënimi gjyqësor" (Shih Kreun VII, rubrika H.2: Shënimi gjyqësor).

162 Dokumentet përfshijnë parashtrime, materiale provuese dhe regjistrime të provave joshkresore.

provat materiale në sistemin elektronik të gjykatës. Gjatë procesit gjyqësor, dokumentet e ruajtura në "e-court" i japin mundësi nëpunësit të gjykatës t'i "publikojë" dokumentet në sallën e gjyqit gjatë zhvillimit të seancave. Sistemi elektronik i gjykatës i jep mundësi dëshmitarit të bëjë shënime në dokument, për shembull në një hartë a diagram, gjatë zhvillimit të seancës.[163] Ky sistem e ka lehtësuar administrimin pa probleme të dokumenteve gjatë procesit, si edhe ka mundësuar paraqitjen paralele dhe të njëkohshme të këtyre dokumenteve te të gjitha palët në kohë reale.

78. Ky sistem ofron edhe pika të tjera të forta, në lidhje me përgatitjen dhe përpilimin e provave materiale zyrtare të gjykatës dhe të listave të dëshmitarëve nga ana e nëpunësve gjyqësorë të Sekretarisë. Në një sallë gjyqësore pa sistemin elektronik gjyqësor, nëpunësi gjyqësor i Sekretarisë duhet të mbajë shënim me dorë të gjitha informacionet për dëshmitarët dhe provat materiale, për shembull përshkrimin e dokumentit, statusin, datën e marrjes së dokumentit, etj. Në rastin e sistemit elektronik gjyqësor, palët janë në gjendje të nxjerrin relacionet e tyre dhe ta marrin informacionin në çast. Në mbyllje të lëndës dhe përpara dhënies së gjykimit, listat zyrtare të provave dhe dëshmitarëve, të krijuara në mënyrë elektronike nga Sekretaria ruhen në dosjen e lëndës.

79. Sistemi elektronik gjyqësor i jep mundësi secilës palë të bëjë shënimet e veta në një dokument. Këto shënime elektronike, janë konfidenciale dhe nuk mund të shihen nga palët e tjera. Këto shënime i kanë përdorur Dhomat e ndryshme për të përmirësuar analizën e provave. Instrumentet e kërkimit elektronik mundësojnë kërkimin e titujve të dokumenteve sipas kritereve të ndryshme të kërkimit. Mirëpo, sistemi nuk mund të bëjë kërkime të plota e të besueshme të tekstit të dokumenteve të ngarkuara në sistem. Rrjedhimisht, rëndësi tejet të madhe kanë titujt që u vendosen dokumenteve të ndryshme në sistemin elektronik gjyqësor dhe meta-datat e regjistruara, ndër të tjera në lidhje me datën e krijimit dhe datën e pranimit në provat gjyqësore. Nëse ky informacion nuk është i saktë, atëherë dobia e instrumenteve të kërkimit bie në lidhje me dokumentin në fjalë. Praktika më e mirë në këtë fushë kërkon që palët ta regjistrojnë me saktësi informacionin në lidhje me dokumentin dhe të mbajnë një sistem ku dokumenteve të vendosen tituj të qartë, të saktë dhe informues.

80. Brenda sistemin elektronik gjyqësor, dokumentit i bashkëlidhet edhe përkthimi i tij, të cilit i vendoset lista e dëshmitarëve dhe e dokumenteve që secila palë ia paraqet Gjykatës dhe palëve të tjera. Në disa raste të caktuara, kjo nuk është e mundshme, mirëpo përkthimi duhet bërë kur dokumenti shënohet si dokument që mund të përdoret në lidhje me një dëshmitar dhe duhet të sigurohet përpara se dokumenti të pranohet në provat gjyqësore të lëndës. Në gjykimet me disa të akuzuar dhe me shumë dokumente, kërkesat për përkthim mund ta vonojnë procesin e gjykimit dhe të apelimit. Është e rëndësishme që Dhoma t'i informojë palët për detyrimin që kanë për t'i përkthyer të gjitha materialet të cilat synojnë t'i përdorin me një dëshmitar, përpara se të fillojë dëshmia në sallë e këtij dëshmitari, dhe në përputhje me detyrimet për bërjen të ditur dhe për njoftimin, sipas Rregullores.

81. Kur krijohet një sistem elektronik gjyqësor, është e rëndësishme të sigurohet integrim i plotë me sistemet ekzistuese informatike. Dhomat, Prokuroria dhe Mbrojtja përdorin herë pas here në sallë dokumente në formë të shtypur, sidomos kur bëhet fjalë për dokumente të gjata të cilat u duhen treguar dëshmitarëve. Ekziston mendimi i përbashkët se përdorimi vetëm i një sistemi "pa letër" mund ta pengojë rrjedhën efikase dhe efektive të lëndës dhe se duhen bërë edhe përjashtimet e duhura.

163 Dokumenteve që nxjerrin palët gjatë procesit gjyqësor u vendoset një numër provizor XX, në pritje të skanimit dhe hedhjes së tyre në sistemin elektronik gjyqësor.

82. Një mësim që kemi nxjerrë nga sistemi elektronik gjyqësor është se është e kështillueshme që i gjithë sistemi të konceptohet si elektronik domethënë që nga hetimi deri në fillim të gjykimit. Kjo nuk ishte e mundshme të arrihej në TPNJ gjatë viteve '90, kur programet informatike të Tribunalit ishin ende në fillimet e tyre. Futja në përdorim e sistemit "e-Court" në faza të mëvonshme, pasi Zyra e Prokurorit kishte ecur mjaft përpara me kompjuterizimin e vet, shkaktoi disa vështirësi madje edhe për detyra të tilla të thjeshta siç ishte caktimi i numrave provave materiale. Çdo gjykatë e posaçme e cila fillon punën e saj tani, duhet të shmangë situatën në të cilën sistemet e administrimit të dokumenteve nga prokuroria zhvillohen më vete dhe vetëm më vonë përshtaten me një paketë kompjuterike të gjykatës. Jeta e materialit provues duhet të shikohet nga një qasje tërësore. Është gjithashtu e rëndësishme të kuptohet që sistemi elektronik gjyqësor nuk konceptohet si një paketë për paraqitjen e provave dhe se ka avantazhe nëse lejohet Prokuroria të vazhdojë ta përdorë programin e vet së bashku me produktin e Sekretarisë.

K.2 "E-court" – sistemi i administrimit të procesverbalit gjyqësor

83. Nga mospërdorimi i gjuhës BKS si gjuhë pune e Tribunalit, janë shkaktuar shumë probleme. Për shumë arsye (të qenit tre gjuhë të veçanta—boshnjake, kroatisht, serbisht—vështirësia në gjetjen e stafit që i përdor këto tre gjuhë, etj.) mospërdorimi i BKS-së do të thotë që i akuzuari të mos e ketë tekstin e zbardhur të seancës në një gjuhë që kupton, por ose duhet të përdorë videoregjistrimet ose duhet të presë gjersa të bëhet përkthimi. Në aspekte të tjera, serbokroatishtja është bërë praktikisht gjuhë pune.

Lënda Halilović – Efekti i sistemit elektronik gjyqësor në procesin e hartimit të Aktgjykimit

Pas publikimit të Aktgjykimit në lëndën "Halilović", Dhoma Gjyqësore I i bëri një shqyrtim efektit që sistemi elektronik gjyqësor kishte në procesin e hartimit të aktgjykimit.** Fushat ku kishte ndikim sistemi elektronik gjyqësor qenë:*

*1) **Raporti i nxjerrë nga sistemi elektronik në dallim nga përpilimi i provave dhe dëshmive:***

*Në lëndën "Halilović" u përdorën si raportet e nxjerra nga sistemi elektronik*** ashtu edhe metodat tradicionale të përpilimit të provave dhe dëshmive. Sipas çmuarjeve, në lëndën "Halilović" përdorimi i sistemit elektronik gjyqësor kurseu afërsisht 96 orë pune.*

*2) **Kërkimi në transkriptimet e seancave dhe në provat gjyqësore:***

Kursimet e mëdha të kohës gjatë procesit të hartimit të aktgjykimit, kishin të bënin me mundësinë për të kërkuar dhe krahasuar provat materiale dhe pasazhet në procesverbalin gjyqësor.

*3) **Verifikimi i poshtëshënimeve:***

Përdorimi i sistemit elektronik gjyqësor kurseu kohë përmes përmirësimit të integritetit të poshtëshënimeve. Për më tepër, sistemi elektronik gjyqësor ua lehtësoi shumë punën anëtarëve të ekipit, gjatë leximit të draftit, për ta kontrolluar me shpejtësi informacionin që përmbante drafti.

*4) **Vlerësimi i përgjithshëm:***

Siç ndodh me të gjitha lëndët e tjera gjyqësore, puna me rubrikat mbi ligjin dhe mbi faktet, në aktgjykimin e lëndës "Halilović" filloi përpara mbylljes së gjykimit të lëndës. Mirëpo, procesi faktik i hartimit të aktgjykimit, në të cilin gjyqtarët diskutojnë për provat dhe dëshmitë dhe japin udhëzime për draftin, kërkuan diçka më shumë se dy muaj (9,5 javë).

INë krahasim me lëndën e tjera të ngjashme, në të cilat nuk është përdorur sistemi elektronik gjyqësor, hartimi i aktgjykimit prej 285 faqesh përfundoi shumë më shpejt, duke kursyer afro 40% të kohës.

* Prokurori kundër Sefer Halilović-it, Lënda Nr. it-01-48, Aktgjykim, 16 nëntor 2005.

** Një vlerësim i ndikimit që ka sistemi elektronik gjyqësor mbi zhvillimin e gjykimit është bërë edhe nga Sektori i Administrimit dhe Mbështetjes Gjyqësore, i cili është publikuar në muajin qershor 2005.

*** "Raportet e nxjerra nga sistemi elektronik" janë përmbledhje të pjesëve të ndryshme të dëshmive dhe provave shkresore që janë shënuar në mënyrë elektronike për çështje të paracaktuara, të cilat zakonisht kanë lidhje me vendet, personat dhe temat që lidhen me aktgjykimin.

84. Sasia e madhe e dëshmive të dëshmitarëve, të paraqitura gjatë zhvillimit të gjykimit, mund të shkaktojë vonesa dhe mungesë të efikasitetit në përdorimin e kohës së gjykatës. Ndonjëherë, lëndët mund të kërkojnë paraqitjen e qindra dëshmitarëve. Për ta

administruar në mënyrë më të efektshme numrin e madh të tekstit të zbardhur të dëshmive të dëshmitarëve në të gjitha lëndët, TPNJ-ja filloi përdorimin e një aplikacioni të administrimit elektronik të procesverbaleve, përmes të cilit i regjistron, i ruan dhe i përdor procesverbalet e dëshmive të dëshmitarëve gjatë gjithë procesit të gjykimit dhe apelimit.

85. Përdorimi i procesverbaleve elektronike mundëson regjistrimin dhe paraqitjen e dëshmisë së dëshmitarit në kohë reale. Kjo u jep mundësi pjesëmarrësve të sallë ta shohin të shkruar dëshminë që dëshmitari jep gojarisht, në monitorët e tyre, ndërkohë që dëshmia është duke u dhënë. Përdoruesi mund ta ndalojë rrjedhën e tekstit në monitor dhe të kthehet mbrapa në kohë në procesverbal për të parë pyetjet dhe përgjigjet e mëparshme gjatë seancës.

86. Ky sistem i jep mundësi secilës palë të bëjë shënime të veçanta të vetat në versionet e tyre të procesverbalit. Këto shënime elektronike, të cilat janë të fshehta dhe nuk mund të shihen nga të tjerët, i kanë përdorur disa Dhoma për të përmirësuar analizën e provave dhe dëshmive. Aplikacioni përmban një sërë instrumentesh kërkimi elektronik të cilat mundësojnë kërkimin elektronik të titujve të dokumenteve sipas kritereve të ndryshme të kërkimit. Ky sistem mund të përdoret, si në sallën e gjyqit, ashtu edhe nga larg, nga kompjuteri i përdoruesit (shih kutinë *"Lënda Halilović – Efekti i sistemit elektronik gjyqësor në procesin e hartimit të Aktgjykimit"*).

87. Nëse gjykata të tjera të posaçme vënë në zbatim një sistem të administrimit elektronik të dokumenteve, vendimi për ta bërë një gjë të tillë duhet marrë sa më herët në proces, në mënyrë që të mund të fillojnë sa më shpejt aktivitetet e mëposhtme:

- standardizimi i proceseve dhe formateve për kapjen e përmbajtjes së dokumentit dhe për ruajtjen dhe paraqitjen e tyre,
- njoftimi i palëve të gjykimeve të ardhshme se duhet t'i përgatisin provat sipas formës së duhur elektronike,
- prokurimi dhe instalimi i pajisjeve të nevojshme në sallën e gjyqit,
- përpilimi dhe miratimi i protokolleve dhe udhëzimeve praktike për zbatimin teknologjik (mungesa e udhëzimeve praktike dhe e protokolleve ishte një burim vështirësie që në fillim në TPNJ), dhe
- parashikimi dhe zbatimi i programeve të duhura të trajnimit.

88. Po ashtu rekomandohet që të caktohet një menaxher projekti për të mbikëqyrur vënien në zbatim të sistemit elektronik dhe që këtij menaxheri t'i jepen burime të mjaftueshme dhe mbështetje nga nivelet e larta (Prokuroria, Mbrojtja, Dhomat dhe Sekretaria) në mënyrë që të jetë në gjendje ta përmbushë mandatin e vet. Kjo strategji mund të kërkojë që gjykata t'u japë mbështetje ekipeve të prokurorisë dhe mbrojtjes në mënyrë që këto të mund ta marrin formatin e provave si duhet dhe në kohë. Kjo ka sidomos rëndësi për një lëndë të madhe, ku numri i dokumenteve mund të jetë shumë i madh.

L. Lëndët me disa të akuzuar

89. Praktika e mirë prokurore dhe gjyqësore e do që personat e akuzuar për të njëjtat krime të gjykohen bashkërisht. Në këtë aspekt, strategjia që ka ndjekur Tribunali në vitin 2006 për të bashkuar në gjykim disa të akuzuar ka kursyer ndjeshëm kohë dhe e ka rritur efikasitetin. Mes gjykimeve me disa të akuzuar, ka pasur të

paktën tri gjykime me gjashtë a më shumë të akuzuar.[164] Lëndët e tjera me disa të akuzuar kanë pasur dy, tre ose katër të akuzuar të akuzuar dhe gjykuar së bashku.

90. Vendimi për t'i bashkuar në gjykim të akuzuarit, rregullohet nga Rregulla 48 e RrPP-së, e cila parashikon:

> *Personat e akuzuar për të njëjtin krim apo për krime të ndryshme të kryera gjatë të njëjtës veprimtari, mund të akuzohen dhe të gjykohen bashkërisht*.

91. Në rubrikat në vijim evidentohen një sërë çështjesh që duhen konsideruar gjatë administrimit të një gjykimi me bashkim të akuzuarish.

L.1 Shqyrtimi i kujdesshëm i aktakuzës

92. Përpara se të vendoset se bashkimi i disa të akuzuarve në një gjykim të vetëm do ta ndihmonte procesin, Dhoma duhet t'i shqyrtojë me kujdes aktakuzat për të akuzuarit e ndryshëm. Kur merr vendimin për bashkimin e të akuzuarve, Dhoma duhet të shohë me kujdes nëse të akuzuarit mund të thirren si dëshmitarë për një të akuzuar tjetër. Gjatë këtij konstatimi, është e rëndësishme të vendoset një drejtpeshim midis ekonomisë gjyqësore që do të arrihet nga bashkimi dhe të drejtës së ka secili i akuzuar për një gjykim të drejtë.

93. Një arsye për ta shqyrtuar me kujdes aktakuzën, është se Rregulla 82 germa "A" në mënyrë specifike garanton që "çdo të akuzuari i akordohen të drejta të njëjta sikur të akuzuarit të gjykoheshin veças". Ky rregull paraqet sidomos vështirësi në zbatim. Çdo i akuzuar e ka mundësinë që të thërrasë një tjetër të akuzuar me të cilin akuzohet bashkërisht, si dëshmitar shfajësues nëse gjykohen veçmas. Kur të akuzuarit gjykohen së bashku, e drejta për të thirrur si dëshmitar të tjerët që gjykohen me ta mund të kufizohet, duke qenë se edhe këta persona të tjerë gëzojnë të drejtën të mos flasin, pra nuk mund të detyrohen të dëshmojnë si dëshmitarë përpara trupit gjykues.[165]

L.2 Trajtimi i deklaratave të personave të dyshuar

94. Në lëndët me gjykim të përbashkët "Milutinović",[166] "Prlić"[167] dhe "Popović",[168] Dhomave Gjyqësore u është dashur të vendosin nëse duhet t'i pranonin apo jo deklaratat e bëra nga një i akuzuar dhe nëse ishin apo jo të pranueshme në provat gjyqësore kundrejt të akuzuarve të tjerë në të njëjtën lëndë këto deklarata.

95. Në lëndën "Prlić", Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se deklarata e të akuzuarit Jadranko Prlić, e marrë në përputhje me kriteret e Rregullës 42 dhe 43 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (ku mbrohen të drejtat e personave të dyshuar), "mund të pranohet në provat gjyqësore dhe të përdoret pa pasur nevojë për kundërpyetje edhe pse bën fjalë veprat dhe sjelljen e bashkë-të-akuzuarit".[169] Dhoma e Apelit e la më pas në fuqi këtë vendim.[170]

---

164 Këtu përfshihen lëndët "*Prokurori kundër Popović-it dhe të tjerëve*", "*Prokurori kundër Milutinović-it dhe të tjerëve*" dhe "*Prokurori kundër Prlić-it dhe të tjerëve*",

165 Shembull është procedura sipas Rregullës 90(E), në të cilën i akuzuari nga një gjykim tjetër ose dikush për të cilin mendohet të fillohet ndjekje penale mund të detyrohet nga një Dhomë të japë dëshmi me kusht që dëshmia e nxjerrë në këtë mënyrë nuk përdoret si provë në asnjë proces penal të mëvonshëm kundër dëshmitarit në fjalë.

166 *Prokurori kundër Milutnović-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT -05-87.

167 *Prokurori kundër Prlić-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74.

168 *Prokurori kundër Popović-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. it-05-88.

169 *Prokurori kundër Prlić-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74, "Vendim për kërkesën pranimin e deklaratës së Jadranko Prlić-it", 22 gusht 2007.

170 *Prokurori kundër Prlić-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.6, "Vendim për apelimin e vendimit për pranimin në provat gjyqësore, të procesverbalit të marrjes në pyetje të Jandranko Prlić-it", 23 nëntor 2007.

96. Lënda "Milutinović" dëshmoi se përdorimin e lejueshëm të deklaratës së një të akuzuari tjetër në të njëjtin gjykim do ta përcaktonte korniza e gjykimit. Dhoma Gjyqësore nuk e zgjidhi këtë çështje përpara mbylljes së paraqitjes së lëndës nga Prokuroria. Mirëpo, Prokuroria pranoi, përpara mbylljes së paraqitjes së lëndës së saj, që të mos kërkojë përdorimin e dëshmive të të akuzuarve kundër njëri-tjetrit.[171] Pas vendimit në lëndën "Prlić", Prokuroria kërkoi ta ndryshojë qëndrimin e saj lidhur me këtë çështje, duke përfituar nga interpretimi më i favorshëm që i kishte bërë Dhoma e Apelit këtij rregulli. Dhoma nuk e lejoi Prokurorinë ta ndryshojë qëndrimin e saj, duke arritur në konstatimin se Mbrojtja ishte mbështetur në mënyrë të arsyeshme në qëndrimin e gjeratëhershëm të Prokurorisë.[172]

97. Sa më lart nënvizon një çështje të praktikës së mirë për gjykatat që gjykojnë lëndë me disa të akuzuar. Këshillohet që të shihet që në një fazë të hershme të gjykimit nëse ka apo ajo deklarata të bashkë-akuzuarve dhe, nëse po, se si do të përdoret ky informacion gjatë gjykimit nga Dhoma.

L.3 Paraqitja e provave dhe dëshmive nga Mbrojtja

98. Një problem me rëndësi, të cilit duhet t'i japë zgjidhje Dhoma që herët në proces, ka të bëjë me kohën që i jepet secilit të akuzuar për të paraqitur provat dhe dëshmitë. Praktika e zakonshme e Tribunalit ka qenë që të akuzuarit i është dhënë e drejta të shfrytëzojë të njëjtën kohëzgjatje për paraqitjen e mbrojtjes sa i është dhënë edhe prokurorisë. Mirëpo, kur gjashtë a shtatë të akuzuar gjykohen bashkërisht, Mbrojtja nuk duhet të marrë sa gjashtë a shtatë herë më shumë se pjesa e prokurorisë.

99. Në përgjithësi, Tribunali e ka zgjidhur problemin e kohës duke vendosur kohëzgjatjen gjithsej të pjesës së Prokurorisë dhe pastaj duke e pjesëtuar në mënyrë të barabartë këtë kohë mes të akuzuarve që gjykohen bashkërisht.[173] Por, kjo qasje është kritikuar.[174] Sikurse thuhet më lart, Rregullorja i jep të akuzuarit të njëjta të drejta sikur të gjykohej veçmas. Për pasojë, praktika e ndarjes së kohës për paraqitjen e mbrojtjes mes disa të akuzuarve, mund të konsiderohet se nuk arrin t'i garantojë secilit të akuzuar të njëjtat të drejta që do të kishte sikur të gjykohej veçmas.

100. Është e rëndësishme që Dhoma Gjyqësore të mos ndjehet veçanërisht e detyruar t'i japë Mbrojtjes të njëjtën kohë me të Prokurorisë. Për të siguruar një gjykim të drejtë, Dhoma duhet të vlerësojë me kujdes sa kohë i duhet Mbrojtjes për të paraqitur provat e veta. Po kështu, kur merr vendim për kohën që i cakton Mbrojtjes, Dhoma duhet të konsiderojë me kujdes provat e propozuara të paraqitura në parashtrimet për listat e provave dhe të dëshmitarëve,[175] dhe t'ia caktojë kohën Mbrojtjes për provat e saj në bazë të parimeve të gjykimit të drejtë dhe të shpejtë.

L.4 Marrja në pyetje e dëshmitarit

101. Një sfidë tjetër që i paraqet Dhomës Gjyqësore lënda me disa të akuzuar, është se si ta trajtojë paraqitjen e provave dhe dëshmive nga Mbrojtja. Në disa raste, të akuzuarit mund të punojnë në bashkëpunim për paraqitjen e provave dhe dëshmive të Mbrojtjes. Mirëpo, jo gjithmonë Avokati i Mbrojtjes e njofton Dhomën

171 *Prokurori kundër Milutinović-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Vendim për përdorimin e intervistave që ka bërë me të akuzuarit Prokuroria, 20 mars 2008, para. 6.

172 *Prokurori kundër Milutinović-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Vendim për përdorimin e intervistave që ka bërë me të akuzuarit Prokuroria, 20 mars 2008, para. 9.

173 Shih, për shembull, *Prokurori kundër Milutinović dhe të tjerë*, Lënda Nr. it-05-87-t, vendim verbal, T. T. 12821-12848 (22 qershor 2007). *Prokurori kundër Milutinović-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Mocion i Pavković-it për veçim të pjesshëm, 31 gusht 2007

174 *Prokurori kundër Prlić-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-T, Vendim për ndryshimin e rendit të ditës për konferencën përpara Mbrojtjes të datës 21 prill 2008, 13 prill 2008.; *Prokurori kundër Prlić-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-74-T, Mocion i Jadranko Prlić-it për veçim të lëndës, 19 qershor 2007.

175 Këto lista depozitohen sipas Rregullës 65*ter* (G), RrPP e TPNJ-së.

për një punë të tillë të përbashkët. Kjo merr rëndësi, sa i takon mënyrës dhe rendit të pyetjes së dëshmitarëve. Për shembull, në përgjithësi rregulli i kërkon që kur i bën pyetje dëshmitarit pala që e ka thirrur dëshmitarin të bëjë pyetje jo-orientuese gjatë pyetjeve kryesore. Për më tepër, në lëndën me disa të akuzuar, do t'i ishte mirë për Dhomën Gjyqësore që ajo të ishte në dijeni nëse dëshmitarët që thërret pala janë apo jo dëshmitarë të përbashkët. Me këtë dijeni në dorë, Dhoma do të ishte në gjendje ta drejtonte si duhet mënyrën dhe rendin e marrjes në pyetje të dëshmitarit. Për shembull, dy prej gjashtë të akuzuarve mund të duan të paraqesin së bashku dëshminë e një dëshmitari. Këta dy dëshmitarë do t'i bënin pyetjet kryesore dëshmitarit, pas të cilave do të vinin kundërpyetjet nga katër të akuzuarit e tjerë si edhe kundërpyetjet nga Prokuroria.

102. Kjo çështje ngre shqetësime me rëndësi, sa i takon vlerësimit të besueshmërisë. Nëse një ekipi mbrojtës, që nuk e ka thirrur dëshmitarin, i lejohet ta orientojë dëshmitarin e mbrojtjes të paraqesë dëshmi të favorshme për një të akuzuar tjetër, kjo procedurë do të ngrinte pikëpyetje mbi drejtësinë si edhe mbi besueshmërinë, çka do të ndikonte në vendimet thelbësore të Dhomës në mënyrë jo të duhur.

103. Rregullorja e Procedurës dhe Provave, e cila është mbështetur në të drejtën civile (kontinentale evropiane) duke ruajtur një sistem përgjithësisht si ai anglosakson, e përmend disa herë konceptin e "kundërpyetjeve". Mirëpo, ky koncept nuk është përkufizuar qartë në Rregullore. Për rrjedhojë, gjyqtarët e Tribunalit kanë shpenzuar sasi të madhe kohe për të zgjidhur kuptimin e termit "kundërpyetje". Modeli me dy palë kundërshtare në të drejtën anglosaksone vendos kufizime mbi formën e marrjes në pyetje. Pra, në të drejtën anglosaksone, pyetjet orientuese mund të përdoren vetëm si pjesë e kundërpyetjeve, ose kur dëshmitari është shpallur "armiqësor" për palën që e ka thirrur dëshmitarin, si edhe në rrethana të tjera të kufizuara.[176]

M. Vizitat në terren dhe seancat jashtë selisë së Tribunalit

104. Rregulla 4 thotë se "Një Dhomë mund të ushtrojë funksionet e saj në një vend jashtë selisë së Tribunalit, nëse për hir të interesave të drejtësisë, Kryetari jep autorizimin". Kjo dispozitë përbën bazën mbi të cilën Dhomat vendosin për vizitat në terren si edhe për seancat gjyqësore jashtë selisë së Tribunalit, e cila ndodhet në Hagë.

M.1 Vizitat në terren

105. Vizitat e para në terren janë organizuar në kuadër të lëndës "Brđanin"[177] në muajin mars 2004. Prej atëherë, një sërë Dhomash Gjyqësore e kanë konsideruar të dobishëm organizimin e vizitave në terren për t'u njohur me vendet e përmendura në aktakuzat përkatëse, pra për t'i dhënë mundësi vetes të njihen më mirë me terrenin dhe karakteristikat e tjera. Vizitat në terren janë misione të cilat nuk konstatojnë fakte dhe gjatë të cilave nuk mblidhen prova. Shënimet e mëposhtme janë përpiluar pas vëzhgimit dhe pjesëmarrjes në vizitat në terren në lëndët "Brđanin",[178] "Orić",[179] "Popović",[180] "Hadžihasanović dhe Kubura"[181] dhe "Prlić".[182]

176 Shih, për shembull, procesverbalin në lëndën "*Prokurori kundër Prlić-it dhe të tjerëve*", Lënda Nr. IT-04-74.
177 *Prokurori kundër Radoslav Brđanin-it*, Lënda Nr. it-99-36.
178 Po aty.
179 *Prokurori kundër Orić-it*, Lënda Nr. IT-03-68.
180 *Prokurori kundër Popović-it dhe të tjerëve*, Lënda Nr. it-05-88.
181 *Prokurori kundër Enver Hadžihasanović-it dhe Amir Kubura-s*, Lënda Nr. IT-01-47.
182 *Prokurori kundër Prlić-it*, Lënda Nr. IT-04-74.

M.1.1 Hapat që duhen marrë përpara vizitës

106. Përgatitja e një vizite në terren është një proces i gjatë i cili kërkon pjesëmarrjen e sektorëve të ndryshëm të Tribunalit, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e Tribunalit në terren dhe autoritetet e brendshme. Për shkak të punës dhe shpenzimeve që kërkon organizimi i një vizite në terren, gjykata duhet të shikojë me kujdes nëse vizita është apo jo me përfitim të mjaftueshëm për gjykimin. Nëse vizita konsiderohet se ia vlen të bëhet, gjykata duhet të konsiderojë se si mund të realizohet me sukses. Në një situatë ideale, përgatitjet duhet të fillojnë më shumë se katër muaj përpara datës së nisjes.

107. Vizita mund të zhvillohet në çdo fazë të gjykimit. Por, nëse vizita bëhet pas dëgjimit të provave dhe dëshmive, gjyqtarët mund ta kuptojnë më mirë terrenin dhe mund ta krahasojnë me më shumë efikasitet dëshminë e dëshmitarit me realitetin që gjejnë në terren. Nga ana tjetër, zhvillimi i një vizite në terren në fillim të gjykimit u jep mundësi gjyqtarëve të njihen me rajonin dhe të krijojnë një marrëdhënie pune me palët, përmes kontaktit me përfaqësuesit e palëve të cilët marrin pjesë në vizitën në terren.

108. Hapi i parë i organizimit të vizitës në terren është të informohet Sekretari se Dhoma Gjyqësore dëshiron të kryejë një vizitë dhe t'i kërkohet të shikojë nëse mund të sigurohen apo jo fondet e nevojshme. Nëse mund të gjenden fondet e nevojshme, nëpunësi ligjor i Dhomës duhet të kontaktojë Shefin e Departamentit të Sigurimit të Sekretarisë, për t'i kërkuar kryerjen e një vlerësimi të sigurisë të pikave që do të vizitohen. Në varësi të vendndodhjes së këtyre pikave, Shefi i Sigurimit lidhet me partnerë të ndryshëm vendorë dhe shikon rrethana të tilla si rruga që do të ndiqet, situata politike dhe, madje, edhe moti. Vetëm pasi merret një "dritë e gjelbër" e përkohshme nga departamenti i sigurimit, mund të vazhdojë kryerja e përgatitjeve.

109. Këshillohet që gjykata të konsultohet me Prokurorinë dhe me Mbrojtjen, për të përcaktuar pikat që do të vizitohen. Zakonisht itinerari përkon me vendngjarjet e krimeve të përmendura në aktakuzë. Por, pas konsultimit me palët, Dhomat Gjyqësore kanë përfshirë edhe vendndodhje të cilat Mbrojtja i ka konsideruar si të lidhura me argumentet e saj. Mund të lindë nevoja për të marrë leje nga autoritetet e brendshme për të hyrë në ndërtesa të caktuara. Pasi merr njoftim paraprak të mjaftueshëm, nëpunësi ligjor duhet t'u dërgojë në emër të Dhomës institucioneve të brendshme, kërkesa për asistencë.

110. Pastaj, palët duhet të bien dakord për një protokoll për vizitat në terren. Duke qenë se vizita në terren nuk është as mision për konstatimin e fakteve, e as zgjatim i procesit gjyqësor, palët duhet të bien dakord të mos i bëjnë asnjë parashtrim Dhomës Gjyqësore gjatë vizitës, nëse këtë nuk ua kërkon Dhoma. Edhe në këtë rast, çdo parashtrim i palëve mbahet shënim. Për shembull, protokolli i vizitës në terren mund të kishte një formulim të tillë:

111. Protokoll: 1. Udhërrëfyesi tregon vetëm vendndodhjet gjeografike, pa dhënë asnjë shpjegim në lidhje me ngjarjet që pretendohet të kenë ndodhur në këto vendngjarje. 2. Gjatë vizitës në terren, as Prokuroria e as Mbrojtja nuk parashtrojnë asnjë qëndrim në lidhje me informacionet shtesë nga terreni, nuk ofrojnë asnjë këshillim apo opinion e as nuk bëjnë asnjë parashtrim, nëse një gjë të tillë nuk ua kërkojnë Gjyqtarët.

112. Gjatë organizimit të vizitës në terren, nëpunësi ligjor i Dhomës duhet të lidhet me njësitë e tjera të Tribunalit, duke përfshirë Njësinë për Udhëtimet dhe Vizat, Njësinë e Financës, Njësinë e Sigurimit dhe Sektorin e Shërbimeve Gjuhësore të Gjykatës, të cilat janë të gjitha në vartësi të Sekretarisë, si edhe me Palët, për t'u kujdesur për trajtimin e të gjitha çështjeve administrative dhe logjistike (bileta fluturimi, organizim i qëndrimit në hotel, kryerje e testit "sigurimi në terren" nga ana e gjyqtarëve dhe punonjësve që do të marrin pjesë në mision, përgatitja e lejes së kalimit dhe vizat për avokatët e mbrojtjes). Nëpunësi ligjor, ose Prokuroria me pëlqimin e Mbrojtjes, u jep Gjyqtarëve edhe një dosje me informacion për të gjitha vendet që do të vizitohen (duke përcaktuar, ndër të tjera, krimet që pretendohet se kanë ndodhur në një

vend, si edhe fotot që janë propozuar ose do të propozohen të pranohen në provat gjyqësore). Një ose dy javë përpara vizitës, udhërrëfyesi (ose, nëse nuk është arritur një marrëveshje për një udhërrëfyes të vetëm, udhërrëfyesi i Prokurorisë dhe udhërrëfyesi i përbashkët i Mbrojtjes) dhe personeli i sigurimit bëjnë një ekspeditë zbulimi në vendet që do të vizitohen. Rrjedhimisht, për arsye sigurimi, mund të dalë nevoja që itinerari të ndryshojë, edhe në minutën e fundit.

M.1.2 Pjesëmarrësit

113. Zakonisht, Prokurorinë e përfaqëson në vizitat në terren të paktën një prokuror që paraqet lëndën e prokurorisë në gjykim, secili i akuzuar përfaqësohet nga një avokat apo avokat i përbashkët dhe secila palë dërgon të paktën një hetues i cili e njeh rajonin dhe mund ta ndihmojë Dhomën si udhërrëfyes për zbulimin e pikave që do të vizitohen.

114. Është e rëndësishme prania e një përfaqësuesi të Sekretarisë, si drejtues i vizitës dhe si mbajtës i procesverbalit.

115. Pasi vendoset itinerari, Dhoma duhet t'u kërkojë palëve të përgatisin materialet që do ta ndihmojnë gjatë vizitës Dhomën. Është mirë që këto materiale të organizohen sipas vendndodhjeve dhe në to të ketë edhe harta, pasazhe përkatëse të aktakuzës dhe, sa mundet, në to bëhet edhe lidhja me provat dhe dëshmitë që i janë paraqitur gjer në atë moment Dhomës.

M.1.3 Organizimi gjatë vizitës

116. Nëpunësi ligjor i Dhomës duhet të sigurohet që të ketë edhe një kompjuter portativ, i cili të ketë qasje në diskun ruajtës të përbashkët, ku të mbahen procesverbalet dhe materialet e tjera me rëndësi, të nevojshme për përfundimin me sukses të vizitës. Kompjuteri portativ duhet të mbajë edhe materialet e tjera që mund të jenë të nevojshme gjatë vizitës, si harta dhe foto.

117. Gjatë vizitës, përgjegjës për organizimin është "udhërrëfyesi", në bashkëpunim me personelin e sigurimit. Është e rëndësishme që të gjithë pjesëmarrësit të shkojnë pas personelit të sigurimit dhe të zbatojnë çdo udhëzim që u jepet.

M.1.4 Raportimi pas vizitës, në selinë e Tribunalit

118. Në seancën e parë gjyqësore pas vizitës, Dhoma duhet të lexojë një deklaratë të shkurtër verbale, ku të jenë të shprehura si më poshtë:
   - që është respektuar protokolli,
   - një përmbledhje e shkurtër e vendeve të vizituara.

119. Në emër të Gjyqtarëve, u dërgohen letra falënderimi nëpunësit ligjor, autoriteteve të brendshme dhe atyre ndërkombëtare, që kanë bashkëpunuar në organizimin e përbashkët të vizitës.

M.2 Seancat jashtë selisë së Tribunalit

120. Për të siguruar realizueshmërinë përpara konfirmimit të udhëtimit, të gjithë hapat e parë përpara nisjes duhet të fillojnë përpara depozitimit zyrtar të vendimit të Dhomës Gjyqësore sipas Rregullës 4. Hapat e mëpasshëm duhet të ndiqen për të siguruar që seanca gjyqësore në distancë të jetë e suksesshme.

M.2.1 Kontakti i parë me gjykatën e huaj

121. Kontakti i parë duhet bërë me organin e ngjashëm me Sekretarinë, pranë gjykatës së huaj, nga nëpunësi gjyqësor ("nëpunësi i sekretarisë") i Sektorit të Administrimit dhe Shërbimeve të Gjykatës (CMSS), i cili bën një vizitë paraprake në mjedisin e propozuar për seancën gjyqësore. Vlerësimi i kapaciteteve të gjykatës së huaj duhet të përfshijë disa çështje. Së pari, duhet diskutuar për kalendarin e gjykatës së huaj dhe a është në dispozicion, me qëllim gjetjen e një date të përshtatshme për gjykatën ku do të mbahet seanca, e cila do të mundësonte zhvillim të shpejtë të procesit të Tribunalit. Duhen parë çështjet e sigurimit, në bashkëpunim me nëpunësit dhe punonjësit e sigurimit të gjykatës së huaj, për të siguruar që juridiksioni i huaj të ketë mundësi t'i ruajë anëtarët e Tribunalit dhe për të evidentuar çdo problem të mundshëm të sigurimit i cili duhet parë nga ana e Tribunalit.

122. I akuzuari ka të drejtë të jetë i pranishëm në të gjithë gjykimin, kështu që zakonisht Sekretarisë i duhet të organizojë transferimin, mbajtjen në paraburgim dhe praninë e tij në seancat e zhvilluara në vendin e huaj, nëse i akuzuari nuk heq dorë nga kjo e drejtë e tij. Pra, nëse i akuzuari dëshiron të marrë pjesë në seancat jashtë Tribunalit, duhet diskutuar me gjykatën e huaj për çështjet e qëndrimit të tij në paraburgim. Në këtë diskutim duhet folur me organin e ngjashëm me Sekretarinë, pranë gjykatës së huaj, për të siguruar plotësimin e nevojave të të akuzuarit për ushqim dhe shërbim mjekësor, gjatë kohës që do të ndodhet në juridiksionin e huaj.

123. Nëpunësi i Sekretarisë duhet të shikojë edhe nëse do të jetë apo jo e mundshme që punonjësit e gjykatës së huaj të luajnë rolin e stenografit, përkthyesit (sipas gjuhëve zyrtare të Tribunalit) dhe nëse gjykata mund të ofrojë edhe personel tjetër mbështetës sipas nevojës. Nëse gjykata e huaj ka punonjës të kualifikuar të cilët mund t'i kryejnë këto detyra, nga familjariteti i tyre me sallën e gjyqit dhe lehtësia logjistike e përdorimit të personelit mbështetës vendas do të përfitonte shumë zhvillimi i shpejtë dhe me sukses i seancës jashtë Tribunalit.

124. Dhe në fund, duhet parë realizueshmëria teknologjike e zhvillimit të seancës së Tribunalit në sallën e propozuar nga juridiksioni i huaj. Kërkesat e veçanta të Tribunalit për teknologji audio, video, përkthimi dhe teknologji të tjera nuk mund të plotësohen nga çdo juridiksion i huaj.

M.2.2 Mbledhja e aktorëve të Sekretarisë

125. Pasi nëpunësi i Sekretarisë ka diskutuar për çështjet përkatëse me punonjësit e juridiksionit të huaj, duhet zhvilluar një mbledhje me të gjithë sektorët përkatës të Tribunalit, duke përfshirë edhe përfaqësuesit nga Sektori i Sigurimit, Sektori i Viktimave dhe Dëshmitarëve, Sektori i Shërbimeve Gjuhësore dhe Konferencave (SShKGj), Shërbimet Mbështetëse të Teknologjisë Informative/Audio-vizuale (ITSS/AV), dhe Zyrës për Ndihmë Ligjore dhe Çështje të Paraburgimit (OLAD), për të vendosur për çështjet logjistike të seancës jashtë selisë së Tribunalit. Nëpunësi i Sekretarisë raporton për atë që ka mësuar nga përfaqësuesit e juridiksionit të huaj dhe koordinon kanalet e komunikimit ndërmjet secilit sektor të Sekretarisë dhe organit të ngjashëm me to pranë gjykatës së huaj, për të siguruar një përmbushje pa probleme të përgjegjësive të secilit sektor.

M.2.3 Mbledhja përpara nisjes

126. Pasi Sekretaria i ka kryer përgatitjet e para në bashkëpunim me gjykatën e huaj, duhet bërë një mbledhje përpara nisjes, e thirrur nga nëpunësi i Sekretarisë, me përfaqësuesit e Dhomave dhe të palëve. Qëllimi i kësaj mbledhjeje, është të diskutohet për planet lidhur me seancën e parashikuar nga Rregulla 4 dhe çdo çështje që mund të lindë gjatë procesit. Në mbledhje duhet folur edhe për çdo provë që do të prezantohet

ose përdoret në seancën jashtë selisë së Tribunalit. Pas pranimit në provat gjyqësore, ato i kalojnë nëpunësit të Sekretarisë.

M.2.4 Telekonferenca e përbashkët ndërmjet Sekretarisë dhe gjykatës së huaj

127. Në fund, duhet zhvilluar një telekonferencë ose mbledhje me përfaqësuesit e Sigurimit, SMSS-së dhe ITSS/AV-së të Tribunalit dhe me homologët e tyre pranë juridiksionit të huaj për të siguruar se janë kryer të gjitha përgatitjet dhe se seanca do të zhvillohet pa probleme.

M.2.5 Shkëmbimi i letrave dhe përgatitjet përfundimtare

128. Pasi kanë përfunduar të gjitha diskutimet dhe masat paraprake për organizimin e seancës, Kryetari dhe gjykata e huaj bëjnë një shkëmbim zyrtar të letrave përmes të cilave autorizohet gjykata a huaj për pritjen e seancës së Tribunalit.

M.2.6 Hapat përpara nisjes

129. Nëpunësi i Sekretarisë së bashku me Dhomat duhet të punojë me Njësinë e Udhëtimit të Tribunalit për të organizuar udhëtimin për të gjitha palët që do të shkojnë në juridiksionin e huaj. Nëpunësi i Sekretarisë është përgjegjës për shtypjen e të gjitha materialeve të nevojshme të gjykimit, duke përfshirë listat e dëshmitarëve të mbrojtur, procesverbalet dhe shënimet e sistemit “e-court”. Nëpunësi i Sekretarisë duhet të kujdeset edhe që të ketë një numër të mjaftueshëm kopjesh të shtypura të dokumenteve për përkthyesit me gojë, gjyqtarët, personelin juridik të Dhomave dhe Sekretarinë, dhe të kujdeset për përgatitjen dhe transportimin e togave të gjyqtarëve, flamurit të OKB-së (i cili ka të ngjarë të vendoset në krah të flamurit të shtetit ku ndodhet gjykata e huaj) dhe çdo material tjetër i nevojshëm për procesin gjyqësor.

VIII. Shtojca 7: Rekomandimet e SVD-së për përgatitjen e dëshmitarëve

Caktimi i kohës për përgatitjen

- *Është e ditur mirë në jurisprudencën e TPNJ-së që disa krime të caktuara kanë kritere chapeau , të cilat duhen provuar krahas elementeve të krimit bazë. Këto janë:*
  - *Nëse përgatitja është medoemos e nevojshme ditën e mbërritjes së dëshmitarit, atëherë duhet të bëhet jo më parë se katër orë pas mbërritjes së dëshmitarit në hotel dhe pas ngrënies së një vakti ushqimi, për të siguruar që kjo përvojë të mos e dëmtojë dëshmitarin dhe të përjetohet si ngjarje pozitive.*
  - *Kohëzgjatja e përgatitjes në një ditë duhet të jetë jo më e gjatë se "dita gjyqësore". Dita gjyqësore përbëhet nga tri seanca prej 90 minutash me 20 minuta pushim mes tyre. Rekomandohet ky kufizim për përgatitje sepse ndihmon dëshmitarin të mësohet me kalendarin e punës të Gjykatës dhe siguron sasi pune të arsyeshme për një ditë.*
- *Kur është e mundur, përgatitja dhe dhënia e dëshmisë së një dëshmitari është mirë të parashikohet të bëhet jo në të njëjtën ditë, për të zvogëluar stresin.*

Organizimi i përgatitjes

- *Respektoni parimet e përgjithshme të mikpritjes, domethënë shkoni në kohën e parashikuar për ta takuar apo për ta marrë dëshmitarin, sepse kjo është shumë e rëndësishme, siç është e rëndësishme edhe nëse u jepni atyre pije dhe ushqime.*
- *Informojeni dëshmitarin për orën e fillimit dhe mbarimit dhe për orën e parashikuar për pushim. Flisni qartë për orarin dhe shmangni ndryshimet në minutën e fundit. Dhënia e këtij informacioni për orarin e propozuar, e ndihmon dëshmitarin të ndjehet si i barabartë në proces.*
- *Ngulni këmbë që dëshmitari t'ju vërë në dijeni nëse ka nevojë për pushim në çdo moment përpara pushimit të parashikuar. Çka është e rëndësishme, i thoni dëshmitarit se është normale dhe e pranueshme të kërkojë pushim përpara kohe dhe se kjo do t'i bënte mirë procesit. Synimi është të fuqizohet dëshmitari, të sigurohet një ndjesi kontrolli mbi procesin dhe t'u thuhet dëshmitarëve se pushimet nuk janë barrë apo vështirësi për punonjësit (edhe sikur të jenë).*

Çfarë të bëni nëse dëshmitari pëson krizë psikike gjatë procesit të përgatitjes

- *Ndalojeni menjëherë përgatitjen, sepse ky është qartësisht çasti kur dëshmitari ka nevojë të bëjë pushim.*
- *Pyeteni dëshmitarin nëse dëshiron të qëndrojë vetëm për pak kohë apo nëse dëshiron që pranë t'i qëndrojë një punonjës i gjykatës (për shembull, nëpunësi mbështetës).*
- *Mos druani të qëndroni të heshtur gjatë kësaj kohe, dhe lëreni veten të orientoheni nga dëshmitari sa i takon përmbajtjes së bisedës. Dëshmitari e di vetë se kur është më shumë në gjendje të përqendrohet për të rifilluar përgatitjen.*
- *Nëse për ta marrë veten, po kalon më shumë kohë se nga sa do të ishte e parashikueshme apo e rehatshme, ofroni t'i jepni fund përgatitjes dhe informoni për këtë nëpunësin mbështetës nga SVD-ja.*
- *Informojini nëpunësit mbështetës të SVD-së nëse dëshmitari ka vështirësi gjatë përgatitjes, duke qenë se është mirë për dëshmitarin që të takohet me një nëpunës mbështetës përpara ditës së dhënies së dëshmisë në gjykatë, në mënyrë që të njihet dhe të mësojë për rolin e nëpunësit mbështetës përpara e të fillojë dhënien e dëshmisë.*

VIII. Shtojca 8: Shënim shpjegues për dëshmitarët për urdhërparaqitjet

- ***TË JESH DËSHMITAR***
  - *Të qenit dëshmitar është një përgjegjësi e rëndësishme. Nëse i keni dhënë deklaratë një hetuesi të TPNJ-së dhe ju është kërkuar të shkoni në TPNJ për të dëshmuar, këtë e keni detyrim.*
  - *Roli juaj ka shumë rëndësi, duke qenë se dëshmia juaj ndihmon në sigurimin e drejtësisë. Me ndihmën tuaj, mund të arrijmë tek e vërteta dhe të sigurohemi që të jepet vendimi i duhur. Roli juaj është jetik dhe pa ju lënda mund të dështojë.*
- ***ÇFARË ËSHTË URDHËRPARAQITJA?***
  - *Urdhërparaqitja është një urdhër gjyqësor i cili ju kërkon të paraqiteni personalisht përpara Tribunalit të Hagës më datën dhe orën e caktuar për të dëshmuar për faktet që ia keni treguar hetuesve.*
  - *Nëse nuk paraqiteni përpara Tribunalit sipas urdhërparaqitjes, do t'i nënshtroheni një dënimi.*
- ***PO SIKUR TË MOS DËSHIRONI TË SHKONI NË GJYKATË?***
  - *Përbën vepër penale nëse personi të cilit i drejtohet urdhërparaqitja si dëshmitar nuk paraqitet në Gjykatë, pa pasur një justifikim të arsyeshëm.*
  - *Nëse merrni në dorëzim një urdhërparaqitje, nuk mund ta shpërfillni. Nëse veproni kështu, atëherë rrezikoni të akuzoheni për shpërfillje të gjykatës.*
  - *Nëse nuk paraqiteni personalisht, sikurse jua kërkon urdhërparaqitja dhe nëse nuk keni justifikim për këtë, gjykata ka të drejtë të japë fletarrestim për ju, rast në të cilin do t'ju arrestojnë dhe do t'ju shoqërojnë për në gjykatë, ku do të gjykoheni për mosbindje ndaj gjykatës. Nëse shpalleni fajtor për shpërfillje të gjykatës, mund të dënoheni me gjobë ose me burg.*
- ***PO SIKUR TË MOS JENI NË GJENDJE TË SHKONI NË GJYKATË?***
  - *Nëse e keni të pamundur ose tejet të vështirë që të paraqiteni në kohën e kërkuar në urdhërparaqitje për një arsye të justifikueshme (personale, mjekësore, sigurie apo arsye tjetër) ju lutemi të kontaktoni Sektorin e Viktimave dhe Dëshmitarëve (00 31 70 512 88 77) për t'ua shpjeguar shqetësimet që keni duke qenë se mund të ketë zgjidhje për vështirësitë me të cilat përballeni. SVD-ja është përgjegjës për të siguruar të gjithë dëshmitarët të mund të dëshmojnë në gjendje të sigurt dhe që përjetimi i dhënies së dëshmisë të mos sjellë vështirësi, vuajtje apo tronditje të tjera.*
  - *Ju mund ta informoni punonjësin e policisë i cili ju dorëzon urdhërparaqitjen se dëshironi t'ju kontaktojë Sektori i Viktimave dhe Dëshmitarëve pranë Tribunalit, për t'ia shpjeguar shqetësimet tuaja personale, mjekësore apo në lidhje me sigurinë.*
  - *Nëse nuk është e volitshme ora apo data e paraqitjes përpara gjykatës, ekziston mundësia të paraqiteni në një moment tjetër. Po kështu, nëse keni shqetësime legjitime lidhur me udhëtimin për në Hagë, gjyqtarët mund të bien dakord ta dëgjojnë dëshminë tuaj përmes lidhjes me video, nga një vendndodhje pranë vendbanimit tuaj.*
  - *Nëse keni shqetësime sigurie lidhur me paraqitjen në gjykatë apo me dhënien e dëshmisë, Sektori i Viktimave dhe Dëshmitarëve mund të kërkojë marrjen e masave mbrojtëse në emrin tuaj.*
  - *Mund të merren masa të posaçme nga Sektori i Viktimave dhe Dëshmitarëve për dëshmitarët e moshuar apo me aftësi të kufizuara apo për fëmijët që keni në varësi. Masa të posaçme mund të merren edhe nëse do të kërkoni t'ju shoqërojë një person mbështetës.*
- **VLERËSOHET SHUMË KONTRIBUTI JUAJ SI DËSHMITAR. JU FALËNDEROJMË PËR KOHËN QË NA KUSHTUAT.**

VIII. Shtojca 9: Formulari për regjistrimin e heqjes dorë nga të drejtat

ABSENCE FROM COURT DUE TO ILLNESS
OTSUSTVO SA SUDA ZBOG BOLESTI
MUNGESË NGA GJYKATA PËR SHKAQE SHËNDETËSORE
ОТСУСТВО ОД СУД ПОРАДИ ЗДРАВСТВЕНИ ПРИЧИНИ

Detainee / *Pritvorenik* / I paraburgosur / *Притвореник*

I, the undersigned, hereby declare that:
Ja, dolje potpisani, izjavljujem da:
Unë, i nënshkruari, deklaroj se:
Јас, долупотпишаниот, изјавувам дека:

☐ I am unable to attend court proceedings on this date due to illness.
Danas nisam u stanju prsustvovati suđenju zbog bolesti.
Sot nuk mund të marr pjesë në gjykim për shkak të sëmundjes.
Денес не сум во состојба да присуствувам на судење поради болест.

☐ I have discussed the matter with my counsel.
Razgovarao sam o ovome sa svojim advokatom odbrane.
Këtë çështje e kam biseduar me avokatin tim të mbrojtjes.
Ова прашање сум го разговарал со мојот адвокат.

☐ I understand that I have a right to be present at all trial proceedings against me, however I waive my right to be present in court on this date and give my consent for the proceedings to continue in my absence but in the presence of my counsel.
Razumijem da imam pravo prisustvovati svim sjednicama suđenja protiv mene, međutim odričem se tog prava danas i dajem svoje dopuštenje da se sudski postupak nastavi u mome odsustvu, ali u prisustvu mog advokata odbrane.
Kuptoj se kam të drejtë të marr pjesë në të gjitha seancat gjyqësore kundër meje, mirëpo sot heq dorë nga kjo e drejtë dhe pajtohem që seanca gjyqësore të vazhdojë pa prezencën time, me kusht që avokati im të jetë present.
Разбирам дека имам право да присуствувам на сите судски седници против мене, меѓутоа денес се одрекувам од тоа право и се согласувам судскиот постапка да продолжи во мое отсуство, но во присуство на мојот адвокат.

Date
Datum
Data
Датум _____

_____ (PRINT NAME) (IME I PREZIME ŠTAMPANIM SLOVIMA) (EMRI E MBIEMRI ME SHKRONJA SHTYPI) (ИМЕ И ПРЕЗИМЕ СО ПЕЧАТНИ БУКВИ)

_____ (SIGNATURE) (VLASTORUČNI POTPIS) (NËNSHKRIMI) (ПОТПИС)

IX. Hartimi i Aktgjykimeve

A. Skica e aktgjykimit.....115
B. Konsiderata paraprake.....121
C. Përmbledhje të deponimeve të dëshmitarëve dhe të provave materiale.....122
C.1 Metoda tradicionale.....122
C.2 Metoda e sistemit elektronik të gjykatës.....123
D. Ligji i zbatueshëm.....125
E. Konstatimet faktike 126
F. Ndjekja e historisë procedurale.....127
G. Mocionet për pafajësi.....127
H. Implikimet e gjyqeve me shumë të akuzuar.....128
I. Konsiderata të përgjithshme.....129
J. Rishikimi i draftit të aktgjykimit.....130
K. Konsideratat përfundimtare.....132
IX. Shtojca 10: Kërkesat Chapeau.....133
IX. Shtojca 11: Modeli elektronik i aktgjykimit.....134

1. Për shkak të gjerësisë dhe kompleksitetit të lëndëve të krimeve të luftës, si edhe lëndëve të krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit, procesi i hartimit të aktgjykimeve të tyre mund të ndryshojë nga procesi i hartimit të aktgjykimeve në lëndë që përfshijnë krime të brendshme. Meqenëse drejtësia kërkon që aktgjykimet të nxirren brenda një periudhe të arsyeshme kohore, nuk mund të pritet deri sa të përfundojë gjykimi i çështjes për të nisur procesin e hartimit të aktgjykimit. Përgatitja paraprake për hartimin e aktgjykimit duhet të nisë që me fillimin e çështjes gjyqësore. Ndonëse gjykatësit nuk mund të nxitojnë për të nxjerrë konkluzione para kohe, përpara se të kenë dëgjuar të gjitha provat materiale, ka shumë hapa që mund të ndërmerren qysh në fillim të procesit, që mund ta vënë trupin gjykues në pozitën më të mirë për të përgatitur një aktgjykim të arsyetuar, të qartë dhe konciz brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Ky kapitull do të përqendrohet në fazat e ndryshme të procesit të hartimit të një aktgjykimi, duke filluar që nga përgatitja e skicës së një aktgjykimi, deri te procesi i rishikimit të draftit përfundimtar.

A. Skica e aktgjykimit

2. Hapi i parë në procesin e hartimit të aktgjykimit ka të bëjë me përgatitjen e një skice paraprake të aktgjykimit. Përgatitja e skicës duhet të nisë që në fillim të çështjes gjyqësore, madje përpara se të fillojë gjyqi. Në TPNJ, ku përdoret sistemi i vënë në lëvizje nga palët, i ngjashëm me sistemet që përdoren në juridiksionet e të drejtës zakonore anglo-saksone, skica krijohet në bazë të Aktakuzës dhe të dosjeve paragjyqësore të palëve. Epërsia e përgatitjes së hershme të skicës së një aktgjykimi është se, gjatë procesit të gjykimit, i kushtohet vëmendje atyre informacioneve që lidhen me aktgjykimin (dhe urdhrave për mocione të mundshme shfajësimi pas përfundimit të paraqitjes së çështjes nga Prokuroria, sikurse parashikohet në Rregullin 98*bis*).

3. Skica e një aktgjykimi është një punë në vazhdim. Në rast se gjatë gjykimit dalin informacione që nuk janë parashikuar në skicën e aktgjykimit, atëherë skica duhet të plotësohet.

4. Skica fillestare e aktgjykimit nuk ka nevojë të jetë tepër e hollësishme; mjafton që të përfshijë titujt e kapitujve që në fund do të përbëjnë tabelën e lëndës së aktgjykimit. Në fakt, ka argumente të forta kundër përfshirjes që në fillim të hollësive tepër të shumta, sepse është e pamundur të parashikohet me saktësi se si do të zhvillohet një çështje gjyqësore. Më e mira është që të pritet deri sa çështja gjyqësore të ketë përparuar dhe pastaj, në një fazë të mëvonshme, të formulohen aspektet e hollësishme. Ajo që ka më rëndësi është se një skicë e mirë e një aktgjykimi do të sigurojë që pyetjet në lidhje me përgjegjësinë penale dhe të

gjitha krimet e pretenduara të trajtohen në mënyrën më logjike dhe më të efektshme të mundur, duke minimizuar përsëritjet.

5. Përgatitja e hershme e aktgjykimit u jep mundësi Gjykatësve të marrin vendime në kohë në lidhje me përparësitë e hartimit. Vendimmarrja e hershme mund t'i ndihmojë gjykatësit të përcaktojnë dobësitë e paraqitjes së çështjes nga Prokuroria dhe elementët për të cilët gjykatësit mund të duan t'u kërkojnë palëve informacione të mëtejshme.

6. Në TPNJ duket se janë krijuar disa modele të ndryshme të skicave të aktgjykimeve. Një model i preferuar në TPNJ përfshin komponentët e mëposhtëm:
   - përmbledhja e akuzave;
   - deklarata e aspekteve të përgjithshme në lidhje me vlerësimin e provave;
   - vështrimi i përgjithshëm;
   - deklarata me kërkesat e përgjithshme për krimet e pretenduara në Aktakuzë;
   - deklarata përgjegjësisë penale individuale;
   - deklarata në lidhje me rolin dhe përgjegjësinë e të akuzuarit në përgjithësi;
   - deklarata e akuzave dhe konstatimeve, pra, vrasjet si krim kundër njerëzimit dhe/ose si krim lufte;
   - deklarata e elementëve të dënimit (në rast shpalljeje fajtor);
   - dispozitat;
   - shtojcat: fjalori i termave dhe historikun procedural.

7. Përmbledhja e akuzave: Përmbledhja paraqet shkurtimisht akuzat e paraqitura në Aktakuzë, të cilat përshkruhen më me hollësi në parashtrimet paragjyqësore.

8. Aspekte të përgjithshme në lidhje me vlerësimin e provave: Ky dokument paraqet kuadrin në të cilin Dhoma Gjyqësore bën analizën e provave dhe bazën mbi të cilën ajo mbështetet për të nxjerrë konkluzionet e saj. Si pikënisje, ky dokument përfshin prezumimin e pafajësisë dhe standardin e provës (pra, prokuroria ka barrën e provës së fajit përtej dyshimit të arsyeshëm). Përveç kësaj, dokumenti duhet të përcaktojë konstatimet, ku zbatohet standardi i provës, duke përfshirë jo vetëm konkludimin përfundimtar të fajësisë, por edhe ato elementë të krimeve dhe formave të përgjegjësisë mbi të cilat mbështetet shpallja e fajësisë. Dokumenti duhet të shtjellojë gjithashtu edhe mënyrën se si Dhoma i trajton dëshmitë rrethanore, që do të thotë se përfundimi që nxirret nga prova të tilla duhet të jetë përfundimi i vetëm i arsyeshëm i mundshëm. Dokumenti mund të sqarojë gjithashtu se cilët faktorë do të marrë parasysh Dhoma Gjyqësore për të përcaktuar nëse mospërputhjet i diskreditojnë provat, si edhe faktorë të tillë, si sasia e kohës që ka kaluar qysh nga ndodhja e ngjarjeve. Aspekte të tjera të përgjithshme që duhen trajtuar në këtë fazë përfshijnë nevojën (nëse ka) për konfirmim, peshën e ndryshme që i duhet dhënë provave të mbështetura në kujtesën e dëshmitarëve, përkundrejt provave të mbështetura në shënime, që regjistrojnë atë që të tjerët u kanë thënë atyre dhe qasjen e ndjekur në lidhje me provat e mbështetura në fjalët e palëve të treta. Dhoma Gjyqësore në çështjen *Krnojelac*, duke i trajtuar të gjitha sa më sipër, deklaroi se ajo ka ndjekur metodën "e përcaktimit nëse provat e dhëna nga dëshmitarët, mbi të cilat është mbështetur Prokuroria, duhet të pranohen se vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshëm faktet e pretenduara, pavarësisht nga dëshmitë e dhëna nga i akuzuari dhe dëshmitarët mbi të cilët është mbështetur Mbrojtja".[183]

9. Vështrim i përgjithshëm: Ky dokument jep informacion rreth sfondit të konfliktit, për të vendosur në këtë sfond krimet e pretenduara dhe i jep gjykatës mundësinë të rrëfejë "historinë" e konfliktit, duke u nisur nga ngjarjet në përgjithësi (për shembull, duke vënë në dukje konfliktin në Bosnjë), dhe pastaj duke e ngushtuar

183 *Prokurori kundër Krnojelac*, Lënda Nr. IT-97-25-T, Aktgjykimi, 15 mars 2002, para. 68.

diskutimin në krimet konkrete që diskutohen (duke u përqendruar në një rajon të caktuar, qytet, fshat, apo në të gjitha së bashku). Këtu duhet të pasqyrohen temat dhe periudhat kohore më të rëndësishme me qëllim për të bërë të mundur të kuptohet konteksti në të cilin krimet e caktuara kanë ndodhur. Do të ishte me vend që në këtë fazë të përmendeshin krimet që përbëjnë çështjen gjyqësore, sepse kështu ato vendosen në kontekst. Megjithatë, paraqitja e krimeve duhet bërë në mënyrë të përgjithshme, duke e lënë shqyrtimin e tyre të hollësishëm në një fazë të mëvonshme. Meqenëse kjo pjesë e aktgjykimit përfaqëson konstatimet e para faktike të Dhomës Gjyqësore, është me rëndësi që të paraprihet nga pjesa e Aspekteve të Përgjithshme të Vlerësimit të Provave, me qëllim që baza mbi të cilën është duke punuar Dhoma Gjyqësore të jetë e qartë për të gjithë.

10. Kërkesa të përgjithshme për krimet e pretenduara në aktakuzë: Pjesa më e madhe e krimeve në juridiksionin e TPNJ-së kërkojnë vërtetimin e atyre që njihen me emrin kërkesa "të përgjithshme" ose "ombrellë". Kjo vlen për shkeljet e rënda të Konventave të Gjenevës (Neni 2 i Statutit të TPNJ-së), shkeljet e ligjeve dhe zakoneve të luftës (Neni 3) dhe krimet kundër njerëzimit (Neni 5). Për këto krime, duhet të ekzistojnë disa elementë kontekstualë përpara se të konstatohet se veprimi kryesor përbën krimin në fjalë. Për shembull, përpara se të përcaktohet nëse një vrasje e caktuar apo një veprim torture mund të konsiderohet si shkelje e rëndë, së pari, duhet të provohet se ka pasur një konflikt të armatosur dhe lidhje midis veprimeve në fjalë dhe konfliktit të armatosur (shih Shtojcën 10 – Kërkesat ombrellë).

11. Për sa i takon hartimit të aktgjykimit, është e këshillueshme që kërkesat ombrellë për krime të ndryshme të trajtohen së bashku përpara se të analizohen veprimet konkrete për të cilat akuzohet i pandehuri. Në pjesën për Kërkesat Ombrellë në lidhje me Krimet e Pretenduara në Aktakuzë duhet të përcaktohen këto kërkesa dhe të dilet me konstatime në lidhje me plotësimin apo jo të tyre, duke nxjerrë konkluzione nga zbatimi i informacionit faktik të paraqitur në Vështrimin e Përgjithshëm në kërkesat ligjore. Në rast se kërkesat janë plotësuar, atëherë Dhoma mund të vazhdojë me analizën e krimeve individuale të pretenduara. Në rast se këto kërkesa nuk plotësohen, atëherë Dhoma nuk ka pse të analizojë veprimet individuale, sepse ligjërisht ato nuk janë baras me krimet në fjalë.

12. Ka disa avantazhe në bërjen e analizës së kërkesave ombrellë në këtë pikë të procesit të hartimit. Duke qenë se këto kërkesa vijnë menjëherë pas seksionit të Vështrimit të Përgjithshëm, i cili jep bazën faktike, përfundimet e Tribunalit duhet të jenë të qarta për lexuesin. Në fakt, është më e lehtë për hartuesin të ndjekë analizën ombrellë meqenëse informacioni faktik që mbështet përfundimin nuk është në këtë fazë i ndërthurur me informacionet shumë më të hollësishme rreth veprimeve të veçanta që akuzohen. Për më tepër, informacioni faktik që lidhet me veprimet individuale nuk nevojitet për analizën e kërkesave të përgjithshme ombrellë. Pastaj, kur të jenë provuar kërkesat ombrellë, analiza e tyre nuk ka pse të përsëritet, duke bërë të mundur një analizë më të qartë dhe më të përqendruar të akteve individuale që akuzohen si krime.

13. Përgjegjësia penale individuale: Duke supozuar se kërkesat ombrellë janë provuar të paktën për disa nga krimet e akuzuara, aktgjykimi pastaj duhet të vazhdojë me shqyrtimin e përgjegjësisë penale individuale të të akuzuarit. Kjo pjesë duhet së pari të japë me hollësi kërkesat ligjore për format e akuzuara të përgjegjësisë. Në TPNJ, format e përgjegjësisë gjenden në Nenin 7(1) dhe (3), që përcaktojnë, përkatësisht, përgjegjësinë e drejtpërdrejt (planifikimi, shtytja, urdhërimi, kryerja ose ndryshe ndihma dhe nxitja) dhe përgjegjësinë e tërthortë (përgjegjësia eprore). Jurisprudenca e TPNJ-së ka përcaktuar se edhe kjo përfshin ndërmarrjen e përbashkët kriminale (NPK) si një formë veprimi.

14. Roli dhe përgjegjësia e të akuzuarit në përgjithësi: Kur një i akuzuar akuzohet për një gamë të madhe krimesh, shumë aspekte të rolit dhe përgjegjësisë së tij duhet të kenë lidhje me akuzat. Për faktet e përbashkëta, është mirë që këto aspekte të shqyrtohen një herë në fillim, duke i lënë aspektet konkrete që lidhen vetëm me akuza individuale të trajtohen ndaras në analizën e akuzave konkrete. Mbështetur në këto informacione, Dhoma mund të dalë me konstatime të përgjithshme në lidhje me format përkatëse të përgjegjësisë, duke i lënë konstatimet e veçanta në lidhje me krimet e akuzuara të trajtohen në pjesën që flet për ato akuza. Kjo mënjanon përsëritjen e madhe të informacionit (shih kutinë "*Lënda Krnojelac – Roli dhe përgjegjësia e të akuzuarit në përgjithësi*").

> ***Lënda Krnojelac – Roli dhe përgjegjësia e të akuzuarit në përgjithësi***
>
> *Milorad Krnojelac ishte rojtar i burgut KP Dom në qytetin Foča (që sot është në Republika Srpska) që nga 18 prilli i vitit 1992 deri në fund të korrikut 1993. Ai u akuzua për krime kundër njerëzimit dhe shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës në përputhje me Nenet 7(1) (përgjegjësi e drejtpërdrejt) dhe 7(3) (përgjegjësi eprore) të Statutit të TPNJ-së.*
>
> *Si hap paraprak në shqyrtimin e akuzave kundër Krnojelac, pasi përcaktoi ligjin për format e përgjegjësisë për të cilat akuzohej, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi pozicionin e tij si rojtar i KP Dom-it në një pjesë të veçantë të aktgjykimit. Pasi provoi se Krnojelac ishte vërtet rojtar gjatë periudhës në fjalë, Dhoma Gjyqësore analizoi gamën e detyrave të atij posti, përgjegjësitë dhe të drejtat, si një mjet për të krijuar kontekstin e duhur për analizimin e akuzave kundër tij.*
>
> *Në nxjerrjen e konstatimeve të përgjithshme për rolin e të akuzuarit, ajo pranoi "se pushteti i një rojtari në një sistem burgimi nuk është i pakufizuar " dhe konstatoi se "kishte edhe disa grupe të caktuara që hynin në KP Dom ndaj të cilëve i akuzuari mund të ushtronte vetëm kontroll të kufizuar. Këta përfshinin hetuesit dhe paraushtarakët". Më tej ajo përcaktoi në lidhje me kufizimet për pushtetin e Krnojelac-it se "ajo nuk ishte e bindur se në postin e tij si rojtar i përkohshëm dhe pastaj rojtar, i akuzuari mund të urdhëronte në mënyrë të njëanshme apo jepte lirimin e ndonjërit prej të ndalurave. Lirimi i të burgosurve joserbë ishte një çështje që vendosej nga ushtarakët dhe shtabi i krizës."*
>
> *Dhoma Gjyqësore erdhi në përfundim se Krnojelac mbante postin e rojtarit në kuptimin e përgjithshëm të atij termi dhe se ai ushtronte përgjegjësi mbikëqyrëse ndaj të gjithë personelit vartës dhe të burgosurve në the KP Dom. Ky përfundim i përgjithshëm e lejoi atë të vazhdonte me shqyrtimin e secilit prej krimeve për të cilat akuzohej ai dhe me përgjegjësinë penale individuale të tij për ato krime.*

15. Akuzat dhe konstatimet: Pasi të jetë bërë e gjithë analiza e mësipërme, pjesa tjetër e aktgjykimit duhet të trajtojë akuzat dhe konkludimet specifike. Për qartësi analize, secili nga krimet duhet të trajtohet në kapituj apo seksione të veçantë. Për sa i takon një krimi individual, është e kështillueshme që së pari, të parashtrohet ligji për atë krim, duke mbajtur parasysh se nuk është e nevojshme të përsëritet analiza për kërkesat ombrellë**.** Përkundrazi, mjafton të jepet një shënim në fund të faqes, ku të përmenden përfundimet përkatëse sipas të cilëve këto kërkesa janë plotësuar. Pastaj, është me vend të jepet baza faktike dhe konstatimet se a ka ndodhur apo jo krimi në fjalë. Së fundi, është e nevojshme që Dhoma të nxjerrë konkluzionet e saj nëse është provuar përgjegjësia e të akuzuarit për krimin në fjalë.

16. Në këtë qasje ka disa avantazhe. Përmes lidhjes së ngushtë të përkufizimit të krimit, konstatimeve faktike dhe konkluzioneve në lidhje me përgjegjësinë, sigurohet një qartësi maksimale për sa i takon bazës faktike për nxjerrjen e përfundimeve në lidhje me përgjegjësinë. Kjo është në të mirën e lexuesit në përgjithësi por edhe të Dhomës së Apelit në rast se përballet me nevojën për të përcaktuar bazën mbi të cilën Dhoma Gjyqësore është mbështetur për të nxjerrë përfundimet e saj. Përdorimi i kësaj qasjeje i shton në maksimum gjasat që Dhoma Gjyqësore të miratojë një metodë rigoroze për të gjithë elementet e veprës përpara se të përcaktojë nëse një krim ka ndodhur dhe nëse i akuzuari është penalisht përgjegjës për atë krim. Të mirat e një qasjeje të tillë diskutohen me më shumë hollësi më poshtë, në pjesën mbi konstatimet e faktit. Është me rëndësi të vihet në dukje se nga ana strukturore është më mirë që krimet e pretenduara të trajtohen sipas një

rendi të caktuar në aktgjykim. Disa krime janë krime "ombrellë" në kuptimin që potencialisht përfshijnë një numër të madh veprimesh që mund të akuzohen ose jo si krime individuale në vetvete. Gjenocidi dhe përndjekjet janë shembuj të krimeve ombrellë. Secili nga këto krime mund të përfshijnë vrasjet si pjesë përbërëse të tij. Këto vrasje mund të akuzohen (dhe në praktikën e TPNJ-së, zakonisht akuzohen) veç e veç, përveç akuzës për gjenocid dhe/ose përndjekje Kur ndodh kjo, më e mira është të bëhet një analizë e nevojshme vetëm një herë, me qëllim minimizimin e përsëritjeve. Për qartësinë e paraqitjes, është e këshillueshme që analiza të bëhet në bazë të çdo krimi të veçantë (p.sh. vrasje) dhe jo në bazë të krimit ombrellë (p.sh. gjenocid apo përndjekje). Në rast se veprimi/krimi duhet trajtuar përsëri në seksionin apo kapitullin që trajton krimin ombrellë, analiza e mëparshme mund të përfshihet thjesht si referencë, me një analizë shtesë që mund të kërkohet për qëllimet e krimit ombrellë (shih kutinë *"Lënda Brđanin – Analiza e veprimeve/krimeve që përbëjnë përndjekje"*).

Lënda Brđanin – Analiza e veprimeve/krimeve që përbëjnë përndjekje

Radoslav Brđanin, udhëheqës politik në "Rajonin autonom të Krajinës" e akuzuan për krime të shumta, përfshirë përndjekjet si krim kundër njerëzimit. Krimi i përndjekjeve përkufizohet si një vepër apo mosveprim i cili "diskriminon në fakt apo mohon apo shkel një të drejtë themelore të parashikuar në të drejtën zakonore ndërkombëtare apo të drejtën e traktatit (actus reus)" dhe "është kryer qëllimisht me synimin për të diskriminuar për një nga shkaqet e paraqitur, konkretisht raca, feja apo politika (mens rea)".

Sikundër bëhet e qartë nga Aktgjykimi i asaj çështjeje, "veprimi apo mosveprimi që përbën krimin e përndjekjes mund të marrë forma të ndryshme. Megjithatë, parimi i ligjshmërisë kërkon që Prokuroria të akuzojë veprime të caktuara që janë baras me përndjekje në vend të përndjekjes në përgjithësi". Po ashtu, përndjekja funksionon si një krim "ombrellë" që përbëhet nga veprime të ndryshme të rëndësishme apo krime.

Prokuroria ngriti akuza për pesë kategori veprimesh si përndjekje. Për disa nga këto veprime, ajo ngriti akuza të veçanta.

Aktgjykimi në çështjen Brđanin u strukturua në mënyrë të tillë që veprimet për të cilat ishin ngritur akuza të veçanta u analizuan përpara shqyrtimit të krimit të përndjekjes. Kështu, kur Dhoma Gjyqësore më parë kishte konstatuar se krimi i përfshirë ishte provuar (p.sh., vrasje të caktuara), ajo e kufizoi shqyrtimin e saj për qëllimet e krimit të përndjekjes në përcaktimin nëse vrasjet në fjalë ishin diskriminuese në të vërtetë dhe të kryera me synimin e kërkuar diskriminues. E njëjta qasje u ndoq kur shqyrtimi i mëparshëm shpuri në konkluzionin se veprimet kishin ndodhur, por jo se ishte kryer një krim (p.sh., në lidhje me shkatërrimet e paligjshme dhe pa dallim, në shkallë të gjerë dhe kur përvetësimi i pronës nuk përligjej nga nevoja ushtarake), sepse një veprim i akuzuar si përndjekje nuk ka nevojë të shkojë deri në krim në vetvete Për ato veprime të akuzuara vetëm si përndjekje dhe si pasojë të jo të analizuara më parë në aktgjykim (p.sh., mohimi i të drejtave themelore), Dhomës Gjyqësore iu desh së pari të trajtonte elementët përbërës përpara se t'i zbatonte ato në faktet e çështjes.

17. Në fund të seksioneve që trajtojnë krimet individuale, Dhoma Gjyqësore duhet të dalë me konkluzione në lidhje me vërtetimin e krimeve dhe të përgjegjësisë individuale të të akuzuarit. Në rast se Dhoma Gjyqësore vjen në përfundim se i akuzuari është përgjegjës të paktën për disa nga krimet, atëherë ajo duhet që të marrë në shqyrtim dhënin e dënimit.[184] Përpara se ta bëjë këtë, praktika e TPNJ-së është e tillë që duhet të shqyrtohet paraprakisht elementi i fajësive të shumëfishta. Jurisprudenca e TPNJ-së ka provuar se, ndërsa lejohen akuzat e përsëritura, fajësitë e shumëfishta të dhëna në bazë të dispozitave të ndryshme ligjore, por mbështetur në të njëjtën sjellje lejohen vetëm kur secila prej këtyre dispozitave ka një element të ndryshëm material që nuk e përmban dispozita tjetër. Vetëm pasi bëhet një analizë e tillë Trupi Gjykues është në gjendje të dijë fajësitë e sakta për të cilat i akuzuari duhet dënuar. Analiza e fajësive të

184 Në fillim të praktikës së Tribunalit, dhënia e dënimit bëhej një proces më vete, që zhvillohej vetëm pasi të kishte dalë aktgjykimi, i cili përmbante një apo më shumë shpallje fajësie. Për arsye efektiviteti, Dhoma Gjyqësore kaloi me shpejtësi në një procedurë në të cilën pretenca e dënimit bëhej në kuadër të procesit të gjykimit. Pastaj, këto mund të shqyrtoheshin nga Dhoma përkatëse në rastin që ajo dilte me një vendim për fajësim.

shumëfishta mund të bëhet në një seksion të veçantë, por mund të përfshihet edhe si një nënseksion paraprak në seksionin për Dënimin (shih kutinë "*Lëndët Čelebići, Jelisić dhe Kordić dhe Čerkez – Fajësi të shumëfishta dhe elementë "të ndryshëm material" të krimeve*").

18. Aspektet e dënimit: Seksioni i dënimit duhet të trajtojë aspektet që me ligji janë të detyrueshme. Në rastin e TPNJ-ë, këto aspekte përfshijnë me sa vijon:
   - Praktikën e përgjithshme në lidhje me dënimin me burgim në gjykatën e ish-Jugosllavisë;
   - Pesha e veprës penale;
   - Rrethanat individuale të personit të shpallur fajtor;
   - Çdo rrethanë rënduese apo lehtësuese;
   - Masën në të cilën është vuajtur në ndërkohë dënimi i dhënë për të njëjtën veprim.

19. Në praktikën e TPNJ-së, përcaktimi i dënimit vazhdon të mbetet e drejta e lirë e Gjykatësve. Si rrjedhojë, apelimet përgjithësisht bëhen në lidhje me faktin nëse Gjykatësit e Dhomës Gjyqësore kanë abuzuar me lirinë e tyre për të vendosur. Gjasat që një dënim të rrëzohet në apel minimizohen duke siguruar që faktorët e përmendur më lart të shqyrtohen shprehimisht në Aktgjykim.

> ***Lëndët Čelebići, Jelisić dhe Kordić dhe Čerkez – Fajësi të shumëfishta dhe elementë "të ndryshëm material" të krimeve***
>
> *Ligji për fajësitë e shumëfishta varet nga nocioni i elementëve "materialisht të ndryshëm". Një element është materialisht i ndryshëm nga një tjetër, në rast se kërkon provën e një fakti që nuk e kërkon tjetër. Ligji përkatës u sqarua në Aktgjykimin e Apelit të çështjes Čelebići:*
>
> *Pasi shqyrtoi qasjet e ndryshme të shprehura për këtë aspekt si brenda TPNJ-së, ashtu edhe në juridiksione të tjera, kjo Dhomë Apeli deklaron se shkaqet e drejtësisë ndaj të akuzuarit dhe faktit se vetëm krimet e dallueshme nga njeri tjetri mund të përligjin fajësimin e shumëfishtë, shpuri në konkluzionin se fajësitë e shumëfishta penale të shpallura në bazë të dispozitave të ndryshme ligjore, por të mbështetura në të njëjtën sjellje janë të lejueshme vetëm kur secila nga dispozitat ligjore në fjalë ka një element të ndryshëm material që nuk e përmban dispozita tjetër. Një element është i ndryshëm materialisht nga një tjetër në rast se kërkon provën e një fakti që nuk e kërkon tjetra.*
>
> *Aty ku testi nuk plotësohet, Dhoma duhet të vendosë se për cilën vepër penale do të shpallë një fajësi. Kjo duhet bërë në bazë të parimit se duhet lënë në fuqi fajësia e përcaktuar në bazë të dispozitës më specifike. Kështu, në rast se një grup faktesh rregullohet nga dy dispozita, një prej të cilave përmban një element materialisht të ndryshëm, atëherë fajësia duhet të shpallet vetëm në bazë të dispozitës që kërkon elementin e ndryshëm material.*
>
> *Në praktikë, zbatimi i këtij testi ka marrë parasysh edhe kërkesat e përgjithshme si edhe kërkesat e posaçmet të një krimi. Kjo qasje ka rezultuar në lejimin e më shumë fajësive të shumëfishta se sa do të ndodhte po të mos ishte marrë parasysh kërkesa e përgjithshme.*

20. Dispozita: Pas seksionit mbi dënimin, aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore duhet të përcaktojë dispozitën e tij, e cila përmban konstatimet e pafajësisë apo fajësisë për secilën nga pikat e aktakuzës. Në dispozitë, TPNJ-ja shpreh gjithashtu edhe dënimin që jep, duke pranuar se koha e kaluar ndërkohë në paraburgim nga i akuzuari do të njihet dhe do t'i ulet nga dënimi. Kur një vendim për një akuzë të caktuar nuk është unanim, praktika e TPNJ-së është e tillë që të pasqyrojë ndarjen e mendimeve në Dispozitë (p.sh., "VENDOS me shumicë, ku Gjykatësi XXX kundërshton, se"). Kur një Gjykatës apo disa Gjykatës i bashkëngjisin aktgjykimit opinionet e tyre kundërshtuese apo të veçanta, këto opinione vihen në dukje edhe në Dispozitë, pas paragrafëve të dispozitës dhe firmave të gjykatësve.

21. Shtojcat: Zakonisht Aktgjykimet e shkallës së parë në TPNJ përfshijnë një numër shtojcash. Disa aktgjykime e përfshijnë aktakuzën që është në fuqi si shtojcë, për shkak të gjatësisë së disa aktgjykimeve dhe aktakuzave. Mjaft shpesh, aktgjykimet përfshijnë si shtojcë një fjalor termash dhe një Historik Procedural, dhe zakonisht të dyja dalin se janë të dobishme për palët dhe Dhomën e Apelit. Shembuj të tyre mund të gjenden në Aktgjykimet e Dhomës në çështjet *Orić*, *Halilović* dhe *Galić*. Disa aktgjykime kanë përfshirë edhe lloje të tjera shtojcash të tilla si listat e ndërtesave apo strukturave të shkatërruara apo dëmtuara (Aktgjykimi i Dhomës në

çështjen *Strugar*), listën e viktimave me emra (Aktgjykimi i Dhomës për çështjen *Stakić*) apo harta, fotografi dhe skica (Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore për çështjen *Orić*). Nuk ka asnjë rregull të përcaktuar një herë e mirë për atë që mund të përfshihet në shtojcë. Kjo duhet të vendoset rast pas rasti, në varësi të natyrës së aktgjykimit.

22. Sa për krahasim, është me dobi që t'i referohemi shkurtimisht një modeli alternativ të hartimit të aktgjykimit. Ky model favorizon përfshirjen e përshkrimit të të gjitha fakteve të çështjes, i pasuar nga një seksion i veçantë për ligjin (të gjitha krimet e akuzuara dhe format e deklaruara të përgjegjësisë), konstatime në lidhje me krimet, dhe së fundi, një seksion për gjetjet e përgjegjësisë. E keqja e kësaj metode është se opinioni nuk bën të qartë lidhjen midis një krimi të caktuar dhe fakteve dhe konstatimeve, dhe si pasojë, kjo metodë e bën aktgjykimin më të ngatërruar për lexuesin në përgjithësi dhe më të vështirë për trupin gjykues në apel që të ndjekë arsyetimin gjatë gjyqit. Në disa raste, Dhomës së Apelit i është dashur të bëjë përpjekje të konsiderueshme për të përcaktuar faktet e gjetura nga Dhoma Gjyqësore në mbështetje të një konstatimi të përgjegjësisë penale për një akuzë të caktuar, dhe më në fund, një numër akuzash janë kthyer mbrapssh në apel për shkak të mungesës së gjetjeve të nevojshme.

B. Konsiderata paraprake

23. Përpara se të hartohet një aktgjykim në strukturën e përmendur më sipër, ka shumë punë që duhen bërë. Si hap i parë, është mirë të përcaktohen konsideratat paraprake që do të lehtësojnë procesin e përpilimit.

24. Me qëllim që të sigurohet vijimësia e një aktgjykimi, por edhe vijimësia midis aktgjykimeve, është e këshillueshme të miratohet një model elektronik i aktgjykimit. Në një format më të avancuar, modeli përfshin një paletë me vegla (toolbar) ku përfshihen tituj të gatshëm aktgjykimesh dhe instrumente të tjera të formatimit (sikurse ndodh në TPNJ). Kur kjo nuk është e mundur, do të ishte e mjaftueshme të bihet dakord për formatin që më parë (shih Shtojcën 1 – *Modeli elektronik i Aktgjykimit*).

25. TPNJ-ja konstatoi se ishte me dobi të ruhej një dosje e përbashkët në hard drive të një kompjuteri të përbashkët gjatë kohës së hartimit të aktgjykimeve. Të gjitha dokumentet e rëndësishme për procesin e përpilimit të aktgjykimit mund të mbahen në këtë dosje qendrore për t'u përdorur nga Gjykatësit dhe çdo pjesëtar i stafit sipas nevojës. Qasja në këtë dosje duhet të jetë e kufizuar, me qëllim që vetëm ata që punojnë në atë çështje të caktuar të mund ta përdorin atë. Ka një numër dokumentesh që zakonisht mund të ruhen aty, duke përfshirë:
    - aktakuzën në fuqi (dhe versione të mëparshme, sipas nevojës),
    - dosjet paragjyqësore dhe të parambrojtjes,
    - vendime të rëndësishme të Dhomës Gjyqësore,
    - përmbledhjet të dëshmive të dëshmitarëve dhe të provave materiale,
    - skicën e aktgjykimit,
    - draftet e aktgjykimit,
    - udhëzuesin e stilit,
    - fjalorin,
    - dokumentin e përgjithshëm që përcakton ndarjen e detyrave, afatet kohore.

26. Duhet rënë dakord që më parë për udhëzuesin e stilit për të shmangur nevojën për të shpenzuar kohë dhe përpjekje për standardizimin e shumë gjërave, përfshirë gjuhën, ortografinë, formatimin, sistemin e

pikëzimit, germat e mëdha, numrat dhe datat, shkurtimet dhe akronimet, citimet, shënimet në fund të faqes, dhe përdorimin e fjalorit. Ky udhëzues nuk duhet të jetë i gjatë dhe i komplikuar me qëllim që të jetë i efektshëm. Megjithatë, udhëzuesi do të kursejë shumë kohë në rast se ndiqet qysh në fillim nga të gjithë hartuesit. Në kushte ideale, të gjitha Dhomat duhet të bien dakord me një udhëzues të të njëjtit stil, duke siguruar një konsekuencë në punën e mbarë gjykatës/Tribunalit. Në TPNJ, Dhoma të ndryshme kanë përdorur udhëzues të ndryshëm, të cilët me kohë janë zhvilluar dhe bërë dokumente të gjata dhe të hollësishme.

C. Përmbledhje të deponimeve të dëshmitarëve dhe të provave materiale

27. Duke pasur skicën dhe modelin të një aktgjykimi, përgatitjet paraprake të aktgjykimit mund të fillojnë menjëherë pas deponimit të dëshmitarëve të parë dhe pranimit si prova materiale të dokumenteve të para. Megjithatë, gjykatat ndjekin qasje të ndryshme ndaj procesit të hartimit, dhe këto dallime shpesh i atribuohen faktit nëse një gjykatë përdor një lloj sistemi elektronik, apo nëse hartimi i aktgjykimeve duhet bërë kryesisht përmes përdorimit të dokumenteve në Word. TPNJ-ja ka përvojë në të dy sistemet, duke u larguar nga qasja "tradicionale" e metodës me dokumente në Word, drejt sistemit elektronik të gjykatës, gjatë gjyqit të *Halilović-it* në vitin 2005.[185] Meqenëse shumë gjykata të brendshme nuk e përdorin sistemin elektronik, është mirë që më poshtë të paraqesim aspekte të të dy metodave.

C.1 Metoda tradicionale

28. Sipas metodës tradicionale, personeli gjyqësor përmbledh dëshmitë e secilit dëshmitar që paraqitet përpara Dhomës Gjyqësore. Përmbledhjet e tilla duhet të verifikohen me transkriptimin aktual gjatë procesit të hartimit dhe përdoren nga Dhoma Gjyqësore gjatë kështillimeve, si dhe gjatë hartimit të aktgjykimit. Është me rëndësi që përmbledhjet të përfundohen sa më shpejt që të jetë e mundur pasi deponon një dëshmitar, sepse përshtypja është e freskët në mendjen e hartuesit dhe sepse ekziston rreziku i grumbullimit të punës. Në kushte ideale, të gjitha përmbledhjet e dëshmive të dëshmitarëve duhen përfunduar brenda një apo dy javësh pasi ka deponuar dëshmitari (si rrjedhojë, duhet të përfundojnë plotësisht brenda dy javësh pas përfundimit të gjyqit).

29. Forma që duhet të marrë përmbledhja e dëshmisë së një dëshmitari varet nga vendimi gjyqësor. Herë pas here, TPNJ-ja ka përdorur struktura të njëjta për përmbledhjet. Megjithatë, meqenëse jo të gjithë dëshmitarët ndjekin të njëjtën strukturë gjatë deponimit, një strukturë e njëjtë mund të jetë kundërproduktive, dhe në fund mund të jetë më e lehtë që të bëhet një përmblidhje e provave sipas renditjes në të cilën janë paraqitur. Në një kohë të mëvonshme, përmbledhja mund të strukturohet ndryshe në bazë të nevojës së skicës së aktgjykimit.

30. Gjithashtu, provat përkatëse materiale të paraqitura në gjyq duhet të përmblidhen. Kjo mund të bëhet ose së bashku me deponimin e një dëshmitari, kur prova materiale është përdorur në lidhje me atë deponim, ose mund të bëhet si një ushtrim i veçantë. Sikurse me përmbledhjet e deponimeve të dëshmitarëve, përmbledhja e provave materiale duhet të kontrollohet me provën aktuale dhe, në kushte ideale, përmbledhjet duhet të përfundojnë brenda dy javësh pas mbylljes së gjyqit. Ajo që duhet të përmblidhet është vetëm pjesa përkatëse e një prove materiale të caktuar. Për shembull, kur janë paraqitur si provë materiale vetëm disa faqe të një libri, nuk ka nevojë të përmblidhet i gjithë libri.

185 *Prokurori kundër. Halilović*, Lënda Nr. IT-01-48-T, Aktgjykimi, 16 nëntor 2005.

31. Pasi të kenë përfunduar përmbledhjet e verifikuara të dëshmive të dëshmitarëve dhe përmbledhjet e provave materiale dhe në përputhje me skicën e aktgjykimit, ato mund të priten dhe të ngjiten pa humbur kohë në pjesët përkatëse të draftit të aktgjykimit. Për shembull, në rast se dëshmia e një dëshmitari jep informacion në lidhje me konfliktin në përgjithësi, ajo mund të futet menjëherë në kapitullin e Vështrimit të Përgjithshëm. Në rast se i përshtatet një krimi të caktuar, dëshmia mund të futet në pjesën që flet për atë krim. Në rast se lidhet me më shumë se një kapitull të aktgjykimit, atëherë pjesët përkatëse të përmbledhjes mund të ngjiten në secilin kapitull përkatës. Më vonë në procesin e hartimit të aktgjykimit, do të duhet të redaktohen diskutimet rreth përmbledhjeve, me qëllim që të evitohet përsëritja e panevojshme. Megjithatë, gjatë fazave të para të procesit të hartimit, është e këshillueshme të jesh sa më gjithëpërfshirës që është e mundshme, dhe redaktimi më i hollësishëm t'i lihet për një fazë të mëvonshme, kur gjykata të ketë informacion të mjaftueshëm për të marrë vendime më të arsyetuara për vendin se ku është më mirë të vendoset informacioni.

32. Pasi të jenë përgatitur përmbledhjet, ka praktika të ndryshme nga një Dhomë në tjetrën, madje dhe nga një gjykatës në tjetrin. Disa gjykatës kanë preferuar t'i shohin përmbledhjet menjëherë pasi ato të jenë përfunduar, me qëllim që t'i krahasojnë ato me shënimet e tyre dhe të kërkojnë ndryshime. Disa gjykatës të tjerë kanë preferuar të presin dhe t'i shohin përmbledhjet pasi që dëshmitë të jenë paraqitur në draftin e parë të një seksioni të caktuar të aktgjykimit, dhe pastaj të kërkojnë sqarimet e nevojshme. Metoda që do të ndiqet në fund, vendoset nga trupi gjykues apo nga secili gjykatës vetë.

33. Është vendimtare që përmbledhja të pasqyrojë konstatimet e gjykatësve në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit në fjalë. Në veçanti, është e rëndësishme të dihet nëse trupi gjykues konstaton se një dëshmitar nuk është i besueshëm – rast në të cilin dëshmia e tij nuk do të merret parasysh – apo nëse trupi gjykues ka rezerva në lidhje me besueshmërinë e tij, me qëllim që pastaj të mund të kërkojë vërtetimin e dëshmisë. Çdo shënim rreth besueshmërisë duhet t'i bashkëngjitet përmbledhjes, për të siguruar që gjykatësit do t'ia japin peshën e duhur dëshmisë kur të nxjerrin përfundimet e faktit apo kur të përcaktojnë përgjegjësinë penale. Sistemi i TPNJ-së bën edhe fotografi të dëshmitarëve dhe ua vë në dispozicion gjykatësve me qëllim që në fund të procedurave të gjata gjyqësore, ata të kenë mundësi të rifreskojnë kujtesën dhe t'i vendosin provat në kontekstin e tyre.

34. Në fund të çështjes gjyqësore (apo në fund të paraqitjes së çështjes nga Prokuroria, kur sistemi ligjor parashikon mundësinë e paraqitjes së një mocioni për shfajësim, si në TPNJ), duhet të jetë e mundur që të fillojë procesi i përpilimit paraprak të aktgjykimit. Deri në atë kohë, secili nga seksionet e tij duhet të përmbajë një përmbledhje të të gjitha deponimeve/provave materiale përkatëse me qëllim që t'i marrë parasysh hartuesi.

C.2 Metoda e sistemit elektronik të gjykatës

35. Sistemi elektronik i gjykatës[186] (e-court) u fut në TPNJ kryesisht për të ndihmuar në menaxhimin e provave gjatë gjykimeve. Sistemi i TPNJ-së përfshin si transkriptimin e procedurave të gjyqit ashtu edhe të gjitha provat dokumentare të marra gjatë gjykimit. Qëllimi është që të hiqen "letrat" me qëllim që të gjithë pjesëmarrësit të kenë qasje në transkriptimet dhe në provat dokumentare përmes kompjuterëve në sallën e gjyqit, si edhe nga larg, nga zyrat në ndërtesën e TPNJ-së, apo edhe që nga përjashta ndërtesës. Sistemi elektronik eliminoi mjaft nevojën që palët, punonjësit e Sekretarisë, dhe Gjykatësit të sillnin në gjykatë dosjet e shumta me dokumente dhe materiale të tjera që mund të nevojiteshin gjatë një seance të caktuar gjyqësore.

186 Për një hyrje të hollësishme në sistemin elektronik (e-court), shih mbi Administrimin e Gjyqit.

36. Përveç përfitimeve që ka një sistem krejtësisht elektronik, sistemi elektronik e ka ndihmuar gjykatën në hartimin e aktgjykimeve të saj. Sistemi i TPNJ-së siguron një metodë për mbajtjen e shënimeve, organizimin, theksimin e pjesëve në të, të transkripteve dhe të provave dokumentare në bazë të vazhdueshme. Në disa raste, ai tipar e ka eliminuar realisht nevojën për përgatitjen e përmbledhjeve të gjata të provave dhe dokumenteve në një fazë të hershme në procesin e hartimit të aktgjykimeve.

37. Gjatë paraqitjes së provave, mbi to mund të bëhen elektronikisht shënime që tregojnë se janë prova që lidhen me çështje të caktuara apo me çështje të një liste. Lista e çështjeve përgatitet përpara fillimit të gjykimi dhe mbështetet në skicën e diskutuar më sipër.[187] Megjithatë, një listë më e hollësishme mund të ishte e dobishme. Përgatitja e një liste të hollësishme kërkon një njohje të madhe të çështjes në përgjithësi dhe të temave dhe nëntemave që kanë më të ngjarë të përbëjnë bërthamën e aktgjykimit. Një listë tipike do të përfshinte një çështje për secilin prej të akuzuarve, plus një çështje në lidhje me vendngjarjen e akuzuar në aktakuzë. Pra, sa herë që një dëshmitar apo një dëshmi dokumentare pranohet gjatë gjyqit, sidomos kur janë prova që lidhem me një të akuzuar të caktuar apo me ngjarje të ndodhura në një vendngjarje të caktuar, seksionit përkatës të transkriptit apo dokumentit mund t'i vihet një shënim që tregon se ai lidhet me atë çështje. Në rastin e çështjeve gjyqësore komplekse, sidomos çështjeve me shumë të akuzuar, lista e problemeve mund të jetë shumë e gjatë, prandaj provat që pasqyrojnë secilin nga problemet e lidhura me të duhen shënuar me rigorozitet. Në rast se del e pamundur që të bëhen shënime sipas problemeve të ndryshme kur janë duke u paraqitur provat, mund të përdoren edhe kompjuterët e zyrave për të shtuar shënime që lidhen me problemet në fjalë në provat materiale pasi të ketë përfunduar sesioni i asaj dite në gjykatë.

38. Duhet theksuar se të gjithë pjesëmarrësit në gjyq, përfshirë Prokurorinë, Mbrojtjen, dhe Gjykatësit, kanë fushat e tyre në sistemin e tyre elektronik. Si rrjedhojë, vetëm palët mund të shohin shënimet apo shenjat që kanë bërë në provat, ndërsa Gjykatësit mund të krijojnë dosjet e tyre personale elektronike ku nuk mund të hyjnë dot Gjykatësit e tjerë apo personali tjetër ligjor që mund të ndihmojë në gjyq.

39. Në rastet kur përbri provave mbahen shënime për këto çështje, në sistemin elektronik mund të kërkohet një "raport i çështjeve". Ky raport mund të nxjerrë të gjitha provat që janë shënuar si prova që lidhen me një problem të caktuar. Sistemi mund të identifikojë menjëherë të gjitha seksionet e transkriptit dhe dokumentet që janë shënuar se lidhen me një vendndodhje të caktuar krimi apo me një të akuzuar. Provat për atë çështje të caktuar pastaj mund të analizohen dhe përfshihen në draft. Ky proces kryhet në bazë të vazhdueshme gjatë gjithë gjyqit me qëllim që draftet të jenë gjithëpërfshirës dhe të përfshijnë provat përkatëse deri në fund të procedurës.

40. Ndonëse sistemi elektronik e largon nevojën për t'i futur përmbledhjet e hollësishme të dëshmive të dëshmitarëve në formë teksti në pjesët e draftit të aktgjykimit, praktika e TPNJ-së është që të përgatisë përmbledhje të reja në formë të shkurtër të dëshmive të dëshmitarëve në disa raste. Këto përmbledhje japin një ide të përgjithshme të shkurtër të fushave të provave të mbuluara nga një dëshmitar i caktuar, dhe përfshijnë informacion bazë rreth dëshmitarëve. Këto përmbledhje në formë të shkurtuar janë të dobishme, sidomos në çështje të mëdha gjyqësore që zgjasin me muaj, sepse shërbejnë si referenca të shpejta për secilin dëshmitar. Përmbledhjet i lejojnë Gjykatësit të freskojnë kujtimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e dëshmisë së dëshmitarëve, si edhe me kundërshtimet e palëve në lidhje provat dhe besueshmërinë e dëshmitarëve. Të paktën në dy nga çështjet gjyqësore më të mëdha të TPNJ-së, Gjykatësit kanë zhvilluar diskutime paraprake rreth dëshmisë së dëshmitarëve menjëherë pas mbarimit të tyre, dhe komentet e shprehura në këto diskutime janë regjistruar në përmbledhjet e dëshmive për t'u përdorur si pika referimi në të ardhmen.

187 *Shih* Kapitulli IX, seksioni A - "Skica e Aktgjykimit".

41. Sistemi aktual elektronik i TPNJ-së ka kufizimet e veta, por megjithatë ka përparësitë e veta sepse u jep mundësi pjesëmarrësve të mbajnë shënime për probleme të caktuara, dhe të bashkëngjisin shënime në pjesë të caktuara apo seksione të dokumenteve, në mënyrë që të sigurohet një proces më i efektshëm i përpilimit të aktgjykimeve. Përveç kësaj, sistemi u jep mundësi Gjykatësve që të kërkojnë me shpejtësi dhe lehtësi transkriptimet dhe provat dokumentare nga kompjuterët e zyrave (shih kutinë "*Kufizimet e sistemit elektronik të gjykatës*").

Kufizimet e sistemit elektronik të gjykatës

Sistemi elektronik i gjykatës është një instrument i dobishëm për analizën e provave dhe hartimin e aktgjykimeve të shkallës së parë në TPNJ. Megjithatë, ai ka kufizimet e veta kur përdoret për qëllimet e hartimit të aktgjykimeve.

Së pari, efektiviteti i sistemit varet nga kompetenca dhe vigjilenca e përdoruesve. Për shembull, kur palët fusin dokumente në sistem, ato u vënë atyre një titull. Shpesh, ai titull përmban gabime, apo nuk reflekton emrin aktual të dokumentit. Kjo shkakton probleme kur Gjykatësit apo pjesëtarët e stafit ligjor kërkojnë dokumente me fjalë të caktuara kyçe, apo për kategori dokumentesh. I njëjti dokument mund të futet në sistem më shumë se një herë nga palë të ndryshme, me tituj pak më të ndryshëm dhe kjo mund të shkaktojë konfuzion. Përveç kësaj, kur një dokument futet në sistem gjatë gjyqit, punonjësi ligjor që merr pjesë në procedurat gjyqësore duhet të jetë i kujdesshëm të sigurojë që në të të shënohen me kujdes të gjithë elementët e duhur që të dalë më vonë në sistem kur hartuesit të kërkojnë raporte të një elementi për çështje të caktuara. Kur një çështje e duhur nuk shënohet në dokument, hartuesi nuk ka se si ta dijë se ai dokument mund të jetë ai që duhet për pjesën e tij apo të saj.

Së dyti, ka shumë kufizime teknike në sistemin që përdoret aktualisht në TPNJ. Ajo që ka më rëndësi nga pikëpamja e perspektivës së hartimit të aktgjykimeve është se tani nuk është e mundur të kërkohen dokumente në sistemin elektronik të gjykatës për terma të caktuara. Me fjalë të tjera, edhe pse mund të kërkohet titulli i dokumentit për të parë se sa prej tyre kanë një fjalë të caktuar (emri i të akuzuarit, për shembull) në titull, nuk mund të kërkosh përmbajtjen aktuale të dokumenteve (qoftë veç e veç apo së bashku) për atë fjalë të caktuar. Ky do të ishte një instrument i dobishëm për ta shtuar në sistem. Në shënimet e drejtpërdrejta të gjyqit (transkriptimi), është e mundur të kërkosh fjalë të caktuara, por jo fjalë të shumëfishta apo fraza. Përsëri, do të ishte me dobi që të kishte mundësi të kërkohej për një term që mund të përmbajë më shumë se një fjalë (për shembull, Tribunali Ndërkombëtar) apo Këshilli i Lartë i Mbrojtjes).

D. Ligji i zbatueshëm

42. Në përgjithësi, pjesët e aktgjykimit që flasin për ligjin e zbatueshëm mund të hartohen menjëherë. Hartimi i hershëm i këtyre seksioneve bën të mundur të identifikohen pikat e ligjit ku nevojiten dëshmi.

43. Ndërsa kërkesat ombrellë bëjnë pjesë në përkufizimet e krimeve individuale, metoda e hartimit të aktgjykimeve që përshkruhet këtu nuk kërkon përsëritjen e këtyre kërkesave në këtë fazë, meqenëse ato trajtohen në një kapitull të mëparshëm. Kështu që, ligji i zbatueshëm duhet të përqendrohet vetëm në krimet kryesore (p.sh., vrasja). Kur sistemet e brendshme përfshijnë përkufizimet e krimeve të Statutit të Romës të GJPN-së, ku përzihen kërkesat e përgjithshme me ato specifike që lidhen me krimin, mund të jetë e nevojshme që të shihet mundësia e një metode alternative të hartimit të aktgjykimeve.

44. Hartimi i seksioneve për ligjin duhet, aq sa të jetë e mundur, të përfundojë deri në fund të çështjes. Mund të ndodhë që të jetë e nevojshme të përshtaten draft-seksionet për të futur në to informacione që do të paraqiten në dosjet dhe argumentet përmbyllëse. Megjithatë, është me rëndësi që të përfundojë seksioni për ligjin e zbatueshëm sa më shpejt që të jetë e mundur sepse faza tjetër e hartimit do të përfshijë konstatimet e mbështetura në zbatimin e ligjit për faktet e nxjerra nga dëshmitë dhe provat materiale të dëshmitarëve. Ky proces lehtësohet shumë nga sistemi i prerë i mbështetjes te elementët e krimit, i cili parashtron elementët fizikë dhe mendorë të krimeve të akuzuara dhe format e përgjegjësisë.

E. Konstatimet faktike

45. Në nxjerrjen e konstatimeve faktike, është me rëndësi që Dhoma që dalë me përfundime të qarta në lidhje me secilin nga këta elementë të krimit që diskutohet. Ky proces lehtësohet nga miratimi i një strukturë të përshtatshme paraqitjeje të aktgjykimit, sikurse sugjerohet më lart. Përcaktimi i menjëhershëm i ligjit të zbatueshëm përpara konstatimeve të faktit që lidhen me akuzën në diskutim, e bën më të lehtë për Dhomën Gjyqësore të sigurohet se janë nxjerrë të gjitha konkluzionet e nevojshme. Këto konstatime të fakteve duhet të jenë përtej dyshimit të arsyeshëm.

Lëndët Kordić dhe Čerkez, Kvočka e të tjerët dhe Orić - Mosparaqitja e konstatimeve për secilin element të krimit apo të secilit krim kryesor

Në çështjen Kordić dhe Čerkez, Dhoma Gjyqësore erdhi në përfundim se krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit ishin kryer, pa bërë konstatime të qarta faktike në lidhje me secilin nga elementët e krimeve. Si rrjedhojë, Dhoma e Apelit, rishqyrtoi elementët e krimeve dhe vendndodhjet e krimeve një nga një. Me qëllim për të përcaktuar nëse një gjykues i arsyeshëm faktesh do të kishte dalë me gjetjet faktike të Dhomës Gjyqësore që provonin elementët e kërkuar të krimeve të akuzuar. Duke bërë këtë, Dhoma e Apelit përcaktoi se në disa raste, provat përpara Dhomës Gjyqësore tregonin se në disa raste, provat përpara Dhomës Gjyqësore nuk e mbështesnin konstatimin se disa krime të caktuara ishin kryer.***

*Po ashtu, në çështjen Kvočka e të tjerë***, Dhoma Gjyqësore nuk i organizoi konstatimet faktike të saj në mënyrë të tillë që të trajtonte veç e veç secilin incident që përmbanin listat e incidenteve në shtojcat e aktakuzës. Përkundrazi, Dhoma Gjyqësore doli me konstatime faktike më të përgjithshme në lidhje me kushtet e paraburgimit dhe trajtimit në kampin Omarska. Ndonëse Dhoma e Apelit ishte e mendimit se kjo nuk e bënte të pavlefshëm Aktgjykimin e Dhomës, për sa kohë që Dhoma Gjyqësore në fakt i kishte nxjerrë përfundimet e faktit të paktën për disa krime individuale mbi të cilat mbështeteshin fajësimet e Apeluesve, ajo shprehu pëlqimin e saj të qartë për metodën sistematike të ndjekur nga Dhoma Gjyqësore e çështjes Krnojelac.**** Ajo Dhomë, e përballur me një aktakuzë të strukturuar në mënyrë të ngjashme, duke përfshirë listat e incidenteve të caktuar që lidheshin me krimet e ndryshme të akuzuar, së pari, doli me gjetjet faktike për secilin incident të paraqitur në listat e bashkëngjitura aktakuzës përpara se të shqyrtonte përgjegjësinë e të akuzuarit.*

Në çështjen Orić, Dhoma Gjyqësore e shpalli fajtor të akuzuarin për moskryerjen e detyrës së tij si epror në marrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e vrasjeve dhe trajtimit mizor. Në apel, Dhoma e Apelit konstatoi se Dhoma Gjyqësore nuk kishte nxjerrë konstatimet e nevojshme për të mbështetur shpalljen e fajësisë sipas përgjegjësisë komanduese. Konkretisht, Dhoma Gjyqësore gaboi në moszgjidhjen e dy elementë thelbësore: përgjegjësinë penale të vartësve të Orić-it, dhe nëse Orić kishte dijeni apo arsye ta dinte se vartësi i tij do të kryente apo kishte kryer krime. Vendimi i Dhomës së Apelit konstatoi se këto gabime e nxirrnin të pavlefshëm vendimin e Dhomës Gjyqësore. Pasi hodhi poshtë edhe apelimin e çështjes nga Prokuroria, Dhoma e Apelit e la të lirë Orić-in.

* Prokurori kundër Kordić dhe Čerkez, Lënda Nr. IT-95-14/2-T, Aktgjykimi, 26 shkurt 2001.
** Prokurori kundër Kordić dhe Čerkez, Lënda Nr. IT-95-14/2-A, J Aktgjykimi, 17 dhjetor 2004.
*** Prokurori kundër Kvočka e të tjerë, Lënda Nr. IT-98-30/1-T, Aktgjykimi 2 nëntor 2001.
**** Prokurori kundër Kvočka e të tjerë, Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Aktgjykimi, 28 shkurt 2005, para. 69-73.

46. Duke qenë se çështjet gjyqësore në TPNJ përfshijnë krime komplekse që shtrihen në një gamë të gjerë kohore dhe gjeografike, ato priren të përfshijnë shumë më tepër prova se sa mund të priten në një çështje të vendore penale. Si pasojë, rrjedhimisht bëhet më e vështirë të ndiqen të gjithë faktet përkatëse, me qëllim nxjerrjen e konstatimeve. Përsëri, struktura e skicës (ose kur ka një sistem elektronik në gjykatë, lista gjithëpërfshirëse e problemeve) luan një rol të rëndësishëm për të siguruar që të gjitha provat përkatëse të merren parasysh në vendimin përfundimtar. Sikurse thuhet me hollësi më lart, me anë të metodës tradicionale, kur të gjitha përmbledhjet e dëshmive që lidhen me një krim të caktuar (p.*sh.*, përndjekje) shtohen sistematikisht në atë seksion të draft-aktgjykimit me ecurinë e çështjes gjyqësore, trupi gjykues mund të jetë i sigurt se do të ketë të gjitha provat përpara tij kur të nxjerrë konstatimet e fakteve dhe përfundimet ligjore që lidhen me atë krim.

47. Do të duket se gjëja më normale që duhej theksuar do të ishte nevoja për të bërë konstatimet e nevojshme të faktit në lidhje me secilin nga elementët e krimit apo formë të përgjegjësisë, por përvoja në TPNJ ka treguar se kjo nuk ndodh gjithmonë. Meqenëse, sipas Rregullores së TPNJ-së, Dhomat Gjyqësore nuk bëjnë raporte të veçanta për Dhomën e Apelit mbi arsyet ku mbështeten aktgjykimet e tyre, rezultat i mosparaqitjes së konstatimeve sistematike në vetë aktgjykimin mund të jetë kthimi i këtyre konstatimeve në apel apo rrëzimi i shpalljes së fajësisë (shih kutinë "*Lëndët Kordić dhe Čerkez, Kvočka e të tjerët dhe Orić - Mosparaqitja e konstatimeve për secilin element të krimit apo të secilit krim kryesor*").

F. Ndjekja e historisë procedurale

48. Ndjekja e çështjeve të tjera të mëdha procedurale që dalin gjatë gjykimit do të lehtësojë hartimin e historisë procedurale në fund të çështjes. Një ndjekje më e hollësishme e çështjeve procedurale do të ndihmojë gjithashtu në zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë gjyqit.

49. Ndonëse ka të ngjarë se do të ketë një sistem me anë të së cilit ndiqen vendimet me shkrim gjatë gjyqit, po ashtu është me rëndësi që të ndiqen edhe vendimet gojore me qëllim që të shmanget kërkimi i tyre në fund të gjyqit. Si rrjedhojë, vendimet me gojë duhet të ndiqen në bazë ditore në gjykatë në një dokument që mbahet në hard drive-n e një kompjuteri të përbashkët. Kjo siguron që të gjitha vendimet me gojë të regjistrohen në një vend të vetëm, bashkë me të dhënat dhe transkriptimet e nevojshme për t'u përdorur me lehtësi si referenca.

50. Në rast se gjatë shqyrtimit të çështjes gjyqësore, dikush futet në atë faqe, hollësitë e asaj vizite duhen parë, për qëllime të historisë procedurale. Në rast se qëllimi i asaj vizite në atë faqe është që të merren prova, i akuzuari duhet të jetë i pranishëm meqenëse ai ka të drejtë të jetë i pranishëm në gjyqin e tij.

G. Mocionet për pafajësi

51. Rregullat e TPNJ-së – të ndërtuara kryesisht në bazë të sistemit zakonor anglo-sakson të vënies në lëvizje të çështjes nga palët – parashikojnë mundësinë e aktgjykimit të shfajësimit pas mbylljes së paraqitjes së çështjes nga Prokuroria. Ndodh shumë shpesh që i akuzuari të kërkojë shfajësimin e tij në bazë të faktit se Prokuroria ka paraqitur prova të pamjaftueshme për të mbështetur fajësimin e tij. Pavarësisht se deri më sot asnjë Dhomë Gjyqësore nuk e ka shpallur një të akuzuar plotësisht të pafajshëm në fund të paraqitjes së çështjes nga Prokuroria pas një mocioni për shfajësim, shpesh pika të caktuara të aktakuzës janë rrëzuar në atë fazë (shih kutinë "*Lëndët Delalić e të tjerët, Naletelić dhe Martinović, Stakić, Orić - Rrëzimi i akuzave pas paraqitjes së çështjes nga Prokuroria*").

52. Me qëllim që një Dhomë të vendosë për një mocion shfajësimi pas përfundimit të çështjes së Prokurorisë, ajo duhet të jetë e qartë për elementët ligjorë të krimeve dhe/ose të formave të përgjegjësisë që diskutohen. Si rrjedhojë, seksionet ligjore të draft-aktakuzës duhet të jenë avancuar aq sa për t'i dhënë mundësi Dhomës të japë vendimin e saj.

53. Në rast se një i akuzuar shpallet i pafajshëm për ndonjërën nga pikat a aktakuzës në këtë faqe, kjo gjë duhet të pasqyrohet në draft-aktakuzë. Për më tepër, shfajësimi duhet të vihet në dukje që në fillim të Përmbledhjes së seksionit të Akuzave.

H. Implikimet e gjyqeve me shumë të akuzuar

54. Qysh nga themelimi i saj, TPNJ-ja ka zhvilluar gjyqe të shumta që përfshinin më shumë se një të akuzuar, disa prej të cilëve me rreth gjashtë apo shtatë të akuzuar që janë gjykuar së bashku. Një faktor që i shtohet kompleksitetit të gjyqeve me shumë të akuzuar është fakti se shpesh aktakuzat janë të gjata, mbulojnë zona të gjera gjeografike dhe/ose periudha të gjata kohe. Si rrjedhojë, një aktakuzë mund të përmbajë akuza të shumta individuale dhe një sasi shumë të madhe provash, përfshirë transkriptimet e gjykatës, që përbëhen nga mijëra faqe, si dhe gjasat e pranimit të disa mijëra provave materiale gjatë gjyqit. Si rrjedhojë, edhe aktgjykimet do të jenë të gjata. Për më tepër, në disa gjykime me shumë të akuzuar në TPNJ, personat në gjykatë janë individë që kanë pasur poste të larta në strukturat politike, ushtarake apo policore në vendet e tyre, që nuk akuzohen për kryerje të drejtpërdrejtë fizike të ndonjë krimi, por për faktin se kanë qenë përgjegjës për krime në shkallë të gjerë në sajë të posteve të tyre drejtuese. Ky fakt i shtohet kompleksitetit të provave dhe shton numrin e analizave të ligjit dhe faktit që kërkohen për aktgjykimin përfundimtar.

Lëndët Delalić e të tjerët, Naletelić dhe Martinović, Stakić, Orić – Rrëzimi i akuzave pas paraqitjes së çështjes nga Prokuroria

Dhoma e Apelit në çështjen Delalić e të tjerë përcaktoi testin që duhet përdorur për të përcaktuar nëse provat janë të pamjaftueshme për të lënë në fuqi një vendim fajësie, pra, nëse ka prova (nëse pranohen) në bazë të të cilave një gjykues i arsyeshëm faktesh mund të ishte i bindur përtej dyshimit të arsyeshëm për fajësinë e të akuzuarit në lidhje me akuzën në fjalë.

Në çështjen Naletelić dhe Martinović, Dhoma Gjyqësore e përdori këtë standard dhe vendosi se Prokuroria kishte paraqitur prova të mjaftueshme për të plotësuar standardin për të gjitha pikat e aktakuzës. Megjithatë, ajo konstatoi gjithashtu se nuk ishin paraqitur prova, apo nuk ishin paraqitur prova të mjaftueshme për incidentet e përshkruar në dy paragrafë konkretë të aktakuzës. Në çështjen Stakić, Dhoma Gjyqësore përdori standardin duke rezultuar në hedhjen poshtë të akuzave për nxitje në një numër pikash të aktakuzës për mungesë provash.

Në vitin 2004, Rregulli I TPNJ-së 98bis u ndryshua duke parashikuar që mocione të tilla të trajtoheshin gojarisht. Në çështjen Orić, ku u përdor për herë të parë procedura e re gojore dhe u dha vendim me gojë në të cilin Dhoma Gjyqësore konstatoi se Prokuroria nuk kishte arritur të siguronte prova të mjaftueshme për të mbështetur vendimin e fajësisë për krimin e plaçkitjes së pronës publike, dhe kështu e shfajësoi të akuzuarin nga të gjitha pikat e Aktakuzës. Më tej Dhoma Gjyqësore konstatoi se Prokuroria nuk kishte arritur të siguronte prova për të mbështetur fajësinë për disa incidente të akuzuar si krime, por kjo rezultoi në heqjen nga aktakuza vetëm të këtyre incidenteve të pretenduar meqenëse u paraqitën prova për incidente të tjera që mbështetën lënien në të të akuzave të tjera më të gjera.

55. Në gjykime me shumë të akuzuar është veçanërisht e rëndësishme që të fillohet procesi i organizimit dhe analizës së provave për aktgjykimin që në fillim të procedurave gjyqësore. Ndryshe, kjo përbën rrezik për vonesa të gjata pas mbyllja e gjykimit, deri në daljen e aktgjykimit. Përpara fillimit të gjykimit, duhet të ketë një farë mirëkuptimi në lidhje me çështjet që kanë të ngjarë të kundërshtohen gjatë gjyqit, gjë që do të shpjerë në përgatitjen e një skice të aktgjykimit dhe (për çështje që përdorin sistemin elektronik të gjykatës) një listë të hollësishme të çështjeve për diskutim. Meqenëse do të ketë më shumë se një hartues të aktgjykimit, gjykata duhet ta bëjë të qartë se cilët persona do të merren me cilën pjesë të aktgjykimit, me qëllim që secili "hartues" të analizojë dhe përfshijë provat që lidhen me atë seksion apo seksione në bazë të vazhdueshme gjatë gjithë gjyqit.

56. Aq sa është e mundur, secilit hartues duhet t'i caktohet subjekti që do të mbulojë. Caktimi i tyre mund të thotë se një hartues merr përgjegjësi për një seksion të tërë që mund të përfshijë një apo më shumë çështje. Kur një seksion ndahet në nën-seksione, të cilët janë në vetvete të mëdhenj (si, për shembull, seksioni për krimet dhe konstatimet), një hartuesi mund t'i caktohet një nënseksion për një krim të caktuar.

57. Sikurse u tha më sipër, stili i përdorur në aktgjykimin përfundimtar varet kryesisht nga pikëpamjet e Gjykatësve të caktuar të Dhomës Gjyqësore. Megjithatë, në çështje gjyqësore me shumë të akuzuar, dhe me qëllim që të shmangen aktgjykime prej më shumë se një mijë faqesh, mund të jetë e nevojshme që disa aspekteve t'u kushtohet më pak diskutim krahasuar me çështje gjyqësore të vogla. Në fakt, në çështje që përfshijnë udhëheqës të lartë ushtarakë, politikë apo policorë, që nuk akuzohen si autorë fizikë, por si persona që në fund të fundit janë përgjegjës për veprimet e qindra apo mijëra autorëve fizikë, ngjarjet e akuzuara si krime në aktakuzë mund të mos kundërshtohen shumë nga Mbrojtja. Përkundrazi, në çështje që përfshijnë udhëheqës të lartë, Mbrojtja mund të përqendrohet në zinxhirin e përgjegjësive të të akuzuarve në këto ngjarje. Në një rast të tillë, aktgjykimet priren të përqendrohen në ato çështje dhe jo në prova që lidhen me vendndodhjet e krimeve.

58. Ka më të ngjarë që çështje të rëndësishme në gjykim mund të lidhen me më shumë se një të akuzuar në një çështje gjyqësore me shumë të akuzuar, si për shembull, mënyra e strukturimit të ushtrisë dhe funksionimi i saj gjatë periudhës në fjalë. Për të shmangur përsëritjet e këtyre çështjeve në aktgjykim, mund të jetë e nevojshme që të shtohen seksione të tjera përveç atyre të përshkruar më lart përpara diskutimit të përgjegjësive individuale penale të secilit prej të pandehurve. Për shembull, në rast se akuzat sugjerojnë se të akuzuarit kanë qenë pjesëtarë të një Ndërmarrjeje të Madhe të Përbashkët Kriminale (NPK), dhe se ata kanë marrë pjesë në atë ndërmarrje përmes anëtarësisë së tyre në organe zyrtare apo jozyrtare komanduese, do të duhet të diskutohet nëse këto organe kanë ekzistuar dhe cilat kanë qenë të drejtat e tyre përpara se të trajtohet pjesëmarrja e pretenduar e secilit të akuzuar në NPK.

59. Këto gjyqe të mëdha krijojnë rrezikun që hartuesit do të mbeten shumë mbrapa në procesin e hartimit, dhe kjo do të shkaktojë vonesa të gjata në mbylljen e procedurave përpara nxjerrjes së aktgjykimit. Vendosja e një plani kohor për prodhimin dhe rishikimin e drafteve është një pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Ka rëndësi që të organizohet renditja e diskutimeve paraprake dhe të rishikohen draftet me ecurinë e çështjes gjyqësore.

I. Konsiderata të përgjithshme

60. Është e këshillueshme që të vendoset një afat kohor për përgatitjen e draft-aktgjykimit me qëllim që seksione të ndryshme të përfundojnë në kohë të ndryshme. Një plan kohor i shkallëzuar do të pasqyrojë realitetin se disa pjesë do të kërkojnë më shumë punë të përgatiten se të tjerat dhe se disa pjesë do të fillohen dhe mbarohen më shpejt se të tjerët. Përveç kësaj, Gjykatësit mund të shohin vetëm një draft njëherazi, kështu që një proces i shkallëzuar maksimizon efektivitetin. Një përfitim tjetër i afatit kohor është se çdo draft duhet të shihet të paktën një herë, për të mos thënë dy herë, përpara se të konsolidohet i gjithë drafti dhe t'u shpërndahet si "drafti i parë i aktgjykimit". Kështu, drafti i parë duhet të jetë mjaft i avancuar.

61. Është mirë që disa pjesë të caktuara të hartohen qysh në fillim të procesit të gjykimit. Këtu hyjnë pjesë të tilla si Përmbledhja e Akuzave dhe Konsideratat e Përgjithshme për Vlerësimin e Provave. Në lidhje me këtë të fundit, është me rëndësi që kjo pjesë të përfundohet herët me qëllim që gjithkush të ketë dijeni për parametrat me të cilat do të punojë. Pjesët për ligjin po ashtu mund të shqyrtohen veçan dhe përpara konstatimeve të faktit.

62. Është me dobi që Gjykatësit të mblidhen dhe diskutojnë draftin midis tyre dhe në diskutim të përfshijnë ata pjesëtarë të stafit që do t'i ndihmojnë. Mbledhje të tilla duhet të mbahen sa më shpejt që të jetë e mundur pas përfundimit të një drafti, pas përcaktimit të planit kohor që përmendëm më sipër.

63. Në TPNJ nuk ka ndonjë marrëveshje për kohëzgjatjen ideale të një aktgjykimi. Në përgjithësi, aktgjykimet janë aq të gjata sa Gjykatësit mendojnë se është e nevojshme për të trajtuar çështjet në diskutim. Në fakt, ka pasur aktgjykime me gjatësi të ndryshme (për shembull, krahasoni aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore në çështjen *Furundžija*, me mbi 100 faqe, me Aktgjykimin e Dhomës në çështjen *Hadžihasanović* dhe *Kubura*, me gati 700 faqe në përkthimin anglisht, dhe me Aktgjykimin e çështjes *Milutinović e të tjerë* me mbi 1700 faqe).

64. Hartuesit e Aktgjykimeve duhet të mbajnë parasysh se gjatësia e aktgjykimeve ndikon në sasinë e përkthimeve që kërkohen, dhe lehtësinë me të cilën një gjykatë apeli mund të gjykojë çështjen në apel. Në TPNJ, Aktgjykimet e shkallës së parë duhet të përkthehen rregullisht në boshnjakisht - kroatisht-serbisht (BKS) me qëllim që të akuzuarit të shprehin mendimet e tyre në apel. Për shkak se përkthimi kërkon kohë dhe përbën një barrë të rëndë për burimet financiare të TPNJ-së, kohët e fundit ka pasur një numër vonesash në procesin e përgatitjeve të dosjeve të apelit, duke shkaktuar vonesa në përfundimin e apeleve. Gjatësia e Aktgjykimeve të Dhomave po ashtu mund të ndikojë në lehtësinë me të cilën Dhoma e Apelit mund të gjejë informacion të nevojshëm për të vendosur për apelin. Edhe pse nuk ndodh gjithnjë kështu, një aktgjykim më i gjatë mund t'ia vështirësojë më shumë punën Dhomës së Apelit për të identifikuar informacionin që kërkon se sa po të kishte të bënte me një Aktgjykim më të shkurtër dhe më të saktë.

65. Është jashtëzakonisht me rëndësi që të ndiqet një metodë e rrjedhshme në lidhje me mënyrën se si pasqyrohet informacioni konfidencial në një Aktgjykim. Në praktikën e TPNJ-së, informacioni konfidencial zakonisht përfshihet në draft-aktgjykime me qëllim që gjykatësit të jenë të sigurt se vendimet që po marrin, janë të mbështetur në të gjithë informacionin ekzistues. Megjithatë, informacioni konfidencial identifikohet (duke përdorur germa të tjera, p.sh.) që të sigurohet që ai informacion të mos përdoret në formën e tij konfidenciale. Përpara finalizimit të aktgjykimit, gjykatësit duhet të marrin vendim nëse ky informacion konfidencial do të përfshihet në aktgjykim, sepse (sipas Nenit 23(2) të Statutit) Aktgjykimi i Dhomës është një dokument publik. Ka të paktën tre mundësi për trajtimin e informacionit konfidencial: (1) ai mund të përfshihet nëse realisht nuk ka pse të mbetet konfidencial (pra, duke e përfshirë atë, Dhoma heq konfidencialitetin e tij); (2) ai mund të përmendet në mënyrë të tillë që të përçojë pikat thelbësore pa iu referuar asgjëje konfidenciale (duke përfshirë referimin ndaj dëshmisë konfidenciale të një dëshmitari në bazë të faqeve të transkriptit në një shënim në fund të faqes, që nuk e identifikon dëshmitarin e mbrojtur, dhe që mund të mos përdoret nga publiku); ose (3) ai mund të lihet krejtësisht jashtë.

J. Rishikimi i draftit të aktgjykimit

66. Në qarkullimin e draftit të partë të aktgjykimit, duhet të vendoset një afat kohor që të mbulojë periudhën nga shpërndarja e tij deri te aktgjykimi përfundimtar. Në TPNJ, praktika është që të qarkullohen dy apo tre drafte, por edhe më shumë drafte mund të jenë të nevojshme në varësi të metodës së ndjekur dhe shkallës së marrëveshjes midis gjykatësve për çështjet kryesore. Afati duhet të përcaktojë datat për:

- komentet për draftin e parë;
- qarkullimin e draftit të dytë;
- komentet për draftin e dytë;
- qarkullimin e draftit të tretë/të fundit;

- qarkullimin e opinioneve të veçanta/kundërshtuese, kur ka;
- komentet përfundimtare;
- nënshkrimin e aktgjykimit.

67. Afati kohor mund të parashikojë edhe rrahjen e mendimeve midis gjykatësve për të diskutuar draftet, sidomos çështje të veçanta për të cilat ka mendime të kundërta. Ndihmësit e stafit të përfshirë në procesin e hartimit të aktgjykimit duhet të jenë të pranishëm në këto rrahje mendimesh.

68. Ndërsa është duke u rishikuar thelbi i draft-aktgjykimeve, mund të vazhdojë të bëhet edhe rishikimi i thellë redaktorial i draftit me qëllim për të siguruar konsistencë termash dhe formati. Ka disa kontrolle që duhen bërë, duke përfshirë:

- standardizimin e tekstit;
- rishikimin e tekstit për të parë dëshmitë e dhëna në seancë të mbyllur apo private, apo referencat ndaj dokumenteve të vulosura;
- kontrollin e përgjithshëm të konfidencialitetit;
- kontrollin e identitetit të dëshmitarit (për t'u siguruar se dëshmitarëve që u janë dhënë pseudonime të përmenden me pseudonime dhe që të mos ketë informacion tjetër i cili mund të nxjerrë identitetin e tyre);
- kontrollin gjuhësor (në TPNJ është e nevojshme të kontrollohet p.sh., germat që shkruhen me shenja në BKS);
- standardizimin e stilit të shënimeve në fund që faqes;
- referencat fillestare në fjalor (kur del për herë të parë, duhet të jetë në formë të plotë, por më pas mund të përdoret në formë të shkurtuar);
- kontrollin e citimeve – saktësia e referencave në shënimet në fund të faqes;
- heqjen e metadata-ve që rezultojnë nga draft-komentet (nuk mjafton që vetëm të pranosh apo të mos pranosh ndryshimet – duhen hequr edhe metadata-t pas tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur aktgjykimi do të vendoset në format elektronik për përdorim publik, ku përdoruesit e sofistikuar të kompjuterëve mund të shohin pas dokumentit); dhe
- referencat e ndërthurura, sidomos në shënimet në fund të faqeve.

69. Siç thuhet më sipër, përdorimi i një udhëzuesi për stilin do të ndihmojë shumë për reduktimin e sasisë së redaktimeve të minutës së fundit që mund të nevojiten. Megjithatë, është e qartë se gjithmonë do të ketë shumë gjëra që do të duhet të kontrollohen në fund. Sugjerohet të përdoret një listë për të monitoruar të gjitha gjërat e ndryshme që duhen bërë gjatë procesit të rishikimit. Lista do të sigurojë bërjen e të gjitha kontrolleve në të gjithë kapitujt.

70. Ka një avantazh në vonesën e konsolidimit elektronik të draftit deri në një fazë relativisht të vonë, sepse në versionin bazë elektronik mund të punojë vetëm një person njëherazi. Për sa kohë që kapitujt në formë drafti ruhen në dokumente të veçanta elektronike, është e mundur të punojnë shumë persona njëherazi në aktgjykim. Gjatë procesit të hartimit, është e mundur të shpërndahen draft-aktgjykimet si një grup dokumentesh të shumëfishtë të ndarë nga ndarës, duke lënë vetëm versionin përfundimtar për ta konsoliduar.

71. Pas konsolidimit të tekstit, vetëm një person caktohet për të shërbyer si "rojtar" i dokumentit. Ky person siguron që gjithkush të punojë me dokumentin e duhur, dhe që asnjë punë e paaprovuar të mos kryhet mbi të. Rojtari gjithashtu menaxhon edhe afatin kohor të dokumentit, duke i informuar të tjerët se kur mund të presin të punojnë me dokumentin bazë.

K. Konsideratat përfundimtare

72. Teksa finalizohet aktgjykimi, mund të futen në lojë një numër konsideratash të tjera. Për dhënien e aktgjykimit në seancë të hapur, duhet të përgatitet një përmbledhje e aktgjykimit për t'u paraqitur në gjykatë. Në rast se ka një zyrë shtypi për marrëdhënie me publikun, ajo zyrë duhet të informohet me qëllim që të përgatisë një deklaratë për shtyp. Personeli i Dhomës po ashtu duhet të marrë masa që të jenë gati printerët me qëllim që aktgjykimi të jepet në kohë për t'u shtypur dhe shpërndarë.

IX. Shtojca 10: Kërkesat Chapeau

Është vendosur tashmë në jurisprudencën e TPNJ-së se për disa krime ka kërkesa ombrellë që duhet të provohen, përveç elementëve të krimit kryesor në fjalë. Ato janë si më poshtë:

- ***Neni 2: Shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës** – ka katër kërkesa ombrellë për zbatimin e këtyre dispozitave: të ekzistojë një konflikt i armatosur;*
  - *konflikti i armatosur duhet të ketë natyrë ndërkombëtare;*
  - *të ketë një lidhje midis krimeve të pretenduara dhe konfliktit të armatosur; dhe*
  - *viktimat e krimeve të pretenduara të jenë persona të mbrojtur në përputhje me dispozitat e Konventave të Gjenevës të vitit 1949.*
- ***Neni 3: Shkeljet e ligjeve dhe zakoneve të luftës** – ka gjashtë kërkesa ombrellë për përcaktimin e këtyre shkeljeve:*
  - *të ekzistojë një konflikt i armatosur;*
  - *të ketë një lidhje midis krimeve të pretenduara dhe konfliktit të armatosur;*
  - *dhunimi duhet të përbëjë një shkelje të një rregulli të së drejtës humanitare ndërkombëtare;*
  - *rregulli duhet të ketë natyrë zakonore apo, në rast se i takon të drejtës së traktatit, duhet të plotësojë disa kushte;*
  - *shkelja duhet të jetë serioze, që do të thotë, duhet të përbëjë shkelje të një rregulli që mbron vlera të rëndësishme, dhe shkelja duhet të përfshijë pasoja serioze për viktimën;*
  - *shkelja e rregullit duhet të përfshijë përgjegjësinë penale individuale të personit që shkel rregullin.*
- ***Neni 5: Krimet kundër njerëzimit** – ka dy kërkesa ombrellë për përcaktimin e këtyre krimeve. Ata duhet të kryhen:*
  - *gjatë një konflikti të armatosur, qoftë me karakter të brendshëm apo ndërkombëtar (vini re se kjo është kërkesë e praktikës ligjore të TPNJ-së dhe jo një kërkesë sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare); dhe*
  - *si pjesë e një sulmi të gjerë sistematik të drejtuar ndaj popullsisë civile. Kjo kërkesë kërkon përcaktimin e pesë nën-elementëve:*
    - *duhet të ketë një sulm;*
    - *veprimet e të akuzuarit duhet të jenë pjesë e sulmit;*
    - *sulmi duhet drejtuar ndaj një popullsie civile;*
    - *sulmi duhet të jetë i gjerë ose sistematik;*
    - *i akuzuari duhet të dijë se veprimet e tij janë pjesë e një modeli krimesh të gjera ose sistematike të drejtuara ndaj një popullsie civile dhe se veprimet e tij futen në një model të tillë.*

IX. Shtojca 11: Modeli elektronik i aktgjykimit

- *Shpejt u pa qartë se Dhomat Gjyqësore të TPNJ-së do të përfitonin nga një model elektronik i aktgjykimit i cili do të standardizonte formatimin. Një model i tillë u prodhua nga departamenti i informatikës i gjykatës dhe është përdorur për pjesën më të madhe të aktgjykimeve të dhëna nga TPNJ-ja. Në të vërtetë është modeli i përdorur për paraqitjen e këtij Manuali. Modeli standardizon shtatë nivele titujsh si edhe paragrafët, pjesët e futura më brenda tekstit dhe shënimet në fund të faqes, sikurse tregohet më poshtë:*



A. Heading 2

Heading 3

(a) Heading 4

(i) Heading 5

α. Heading 6

1. Heading 7

#. Paragraph text, paragraph text, paragraph text, paragraph text, paragraph text, paragraph text, paragraph text, paragraph text, paragraph text.

Indented passage, indented passage, indented passage, indented passage, indented passage, indented passage, indented passage, indented passage, indented passage.

X. Apelet

A. Standardi i rishikimit në apel.....135
A.1 Kërkesa të zbatueshme për të gjitha apelet.....135
A.2 Standardi i zbatueshëm në rastet e gabimeve ligjore.137
A.3 Standardi i zbatueshëm në rastet e gabimeve të faktit 140
B. Vetëpërfaqësimi në apel.....142
C. Para-apeli.....144
C.1 Rolet përkatëse të gjykatësit para-apelues dhe seancës paradëgjimore të Dhomës së apelit.....144
C.2 Përgatitja e dosjes brenda një kohe të arsyeshme....145
C.3 Provat plotësuese në apel.....145
D. Përgatitja për seancën apelit.....147
E. Seanca e apelit.....148
F. Këshillimi dhe përpilimi i aktgjykimeve të apelit.....149
G. Administrimi i apeleve të ndërkohshëm dhe apeleve të tjerë 150
H. Procedura e apelit të përshpejtuar.....152

1. Dhoma e apelit dëgjon apelimet, që ngrihen mbi bazën e pretendimeve të gabimeve të kryera në çështjet e ligjit dhe që kanë të bëjnë me vendimet paragjyqësore dhe gjyqësore të shkallës së parë dhe/ose gabimeve të faktit, që çojnë në dështimin e drejtësisë.[188] Apelet mund të bëhen si nga Mbrojtja ashtu edhe nga Prokuroria. Apelet nuk janë rigjykime të çështjeve të gjykuara nga Dhoma gjyqësore e shkallës së parë, por palët munden, në kushte tejet strikte,[189] të lejohen të paraqesin prova plotësuese mbi disa çështje të caktuara. Procesi i apelit është kryesisht një proces me shkrim,[190] ndonëse ai përfshin edhe një seancë të deklarimeve gojore në secilën çështje, ku palët mund të paraqesin argumentet e tyre kryesore. Kur shihet e nevojshme, gjykata mund të organizojë edhe seanca dëgjimore rreth provave plotësuese. Më pas, Dhoma e apelit tërhiqet për të marrë vendim përpara se ta shpallë atë në seancë publike. Në raste të veçanta, palëve u është kërkuar të plotësojnë dosjet e tyre përmes parashtrimit me shkrim, përpara ose pas seancës dëgjimore.

2. Procesi i apelit, ashtu sikurse edhe çdo fazë tjetër e të proceduarit në Tribunal, kërkon nga Dhomat një punë me rendiment. Më poshtë jepen standardet e rishikimit, të zbatuar në Dhomën e apelit të TPNJ-së, si edhe një numër instrumentesh administrues, të konceptuar për mbarëvajtjen e apeleve në mënyrë të drejtë, të paanshme e të shpejtë.

A. Standardi i rishikimit në apel

3. Në apel, palët duhet t'i kufizojnë argumentimet e tyre në gabimet ligjore që zhvleftësojnë vendimin e Dhomës gjyqësore të shkallës së parë ose në gabime faktike që shkaktojnë një dështim të drejtësisë.[191]

A.1 Kërkesa të zbatueshme për të gjitha apelet

4. Me mënyrë që Dhoma e apelit të vlerësojë argumentet e një pale, duhet që pala apeluese të sjellë referenca të sakta lidhur me faqet apo paragrafët përkatës të transkripteve të vendimit të gjykatës së shkallës së parë,

188 Neni 25, Statuti TPNJ. Kjo mund të përfshijë apelime lidhur me vendimet e dënimeve, në vijim të pranimit nga ana e Dhomës gjyqësore të shkallës së parë të një marrëveshje vetëdeklarimi fajësie. Procedimet në apele të tillë janë më të shpejtë se në llojet e tjerë lidhur me aktgjykimet, pasi zakonisht, ata kanë të bëjnë me një numër më të vogël bazash apeluese se sa në rastin e aktgjykimeve.

189 Standardi i aplikueshëm për pranimin e provave plotësuese në apel parashikohet në Rregullin 115, RrPP e TPNJ-së.

190 Rregullat 108 dhe 111-113, ICTY RrPP kërkojnë paraqitjen e këtzre dokumenteve: Paralajmërim të Apelit, Dosjen e Apeluesit, Dosja e Përgjigjes, Dosja e Kundërpërgjigjes.

191 Neni 25, statuti i TPNJ-së dhe 24 i Statutit të TPNR-së. Shih, p.sh. *Brđanin,* Aktgjykim i apelit, para. 8; *Galić* Aktgjykim i apelit , para. 6.

të cilat kundërshtohen prej saj.[192] Për më tepër, "Nuk mund të pritet që Dhoma e apelit të shqyrtojë hollësisht parashtrimet e një pale, në rast se ato janë të errta, kontradiktore, të vagëta ose që vuajnë nga mangësi të dukshme formale".[193]

5. Së fundmi, Dhoma e apelit ka të drejtën të përcaktojë se cilat parashtrime meritojnë shprehjen e një opinioni të shkruar, të hollësishëm e të arsyetuar,[194] duke ruajtur njëkohësisht edhe të drejtën të rrëzojë ato parashtrime, që janë dukshëm të pabazuara, pa dhënë ndonjë arsyetim të hollësishëm.[195]

6. Përvoja ka treguar se apelet përmbajnë shpesh, argumente ose baza apeluese që nuk arrijnë të përmbushin standardin e rishikimit. Dhoma e apelit duhet të kursejë kohën dhe burimet e saj, duke zbatuar me përpikëri standardin e rishikimit, duke identifikuar paraprakisht të gjitha ato argumente dhe baza që janë të pamjaftueshme e që mundësojnë rrëzimin e tyre në bllok. Kohët e fundit, gjykime të ndryshme kanë identifikuar kategori argumentimesh, të cilat janë të pamjaftueshme:
   - Argumente që shtrembërojnë konkludimet faktike të Dhomës Gjyqësore ose provat , ose që injorojnë konstatime të ndryshme të rëndësishme të bëra nga Dhoma gjyqësore e shkallës së parë;[196]
   - Argumente që thjesht pohojnë se Dhoma gjyqësore e shkallës së parë ka dështuar në shqyrtimin siç duhet të provave përkatëse;[197]
   - Argumente që thjesht pohojnë se asnjë Dhomë gjyqësore e shkallës së parë nuk mund të mbërrinte në një konkluzion të tillë, në rast se ajo do të mbështetej mbi provat rrethanore;[198]
   - Argumente që janë qartazi të pavend ose që mbështesin kundërshtimin e gjetjeve të Gjykatës;[199]
   - Argumente që shkojnë kundër gjykimit të shëndoshë dhe kundërshtojnë gjetjet e fakteve, atje ku përshtatshmëria e gjetjes së faktit është e paqartë dhe nuk është shpjeguar nga Apeluesi.[200]

7. Vetëm një qasje tejet e rreptë, mund të bëjë të mundur që Dhoma e apelit të përqendrojë burimet e saj mbi ato apele që ngrihen mbi argumentime dhe baza të qëndrueshme. Gjykimi në apel i çështjes *Brđanin* përbën një shembull verifikimi proaktiv, ku pas një rishikimi të kujdesshëm të argumenteve të ngritur nga të akuzuarit, Dhoma e apelit hodhi poshtë në mënyrë të përmbledhur kundërshtimet ndaj gjetjeve faktike, të cilat ishin haptazi të pamjaftueshme. Në këtë rast, Apeluesi pretendonte se ishin kryer një sërë gabimesh fakti, pa cilësuar paragrafët përkatës të gjykimit në shkallë të parë.[201] Në vijim të udhëzimit të Dhomës së apelit për fazën paragjyqësore, Apeluesi depozitoi një pasqyrë, ku ai tregonte se si paragrafët përkatës të Dhomës gjyqësore të shkallës së parë, korrespondonin me secilën prej gjetjeve faktike që, sipas tij, përbënin edhe bazën për shpalljen fajtor dhe asnjë prej tyre nuk kishte mundur të provohej përtej dyshimit të

---

192 Udhëzim lidhur me kërkesat formale për apelim të gjykimeve, para .4(b). *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 11; shih gjithashtu *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 15; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 11; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 12; *Blaškić* Aktgjykim i apelit, para. 13; *Vasiljević* Aktgjykim i apelit, para. 11.

193 *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 11; shih gjithashtu *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 11; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 12; *Vasiljević* Aktgjykim i apelit, para. 12; *Kunarac e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 43, 48.

194 *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 16; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 12; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 13; *Kunarac e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 47.

195 Një shembull i një argumenti dukshëm të pathemeltë, mund të gjendet në çështjen *Brđanin*, Aktgjykim i apelit, në para. 23, ku Dhoma e apelit rrëzoi në mënyrë të përmbledhur argumentet në formën e pohimeve të thjeshta, të cilat, ose keqpërfaqësonin gjetjet faktike të Dhomës gjyqësore të shkallës së pare, ose provat në të cilat Dhoma gjyqësore mbështetej, duke injoruar njëkohësisht gjetjet e tjera përkatëse faktike. Atje ku një vlerësim i tillë është dukshëm i pasaktë, Dhoma e apelit e rrëzon në bllok argumentin e gabuar.

196 *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 23; shih gjithashtu *Galić* Aktgjykim i apelit, paras.107-108.

197 *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 24.

198 *Po aty, në* para. 25.

199 *Po aty, në* para. 26.

200 *Po aty, në* para. 30-31.

201 *Po aty,* para. 20.

arsyeshëm. Në vijim të hetimit të mëtejshëm të saj, Dhoma e apelit konstatonte se disa prej gabimeve të pretenduara, në të vërtetë nuk kishin ndonjë ndikim mbi fajësinë ose dënimin e dhënë, por apeluesi, gjithsesi, nuk hoqi dorë prej tyre, pasi ai ishte i bindur se ato "ishin një shembull i mangësive të vërejtura në krejt gjykimin e çështjes së tij". Dhoma e apelit rikujtonte se "vetëm gabimet faktike, që shkaktojnë dështimin e drejtësisë, përligjin rishikimin e çështjes. Për sa kohë që gjetjet faktike, që mbështesin fajësinë dhe dhënien e dënimit, janë të shëndosha, gabimet që lidhen me përfundime të tjera faktike nuk kanë ndikim mbi gjykimin e shkallës së parë". Në përputhje me këtë arsyetim, Dhoma e apelit nuk pranoi të diskutonte rreth gabimeve të pretenduara, të cilat, sikurse e pranoi edhe vetë Brđanin-i, nuk kishin ndonjë ndikim mbi fajësinë ose dënimin.[202]

A.2 Standardi i zbatueshëm në rastet e gabimeve ligjore

8. Kërkesa, sipas së cilës, gabimi i pretenduar ligjor duhet të bëjë të pavlefshëm vendimin, gjen zbatim në apel, si në rastin e Mbrojtjes ashtu edhe të Prokurorisë. Dhoma e apelit mund të dëgjojë apelime që kanë të bëjnë me një çështje ligjore, që nuk shpie në pavlefshmërinë e një vendimi, vetëm në raste të jashtëzakonshme, por megjithatë, një gjë e tillë, në jurisprudencën e TPNJ-së është me rëndësi të përgjithshme.[203]

9. Standardi ligjor në apel kërkon nga pala apeluese e cila ngre pretendimin për ekzistencën e një gabimi ligjor të identifikojë gabimin, të paraqesë argumentet në mbështetje të pretendimit të vet dhe të shpjegojë se në ç'mënyrë gabimi në fjalë e zhvleftëson gjykimin. Pretendimi rreth një gabimi juridik të kryer, i cili, në rast se korrigjohet, nuk ka shans të ndryshojë rezultatin e një gjykimi, mund të rrëzohet si bazë për apelim.[204] Edhe sikur argumentet e palës kërkuese të jenë të pamjaftueshme për të mbështetur debatin rreth një gabimi, Dhoma e apelit mund të arrijë në përfundimin se, për arsye të tjera, ekziston një gabim ligjor. Me fjalë të tjera, kompetenca e Dhomës së apelit, për të korrigjuar gabimet e Dhomës gjyqësore të shkallës së parë, nuk kufizohet vetëm në çështjet që ngrihen nga dosjet apeluese të palëve.[205]

10. Dhoma e apelit rishikon gjetjet ligjore të Dhomës gjyqësore të shkallës së parë, për të bërë konstatimin nëse ato janë ose jo të sakta.[206] Atje ku Dhoma e apelit gjen një gabim ligjor që rrjedh nga zbatimi që Dhoma gjyqësore e shkallës së parë i ka bërë një standardi ligjor të caktuar, ajo artikulon në vend të tij standardin e saktë ligjor,[207] dhe e zbaton atë në mënyrë të saktë ndaj provave të dokumentuara gjatë gjykimit. Përmes këtij veprimi, Dhoma e apelit përcakton nëse është edhe ajo vetë e bindur përtej dyshimit të arsyeshëm lidhur me gjetjet faktike që kundërshtohen nga Mbrojtja. Vetëm pasi të ketë kryer një veprim të tillë, Dhoma e apelit mund të konfirmojë ose të rrëzojë konstatimin në fjalë.[208] Dhoma e apelit vepron kështu, pa rishikuar nga e para krejt dokumentacionin gjyqësor. Mund të thuhet se ajo mban parasysh, kryesisht, vetëm provat që i janë sjellë asaj nga Dhoma gjyqësore e shkallës së parë, të përdorura gjatë gjykimit që kjo Dhomë i ka bërë

202 *Po aty,* para. 20-22.

203 Shih *Prokurori kundër Brđanin*, IT-99-36-A, Vendim lidhur me mocionin për të hedhur poshtë Bazën 1 të apelit të Prokurorit, 5 maj 2005, f. 3; shih gjithashtu *Tadić* Aktgjykim i apelit, para. 247 dhe 315-317; kutia mbi *Çështje të rëndësisë së përgjithshme*.

204 *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 7; *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 9; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 7; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 8; *Kvočka e të tjerë* Aktgjykim i apelit, para. 16, citing *Krnojelac* Aktgjykim i apelit, para. 10.

205 *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 7; *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 9; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 7; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 8; *Kvočka e të tjerë*, Aktgjykim i apelit , para. 16; *Kordić dhe Čerkez* Aktgjykim i apelit, para. 16; *Vasiljević* Aktgjykim i apelit, para. 6; *Kupreškić e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 26; shih gjithashtu *Gacumbitsi* Aktgjykim i apelit, para. 7; *Ntagerura* Aktgjykim i apelit, para. 11; *Semanza* Aktgjykim i apelit, para. 7; *Kambanda* Aktgjykim i apelit, para. 98.

206 *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 8; *Brđanin* Aktgjykim i apelit , para. 10; *Galić* Deklarim në apel, para. 8; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 9; *Krnojelac* Aktgjykim i apelit, para. 10.

207 *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 8; *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 10; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 8; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 9; *Kvočka e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 17; *Kordić dhe Čerkez* Aktgjykim i apelit, para. 17; *Blaškic* Aktgjykim i apelit, para. 15.

208 *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 8; *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 10; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 8; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 9; *Kvočka e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 17; *Kordić dhe Čerkez* Aktgjykim i apelit, para. 17; *Blaškić* Aktgjykim i apelit, para. 15.

çështjes ose një shënim bashkëlidhur ku figurojnë provat që gjenden në dokumentacionin gjyqësor dhe që jepen nga palët si edhe provat plotësuese që pranohen në apel.[209]

11. Ekzistojnë shumë mënyra se si Dhoma gjyqësore e shkallës së parë mund të gabojë në artikulimin e saj lidhur me përdorimin e standardit të saktë ligjor. Në rastet më të shpeshta, gjatë analizimit që Dhoma gjyqësore i bën një krimi ose formës së përgjegjësisë që i korrespondon atij, ajo mund të mos arrijë të çmojë se një element i kërkuar për këtë figurë krimi ekziston, ose ajo mund të imponojë një element plotësues të panevojshëm. Ky ishte rasti që u vërejt në çështjen *Krstić*, ku Dhoma e apelit, fillimisht, provoi dhe më pas zbatoi standardin ligjor korrekt për krimet e gjenocidit, shfarosjes dhe persekutimit.

12. Në çështjen *Krstić*, në apel, Prokurori ngriti pretendimin se Dhoma gjyqësore e shkallës së parë, kishte bërë një gabim ligjor, kur kishte nxjerrë ligjërisht të pavlefshme fajësitë për shfarosje dhe persekutim (si krime kundër njerëzimit sipas Nenit 5), duke e motivuar një gjë të tillë me faktin se ato ishin të përsëritura në mënyrë të palejueshme me fajësinë e Krstić-it për gjenocid sipas Nenit 4, i cili bazohej mbi të njëjtat fakte. Dhoma gjyqësore e shkallës së parë konstatoi se kërkesa e Nenit 5, sipas së cilës, krimet e persekutimit dhe shfarosjes ishin pjesë e një sulmi në shkallë të gjerë dhe sistematik kundër një popullsie civile, përfshihet në elementët ligjorë të gjenocidit. Dhoma e apelit vërente se, sipas jurisprudencës së pranuar të Tribunalit, "fajësitë shumëfishe që bëjnë pjesë në dispozita ligjore të ndryshme, por bazohen mbi të njëjtën sjellje, janë të lejueshme vetëm kur çdo dispozitë ligjore përmban një element materialisht të dallueshëm, i cili nuk ngërthehet tek tjetri." Dhoma e apelit vërente se, ndërsa krimi i shfarosjes dhe persekutimit, si krime kundër njerëzimit, kërkojnë të provohet që vepra e ndaluar të jetë pjesë e një sulmi sistematik dhe në shkallë të gjerë mbi popullsinë civile dhe që autori i tij të jetë i vetëdijshëm se vepra e tij përputhet me një figurë të tillë, elementët ligjorë të gjenocidit nuk e përmbajnë këtë kërkesë. Gjithashtu, Dhoma e apelit vërente se kërkesa për ekzistencën e qëllimit, në rastin gjenocidit, ndryshe nga shfarosja ose persekutimi, nuk kufizohet vetëm në raste kur autori kërkon të shkatërrojë civilët. Me të drejtë, Dhoma e apelit konstatoi se krimi i gjenocidit nuk përfshihet në krimin e shfarosjes dhe të persekutimit dhe se Dhoma gjyqësore e shkallës parë, kishte gabuar kur kishte mbërritur në përfundimin se fajësitë për shfarosje dhe persekutim, të parashikuara në Nenin 5 dhe gjenocidi sipas Nenit 4, janë akuza përsëritëse të palejueshme.[210]

13. Hapat e mëtejshëm të ndërmarra nga Dhoma e apelit për vlerësimin e ndikimit të këtij gabimi mbi vendimin përfundimtar, mund të gjenden në paragrafin 269 të Aktgjykimit në Apel. Dhoma e apelit rikujtonte konkluzionin e saj, sipas të cilit, Dhoma gjyqësore shkallës së parë kishte gabuar kur kishte lënë mënjanë fajësimin e Krstić-it për shfarosje dhe persekutim si krime kundër njerëzimit dhe kujtonte gjithashtu, njëkohësisht, edhe përcaktimin e saj plotësues se niveli i përgjegjësisë së Krstić-it ishte ai i një ndihmësi dhe nxitësi dhe jo ai i një autori kryesor. Megjithatë, duke mbajtur parasysh se Prokuroria nuk kërkonte shtim të dënimit të Krstić-it mbi bazën e këtyre fajësive, Dhoma e apelit nuk pranoi të mbante parasysh pjesëmarrjen e Krstić'-it në përcaktimin e dënimit të tij.

14. Një shembull se në ç'mënyrë Dhoma e apelit zbaton standardin ligjor korrekt ndaj provave që gjenden në dokumentacionin gjyqësor të shkallës së parë në një çështje ku në apel janë shtuar prova plotësuese mund të shihet në aktgjykimin e çështjes *Blaškić*.[211] Në këtë çështje, "pasi shqyrtoi qasjet e sistemeve kombëtare si edhe precedentët në TPNJ", Dhoma e apelit përcaktoi, në mungesë të *qëllimit të drejtpërdrejtë*, elementin mendor, si element të kërkuar për provimin e përgjegjësisë penale në urdhërimin e një krimi sipas Nenit 7 (1)

209 *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 15; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 8; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 9; *Blaškić* Aktgjykim i apelit, para. 13; *Kordić dhe Čerkez* Aktgjykim i apelit, para. 1, f.12.
210 *Krstić* Aktgjykim i apelit, para. 216-229.
211 *Blaškić* Aktgjykim i apelit, para. 345-347.

të Statutit.[212] Ajo konstatoi se Dhoma gjyqësore e shkallës së parë kishte gabuar në artikulimin e standardit të zbatueshëm, d.m.th. që një person që urdhëron një veprim ose mosveprim me vetëdijen e një ngjashmërie substanciale se një krim do të kryhet në zbatim të këtij urdhri, ka *mens rea-n* e kërkuar që bën të mundur provimin e përgjegjësisë sipas Nenit 7 (1).[213] Paskëtaj, Dhoma e apelit zbatoi standardin korrekt ndaj provave përkatëse, me qëllim që të përcaktonte nëse edhe ajo vetë ishte e kënaqur ose jo me provat përkatëse të shkallës së parë si dhe me provat plotësuese të sjella në apel dhe nëse ato mund të provonin se Apeluesi ishte përgjegjës sipas Nenit 7(1) të Statutit për urdhërimin e kryerjes së krimeve në territorin e Ahmići-t më 16 prill 1993.[214] Në paragrafin 347 të aktgjykimit të apelit shihet se rasti nuk ishte i tillë.

15. Sikundër tregohet më lart, në rrethana të jashtëzakonshme, Dhoma e Apelit mund të pranojë apelime, ku një palë ka ngritur një çështje ligjore që nuk do të shpjerë në zhvleftësimin e vendimit, por që gjithsesi është me rëndësi të përgjithshme për jurisprudencën e Tribunalit Ndërkombëtar (shih kutinë *"Çështjet e rëndësisë së përgjithshme"*).

16. Përpara se të kalojmë te gabimet e faktit, është e rëndësishme të nënvizojmë një lloj të veçantë gabimi ligjor, të pretenduar në apel: aktakuzat me të meta ose mangësi dhe/ose fajësitë e kërkuara mbi bazë faktesh që nuk janë deklaruar në aktakuzë. Ligji që zbatohet në rastin e aktakuzave është paraqitur në një seksion të mëparshëm.[215] Kur kërkohet të provohet se, një aktakuzë nuk ka mundur të përcaktojë fajësinë rreth disa fakteve materiale ose që një gjë të tillë nuk ka mundur ta bëjë në mënyrë të mjaftueshme, për rrjedhojë pra, e ka bërë me mangësi, Dhoma e apelit i jep një peshë vendimtare karakterizimit që Prokurori i bën sjelljes kriminale të pretenduar dhe afërsisë që ekziston mes të akuzuarit dhe krimit. Dhoma e apelit ka nënvizuar se, në disa raste, një aktakuzë me mangësi mund të "kurohet" dhe kjo fajësi të kërkohet përpara trupit gjykues, në rast se Prokurori e furnizon në kohë të akuzuarin me informacion, të qartë dhe në vazhdimësi, informacion që detajon bazën faktike mbi të cilën ngrihen akuzat kundër tij. Dhomat e apelit ka përcaktuar se, në disa raste, një aktakuzë me mangësi mund "të kurohet" dhe një fajësi të kërkohet, në qoftë se Prokurori i ka dhënë të akuzuarit, me kohë, me qartësi dhe në vazhdimësi, informacion që detajon bazën faktike mbi të cilën ngrihen akuzat kundër tij.[216] Ky informacion mundet, në varësi të rrethanave, të jepet në dosjen paragjyqësore të Prokurorit ose në deklarimin hyrës të tij.[217] Megjithatë, duhet theksuar se mundësia e kurimit të mangësive në aktakuzë nuk është e pakufizuar. Një dallim i qartë duhet bërë mes papërcaktueshmërisë ose dyzimit që mund të ketë një aktpadi dhe një aktpadie, së cilës i mungojnë disa akuza. Ndërkohë që dyzimi apo papërcaktueshmëria e një aktpadie mund të riparohen, akuzat që mungojnë në aktpadi mund t'i bashkëngjiten aktpadisë në fjalë vetëm përmes ndryshimit formal sipas Rregullit 50 të Rregullores.[218]

---

212 *Po aty,* para. 41-42.
213 *Po aty,* para. 41-42.
214 *Po aty,* para. 345-347.
215 Shih Kapitullin V.
216 *Naletilić dhe Martinović* Aktgjykim i apelit, para. 26; *Kvočka e të tjerë* Aktgjykim i apelit, para. 33; *Kupreškić* e të tjerë. Aktgjykim i apelit, para. 114; *Simić* Aktgjykim i apelit, para. 23.
217 *Naletilić dhe Martinović* Aktgjykim i apelit, para. 27 (që citon *Kupreškić e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 117 dhe *Kordić dhe Čerkez* Aktgjykim i apelit, para. 169, përkatësisht); *Simić* Aktgjykim i apelit, para. 24.
218 *Ntagerura e të tjerë*, para. 32.

17. Sipas jurisprudencës së Dhomës së apelit, një aktpadi paqartë ose e pasaktë, e cila nuk është spastruar nga mangësitë, duke i dhënë të akuzuarit, me kohë, qartë dhe në vazhdimësi informacion, përbën një dëmtim ndaj të akuzuarit. Mangësia mund të konsiderohet e padëmshme vetëm kur është përcaktuar se aftësia e të akuzuarit për të përgatitur mbrojtjen e vet nuk është dëmtuar materialisht.[219] Kur e drejta e një të akuzuari për gjykim të drejtë e të paanshëm, shkelet nga mosdhënia atij nga ana e Prokurorisë njoftim të mjaftueshëm gjyqësor lidhur me arsyet ligjore dhe faktike për akuzat që rëndojnë ndaj tij, atëherë ai nuk mund të fajësohet dhe të dënohet.[220] Barra, për të demonstruar në apel, nëse mbrojtja e të akuzuarit ishte ose jo materialisht e dëmtuar gjatë procesit gjyqësor, varet nga fakti nëse mangësia e pretenduar në aktpadi është ngritur ose jo për herë të parë në apel. Kur personi i gjendur fajtor, pretendon se aktpadia ka të meta dhe këtë e bën, për herë të parë, vetëm në apel, ai/ajo mbart detyrimin për të provuar përpara Dhomës së apelit se aftësia e tij/saj për të përgatitur mbrojtjen ka qenë materialisht e dëmtuar, si rrjedhojë e mungesës së një njoftimi të tillë. Sidoqoftë, kur një i akuzuar e ka ngritur edhe më parë çështjen e mungesës së njoftimit përpara Dhomës gjyqësore të shkallës së parë, barra për të provuar në apel se aftësia e të akuzuarit për të përgatitur mbrojtjen e tij nuk ka qenë e materialisht e dëmtuar, i takon Prokurorit. [221]

Çështjet e rëndësisë së përgjithshme

Një shembull i fundit i një çështjeje juridike, që është trajtuar nga Dhoma e apelit si një çështje me rëndësi të përgjithshme për jurisprudencën e Tribunalit, është fusha e teorisë mbi veprën penale në bashkëpunim (NPK). Në çështjen Brđanin, Prokurori kërkoi një sqarim lidhur me ligjin e zbatueshëm, që trajton NPK-në, pa kërkuar rrëzimin e Aktgjykimit në shkallë të parë apo ndonjë rishikim të dënimit të dhënë.**Teoria e përgjegjësisë në NPK, është forma e kryerjes së krimit, që është trajtuar më shumë në TPNJ. Jurisprudenca ka konstatuar se NPK-ja ekzistonte tashmë si formë përgjegjësie në të drejtën zakonore ndërkombëtare në kohën e zhvillimit të ngjarjeve në ish-Jugosllavi.****

*Dhoma e apelit vendosi të trajtonte fushën e veprimit të NPK-së, si një çështje "me rëndësi mjaft të madhe për jurisprudencën e Tribunalit", dhe arriti në përfundimin, pasi kishte rishikuar çështjet gjyqësore të Pas Luftës së II Botërore dhe të çështjeve të vet Tribunalit, se kjo pjesë e apelit duhej pranuar. **** Çështje të tjera të vlerësuara nga Dhoma e Apelit si çështje me rëndësi të përgjithshme për jurisprudencën e Tribunalit përfshijnë faktin nëse një I akuzuar nuk mund të konsiderohet përgjegjës sipas formës së tretë të NPK-së sikurse figuron në Aktgjykimin e apelit në çështjen Tadić lidhur me secilin prej krimeve të kryer, me përjashtim të rasteve, kur në aktakuzë pranohet hapur një formë "e zgjeruar" e veprës penale në bashkëpunim;***** nëse krimet kundër njerëzimit nuk janë kryer thjesht nisur nga motivet personale të individit;******nëse të gjitha krimet kundër njerëzimit të radhitur në Nenin 5 kërkojnë provën e qëllimit diskriminues.*

Kompetenca e nënkuptuar e Dhomës së apelit, për të shqyrtuar "çështje të një rëndësie të përgjithshme" në pikëpamje thjesht studimore/këshillimore, ka qenë dhe mbetet veçanërisht e rëndësishme për jurisprudencën e Gjykatave ad hoc.

* Shih Brđanin Aktgjykim i apelit, para. 361.
** Brđanin Aktgjykim i apelit, para. 361.
*** Krnojelac Aktgjykim i apelit, para. 29.
**** Brđanin Aktgjykim i apelit, para. 361 dhe 414.
***** Krnojelac Aktgjykim i apelit, para. 125-128.
****** Tadić aktgjykim i apelit, para. 247
******* Tadić Aktgjykim i apelit, para. 281.

A.3 Standardi i zbatueshëm në rastet e gabimeve të faktit

18. Kur shqyrton gabimet e pretenduara të faktit në apel, Dhoma e apelit duhet të përcaktojë që asnjë gjetës i arsyeshëm i faktit, nuk do të kishte mundur të arrinte të jepte vendimin e fajësisë përtej dyshimit të

219 Shih p.sh., *Simić* Aktgjykim i apelit, para. 24; *Kupreškić e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 122.
220 *Naletilić dhe Martinović* Aktgjykim i apelit, para. 26; *Kvočka e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 33.
221 *Simić* Aktgjykim i apelit, para. 25; *Kvočka e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 35.

arsyeshëm.[222] I njëjti standard gjen zbatim edhe në apelet e Prokurorisë përkundrejt shfajësimit.[223] Standardi i një gabimi faktik, që shkakton dështimin e drejtësisë, zbatohet disi në mënyrë të ndryshme në rastin e një apelimi të Prokurorisë ndaj vendimit të shfajësimit nga rasti i apelimit të Mbrojtjes ndaj shpalljes së fajësisë. I akuzuari duhet të tregojë se gabimet faktike të Dhomës krijojnë një dyshim të arsyeshëm për sa i përket fajësisë së tij. Prokuroria duhet të tregojë se, kur mbahet parasysh gabimi faktik, i bërë nga Dhoma gjyqësore e shkallës së parë, krejt dyshimi i arsyeshëm lidhur me fajin e të akuzuarit është eliminuar.[224]

19. Dhoma e apelit zbaton të njëjtin standard arsyetimi ndaj gabimeve të pretenduara faktike, pavarësisht nga rastet kur konkludimi faktik bazohej në prova të drejtpërdrejta apo rrethanore.[225] Gjatë përcaktimit nëse konkludimi i Dhomës gjyqësore të shkallës së parë ishte i tillë që asnjë gjykues i arsyeshëm i faktit mund ta kishte dhënë, Dhoma e apelit "nuk i cenon lehtazi konkludimet faktike Dhomës gjyqësore e shkallës së parë".[226] Ky rregull bazohet në premisën se detyra e seancës, vlerësimit dhe peshimit të provave të paraqitura para gjykatës, është kryesisht detyrë e Dhomës gjyqësore të shkallës së parë, konkludimeve faktike të cilës duhet t'i lihet një hapësirë e mirëbesimit. Vetëm në rastet kur provat mbi të cilat është mbështetur Dhoma gjyqësore e shkallës së parë, nuk mund të pranoheshin nga çfarëdo lloj gjykuesi i arsyeshëm faktik dhe vetëm kur vlerësimi i provave rezulton "krejtësisht i gabuar", Dhoma e apelit mund të zëvendësojë gjetjet e Dhomës gjyqësore të shkallës së parë me gjetjet e saj.[227]

20. Në apel, një palë nuk mund të përsërisë thjesht argumente që nuk kanë pasur sukses gjatë gjykimit të shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur pala është në gjendje të demonstrojë se, rrëzimi i këtyre argumenteve nga ana e Dhomës gjyqësore të shkallës së parë ka qenë një gabim aq serioz sa kërkon ndërhyrjen e Dhomës së apelit.[228] Dhoma e apelit mund të rrëzojë menjëherë një argument dhe të mos e shqyrtojë atë në themel të tij, në rast se ky argument nuk ka potencial të hedhë poshtë ose ndryshojë vendimin e sfiduar.[229]

---

222 *Kupreškić e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 30 (referuar në *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 9); *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 13; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 9; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 10; *Kvočka e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 18; *Kordić dhe Čerkez* Aktgjykim i apelit, para. 18; *Blaškić* Aktgjykim i apelit, para. 16; *Čelebići* Aktgjykim i apelit, para. 435; *Furundžija* Aktgjykim i apelit, para. 37; *Aleksovski* Aktgjykim i apelit, para. 63; *Tadić* Aktgjykim në apel, para. 64.

223 *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 9.

224 *Po aty,* në para. 9; *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 14.

225 *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 226; *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 13; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 9; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 220; *Čelebići* Aktgjykim i apelit, para. 458. Në mënyrë të ngjashme, lloji i provave, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, nuk kanë rëndësi për standardin e provës në gjykim të shkallës së parë, ku i pandehuri mund të shpallet fajtor për një krim, vetëm nëse Prokuroria ka provuar çdo element të krimit si edhe formën përkatëse të përgjegjësisë, përtej dyshimit të arsyeshëm. Shih *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 219; *Čelebići* Aktgjykim i apelit, para. 458.

226 *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 9; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 9; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 10; *Furundžija* Aktgjykim i apelit, para. 37, që i referohet Aktgjykimit të apelit të *Tadić*, para. 64; shih gjithashtu *Kvočka e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 19; *Krnojelac* Aktgjykim i apelit, para. 11; *Aleksovski* Aktgjykim i apelit, para. 63; *Limaj* Aktgjykim i apelit, para. 12; *Hadžihasanović* Aktgjykim i apelit, para. 10.

227 *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 9; *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 14; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 9; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 10; *Kvočka e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 19; *Limaj* Aktgjykim i apelit, para. 12; *Hadžihasanović* Aktgjykim i apelit, para. 11, që citon *Kupreškić e të tjerë*. Aktgjykim i apelit, para. 30; shih gjithashtu *Kordić dhe Čerkez* Aktgjykim i apelit, para. 19, fn.11; *Blaškić* Aktgjykim i apelit, para. 17-18.

228 *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 10; *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 16; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 10; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 11; shih gjithashtu *Blaškić* Aktgjykim i apelit, para. 13.

229 *Blagojević dhe Jokić* Aktgjykim i apelit, para. 10; *Brđanin* Aktgjykim i apelit, para. 16; *Galić* Aktgjykim i apelit, para. 10; *Stakić* Aktgjykim i apelit, para. 11.

B. Vetëpërfaqësimi në apel

21. E drejta për t'u vetëpërfaqësuar në apel pas gjykimit të shkallës së parë është shqyrtuar për herë të parë (dhe të vetme) në çështjen *Krajišnik*.[230] Gjatë fazës së para-apelimit, Krajišnik-u shfaqi qëllimin e tij për të përfaqësuar veten gjatë fazës së apelimit të çështjes së tij.[231] Ndërsa Dhoma e apelit e konsideronte vetëpërfaqësimin në apel "një çështje të ngatërruar e komplekse", ajo arriti në përfundimin se një gjë e tillë nuk ishte më e vështirë (e në të vërtetë ndoshta më pak e vështirë) se sa vetëpërfaqësimi në gjykimin e shkallës së parë. Të dy fazat kanë të bëjnë me çështje ligjore dhe faktike të ndërlikuara dhe kërkojnë njohje mbi tërësinë e vështirë të rregullave të procedurës. Në marrjen e vendimit rreth këtij problemi, ndonëse Dhoma e apelit pranonte se "ndoshta nuk është kurrë në interes të të akuzuarit të vetëpërfaqësohet, as në gjykim të shkallës së parë dhe as në apel", ajo vërente se i akuzuari apo çdo apelues "gëzojnë të drejtën 'themelore' ta paraqesin vetë çështjen e tyre përpara Tribunalit".[232] Baza për këtë arsyetim të Dhomës së apelit gjendet në tekstin e Statutit të Tribunalit[233], i cili i njeh të akuzuarit të drejtën "të mbrojë veten personalisht ose përmes ndihmës ligjore që ai zgjedh vetë",[234] dhe nuk bën dallim midis fazave të gjykimit të shkallës së parë dhe atij në apel të një çështjeje.[235] Në dhënien e vendimit të saj, Dhoma e apelit bëri të njëjtin cilësim rreth të drejtës për t'u vetëpërfaqësuar edhe në nivelin e gjykimit në shkallë të parë. E drejta për t'u vetëpërfaqësuar mund të mos pranohet dhe apeluesit që e kërkon një gjë të tillë, i caktohet një avokat mbrojtës, dhe kjo ndodh kur, apeluesi, në thelb dhe në vijueshmëri, pengon zhvillimin e rregullt dhe të shpejtë të gjykimit në apel.[236]

22. Ndërkohë që Dhoma e apelit i njohu Krajišnik-ut të drejtën për të përfaqësuar veten, duhet thënë se njohja e së drejtës për vetëpërfaqësim në apel nuk përbën një praktikë të mirë. Për sa u përket disa vendeve, që e shohin apelin penal si një çështje teknike, që mund të vendoset vetëm nga Gjykata e apelit dhe që mund të realizohet vetëm përmes avokatëve të përgatitur, kjo çështje mund të mos shtrohet. Megjithatë, kur një gjë e tillë ndodhë, detyra që ngrihet përpara një apeluesi të vetëpërfaqësuar është tejet e vështirë dhe ndikimi i zbatimit të vetëpërëfaqësimit mund të rezultojë tejet i lodhshëm, jo vetëm për Dhomën e apelit, por edhe për krejt Gjykatën. Në përputhje me një konstatim të tillë, qëllimi i këtij seksioni është të theksojë se ndikimi i vetëpërfaqësimit mbi burimet e Tribunalit, sikundër ai përshkruhet edhe në seksionin e administrimit të gjykimit të shkallës së parë në këtë manual, është i pranishëm edhe në apel. Problemet përfshijnë nevojën për përkthim, gjë që mund të ndikojë negativisht në kohëzgjatjen e procesit të apelit. Apeli nuk mund të

230 *Prokurori kundër Momčilo Krajišnik*, IT-00-39-A, Vendim lidhur me Kërkesën e Momčilo Krajišnik për t'u vetëpërfaqësuar, Mocion në lidhje me caktimin e *amicus curiae*, dhe për Mocionin e Prokurorisë të 16 shkurt 2007, 11 maj 2007 ("Vendim lidhur me Kërkesën e Krajišnik-ut për Vetëpërfaqësim").

231 *Prokurori kundër Momčilo Krajišnik*, IT-00-39-A, Mocion që kërkon Rishikimin e Vendimeve të Sekretarit Gjyqësor lidhur me caktimin e Avokatit mbrojtës, 27 dhjetor 2006, Shtojca A, f. 2.

232 Vendim lidhur me Kërkesën e Krajišnik-ut për Vetpërfaqësim, para. 11; shih gjithashtu *Prokurori kundër Slobodan Milošević*, Lënda Nr. IT-02-54-AR73.7, Vendim lidhur me Apelin Ndërkohës për Vendimin e Dhomës gjyqësore të shkallës së parë për caktimin e avokatit mbrojtës, 1 nëntor 2004, para. 11, ku Dhoma e apelit konstatonte se "përpiluesit e Statutit e shihnin qartë të drejtën e vetëpërfaqësimit si një gur themeltar të rëndësishëm të drejtësisë, duke e vendosur atë në të njejtën këmbë barazie me të drejtën e të pandehurit për të ruajtur heshtjen, të drejtën për t'u ballafaquar me dëshmitarët, të drejtën për gjykim të shpejtë e madje edhe me të drejtën, për të kërkuar një avokat të caktuar nga gjykata, nëse nuk arrijnë të përballojnë shpenzimet për të." Ajo gjithashtu përfundonte se "të pandehurit gëzojnë përpara këtij Tribunali të drejtën e mirëqenë për të përfaqësuar veten pavarësisht nga gjykimi i Dhomës gjyqësore të shkallës së parë se do të ishte më mirë që ata të përfaqësoheshin nga një avokat.

233 Neni 21 (4) (d), Satatuti TPNJ

234 *Prokurori kundër Slobodan Milošević*, Lënda Nr. IT-02-54-AR73.7, Vendim lidhur me Apelin ndërkohës për Vendimin e Dhomës gjyqësore të shkallës së parë për caktim avokati mbrojtës, 1 nëntor 2004, para. 11.

235 Vendim lidhur me Kërkesën e Krajišnik-ut për Vetëpërfaqësim, para. 11.

236 *Po aty,* para. 9 dhe 13.

fillojë përpara se aktgjykimi i shkallës së parë të jetë përkthyer në një gjuhë që apeluesi kupton. Për më tepër, dosjet e apeluesit të vetëpërfaqësuar duhet të përkthehen në një prej gjuhëve të punës së Tribunalit, e po kështu edhe çdo dosje Kundërpërgjigjëse apo urdhër ose vendim i gjykatës duhet të jenë në një gjuhë që apeluesi i vetëpërfaqësuar e kupton. Procesi i përkthimit ngadalëson në mënyrë të ndjeshme procesin e para-apelimit.

23. Siç është demonstruar në rastin e çështjes *Krajišnik*, kompleksiteti i procesit të apelit në rastin e një apeluesi të vetëpërfaqësuar, mund të shtohet edhe më nga prania e një sërë faktorësh të tjerë. Së pari, përveç njoftimit që i duhet bërë apeluesit të vetëpërfaqësuar se ai duhet të pranojë përgjegjësinë për pasojat negative që rezultojnë nga vetëpërfaqësimi, Dhoma e apelit ka detyrimin të garantojë që procesi në apel të jetë i drejtë dhe i paanshëm. Në çështjen *Krajišnik*, duke mbajtur parasysh këtë përgjegjësi detyruese, Dhoma e apelit vendosi të emëronte një *amicus curiae*.[237] Roli i *amicus curiae* në apel, sikurse figuron në Vendimin mbi Kërkesën e Krajišnik-ut për Vetëpërfaqësim, nuk përfshin kryerjen e hetimeve të reja rreth fakteve, por kufizohet vetëm në nxjerrjen në pah të bazave për apelim, që bëjnë të mundur përmbysjen e fajësisë ose reduktimin e dënimit të dhënë dhe që argumentojnë se përse kundërshtohet argumentimi i bërë në apel nga Prokuroria.[238] A*micus curiae*, si një mik i gjykatës, e ndihmon Gjykatën në mënyrë të pavarur prej apeluesit të vetëpërfaqësuar dhe nuk konsiderohet palë në proces gjyqësor.[239] Në këtë kuptim, Dhoma e apelit nuk ka detyrim të shqyrtojë argumentet që sjell *amicus curiae*, por një gjë të tillë ajo mund ta bëjë kur "interesi i drejtësisë e kërkon që ajo të shqyrtojë, *proprio motu*, çështje që nuk ngrihen në apelin [e apeluesit] ose në kundërpërgjigjet e tij ndaj apelit të Prokurorisë."[240]

24. Për shkak të kompleksitetit të çështjeve ligjore të ngritura në apelin e z. Krajišnik, dhe me kërkesë të tij gjatë procesit të apelit, Dhoma e apelit e autorizoi atë të merrte një avokat mbrojtës për qëllimin e kufizuar, për të argumentuar rreth çështjes së Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale (NPK), një fushë në të cilën *amicus curiae* tashmë kishte sjellë argumente.[241] Ky vendim mbështetej në arsyetimin se procesi i apelit duhej të ishte i paanshëm. Dhoma e apelit arriti në përfundimin se çështja e NPK-së "mund të rezultojë tepër komplekse, për t'u trajtuar nga një njeri që nuk ishte avokat", se Apeluesit do t'i duhej t'i jepej "mundësia për të argumentuar çështjen sa më bindshëm që mundet," ndaj avokati mbrojtës i caktuar, mund të përfaqësonte argumentet e vet personit të vetëpërfaqësuar, lidhur me këtë çështje komplekse.[242] Me qëllim që të kufizonte vonesat, përsëritjet e gjërave tashmë të tepërta dhe ndërlikimet e krijuara si pasojë e kësaj situate, Dhoma e apelit vendosi disa parametra lidhur me përfaqësimin e Avokatit. Në veçanti, Dhoma e apelit urdhëroi vendosjen e një afati të rreptë informimi, me qëllim që të ndalonte parashtrimet e panevojshëm të gjata ose që marrin shumë kohë. Më tej ajo vendosi se në rast se do të konstatohej ndonjë kontradiktë midis parashtrimeve të bëra nga *amicus curiae* dhe Avokati, ajo do të trajtonte vetëm argumentet e këtij të fundit, si përfaqësuese të pikëpamjeve të klientit dhe ajo e udhëzonte atë të përcaktonte me saktësi se me cilat argumente të paraqitura nga *amicus curiae* pajtohej dhe cilët argumente hidhte poshtë. Gjithashtu, Dhoma e apelit vendosi t'i trajtonte parashtrimet e Avokatit si një dosje suplementare në emër të Apeluesit. [243]

237 Vendim lidhur me Kërkesën e Krajišnik-ut për Vetëpërfaqësim, para. 18. Kjo çështje u debatua seriozisht. Shih opinionin e veçantë të Gjykatësit Pocar, bashkëngjitur Vendimit për Kërkesën e Krajišnik-ut për Vetëpërfaqësim.
238 Vendim lidhur me Kërkesën e Krajišnik-ut për Vetëpërfaqësim, para. 19.
239 *Po aty,* para. 9-20.
240 *Po aty,* para. 20.
241 Vendim lidhur me Mocionin e Momčilo Krajišnik për rivendosjen në afat të Konferencës mbi Status-in dhe Lejen për Alan Dershowitz, për t'u paraqitur përpara Trupit gjykues, 28 shkurt 2008.
242 *Po aty,* para. 9.
243 *Po aty,* para. 10-11.

25. Procesi kompleks që rezultoi nga një kërkesë për vetëpërfaqësim në apel, në këtë rast, demonstron vështirësinë që ekziston për të ekuilibruar të drejtën për vetëpërfaqësim gjatë procesit të apelit pas gjykimit në shkallë të parë dhe detyrimit të përgjithshëm për të garantuar drejtësinë dhe paanshmërinë e procesit gjyqësor në këtë shkallë të gjykimit.

C. Para-apeli

C.1 Rolet përkatëse të gjykatësit para-apelues dhe seancës paradëgjimore të Dhomës së apelit

26. Ndërkohë që Gjykatësi i fazës paragjyqësore në shkallë të parë dhe gjykatësit e tjerë të trupit të fazës paragjyqësore në shkallë të parë, nuk janë caktuar për të qenë domosdoshmërisht pjesë e trupit gjykues në shkallë të parë, në Dhomën e apelit, i njëjti trup gjykues e trajton zakonisht çështjen, si në momentin e depozitimit të njoftimit gjyqësor për apel ashtu edhe në dhënin e aktgjykimit përfundimtar të saj. Kur gjykatësi që kryeson Dhomën e apelit është anëtar i një trupi gjykues në apel për një çështje të dhënë, ai ose ajo, automatikisht kryeson trupin gjykues në fjalë dhe mund të jetë Gjykatës në fazë para-apeluese për çështjen në fjalë ose cakton një tjetër anëtar të trupit gjykues për këtë qëllim. Në dallim me këtë, kur Gjykatësi që kryeson Dhomën e apelit nuk është anëtar i trupit gjykues të apelit, gjykatësit që përbëjnë trupin gjykues mund të zgjedhin gjykatësin kryesues për çështjen në fjalë, i cili shërben njëkohësisht edhe si Gjykatës në Para-apel.

27. Apelet e depozituar pas gjykimit në shkallë të parë, gjenerojnë një volum të madh pune në fazën e para-apelimit. Në nivel formal, Rregullorja imponon detyrimin e mbajtjes së një konference statusi të paktën, një herë në çdo njëqind e njëzetë ditë, me qëllim që çdo personi në gjendje paraburgimi t'i jepet mundësia e apelimit për të ngritur çështje në lidhje me burgimin e tij, përfshi këtu edhe çështje që lidhen me kushtet e gjendjes së tij mendore dhe fizike.[244] Në praktikë, konferenca e statusit krijon gjithashtu mundësinë për të diskutuar rreth gjendjes së çështjes si dhe të marrë vendimet e duhura lidhur çështje të karakterit procedural, që mund të ngrihen nga palët gjatë seancës dëgjimore.

28. Gjykatësi i fazës së para-apelimit është përgjegjës për bashkërendimin e të gjithë mocioneve të fazës para-apeluese, të depozituara përpara seancës në apel. Kur këto mocione nuk prekin thelbin e apelit, gjykatësi i fazës para-apeluese është kompetent për gjykimin e tyre. Kur mocionet prekin substancën e apelit, gjykatësi i fazës para-apeluese merr përgjegjësinë e përgatitjes së një projekt-urdhri/vendimi, i cili duhet të adoptohet prej krejt trupit gjykues. Mocionet e bëra në fazën e para-apelimit kanë të bëjnë, mes të tjerash, me çështjet që lidhen me informimin e apelit, d.m.th. mocionet për shtimin e kohës në dispozicion dhe limiteve të fjalëve; heqjen e disa pjesëve të dosjes; shtimin/tërheqjen/modifikimin e bazave të apelimit; paraqitjen e provave plotësuese; kërkesat për ekspertë mjeko-ligjorë; mocionet për marrjen e masave mbrojtëse, mocione nga palë në çështje të tjera (në Tribunal ose përpara juridiksioneve të tjera), të cilat kërkojnë qasje ndaj materialit konfidencial në çështjen në fjalë në fazën e apelit; dhe çështjet që lidhen me periudhën e paraburgimit.

29. Volumi i punës në fazën e para-apelit ndryshon nga çështja në çështje, por ajo kërkon shumë kohë dhe mund të ketë të bëjë me çështje shumë komplekse.

244 Shih Rregullin 65*bis*, RrPP e TPNJ-së

C.2 Përgatitja e dosjes brenda një kohe të arsyeshme

30. Një aspekt i rëndësishëm i fazës dëgjimore para-apeluese është garantimi i plotësimit të dosjes. Çdo apel i depozituar përpara Dhomës së apelit të TPNJ-së, kërkon një njoftim për apel, një dosje të personit apelues, një Dosje përgjigjeje dhe një Dosje kundërpërgjigjeje. Në këtë drejtim, apelimet mund të jenë po aq sa janë edhe palët në proces gjyqësor. Prokuroria ka pasur prirje të apelojë pjesën më të madhe të shfajësimeve dhe Mbrojtja ka apeluar pjesën më të madhe të fajësimeve dhe dënimeve.

31. Rregullorja parashikon që dosja e apelit duhet të përgatitet jo me vonë se 160 ditë nga shpallja e Vendimit të Dhomës gjyqësore të shkallës së parë (ose 100 ditë në rastin e një kërkese që ka të bëjë me apelimin e një dënimi të caktuar).[245] Dhoma e apelit e bën zgjatjen e afateve, zakonisht, vetëm kur një kërkesë e tillë bazohet mbi arsye të mjaftueshme, siç parashikohet nga Udhëzimet Praktike mbi Rregullat e Procedurës lidhur me Depozitimin e Parashtrimeve me Shkrim.[246]Përgjithësisht, afatet kohore zgjaten për dy arsye. Së pari, kur i akuzuari ka vendosur të ndryshojë avokatin mbrojtës kryesor të tij gjatë procesit gjyqësor të apelit. Kur ndryshimi ndodhë në një fazë të mëvonshme, përgjatë procesit të apelit, zakonisht ai ka çuar në dhënien e vendimit për t'i dhënë mundësinë avokatit të ri të plotësojë dosjen ekzistuese. Së dyti, zgjatja e afatit, zakonisht, është akorduar kur Mbrojtja kërkon që aktgjykimi në shkallë të parë të përkthehet në një prej gjuhëve të punës së Tribunalit (anglisht ose frëngjisht) ose në BKS, me qëllim që i akuzuari të ketë mundësi të kuptojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe të japë kontributin e tij në apel. Në rastin e dytë, praktika e regjistruar në TPNJ ka qenë e ndryshme. Në disa procese në apel,[247] afati i caktuar për përgatitjen e dosjes është shtyer deri në momentin kur aktgjykimi është përkthyer në BKS, dhe paskëtaj, procesi gjyqësor ka vijuar, ose me një ritëm normal, ose në mënyrë të përshpejtuar. Në vend që t'i japë apeluesit të drejtën për të vonuar depozitimin e dosjes në pritje të marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë në BKS, apeluesit mund t'i jepet mundësia të plotësojë njoftimin e apelit ose dosjen e tij pas marrjes së aktgjykimit të përkthyer.[248] Përgjithësisht, kjo praktikë konsiderohet si më e përshtatshme për një administrim më të frytshëm në fazën e para-apelit.

32. Lidhur me mocionet rutinë, të cilat i referohen shtyrjes së afatit ose shtimit të limitit të fjalëve të lejuara, udhëzimi përkatës i TPNJ-së është plotësuar për t'i dhënë mundësinë Gjykatësit të fazës para-apeluese t'i trajtojë këto mocione pa dëgjuar palën tjetër, me përjashtim të rasteve kur gjykatësi në fjalë konsideron se ekziston rreziku që pala tjetër mund të dëmtohet nga një qëndrim i tillë. Është e rekomandueshme që Dhoma të kontaktojë avokatin e palës që nuk ka bërë mocionin, për të verifikuar nëse ai/ajo ka qëllim që të japë përgjigje apo të kundërshtojnë mocionin, duke shmangur, kësisoj një situatë, ku pala tjetër, do të shpenzonte burime për të përgatitur një përgjigje që thjesht do t'i shërbente asaj vetëm për të mësuar se Gjykatësi i fazës para-apeluese tashmë e kishte trajtuar këtë mocion.

C.3 Provat plotësuese në apel

33. Pranimi i provave plotësuese në apel rregullohet nga Rregullorja.[249] Në mënyrë që paraqitësi të jetë i suksesshëm, ai duhet të jetë në gjendje të demonstrojë se provat plotësuese nuk i kishte pasur në dispozicion gjatë fazës së gjykimit në shkallë të parë, në çfarëdo lloj forme qoftë, dhe se ato, po kështu, nuk mund të zbuloheshin edhe po të ishin bërë të gjitha përpjekjet e mundshme. Në përcaktimin e disponueshmërisë së

245 Shih Rregullat, 111, 112 dhe 113 RrPP e TPNJ-së. Limiti i fjalëve të lejuara parashikohet në Udhëzimin mbi Volumin e Dosjeve dhe Mocioneve (IT:184/Rev.2).
246 Shih Rregullin 127 RrPP e TPNJ-së lidhur me Ndryshimin e Afateve Kohore dhe Rregullin 116 të RrPP të TPNR-së.
247 Shih, p.sh. *Mrkšić e të tjerë*, D. Milošević.
248 Një praktikë e tillë, natyrisht, nuk është e disponueshme në rastin e një të akuzuari të vetpërfaqësuar.
249 Shih Rregullin 115 RrPP të TPNJ-së.

provave, gjatë procesit gjyqësor në shkallë të parë, Dhoma e apelit duhet të shqyrtojë nëse pala që paraqet provën ka mundur të demonstrojë apo jo se ajo është përpjekur të përdorë në mënyrën e duhur të gjithë mekanizmat e mbrojtjes dhe të detyrimit, që ofron Statuti dhe në Rregullorja, për sjelljen provave përpara Dhomës gjyqësore të shkallës së parë. Gjithashtu paraqitësi duhet të demonstrojë që, provat e ofruara janë njëherazi të përshtatshme dhe të besueshme për çështjen materiale në fjalë dhe se ato mund të kishin qenë me rëndësi vendimtare për vendimin e Dhomës gjyqësore të shkallës së parë. Për më tepër, praktika gjyqësore e TPNJ-së ka vendosur se, kur prova është e përshtatshme dhe e besueshme, por e gjindshme gjatë gjykimit në shkallë të parë, ose që ajo mund të zbulohej në rast se do të ishte bërë përpjekja e duhur, Dhoma e apelit, mund ta pranojë atë përsëri në apel me kusht që pala kërkuese të provojë se përjashtimi i kësaj prove *do të* shpinte në një dështim të drejtësisë. Domethënë, duhet të demonstrohet se, në rast se gjatë gjykimit në shkallë të parë, do të shqyrtoheshin prova plotësuese, një gjë e tillë *do të* kishte ndikim mbi vendimin e dhënë.[250]

Lënda Blaškić: Ndikimi mbi procesin gjyqësor në apel pas hapjes së një arkivi kombëtar

Faktet që kanë të bëjnë me çështjen Blaškić kanë ndodhur gjatë konfliktit midis Këshillit të Mbrojtjes Kroate (KMK) dhe Ushtrisë Myslimane Boshnjake në rajonin e luginës së Lašva-s, në Bosnjën Qendrore, në periudhën që shkon nga muaji maj 1992 deri në janar 1994. Apeluesi, Tihomir Blaškić, ishte komandant i forcave të Armatosura të KMK-së për Bosnjën Qendrore për periudhën kur ishin kryer krimet në fjalë. Më 3 mars 2000, Dhoma gjyqësore e shkallës së parë e dënoi atë me 45 vjet burg, për nëntëmbëdhjetë akuza, që lidheshin me krimet e kryera në këtë rajon, përfshi edhe për shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës dhe krime kundër njerëzimit, si për urdhërimin e krimeve ashtu edhe për cilësinë e tij eprore, sipas Nenit 7(3) të Statutit. Blaškić-i e depozitoi njoftimin e tij për apel më 17 mars 2000. Ky apel i vonuar karakterizohej nga një sasi jashtëzakonisht e madhe provash plotësuese. Midis arsyeve të tjera, kjo vonesë i detyrohej edhe faktit që, gjatë procesit gjyqësor, Republika e Kroacisë kishte shfaqur mungesë bashkëpunimi dhe kishte vonuar hapjen e arkivave të saj, gjë që u bë e mundur vetëm pas vdekjes së ish-presidentit Franjo Tuđman më 10 dhjetor 1999, duke i penguar kësisoj palët të përdornin gjatë procesit gjyqësor këtë material arkivor.

*Gjatë procedurës në apel, apeluesi depozitoi katër mocione, ku ai kërkonte pranimin e mëse 8,000 faqeve material si prova plotësuese në apel. Mocioni i parë i për provat plotësuese u depozitua më 19 janar 2001, dhe i fundit, më 12 maj 2003. Më 31 tetor 2002, Dhoma e Apelit nxori një urdhër lidhur me tre mocionet e parë dhe konsideroi të pranueshme një pjesë të provave plotësuese në fjalë. Pasi dëgjoi argumentet gojore të palëve, për të vendosur më pas nëse këto prova e përligjnin zhvillimin e një gjykimi të ri në shkallë të parë për disa ose për të gjitha akuzat e ngritura, Dhoma e Apelit i dha mundësinë Prokurorisë të depozitonte një dosje me materialin kundërshtues që kjo e fundit disponontе.**** Pas depozitimit të mocionit të katërt dhe përfundimtar të Apeluesit dhe materialit kundërshtues të Prokurorisë, Dhoma e apelit dha vendimin e saj lidhur me provat plotësuese, më 31 tetor 2003. Ajo konstatonte se, në rrethanat e kësaj çështjeje, një ri-gjykim I çështjes nuk garantohej. Përfundimisht, si prova plotësuese u pranuan 108 prova dhe në pjesën e seancës në apel për deklarimin e provave, u dëgjuan një sërë dëshmitarësh, nga 8 deri 11 dhjetor 2003, gjë që u pasua nga argumentimet përmbyllëse të palëve.**

* Blaškić, Aktgjykimi në apel, para. 2-6.

34. Në fillimet e veta, praktika e TPNJ-së kërkonte që mocionet e depozituara për pranimin e provave plotësuese, të bëheshin sapo provat të zbuloheshin. Kjo praktikë rezultoi në depozitimin e mocioneve të shumta për disa

250 *Prokurori kundër Ramush Haradinaj e të tjerë.*, Lënda Nr. IT-04-84-AR65.2, Vendim lidhur me kërkesën e Lahi Brahimaj-t për të paraqitur prova plotësuese sipas Rregullit 115, 3 mars 2006, para. 11; *Prokurori kundër Jovica Stanišić dhe Franko Simatović*, Çështja Nos. IT-03-69-AR65.1 dhe IT-03-69-AR65.2, Vendim lidhur me Kërkesën e Prokurorisë sipas Rregullit 115 për të paraqitur Prova Plotësuese në apelin e saj kundër Lirimit të Përkohshëm, 11 nëntor 2004, para. 4-7; *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Lënda Nr. IT-95-14-A, Vendim për Provat, 31 tetor 2003, f. 3; *Prokurori kundër Radislav Krstić*, Lënda Nr. IT-98-33-A, Vendim lidhur me kërkesat për Pranim të Provave Plotësuese në Apel, 5 gusht 2003, f. 4.

çështje, dhe shërbeu gjithashtu si një arsye për të kërkuar rivendosjen në afat të depozitimit të dosjeve në apel.

35. Në vijim të rekomandimit të Grupit të Punës për Përshpejtimin e Apeleve, Rregulli u ndryshua me synimin për të mundësuar shtyrjen e afatit të depozitimit të dosjeve "jo më vonë se tridhjetë ditë pas datës për depozitimin e dosjes së kundërpërgjigjes, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë arsye dhe shkaqe të mjaftueshme dhe bindëse për shtyrje në fjalë, ose kur, pas seancës dëgjimore jepen arsye që përligjin një veprim të tillë." Ky ndryshim ka pasur efektin pozitiv që pritej lidhur me kufizimin e numrit të mocioneve të bëra për pranimin e provave plotësuese në Dhomën e apelit, duke i mundësuar kësaj të fundit që këto mocione t'i merrte pasi ato ishin analizuar në Aktgjykimin e shkallës së parë, të njihte bazat e apelit dhe argumentet mbështetës që palët kishin ngritur, në pritje të përgatitjes së seancës së apelit. Secila prej palëve që preket nga këto mocione mund të paraqesë material kundërshtues dhe palët kanë të drejtë të depozitojnë dosje plotësuese lidhur me ndikimin e krijuar nga provat plotësuese.

36. Gjatë fazës së apelit mund të krijohen vështirësi në drejtim të qasjes së provave të fazave hetimore, paragjyqësore dhe gjyqësore të shkallës së parë. Për më tepër, zgjidhjet pozitive të këtyre vështirësive, të tilla si hapja e një arkivi kombëtar pas procesit gjyqësor, mund të kenë një ndikim serioz në procesin gjyqësor në apel (shih kutinë *"Lënda Blaškić: Ndikimi mbi procesin gjyqësor në apel pas hapjes së një arkivi kombëtar"*). Nisur nga fakti që arkivat në rajonin e Ballkanit janë bërë të disponueshme vetëm pasi një numër gjykimesh kishin përfunduar, pranë Dhomës së apelit u depozituan një numër i konsiderueshëm mocionesh, të cilat synonin të paraqisnin një numër të madh provash plotësuese për apel. Kjo është një gjendje e pritshme në rastin e vendeve ku konflikti është në vijim e sipër ose sapo ka përfunduar.

D. Përgatitja për seancën apelit

37. Detyra e Dhomës së apelit është veçanërisht komplekse si rrjedhojë e shumë faktorëve, përfshi këtu edhe përmasat e çështjeve në apel, kompleksitetin e çështjeve ligjore të ngritura, prirjen e palëve për të ngritur pretendime për gabime lidhur me pjesën më të madhe të fakteve të përdorura nga gjykimi i shkallës së parë, pa plotësuar domosdoshmërish standardin e apelit. Kjo detyrë, bëhet akoma më e ndërlikuar, nga disa procese gjyqësore të shkallës së parë, të cilat kanë dështuar për të nxjerrë në pah konkludimet faktike specifike lidhur me çdo element të krimit nën akuzë sipas formës së përgjegjësisë së përcaktuar si edhe nga mos-organizimi i konkludimeve faktike sipas ngjarjeve të veçanta, për të cilat ngrihet çdo akuzë e veçantë.

38. Duke mbajtur parasysh këto ndërlikime, TPNJ-ja ka arritur në përfundimin se, do të ishte më dobiprurëse që të vihej në jetë një analizim sistematik i krejt aspekteve të apelit, *përpara* se të organizohej seanca dëgjimore në apel. Ky proces përfshin përgatitjen e një memorandumi për çdo apel, i cili përmbledh argumentimet e palëve. Më pas, ky proces u braktis, sepse ai nuk dha ndonjë përfitim real. Më tej, Tribunali adoptoi praktikën e nxjerrjes së një "dokumenti përgatitor" për seancën dëgjimore në apel, dokument në të cilin analizoheshin dosjet e apelit. Dokumenti përgatitor ishte konceptuar për të vënë në dijeni gjykatësit rreth argumenteve që mund të rrëzoheshin në bllok dhe ai përmblidhte njëkohësisht edhe argumente të tjera si edhe rekomandonte rrugët se si mund të përdoreshin ato. Dokumenti siguronte mbështetjen e nevojshme kërkimore për rekomandimet e projektuesve të tij, d.m.th. për kërkimin ligjor që lidhej me gabimet e pretenduara të ligjore si edhe me pjesët përkatëse të transkripteve, provave materiale, etj., që lidheshin me gabimet e pretenduara të faktike. Në këtë mënyrë, Gjykatësve u sigurohej materiali përkatës i përshtatshëm për këshillim lidhur me çështjet e apeluara. Së fundmi, dokumenti përgatitor identifikonte hapësirat e

dosjeve të palëve që kishin nevojë për sqarim dhe pyetjet që gjykatësit mund të dëshironin të ngrinin gjatë seancës dëgjimore, si edhe ato aspekte të apelimit që gjykatësit mund të kishin më tepër dëshirë që palët e angazhuara në çështjen në fjalë, të trajtonin më gjatë në parashtrimet e tyre gojore.

39. Dokumenti përgatitor është konceptuar përmes përdorimit të modelit të aktgjykimit të TPNJ-së dhe mbi bazën e stilit të aktgjykimeve të apelit, me qëllim që të kursehet kohë në momentin e nxjerrjes së projekt-aktgjykimit të parë. Në praktikë, rreth katër javë përpara mbajtjes së seancës dëgjimore të apelit, gjykatësi kryesor qarkullon në pjesën tjetër të trupit gjykues dokumentin në fjalë. Një gjë e tillë u mundëson gjykatësve, të tregojnë nëse ata dëshirojnë të bëjnë pyetje të veçanta ndaj palëve, përpara mbajtjes së seancës dëgjimore, zakonisht si pjesë apo shtojcë përkundrejt afatit të caktuar për seancën dëgjimore. Dokumenti përgatitor ka për qëllim të informojë plotësisht gjykatësit rreth apelit në fjalë dhe t'i ndihmojë ata, si në drejtim të seancës ashtu edhe gjatë tërheqjes së tyre për marrjen e vendimit. Një gjë e tillë, nuk do të thotë se gjykatësit duhet të japin ose të marrin vendime të nxituara përpara se të organizohet seanca dëgjimore në apel. Përkundrazi, dokumenti përgatitor e vendos trupin gjykues në situatën më të mirë të mundshme, për të përfituar sa më shumë nga argumentimet e palëve gjatë seancës dëgjimore, si edhe për të shfrytëzuar sa më mirë burimet e veta, për t'u përqendruar në elementët më kryesorë të apelimit dhe për të përgatitur në apel një aktgjykim të saktë, të qartë dhe të arsyetuar brenda një kuadri kohor që është i pranueshëm për Tribunalin. Kjo qasje, jo vetëm mundëson shfrytëzimin optimal të periudhës kohore që shtrihet midis kompletimit të dosjes dhe kohës, në të cilën, pasi janë gjykuar të gjitha çështjet e para-apelit, Dhoma e apelit është në gjendje të dëgjojë apelin, por edhe të shkurtojë kohën për shpalljen e Aktgjykimit të Apelit.

40. Lloji i pyetjeve që mund të bëhen, si rrjedhojë e rishikimit të dosjeve të palëve, shkojnë nga pyetjet specifikuese, lidhur me provat që figurojnë në dokumentacionin gjyqësor, qartësimin e pozicionit të palëve lidhur me kërkesat ligjore të veçanta, ose pohimin e pikëpamjeve të tyre rreth procedurës së përshtatshme që ata do të dëshironin që Dhoma e apelit të ndiqte në rast se në apel do të arrihej në disa konkluzione të caktuara. Një model i këtyre lloj pyetjesh, mund të gjendet në urdhrin për shtyrje të afatit për përgatitjen e seancës dëgjimore për apelin e çështjes *Orić*.[251]

E. Seanca e apelit

41. Zakonisht, seancat në apel zgjasin një deri në dy ditë, në varësi të numrit të apeluesve. Ngandonjëherë ato paraprihen nga seancat e seancës së provave, në varësi të rezultatit të mocioneve të depozituara nga palët për pranimin e provave plotësuese. Dhoma e apelit u kujton palëve standardin që kërkohet nga procesi i apelit

251 *Prokurori kundër Naser Orić*, Lënda Nr. IT-03-68-A, Shtojcë për Urdhrin për Shtyrje të Afatit të Seancës Dëgjimore në apel, 10 mars 2008 ("*Orić* Urdhër për Shtyrje të Afatit), këto pyetje, ndër të tjera, i ftonin palët të: 1) të identifikonin provat në dokumentacionin gjyqësor, në rast se kishte të tilla, të cilat mbështesnin ose rrëzonin pretendimin sipas të cilit, një prej vartësve të Apeluesit kishte ose jo përgjegjësi penale; dhe 2) të pozicionoheshin lidhur me qëndrimin që palët do të mbanin, nëse Dhoma e apelit do të pranonte pretendimin e Mbrojtjes, sipas të cilit, Dhoma gjyqësore e shkallës së parë nuk kishte mundur të gjente provat e duhura faktike lidhur me elementët që kërkoheshin për fajësimin e të akuzuarit sipas Nenit 7(3) të Statutit; shih gjithashtu *Prokurori kundër Blagoje Simić*, Lënda Nr. IT-95-09-A, Urdhër për rivendosje në afat të seancës dëgjimore, 05 maj 2006, që i ftonte të dy palët të 1) shpjegonin se kur mund të riparohej në kohën e duhur, gjatë procesit gjyqësor, një padi me mangësi, në mënyrë që i akuzuari të konsiderohej i njoftuar me kohë për akuzat që rëndonin mbi të si edhe me faktet që mbështesnin këto akuza, në mënyrë që ai të kishte kohë të përgatiste Mbrojtjen e tij; dhe 2) t'i mundësonin të akuzuarit, të pozicionohej, në rast se Dhoma e apelit do të arrinte në përfundimin se Apeluesi nuk ishte njoftuar për faktin se ai kishte marrë pjesë në një vepër penale në bashkëpunim dhe se si përgjegjësia e tij mund të karakterizohej përmes një forme tjetër përgjegjësie, të ndryshme nga forma e fajit që ishte pranuar në Marrëveshjen e vetëdeklarimit të fajësisë, e cila figuronte në aktakuzë, dhe nëse në këtë rast, elementët e kësaj forme përgjegjësie mund të përmbusheshin, bazuar mbi provat e gjetura në gjykimin e shkallës së parë.

dhe i fton ato të jenë të sakta dhe të shmangin përsëritjen e atyre elementëve që tashmë figurojnë në dosjen e depozituar prej tyre (ky rikujtim u bëhet gjithnjë e më shumë palëve qysh më parë, si pjesë e afateve të përcaktuar apo të një shtese përkatëse). Gjykatësit mund t'u drejtojnë pyetje palëve dhe, pas këtij momenti, Dhoma e apelit e ka praktikë të saj, t'i japë të drejtën personave apelues, që janë të dënuar, të bëjnë një ndërhyrje të shkurtër, përpara se ajo të tërhiqet për marrjen e vendimit.

F. Këshillimi dhe përpilimi i aktgjykimeve të apelit

42. Përgjithësisht, këshillimi bëhet pas seancës. Në vijim të këshillimit, gjykatësi kryesues mbikëqyr përpilimin paraprak të aktgjykimit, duke bërë amendimet e nevojshme të dokumentit përgatitor, për të futur në të informacionin e ri që ka rezultuar nga seanca e apelit si edhe vendimet zbatuese të ndërmarra nga gjykatësit gjatë këshillimit mbi çështjet e ndryshme të ngritura në apel(e). Projekt-aktgjykimi qarkullohet në trupën gjyqësore, në mënyrë që kjo e fundit të bëjë vërejtjet e saj sa më shpejt të jetë e mundur. Pasi përfundon qarkullimi i draftit të parë, mund të rezultojë se është e nevojshme të bëhet një këshillim tjetër si dhe të kryhen edhe kërkime të tjera, që mund të konsiderohen të nevojshme. Rekomandohet një zbatim i rreptë i standardit të rishikimit në apel. Me qëllim që të kufizohet përmasa e aktgjykimeve, praktika ka përcaktuar që të hidhen poshtë në mënyrë të përmbledhur, mbi bazë argumentesh, prova që nuk përmbushin kriteret e standardit. Për të bërë një gjë të tillë, Dhoma e apelit përdor mënyra të ndryshme. Një prej mënyrave të përdorura, ka të bëjë me gjetjen e arsyes se përse një kategori e veçantë dokumentesh nuk e plotëson standardin dhe thjesht bën listën e argumenteve të palëve, që përfshihen në këtë kategori, pa hyrë në diskutime të mëtejshme.

Lënda Galić: Pretendimet për gabime faktike

Në çështjen Galić, Dhoma e apelit diskutoi deri diku hollësisht, një pretendim të veçantë të ngritur, sipas të cilit, Dhoma gjyqësore e shkallës së parë kishte kryer një gabim faktik, duke mos shqyrtuar provat që kishte përpara saj. Dhoma e apelit konstatoi se pretendimet e apeluesit për gabime faktike ishin të gabuara dhe bazoheshin mbi një keqkuptim të standardit të provës përtej dyshimit të arsyeshëm. Më pas, Dhoma e apelit thjesht listoi pretendimet që binin nën të njëjtën kategori.

Para. 260. Në mënyrë të ngjashme, Galić deklaron, në raste të ndryshme, se Dhoma gjyqësore e shkallës së parë, ose nuk ka mbajtur parasysh faktin se ka pasur luftime të shpeshta, ose ka injoruar aktivitetin e Armatës së BH-së. Një gjë e tillë është e pasaktë – shpesh, Dhoma gjyqësore e shkallës së parë ka përmendur dhe ka shqyrtuar pozicionin e forcave të armatosura të BH-së.

Para. 261. Në kategorinë e provave të shqyrtuara nga Dhoma gjyqësore e shkallës së parë janë përfshirë edhe pretendimet e mëposhtme:

(a) Pretendimi se Dhoma gjyqësore e shkallës së parë nuk ka shqyrtuar provat e sjella nga dëshmitarët e mbrojtjes Dunjić dhe Kunjadić, në lidhje me Incidentet e parashikuara, si rrjedhojë e Incidenteve të Regjistruara me Snajperë 10 dhe 6. Ajo e ka shqyrtuar këtë provë.

(b) Pretendimin se Dhoma gjyqësore e shkallës së parë nuk ka shqyrtuar provat që lidhen me objektivat ushtarake në Alipašino Polje. Dhoma gjyqësore e ka shqyrtuar këtë provë.

(c) Pretendimin se Dhoma gjyqësore e shkallës së parë nuk ka shqyrtuar dislokimin e forcave të armatosura të BH-së në rajonin e Dobrinja-s. Një gjë të tillë ajo e ka bërë.

(d) Pretendimin se Dhoma gjyqësore e shkallës së parë duhej të kishte shqyrtuar faktin se granata në Incidentin e Regjistruar të Bombardimit 2, kishte qëlluar dikë. Dhoma gjyqësore ka shqyrtuar pikërisht një gjë të tillë.

43. Tashmë janë dhënë shembuj rreth prirjes që ka Dhoma e apelit, për të rrëzuar në bllok argumente ose baza që nuk plotësojnë standardin e rishikimit në apel, një variant i së cilës mund të gjendet në Aktgjykimin e çështjes *Galić* (shih kutinë *"Lënda Galić: Pretendimet për gabime faktike"*).

44. Pas marrjes së komenteve të gjykatësve, në trupin gjykues qarkullon një draft i dytë, i cili përmban vërejtjet në fjalë. Drafti i ri nënvizon ndryshimet që ekzistojnë midis draftit të parë dhe të dytë si edhe tregon

hapësirat ku kërkohet një këshillim i mëtejshëm ose ku nuk ka një shumicë të qartë mendimi. Në vijim të marrjes së raundit të dytë të vërejtjeve të gjykatësve, fillon qarkullimin një draft i tretë e zakonisht përfundimtar para nënshkrimit. Faza përfundimtare e procesit të përpilimit mund të përfshijë gjithashtu qarkullimin e projektdeklaratave, si edhe të mendimeve të ndryshme dhe/ose të veçanta, që, nga ana e tyre, mund të kenë nevojë për një përmirësim përfundimtar të Aktgjykimit. Pasi caktohet data e shpalljes së aktgjykimit, nxirret një urdhër lidhur me afatet, i cili njofton palët dhe depozitohet publikisht. Veç kësaj përgatitet edhe një version i përmbledhur i aktgjykimit, i cili do të lexohet në seancë publike nga gjykatësi kryesues në prani të trupit gjykues dhe të palëve. Kopje të lidhura të Aktgjykimit janë të gjindshme në një nga gjuhët e punës së Tribunalit, për t'ju shpërndarë palëve që marrin pjesë në seancë. Menjëherë pas Aktgjykimit, është mirë që Tribunali të nxjerrë një deklaratë për shtyp në të gjitha gjuhët zyrtare të tij. Kjo deklaratë për shtyp kërkohet të jetë e kuptueshme edhe nga njerëzit e zakonshëm dhe duhet të përqendrohet në aspektet kryesore të aktgjykimit. Deklaratat për shtyp, që bëhen lidhur me aktgjykimin, zakonisht përgatiten në bashkëpunim midis Dhomës së apelit dhe Zyrës së shtypit.

G. Administrimi i apeleve të ndërkohshëm dhe apeleve të tjerë

45. Apelet e ndërkohshëm janë apele që ngrihen gjatë fazës paragjyqësore ose gjyqësore të shkallës së parë kundër vendimeve të Dhomës gjyqësore të shkallës së parë dhe ato dallojnë nga apelet që bëhen ndaj aktgjykimeve të kësaj Dhome. Në varësi të natyrës së tyre, apelet e ndërkohshme mund të marrin shumë kohë dhe mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit paragjyqësor dhe atij gjyqësor. Në varësi të numrit të tyre, apelet e ndërkohshme mund të kufizojnë aftësinë e Dhomës së apelit, për të trajtuar apelimet e aktgjykimeve brenda një kohe të arsyeshme. Për rrjedhojë është e rëndësishme që apelet e ndërkohshme të panevojshme të shmangen dhe ndaj tyre të adoptohet një qasje që garanton trajtimin e tyre të shpejtë e të drejtë.

46. Në një përpjekje të hershme për të përshpejtuar procedimin gjyqësor përmes eliminimit të apeleve të pathemelta, Rregullorja parashikonte se një palë që depozitonte një kërkesë në apel, duhej të depozitonte gjithashtu përpara një trupi gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë të Dhomës së apelit, një kërkesë ku ajo të kërkonte lejimin e apelimit. Në atë kohë, rregullat e zbatueshëm për apelet e ndërkohshme i kufizonin ato brenda dy situatave të mëposhtme: (1) në rast se vendimi i apeluar shkaktonte ndaj çështjes së palës kërkuese një dëm, i cili nuk mund të ndreqej nga vendimi përfundimtar i gjykimit dhe as nga aktgjykimi përfundimtar i apelit dhe ; (2) në rast se çështja në apelin e kërkuar ishte e një rëndësie të përgjithshme për procesin gjyqësor përpara Tribunalit ose të drejtës ndërkombëtare në përgjithësi. Një praktikë e tillë rezultoi kundërproduktive, pasi ajo përdorte burime gjyqësore të Dhomës së apelit për të përcaktuar nëse duhej ose jo të jepej leje, në një kohë që këto burime mund të përdoreshin ose të orientoheshin më me rendiment në drejtim të shqyrtimit të meritave të çështjeve në apel. Për më tepër, në shumë raste, u konstatua se, ishte më e përshtatshme për Dhomën gjyqësore të shkallës së parë që kishte dhënë vendimin, se sa për Dhomën e apelit, të vepronte si filtruese dhe të përcaktonte se cilët vendime duhej t'i nënshtroheshin apelit të ndërkohshëm. Për rrjedhojë, praktika e hershme u eliminua nga Rregullorja, pas rekomandimit të bërë nga Grupi i Punës për Përshpejtimin e Apeleve. Ajo u zëvendësua me një sistem, në të cilin, disa apele pranohen automatikisht dhe disa apele të tjerë kërkojnë certifikim nga Dhoma gjyqësore të shkallës së parë. Apelet e ndërkohshme përfshijnë kryesisht apelet që bëhen kundër:

- vendimeve për mocione që kundërshtojnë juridiksionin,[252]
- vendimeve që lidhen me lirimin e përkohshëm,[253]
- vendimeve të Bankës së Transferimit të Çështjeve,[254] dhe
- vendimeve për procedimin e aktit të Shpërfilljes.[255]

47. Apelet që bëhen si pasojë e të gjitha vendimeve të tjera, kërkojnë certifikim nga Dhoma gjyqësore e shkallës së parë. Në to përfshihen apelimet e vendimeve për mocionet paraprake, të ndryshme prej atyre që kundërshtojnë juridiksionin (d.m.th. që pretendojnë për mangësi në formën e aktakuzës, që kërkojnë ndarjen e akuzave që janë bashkuar në një aktpadi të vetme ose që kërkojnë ndarjen e gjykimeve; ose që ngrenë kundërshtime bazuar mbi refuzimin e një kërkese për caktim avokati mbrojtës),[256] si dhe apelimet e vendimeve për mocione, që janë të ndryshme nga mocioni paraprak(paragjyqësor). Në rastin e fundit, Dhoma gjyqësore e shkallës së parë, mund të japë certifikimin e saj në rast se vendimi ka të bëjë me një çështje që "do të prekte realizimin e shpejtë dhe të drejtë të procesit gjyqësor ose rezultatin e gjykimit, dhe ku, sipas opinionit të Dhomës gjyqësore të shkallës së parë, një vendim i shpejtë i Dhomës së apelit mund të çonte materialisht përpara procesin."[257]

48. Dhoma e apelit e ka braktisur praktikën e saj të mëparshme për përgatitjen e një memorandumi paraprak, që nxirrte në pah çështjet e ngritura nga apeli ndërkohës dhe propozonte rrugët për trajtimin e tyre. Në pjesën më të madhe të rasteve, përgatitja e një memorandumi të tillë nuk është e nevojshme. Një projekt vendim duhet të jetë vetëshpjegues dhe, nëse është e nevojshme, mund të ngërthejë në vetvete opsione ose shënime të gjykatësit, i cili qarkullon projektin. Në Dhomat e apelit të TPNJ-se dhe TPNR-së, është favorizuar dhe zbatuar me më tepër sukses një qasje tjetër. Sapo dosja është plotësuar, gjykatësi kryesues përgatit dhe qarkullon projektvendimin tek anëtarët e tjerë të trupit gjykues. Projektvendimi përfshin opsionet ose shënimet, kur është e nevojshme, dhe formon bazën mbi të cilën bëhen vërejtjet e ndryshme. Më pas këto gjykime përfshihen dhe përpilohet një projekt i ri, i cili qarkullon sipas së njëjtës mënyrë sikurse ndodh edhe me apelimet e aktgjykimeve.

49. Shpesh, apelet e ndërkohshme bëhen ndaj vendimeve të marra nga Dhoma gjyqësore e shkallës së parë, në hapësira ku këto të fundit ushtrojnë të drejtën e tyre. Në apelime të tilla, çështja që shtrohet nuk është "nëse vendimi ishte i drejtë, në kuptimin që Dhoma e apelit pajtohet ose jo me këtë vendim, por më tepër nëse Dhoma gjyqësore e shkallës së parë ka ushtruar ose jo me korrektësi të drejtën e saj në arritjen e këtij përfundimi".[258] Kësisoj, sa herë që Dhoma gjyqësore do të kundërshtojë një vendim, që është në të drejtën e saj, pala kërkuese duhet të provojë se Dhoma gjyqësore ka kryer një gabim të "dallueshëm," i cili rezulton me dëmtimin e palës në fjalë.[259] Dhoma e apelit e përmbys ushtrimin e të drejtës së Dhomës gjyqësore të shkallës së parë, vetëm kur ajo konstaton se ky ushtrim "(1) bazohet mbi një interpretim jo të saktë të ligjit

252 Rregulli 72(B)(i) RrPP e TPNJ-së.
253 Rregulli 65(D) RrPP e TPNJ-së.
254 Rregulli 11*bis*(I) RrPP e TPNJ-së. Mbështetur në Nenin 11*bis* të Rregullores, Banka Ligjore e Transferimit të Çështjeve ka kompetencën të vendosë, pasi aktakuza të jetë konfirmuar dhe përpara fillimit të procesit gjyqësor, me nismën e vet Dhomës ose me kërkesë të Prokurorit, nëse një çështje gjyqësore do t'i kalohet ose jo për gjykim autoriteteve të një shteti për t'u gjykuar brenda juridiksionit të tij.
255 Rregulli 77(J)-(K) RrPP e TPNJ-së.
256 Rregulli 72(B)(ii) RrPP e TPNJ-së.
257 Rregulli 73(B) RrPP e TPNJ-së.
258 *Milošević* Vendim për Bashkim Gjykimi, para. 4.
259 Vendim i Dhomës së apelit i 8 dhjetorit 2006, para. 16; shih gjithashtu *Prlić* Vendim lidhur me Pyetjet e Drejtpërdrejta, f. 3 që citon Vendimin për Bashkim Gjykimi në Çështjen *Milošević*, para. 4. Shih gjithashtu *po aty,* para. 5-6; shih gjithashtu Vendim për Caktim Avokati në Çështjen *Milošević*, para. 10; Vendim lidhur me Mocionin e Ndërkohshëm në Çështjen Radivoje Miletić, para. 6 *që citon Prokurori kundër Mićo Stanišić*, Lënda Nr. IT-04-79-AR65.1, Vendim lidhur me Apelin e Ndërkohshëm të Prokurorisë për Lirimin e Përkohshëm të Mićo Stanišić, 17 tetor 2005 ("Vendim për Lirimin e Përkohshëm të *Stanišić*"), para. 6.

të zbatueshëm; (2) bazohet mbi një konkluzion haptazi të pasaktë fakti; ose (3) është aq i padrejtë dhe i paarsyeshëm, saqë zbatimi i tij do të përbënte një abuzim ndaj vetë të drejtës së Dhomës gjyqësore për të vendosur."[260]

H. Procedura e apelit të përshpejtuar

50. Praktika, e cila synonte përshpejtimin e procedurave që lidheshin me apelet e ndërkohshëm, apelet e vendimeve të Shpërfilljes dhe apelet e vendimeve të Trupit Gjykues për Transferim të Çështjeve gjyqësore, tashmë është pasqyruar edhe në Rregulloren e Tribunalit, në vijim të rekomandimit të Grupit të Punës për Përshpejtimin e Proceseve në Apel të vitit 2005. Në rastin e apeleve të tillë, praktika e re zbaton një procedurë të përshpejtuar apeli që përfshin shkurtimin e afatit kohor për përgatitjen e dosjes dhe lejon mundësinë e bërjes së apeleve krejtësisht mbi bazën e dosjeve me shkrim.[261] Një afat i shkurtuar për përgatitjen e dosjes gjen gjithashtu zbatim edhe në rastin e apelimit të dënimeve, të cilët janë shumë më pak të ndërlikuar dhe voluminozë se sa aktgjykimet e tjera të apelit. Sipas këtij afati të shkurtuar kohor në përgatitjen e dosjes, dosja e Apeluesit duhet të depozitohet brenda tridhjetë ditësh nga momenti i depozitimit të njoftimit në apel, dosja përgjegjëse brenda tridhjetë ditëve nga depozitimi i dosjes së apeluesit dhe dosja e kundërpërgjigjes brenda dhjetë ditësh nga depozitimi i dosjes së përgjigjes.[262]

260 Vendim lidhur me Apelin e Ndërkohshëm të Radivoje Miletić, para. 6 dhe n. 17 *që citon* Vendimin për Lirimin e Përkohshëm të *Stanišić, para.* 6 dhe n. 10. "Dhoma e apelit do të shqyrtojë gjithashtu nëse Dhoma gjyqësore e shkallës së parë i ka dhënë ose jo peshë konsideratave të jashtme ose të papërshtatshme, duke mos u dhënë peshën e duhur konsideratave të përshtatshme…" Vendim për Bashkim Gjykimi në Çështjen *Milošević*, para. 5.

261 Rregulla 116*bis* RrPP e TPNJ-së.

262 Krahasuar me, përkatësisht, shtatëdhjetepesë ditë, dyzet ditë dhe pesëmbëdhjetë ditë, në apelet e tjera ndaj aktgjykimeve (Rregullat 111-113 RrPP e TPNJ-së).

XI. Rishikim

A. Konturat ligjore të rishikimit.....154
B. Çështje praktike që i përkasin Rishikimit.....156
B.1 Dhoma kompetente.....156
B.2 Para-rishikimi.....157
B.3 Praktikat dhe Prirjet.....159

1. Me qëllimin e shmangies së dështimeve të drejtësisë, është mirë që të punohet për të dëgjuar fakte të rejae të vërteta, të cilat, zakonisht dalin në dritë pas përfundimit të çdo gjykimi në shkallë të parë dhe në apel. Pavarësisht nga përpjekjet e Tribunalit, për të shqyrtuar tërësinë e aspekteve të një çështjeje gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel, mund të zbulohet gjithnjë një informacion i ri, i cili mund të cenojë vendimin gjyqësor përfundimtar pas mbylljes së çështjes. Për më tepër, dhe jo për faj të palëve, mund të gjenden gjithnjë ose të shfaqen dëshmitarë të rinj të rëndësishëm ose mund të zbulohen e të bëhen të disponueshme materiale të reja, të siguruara nga arkivat, të cilët ka qenë e pamundur deri atëherë t'i kërkoheshin shteteve, që, deri në atë moment nuk kishin pranuar të bashkëpunonin. Ashtu si edhe në pjesën më të madhe të juridiksioneve të brendshme, Statuti dhe Rregullorja e TPNJ-së parashikojnë një procedurë rishikimi, të ndryshme nga procesi i zakonshëm në apel. {Ky seksion do të ravijëzojë shkurtimisht konturat ligjore të kësaj procedure dhe do të përshkruajë se në ç'mënyrë Tribunali administron praktikisht kërkesat për rishikim}.

2. Deri tani Tribunali nuk është përgjigjur pozitivisht ndaj asnjë kërkese për rishikim. Për rrjedhojë, deri tani, rishikimi nuk mbështetet prej asnjë lloj praktike të tillë. Standardi për njohjen e së drejtës të rishikimit duhet të vendosë një ekuilibër midis dy interesash konkurrues. Nga njëra anë, ai duhet të sigurojë finalitetin e gjykimeve të Tribunalit. Përvoja tregon se kërkuesit e rishikimit nuk hezitojnë asnjëherë për të depozituar mocione që kërkojnë të rigjykojnë çështjet, që tashmë janë gjykuar edhe në apel, duke u përpjekur që t'i kamuflojnë ato si kërkesa për "rishikim".[263] Me qëllimin për të ndalur një lumë kërkesash, që faktikisht nuk kërkojnë gjë tjetër veç zhvillimit të një gjykimi të dytë në apel, testi për rishikim është mjaft i ngushtë dhe Tribunali e ka zbatuar atë sipas një mënyre tepër të ngurtë (shih kutinë "*Lëndët Žigić: Dekurajimi i mocioneve të pabaza për Rishikim*").

3. Nga ana tjetër, gjykimi i një çështjeje përpara Tribunalit, paraqet vështirësi të mëdha në drejtim të grumbullimit në kohën e duhur të të gjitha provave që kanë të bëjnë me çështjen. Siç është përmendur më lart, çështjet që trajtohen në Tribunal janë shumë komplekse dhe kërkojnë prova përsa i përket qëndrueshmërisë së fakteve që pretendohen. Për më tepër, shpesh këto çështje kanë të bëjnë me individë të rangut të lartë brenda strukturës ushtarake dhe/ose politike. Procesi gjyqësor, i cili është kryesisht i natyrës adversiale, kërkon nga palët që të grumbullojnë një sasi të madhe provash, të cilat mjaft shpesh gjenden nën zotërimin e shteteve të ndryshme. Duke mbajtur parasysh mekanizmat e kufizuar në drejtim të zbatimit të ligjit si edhe mundësitë e pakta të Tribunalit për kërkimin dhe kapjen e kriminelëve të pretenduar, palët, për të siguruar materialet e nevojshëm për të argumentuar qëndrimet e tyre në çështjet në fjalë, mbështeten kryesisht në bashkëpunimin e shteteve. Megjithatë, klima politike në një shtet të caktuar, mund të mos lejojë dhënien e informacionit të kërkuar deri pas përfundimit të çështjes. Në rast se të gjitha kriteret janë plotësuar, rishikimi garanton që një material i tillë nuk do të përjashtohet nga procesi fakt-mbledhës dhe pengon dështimin potencial të drejtësisë (shih kutinë*"Lënda Blaškić : Mospasje e një numri të konsiderueshëm të provave si rrjedhojë e mungesës së bashkëpunimit të një shteti të caktuar"*) (shih

263 Shih *Prokurori kundër Zoran Žigić a/k/a "Žiga*", Lënda Nr. IT-98-30/1-R.2, Vendim lidhur me Kërkesën për Rishikim të Zoran Žigić sipas Rregullës 119, 25 gusht 2006 ("*Žigić* 25 gusht 2006 Vendim"), para. 10.

vendimin *Žigić* lidhur me Rishqyrtimin, i cili ilustron ekuilibrimin e këtyre dy interesave. Në këtë vendim, Dhoma e apelit u shkëput nga vendimi i saj i më I hershëm në çështjen *Čelebići*, duke konstatuar se në këtë rast, veç rishikimit, kishte një mundësi për të "rishqyrtuar" gjykimet[264]).

A. Konturat ligjore të rishikimit

4. Sipas Nenit 26 të Statutit dhe Rregullave 119 dhe 120, rishikimi është i mundur kur:
   - ka dalë një fakt i ri;
   - fakti i ri nuk njihej nga pala kërkuese në kohën e zhvillimit të procesit gjyqësor;
   - dështimi për të zbuluar faktin e ri nuk është pasojë e mungesës së përpjekjeve nga ana e palës kërkuese; dhe
   - Termi "fakte të reja" i referohe Fakti i ri mund të përbënte një faktor vendimtar në vendimin e dhënë.[265]

5. Termi "fakte të reja" i referohet informacionit të sjellë nga provat, që mbështesin një fakt që nuk është marrë në analizë gjatë gjykimit të shkallës së parë ose gjatë gjykimit në apel,[266] përkundrejt një informacioni të ri të një natyre thjesht faktike. Për shembull, në Vendimin për rishikimin e çështjes *Delić*, Dhoma e apelit nuk e njohu të drejtën për rishikim, bazuar mbi deklaratat e dëshmitarit të ri, sipas të cilit, përpara se të sulmohej, një prej viktimave të një kampi izolimi, ishte nxjerrë me forcë nga rreshti i të burgosurve nga një person tjetër dhe jo nga i akuzuari. Meqenëse dy dëshmitarë, gjatë procesit gjyqësor e kishin identifikuar të akuzuarin si personin që e kishte tërhequr viktimën nga rreshti, e meqenëse i akuzuari që gjatë kësaj kohe e kishte kundërshtuar dëshminë e tyre, deklarata e dëshmitarit të ri, u konsiderua thjesht provë plotësuese dhe nuk përbënte një fakt të ri. Meqenëse informacioni duhet të jetë i një natyre "provuese", zhvillimet ligjore nuk cilësohen si "fakte të

> ***Lëndët Žigić: Dekurajimi i mocioneve të pabaza për Rishikim***
>
> *Në çështjen Žigić, Dhoma e apelit dekurajoi depozitimin e përsëritur të mocioneve për rishikim, duke i konsideruar ato një abuzim me gjykimin e Dhomës së apelit, duke paralajmëruar njëkohësisht për sanksione të mundshme:*
>
> *Ky është mocioni i tretë që Žigić ka depozituar në Dhomën e apelit, duke ngritur pretendime të pabaza e mendjelehta lidhur me integritetin e gjykimit të Dhomës së apelit kundër tij. Pretendimi i parë, një kërkesë për rishqyrtim të gjykimit të Dhomës së apelit, u gjet I pabazë dhe i dyti rezultoi se ishte një ankesë sipas së cilës ndaj tij ishte bërë një gjykim jo i drejtë dhe i anshëm, si rrjedhojë e gabimeve të bëra nga avokati i tij mbrojtës, kërkesë e cila gjithashtu u rrëzua në themel.*
>
> *Gjithashtu, kjo kërkesë për rishikim të Gjykimit të Dhomës së apelit është krejtësisht e pathemeltë. Për më tepër, pretendimet haptazi jo të vërteta të bëra nga Zigić lidhur me gjoja mosnjohjen nga ana e tij të Përmbledhjes së Prokurorisë si edhe të përpjekjeve të bëra, gjithnjë sipas tij, nga Prokuroria për t'i fshehur ato prej tij, jo vetëm që janë të pabaza, por përbëjnë edhe një abuzim të procesit në Dhomën e apelit. Žigić-i duhet ta marrë këtë si një paralajmërim serioz që I bëhet atij nga Dhoma e apelit, dhe çdo përpjekje tjetër nga ana e tij në këtë drejtim, përmes mocionesh të pathemelta, do e shtyjë Dhomën e apelit të ndërmarrë sanksione të ashpra ndaj tij.**
>
> * *Žigić 25 gusht 2006 Vendim,, para. 10.*

264 *Prokurori kundër Zdravko Mucić, Hazim Delić dhe Esad Landžo*, Lënda Nr. IT-96-21-A*bis*, Aktgjykim mbi Vendimin e Apelit, 8 prill 2003, para. 49-53.

265 Ky tekst është zbatuar në mënyrë uniforme e në vazhdimësi në të gjitha vendimet e mëdha të rishikimit. Shih *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Lënda Nr. IT-95-14-R, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit për Rishikim ose Rishqyrtim, 23 nëntor 2006 ("*Blaškić* Vendim për Rishikim"), para. 7; *Prokurori kundër Mlađo Radić*, Lënda Nr. IT-98-30/1-R.1, Vendim mbi Kërkesën e Mbrotjes për Rishikim, 31 tetor 2006 (Version i redaktuar për Publikun) ("*Radić* Vendim për Rishikim"), para. 10; *Žigić* 25 gusht 2006 Vendim, para. 8; *Prokurori kundër Drago Josipović*, Lënda Nr. IT-95-16-R.3, Vendim lidhur me Mocionin për Rishikim, 2 prill 2004, p. 3; *Prokurori kundër Drago Josipović*, Lënda Nr. IT-95-16-R2, Vendim për Rishikim, 7 mars 2003 ("*Josipović* Vendim lidhur me Mocionin për Rishikim "), para. 12; *Prokurori kundër Duško Tadić*, Lënda Nr. IT-94-1-R, Vendim lidhur me Mocionin për Rishikim, 30 korrik 2002, depozituar më 8 gusht 2002 ("*Tadić* Vendim për Rishikim"), para. 20; *Prokurori kundër Goran Jelisić*, Lënda Nr. IT-95-10-R, Vendim lidhur me Mocionin për Rishikim, 2 maj 2002 ("*Jelisić* Vendim për Rishikim"), f. 2-3; *Prokurori kundër Hazim Delić*, Lënda Nr. IT-96-21-R-R119, Vendim lidhur me Mocionin për Rishikim, 25 prill 2002 ("*Delić* Vendim për Rishikim"), para. 8.

266 Shih, *p.sh.*, *Blaškić* Vendim për Rishikim, para. 14-15; *Tadić* Vendim për Rishikim, para. 25. Njohja e faktit "të ri" nuk është e domosdoshme për akordimin e rishikimit. Shih *Blaškić* Vendim për Rishikim, para. 30.

reja".[267] Kërkesa, sipas së cilës, fakti "nuk përbënte objekt diskutimi" gjatë procesit gjyqësor, do të thotë se ai nuk duhej të gjendej midis faktorëve që trupi gjykues mund të kishte mbajtur parasysh në arritjen e vendimit të vet.[268] Në thelb, pala kërkuese duhet të jetë në gjendje të demonstrojë se Dhoma nuk e njihte këtë fakt në momentin e marrjes dhe shpalljes së vendimit të saj.[269]

6. Katër kriteret për dhënien e të drejtës së rishikimit janë të një karakteri përsëritës, gjë që do të thotë se ata duhet të plotësohen të katërt, ndryshe e drejta për rishikim nuk mund të jepet. Megjithatë, në rrethana krejtësisht të jashtëzakonshme, e drejta për rishikim mund të jepet edhe në rast se fakti i ri ishte i njohur për palën kërkuese në momentin e procesit fillestar ose nuk ishte zbuluar për mungesë të përpjekjeve të duhura (kriteri i dytë dhe i tretë më sipër). Në këto raste, pala që kërkon rishikimin duhet të jetë në gjendje të provojë se injorimi i faktit të ri do të shpinte në dështimin e drejtësisë.[270]

7. Subjekt i rishikimit mund të jenë vetëm vendimet që i japin fund gjykimit.[271] Ndonëse, përgjithësisht, një gjë e tillë, nënkupton aktgjykimet në apel, në ato raste kur kërkesa për apel nuk depozitohet, gjykimi i shkallës së parë do të përbëjë vendimin përfundimtar që mbyll procesin. Në rast se afatet për depozitimin e një apeli kanë kaluar, rishikimi mbetet i vetmi mjet në dispozicion për të rishikuar vendimet në fjalë.[272] Sidoqoftë, duhet nënvizuar se, rishikimi është në vetvete një procedurë e jashtëzakonshme. Atje ku një Gjykim i shkallës së parë është apeluar, ai nuk përbën një apelim të dytë.[273] Për rrjedhojë, materiali që mund të shqyrtohet gjatë procedurës së rishikimit (i cili shkon për të provuar fakte që nuk trajtohen në çështjen në fjalë nën gjykim) ndryshon prej materialit që mund të shqyrtohet si provë plotësuese në procedimin në apel (të cilët shkojnë për të provuar fakte që trajtohen në çështjen në fjalë nën gjykim). [274]

Lënda Blaškić : Mospasje e një numri të konsiderueshëm të provave si rrjedhojë e mungesës së bashkëpunimit të një shteti të caktuar

Çështja Blaškić ilustron problemin e shteteve që nuk janë të gatshëm t'u japin material palëve që trajtojnë një çështje përpara Tribunalit. Në gjykimin e saj, Dhoma e apelit vërente se:

*ky proces i gjatë në apel, është karakterizuar, pjesërisht, nga depozitimi i një numri të jashtëzakonshëm provash plotësuese. Ndër të tjera, një gjë e tillë i detyrohet mungesës së bashkëpunimit nga ana e Republikës së Kroacisë në fazën e gjykimit në shkallë të parë si dhe vonesës së shkaktuar si rrjedhojë e mosgatishmërisë së saj për të hapur arkivat e veta, gjë që u bë e mundur vetëm pas vdekjes së ish presidentit Franjo Tuđman, më 10 dhjetor 1999, duke u bërë kështu pengesë për palët që të dispononinn gjatë gjykimit në shkallë të parë të materialeve në fjalë. Gjatë procesit gjyqësor në apel, Apeluesi depozitoi katër mocione sipas Rregullës 115 të Rregullores[…]. Në këto mocione, ai kërkoi të pranoheshin në apel më shumë se 8,000 faqe material si provë plotësuese.**

*Sasia e provave plotësuese ishte aq e madhe sa që Dhoma e apelit shqyrtoi madje edhe vetë mundësinë nëse kjo e përligjte zhvillimin e një gjykimi të ri në shkallë të parë.***

* *Prokurori kundër Tihomir Blaškić, Lënda Nr. IT-95-14-A, Vendimi, 29 korrik 2004 (Aktgjykimi në apel "Blaškić "), para. 4 (shënimi mungon).*

** *laškić Aktgjykimi në apel, para. 5-6; Prokurori kundër Tihomir Blaškić, Lënda Nr. IT-95- 14-A,Urdhër rivendosjeje në afat, 31 tetor 2002, p. 3.*

267 *Tadić* Vendim për Rishikim , para. 41; *Jelisić* Vendim për Rishikim, f. 2-3.
268 Shih, *p.sh., Blaškić* Vendim për Rishikim, para. 14-15; *Tadić* Vendim për Rishikim, para. 25.
269 Shih, *p.sh.,* Blaškić Vendim për Rishikim, para. 14.
270 Shih, *p.sh., Blaškić* Vendim për Rishikim, para. 8; *Tadić* Vendim për Rishikim, para. 26-27. Vlerësimi nëse ekzistojnë "rrethana krejtësisht të jashtëzakonshme" varet nga karakteri i veçantë i çështjeve. Për shembujt kur rrethana të tilla nuk janë të pranishme, shih, *p.sh., Tadić* Vendim për Rishikim, para. 27 dhe 32-33; *Josipović* Vendim për Rishikim, para. 31-38; Delić Vendim për Rishikim, para. 17-22.
271 Rregulla 119(A) RrPP e TPNJ-së, *Blaškić* Vendim për Rishikim, para. 22-23.
272 *Prokurori kundër Zoran Žigić a/k/a/ "Ziga*", Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Vendim lidhur me "Mocionin për Rishqyrtimin e Aktgjykimit të Dhomës së Apelit" të bërë nga *Zoran Žigić* IT-98-30/1-A. Bërë më 28 shkurt 2005", 26 qershor 2006, para. 8-9 ("*Žigić* Vendim për Rishqyrtim").
273 *Tadić* Vendim për Rishikim, para. 24.

8. Procedura e rishikimit në Tribunal është e hapur si për Mbrojtjen ashtu edhe për Prokurorinë. Sidoqoftë, Prokuroria mund të kërkojë rishikim vetëm brenda një viti nga dhënia e gjykimit përfundimtar.[275] Përsa i përket përfaqësimit, një kërkues për rishikim, i cili nuk disponon mjetet e nevojshme ekonomike, gëzon të drejtën të ketë një avokat, shpenzimet e të cilit mbulohen nga Tribunali, në rastet kur rishikimi autorizohet. Madje edhe në këtë rast, Tribunali duhet të vendosë nëse avokati mbrojtës është i nevojshëm edhe për të garantuar paanshmërinë e procedimit. Avokati mbrojtës mund të caktohet edhe për fazën e shqyrtimit paraprak, ndonëse normalisht, për një periudhë kohore shumë të kufizuar.

Lënda Tadić: Shqyrtimet në mungesë të Gjykatësve fillestarë të shkallës së parë

Vendimi për rishikim në Çështjen Tadić ilustron disa konsiderata të rëndësishme në këtë drejtim. Në këtë vendim, dhoma e apelit konstatoi se: 'Mungesa në tërësi ose pjesërisht, e gjykatësve që përbënin trupin gjykues që dha vendimin përfundimtar nuk e eliminon kompetencën e këtij trupi gjyqësor që të trajtojë një kërkesë për rishikim. Kështu, në mungesë të gjykatësve që, fillimisht, përbënin dhomën gjyqësore të shkallës së parë ose Dhomën e apelit që fillimisht dha aktgjykimin përfundimtar, kërkesa për rishikim mund të depozitohet ende me secilin prej këtyre trupave gjykues dhe jo me Kryetarin. Kur një kërkesë për rishikim është depozituar me trupin gjykues kompetent, I takon Kryetarit të të emërojë gjykatësit që do të trajtojnë kërkesën për rishikim ashtu sikurse vepron edhe në rastet e apeleve ndërkohshme dhe apeleve në themel.

Si rrjedhojë e nevojës për të pasur gjykatës që të jenë të familjarizuar me faktet e çështjes, Kryetari do të caktojë gjykatësit që fillimisht e kanë dëgjuar çështjen në fjalë. Sikurse përcaktohet në Rregullën 119 të Rregullores, në rast se këta gjykatës nuk do të gjenden më pranë Tribunalit ndërkombëtar ose nuk do të kenë mundësinë të dëgjojnë kërkesat për rishikim për arsye të ndryshme, Kryetari do të caktojë gjykatës të rinj, që do të zëvendësojnë gjykatësit fillestarë.

B. Çështje praktike që i përkasin Rishikimit

B.1 Dhoma kompetente

9. Pala kërkuese duhet ta depozitojë kërkesën e saj për rishikim me trupin gjyqësor që dha vendimin përfundimtar. Kur palët nuk kanë depozituar një kërkesë për apelim, ky trup është Dhoma gjyqësore e shkallës së parë. Megjithatë, kur vendimi gjyqësor është apeluar, kërkesa duhet të depozitohet në Dhomën e apelit , e cila, pas kësaj, duhet të përcaktojë nëse do e trajtojë kërkesën vetë apo nëse është e nevojshme që këtë çështje t'ia kalojë një trupi gjykues tjetër në shkallë të parë. [276]

10. Mund të ndodhë që disa ose të gjithë gjykatësit që përbënin trupin gjykues fillestar, të mos jenë të në dispozicion për të dëgjuar kërkesën, siç do të ishte për shembull rasti kur ata nuk punojnë më pranë Tribunalit[277] (shih kutinë "*Lënda Tadić: Shqyrtimet në mungesë të Gjykatësve fillestarë të shkallës së parë*").

11. Në mënyrë të ngjashme me praktikën e procedimit në fazën e para-apelimit, në rast se Kryetari i tribunalit, bën pjesë në trupin gjykues të formuar kësisoj, ai do të kryesojë trupin gjykues. Ndryshe, Gjykatësit do e zgjedhin Gjykatësin kryesues mes tyre.

274 Shih, *p.sh., Radić* Vendim për Rishikim, para. 22; Delić Vendim për Rishikim, para. 10-11; shih gjithashtu *Prokurori kundër Duško Tadić*, Lënda Nr. IT-94-I-A,Vendim lidhur me Mocionin e Apeluesit për zgjatjen e limitit kohor dhe Pranimin e Provave Plotësuese, 15 tetor 1998, para. 28-32.
275 Neni. 26, Statuti TPNJ; Rregulla 119(A), RrPP e TPNJ-së.
276 Rregulla 119(A), RrPP e TPNJ-së; *Tadić* Vendim për Rishikim, para. 22.
277 Shih *Tadić* Vendim për Rishikim, para. 23.

B.2 Para-rishikimi

12. Gjykatësi kryesues mund të caktojë një Gjykatës të para-rishikimit nga Dhoma gjyqësore.[278] Gjykatësi i para-rishikimit bashkërendon të gjithë punën rreth mocioneve që bëhen në fazën e para-rishikimit, duke garantuar, mes të tjerash, që krejt çështja të depozitohet brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Çdo dosje, që është krijuar mbi bazën e një kërkese për rishikim, duhet të depozitohet brenda dyzetë ditësh nga momenti i depozitimit të kërkesës dhe dosja e kundërpërgjigjes duhet të depozitohet brenda pesëmbëdhjetë **ditësh** nga dosja e përgjigjes.[279] Gjykatësi i para-rishikimit është kompetent të gjykojë kërkesat për zgjatjen e afateve ose mocionet që kanë të bëjnë me kufizimin e fjalëve apo mocione të tjera që nuk kanë të bëjnë me thelbin e kërkesës për rishikim. Rregulla 127 e Rregullores, i cili lejon zgjatjen e kufijve kohorë, pasi pala kërkuese të ketë demonstruar "arsye të mira" gjen zbatim edhe për dosjet në rishikim.[280] Ndryshe nga faza e gjykimit në shkallë të parë ose nga gjykimi në apel,[281] në praktikën e Rishikimit nuk ekziston ndonjë Udhëzim i Praktikës që trajton në mënyrë specifike volumin e dosjeve në fjalë, ndonëse, në praktikën gjyqësore të Tribunalit janë kristalizuar disa vija udhëzuese.

13. As Statuti, as Rregullorja dhe as praktika gjyqësore e Tribunalit nuk kërkojnë që kërkesat për rishikim të dëgjohen edhe gojarisht.[282] Ndonëse Tribunali nuk pengohet në rast se dëshiron të dëgjojë palët të shprehen edhe gojarisht rreth kërkesave të tyre, kjo gjë nuk është konsideruar ende si diçka e nevojshme në ndonjë prej çështjeve, lidhur me të cilat palët kanë kërkuar rishikim në TPNJ. Kësisoj, kërkesat trajtohen vetëm mbi bazën e parashtrimeve me shkrim të palëve.

14. Ashtu si edhe në rastin e apeleve të ndërkohshme, Gjykatësi kryesues i paraqet Trupit Gjykues një përmbledhje të parashtrimeve të palëve, shoqëruar me një analizë paraprake në formën e një projektvendimi, ku përfshihen, nëse është e nevojshme, edhe opsione të ndryshme. Persiatjet vijuese, bëhen mbi bazën e memorandumeve konfidenciale[283] të shkëmbyera mes gjykatësve, ku ata paraqesin komentet e tyre lidhur me projektvendimin. Ndryshimet e projektvendimit, të cilët mbështeten nga shumica e gjyqtarëve, zbatohen dhe më pas Gjykatësi kryesues qarkullon tek trupi gjykues një projektvendim të dytë, duke

278 Shih *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Lënda Nr. IT-95-14-R, Urdhër konfidencial i Gjykatësit kryesues për Caktimin e Gjykatësit të Para-rishikimit, 25 tetor 2005 (i bërë publik në *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Lënda Nr. No. IT-95-14-R, Urdhër që heq Statusin Konfidencial mbi Urdhërin e Para-shikimit dhe Vendimeve, 5 dhjetor 2005 ("*Blaškić* 5 dhjetor 2005 Urdhër"). Për rastet kur kërkesa për rishikim bëhet përpara Dhomës së apelit të TPNJ-së, shih Rregullat 65 *ter* dhe 107 të RrPP të TPNJ-së.

279 Rregulla 119 RrPP e TPNJ-së.

280 *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Lënda Nr. IT-95-14-R, Vendim Konfidencial rreth Mocionit për Zgjatje Afati, 9 nëntor 2005, f. 3; *Prokurori kundër Tihomir Blaškić*, Lënda Nr. IT-95-14-R, Vendim Konfidencial rreth Mocionit për Zgjatje Afati dhe mocion për Zgjatje kohe, 26 tetor 2005, f. 3 (të bëra publike në *Blaškić* 5 dhjetor 2005 Urdhër). Për praktikën e "shkakut të mirë".

281 Shih Udhëzuesin Praktik mbi Volumin e Dosjeve dhe Mocioneve, IT/184/Rev. 2, 16 shtator 2005.

282 Dëgjimi I parashtrimeve me shkrim në këtë rast akordohet vetëm kur kërkesa është pranuar dhe akorduar e drejta. shih Rregullën 120 RrPP e TPNJ-së. Praktika e Tribunalit për të vendosur rreth kërkesave për rishikim pa dëgjimin e parashtrimit gojor, mund të ilustrohet në mënyrë të ngjashme duke iu referuar mocioneve paragjyqësore dhe apeleve të ndërkohshme. Shih *Prokurori kundër Milorad Krnojelac*, Lënda Nr. IT-97-25-PT, Vendim lidhur me Mocionin Paraprak të Mbrojtjes për Formën e Padisë, 24 shkurt 1999, para. 65-67; Shih gjithashtu *Prokurori kundër Enver Hadžihasanović e të tjerë*, Lënda Nr. IT-01-47-PT, Vendim lidhur me formën e Aktakuzës, 7 dhjetor 2001, para. 72 (sipas të cilit "vlerësimi i përgjithshëm që bëhet se, çështjet janë komplekse dhe të rëndësishme" nuk përbën një "arsye të mirë" për të zhvilluar seancë gojore lidhur me mocionin paragjyqësor në këtë çështje); por shih *Prokurori kundër Milan Kovačević e të tjerë*, Lënda Nr. IT-97-24-PT, 95-4-PT, 95-8-PT, Urdhër për Rivendosje në Afat, 7 maj 1998 (sipas të cilit një seancë dëgjimore gojore lidhur me një mocion për bashkim gjykimesh "mund të lehtësojë" vendimin për mocionin në çështjen në fjalë); *Prokurori kundër Zejnil Delalić e të tjerë*, Lënda Nr. IT-96-21-A, Urdhër lidhur me Kërkesën e Esad Landžo'-s për Argumentim gojor, 26 mars 1999, f. 2; *Prokurori kundër Ante Gotovina e të tjerë*, Lënda Nr. IT-06-90-AR73.1, Vendim lidhur me Apelin e Ndërkohshëm të Miroslav Separović kundër Vendimit të Dhomës Gjyqësore të shkallës së parë mbi Konfliktin e interesave dhe konstatimin e Sjelljes së keqe, 4 maj 2007, para. 14 (që hidhte poshtë, ndër të tjera, kërkesën për dëgjim të parashtrimit gojor gjatë apelit ndërkohës, mes të tjerash, nën këndvështrimin e parashtrimeve të gjata të bëra dhe të depozituara nga palët, si përpara Dhomës gjyqësore të shkallës së parë ashtu edhe në Apel). *Prokurori kundër Slobodan Milošević*, Lënda Nr. IT-02-54-AR73.2, Vendim lidhur me Pranueshmërinë e Provave të Hetuesit të Prokurorisë, 30 shtator 2002, para. 12.

283 *Krahaso*. Rregulla 29 RrPP e TPNJ-së.

nënvizuar, sipas nevojës, hapësirat që kanë nevojë për një përsiatje të mëtejshme ose ato elementë mbi të cilët nuk ka një mendim të qartë nga shumica e gjykatësve.

15. Në vijim të marrjes së raundit të dytë të komenteve nga ana e gjykatësve, përpara se të bëhet nënshkrimi përfundimtar i vendimit, qarkullohet edhe një projekt i tretë dhe shpesh përfundimtar. Faza përfundimtare e projektit mund të përfshijë gjithashtu qarkullimin e projektdeklaratave, si edhe opinionet e ndryshme të veçanta të gjykatësve të ndryshëm, të cilat, edhe ato, mund të kenë nevojë për një rregullim përfundimtar. Pas nënshkrimit të vendimit lidhur me kërkesën për rishikim, ai depozitohet pranë Sekretarisë gjyqësore dhe u shpërndahet palëve. Vendimi i vihet gjithashtu në dispozicion publikut, *ndër të tjera*, përmes postimit të tij (ose në rast se ai përmban një informacion konfidencial, përgatitet një version publik) i cili hidhet në faqen e internetit të Tribunalit.

16. Duhet nënvizuar se, si pasojë e karakterit përforcues e për rrjedhojë përjashtues, që kanë katër kriteret që duhen përmbushur për të fituar të drejtën e rishikimit, në rast se kërkuesi nuk arrin të demonstrojë përmbushjen qoftë edhe të një prej tyre, Gjykatësit mund të mos i trajtojnë parashtrimet e kërkuesit lidhur me kriteret e tjera në vendimin e tyre. Kjo ishte edhe qasja që u mbajt në Vendimin e Rishikimit të çështjes *Radić*:

17. Kur Dhoma e apelit konstaton se kërkesa për rishikim nuk përbën “fakt të ri” sipas kuptimit të Nenit 26 të Statutit dhe Rregullave 119 dhe 120 të Rregullores, ajo nuk pranon të shqyrtojë nëse kërkesa e dytë, e tretë apo e katërt të nevojshme për procesin e rishikimit janë plotësuar ose jo.

18. Megjithatë, rrethanat e çështjes mund të meritojnë shqyrtimin e ndonjë prej kritereve, edhe pse Dhoma konstaton se njëri prej kritereve nuk është përmbushur. Në këtë drejtim, Vendimi për Rishikim në çështjen *Tadić* ofron një shembull ilustrues. Në këtë rast, kërkuesi nxori si “fakt të ri” një konkludim të Dhomës së apelit në një aktgjykim për Shpërfillje të Dhomës së apelit, të dhënë pas gjykimit në apel të çështjes Tadić.[284] Dhoma e apelit konstatoi se konkludimi në çështjen e shpërfilljes përbënte një fakt të ri brenda kuptimit të Rregullës 119 të Rregullores; sidoqoftë, Dhoma e apelit përfundonte se konkludimi nuk ishte “një ‘fakt i ri, i panjohur për palën kërkuese’ ose që nuk mund të mos zbulohej përmes përpjekjes normale të parashikuar në Rregullën 119 të Rregullores."[285] Sidoqoftë, Dhoma e apelit procedoi, duke shqyrtuar “nëse fakti i ri mund të kish qenë ose jo faktor vendimtar në arritjen dhe marrjen e vendimit përfundimtar,"[286] duke iu referuar parimit se fakti duhet të ishte vendimtar:

> *27. […] sa herë që ballafaqohet me një fakt të ri, i cili ka forcë të tillë që mund të ndikonte mbi vendimin, mundet që Dhoma, për të ndalur dështimin e drejtësisë, të veprojë dhe të shqyrtojë nëse fakti i ri është ose jo një faktor vendimtar, edhe pse kriteri i dytë dhe i tretë sipas Rregullës 119 të Rregullores mund të mos jetë përmbushur në pikëpamje formale.*

19. Megjithatë, Gjykatësit, gjatë persiatjeve të tyre, shqyrtojnë gjithnjë katër kriteret për të bërë vlerësimin e të gjithë aspekteve të çështjes, për të mbërritur në një vendim plotësisht të mirinformuar. Në praktikë, për rrjedhojë, ata duhet të sigurohen se provat e paraqitura në mbështetje të “faktit të ri” që pretendohet, nuk demonstrojnë ndonjë dështim të mundshëm të drejtësisë.

284 *Blaškić* Vendim për Rishikim, para. 29-30.
285 *Po aty, në* para. 32.
286 *Po aty,* në para. 33.

B.3 Praktikat dhe Prirjet

20. Vitet e fundit është konstatuar një rritje e numrit të kërkesave për rishikim nga Tribunali dhe një gjë e tillë, i detyrohet, pjesërisht, numrit në rritje të çështjeve të përfunduara, gjersa Tribunali po shkon drejt përfundimit të mandatit të tij. Duke mbajtur parasysh mungesën e ndonjë kufizimi statutor lidhur me kërkesat për rishikim të bëra nga Mbrojtja, kërkesat mund të vazhdojnë të depozitohen edhe pas mbylljes së Tribunalit. Aktualisht, Tribunali po shqyrton mundësinë e gjetjes së një mekanizmi të përshtatshëm vijues, i cili, *ndër të tjera*, do të trajtonte edhe kërkesat që mund të bëhen në këtë drejtim.

XII. Zbatimi i Dënimeve

A. Puna paraprake e Sekretarisë Gjyqësore.....162
A.1 Negocimi i marrëveshjeve për zbatimin e vendimeve me Shtetet.....162
A.2 Hetimi paraprak me shtetet.....164
A.3 Mbledhja e informacionit për caktimin e Shteteve....165
B. Caktimi i Shtetit.....166
B.1 Përshtatshmëria e preferencave të shprehura nga personat e dënuar.....166
B.1.1 Kufijtë gjeografikë për zbatimin e dënimeve të TPNJ-së.....166
B.1.2 A është caktimi i shtetit një çështje që mund të negociohet.....168
B.2 Transferimi i personit të dënuar në shtetin e caktuar.169
B.2.1 Kërkesa për rishikim dhe transferimi i të dënuarit në shtetin e zbatimit të dënimit.....169
C. Mbikëqyrja e zbatimit të dënimit.....170
C.1 Procedura e inspektimit.....170
C.2 Kontakti i personave të dënuar me mediat.....171
D. Falja dhe ulja e dënimit.....171
D.1 Njoftimi nga shtetet.....171
D.2 Përjashtimi nga procedura.....172
D.3 Marrja e vendimit nga Kryetari.....172
D.4 Faktorët përkatës për faljen, uljen e dënimit ose lirimin e parakohshëm.....172
D.4.1 Pesha e krimeve.....173
D.4.2 Demonstrimi i rehabilitimit nga ana e të dënuarit 173
D.4.3 Bashkëpunimi thelbësor me Prokurorinë.....173
D.4.4 Trajtimi i të burgosurve që ndodhen në pozicion të ngjashëm.....173
D.4.5 Pragu vendor i kualifikimit.....174
D.4.6 Reduktimi automatik i vuajtjes së dënimit.....174
D.5 Lirimi dhe transferimi.....175
D.6 Çështje që lindin nga transferimi/deportimi.....176

1. Roli i TPNJ-së në një procedurë penale nuk përfundon me shpalljen e aktgjykimit. Megjithatë, Njësia e Paraburgimit të Tribunalit ishte konceptuar vetëm për të strehuar të akuzuarit, në pritje përpara dhe gjatë gjykimit të tyre në shkallë të parë dhe në apel. Të burgosurit që kanë marrë dënime të gjata duhet ta vuajnë dënimin në sistemin e burgjeve të shteteve të ndryshëm jashtë territorit të ish-Jugosllavisë. Në rast se shpallet fajësia dhe jepet dënimi i burgosjes, zbatimi i këtij vendimi përbën një fazë të re në punën e Tribunalit. Zbatimi i një dënimi përbën një fazë, e cila, shpesh, zgjat më shumë se sa procesi i gjykimit në shkallë të parë, ndaj një gjë e tillë kërkon mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, përgatitje të madhe dhe aftësinë për të reaguar shpejt ndaj vështirësive të papritura.

2. Përvoja e TPNJ-së në zbatimin e vendimeve përbën një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë së saj. Në identifikimin e strategjive më të mira për të trajtuar zbatimin e dënimeve, Tribunali (sikurse ka qenë e vërtetë edhe për shumë aspekte të tjerë të punës së vet), në këtë drejtim ka fare pak precedentë. Në dallim nga shtetet e veçantë, TPNJ-ja nuk ka forcë policore, nuk ka burgje dhe as sistem burgjesh apo kompetenca shtrënguese për të zbatuar dënimet që ajo jep.

3. Sistemi i zbatimit të dënimeve i parashikuar nga projektuesit e Statutit të TPNJ-së ilustrohet në Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, i cili sugjeronte se Këshilli i Sigurimit duhet të bëjë rregullimet e duhura për të pasur nga shtetet një tregues të gatishmërisë së tyre, për të pranuar personat e dënuar, duke ia dërguar më pas këtë informacion Sekretarit të gjykatës, i cili duhet të përgatisë një listë shtetesh, ku do të zbatoheshin edhe dënimet e shpallura.[287] Gjithashtu, Sekretari i Përgjithshëm ka cilësuar se "Shtetet duhet të nxiten të deklarojnë gatishmërinë e tyre, për të realizuar zbatimin e vendimeve të burgosjes, në përputhje me ligjet dhe procedurat e tyre të brendshme, nën mbikëqyrjen e Tribunalit Ndërkombëtar".[288]

287 Raport i Sekretarit të Përgjithshëm në vijim të Paragrafit 2 të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 808 (1993), Dok. K.B. S/25704, 3 maj 1993, para. 122.

288 *Po aty, në* para. 121.

4. Në përputhje me këtë, Neni 27 i Statutit parashikon se “burgosja duhet të vuhet në një shtet të caktuar nga Tribunali Ndërkombëtar, i përzgjedhur nga lista e shteteve që kanë shfaqur përpara Këshillit të Sigurimit gatishmërinë e tyre për të pranuar personat e dënuar.” Në drejtim të identifikimit të burimeve që administrojnë kushtet e vuajtjes së dënimit, Neni 27 më tej pohon se “burgosja duhet të bëhet në përputhje me ligjin e zbatueshëm të Shtetit në fjalë, i cili i nënshtrohet mbikëqyrjes së Tribunalit ndërkombëtar".

5. Kësisoj, ndryshe nga format e tjera të ndihmës, të tilla si dorëzimi, transferimi, nxjerrja para drejtësisë vendase dhe sigurimi i provave, pjesëmarrja në procesin e zbatimit të vendimit të dënimit, për shtetet nuk është detyruese. Gjithashtu, është mjaft kuptimplotë se, ndryshe nga të gjitha fazat e tjera të punës së saj, në fazën e zbatimit të dënimeve, Tribunali i përcakton legjislacionet kombëtare si burime të ligjeve të zbatueshëm.

A. Puna paraprake e Sekretarisë Gjyqësore

A.1 Negocimi i marrëveshjeve për zbatimin e vendimeve me Shtetet

6. Sekretari gjyqësor ka përgjegjësinë të identifikojë shtetet e përshtatshme dhe të marrë kontaktet e nevojshme për të vendosur lidhjet me administratën e tyre për kryerjen e negociatave dhe përfundimin e një marrëveshjeje kuadër ose *ad hoc* për zbatimin e vendimeve të dënimeve. Në periudhën midis viteve 1997 dhe 2008, Tribunali përfundoi marrëveshje kuadër me shtatëmbëdhjetë shtete. Shumë shtete kanë bërë të ditur se ata nuk dëshironin të hynin në një marrëveshje të përgjithshme, por se do të shqyrtonin zbatimin e vendimeve të Tribunalit rast pas rasti. Në përputhje me këtë, Tribunali ka përfunduar marrëveshje të veçanta *ad hoc* edhe me një shtet të veçantë.

7. Për arsye humanitare, marrëveshjet janë negociuar kryesisht me shtetet evropiane. Në përcaktimin e shteteve të mundshëm për zbatimin e vendimeve të dënimit, Tribunali është treguar veçanërisht i kujdesshëm lidhur me distancën gjeografike midis shteteve ku do të vuhet dënimi dhe ish-Jugosllavisë. Distancat e mëdha gjeografike mund të bëhen pengesë për familjarët dhe miqtë e të dënuarve, të cilët do të dëshironin të vizitonin të burgosurit.

8. Për përfundimin e marrëveshjeve lidhur me zbatimin e vendimeve të dënimit, kërkohen të përmbushen edhe disa elementë të tjerë të rëndësishëm. Në pikëpamje të kërkesave ligjore për arritjen e marrëveshjeve në fjalë, shteti zbatues i vendimit duhet të të adoptojë legjislacionin e përshtatshëm, që parashikon zbatimin e Statutit të Tribunalit, duke mbajtur parasysh përshtatjen e metodave të zbatimit të vendimeve të Tribunalit sipas së drejtës së brendshme të tij. Gjithashtu, zbatimi kërkon që kushtet e vuajtjes së dënimit të jenë në përputhje me standardet e së drejtës humanitare ndërkombëtare.[289]

9. Veç kërkesave të mësipërme ligjore e gjeografike, negocimi i marrëveshjeve të zbatimit i nënshtrohet gjithashtu një numri detyrimesh për shtetet, të tilla si kostot e larta të zbatimit të vendimeve për vendet në zhvillim ose më pak të zhvilluara, mbizotërimi i ndjenjave politike/popullore armiqësore ndaj të huajve, mungesës së gatishmërisë së qeverive përkatëse si rrjedhojë e kësaj, për të ndërmarrë veprime që mund të shkaktojnë kundërshtim politik/popullor, mungesës eventuale të dëshirës nga ana e qeverive të këtyre

289 Rregullorja Minimale e Standardeve për Trajtimin e të Burgosurve e miratuar nga rezoluta 663 C (XXIV) e ECOSOC-ut e datës 31 korrik 1957 dhe 2067 (LXII) e 13 majit 1977, Korpusi i Parimeve për Mbrojtjen e të gjithë Personave që gjenden nën çdo lloj forme paraburgimi ose burgimi, adoptuar nga rezoluta 43/173 e Kombeve të Bashkuara, miratuar më 9 dhjetor 1988 dhe Parimet Themelore për Trajtimin e të Burgosurve adoptuar nga rezoluta 45/11 e Kombeve të Bashkuara e 14 dhjetorit 1990.

vendeve, për të pranuar inspektimin e burgjeve të vendeve të tyre nga organizmat e huaj monitorues si dhe mungesës së mjedisit të përshtatshëm socio-kulturor në burgjet e një vendi të caktuar për persona nga ish-Jugosllavia (përfshi këtu edhe mungesën e të burgosurve të tjerë me origjinë të ngjashme sociale, linguistike dhe kulturore).

10. Nën këndvështrimin e këtyre detyrimeve, qasja e përdorur nga Tribunali për negocimin e marrëveshjeve të zbatimit të dënimit duhet të jetë këmbëngulëse dhe krijuese, me qëllimin për të kapërcyer mungesën e mundshme të gatishmërisë së shteteve e në analizë të fundit, të rrisë kapacitetet e veta në drejtim të zbatimit të vendimeve. Me qëllim që kjo mbështetje të sigurohet nga një numër gjithnjë e më i madh vendesh, Tribunali ka ushtruar një trysni të përhershme, përmes bisedimesh të rregullta me shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, për të rritur vetëdijen e tyre rreth nevojave që Tribunali ka në drejtim të zbatimit të vendimeve të dënimeve. Qasjet e drejtpërdrejta të Tribunalit pranë ambasadave në Holandë, me një grafik të dendur takimesh, si edhe bisedimet me Misionet e Përhershme në selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, kanë rezultuar mjaft të frytshme. Organizimi i seminareve nga Presidenca e Bashkimit Evropian në Hagë, lidhur me zbatimin e dënimeve, si edhe përmendja e nevojave që ekzistojnë në këtë drejtim gjatë Seminareve Diplomatike të zhvilluara dy herë në vit nga ana Tribunalit, ka qenë gjithashtu mjaft e dobishme.

11. Në negocimin e marrëveshjeve të zbatimit të vendimeve, është e rëndësishme të garantohet që konfliktet e mundshme që mund të ekzistojnë midis legjislacioneve të vendeve të ndryshëm rreth faljes dhe ndryshimit të dënimeve, nga njëra anë, dhe përparësisë së legjislacionit të Tribunalit, të trajtohen si duhet dhe që në këtë drejtim të zbatohet autoriteti i Presidentit të Tribunalit. Në kushtetutat e një numri shtetesh, e drejta e faljes i njihet Kryetarit të Shtetit. Këto ligje mund të bien ndesh me përparësinë e TPNJ-së dhe autoritetin e kryetarit të TPNJ-së, kur fjala është për të marrë një vendim nëse një falje apo ndryshim vendimi do të ishte ose jo i arsyeshëm në rastin e një të akuzuari të dënuar nga Tribunali. Për të zgjidhur konfliktet e mundshme që mund të lindin, dispozitat e marrëveshjes për zbatimin e vendimeve zakonisht specifikojnë se atje ku ligjet e brendshme lejojnë faljen ose ndryshimin e vendimit të dënimit, por që në një rast konkret, kryetari i TPNJ-së nuk e konsideron këtë gjë si të përshtatshme, personi i dënuar do të rikthehet në Tribunal ose ky i fundit duhet të caktojë një shtet tjetër për zbatimin e mëtejshëm të vendimit të dënimit. Duket se kjo praktikë përbën zgjidhjen më të mirë ndaj konflikteve të mundshëm, që mund të lindin midis legjislacionit të brendshëm të vendeve të veçanta dhe Statutit të Tribunalit, pa qenë e nevojshme që shtetet të hyjnë në debate të gjata parlamentare ose politike të brendshme për rishikimin e legjislacionit të tyre të brendshëm.

12. Nën dritën e dispozitave përkatëse të kodeve të Procedurës Penale përkatëse që ata kanë, një numër shtetesh, të cilët bëjnë pjesë në grupin e vendeve që kanë pranuar zbatimin e vendimeve të dënimit të Tribunalit e kanë kufizuar afatin e dënimit që mund të vuhet në burgjet e tyre. Për shembull, disa shtete, ligjërisht, nuk lejohen të zbatojnë vendime që janë mbi 15, 20 ose 30 vjet. Me qëllim që konflikte të kësaj natyre, midis legjislacionit të brendshëm dhe përparësisë së vendimeve të marra nga Tribunali, të zgjidhen, ky i fundit ka sugjeruar që, në marrëveshjen e zbatimit, të përfshihet një dispozite e veçantë, ku autoriteteve shtetërore të një vendi të veçantë mund t'i lejohet të zbatojnë vetëm një pjesë të caktuar të vendimeve të shpallura nga Tribunali. Neni 3 i Model-Marrëveshjes për zbatimin e vendimeve, për pasojë, është modifikuar në një numër rastesh, për të bërë të mundur që, në rast se dënimi i dhënë nga Tribunali tejkalon dënimin maksimal të parashikuar nga ligji i brendshëm, në shtetin në fjalë të zbatohet vetëm ajo pjesë e vendimit të Tribunalit që përkon me dënimin maksimal të parashikuar nga legjislacioni i brendshëm i shtetit përkatës. Pas kësaj, i dënuari rikthehet sërish në ruajtjen e Tribunalit ose dërgohet menjëherë në ndonjë shtet tjetër, të caktuar nga Kryetari, për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit.

A.2 Hetimi paraprak me shtetet

13. Sekretari i Tribunalit ka për detyrë të bëjë transferimin e shpejtë të personave të dënuar në shtetet që do të zbatojnë dënimin. Tribunali ka pranuar se personi i akuzuar, në pritje të gjykimit dhe që gjendet në paraburgim gëzon të drejtën themelore për të qëndruar i veçuarprej personave të gjendur fajtor dhe të dënuar, të cilët vuajnë dënimin me burg.[290] Meqenëse Tribunali disponon strukturën e paraburgimit dhe jo atë të burgimit, është shumë e rëndësishme që personat që janë shpallur fajtor dhe që janë dënuar, të transferohen sa më shpejt të jetë e mundur pas shpalljes së vendimit të dënimit. Sidoqoftë, procesi është diplomatik dhe në pjesën më të madhe të rasteve, ai merr të paktën disa muaj për të përfunduar. Në rastet kur legjislacioni i shtetit zbatues kërkon kryerjen e procedurës *exequatur* përpara zbatimit të dënimit, Tribunalit mund t'i duhet të presë më shumë se një vit përpara se të marrë një përgjigje përfundimtare dhe në këto raste, përkthimi i aktgjykimit të Tribunalit në gjuhën e vendit ku do të zbatohet vendimi, është i domosdoshëm.[291] Në disa raste, njerëz të akuzuar dhe të dënuar vetëm me pak vjet heqje lirie janë liruar nga njësia e paraburgosje, pasi ka rezultuar që vendimi i dënimit të tyre është plotësuar thjesht me kohën e kaluar në pritje të aktgjykimeve në apel ose fare pak kohë pas kësaj. Për të zgjidhur vonesat që mund të ndeshen në transferimin e personave të dënuar nga NJPKB, kësaj i është dashur të zbatojë, për aq sa një gjë e tillë është e mundur në një qendër të tillë rikthimi, një regjim rezidencial të veçantë. Duke vepruar kështu, është me rëndësi vendimtare të mbahet parasysh efekti i mundshëm dëmtues i ndarjes së plotë të personave të dënuar brenda NJPKB-së. Duke mbajtur parasysh numrin e vogël të personave që janë shpallur fajtorë që mbahen në TPNJ, zbatimi i një regjimi veçues i plotë, mund të shpinte në situatë të izolimit të detyruar, gjë që mund të kishte pasoja të dëmshme për gjendjen mendore të të dënuarit.

14. Kostot që lidhen me përkthimin e aktgjykimeve të Tribunalit në gjuhën e vendit që do të zbatojë vendimin, për qëllimin e nisjes së procedurës *exequatur,* në parim, mbulohen nga Shteti në fjalë. Kjo kosto, në varësi të volumit të aktgjykimit, mund të jetë tepër e madhe. Kohët e fundit Tribunali pranoi kërkesën e një shteti për të mbuluar kostot e përkthimit të dokumenteve mbështetës për procedurën *exequatur* . Megjithatë, angazhimi i Tribunalit për të mbuluar këto kosto është në varësi të gatishmërisë së shtetit për të bërë vlerësimin e kostove si edhe të gatishmërisë që ai tregon që puna të kryhet nga një përkthyes i certifikuar. Kjo zgjidhje duket se është në interesin më të mirë Tribunalit, pasi ka rezultuar se përfundimi i marrëveshjes mbi zbatimin e vendimit është penguar si rrjedhojë e kërkesave të përkthimit. Kjo praktikë pritet të të reduktojë në mënyrë të konsiderueshme vonesën për dhënien e përgjigjeve ndaj kërkesave të Tribunalit për zbatim vendimesh, kur kërkohet njohja e aktgjykimeve të Tribunalit dhe përkthimi i tyre në gjuhën e shtetit që do të zbatojë vendimin.

15. Lidhur me çdo person që është gjendur fajtor dhe që ka marrë vendimin e dënimit, Sekretari i Tribunalit duhet, pikësëpari, të identifikojë shtetin e përshtatshëm për vuajtjen e dënimit. Pasi Sekretari ta ketë bërë një gjë të tillë, ai i dërgon një kërkesë paraprake shtetit në fjalë. Ndonëse marrëveshjet për zbatimin e dënimeve parashikojnë që kërkesa të bëhet pas shpalljes së vendimit përfundimtar, praktika ka treguar se Sekretari duhet të bëjë një kërkesë paraprake përpara shpalljes së fajësisë dhe dënimit të të akuzuarit në fjalë nga Dhoma gjyqësore e shkallës së parë. Kjo qasje paraprake është imponuar qoftë si rrjedhojë e

290 Shih Urdhëin e Sekretarit për mbajtjen të veçuar personat e dënuar nga ata që nuk janë dënuar ende, në Njësinë e Paraburgimit, IT-06-89-Të ndryshme. 1, 15 qershor 2006.

291 Përgjithësisht, qasja e përdorur për zbatimin e aktgjykimeve të Tribunalit është e ndryshme prej asaj që zbatohet në pjesën më të madhe të vendeve gjatë zbatimit të dënimeve të huaja dhe aktgjykimeve të Tribunalit dhe nuk kërkon ndonjë transformim apo konvertim për t'u zbatuar nga Shtetet. Një numër shtetesh me të cilët TPNJ-ja ka nënshkruar marrëveshje zbatimi, kërkojnë, gjithsesi, ndërmarrjen e veprimeve për nxjerrjen e një procedure *exequatur* ose një të një procedure gjyqësore nga ana e një gjykate të brendshme, ku formalisht të pranohet që vendimi i dhënë nga Tribunali duhet të zbatohet në këtë shtet.

vonesave të shteteve në dhënien e përgjigjeve ashtu edhe nga përpjekja për të reduktuar sa më shumë të jetë e mundur kohën që një person i dënuar duhet të kalojë në Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara (NJPKB). Ndërkohë që kjo qasje ka reduktuar së tepërmi kohën e qëndrimit të të paraburgosurve në NJPKB, në pritje të transferimit e që për pasojë duket se është edhe praktika më e mirë, efikasiteti i saj mund të vihet në dyshim në disa rrethana të caktuara të veçanta. Në situata kur njohja e aktgjykimeve të tribunalit kërkohet përpara zbatimit të dënimit, kontaktimi i shteteve vetëm pak përpara se të shpallet vendimi përfundimtar për t'u zbatuar në shtetin zbatues, nuk le vend për kohë të mjaftueshme.

16. Sikurse kemi nënvizuar më sipër, shteti, të cilit i është bërë kërkesë mund të jetë ose një prej shteteve që janë treguar të gatshëm për të pranuar persona të dënuar sipas Nenit 27 të Statutit, dhe për këtë qëllim kanë nënshkruar një marrëveshje me Tribunalin ose një shtet i përcaktuar *ad hoc* nga Tribunali, pas kontakteve shtete të ndryshme për zbatimin e vendimeve të dënimeve. Me synimin për të identifikuar shtetet e mundshme, ku mund të zbatohet vendimi i dënimit, Sekretari duhet të jetë gjithnjë i mirinformuar si lidhur me kërkesat e ligjit të brendshëm të shteteve të caktuar ashtu edhe me kufizimet në fushën politike që shtetet e ndryshme shprehin lidhur me:

- kohëzgjatjen maksimale të dënimittë zbatueshëm në këtë vend;
- numrin maksimal të dënimeve që mund të zbatohen;
- kohëzgjatjen minimale të dënimit që mund të zbatohet;
- rëndësinë e një mjedisi të përshtatshëm në pikëpamje shoqërore dhe kulturore për të dënuarit dhe krijimin e mundësisë, në pikëpamje gjeografike, që ata të mund të vizitohen nga familjarët e tyre.

17. Sekretari përpiqet gjithashtu të sigurojë një ndarje të ekuilibruar të peshës, mes shteteve që zbatojnë vendimet e dënimit, si në pikëpamje të numrit të personave të dënuar të transferuar ashtu edhe në pikëpamje të afateve të dënimeve, që ka secili prej të dënuarve.

18. Për të bërë të mundur që personat e dënuar të transferohen pa vonesë pas shpalljes së dënimit përfundimtar, Sekretari u kërkon shteteve në fjalë të japin një indikacion paraprak lidhur me gatishmërinë e tyre për të zbatuar dënimin e personit të shpallur fajtor. Në përputhje me përgjigjet që shtetet japin, Sekretari u dërgon atyre një kopje të certifikuar të aktgjykimit, një deklaratë ku cilësohet se ç'pjesë e dënimit tashmë është vuajtur, përfshi këtu edhe informacionin që lidhet me periudhën e paraburgosje dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm që mund të kërkohet nga shteti (p.sh., vlerësimin shoqëror, informacionin rreth sjelljes së të dënuarit në kushtet e paraburgimit, vlerësimin e kërcënimit dhe rrezikut si dhe informacionin rreth statusit mjekësor/psikologjik).

19. Ndërkohë që teorikisht, Rregullorja i jep mundësi Sekretarit të kontaktojë shumë shtete në kërkim të zbatimit të një dënimi, në praktikë, Sekretari përgjithësisht identifikon një shtet të vetëm për çdo rast të dhënë. Kjo praktikë është ndjekur për të shmangur shqetësimin e mundshëm që mund të krijohet në rast se numri i shteteve që reagojnë pozitivisht ndaj një kërkese të tillë do të ishte më shumë se një dhe atëherë Tribunalit do t'i duhej të refuzonte ofertat e ndryshme.

A.3 Mbledhja e informacionit për caktimin e Shteteve

20. Pas marrjes së një përgjigjeje pozitive nga ana e Shtetit që eventualisht merr përsipër zbatimin e vendimit të dënimit, Sekretari i Tribunalit përgatit një memorandum konfidencial për Kryetarin e Tribunalit, ku ai e ve atë në dijeni për gatishmërinë e shtetit në fjalë për zbatimin e dënimit. Memorandumi përfshin një përmbledhje të historikut të çështjes në fjalë, fajësinë dhe vendimin e dënimit, një listë të përditësuar të të gjitha shteteve që kanë zbatuar dënime të Tribunalit ose që janë në zbatim e sipër të tyre, si edhe informacionin mbështetës lidhur me familjen e të dënuarit, shëndetin dhe sjelljen e tij gjatë kohës që ai ka qenë në NJPKB.

Gjithashtu Sekretari i paraqet atij edhe një hetim të Zyrës së Prokurorit lidhur me faktin nëse i dënuari pritet të dëshmojë para Tribunalit si dëshmitar në të ardhmen edhe në çështje të tjera.

B. Caktimi i Shtetit

21. Kuadri i parashikuar nga Neni 27 i Statutit plotësohet nga Rregulla 103, e cila i jep Kryetarit autoritetin për të caktuar një shtet nga lista e shteteve që kanë shfaqur gatishmërinë e tyre për të pranuar personat e dënuar. Vendimi i Kryetarit në përzgjedhjen dhe caktimin e një Shteti lidhur me këtë aspekt, udhëhiqet nga Udhëzimi Praktik i Procedurave për Caktimin nga Tribunali të Shtetit ku i Dënuari do të Vuajë Vendimin e Dënimit("Udhëzimi Praktik për Caktimin"), të cilin Kryetari e ka aprovuar më 9 korrik 1998, me synimin për të përcaktuar procedurën e brendshme në këtë fazë.[292] Udhëzimi Praktik për Caktimin parashikon se Kryetari e kryen caktimin e shtetit në fjalë pas këshillimit me Sekretarin për shtetet që tashmë janë treguar të gatshme për zbatimin e vendimit të dënimit për një person nën akuzë.[293] Udhëzimi gjithashtu urdhëron se, në ushtrimin e të drejtës së tij, Kryetari duhet të mbajë parasysh afërsinë gjeografike të familjarëve të personave të dënuar dhe se në këtë drejtim ai ka të drejtë të pyesë edhe personin e dënuar ose Prokurorinë, në rast se dëshiron një gjë të tillë. [294]

B.1 Përshtatshmëria e preferencave të shprehura nga personat e dënuar

22. Jurisprudenca e Tribunalit ka qartësuar se, sipas Statutit, Rregullores dhe Udhëzimit Praktik për Caktimin, personi i dënuar nuk gëzon të drejtën që mendimi i tij të dëgjohet në lidhje shtetin në të cilin do të vuajë dënimin e dhënë. Kërkesat e disa të dënuarve, kur ata kërkojnë të transferohen në shtete të tjera, të ndryshëm nga shteti i përzgjedhur, për rrjedhojë, janë hedhur poshtë me argumentimin se i dënuari nuk ka të drejtë t'i dërgojë peticion të drejtpërdrejtë për këtë çështje Kryetarit.[295] Megjithatë, Kryetari gëzon të drejtën të vendosë vetë lidhur me qëndrimin që duhet mbajtur në secilin prej rasteve. [296]

B.1.1 Kufijtë gjeografikë për zbatimin e dënimeve të TPNJ-së

23. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm përfundon duke cilësuar faktin se, zbatimi i vendimeve të dënimit të dhëna nga TPNJ-ja duhet të bëhet jashtë territorit të ish-Jugosllavisë.[297] Megjithatë, ka argumente se ky Raport duhet të interpretohet nën dritën e situatës politike në ish-Jugosllavi gjatë kohës që u hartua në vitin 1993. Në atë kohë, konflikti i armatosur në rajon ishte në zhvillim e sipër. Zbatimi i dënimeve në ish-Jugosllavi gjatë konfliktit të armatosur dhe paqëndrueshmëria politike do të kishin rrezikuar në mënyrë të palejueshme jetët e personave të shpallur fajtorë. Për më tepër, ekzistonin dyshime të forta nëse regjimi i brendshëm i burgjeve ishte funksional dhe ishte e paqartë nëse TPNJ-ja mund të garantonte mbikëqyrjen gjyqësore të kushteve të burgimit, duke rritur kësisoj rrezikun e ndërhyrjeve lidhur me zbatimin e dënimeve.

24. Sidoqoftë, me kalimin e kohës, mund të diskutohet se ndryshimi i gjendjes në ish-Jugosllavi mund të lejojë zbatimin e dënimeve në shtetet e këtij rajoni, veçanërisht nën dritën e adoptimit të Rregullës 11*bis* në vitin

292 Udhëzim Praktik lidhur me Procedurën e Caktimit të Shtetit nga Tribunali Ndërkombëtar, ku Personi i Dënuar do të Vuajë Dënimin me Burg, IT/137, 9 korrik 1998 ("Udhëzim Praktik lidhur me Procedurën e Caktimit").
293 Udhëzim Praktik lidhur me Procedurën e Caktimit, para. 3.
294 *Po aty* para. 4.
295 *Prokurori kundër Žigić*, Lënda Nr. IT-98-30/1-ES, Vendim mbi Kërkesën e Zoran Žigić, 31 maj 2006.
296 Udhëzim Praktik lidhur me Procedurën e Caktimit, para. 4.
297 Raport i Sekretarit të Përgjithshëm në Vijim të Paragrafit 2 të Rezolutës 808 (1993) të Këshillit të Sigurimit, Dok. K.B. S/25704, 3 maj 1993, para. 121.

2002. Sipas kësaj Rregulle, një çështje mund t'i dërgohet shtetit, në territorin e të cilit krimi është kryer, "duke bërë të mundur që autoritetet e këtij vendi ta kalojnë menjëherë këtë çështje për gjykim brenda shtetit në fjalë." Kur një çështje dërgohet sipas kësaj mënyre, ajo do të dëgjohet dhe gjykohet sipas ligjeve në fuqi të shtetit përkatës dhe vendimi i dhënë nga një gjykatë e këtij vendi do të zbatohet brenda territorit të tij. Ky mekanizëm është mbështetur në mënyrë të nënkuptueshme nga Këshilli i Sigurimit me anë të Rezolutës 1534 (2004).[298] Mendimi i ndryshëm i një Gjykatësi, bashkëngjitur me vendimin e dhënë në çështjen *Strugar* konsideronte se, "nëse është e mundur që një çështje e tërë mund të dërgohet në territorin e ish-Jugosllavisë, mund të arrihet në përfundimin, *a maiore ad minus*, se shtetet në territorin e ish-Jugosllavisë tani mund të jenë të besueshme në drejtim të zbatimit të dënimeve të dhëna. "[299]

25. Nga ana tjetër, Rregulla 11*bis* parashikon se, vetëm çështjet që kanë të bëjnë me të akuzuar të rangjeve të mesme dhe të ulëta mund të transferohen në juridiksionet kombëtare kompetente dhe se zbatimi i dënimeve ndaj udhëheqësve më të lartë duhet të vazhdojë të kryhet jo në shtetet e ish-Jugosllavisë. Një gjë e tillë nënkuptohet edhe në Rezolutën 1534 të Këshillit të Sigurimit (2004) e cila e inkurajon TPNJ-në "të vazhdojë dhe të intensifikojë përpjekjet e saj për të përfunduar marrëveshje të tjera për zbatimin e vendimeve të dënimit ose të realizojë bashkëpunimin me shtetet e tjerë në këtë fushë".

26. Për më tepër, praktika e Tribunalit i ka dhënë një peshë të konsiderueshme Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm. Ndonëse afirmohet se Raporti nuk ka të njëjtin autoritet detyrues sikundër ka Statuti, praktika gjyqësore e Tribunalit ka sugjeruar se:

> *Duke "aprovuar" Raportin, Këshilli i Sigurimit ka treguar qartë se ka dashur të miratojë qëllimin e tij si një dokument shpjegues lidhur me Statutin e propozuar. Natyrisht, në rast se midis Raportit dhe Statutit mund të lindë një kontradiktë, nuk ka dyshim se përparësi ka Statuti. Në raste të tjera, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm duhet të konsiderohet si bazë e fortë për interpretimin e Statutit.*[300]

27. Në përputhje me këtë, Tribunali ka pranuar pikëpamjet e shprehura në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, sipas të cilit, dënimet e dhëna nga Tribunali mund të zbatohen vetëm jashtë territorit të ish-Jugosllavisë. Në çështjen *Strugar*, Dhoma e Apelit shprehej se nuk ekzistonte mundësi ligjore që dënimet e dhëna nga Tribunali të zbatoheshin në vendet e ish-Jugosllavisë. [301]

---

298 Në Rezolutën 1534 (2004) të Këshillit të Sigurimit, në pjesën thelbësore të saj, thuhet se, Këshilli I Sigurimit: "mirëpret veçanërisht përpjekjet e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë, TPNJ-së dhe komunitetit të donatorëve për krijimin e një Gjykate për Krimet e Luftës në Sarajevë; nxit të gjitha palët për të vazhduar përpjekjet për ngritjen e shpejtë të kësaj gjykate; dhe nxit komunitetin e donatorëve të sigurojë mbështetje të mjaftueshme financiare për të garantuar suksesin e hetimeve dhe gjykimeve në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në rajon".

299 *Vendim lidhur me çështjen Strugar*, Opinion i ndryshëm i Gjykatësit Shomburg, para. 27.

300 *Prokurori kundër Tadić*, Lënda Nr. 11-94-1-A, Aktgjykim i Apelit, 15 korrik 1999, para. 295.

301 Shih për këtë pozicion, Vendimi *Strugar*, Opinioni i ndryshëm i Gjykatësit Shahabuddeen, para. 11.

B.1.2 A është caktimi i shtetit një çështje që mund të negociohet

28. Përvoja e grumbulluar në çështjen *Strugar* nxjerr në pah natyrën problematike të përfundimit të një marrëveshjeje, ku i akuzuari i i dënuar cakton shtetin ku të zbatohet dënimi i tij. Në adoptimin e praktikës për të mos lejuar negocimin me të dënuarin lidhur me caktimin e vendit ku ai mund të vuajë dënimin, Tribunali has në dy lloj vështirësish.

29. Së pari, aktorët e Tribunalit që mund të bien në ujdi me të akuzuarin e dënuar lidhur me caktimin e vendit të vuajtjes së dënimit, kanë interesa të ndryshme nga ato të Kryetarit të TPNJ-së, i cili gëzon kompetencën për të përzgjedhur dhe caktuar shtetin ku duhet të vuhet dënimi. Për shembull, Prokurori mund të dëshirojë të nxisë të akuzuarin të bëjë një marrëveshje për pranim të fajësisë, duke i ofruar atij, në perspektivë, vuajtjen e dënimit në një shtet të caktuar të zgjedhur prej tij. Po kështu, gjykatësi i Para-apelit mund të jetë i prirë drejt sugjerimit të mundësisë së plotësimit të preferencave të të akuzuarit lidhur me shtetin e vuajtjes së dënimit, me synimin për të marrë prej të

Lënda Strugar – Kufizimet e preferencave të shprehura

*Më 31 Janar 2005, Dhoma Gjyqësore II dha vendimin e dënimit me tetë vjet burg për Pavle Strugar, i cili u shpall fajtor për shkeljen e Ligjeve dhe Zakoneve të Luftës sipas Nenit 3 të Statutit. Të dy palët fillimisht apeluan. Megjithatë, pas negociatave të gjata, palët i tërhoqën apelimet e tyre dhe Dhoma e Apelit i pranoi këto tërheqje. Çështja kryesore e trajtuar gjatë negociatave që paraprinë tërheqjet kishte të bënte me mundësinë që i akuzuari ta vuante dënimin e tij në Republikën e Malit të Zi, prej ku ai ishte. Sipas fjalëve të Dhomës së Apelit, Mundësia që ai të vuante dënimin e tij në Mal të Zi, fillimisht, ishte ngritur nga Gjykatësi i Para-apelit; ai kishte marrë sigurinë nga gjykatësi i Para-apelit qysh prej një periudhe prej disa muajsh se një gjë e tillë mund të bëhej (pavarësisht se ato kishin qenë garanci të një karakteri të luhatshëm); në konferencën përfundimtare të status-it ai dëgjoi opinionin personal të Gjykatësit të Para-apelit (një opinion i dhënë me vërejtjen se një gjë e tillë nuk ishte fort e sigurt), se ligjërisht nuk ekzistonte ndonjë pengesë e përgjithshme që ai ta vuante dënimin e tij në Mal të Zi.**

*Gjatë procesit në para-apel, Republika e Malit të Zi shprehu gatishmërinë që të bashkëpunonte me Tribunalin për t'i dhënë mundësinë Strugar-it të vuante dënimin në Mal të Zi. Nga ana e saj, Sekretaria e Tribunalit ua bëri të qartë palëve se "zbatimi i një dënimi në Mal të Zi, aktualisht do t'i nënshtrohej një numri të rëndësishëm pengesash ligjore e të tjera, të cilat duhet të tejkalohen ".***

*Sidoqoftë, disa muaj më vonë, Sekretaria Gjyqësore e njoftonte Strugar-in se Tribunali, në këtë kohë, nuk ndodhej në pozicionin që të mund të përfundonte një marrëveshje për zbatim dënimi brenda territorit të Malit të Zi. Në mënyrë të veçantë, Sekretaria Gjyqësore deklaronte se ajo kishte "verifikuar me Zyrën e Çështjeve Ligjore në Selinë e OKB se rezoluta 827 e Këshillit të Sigurimit, e cila pranonte raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, S/25704, ku cilësohej se 'zbatimi I vendimeve të dënimeve duhej të bëhej jashtë territorit të ish-Jugosllavisë', vendoste një kufizim gjeografik"****

*Sipas këndvështrimit të Strugar-it, shpjegimi i dhënë nga Sekretaria Gjyqësore tregonte se faktikisht ekzistonte një pengesë ligjore e qartë për të që ai të kishte mundësinë ta vuante dënimin e tij në Mal të Zi — e pikërisht, Rezolutën 827 të Këshillit të Sigurimit (sipas interpretimit të Zyrës për Çështjet Ligjore në selinë e OKB-së). Nisur nga fakti që ai nuk e kishte njohur këtë pengesë ligjore në kohën që ai tërhoqi apelimin e tij, ai besonte se tërheqja e tij nuk ishte bërë në kushtet e informimit.*****

*Dhoma e Apelit konstatoi se miratimi I dhënë nga Strugar-i për tërheqjen e apelit të tij nuk ishte bërë në kushtet e informimit, ndaj e rishqyrtoi Vendimin që pranonte Tërheqjen e Apelit, pikërisht mbi këtë bazë dhe e rrëzoi atë, duke i dhënë, kësisoj, Strugar-it të drejtën të rihapte procedurën e apelit "me qëllim që të shmangte një dështim të drejtësisë".****** Dhoma e Apelit pranoi se Strugar-i ishte në dijeni se ai mund të mos lejohej ta vuante dënimin e tij në Mal të Zi si edhe rreth faktit se tërheqja e bënte apelin e tij përfundimtar. Megjithatë, ajo vinte në dukje gjithashtu se Strugar-i nuk e dinte se "nuk ekzistonte mundësi ligjore" që ta vuante dënimin e tij në Mal të Zi.*

_____

* Prokurori kundër Pavle Strugar, Lënda Nr. IT-01-42-Të ndryshme 1, Vendim lidhur me Kërkesën e Strugar për të rihapur procedurën në apel, 7 qershor 2007 ("Vendimi Strugar"), para. 28.
** Vendimi Strugar, para. 9-10.
*** Vendimi Strugar, para. 15.
**** Vendimi Strugar, para. 16.
***** Vendimi Strugar, para. 29.

akuzuarit miratimin e tij, për të përfunduar procesin gjyqësor. Sidoqoftë, fjala përfundimtare në këtë drejtim i përket Kryetarit të Tribunalit dhe ushtrimi i të drejtës së tij ose të saj do të udhëhiqet pashmangshmërisht nga faktorë të ndryshëm prej atyre mbi të cilët mbështetet parapëlqimi i të akuzuarve të shpallur fajtorë e të dënuar. Në përcaktimin e shtetit ku mund të zbatohet dënimi, Kryetari mund të mbajë parasysh, kryesisht, afërsinë e vendndodhjes së të afërmeve të personit të dënuar. Megjithatë, në këtë drejtim, ka edhe faktorë të tjerë që ndikojnë, siç mund të jenë shpresa që personi i dënuar mund të shërbejë si dëshmitar në proceset e mëtejshme gjyqësore në Tribunal, fakti nëse personi do të paraqitet përsëri si dëshmitar në vijim të çështjes gjyqësore si edhe ekzistenca e çdo lloj raporti tjetër mjekësor ose psikologjik, mundësitë gjuhësore, kushtet e përgjithshme të vuajtjes së dënimit dhe rregullat që administrojnë sigurinë dhe lirinë në shtetin në fjalë. Në këtë mënyrë, ata që janë në pozicionin për të ndërmarrë realizmin e një marrëveshjeje me të akuzuarin nuk kanë kompetencë të garantojnë zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

30. Së dyti, koha në dispozicion për caktimin e Shtetit ku do të vuhet dënimi është aq e shkurtër sa që nuk arrin të përputhet me mundësinë që marrëveshja me të akuzuarin të mund të arrihet. Sikurse është thënë më sipër, Tribunali duhet të njoftojë shtetin e caktuar lidhur me dënimin përfundimtar (d.m.th. të parevokueshëm) përpara se Shteti në fjalë të mund të deklarojë disponueshmërinë e tij përfundimtare për zbatimin e vendimit. Megjithatë, çdo marrëveshje e mundshme me të akuzuarin rreth caktimit të shtetit zbatues të dënimit duhet bërë për sa kohë që procedurat janë ende të hapura. Kështu, çdo lloj premtimi që mund t'i bëhet të akuzuarit lidhur me caktimin e shtetit ku do të vuhet dënimi është diçka e pathemeltë, pasi hapat përfundimtarë të procedurës së përzgjedhjes dhe caktimit të shtetit përkatës nuk janë marrë ende përfundimisht (shih kutinë "*Lënda Strugar - Kufizimet e preferencave të shprehura*")

B.2 Transferimi i personit të dënuar në shtetin e caktuar

31. Pjesa përfundimtare e Rregullës 103, parashikon që transferimi i personit të dënuar në shtetin ku do të kryhet vuajtja e dënimit, duhet të realizohet sa më shpejt që është e mundur pas përfundimit të kohës së caktuar për apelimin e çështjes dhe gjatë kohës që personi i shpallur fajtor dhe i dënuar do të qëndrojë i paraburgosur pranë Tribunalit, në pritje të përfundimit të marrëveshjes dhe teknikaliteteve që kanë lidhje me transferimin drejt shtetit të caktuar. Pas nxjerrjes së Urdhrit të Kryetarit, ku cilësohet se vuajtja e dënimit nga ana e personit të dënuar do të kryhet në X shtet, Sekretari i Gjykatës duhet të kujdeset për ecurinë e krejt elementëve praktikë (p.sh. transferimin e të dhënave të paraburgimit dhe ato shëndetësore të të dënuarit, përpilimin e të dhënave që kanë të bëjnë me rrezikshmërinë e personit në fjalë), përfshi këtu edhe lidhjen me autoritetet e vendit përkatës ku do të vuhet dënimi si edhe me autoritetet holandeze.

32. Për të garantuar sigurinë e personit të dënuar dhe atë oficerëve shoqërues gjatë transferimit si edhe për të parandaluar ndonjë ndërhyrje që ka të bëjë me çështjet e sigurisë dhe operacionet e transferimit drejt shtetit që do të zbatojë vendimin, Tribunali nuk bën asnjë njoftim publik deri sa transferimi të kryhet plotësisht me sukses. Kjo është praktika e Tribunalit. Gjithashtu, ndonëse vendndodhja e shtetit ku do të zbatohet vendimi i bëhet e njohur për publikun, Tribunali nuk e shpalos vendin e saktë ku do të vuhet dënimi.

B.2.1 Kërkesa për rishikim dhe transferimi i të dënuarit në shtetin e zbatimit të dënimit

33. Kryetari i Tribunalit ka konfirmuar, në raste të ndryshme, se Kërkesa për rishikim të një çështjeje që është në pritje përpara Tribunalit nuk pezullon dhe as shtyn në një afat tjetër transferimin e personit të dënuar në shtetin e caktuar për zbatimin e vendimit.[302] Disa avokatë mbrojtës kanë ngritur pretendimin se, në pritje të

302 Shih, *p.sh.*, *Prokurori kundër Josipović*, Lënda Nr. IT-095-16-ES, Vendim mbi Kërkesën e avokatit mbrojtës të Drago Josipović sipas së cilës vuajtja e dënimit nga ana e të Dënuarit duhet të ndërpritet, si rrjedhojë e fillimit të afatit të burgosjes së tij, 10 prill 2002 ("*Josipović* Vendim"), f. 2.

një kërkese për rishikim, prania e personit të dënuar në territorin e Holandës, është e domosdoshme për të lehtësuar komunikimin midis avokatit mbrojtës dhe personit të dënuar. Sidoqoftë, Kryetari e ka bërë të qartë se Rregulla 118(A) sanksionon se një vendim dënimi i shpallur nga Dhoma e Apelit duhet të zbatohet *menjëherë* dhe se kërkesa për rishikim nuk ushtron ndikim mbi këtë dispozitë urdhëruese.[303] Për më tepër, nëse zbatimi i vendimit pezullohet kur një kërkesë për rishikim është në pritje, mocionet për rishikim mund të keqpërdoren lehtësisht për të shtyrë transferimin e të dënuarit në shtetin e caktuar. Tribunali nuk disponon mjete të mjaftueshme për të mbajtur veç nga të paraburgosurit një person i cili është shpallur fajtor dhe është dënuar, ndërkohë që mbajtja bashkë e të dy kategorive do të çonte në shkeljen e të drejtave të personave që nuk janë dënuar ende, në rast se ata do të mbaheshin bashkë me personat tashmë të dënuar.

C. Mbikëqyrja e zbatimit të dënimit

C.1 Procedura e inspektimit

34. Kur një i dënuar në TPNJ është transferuar, në vuajtjen e dënimit prej tij, zbatohet ligji i brendshëm i shtetit përkatës, sikurse parashikohet edhe në marrëveshjet e zbatimit të dënimit, por zbatimi i vendimit të dënimit i nënshtrohet mbikëqyrjes nga ana e Kryetarit të Tribunalit. Rregulla 104 sanksionon se "të gjitha vendimet e dënimit me burgim duhet të mbikëqyren nga Tribunali ose nga organizmi i caktuar prej tij".

35. Në pjesën më të madhe të shteteve zbatues të vendimeve, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) kryen inspektimin e kushteve të vendeve të kryerjes së vuajtjes së dënimit. Për Portugalinë, Ukrainën dhe Mbretërinë e Bashkuar, inspektimet kryhen nga Komiteti Evropian për Ndalimin e Torturës (KNT). Për Spanjën dhe Gjermaninë, kushtet e burgjeve inspektohen nga një Komision i Përbashkët Paritetit, i përbërë nga pjesëtarë të TPNJ-së dhe zyrtarë të shtetit në fjalë. Nisur nga fakti që disa shtete kanë ngritur kundërshtime ndaj inspektimeve të KNKK-së dhe kanë cilësuar se ata do të parapëlqenin një variant tjetër lidhur me kryerjen e inspektimeve, Tribunali ka bërë me KNT-në një marrëveshje tjetër, me synimin për të rritur elasticitetin në bërjen e marrëveshjeve për zbatimin e dënimit me shtetet evropiane. Kjo alternativë e ka ndihmuar Tribunalin të arrijë të paktën tri marrëveshje për zbatim dënimi.

36. KNKK-ja ia paraqet konstatimet e saj drejtpërdrejt kryetarit, i cili, normalisht, kërkon që Sekretari të ndjekë në bashkëpunim me autoritetet vendase çdo rekomandim apo shqetësim që ngrihet nga parashtrimet KNKK-së, e më pas të bëjë raportimet përkatëse. Gjithashtu, Sekretarit i kërkohet të trajtojë *ad hoc* letrat dhe kërkesat e bëra nga personat e dënuar, nga familjet e tyre apo autoritetet kombëtare përkatëse, rast pas rasti. Këto letra dhe kërkesa mund të kenë të bëjnë me çështje të tilla si kushtet e vuajtjes së dënimit, kërkesat për informim si dhe kërkesat për ndihmë ligjore.

37. Ndërsa Tribunali ka ngritur Komisione të Përbashkëta të Paritetit për monitorimin e kushteve në dy shtete zbatuese të vendimeve të dënimeve, rrugët për një monitorim të pavarur të këtyre komisioneve janë larg të qenit ideale. Ka pasur raste kur një i akuzuar i dënuar, i ka drejtuar një peticion të drejtpërdrejtë Kryetarit të Tribunalit, me anë të të cilit, ai ankohej rreth kushteve të vuajtjes së dënimit si dhe rreth nëpunësve të Tribunalit. Në këto rrethana, personat që akuzoheshin se kishin shkelur të drejtat e personit të dënuar, ishin po ata njerëz që ishin të ngarkuar me përgjegjësinë për të garantuar mbrojtjen e të drejtave në fjalë. Në një rast të tillë, Kryetari ka kërkuar që i akuzuari i dënuar të kishte mundësinë të kontaktonte një organizëm monitorues të pavarur, të tillë si KNKK-ja, të hetonte rreth pretendimeve të ngritura. Përcaktimi i

303 *Josipović* Vendim, f. 2.

procedurave për monitorimin e pavarur të kushteve të burgjeve nga një organizëm i jashtëm përbën një mjet të rëndësishëm për garantimin e besueshmërisë institucionale dhe besimit të publikut.

C.2 Kontakti i personave të dënuar me mediat

38. Ndonëse kushtet e vuajtjes së dënimit përcaktohen nga ligji i zbatueshëm i shtetit që zbaton vendimin e dënimit, dhe në parim, shtetet që zbatojnë vendimin kanë të drejtë të rregullojnë vetë të drejtën e një të akuzuari për të komunikuar me botën e jashtme, këto shtete kanë kërkuar nga Tribunali që ai të shprehë pozicionin e tij lidhur me kontaktet që i burgosuri mund të ketë me mediat. Duke pasur parasysh interesin politik dhe historik në punën e Tribunalit, ky ka kërkuar procedurë dhe procedim të hapët dhe transparent. Megjithatë, në të gjitha etapat, kjo transparencë duhet të jetë e ekuilibruar përkundrejt nevojës për të mbrojtur të drejtat e palëve, përfshi ato të viktimave, të dëshmitarëve dhe të akuzuarve. Përvoja e TPNJ-së ka treguar se, në këshillimin e shteteve se si ato mund t'u përgjigjen kërkesave të mediave për qasje ndaj personit të dënuar, duhet të mbahen parasysh një numër faktorësh, d.m.th. të drejtat e individit të dënuar, të drejtat e viktimave dhe të dëshmitarëve të prekur nga veprimet e individit të dënuar si edhe efekti i dëmshëm që komunikimi me mediat mund të ketë mbi gjykimet dhe proceset e tjerë gjyqësore në vijim e sipër, në tërësi. Duke mbajtur parasysh peshën e krimeve të shqyrtuar nga Tribunali, praktika më e mirë është ajo e rekomandimit të një shqyrtimi të kujdesshëm të kërkesave që vijnë nga ana e mediave.

D. Falja dhe ulja e dënimit

39. Neni 28 i Statutit trajton çështjet që lidhen me faljen dhe uljen e dënimeve të dhëna,[304] gjë që parashikohet nga Rregullat 123-125 dhe nga Udhëzuesi Praktik mbi Procedurën dhe Përcaktimin për Zbatimin e Faljes, Uljes së Dënimit dhe Lirimit të Parakohshëm të Personave të Dënuar nga Tribunali Ndërkombëtar ("Udhëzuesi Praktik për Lirimin e Parakohshëm"), të cilët përcaktojnë modalitetet e zbatimit të ligjit në këtë drejtim.

D.1 Njoftimi nga shtetet

40. Rregullorja thekson se, në qoftë se një person i dënuar është i tillë që mund të përfitojë nga falja ose nga ulja e dënimit sipas ligjit të shtetit ku ai vuan dënimin, shteti në fjalë duhet të njoftojë Tribunalin lidhur me këtë mundësi.[305] Pas marrjes së njoftimit nga shteti në fjalë se personi i dënuar mund të përfitojë nga lirimi i parakohshëm apo ulja e dënimit sipas ligjit të brendshëm, Sekretari i Tribunalit duhet të vej në dijeni lidhur me këtë fakt Kryetarin e Tribunalit dhe duhet të marrë nga Zyra e Prokurorit (ZP) dhe autoritetet kombëtare përkatëse informacionin e nevojshëm, të parashikuar në paragrafin 2 të Udhëzuesit Praktik për Lirimin e Parakohshëm. Ky proces parashikon dërgimin e një letre të shkruar, drejtuar autoriteteve kombëtare të vendit përkatës ku vuhet dënimi, me anë të së cilës kërkohet raportimi i hollësishëm lidhur me të gjitha të dhënat mjekësore dhe ato të sjelljes së personit të dënuar. Më pas, Sekretari duhet të përkthejë të gjithë informacionin përkatës në gjuhën e personit të dënuar, t'ia kalojë atij dhe të shpjegojë procedurën që Tribunali do të ndjekë në marrjen e vendimit të faljes ose të uljes së dënimit. Më tej, Sekretari i Tribunalit duhet të përpilojë dhe t'ia paraqesë gjithë këtë dokumentacion Kryetarit të Tribunalit, përfshi këtu edhe çdo

304 Neni 28, Statuti i TPNJ-së thotë: "Në rast se, në pajtim me ligjin e zbatueshëm të shtetit në të cilin vuan dënimin, i dënuari mund të përfitojë nga falja ose nga ulja e dënimit, Shteti në fjalë duhet të njoftojnë për këtë në kohën e duhur Tribunalin Ndërkombëtar. Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar, pas këshillimit me gjykatësit, vendosë mbi këtë çështje mbi bazën e interesave të drejtësisë dhe parimeve të përgjithshme të ligjit."

305 Rregulla 123 RrPP e TPNJ-së.

lloj komenti që mund të jetë bërë nga personi i dënuar. Gjithashtu, Sekretari duhet të sigurohet që çdo person, i cili aplikon për falje, lirim të parakohshëm ose ulje të dënimit të jetë asistuar më parë nga avokati mbrojtës, i cili, ose është zgjedhur prej vetë të dënuarit ose i është caktuar atij me kërkesë të tij nga Sekretari.

D.2 Përjashtimi nga procedura

41. Në shumë raste, njoftimi i parashikuar nga Rregulla 123 bëhet personalisht më shumë nga personi i dënuar se sa nga Shteti që zbaton dënimin. Njoftime të tilla janë bërë sa herë që i dënuari beson se gjendja e tij është e krahasueshme me gjendjen e personave të tjerë të dënuar nga TPNJ-ja, të cilëve u është dhënë lirim i përkohshëm.

42. Ndonëse Rregullorja nuk e njeh në mënyrë eksplicite të drejtën e personit të dënuar për të aplikuar për lirim të përkohshëm, praktika e TPNJ-së ka qenë ajo e të trajtuarit të këtyre kërkesave në përputhje me jurisprudencën e saj.

43. Pas marrjes së kërkesës së të dënuarit, Kryetari i Tribunalit i kërkon Sekretarisë të sigurojë materialet përkatëse, në përputhje me Nenin 2 të Udhëzuesit Praktik. Më pas, Sekretaria i kërkon Shtetit ku vuhet dënimi, të shprehet për pozicionin e tij lidhur me mundësinë që ekziston për t'i dhënë personit të dënuar të drejtën e përfitimit prej faljes ose lirimit të parakohshëm.

D.3 Marrja e vendimit nga Kryetari

44. Në vijim të Rregullës 124, pas marrjes së njoftimit, Kryetari duhet të vendosë, në këshillim me anëtarët e Byrosë dhe çdo Gjykatës të Përhershëm të Dhomës gjyqësore që ka kryer gjykimin dhe që vazhdon të jetë gjykatës pranë Tribunalit, nëse falja apo ulja e dënimit janë ose jo me vend.

45. Praktika gjyqësore e Tribunalit ka qartësuar se Kryetari gëzon të drejtën të aprovojë ose të mohojë faljen ose ndryshimin e dënimit. Ndonëse në këtë drejtim, Kryetari këshillohet edhe me gjyqtarët e tjerë, ai nuk është i detyruar të veprojë sipas pikëpamjeve të tyre.[306] Në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me ndryshimin e dënimit, normalisht, Kryetari deklaron në mënyrë të përmbledhur nëse vendimi i tij ka qenë ose jo i mbështetur njëzëri nga Gjykatësit apo nëse ndonjëri prej tyre ka shprehur ndonjë opinion të ndryshëm.

46. Duke e përqendruar kompetencën lidhur me faljet dhe ndryshimet e dënimeve në duart e Kryetarit, TPNJ-ja ka dashur të garantojë një proces vendimmarrës të qëndrueshëm në vlerësimin e të gjithë faktorëve. Synimi përfundimtar është që të dënuarit të jenë të garantuar për një trajtim dhe shanse të barabarta për të marrë lirimin e parakohshëm.

D.4 Faktorët përkatës për faljen, uljen e dënimit ose lirimin e parakohshëm

47. Rregulla 125 sanksionon se Kryetari, gjatë marrjes nëse vendimi për falje ose ose ulje të dënimit është i përshtatshëm ose jo, duhet të mbajë parasysh një larmi faktorësh: peshën e krimit ose krimeve për të cilat është dënuar i burgosuri, mënyra se si janë trajtuar të burgosurit e tjerë në situatë ngjashme, rehabilitimin e mundshëm të personit të burgosur dhe nëse ky i fundit, para se të dënohej, është treguar ose jo bashkëpunues me Prokurorin.

306 *Prokurori kundër Vuković*, Lënda Nr. IT-96-23/1-ES, Vendim I Kryetarit lidhur me Ndryshimin e Dënimit, 12 mars 2008 ("*Vuković* Vendim"), para. 12-13.

D.4.1 Pesha e krimeve

48. Kriteret e radhitur në Rregullën 125 duhet të vlerësohen nga Kryetari gjatë ushtrimit të së drejtës së tij. Kështu, për shembull, në rastet kur ulja e dënimit është dhënë, Kryetari i Tribunalit nuk e ka mbështetur kurrë vendimin e tij në peshën relativisht të ulët të krimeve të kryera nga i dënuari. Nga ana tjetër, Kryetari ka vendosur të ulë dënimin e dhënë, "pavarësisht" nga pesha e krimeve të kryera, mbi bazën e faktorëve të tjerë. [307]

D.4.2 Demonstrimi i rehabilitimit nga ana e të dënuarit

49. Në vlerësimin e faktorit të rehabilitimit, Kryetari mbështetet në raportet e autoriteteve shtetërore të vendit ku i dënuari vuan dënimin. Midis faktorëve që demonstrojnë rehabilitimin, jurisprudenca e Tribunalit i ka dhënë peshë zbatimit të mirë nga ana e të akuzuarit të dënuar të rregullave të burgut dhe marrëdhënieve të tij të mira me nëpunësit e shërbimit të burgimit apo me të burgosurit e tjerë. Lidhur me këtë aspekt, një rëndësi e veçantë i është kushtuar faktit nëse i burgosuri ka mbajtur ose jo marrëdhënie të mira me individë të tjerë që i përkasin së njëjtës kombësi, etni, ose fe me ato të viktimave të shkaktuara nga i dënuari. [308] Për më tepër, Kryetari ka mbajtur parasysh faktorë që demonstrojnë rehabilitim, të tillë si fakti nëse i akuzuari ka shfaqur ose jo pendesë dhe keqardhje për krimet e kryer,[309] nëse ai ka marrë pjesë ose jo në veprimtaritë e organizuara nga shërbimi i burgut dhe nëse sjellja e tij është prekur ose jo nga fakti që vuajtja e dënimit nga ana e tij nuk është prekur nga zbatimi i dënimit në një vend të ndryshëm prej vendit të tij.[310]

D.4.3 Bashkëpunimi thelbësor me Prokurorinë

50. Bashkëpunimi i të akuzuarit me Prokurorinë përpara marrjes së dënimit nuk merret parasysh në marrjen e vendimit për të ulur një dënim sipas Rregullës 125 dhe Nenit 2 të Udhëzuesit Praktik. Në përcaktimin e dënimit të të dënuarit, Dhoma Gjyqësore, tashmë, këtë faktor e ka mbajtur parasysh. [311]

51. Kryetari ka mbështetur mendimin se thjesht *gatishmëria* e personit të dënuar për të dëshmuar në çështje të tjera përpara Tribunalit, ose përpara gjykatave rajonale, nuk duhet të konsiderohet si një formë bashkëpunimi me Prokurorinë. Gjithashtu, kur Prokuroria nuk e kërkon bashkëpunimin e të dënuarit, gatishmëria e të dënuarit për të bashkëpunuar trajtohet si një faktor neutral.[312] Kur personi i dënuar ka dëshmuar *me të vërtetë* në çështje të tjera, ky veprim konsiderohet si një faktor pozitiv në marrjen e vendimit për të ulur dënimin.[313]

D.4.4 Trajtimi i të burgosurve që ndodhen në pozicion të ngjashëm

52. Ndonëse nuk është rregull, lirimi i parakohshëm u është dhënë një numri të akuzuarish pasi ata kanë vuajtur dy të tretat e dënimit të tyre. Në pjesën më të madhe, kjo praktikë varet nga përputhja e saj me

307 *Vuković* Vendim, para. 9; *Prokurori kundër Tadić,* Lënda Nr. IT-94-1-ES, Vendim I Kryetarit për Zbatimin e Faljes ose ndryshimin e vendimit të Dënimit për Duško Tadić, 17 korrik 2008, Material I redaktuar për Publikun, ("*Tadić* Vendim"), para. 17.

308 *Prokurori kundër Todorović,* Lënda Nr. IT-95-9/1-ES, Vendim I Kryetarit për Zbatimin e Faljes ose Uljes së Dënimit të Stevan Todorović, 22 qershor 2005 ("*Todorović Vendim*"*), para.* 9; *Prokurori kundër Jokić,* Lënda Nr. IT-01-42/1-ES, Vendim i Kryetarit rreth Kërkesës për Lirim të Parakohshëm, 1 shtator 2008 ("*Jokić* Vendim"), para. 8, 14.

309 *Todorović* Vendim, *para.* 9; *Tadić* Vendim, para. 16.

310 *Vuković* Vendim, para. 6; *Jokić* Vendim, para. 14; *Tadić* Vendim, para. 16.

311 *Prokurori kundër Radić*, Lënda Nr. IT-98-30/1-ES, Vendim i Kryetarit për Ndryshimin e vendimit të Dënimit, 22 qershor 2007, para. 15; *Tadić* Vendim, para. 10 dhe 18.

312 *Prokurori kundër Banović*, Lënda Nr. IT-02-65/1-ES, Vendim i Kryetarit për Ndryshimin e vendimit të Dënimit, 10 mars 2006, para. 5 dhe 14; *Vuković* Vendim, para. 10; *Tadić* Vendim, para. 18.

313 *Todorović* Vendim, para. 8, 10; *Jokić* Vendim, para. 9, 15. Në çështjet ku i dënuari ka bashkëpunuar aktivisht me Prokurorinë, gatishmëria e personit të dënuar për të dëshmuar në favor të Prokurorisë në çështje të tjera, është konsideruar një faktor plotësues për lirim të parakohshëm.

legjislacionin e shtetit që zbaton vendimin e dënimit, por ky legjislacion shpesh parashikon se një person i dënuar, ka mundësi të përfitojë nga lirimi i parakohshëm vetëm pasi të ketë kryer dy të tretat e periudhës së dënimit të tij ose të saj. Sidoqoftë, kjo pririje drejt përputhshmërisë nuk krijon njëjësim midis ligjeve të shteteve zbatuese të vendimit. Kur midis legjislacioneve të shteteve të ndryshëm zbatues të vendimeve, ekzistojnë mospërputhje, shtrohet çështja e trajtimit të barabartë mes të burgosurve. Në këtë drejtim, praktika e Tribunalit lidhur me dënimet e vuajtura në Spanjë dhe në Francë meritojnë një vëmendje të veçantë.

D.4.5 Pragu vendor i kualifikimit

53. Sipas ligjit të shtetit të caktuar zbatues të vendimit, personat e dënuar mund të përfitojnë nga falja ose nga ndryshimi i vendimit të dënimit vetëm pasi ata të kenë vuajtur tre të katërtat e dënimit të tyre. Megjithatë, në rrethana të jashtëzakonshme, kodi penal përkatës i shtetit ku vuhet dënimi, mund të japë të drejtën e kërkesës për falje ose ulje të vendimit, edhe kur një i dënuar ka kryer më pak se dy të tretat e dënimit të tij. Rrethanat e jashtëzakonshme që e lejojnë një gjë të tillë, mund të gjenden, kur personi i dënuar ka "ngjitur tre shkallë të statusit të të burgosurit", ka treguar sjellje të mira dhe ka lënë të kuptohet se mund të riintegrohet me sukses në gjirin e shoqërisë.

54. Në dy raste, personat e dënuar kanë depozituar kërkesa për ulje të dënimit, pasi ata kanë kryer dy të tretat e dënimit të tyre, pavarësisht nga fakti se autoritetet e shtetit ku vuhet dënimi nuk i kanë bërë ndonjë njoftim Tribunalit. Në të dy rastet, pasi Tribunali pat kërkuar një raport lidhur me faktin nëse të dënuarit kishin përmbushur ose jo kushtet për një lirim të parakohshëm, autoritetet e shtetit ku vuhet dënimi e kanë ngritur statusin e personave të dënuar në fjalë deri në shkallën tre, sipas sistemit të burgimit të shtetit përkatës, duke krijuar kështu mundësinë që këta të burgosur të fitonin të drejtën për të bërë kërkesën në këtë vend, duke lehtësuar kësisoj depozitimin e kërkesës së tyre para Tribunalit.[314]

55. Në të dy rastet, Kryetari ka theksuar se lirimet e parakohshme të personave të dënuar nuk do të ishin të mundur në rast se i burgosuri nuk do të kishte fituar të drejtën për të bërë kërkesën për uljen e dënimit sipas ligjit të shtetit ku vuhet dënimi.

D.4.6 Reduktimi automatik i vuajtjes së dënimit

56. Në një shtet tjetër zbatues të dënimit, nenet përkatëse të Kodit të Procedurës Penale lidhur me faljen ose uljen e dënimeve të të dënuarve, parashikojnë se të burgosurit e dënuar mund të përfitojnë nga një ulje dënimi, e cila përllogaritet mbi bazën e dënimit të dhënë dhe jo mbi bazën e dënimit që faktikisht është kryer. Në këtë rast, reduktimi i dënimit të personave të dënuar, bëhet automatikisht qysh nga fillimi i vuajtjes së dënimit të tyre, duke u përllogaritur tre muaj për vitin e parë, dy muaj për vitet në vijim dhe për pjesën e fundit të dënimit që është më pak se një vit, shtatë ditë në muaj. Megjithatë, ky reduktim mund të anulohet nga Gjykatësi i zbatimit të vendimit në rast se i dënuari ka sjellje të keqe. Kodi i Procedurës Penale parashikon se një ulje plotësuese e dënimit mund t'u akordohet të burgosurve që japin shenja serioze riintegrimi shoqëror. Në rast se personi i dënuar nuk është recidivist, ulja plotësuese e akorduar mund të shkojë deri në tre muaj për çdo vit dënimi. Ulja e dënimit bëhet pjesë-pjesë, në rast se burgimi është më i gjatë se një vit.

314 *Prokurori kundër Josipović*, Lënda Nr. IT-95-16-ES, Vendim i Kryetarit për Zbatimin e Faljes ose Uljen e Dënimit për Drago Josipović, 30 janar 2006, para. 6-8.

57. Në një Vendim të marrë,[315] Kryetari ka shprehur shqetësim lidhur me mospërputhshmërinë midis legjislacionit të shtetit përkatës në lidhje me uljen e dënimit dhe sistemit të zbatuar nga Tribunali, gjë që mund të rezultojë në trajtim jo të barabartë të të dënuarve që vuajnë dënimet e tyre në këtë shtet, krahasuar me të dënuarit që i vuajnë këto dënime në vende të tjera. Kjo papajtueshmëri buron prej ligjeve të shteteve të veçantë, të cilët pranojnë uljen e periudhave të dënimit që në fillim të vuajtjes së dënimit. Sistemi Tribunalit e lejon zbatimin e uljeve të tilla, vetëm pasi i dënuari të ketë vuajtur një pjesë të mirë të dënimit të tij.

58. Në një rast të veçantë, autoritetet shtetërore e kanë njoftuar Tribunalin lidhur me fitimin prej të burgosurit të së drejtës për lirim të parakohshëm, sipas Kodit të Procedurës Penale të shtetit në fjalë qysh në fillim të periudhës së vuajtjes së dënimit (me fjalë të tjera, shumë më herët se sa e lejon pragu i dy të tretave). Tribunali e rrëzoi lirimin e parakohshëm të akorduar në këtë rast me arsyetimin, *ndër të tjera,* se ende nuk ishte vuajtur një pjesë e mirë e dënimit.[316] Pas vuajtjes së dy të tretave të dënimit të tij, i dënuari e përtëriu përsëri kërkesën e tij për lirim të parakohshëm përpara Kryetarit. Kur autoriteteve të shtetit zbatues të vendimit iu kërkua të cilësonin pozicionin e tyre lidhur me të drejtën e të dënuarit për të kërkuar uljen e dënimit, ato deklaruan se i dënuari nuk e fitonte këtë të drejtë sipas Kodit të Procedurës Penale. Arsyeja që u dha në këtë rast, ishte se ulja e dënimit në atë vend ishte e parashikueshme vetëm në fillim të vuajtjes së dënimit të dënuarit dhe se kërkesa e tij, e bërë në atë periudhë ishte rrëzuar nga Kryetari i Tribunalit. Megjithatë, autoritetet e Shtetit Zbatues sugjeruan se i dënuari mund të përfitonte nga "ulja plotësuese e dënimit" e parashikuar nga një tjetër dispozitë e Kodit të Procedurës Penale. Por, siç ilustrohet më lart, mbështetur mbi këtë dispozitë, mundësia për lirim të parakohshëm i nënshtrohet kushtëzimeve të tjera të ndryshme e shumë më strikte.

59. Lidhur me këtë dispozitë të fundit, Kryetari ka theksuar se "do të ishte mjaft dobiprurëse në rast se autoritetet (shtetërore) do të adoptonin në sistemin e uljes së dënimeve të kodit të tyre penal praktikat e përdorura nga Tribunali për akordimin e uljeve të dënimeve vetëm pasi të jetë vuajtur një pjesë e mirë e dënimit të dhënë." Në vijim të diskutimeve të tjera me shtetin në fjalë, u arrit të qartësohej se reduktimi automatik i dënimit, në rast se ai aprovohej nga Kryetari, mund të tërhiqej në çdo moment, në rast se Kryetari e shihte atë të papërshtatshëm nën këndvështrimin e sjelljes së personit të dënuar. Në këtë rast specifik, rruga më e mirë që mund të ndiqej ishte ajo e miratimit të përkohshëm të reduktimit automatik të dënimit nga ana e Kryetarit dhe rishqyrtimit të mëtejshëm, kur personi i dënuar ta fitonte të drejtën për të bërë kërkesën për lirim të parakohshëm.

D.5 Lirimi dhe transferimi

60. Në rast se Kryetari akordon lirimin e parakohshëm, faljen ose uljen e dënimit, Sekretari i gjykatës duhet të lidhet me autoritetet kombëtare për kryerjen e të gjitha veprimeve praktike që kanë të bëjnë me lirimin e personit të dënuar në përputhje me marrëveshjet përkatëse të zbatimit të vendimit. Udhëzuesi Praktik për Lirimin e Parakohshëm parashikon se, kur është e përshtatshme, dhe nën drejtimin e Kryetarit, Sekretaria duhet të informojë personat që kanë dëshmuar para Tribunalit gjatë gjykimit të personit të dënuar për lirimin e tij ose të saj, për vendin ose destinacionin ku ai do të udhëtojë pas lirimit, si edhe për çdo informacion tjetër, që Kryetari e konsideron të rëndësishëm.

315 *Prokurori kundër Banović*, Lënda Nr. IT-02-65/1-ES, Vendim i Kryetarit për uljen e Dënimit, 4 shtator 2007 ("*Banović* Vendim"). para. 13; shih gjithashtu *Prokurori kundër Banović*, Lënda Nr. IT-02-65/1-ES, Vendim i Kryetarit për uljen e Dënimit, 3 shtator 2008, para. 10.

316 *Banović* Vendim, para. 13.

61. Sekretarit të Tribunalit mund t'i kërkohet gjithashtu, të marrë masat e nevojshme për të transferuar të dënuarin në përfundim të burgimit ose kur dënimi është e pamundur të zbatohet. Në këto raste duhet të merren masat e nevojshme për transportimin e të dënuarit nga shteti zbatues drejt shtetit tjetër zbatues vendimi. Në disa raste, mund të kërkohen gjithashtu masa për burgim të përkohshëm deri sa personat e dënuar të mund të transferohen në një shtet tjetër zbatues , ku ata do të vuajnë pjesën e dënimit të mbetur. Duket se burgosja e përkohshme është e domosdoshme sa herë që dënimi i dhënë nga TPNJ-ja është më i gjatë se sa dënimi maksimal i zbatueshëm në shtetin zbatues të vendimit ose në rastet kur ligji i brendshëm përkatës lejon lirimin e parakohshëm, faljen ose uljen e dënimit, por ku Kryetari e refuzon kërkesën (shih kutinë "*Lënda Jelisić - Afati maksimal i vuajtjes së dënimit në shtetin zbatuest")*.

Lënda Jelisić - Afati maksimal i vuajtjes së dënimit në shtetin zbatues

*Goran Jelisić, u dënua me 40 vjet burg më 5 korrik 2001. Aktualisht ai vuan dënimin e tij në Itali, sipas marrëveshjes së zbatimit të Vendimeve të dënimit të datës 6 shkurt 1997, ratifikuar me ligj nga parlamenti Italian më 7 qershor 1999. Pavarësisht prej faktit se Marrëveshja qartazi përcakton se në "zbatimin e vendimit të shpallur nga Tribunali Ndërkombëtar, autoritetet kompetente kombëtare të shtetit zbatues të vendimit janë të kushtëzuara përsa I përket zbatimit të kohëzgjatjes së vendimit." (Neni 3), më 5 dhjetor 2002, Gjykata e Lartë e Italisë urdhëronte se kohëzgjatja e vuajtjes së dënimit në Itali nuk duhet të jetë më shumë se 30 vjet, që është afati maksimal I lejuar nga Neni 735 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës Italiane.**

* Gj. Kas. 5 dhjetor 2002, Nr. 3785

D.6 Çështje që lindin nga transferimi/deportimi

62. Pas lirimit ose përfundimit të dënimit të tyre, të gjithë personat e dënuar nga TPNJ-ja, normalisht, kthehen në vendin e tyre të origjinës. Të gjitha marrëveshjet e zbatimit të vendimeve të përfunduara nga Tribunali parashikojnë se Tribunali merr përsipër shpenzimet lidhur me transferimin e personit të dënuar drejt shtetit të kërkuar, me përjashtim të rasteve kur Palët kanë rënë dakord ndryshe. Vetëm në raste të jashtëzakonshme, të tilla si ato kur personat e dënuar janë të kërcënuar me jetë sepse ata u kanë dhënë prova Palëve ose Dhomave gjyqësore, personat e dënuar mund të rivendosen për sigurinë e tyre, në një shtet të tretë. Të dënuarit e liruar dërgohen në shtete me të cilët Tribunali ka arritur një marrëveshje rivendosjeje.

63. Ndonëse marrëveshjet e zbatimit të vendimeve të dënimeve të përfunduara me shtetet zbatuese nuk e trajtojnë statusin e personave të dënuar sipas Rregullores së Imigracionit të Bashkimit Evropian në përfundim të dënimit të tyre, koha e shpenzuar në shtetin zbatues , për qëllimin e vuajtjes së një dënimi të dhënë nga Tribunali, nuk duhet të ketë efekt të dëmshëm afatgjatë për personat e dënuar porsa i përket të drejtës së tyre aplikuar sipas Rregullores së Imigracionit të vendeve të Bashkimit Evropian. Megjithatë, përvoja ka treguar se efekti i vendimeve për deportimet kombëtare mbi të drejtën e personave të liruar për të hyrë më vonë në vendet e BE-së, duhet shqyrtuar plotësisht dhe siç duhet, për të shmangur ndonjë pasojë të dëmshme mbi statusin imigrues të personit të dënuar.

XIII.Referimi i Çështjeve te Juridiksionet Vendore

A. Kriteret për Referim.....178
A.1 Zgjedhja e Shtetit.....178
A.2 Niveli i të akuzuarit dhe pasha e krimeve.....178
A.3 Gjykimi i Drejtë dhe i Paanshëm dhe mosdënimi me vdekje.....179
A.4 Gatishmëria e shtetit dhe përgatitja e mjaftueshme e tij.....180
B. Monitorimi dhe çështje të tjera të periudhës pas referimit 181
C. Transferimi i çështjeve: aspekte të administrimit.....182
C.1 Transferimi fizik i të akuzuarit.....182
C.1.1 Rruga dhe mënyra e transferimit.....182
C.1.2 Udhëtimi dhe dokumentet identifikuese të të akuzuarit.....183
C.1.3 Dosja e paraburgimit.....183
C.1.4 Sendet personale.....184
C.1.5 Ruajtja e të akuzuarit.....184
C.2 Shfrytëzimi i kopjeve të certifikuara të materialeve të gjykatës.....185
C.2.1 Certifikimi.....185
C.2.2 Përkthimet.....185
C.2.3 Baza e të dhënave gjyqësore.....185
C.3 Ndihma ligjore dhe transferimi i materialit të çështjes te Mbrojtja.....186
C.3.1 Përfaqësimi ligjor para Gjykatës kombëtare....186
C.3.2 Transferimi i dosjeve të Mbrojtjes.....186
C.3.3 Ndihma ligjore gjatë periudhës kalimtare.....186
C.4 Kërkesat për ndihmë dhe për ndryshimin e materialit të mbrojtur.....187

1. ITPNJ-së i është njohur kompetenca kryesore për gjykimin e krimeve të përfshira në Statutin e saj e, për rrjedhojë, nuk i është njohur kompetencë ekskluzive mbi të gjitha hetimet. Ndonëse në parim, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara i ka dhënë TPNJ-së përparësi mbi të gjitha gjykatat e brendshme për të gjitha llojet e krimeve brenda juridiksionit të saj dhe Prokuroria ka mundur të hetojë e të marrë informacion për disa qindra persona të dyshuar potencialë, si TPNJ-ja ashtu edhe Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e kuptuan se institucionet ndërkombëtare mund të trajtonin, në të vërtetë, vetëm një numër të kufizuar çështjesh. Për pasojë, TPNJ-ja kërkoi që përpara Forumit ndërkombëtar të silleshin vetëm ato çështje, të cilat nuk do të mund të gjykoheshin në mënyrën e duhur përpara gjykatave të kombëtare. Fillimisht, në nivel vendor, kishte fare pak aftësi apo gatishmëri për të hetuar rreth krimeve të luftës. Për rrjedhojë, TPNJ-ja u përqendrua vetëm mbi të akuzuarit që i përkisnin nivelit më të lartë udhëheqjes dhe përgjegjësisë, ndonëse hetimet e saj filluan domosdoshmërisht me një numër çështjesh të nivelit të mesëm. Me kalimin e kohës, gjykimet përpara TPNJ-së nisën të përqendroheshin mbi ata që kishin pasur edhe përgjegjësinë më të madhe për krimet e kryera në ish-Jugosllavi.

2. Me përparimin e hetimeve dhe me rritjen provave në dispozicion dhe numrit të gjykimeve, Prokurori rishikoi aktakuzat kryesore dhe tërhoqi një pjesë të çështjeve të vjetra të nivelit më të ulët. Si rezultat i një veprimi të tillë, Prokurori u përqendrua vetëm mbi individët e nivelit më të lartë. Kur disa vjet më vonë, TPNJ-ja nisi të zhvillojë strategjinë e përmbylljes, kohë në të cilën aftësia e gjykatave të brendshme ishte rritur, ajo bëri një rishikim të mëtejshëm të çështjeve të mbetura. Aktualisht, fokusi i saj është vendosur në identifikimin e çështjeve, të cilat, ndonëse të tolerueshme për t'u përfshirë në programin e gjykimeve të TPNJ-së, mund të konsiderohen edhe si kandidate për t'u dërguar për gjykim përpara gjykatave të brendshme kombëtare. Në këtë mënyrë, TPNJ-ja ishte në gjendje të përfundonte gjykimin e çështjeve më të rënda brenda afateve të reja të caktuara për mbylljen e mandatit të saj. Ndonëse ideja e dërgimit të çështjeve për gjykim përpara gjykatave të brendshme u paraqit si një masë e re, këto dërgime kishin qenë gjithnjë brenda frymës fillestare të Tribunalit, si institucion që ka përparësi ndaj gjykatave të brendshme kombëtare, të cilat gëzojnë juridiksion konkurrues.

3. Tribunali adoptoi Rregullën 11*bis* në Rregulloren e vet të Procedurës dhe Provave, për t'i dhënë mundësi një Dhome gjyqësore pas konfirmimit të aktakuzës, ose *proprio motu*[317] ose me kërkesë të Prokurorisë, që një çështje e caktuar t'i dërgohet për gjykim një shteti të caktuar. Sipas rregullës, transferimi i një çështjeje në një shtet të dhënë bëhet kur:
   - krimi është kryer në territorin e tij; ose
   - i akuzuari është arrestuar në territorin e tij; ose
   - shteti në fjalë ka juridiksion dhe është i gatshëm dhe i përgatitur sa duhet për pranimin e një çështjeje të tillë.
   - transferimi i një çështjeje pranë gjykatave kombëtare nënkupton se procesi ndaj një të akuzuari tashmë është përgjegjësi kryesore e autoriteteve të shtetit në fjalë.[318]
4. Me qëllim e zbatimit të një standardi të njëjtë në transferimin e çështjeve, TPNJ-ja ka adoptuar praktikën e emërimit të "Trupës për Transferimin e Çështjeve", e përbërë nga tre gjykatës të përhershëm, e cila trajton të gjithë elementet që kanë të bëjnë me marrjen e vendimeve për transferimin e çështjeve në shkallë të parë. Kur këto vendime apelohen, Kryetari i Tribunalit cakton një trup gjykues, që dëgjon apelimin mbi një bazë *ad hoc*.

A. Kriteret për Referim

A.1 Zgjedhja e Shtetit

5. Midis tre kritereve të përdorura për zgjedhjen e shtetit, pra kriterit të Shtetit ku është kryer krimi, kriterit të shtetit ku është arrestuar i pandehuri dhe kriterit të shtetit që ka juridiksion dhe është i gatshëm dhe i përgatitur mirë për të pranuar çështjen, nuk ekziston një hierarki e qartë. Megjithatë, Trupi Gjykues për Referim ka preferuar të zgjedhë Shtetin ku janë kryer krimet e pretenduara, banorët e të cilit kanë qenë viktima, ndaj shtetit ku i pandehuri është dorëzuar.[319] Në zgjedhjen e juridiksionit më të përshtatshëm, Trupi Gjykues për Referim ka mbajtur parasysh gjithashtu edhe faktorë të tjerë, të tillë si aftësia e mundshme e gjykatave të një shteti të caktuar për të gjykuar në mënyrë të drejtë e të paanshme si edhe rrethanat që lidhen me kërcënimet e mundshme që mund t'u kanosen dëshmitarëve.[320]

A.2 Niveli i të akuzuarit dhe pasha e krimeve

6. Në marrjen e vendimit nëse një çështje do të transferohet ose jo, Trupi Gjykues për Referim, duhet të mbajë parasysh peshën e krimeve për të cilat akuzohet i pandehuri si edhe nivelin e përgjegjësisë së të akuzuarit. Kjo kërkesë diktohet nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1504 (2003), e cila konsiston në thirrjen që TPNJ-ja

317 Meqenëse ajo heq një çështje nga forumi ndërkombëtar, përdorimi i kësaj kompetence fillon të cenojë pavarësinë e Prokurorit. Megjithatë, Trupa e Transferimit të Çështjeve ka konstatuar se do të ishte mirë që kjo kompetencë të ushtrohej *proprio motu* "në një çështje të qartë". Shih *Prokurori kundër Mile Mrksić e të tjerë*, Lënda Nr. IT-95-13-1-PT, 20 qershor 2005, para. 14.

318 *Prokurori kundër Radovan Stanković*, Lënda Nr. IT-96-23/2-PT, Vendim për Transferim të Çështjes Mbështetur në Rregullën 11*bis*, Transferim i Çështjes, 17 maj 2005 (Pjesërisht konfidenciale dhe *Ex Parte*) ("*Stanković* Vendim për Transferim të Çështjes"), para. 93.

319 *Prokurori kundër Željko Mejakić e të tjerë.*, Lënda Nr. IT-02-65-AR11*bis*.I, Vendim lidhur me apelimin e përbashkët të Mbrojtjes kundër vendimit për Transferimin e Çështjes sipas Rregullës 11*bis*, 7 prill 2006 ("*Mejakić* Vendim për Transferim Çështjeje"), para. 38. I vetmi përjashtim i qartë ka qenë *Prokurori kundër Vladimir Kovačević*, Lënda Nr. IT-01-42/2-I, Vendim për Transferim Çështjeje në vijim të Rregullës 11*bis*, 17 nëntor 2006, ku i akuzuari ishte transferuar në vendin e kombësisë së tij, për arsye humanitare që lidheshin me për shëndetin e tij.

320 Në lidhje me çështjen e dëshmitarëve, shih gjithashtu para. 9.

duhet të përqendrohet "në udhëheqësit më të lartë të dyshuar si përgjegjësit kryesorë të krimeve" brenda juridiksionit të saj.[321]

7. Në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me rangun e lartë të të akuzuarit, TPNJ-ja vlerëson nivelin e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe peshën e krimeve nën akuzë, duke mbajtur parasysh vetëm faktet që pretendohen në akuzë. [322] Në përcaktimin se cilët janë "udhëheqësit më të lartë", Trupi Gjykues për Referim përqendrohet në ata individë që, nisur nga pozicioni dhe funksioni i tyre në hierarkinë përkatëse, si *de jure* ashtu edhe *de facto*, pretendohet se kanë ushtruar një shkallë të tillë autoriteti, si rrjedhojë e të cilit mund të përshkruhen më tepër si "më të lartë" se sa "të mesëm" [323] (shih kutinë "*Lënda Dragomir Milošević - Refuzimi i një kërkese për Transferim")*

Lënda Dragomir Milošević - Refuzimi i një kërkese për Transferim

Trupi Gjykues për Referim ka refuzuar një kërkesë për transferim të kërkuar nga Prokuroria për çështjen e Dragomir Milošević, i cili pretendohej se kishte qenë gjatë pesëmbëdhjetë muajve komandant i një korpusi me rreth 18,000 ushtarë gjatë rrethimit të Sarajevës. Konkluzionet e tij ishin si më poshtë:

*"Fushata e pretenduar në aktakuzë dhe krimet për të cilët Dragomir Milošević është akuzuar spikasin kur ato krahasohen me çështje të tjera të gjykuara para Tribunalit, veçanërisht përsa i përket kohëzgjatjes së pretenduar të tyre, numrit të civilëve të prekur, shkallës së dëmtimit të pronës dhe numrit të personelit ushtarak të angazhuar. Gjithashtu është e qartë se çështja e Prokurorisë e ngarkon Dragomir Milošević-in përgjegjësi të lartë. Për pasojë, Trupi Gjykues arrin në përfundimin se pesha e krimeve nën akuzë dhe niveli i përgjegjësisë së të akuzuarit, veçanërisht kur këta elemente shqyrtohen të kombinuara me njeri tjetrin, kërkojnë që kjo çështje të gjykohet para Tribunalit."**

* *Milošević* Vendimi për Transferim, veçanërisht para. 24; shih gjithashtu *Prokurori kundër Rasim Delić*, Lënda Nr. IT-04-83-PT, Vendim për Mocionin për Transferim të Çështjes sipas Rregullës 11*bis*, 9 korrik 2007.

A.3 Gjykimi i Drejtë dhe i Paanshëm dhe mosdënimi me vdekje

8. Rregulla 11*bis* e autorizon transferimin e një çështjeje vetëm kur Trupa e Transferimit "është e bindur se i akuzuari do t'i nënshtrohet një gjykimi të drejtë e të paanshëm dhe se ai nuk do të dënohet me vdekje dhe, edhe në rast se ai ka marrë një dënim të tillë, vendimi nuk do të zbatohet." Ndërsa kërkesa e fundit nuk përmban shumë dyzim,[324] nuk është e lehtë të thuhet me siguri se individi nën akuzë do t'i nënshtrohet një gjykimi të drejtë e të paanshëm.

9. Faktorët që lidhen me një gjykim të drejtë e të paanshëm e që mbahen parasysh nga Trupi Gjykues për Referim janë:

- barazia e të gjithë individëve para gjykatës;
- zhvillimi i një seance dëgjimore të drejtë, të paanshme dhe publike nga ana e një gjykate kompetente, të pavarur e të ngritur me ligj;
- pandehja e pafajësisë e zbatueshme deri në momentin e provimit të fajit sipas ligjit;
- i akuzuari ka të drejtë të informohet në kohën e duhur dhe me hollësi, në një gjuhë që ai e kupton, lidhur me natyrën dhe bazën mbi të cilën ngrihet akuza kundër tij;
- e drejta e të akuzuarit për të pasur kohën e nevojshme dhe të gjitha lehtësitë për përgatitjen e mbrojtjes si edhe të komunikimit me avokatin e zgjedhur prej tij;

321 Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1534 (2004) theksonte se transferimi drejt juridiksioneve kombëtare duhej të bëhej vetëm për "rastin e të akuzuarve të rangut të ulët dhe të mesëm".

322 *Prokurori kundër Savo Todović*, Lënda Nr. IT-97-25/1-AR11*bis*.1, Vendim për Transferim Çështjeje sipas Rregullës 11*bis*, 23 shkurt 2006, para. 14.

323 *Prokurori kundër Dragomir Milošević*, IT-98-29/1-PT, Vendim për Transferim të Çështjes sipas Rregullës 11*bis*, 8 korrik 2005 ("*Milošević* Vendim për Transferim të Çështjes"), para. 22.

324 Asnjë shtet i dalë nga ish-Jugosllavia nuk e zbaton dënimin me vdekje. Shih *Stanković* Vendim për Transferim të Çështjes, para. 49-50.

- e drejta e të akuzuarit për t'u gjykuar brenda afateve të arsyeshme dhe pa vonesa të papërligjura;
- e drejta e të akuzuarit për t'u gjykuar në praninë e tij dhe për t'u mbrojtur personalisht ose nëpërmjet avokatit mbrojtës të zgjedhur prej tij;
- e drejta e të akuzuarit për t'u informuar rreth të drejtës që ka për ndihmë ligjore dhe për të pasur një ndihmë të tillë, pa pagesë, në çdo çështje, ku interesat e drejtësisë e kërkojnë një gjë të tillë, në rast se ai nuk disponon mjete ekonomikisht të mjaftueshme;
- e drejta e të akuzuarit për të shqyrtuar përmes pyetjeve të drejtpërdrejta dëshmitarët që kanë dëshmuar kundër tij si dhe për të kërkuar pjesëmarrjen në seancë gjyqësore për shqyrtim të dëshmitarëve që dëshmojnë për të, në të njëjtat kushte sikurse edhe dëshmitarët që kanë dëshmuar kundër tij;
- e drejta e të akuzuarit për të pasur ndihmën e përkthyesit, në rast se ai nuk e kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur gjatë procesit gjyqësor;
- e drejta të akuzuarit për të mos u detyruar të dëshmojë kundër vetes apo për të rrëfyer fajin e vet.[325]

10. Legjislacioni i brendshëm në rajonin e ish-Jugosllavisë (d.m.th. vendet në të cilat TPNJ-ja ka parë mundësinë e transferimit të çështjeve për gjykim), përgjithësisht e garantojnë respektimin e të drejtave të kërkuara nga procesi gjyqësor.[326] Megjithatë, Tribunali e ka interpretuar në thelb këtë standard si një kërkesë ku instrumentet përkatëse ligjore duhet të jenë tashmë funksionale, me garancinë për zhvillimin e një gjykimi të drejtë e të paanshëm, pavarësisht nga rrethanat specifike të një çështjeje të dhënë.[327] Për shembull, Trupi Gjykues për Referime, ka marrë në shqyrtim çështjen e të qenit në dispozicion të dëshmitarëve nën këndvështrimin e dispozitave të brendshme për mbrojtjen e tyre si edhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme për të sjellë dëshmitarë nga vende të tjera.[328]

11. Gjithashtu, TPNJ-ja ka pranuar se Ligji për të Drejtat e Njeriut nuk lejon që një individ të mbahet i paraburgosur në rrethana në të cilat do të përballeshin me torturën apo trajtimin çnjerëzor. Për rrjedhojë, TPNJ-ja ka konsideruar se transferimi i çështjeve në disa vende të caktuara, mund të vinte në rrezik jetën e të akuzuarit dhe për këtë arsye ka udhëzuar për vendet nën shqyrtim, zbatimin e standardeve ndërkombëtare në lidhje me kushtet e vendeve të vuajtjes së dënimeve si dhe që qeveritë e këtyre vendeve të shprehen lidhur me gatishmërinë e tyre për pranimin e kërkesave në fjalë. TPNJ-ja ka rrëzuar ato që ajo i ka përkufizuar si "pretendime të përgjithshme" rreth pamjaftueshmërisë së standardeve të burgosjes në vendet e ish-Jugosllavisë. [329]

A.4 Gatishmëria e shtetit dhe përgatitja e mjaftueshme e tij

12. Duke pranuar faktin se shkeljet e rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare mund të hetohen dhe të gjykohen mbi bazën e një juridiksioni ndërkombëtar, TPNJ-ja mund të transferojë çështje për gjykim edhe në vende të tjera, veç vendeve ku është kryer krimi apo vendeve ku është kryer arrestimi i të akuzuarit, në rast se ky vend "është i gatshëm dhe i përgatitur sa duhet, për t'i pranuar" ato. Në marrjen e vendimeve të tilla, TPNJ-ja duhet të mbajë parasysh parashtrimet e bëra nga shteti në fjalë dhe duhet të shqyrtojë regjimin e tij të brendshëm ligjor, që, me fort të ngjarë, do të zbatohet në çështjen që do të transferohet drejt tij.

325 *Stanković* Vendim për Transferim Çështjeje, para. 55.
326 Të gjitha këto vende janë anëtare të Këshillit të Evropës dhe i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila veç të tjerash, përfshin edhe të drejtën për gjykim të drejtë e të paanshëm.
327 Shih *p.sh.Stanković* Vendim për Transferim të Çështjes të Apelit, para. 28.
328 *Stanković* Vendim për Transferim Çështjeje, para. 81-86.
329 Shih *p.sh.*, *Stanković* Vendim për Transferim Çështjeje, para. 31-37 dhe *Mejakić* Vendim për Transferim të Çështjes, para. 56-62. Krahaso, sidoqoftë, *Prokurori kundër Gaspard Kanyarukiga*, Lënda Nr. ICTR-2002-78-R11*bis*, Vendim lidhur me Kërkesën e Prokurorit për Transferim të Çështjes në Republikën e Ruandës, 6 qershor 2008, i cili rrëzonte kërkesën për transferim mbi bazën, *inter alia*, të rrezikut të burgosjes në kushtet e vetmisë për të akuzuarin, në rast se ai do të dënohej me burgim të përjetshëm.

Transferimi i çështjes do të bëhet vetëm kur Trup Gjykues për Referimtë jetë bindur se në vendin në fjalë ekzistojnë dispozitat e përshtatshme që mundësojnë adresimin e të gjitha veprave penale të pretenduara ndaj të akuzuarit në aktakuzë dhe se nëse në këtë vend ekzistojnë strukturat e përshtatshme penale. [330] Në këtë mënyrë, hamendësohet se Transferimi i çështjes është i mundur vetëm kur shteti do të ngrejë akuza që figurojnë në Statutin e Tribunalit. Me fjalë të tjera, në të duhet të ketë shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Krimet të zakonshme nuk janë të mjaftueshme, pasi mbi këto krime nuk rëndon një paragjykim i mjaftueshëm.

B. Monitorimi dhe çështje të tjera të periudhës pas referimit

13. Sikurse u përmend më lart, transferimi i një çështjeje nga TPNJ-ja në juridiksionet kombëtare nënkupton që procesi gjyqësor kundër të akuzuarit bëhet përgjegjësi parësore, por jo tërësore, e autoriteteve të shtetit në fjalë.[331] Faktikisht, Tribunali ruan kompetencën për të monitoruar çështjet që u janë dërguar autoriteteve kombëtare me synimin për të garantuar që procesi gjyqësor të kryhet siç duhet.[332] Monitorimi, i realizuar sipas Rregullës 11*bis, i jep mundësi* Tribunalit të reagojë menjëherë në rast se një shtet nuk arrin të ushtrojë siç duhet kompetencën që i është deleguar. Kështu, për shembull, Rregulla 11*bis* (F) i jep qartazi të drejtë Trupit Gjykues për Referim, të anulojë urdhrin e transferimit në çdo kohë pas nxjerrjes së urdhrit, me kusht që individi të mos jetë shpallur fajtor ose të mos jetë shfajësuar ende nga ndonjë gjykatë e brendshme.

14. Rregulla 11*bis* i jep Prokurorit autoritet për të monitoruar procedimin gjyqësor që zhvillohet në Gjykatat kombëtare. Për këtë qëllim, Prokuroria ka hyrë në marrëveshje me organizma të jashtëm, për të ndihmuar në monitorimin e çështjeve të transferuara. Për më tepër, Trupi Gjykues për Referim e ka udhëzuar Prokurorinë të raportojë përsëri tek ajo lidhur me zhvillimet që ndodhin pas transferimit të çështjeve.[333] Në këtë drejtim, është me të vërtetë me rëndësi thelbësore që për këtë qëllim, të ngrihen mekanizma monitorues fleksibil, sa herë që një çështje transferohet nga një juridiksion në një tjetër sipas një mënyre të ngjashme me atë të parashikuar nga Rregulla 11*bis*.

15. Neni 27 i Statutit i njeh Tribunalit kompetencën për të mbikëqyrur kushtet e vuajtjes së dënimit në shtetet ku Tribunali ka transferuar individët për vuajtjen e dënimit të tyre. [334] Në çështjet e gjykuara para Tribunalit dhe mbi bazën e marrëveshjeve që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve të dënimit, Tribunalit i njihet e drejta t'i japë fund vuajtjes së dënimit në një vend të caktuar dhe të urdhërojë kthimin e tij në Tribunal.[335] Megjithatë, kur një çështje është transferuar sipas Rregullës 11*bis* dhe gjykata e një shteti të caktuar ka dhënë një dënim që përgjithësisht zbatohet në territorin e vet, një gjë e tillë mund të krijojë probleme. Sipas Rregullës 11*bis*, nuk ekziston asnjë dispozitë që të parashikojë qartë ngritjen e mekanizmave specifikë që mund të administrojnë periudhën pas dhënies së dënimit, si për shembull në rastet kur një i akuzuar arrin të shpëtojë nga paraburgosja ose kur shteti drejt të cilit çështja është transferuar nuk është në gjendje të zbatojë siç duhet vendimin e dënimit të dhënë.

330 *Stanković* Vendim për Transferim të Çështjes në Apel, para. 41-42.
331 Vendim për Transferim të Çështjes , para. 93.
332 Shih *p.sh.* Rregulla 11*bis* (D)(iv) RrPP e TPNJ-së.
333 *Stanković* Vendim për Transferim të Çështjes në Apel, para. 59.
334 Shih Kapitullin XII - Seksioni C: Mbikëqyrja e Zbatimit të Dënimit.
335 Shih, *p.sh.*, Nenet 9 (2) të Marrëveshjeve për Zbatim Vendimesh Dënimi me Francën (25 shkurt 2000), Mbretërinë e Bashkuar (11 mars 2004), Estoninë(11 shkurt 2008), të disponueshme në versionin e tyre anglisht në faqen e internetit të Tribunalit: http://www.un.org/icty/legaldoc-e/index.htm.

C. Transferimi i çështjeve: aspekte të administrimit

16. Pasi Trupa e Transferimit të Çështjeve ka pranuar një kërkesë për dërgimin e një çështjeje në një shtet të dhënë, sikurse cilësohet në Rregullën 11*bis,* Sekretaria e Tribunalit duhet të kryejë dy detyra: të transferojë fizikisht të akuzuarin dhe të sigurojë kopjet certifikuara të materialit zyrtar që i përket çështjes, duke ia dërguar ato të gjitha palëve të interesuara të juridiksionit të brendshëm kombëtar. Duke pasur parasysh numrin e madh të palëve dhe elementeve që përfshihen në transferimin e një çështjeje, Sekretaria i ka standardizuar procedurat e veprimit të saj lidhur me transferimin e çështjeve, në mënyrë të tillë që të mundësojë një transferim sa më të lehtë dhe të parandalojë çdo anashkalim të mundshëm të elementëve të kërkuar për një gjë të tillë. Transferimi fizik i të akuzuarit, deri tani është rregulluar vetëm mbi bazë të Rregullës 11*bis*. Kur Trupi Gjykues i Referimit urdhëron një transferim çështjeje, ajo duhet t'i japë Sekretarisë 30 ditë kohë pas momentit të marrjes së vendimit përfundimtar të transferimit të të akuzuarit drejt shtetit të caktuar ku do të kryhet gjykimi. Veç transferimit fizik të të akuzuarit, Sekretaria ndihmon ZP në vlerësimin e kopjeve të certifikuara të materialit zyrtar që i përket çështjes, ose në *të shtypur* ose në format elektronik. Me qëllim që të mundësohet një transferim në kohë dhe sa më i mirë i dosjes së çështjes së Mbrojtjes drejt juridiksionit kombëtar, Sekretaria luan gjithashtu një rol lidhës midis njësisë kombëtare të Mbrojtjes dhe avokatit mbrojtës, i cili përfaqëson të akuzuarin para Tribunalit.

C.1 Transferimi fizik i të akuzuarit

17. Në mungesë të një marrëveshjeje detyruese midis Tribunalit dhe shtetit ku do të transferohet dhe gjykohet çështja, rekomandohet të përpilohet dhe të nënshkruhet një Memorandum i Mirëkuptimit (MiM). Duke mbajtur parasysh faktin se arritja e MIM-së nuk është gjithnjë e mundur, për shkak të mungesës së kohës, të kufizimeve ligjore ose politike, është e nevojshme të hartohet një plan standard transferimi, i cili do të zbatohet nga të gjithë sektorët përkatës si brenda Tribunalit ashtu dhe Shtetit ku transferohet çështja. Për më tepër, përvoja ka treguar se një individ, mundësisht një oficer gjyqësor, duhet të shërbejë si pikë kryesore kontakti brenda Sekretarisë , për të bërë të mundur monitorimin e procesit të transferimit deri në përfundimin e tij. Kjo pikë kontakti realizon gjithashtu një rol lidhës dhe bashkërendimi, e cila ndihmon që transferimi të përfundojë në mënyrën më të mirë të mundshme. Në këtë aspekt, është e rëndësishme që edhe në shtetin ku çështja do të dërgohet, të ngrihet një njësi kontakti. Kjo njësi kontakti është përgjegjëse për të bashkërenduar disa elementë si më poshtë vijon midis Tribunalit dhe Shtetit ku do të transferohet çështja, përpara se të kryhet transferimi, edhe pse kjo listë nuk është shteruese: negocimi i një marrëveshjeje lidhur me datën e transferimit; planifikimi i rrugës dhe mënyrës së transferimit; sigurimi i dokumenteve të identitetit dhe të udhëtimit për të akuzuarin; ndihma në drejtim të organizimit dhe transferimit të dosjes së paraburgimit, përfshi këtu edhe materialin mjekësor shoqërues; kryerja e transferimit të sendeve personale të të akuzuarit. Për më tepër, nga të gjitha zyrat përkatëse duhet të caktohen përfaqësues dhe (nëpërmjet telekonferencës ose video-link-ut) të organizohet sa më shpejt të jetë e mundur një takim bashkërendues, ku të përfshihen të gjithë partnerët e mundshëm.

C.1.1 Rruga dhe mënyra e transferimit

18. Nisur nga fakti që Tribunali nuk zotëron ndonjë juridiksion territorial apo kompetencë në drejtim të zbatimit të ligjit, për sa i përket transferimit të të akuzuarve, ai duhet të mbështetet në bashkëpunimin e shteteve. Për rrjedhojë, rruga dhe mënyra e transportimit duhet të vendoset në marrëveshje me të gjitha palët e interesuara. Kur një i akuzuar duhet të transferohet përmes një vendi evropian fqinj, ambasada përkatëse në Hagë duhet të kontaktohet menjëherë, për të bërë të mundur që të mos shkelen ligjet e brendshme të vendit

transit. Përvoja ka treguar se Ambasadës në fjalë i duhen lënë të paktën dy javë kohë, për të siguruar një kalim pa probleme. Veç transportit tokësor (i cili nuk është përdorur kurrë nga Tribunali, me përjashtim të rasteve kur ka qenë e nevojshme për të mbërritur në bazën më të afërt ushtarake të NATO-s, ku i akuzuari dhe eskorta shoqëruese e tij kanë marrë një fluturim ushtarak) përsa u përket mënyrave të transportit ekzistojnë dy opsione: fluturimet e zakonshme dhe ato ushtarake, ku që të dy mund të kërkojnë angazhimin e autoriteteve të shtetit transit. Sigurimi i përdorimit të një avioni ushtarak mund të kërkojë, në përgatitjen e transferimit, angazhimin e një vendi të tretë dhe autoritetet e vendit transit mund të kërkojnë një urdhër të Gjykatës, ku të figurojë lejimi i transferimit të të paraburgosurit të akuzuar përmes territorit të tij. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të njihen ligjet e brendshme përkatëse që rregullojnë transferimin ndërkufitar të personave të paraburgosur, përpara se të merret ndonjë vendim përfundimtar lidhur me mënyrën dhe vendin e transferimit.

19. Përdorimi i një linje ajrore të zakonshme, veçanërisht një fluturim me një linjë të një shteti të caktuar, mund të kërkojë angazhimin e përfaqësuesve diplomatikë të shtetit transit, të akreditуar në Hagë, veç pranisë së një zyrtari të lartë të kompanisë ajrore. Për shembull, përpara fillimit të procesit të transferimit me linjë ajrore të zakonshme nga Haga përmes një shteti transit drejt ish-Jugosllavisë, Ambasadës së shtetit transit dhe pikës së kontaktit të kompanisë ajrore, u dërgohet një njoftim zyrtar, ku kërkohet ndihma dhe bashkëpunimi i tyre. Ndonëse përmes këtij njoftimi kërkohet lehtësimi i transferimit, një gjë e tillë nuk garanton që transferimi përmes shtetit transit, do të ecë pa probleme. Nisur edhe nga përvoja e të kaluarës, si për shembull në rastin kur një të akuzuari të TPNJ-së iu refuzua hipja në avion në shtetin transit, është e rekomandueshme që gjatë fluturimit të jetë i pranishëm gjithnjë një oficer gjyqësor, i cili duhet të shoqërojë skuadrën e eskortës deri në destinacionin përfundimtar. Veç kësaj, nëqoftëse një person i paraburgosur transportohet me anë të një linje ajrore të zakonshme, është e nevojshme të caktohen edhe një ose dy oficerë sigurie për çdo të akuzuar, të cilët do e shoqërojnë atë përgjatë gjithë transferimit. Kjo kërkesë është në varësi të rregullores së kompanisë së fluturimit, ndaj personat e ngarkuar me zbatimin e transferimit duhet të njohin qysh më parë të gjitha kërkesat, të paktën dy javë para datës së transferimit.

C.1.2 Udhëtimi dhe dokumentet identifikuese të të akuzuarit

20. Sekretaria duhet t'i dërgojë Shtetit Kërkues një njoftim zyrtar, ku të figurojnë data e mundshme e transferimit, emri i plotë i të akuzuarit (së bashku me emrat e tjerë ose pseudonimet nëse ka), vendi i kombësisë, numri i pasaportës si edhe data dhe vendi i lindjes. Në pjesën më të madhe të rasteve, i akuzuari ka pasaportë; megjithatë, në disa raste, përfaqësuesi konsullor i vendit të tij/të saj në Hagë e ka një të tillë. Ka ndodhur, që disa persona të akuzuar, në momentin e arrestimit të mos kenë pasur pasaportë apo dokument udhëtimi. Në rrethana të tilla, Sekretaria duhet të përgatisë një dokument zyrtar, që përfshin fotografinë e të akuzuarit, emrin e tij të plotë, datën e lindjes, vendin e lindjes dhe emrin e të atit, të gjitha këto të certifikuara me firmën e Sekretarit. Ky dokument, së bashku me dokumentin e udhëtimit, të përdorur nga përfaqësuesi(t) shoqërues të Tribunalit, garanton kalimin transit përmes kufijve ndërkombëtarë. Gjatë udhëtimeve të tyre zyrtare, stafi i Tribunalit përdor *laissez passer* të Kombeve të Bashkuara. Me qëllim që të shmangen problemet gjatë udhëtimit, fakti që i akuzuari nuk zotëron një dokumenti të vlefshëm udhëtimi, duhet t'u bëhet qysh më parë i ditur zyrtarëve vendorë të shtetit ku do të transferohet çështja si dhe atyre të çdo vendi transit.

C.1.3 Dosja e paraburgimit

21. Krahas informacionit personal dhe mjekësor mbi të paraburgosurin, duhet të përgatitet gjithashtu edhe dosja e paraburgimit. Lidhur me njoftimin e dosjes mjekësore, më parë duhet të merret miratimi i vet të akuzuarit.

Të gjitha dokumentet konfidenciale duhet të futen në një zarf të vulosur. Gjithashtu, oficeri komandues i njësisë së paraburgimit së KB-së, duhet të përgatisë një memorandum vlerësimi lidhur me rrezikshmërinë e të paraburgosurit, kopje e së cilës duhet t'i dorëzohet oficerit gjyqësor shoqërues, shefit të sigurisë dhe përfaqësuesit të shtetit ku do të transferohet çështja. Bashkëngjitur me çdo dosje që do t'u dërgohet autoriteteve lokale duhet të ketë një dokument ku të shënohet pohimi i marrjes së dosjes në fjalë. Meqenëse dosja e paraburgimit përbën një material konfidencial të Sekretarisë gjyqësore, është e domosdoshme që këto materiale të transferohen drejtpërsëdrejti tek një përfaqësues i Sekretarisë pranë juridiksionit kombëtar dhe zyrës së Prokurorit të shtetit ku është transferuar dosja. I akuzuari duhet të njoftohet se dosja e tij e paraburgimit do të transferohet drejt juridiksionit të ri. Duke mbajtur parasysh faktin se i akuzuari do të njoftohet rreth datës së saktë të transferimit vetëm pak ditë përpara kryerjes së tij, për shkak të arsyeve që kanë të bëjnë me sigurinë, institucioni i paraburgimit të Tribunalit ka përgjegjësinë të përgatisë psikologjikisht të akuzuarin lidhur me transferimin dhe ndryshimet e mëdha që ai mund të përjetojë.

C.1.4 Sendet personale

22. Sendet personale të të akuzuarit duhet të transferohen ose gjatë ose pas transferimit fizik. Kur është e mundur, është e rekomandueshme që sendet personale të shoqërojnë të akuzuarin. Është rëndësishme që në këtë drejtim, lidhur me faktin se çfarë sendesh personale do të lejohet ose jo i akuzuari të marrë me vete, veçanërisht lidhur me vlerat monetare, të dëgjohen udhëzimet e shtetit ku transferohet çështja. Paraprakisht, njësia e paraburgimit duhet të përgatisë një inventar të sendeve personale të të akuzuarit dhe ky i fundit duhet ta nënshkruajë këtë inventar para transferimit të tij. Për të parandaluar ndonjë përplasje të mundshme, inventari i nënshkruar përpilohet në tre kopje. Një kopje i jepet të akuzuarit, një kopje mbahet nga njësia e paraburgimit dhe një kopje e tretë i bashkëngjitet për konfirmim në destinacionin përfundimtar, sendeve personale. Në rast se një i akuzuar ka ndërmend të transportojë pajisje elektrike (për shembull, një laptop personal) autoritetet e shtetit ku transferohet çështja, duhet të njoftohen qysh më parë. Në shumicën e burgjeve apo të njësive të paraburgimit, të burgosurve nuk u lejohet të përdorin pajisje të tilla pa lejen paraprake të gjykatësit paragjyqësor.

C.1.5 Ruajtja e të akuzuarit

23. Sekretaria gjyqësore është e ngarkuar me detyrën për të rishikuar çështjen se kush është ngarkuar me ruajtjen efektive të të akuzuarit gjatë çdo faze transferimi. Është e rëndësishme që oficeri gjyqësor i Sekretarisë, së bashku me oficerët e tjerë të nevojshëm të sigurisë, të shoqërojë të akuzuarin gjatë krejt transferimit. Zyra përkatëse e Sekretarisë duhet të përpilojë kopjet e certifikuara të nevojshme për një urdhër transferimi standard. Në rastin e Tribunalit, Zyra e Ndihmës Ligjore dhe Paraburgimit nis përpilimin e urdhrit të transferimit. Urdhri i Transferimit niset nga njësia e paraburgimit, e cila ia kalon ruajtjen e të akuzuarit, autoriteteve lokale (*d.m.th.* Policisë Holandeze të shoqërimit), e cila është përgjegjëse për transportimin e të akuzuarit drejt bazës ushtarake apo aeroportit, sikurse është udhëzuar nga vetë oficeri gjyqësor qysh përpara transferimit) Në çdo fazë të kalimit të procesit të ruajtjes, një përfaqësues i Tribunalit duhet të nënshkruajë të gjitha kopjet e certifikuara të urdhrit të transferimit. Një kopje e këtij dokumenti duhet t'i jepet gjithashtu përfaqësuesve të shtetit ku transferohet çështja, i cili, nga ana e tij, e pajis oficerin gjyqësor me dokumentet e nevojshme të transferimit, të nxjerra nga shteti pritës. Urdhri i transferimit, së bashku me dokumentet e transferimit, të nënshkruara nga shteti pritës, depozitohen më pas në dokumentacionin zyrtar, për të vërtetuar se vendimi i transferimit është zbatuar konform rregullave.

C.2 Shfrytëzimi i kopjeve të certifikuara të materialeve të gjykatës

C.2.1 Certifikimi

24. Sekretaria e TPNJ-së nuk ka ndonjë seksion apo njësi të veçantë për përpunimin e çështjeve të transferuara. Në vend të kësaj, Tribunali i ndan detyrat midis seksioneve të ndryshme, ku pjesa më e madhe e tyre i kalohet Seksionit të Shërbimeve dhe Administrimit Gjyqësor (SSHAGJ), meqenëse ky seksion është depozitues i dokumentacionit zyrtar të Tribunalit. Sekretaria gjyqësore përfshihet në këtë punë vetëm kur ajo merr një kërkesë për ndihmë: *p.sh.*, për kopje të certifikuara dokumentesh, zyrtarisht të depozituara në dosjet përkatëse; për transkriptime, dosje çështjesh dhe materiale audio-vizuale. Kur një çështje transferohet sipas Rregullës 11*bis*, Sekretaria gjyqësore ndihmon Prokurorin për transferimin e dosjes, duke dhënë garanci se dokumentacioni gjyqësor i çështjes është certifikuar nga Sekretaria. ZP certifikon se materiali në zotërimin e vet nuk është depozituar ose nuk është pranuar në dokumentacionin zyrtar të Tribunalit. Procesi i certifikimit është konsideruar i mërzitshëm si rrjedhojë e mungesës së një marrëveshjeje paraprake midis shtetit ku transferohet çështja dhe Tribunalit, ndaj Tribunalit i është kërkuar të ndryshojë procedurën e vet e t'ia përshtatë atë procedurës së brendshme të shtetit ku transferohet çështja. Në transferimet e ardhshme të çështjeve, rekomandohet që krejt dokumentacioni zyrtar i Tribunalit duhet të certifikohet dhe të konfirmohet autenticiteti sipas procedurës së Tribunalit. Për më tepër, rekomandohet vetëm një certifikim, i cili të vërtetojë autenticitetin e të gjithë materialit që ndodhet në dosje.

C.2.2 Përkthimet

25. Kur gjuha zyrtare e shtetit ku transferohet çështja nuk është e njëjtë me gjuhët e punës së Tribunalit, çështjet që lidhen me përkthimin e materialit duhet të negociohen qysh më parë. Tribunali ndeshet me dilemën që ka të bëjë me faktin se transkriptimet zyrtare të tij janë në dispozicion vetëm në gjuhën angleze dhe atë frënge, duke e bërë kësisoj të vështirë për juristët e vendeve të ish-Jugosllavisë të kërkojnë në arkivin e transkriptuar, në rast se ata nuk njohin mirë një prej gjuhëve zyrtare të Kombeve të Bashkuara. Në këtë rastesh, juristët vendas kërkojnë të kenë në dispozicion materialin audio/vizual në gjuhët BKS. Ky proces është njëherazi edhe i gjatë edhe i kushtueshëm për shtetin ku është transferuar çështja, pasi personat e ngarkuar me gjykimin e çështjes, fillimisht duhet të dëgjojnë regjistrimin audio/vizual e më pas të transkriptojnë dëshminë në gjuhën e tyre.

C.2.3 Baza e të dhënave gjyqësore

26. Dokumentacioni gjyqësor i Tribunalit është në dispozicion elektronikisht përmes Bazës së të Dhënave Gjyqësore të brendshme (BDhGj), i cili përdoret njëkohësisht edhe si mjet informimi edhe si mjet kërkimi ligjor. Dy vitet e fundit, përmes Memorandumeve të Mirëkuptimit, Tribunali e ka zgjeruar listën e personave që kanë të drejtë shfrytëzimi bazën e të dhënave gjyqësore, duke i dhënë kështu mundësinë gjykatave të jashtme, të kenë kodet shfrytëzimit në distancë. Këto kode u mundësojnë përdoruesve të caktuar të hyjnë në sistem nga distanca dhe të hulumtojnë krejt bazën e të dhënave zyrtare publike të Tribunalit. Për materiale që nuk gjenden në dokumentacionin zyrtar të Tribunalit, ZP u ka dhënë autoriteteve kombëtare të drejtën të kenë hyrje në Sistemin e Informimit Elektronik (SIE), i cili përmban pjesën më të madhe të tërësisë së provave të Prokurorisë.

C.3 Ndihma ligjore dhe transferimi i materialit të çështjes te Mbrojtja

C.3.1 Përfaqësimi ligjor para Gjykatës kombëtare

27. Përfaqësimi ligjor para gjykatës kombëtare përbën një çështje të rëndësishme, e cila duhet të negociohet para transferimit të çështjes dhe/ose të akuzuarit. Në disa juridiksione, e drejta e përfaqësimit të të akuzuarit dhe pjesëmarrja në audiencë u njihet vetëm shtetasve të këtij juridiksioni. Në kontekstin e këtyre rregullave, avokatët mbrojtës që kanë përfaqësuar të akuzuarin para Tribunalit mund të mos jenë në gjendje të vazhdojnë përfaqësimin e tij. Kur një çështje paraqitet për transferim, në mënyrë që të garantohet vijimësia e mbrojtjes dhe ajo e një kalimi të butë, Sekretaria duhet të shohë mundësinë e caktimit të një avokati, i cili të ketë të drejtën e audiencës përpara juridiksionit kombëtar. Synimi i këtij veprimi është që ky avokat të ketë mundësinë e fillimit të përgatitjes së mbrojtjes përpara daljes së çështjes para gjykatës kombëtare. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, koha dhe burimet e shpenzuara nga avokatët e Tribunalit në përgatitjen e çështjeve do të humbasë nëpër procedurat e gjykatave kombëtare.

C.3.2 Transferimi i dosjeve të Mbrojtjes

28. Për të garantuar një kalim të butë të dosjeve të Transferimit të çështjes nga avokati mbrojtës në Tribunal tek çdo jurist që do të trajtojë çështjen përpara gjykatës kombëtare, kërkohet bashkërendim i veprimeve. Problemet mund të nisin nëqoftëse urdhri i Dhomës Gjyqësore që transferon çështjen nuk përmban ndonjë dispozitë që lejon transferimin e dosjeve të mbrojtjes tek avokatët e rinj të Mbrojtjes. Meqenëse Tribunali mund të mos ketë juridiksion pas nxjerrjes së urdhrit, është e domosdoshme të garantohet që urdhri i nxjerrë të trajtojë edhe këtë çështje. Kjo çështje mund të zgjidhet duke u siguruar që rregullat që i përkasin caktimit të avokatit mbrojtës si edhe kodi përkatës i etikës, të përfshijnë një dispozitë të veçantë, ku të trajtohet detyrimi që avokati mbrojtës i Tribunalit ka përkundrejt juridiksionit të ri. Në urdhrin e nxjerrë prej Tribunalit, ku ai ia transferon çështjen gjykatës kombëtare, Dhoma Gjyqësore duhet të theksojë detyrimin që ka avokati mbrojtës i Tribunalit për transferimin e dosjeve të mbrojtjes. Sidoqoftë, është e nevojshme që Tribunali të njohë dhe të kuptojë detyrimet që figurojnë në kodin kombëtar përpara se çështja në fjalë të transferohet. Për shembull, një dispozitë e Kodit të Procedurës Penale të BH-së thekson se palët kanë një afat shtatë-ditor për depozitimin e dosjeve paraprake pas konfirmimit të aktakuzës nga Gjykata e Shtetit. Me përjashtim të rasteve kur i akuzuari e ka tashmë një avokat pranë gjykatës shtetërore qysh përpara transferimit të tij, për avokatin e ri do të ishte e vështirë ose e pamundur t'i përmbahej këtij afati, veçanërisht në rastet kur avokati i ri nuk është i familjarizuar me çështjen dhe/ose nuk disponon dosjet e mbrojtjes. Për më tepër, meqenëse disa çështje paraprake të aktakuzës mund të jenë trajtuar, tashmë, para Tribunalit, do të ishte më se e kuptueshme që një avokat, i cili ka dijeni rreth çështjeve paraprake, të përcaktojë nëse këto çështje duhet të ngrihen para juridiksionit të brendshëm kombëtar. Në rast se një avokat mbrojtës lejohet t'i bashkohet ekipit të mbrojtjes në Hagë, përpara ose gjatë periudhës së transferimit të çështjes, si Tribunali ashtu edhe gjykata kombëtare mund të kursejnë kohë dhe burime.

C.3.3 Ndihma ligjore gjatë periudhës kalimtare

29. Lidhur me skemën e ndihmës ligjore mund të shqyrtohen një numër elementesh dhe kjo në varësi të faktit nëse Tribunali pret që avokati mbrojtës do të vazhdojë ose jo të ndjekë çështjen edhe pas transferimit të saj. Në veçanti, në rast se Tribunali do të ketë një angazhim financiar, ai duhet të përcaktojë një periudhë kalimtare minimale dhe maksimale. Në këtë drejtim nuk ka garanci nëse gjykatat kombëtare do të pajtohen me vlerësimet e Tribunalit lidhur me gjendjen ekonomike të të akuzuarit. Për më tepër, pika e kontaktit duhet të sqarojë kërkesën e përkatësisë së nënshtetësisë për avokatët që kërkojnë të drejtën e audiencës përpara

gjykatave kombëtare. Në rast se këto kërkesa mbeten në fuqi, pika e kontaktit duhet të sqarojë nëse këto kërkesa mund të shmangen për çështje që vijnë të transferuara nga Tribunali.

C.4 Kërkesat për ndihmë dhe për ndryshimin e materialit të mbrojtur

30. TPNJ-ja ka shfrytëzuar maksimalisht, mbi bazën e Rregullës *11bis,* mundësinë e transferimit të çështjeve me akuzë të ngritur prej saj drejt juridiksioneve kombëtare. Në këtë drejtim TPNJ-ja nuk i ka pranuar të gjitha kërkesat për transferim dhe për pasojë, shanset për transferim të kësaj kategorie të parë çështjesh, janë shteruar. Megjithatë, Tribunali ka vazhduar të jetë i angazhuar në dhënien e ndihmës juridiksioneve kombëtare në dy kategori të tjera çështjesh: çështje që janë hetuar në nivele të ndryshme nga Zyra e Prokurorit të Tribunalit, por që nuk kanë rezultuar në ngritjen e një aktakuze nga ana e Tribunalit, të cilat njihen edhe si çështjet e "kategorisë 2"; dhe çështjet e hetuara dhe të vëna në lëvizje nga gjykatat kombëtare, të cilat njihen si çështje të "kategorisë 3".

31. Kur gjykatat kombëtare kërkojnë qasje ndaj materialit të TPNJ-së, kërkesa i paraqitet Sekretarisë në formën e një Kërkese për Ndihmë. Për bashkërendimin e përgjigjeve ndaj kërkesave të tilla nga institucionet gjyqësore/të zbatimit të ligjit, është krijuar një pikë kontakti e Sekretarisë gjyqësore. Sekretaria gjyqësore nuk ka një zyrë cilësisht të përcaktuar si Zyra e Përpunimit të Kërkesave për Ndihmë; megjithatë, si rrjedhojë e shtimit të kërkesave të kësaj natyre, Tribunali po shqyrton mundësinë e krijimit të një zyre të tillë për të plotësuar më mirë kërkesat e gjykatave kombëtare. Përpunimi i këtyre kërkesave ka dhënë të kuptohet se gjykatat kombëtare mund të kërkojnë një qasje të mëtejshme ndaj materialeve që i nënshtrohen masave mbrojtëse, bërja e njohur e të cilave është e ndaluar. Për rrjedhojë, në shkurt 2007, Rregulla 75(H) u ndryshua, për të bërë të mundur plotësimin e kërkesave në këtë drejtim, me kusht që këto kërkesa duhet të bëhet nga autoritetet kombëtare. Ky modifikim i ri i Rregullores përbën një hap themelor drejt mundësisë për të lejuar palët e treta të kenë qasje ndaj materialeve të rezervuara, duke mundësuar që ato të përdoren nga juridiksionet kombëtare dhe të ndihmojnë kështu ushqimin e një partneriteti mes juridiksioneve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare.

XIV. Shërbimet e Ndihmës Gjyqësore

A. Njësia e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara.....190
A.1 Informimi i personelit të Njësisë së Paraburgimit mbi njerëzit e ndaluar.....190
A.1.1 Shëndeti i të ndaluarve.....191
A.1.2 Pacientët mjekësorë dhe çështjet e besimit tek personeli.....191
A.2 Mungesa në Gjykatë për arsye mjekësore.....192
A.3 Punësimi i personelit dhe financimi i NjPKB-së.....192
A.4 Marrëdhënia e NjPKB-së me procesin gjyqësor 193
A.4.1 Problemet mjekësore.....193
A.4.2 Kushtet për të ndaluarit në NjPKB.....193
A.4.3 Veçimi dhe izolimi i të ndaluarve.....194
A.4.4 Planifikimi i lirimeve të përkohshme dhe kthimeve në NjPKB.....194
A.5 Burimet dhe siguria e Teknologjisë së Informacionit. .194
A.6 Politikat që synojnë normalizimin e jetës së të paraburgosurve.....195
A.6.1 Regjimi ditor.....195
A.6.2 Komunikimi dhe vizitat.....195
A.6.3 Ushtrimi fizik dhe dalja në ajër të pastër.....195
A.6.4 Komfortet kulturore.....195
A.7 Shpërndarja e të ndaluarve.....196
B. Shërbimet e përkthimit dhe interpretimit.....196
B.1 Menaxhimi i përkthimit dhe interpretimit në gjyqet ndërkombëtare penale.....196
B.1.1 Sfidat e interpretimit.....196
B.1.2 Sfidat e përkthimit me shkrim.....197
B.2 Referencat dhe terminologjia.....199
B.3 Zyra e Menaxhimit të Dokumenteve.....199
B.4 Raportimi gjyqësor.....199
C. Bashkëpunimi me Shtetin Pritës 200
C.1 Akomodimi i tribunaleve penale ndërkombëtare.....200
C.2 Dispozitat e posaçme të marrëveshjeve me Shtetin Pritës - juridiksioni dhe hyrja në Shtetin Pritës.....200
C.3 Mjediset e paraburgimit.....201
C.4 Hapësirat e punës.....201
C.5 Zbatimi i dënimeve dhe lirimi i personave të shpallur të pafajshëm.....201
C.6 Rivendosja e dëshmitarëve.....202
C.7 Parrezikshmëria dhe siguria.....202
C.8 Menaxhimi i marrëdhënieve me Shtetin Pritës.....202
D. Komunikimi.....203
D.1 Konsideratat hyrëse.....203
D.2 Komunikimi me masmediat dhe bazën.....204
D.3 Personeli i komunikimit.....205
D.4 Kanalet e komunikimit.....205
D.5 Komunikimi dhe ndërgjegjësimi.....206
D.5.1 Sfidat që dalin nga një Program Komunikimi dhe Ndërgjegjësimi.....207
E. Seksioni i Viktimave dhe Dëshmitarëve.....208
E.1 Njësia operacionale.....208
E.1.1 Vizat për të udhëtuar për në Holandë.....209
E.1.2 Ndihma për dëshmitarët në terren.....209
E.1.3 Strehimi në Hagë.....210
E.1.4 Kohëzgjatja e qëndrimit të dëshmitarëve në Hagë 210
E.1.5 Pagesat.....211
E.2 Njësia e Ndihmës.....211
E.2.1 Ndihma profesionale psikosociale dhe vlerësimi i nevojave të dëshmitarëve.....211
E.2.2 Përshtatja e dëshmitarit mjedisit të ri dhe takimet e para ndërmjet dëshmitarit dhe avokatëve të tyre....212
E.2.3 Monitorimi i vazhdueshëm i mirëqenies së dëshmitarit.....212
E.2.4 Simptomat e pas-traumës.....213
E.2.5 Vijimi i kontakteve me dëshmitarët pas dhënies së dëshmisë.....213
E.3 Njësia e Mbrojtjes.....214
E.3.1 Mbrojtja e dëshmitarëve në gjykatë.....214
E.3.2 Mbrojtja e dëshmitarëve jashtë sallës së gjykimit 215
E.4 Konsideratat përfundimtare.....217

1. Aktivitetet gjyqësore të asnjë tribunali ndërkombëtar nuk mund të funksionojnë me efikasitet pa ndihmën dhe bashkëpunimin e ngushtë me seksionet administrative të tribunalit. Eksperienca ka treguar se është me rëndësi kritike që të kryhen konsultime të vazhdueshme ndërmjet seksioneve të ndryshme të tribunalit dhe të bashkërendohen përpjekjet për të zbatuar me efekt dhe efikasitet urdhrat dhe vendimet e gjykatës. Çdo çështje administrative që mund të dalë në lidhje me aktivitetet gjyqësore të TPNJ-së shqyrtohet nga Sekretaria e cila e ka për detyrë ligjore t'i japë ndihmë operacionale Dhomave dhe Zyrës së Prokurorit.[336]

336 Neni 17, Statuti i TPNJ-së përcakton se "Sekretaria do të jetë përgjegjëse për administrimin dhe shërbimin ndaj Tribunalit Ndërkombëtar."

2. Ky kapitull ka për synim të vërë në dukje shërbimet e ndryshme që ofron Sekretaria që janë të pazëvendësueshme për aktivitetet gjyqësore të TPNJ-së, dhe të përshkruaj mësimet e mësuara nga eksperiencat e Sekretarisë.

A. Njësia e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara

3. Njësia e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara (NjPKB) është një qendër ndalimi nën mbikëqyrjen e Sekretarisë së TPNJ-së dhe ndodhet brenda një burgu holandez pak kilometra larg nga selia e Tribunalit. Të ndaluarit përfshijnë të akuzuar që mbahen para dhe gjatë gjykimit dhe apelit, persona të dënuar që presin transferimin në shtetin që do të bëjë zbatimin e dënimit, dëshmitarë të ndaluar dhe persona të akuzuar për shpërfillje. Deklarata e misionit të NjPKB-së është:

> *Të monitorojë dhe ruajë mirëqenien fizike dhe emocionale të të gjithë të ndaluarve, që presin ose janë duke u gjykuar përpara TPNJ-së, duke pasur parasysh pandehmën e pafajësisë, mbrojtjen e dinjitetit të tyre si qenie njerëzore, mbrojtjen e të drejtave të tyre si individë në mënyrë që ata të mund të kuptojnë dhe të marrin pjesë në procesin në Tribunal.*[337]

4. Regjimi rregullator i NjPKB-së përfshin rregulla dhe rregullore të tilla si Rregullorja e Paraburgimit, Rregullorja për Krijimin e Procedurës së Ankesave nga të Ndaluarit ("Procedura e Paraburgimit"), Rregullorja për Krijimin e Procedurave Disiplinore për të Ndaluarit, Rregullorja për Drejtimin e Mbikëqyrjes së Vizitave dhe Komunikimeve me të Ndaluarit dhe Rregullorja e Brendshme për të Ndaluarit. Urdhrat e Procedurat e Punës (UPP-të) përdoren për të përcaktuar se si të zbatohet Rregullorja e Paraburgimit dhe rregulloret e tjera të NjPKB-së. Urdhrat e Procedurat e Punës ofrojnë kuadrin bazë dhe shpjegime dhe zbërthejnë procedurat që duhet të zbatojë personeli ndërkohë që kryen detyrën në NjPKB.

5. Regjimi rregullator dhe UPP-të janë zhvilluar gjatë një periudhe kohore, duke marrë parasysh nevojat dhe kërkesat e procesit gjyqësor, veçoritë e popullatës së të ndaluarve, dhe karakteristikat unike të vetë NjPKB-së si një qendër ndalimi për një gjykatë ndërkombëtare të krimeve. Regjimi dhe UPP-të japin një kuadër të provuar dhe të testuar që aktualisht po përmirësohet për të siguruar mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të të ndaluarve dhe mbrojtjen e personelit të Paraburgimit gjatë detyrës së tyre. Pjesa më poshtë nxjerr në pah se si NjPKB-ja i është përshtatur ndryshimeve të misionit të saj.

A.1 Informimi i personelit të Njësisë së Paraburgimit mbi njerëzit e ndaluar

6. Puna e NjPKB-së udhëhiqet nga pandehma e pafajësisë, dhe parimi i respektit ndërmjet personelit dhe të ndaluarve. Monitorimi i të ndaluarve është një aspekt kritik i detyrës së NjPKB-së. Eksperienca ka treguar se i gjithë personeli i NjPKB-së duhet të njohë aspektet individuale të secilit të ndaluar. Njerëzit e ndaluar të vendosur në NjPKB kanë një profil unik i cili informon dhe përcakton punën dhe fokusin e NjPKB-së.
   - të ndaluarit nuk janë kriminelë të zakonshëm;
   - shumicës së të ndaluarve ju është hequr liria e tyre për herë të parë;
   - të ndaluarit mbahen në paraburgim për një periudhë të gjatë;
   - të ndaluarit janë më të vjetër se të burgosurit e zakonshëm në një institucion burgimi, kanë më pak mekanizma përballimi për të mbijetuar në mjedisin e burgut, dhe kanë moshë të thyer e probleme të ndërlikuara mjekësore;

337 Deklarata e Misionit është vendosur në një dokument të politikës së NJNKB-së.

- shumica e të ndaluarve kanë (ose kanë pasur) statuse të rëndësishme ose të larta në vendet ose rajonet e tyre;
- shumë nga të ndaluarit kanë një intelekt më të lartë se mesatarja kur krahasohet me atë të të ndaluarve kombëtarë;
- ka një interes të madh të medias për TPNJ-në dhe çështjet individuale;
- largësia nga shtëpitë, familjet, rrjeti familjar i ndihmës sociale, mjedisi kulturor dhe mungesa e familjaritetit me rrethin janë të konsiderueshme;
- duhet marrë parasysh gjendja psikologjike e secilit të ndaluar.

7. Në pajtim me profilin e mësipërm dhe pandehmën e pafajësisë, politika e NjPKB-së është që të lehtësojë normalizimin e jetës së përditshme të të ndaluarve aq sa është e mundshme dhe të shmangë masat kufizuese kur nuk janë të nevojshme.

A.1.1 Shëndeti i të ndaluarve

8. Shëndeti i të ndaluarve është një element kritik për çdo gjykatë ose tribunal ndërkombëtar, dhe një faktor i rëndësishëm për procese efikase gjyqësore. Menaxhimi i NjPKB-së është përpjekur të plotësojë kërkesat në rritje për kujdes shëndetësor të të ndaluarve. Edhe pse NjPKB-ja është një institucion ndalimi, periudha mesatare e Paraburgimit është shumë më e gjatë se në shumicën e institucioneve kombëtare të Paraburgimit, dhe ndoshta më e gjatë se ajo e institucioneve të zakonshme ndëshkimore. Kjo situatë ka një ndikim të dëmshëm mbi gjendjen mendore të të ndaluarve ndërkohë që ata kalojnë nëpër gjykime e apelime gjatë një periudhë të gjatë kohe. Kushtet mund të shkaktojnë stres afatgjatë dhe mund të shkaktojnë ose përkeqësojnë problemet shëndetësore. Po ashtu, mosha mesatare e të ndaluarve të NjPKB-së aktualisht është 57 vjeç,[338] që është shumë më e lartë se në institucionet kombëtare të Paraburgimit. Shumica e të ndaluarve mbërrijnë në NjPKB me probleme të ndryshme shëndetësore që i kanë pasur më parë për shkak të moshës së tyre.

9. Të ndaluarit shpesh vuajnë nga probleme shëndetësore për shkak të çështjeve të stilit të mëparshëm të jetesës dhe moshës së thyer.[339] Çrregullimi nga Stresi Post-Traumatik (PTSD) dhe çrregullime të tjera psikiatrike janë shumë të zakonshme. Për shkak të natyrës së PTSD-së dhe çrregullimeve psikiatrike, krijimi i marrëdhënieve personale me të ndaluarit gjatë ofrimit të ndihmës mjekësore bëhet kritik.

10. Si rezultat i këtij profili mjekësor, NjPKB-ja është e pajisur për të trajtuar një numër situatash mjekësore tek të ndaluarit. Shërbimi Mjekësor i NjPKB-së ka një klinikë të vogël por tejet të pajisur që kryen diagnostikime dhe trajtime të sëmundjeve dhe lëndimeve të të ndaluarve. Kur pranohen, të gjithë të ndaluarit bëjnë një ekzaminim mjekësor të gjithanshëm për të krijuar një profil gjithëpërfshirës mjekësor që përfshin një komplet të plotë të analizave të gjakut. Kujdesi mjekësor i ofruar nga Shërbimi Mjekësor i NjPKB-së përfshin kujdesin shëndetësor parësor si dhe kujdesin për shëndetin mendor.[340]

A.1.2 Pacientët mjekësorë dhe çështjet e besimit tek personeli

11. Është jetike për funksionimin e NjPKB-në që të ndaluarit të kenë siguri dhe besim tek personeli. Megjithatë, kjo marrëdhënie besimi mund të dëmtohet nga mosbesimi natyral qoftë edhe paranoja e të ndaluarve të arrestuar që janë sjellë në një vend dhe kulturë të huaj, shpesh kundër dëshirës së tyre. Mbajtja sa më larg

338 Më 16 maj 2008, mosha mesatare e 41 të ndalurave në paraburgim në Njësinë e Paraburgimit ishte 56.5 vjeç.

339 Pas moshës 40 deri 45, zgjedhjet jo të mira të jetës së mëparshme fillojnë të ndikojnë në shëndet. Çështjes e stilit kulturor të jetës dhe mjediset stresuese gjatë konfliktit në Ballkan (p.sh., dieta tradicionale, pirja e duhanit, pirja e alkoolit, stresi, mungesa e ushtrimeve, pozitat e larta të përgjegjësisë, lufta) kanë ndikim në këtë aspekt.

340 Ky kujdes për shëndetin mendor zgjerohet me shërbimin e një Konsulenti Psikiatër i cili flet rrjedhshëm gjuhën e përbashkët të të ndaluarve, gjë e cila lehtëson ndërlikimet e përkthimit.

që të jetë e mundur nga procesi gjyqësor e Punonjësit Mjekësor[341] dhe ruajtja e fshehtësisë për të gjitha të dhënat mjekësore ndihmon në forcimin e marrëdhënies së besimit.

A.2 Mungesa në Gjykatë për arsye mjekësore

12. Një i paraburgosur nganjëherë është tejet i sëmurë për t'u paraqitur në gjykim dhe për këtë arsye politika e TPNJ-së lejon që një i paraburgosur të mungojë. Meqenëse të akuzuarit e TPNJ-së kanë të drejtën të jenë të pranishëm në procesin gjyqësor, heqja dorë nga kjo e drejtë duhet të jetë vullnetare dhe e informuar. Kur kërkohet heqja dorë duhet të kryhet një proces zyrtar. I ndaluari duhet të deklarojë se ai nuk mund të ndjekë procesin gjyqësor për shkak të sëmundjes pas të cilës avokati mbrojtës duhet ta njoftojë atë për pasojat e mungesës nga procesi gjyqësor. Pas kësaj firmoset një dokument i heqjes dorë nga i paraburgosuri në praninë si dëshmitar të një oficeri kryesor. Një anëtar i personelit të shërbimit shëndetësor të NjPKB-së duhet të nënshkruajë një dokument që vërteton se është kryer ekzaminimi i të ndaluarit.[342] Personeli mjekësor duhet të veprojë me kujdes kur jep këtë informacion në mënyrë që të ruajë vazhdimësinë e trajtimit dhe të shmangë kontaktet me procesin gjyqësor i cili mund të prekë marrëdhënien kritike të sigurisë dhe besimit ndërmjet mjekut dhe pacientit.

13. Qëllimi i kësaj procedure është që të sigurohet se interesat e drejtësisë janë përmbushur kur të ndaluarit nuk janë në gjendje të ndjekin procesin gjyqësor për shkak sëmundjeje, të mbrojë të drejtat e të akuzuarit që të ndjekë procesin gjyqësor dhe të mbrojë efikasitetin dhe integritetin e procesit, veçanërisht të drejtën për gjykim pa vonesa të panevojshme e të çdo të bashkë-akuzuari.

A.3 Punësimi i personelit dhe financimi i NjPKB-së

14. Ndërkohë që mjediset ndodhen brenda Burgut Pritës, NjPKB-ja ka një strukturë komanduese autonome përfshi personelin e punësuar nga TPNJ-ja dhe oficerët e Paraburgimit të huazuar nga ana e TPNJ-së nga tri qeveri kombëtare. TPNJ-ja ka negociuar me qeverinë e Holandës që të krijojë një marrëveshje për Burgun Pritës, dhe të ofrojë të gjitha shërbimet dhe mjediset e duhura për të zbatuar programin e Paraburgimit për të plotësuar kërkesat e TPNJ-së. Është përcaktuar një çmim për ditë për qeli që përfshin nivelin e shërbimit dhe mjediset e kërkuara nga NjPKB-ja, d.m.th., vendqëndrimin, pajisjet, mirëmbajtjen, shërbimet për të ndaluarit – vaktet e ngrënies, ajrin e pastër, sportet, dhe arsimimin.

15. Shërbimet dhe mjediset e kërkuara nga NjPKB-ja përfshijnë ofrimin e oficerëve të Paraburgimit të cilët janë zgjedhur nga drejtuesit e NjPKB-së në mesin e kandidatëve, dhe janë përgjegjës para drejtuesve të NjPKB-së për çështjet operacionale, por qëndrojnë brenda Shërbimit Holandez të Burgjeve për qëllime administrative. Kjo marrëveshje ka qenë shumë e dobishme për shkak të një numri të madh në dispozicion që të oficerëve me kualifikime të larta dhe specialistë të Paraburgimit në një shtet i cili promovon menaxhimin e mirë të burgjeve.

16. Si pasojë, pjesa më e madhe oficerëve të Paraburgimit merren nga shërbimi holandez. Megjithatë, ka qenë me shumë përfitim marrja e oficerëve shtesë ndalimi nga vende të tjera në mënyrë që të sigurohet mjedis konkurrues dhe të ruhet karakteri ndërkombëtar. Pasja e një personeli shumëkombësh do të thotë se cilësitë

---

341 Pjesa e përcaktimeve të Rregullave të Paraburgimit përcakton se "Punonjësi Mjekësor për momentin emërohet me marrëveshje ndërmjet Sekretarit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgut Pritës." Rregullorja e Procedurës dhe Provave e TPNJ-së, Rregulla 34 B e më tej përcakton se "punonjësi mjekësor duhet të kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të të ndaluarve dhe duhet të vizitojë rregullisht ose kur është e nevojshme të gjithë të ndaluarit e sëmurë, të gjithë ata që ankohen për sëmundje dhe çdo të ndaluar që i tërheq vëmendjen veçanërisht."

342 Shiko Mungesa në Gjyq për shkak të sëmundjeve. Dokumenti i heqjes dorë lejon anëtarin e personelit të shërbimit mjekësor të nxjerrë në pah rëndësinë e sëmundjes si dhe kohën e pritshme të mungesës, duke lejuar Dhomën të marrë vendime të informuara në lidhje me procedimet.

më të mira të secilit pjesëtar të personelit mund të kultivohen dhe puna e tyre plotëson njëri-tjetrin, duke krijuar një rrjet më efikas të oficerëve të Paraburgimit. Kjo kontribuon në krijimin e një procesi të vetë-rregullimit dhe sigurimin e standardeve të larta të shërbimit brenda NjPKB-së.

A.4 Marrëdhënia e NjPKB-së me procesin gjyqësor

17. NjPKB-ja nuk luan një rol aktiv në procesin gjyqësor. Roli i saj është thjesht ndihmës. Profili i të ndaluarit së bashku me afërsinë e tri organeve të TPNJ-së, gjegjësisht, Dhomave, Zyrës së Prokurorit dhe Sekretarisë, dhe mbrojtjes shkakton shumë probleme të Paraburgimit që duhen ngritur në arenën gjyqësore. Problemet shëndetësore, kulturore dhe të statusit shpesh ndikojnë mbi procesin gjyqësor. Për këtë arsye, problemet e Paraburgimit ngrihen shpesh në arenën gjyqësore dhe menaxhimi i NjPKB-së mundet dhe duhet të reagojë shumë shpejt ndaj problemeve gjyqësore që dalin. UPP është treguar mënyrë tejet efektive e dokumentimit të çështjeve procedurale dhe arsyeve për to.

A.4.1 Problemet mjekësore

18. NjPKB-ja ka pasur vështirësi në krijimin e një mekanizmi të kënaqshëm që trajton problemet mjekësore në arenën gjyqësore. TPNJ-ja ka trajtuar situata të ndryshme kur ka pasur dyshime në lidhje me shëndetin e të ndaluarve. Këto situata përfshijnë aplikime për lirime të përkohshme për trajtime mjekësore, dhe mungesë të zgjatur nga gjykata për shkak të sëmundjeve, grevave të urisë, etj. Pa dyshim, Dhomave ose palëve ju duhet informacion i mëtejshëm rreth shëndetit të një të ndaluari në mënyrë që të shqyrtohen çështjet ligjore që përfshijnë shëndetin dhe aftësinë e të ndaluarit për të ndjekur gjykimin ose nevojën për lirim të përkohshëm për të marrë trajtime jashtë Holandës. Në përgjithësi, sipas Rregullores të Paraburgimit, informacioni mjekësor duhet të mbahet i fshehtë nga Sekretari përveçse kur publikimi bëhet me miratimin e të ndaluarit. Megjithatë, një Gjykatës ose një Dhomë mund të urdhërojë publikimin në interes të drejtësisë, ose administrimit të mirë të gjykimit, pas konsultimit me punonjësin mjekësor të NjPKB-së. Sikurse çdo marrëdhënie ndërmjet mjekut dhe pacientit, duhet të ketë një nivel të lartë besimi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në marrëdhëniet midis punonjësve mjekësorë dhe specialistëve mjekësorë të NjPKB-së dhe të ndaluarve/pacientëve të cilët ata trajtojnë. Nëse të ndaluarit/pacientët mendojnë se publikimi mund të bëhet edhe pa miratimin e tyre, edhe pse është urdhëruar nga një gjykatë, marrëdhënia e besimit mund të thyhet. Ky rrezik lehtësohet nëse caktohen ekspertë të pavarur mjekësorë (që nuk janë pjesë e trajtimit) për të ekzaminuar të ndaluarin dhe të paraqesin një raport për Dhomat dhe/ose palët. Kjo procedurë është në dispozicion sipas Rregullës *74bis* të Rregullores së Procedurës dhe Provave.

A.4.2 Kushtet për të ndaluarit në NjPKB

19. Një shembull tjetër i marrëdhënieve të NjPKB-së me procesin gjyqësor është kur Gjykatësi urdhëron NjPKB-në të ofrojë kushte të jashtëzakonshme për të ndaluarit, për shembull kushte “të privilegjuara” për të akuzuar që përfaqësojnë veten, të tilla si kompjuter, hapësirë më të madhe në qeli, lehtësira që nuk janë në dispozicion të të ndaluarve të tjerë. Marrëveshje të tilla mund të ndikojnë në parrezikshmërinë, sigurinë ose organizimin e brendshëm të NjPKB-së. Prandaj, këshillohet të bëhen konsultime të mëparshme me NjPKB-në në mënyrë që çështjet e parrezikshmërisë dhe sigurisë të mund të identifikohen, dhe fizibiliteti i tyre i përbashkët të mund të ekzaminohet përpara lëshimit të urdhrit. Një konsultim i tillë mundëson NjPKB-në dhe gjykatën të adresojë çështjet e parrezikshmërisë dhe sigurisë që mund të ndalin nga urdhri i gjyqit.

A.4.3 Veçimi dhe izolimi i të ndaluarve

20. Urdhrat për veçim dhe izolim,[343] të cilat rregullohen sipas Rregullores së Paraburgimit, mund të përfitojnë nga konsultimi i mëparshëm me NjPKB-në për ndikimin e tyre mbi parrezikshmërinë, si dhe sigurinë dhe organizimin e brendshëm të NjPKB-së.

A.4.4 Planifikimi i lirimeve të përkohshme dhe kthimeve në NjPKB

21. Eksperienca e TPNJ-së ka treguar se planifikimi i lirimit të përkohshëm, dhe kthimi i të ndaluarve në NjPKB, kërkon organizime të konsiderueshme logjistike nga drejtuesit e NjPKB-së. Datat e largimit dhe kthimit janë informacion i ndjeshëm sigurie, dhe çdo përmendje në publik e planit përpara se të jetë bërë transferimi, mund të kompromet ojë lëvizjen e personave të ndaluar në NjPKB. Lëvizjet gjatë fundjavës si dhe kthimet në mbrëmje krijojnë probleme shtesë me logjistikën dhe personelin e NjPKB-së, dhe konsultimi përpara se të lëshohet urdhri mund të ndihmojë që të shmangen këto ndërlikime. Këshillohet në përgjithësi që kthimi të bëhet të paktën një javë përpara se të fillojë gjyqi për të lejuar kohë të mjaftueshme që drejtuesit e NjPKB-së të sqarojnë problemet logjistike dhe mjekësore që dalin me kthimin e të ndaluarit në NjPKB. Megjithatë, për shkak se kthimi mund të ndikohet nga rrethanat dhe gjendja mjekësore e personit të ndaluar, këshillohet që konsultimi me NjPKB-të bëhet përpara. Gjithashtu kthimet duhet që mundësisht të ndodhin në fillim të javës pasi NjPKB-ja duhet të bëjë ekzaminime mjekësore pas kthimit të të ndaluarit. Për këto arsye, këshillohet që të flitet me NjPKB-në përpara lëshimit të një urdhri.

A.5 Burimet dhe siguria e Teknologjisë së Informacionit

22. NjPKB-ja duhet të mbajë sigurinë kur vendos nëse duhet të lejojë të ndaluarit të përdorin teknologjinë e informacionit. Në të njëjtën kohë, parimi “i barazisë së armëve” kërkon që të ndaluarit të mund të shikojnë materiale për të bërë mbrojtjen e tyre, përfshi mundësinë për të rishikuar një sasi tepër të madhe materialesh të publikuara nga Prokuroria në formate të kërkueshme digjitale.

23. “Politika e brendshme në lidhje me përdorimin e kompjuterëve në NjPKB dhe transferimi i informacionit në vartësi të privilegjit të avokatit-klientit" përcakton procedurat që rregullojnë përdorimin e kompjuterëve si nga të ndaluarit ashtu dhe nga avokati, dhe procedurat e transferimit të informacionit të ruajtur në letër dhe në media digjitale. Rregullat përcaktojnë që materialet e përdorura në mbështetje të aktpadisë dhe deklaratave të dëshmitarëve të prokurorisë duhet t'i jepen mbrojtjes në një gjuhë që i akuzuari e kupton.[344] Sekretaria ka përcaktuar se mënyra më efikase, transparente dhe gjithëpërfshirëse për t'i pasur në dispozicion është që kompjuterët të vihen në dispozicion të të ndaluarve.[345] Çdo të ndaluari i jepet një kompjuter individual dhe ato vendosen në qelitë e tyre individuale. Ajo që është kritike është se këta kompjuterë kontrollohen nga NjPKB-ja dhe bllokohen për të ndaluar çdo përdorim të paautorizuar të hyrjes në internet.

24. Transferimi i informacionit është tejet i rregulluar dhe avokatët lejohen t’i transferojnë klientit të tyre vetëm media që nuk është në letër nëse përmban material të përshtatshëm për mbrojtjen e klientit të tyre përpara TPNJ-së. Përdorimi i kompjuterëve dhe transferimi i informacionit i nënshtrohet “Marrëveshjes në Lidhje me Procedurat dhe Kushtet për Përdorimin e Kompjuterëve dhe Informacionit në Media Digjitale në Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara" (Marrëveshja). Marrëveshja shpjegon detyrimet e të ndaluarve dhe avokatëve të mbrojtjes, dhe veprimet e menaxhimit të NjPKB-së, dhe duhet të nënshkruhet nga të tre palët.

343 Rregullat 40 deri 49 të Rregullave të Paraburgimit të TPNJ-së.
344 Rregulla 66(A) TPNJ RrPD.
345 Marrëveshjet në Lidhje me Procedurat dhe Kushtet për Përdorimin e Kompjuterëve dhe Informacionit në Media Digjitale në Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara §1.2.

25. Pajisjet periferike, përfshi printerët, nuk mund të lidhen me kompjuterët dhënë të ndaluarve dhe për këtë arsye janë krijuar vende printimi në secilin bllok banimi të NjPKB-së për t'i lejuar të ndaluarit të prodhojnë kopje në letër të dokumenteve. Të ndaluarit mund të marrin trajnim bazë dhe ndihmë teknike për teknologjinë e informacionit.

A.6 Politikat që synojnë normalizimin e jetës së të paraburgosurve

A.6.1 Regjimi ditor

26. Regjimi ditor i NjPKB-së është i bazuar mbi politikën e të qenit të hapur. Nëse një i paraburgosur nuk është në gjykim, ai mund të lëvizë lirshëm në pjesën e tij të NjPKB-së për pjesën më të madhe të ditës. Të ndaluarit mund të shoqërohen dhe për shembull mund të gatuajnë ushqime së bashku. Ofrohen edhe mësime edukative në lëndë të tilla si gjuhë, njohuri bazë mbi kompjuterët dhe krijimtari.

A.6.2 Komunikimi dhe vizitat

27. Drejtuesit e NjPKB-së janë në gjendje të komunikojnë direkt me të ndaluarit nëpërmjet përkthyesve të personelit të cilët flasin gjuhën amtare të të ndaluarve. Mundësia e të ndaluarve për të komunikuar në gjuhën e tyre ndihmon në zbutjen e ndryshimeve kulturore. Të ndaluarit që mbërrijnë në NjPKB shpesh kanë ndjenja paranoje dhe nervoze, dhe kanë frikë nga abuzimi si rezultat i influencës së medias në rajon. Mundësia e të ndaluarve për të komunikuar në gjuhën e tyre ndihmon në krijimin e marrëdhënieve të respektueshme dhe të besueshme me drejtuesit e NjPKB-së.

28. Komunikimet e të ndaluarve me personat jashtë NjPKB-së, nëpërmjet vizitave, telefonatave dhe postës nxiten në një përpjekje për të normalizuar marrëdhëniet e të ndaluarve me familjen dhe strukturat e mbështetjes. NjPKB-ja e ka parasysh pandehmën e pafajësisë, dhe është e vetëdijshme për tensionin mbi familjet gjatë periudhave të Paraburgimit, veçanërisht për shkak të largësisë nga vendet e tyre amtare. Vizitat i lejojnë të ndaluarit të normalizojnë sistemin e mbështetjes së familjes së tyre dhe për këtë arsye ato nxiten. Të ndaluarve ju lejohen deri shtatë ditë të plota të njëpasnjëshme vizitash në çdo periudhë tridhjetë ditore, përfshi vizitat bashkëshortore. Vizitat ditore mund të jenë deri në tetë orë të gjata.

A.6.3 Ushtrimi fizik dhe dalja në ajër të pastër

29. Për shkak të gjendjes të dobët fizike dhe mendore të shumë të ndaluarve, si dhe moshës së tyre të thyer, është e rëndësishme t'u jepet mundësia për ushtrim fizik, edukim dhe praktikim shpirtëror si pjesë e një sistemi të mbajtjes të shëndetshëm të të ndaluarve. Të ndaluarit nxiten të ushtrojnë fizikisht dhe të ruajnë shëndet të mirë nëpërmjet vendeve të ndryshme për ushtrim fizik brenda NjPKB-së. Të ndaluarit mund të shkojnë në palestër, në dhomën e peshëngritjes dhe në dhomën e ushtrimeve kardiovaskulare. Të ndaluarit mund të përdorin një shesh të sigurt jashtë ku kanë mundësi të ushtrojnë, të kujdesen për bimët dhe të shoqërohen. Një “kafaz ajri” më i sigurt po ashtu është në dispozicion në NjPKB për t'ju dhënë të ndaluarve dalje në ajër të pastër kur kërkesat e sigurisë për ta e ndalojnë përdorimin e sheshit jashtë.

A.6.4 Komfortet kulturore

30. NjPKB-ja ka mësuar dhe e pranon se lejimi i një mase komforti kulturor për të ndaluarit ndihmon në krijimin e besimit dhe moralit me të ndaluarit. Ofrimi i komforteve kulturore po ashtu është në pajtim me pandehmën e pafajësisë dhe ndihmon për të siguruar normalizimin e jetës së përditshme të të ndaluarve. Kanalet televizive satelitore nga rajoni i ish-Jugosllavisë përforcojnë procesin e normalizimit dhe ju japin të ndaluarve ndjenjën se janë më afër mjediseve të shtëpisë së tyre dhe për këtë arsye ulet ndjenja e izolimit dhe depresionit.

A.7 Shpërndarja e të ndaluarve

31. Një faktor i rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit dhe rendit në NjPKB është aftësia për të përzierë të ndaluarit në grupe që mund të përshtaten dhe të funksionojnë në një mjedis të respektueshëm dhe në të njëjtën kohë të ruaj aftësinë për të veçuar disa të ndaluar për arsye sigurie ose gjyqësore. NjPKB-ja është ndarë në një numër blloqesh banimi që i lejojnë drejtuesit e NjPKB-së të krijojnë grupime banimi të të ndaluarve secili prej të cilëve funksionon si një njësi. Grupimet e të ndaluarve nuk janë bazuar mbi dallimet etnike, por janë formuar për të krijuar një grup të respektueshëm dhe të ndryshëm individësh duke marrë parasysh karakteristikat individuale që secili i paraburgosur sjell në grup. Kjo qasje lejon që çdo individ i paraburgosur të jetojë në një mjedis të respektueshëm, dhe ul potencialin për konflikt ndërmjet personelit dhe të ndaluarve.

B. Shërbimet e përkthimit dhe interpretimit

B.1 Menaxhimi i përkthimit dhe interpretimit në gjyqet ndërkombëtare penale

32. Gjyqet ndërkombëtare penale përfshijnë dëshmitarë të shumtë dhe sasi të mëdha dokumentacioni që kërkojnë interpretim dhe përkthim. Faktorët kohë dhe volum ndikohen edhe më tej nga nevoja për të ruajtur cilësinë pavarësisht faktit se bëhet fjalë për disa gjuhë, përfshi gjuhët e rralla, dhe dokumente gjyqësore e prova të tjera që mund të jenë qindra e mijëra faqe.

33. Të gjithë dëshmitarët dhe pothuaj të gjitha dokumentet e përdorura në gjykimet ndërkombëtare penale kërkojnë interpretim dhe përkthim. Meqenëse TPNJ-ja mund të organizojë deri në tetë gjykime të njëkohshme me interpretim në tre, katër ose pesë gjuhë, TPNJ-ja realisht ka qenë në modalitetin e përkthimit simultan çdo ditë pune për më shumë se një dekadë. Rrjedha e Materialeve të provave dhe dokumentet ligjore kryesore që duheshin përkthyer ka qenë e jashtëzakonshme dhe e vazhdueshme.

34. Duke pasur parasysh natyrën serioze të krimeve në fjalë, kompleksitetin e procesit dhe nevojën për të ruajtur qartësinë e gjuhëve dhe konsistencën në terminologji gjatë gjykimeve të gjata dhe të ndërlidhura ngushtë, këto shërbime duhet të jenë të standardit më të lartë.

35. Seksioni i Shërbimeve të Konferencave dhe Gjuhësore (SSHKGJ) funksionon nën Sekretarinë dhe ofron shërbime për të gjitha organet e Tribunalit sipas kërkesave. Ndërkohë që ZP-ja ka personelin e vet ndihmës për gjuhët, ekipet e Mbrojtjes marrin pagesa të ndihmës juridike nga Zyra e Sekretarisë për Ndihmë Juridike dhe Çështje të Paraburgimit, përgjegjëse për përkthimin e të gjitha dokumenteve kryesore dhe shumicës së provave duhet të mbetet brenda SSHKGJ-së.

B.1.1 Sfidat e interpretimit

36. Detyra e ofrimit të interpretimit për deri në tetë gjyqe të njëkohshme, përveç mbulimit të kërkesave të tjera të ndryshme për interpretim (seancave plenare të gjykatësve dhe këshillimeve, seminareve diplomatike, vizitave të nivelit të lartë, etj.) krijon një sfidë të madhe. Gjykimet penale me shumë gjuhë krijojnë në njëfarë mënyre një vend jo të zakonshëm për ushtrimin e interpretimit simultan i cili është më i përshtatshëm për konferencat ndërkombëtare kur folësit paraqesin mendimet e tyre në një mënyrë më të organizuar dhe rrallë herë sfidojnë fjalët e njëri-tjetrit. Po ashtu, në procedimet e TPNJ-së, niveli i pritur i saktësitë dhe plotësisë së mesazhit të përcjellë është shumë më i lartë se në llojet e tjera të institucioneve. Sfidat

përfshijnë nevojën për të punësuar një numër përkthyesish të kualifikuar simultan për gjuhë të "rralla", të tilla si BKS (boshnjakisht-kroatisht-serbisht), shqip dhe maqedonisht, dhe si personeli i brendshëm ashtu dhe ai i jashtëm të mbahet i mirinformuar me çështjet e lëndës së ligjit dhe çështjet përkatëse të terminologjisë së TPNJ-së. Kur bëhet fjala për logjistikën dhe përdorimin optimal të burimeve, natyra e TPNJ-së luan një rol të rëndësishëm për shkak të nivelit të lartë të paparashikueshmërisë së datave të gjyqit dhe ndryshimeve të shpeshta në orarin e gjykatës që e bën të vështirë planifikimin dhe shfrytëzimin e përkthyesve. Përdorimi në rritje i dokumenteve në gjykim krijon një problem tjetër për përkthimin simultan i cili është kryesisht për komunikimin gojor. Për më tepër, ato që zakonisht konsiderohen si teknika përkthimi legjitime, të tilla si parafrazimi, editimi ose heqja strategjike, mund të paraqesë çështje serioze të gjuhës në gjykim dhe mund të konsiderohet nga palët si një gabim në përkthim.

37. Masat që SSHKGJ-ja rekomandon për të mbuluar këto sfida përfshijnë:

- krijimin e një procedure të përshtatshme punësimi si për personelin e përhershëm ashtu dhe atë të jashtëm dhe zbatimin e një sistemi të kontrollit të cilësisë nëpërmjet mësimit të vazhdueshëm dhe këshillimit aktiv; duhet vënë theksi tek mbledhjet e punës mbi terminologjinë dhe leksioneve mbi konceptet ligjore përkatëse.
- ngritjen e një sistemi për kërkimin e shërbimeve të interpretimit, duke identifikuar ata që i bëjnë kërkesat, vendosjen e afateve kohore, dhe organizimin e një sistemi për t'u ofruar interpretuesve dokumente që ju duhen për përgatitje ose për citim.
- lënien në dispozicion të informacionit të bazuar në sistem që nevojitet për të organizuar ofrimin e shërbimeve cilësore të interpretimit , përfshi ndërlidhjen me departamentet e tjera me qëllim marrjen e informacionit të besueshëm mbi llojet e seancave (parashtrime juridike kundrejt dëshmive të dëshmitarëve ose dëshmitarëve ekspertë), lëndën e çështjes që do të diskutohet dhe organizimet e jashtëzakonshme të gjuhës.
- krijimin e një procedure për ndreqjen e gabimeve në interpretim. Kjo procedurë duhet të diskutohet me personelin e duhur të Sekretarisë dhe Dhomës dhe duhet të adresojë çështjet e mëposhtme:
  - Identifikimi i personave që bëjnë kërkesë dhe kanalet e duhura për paraqitjen e kërkesave të verifikimit (mundësisht nëpërmjet Punonjësit të Gjykatës dedikuar çështjes në fjalë).
  - Detajimi i vetë procedurës së verifikimit (nevojën për të ofruar referenca ekzakte, përdorimin e skedarëve audio për qëllime verifikimi, nevojën për të pasur një formular kërkese zyrtare, etj).
  - Lëshimi i korrigjimeve zyrtare dhe caktimi i veprimeve që duhen ndërmarrë më tej (korrigjimi i transkriptimit, arkivimi, etj.)
  - Sensibilizimi i përdoruesve të shërbimeve të interpretimit ndaj natyrës së punës; rritja e ndërgjegjësimit duke përfshirë çështje të interpretimit në procedurat e orientimit për pjesëmarrësit e rinj në proces.

B.1.2 Sfidat e përkthimit me shkrim

38. Eksperienca e Tribunalit tregon se për të menaxhuar me efikasitet kapacitetin e kufizuar të përkthimit, duhen zbatuar dy lloje masash, njëra në fazën e krijimit të një institucioni, dhe tjetra pasi të jetë në funksionim.

39. Masat fillestare përfshijnë:

- vendosja e kritereve më të larta për punësimin e përkthyesve, përfshi procedura rigoroze të testimit, dhe sigurimin e kohës së mjaftueshme për trajnim të vazhdueshëm të brendshëm;
- krijimi i politikave të qarta që rregullojnë kërkesat dhe ofrimin e shërbimeve të përkthimit;
- organizimi i duhur i qarkullimit elektronik të dokumenteve nga dhe tek kërkuesit dhe krijimi i një mekanizmi për të filtruar kërkesat për të eliminuar përkthimet e dyfishta;

- krijimi i një terminologjie të brendshme për çdo drejtim gjuhe dhe konvencione për të zgjidhur të gjitha problemet e përkthimit që hasen shpesh;
- hartimi i udhëzuesve të stilit, fjalorthëve dhe bazave të të dhënave të terminologjisë dhe sigurimi që terminologjia dhe format e adoptuara të përdoren në të gjithë institucionin.

40. Në fazën operative, dhe veçanërisht pasi të kenë filluar gjykimet, është e domosdoshme që shërbimi i përkthimit të bashkëpunojë ngushtë me Dhomat dhe kërkuesit të sigurohen që nevojat e përkthimit të të gjitha palëve të plotësohen në mënyrën më efektive, efikase, të barabartë dhe ekonomike.

41. SSHKGJ-ja duhet të punojë nga afër me kërkuesit për krijuar udhëzime të qarta për paraqitjen e materialeve të dëshmive, duke detajuar llojin e volumeve të dokumenteve të cilat mund dhe duhet të dorëzohen, kriterin dhe metodat për identifikimin dhe zgjedhjen e dokumenteve ose pasazheve nga dokumentet e gjata, formatin më të pranueshëm për dorëzimin e dokumenteve, kohën e kërkesës, caktimin e afateve kohore dhe mënyra të tjera për të siguruar që përkthimet e tyre të bëhen sa më me efektivitet që të jetë e mundur.

42. Në Tribunal janë adoptuar një numër politikash duke pasur këto parasysh:

- Politika e Sekretarisë që Rregullon Shërbimet e Përkthimit ofron udhëzime mbi llojet e dokumenteve që mund të paraqiten për përkthim dhe procedurat për paraqitjen e kërkesave;
- Direktiva e Praktikës mbi Gjatësinë e Dosjeve dhe Mocioneve kufizon gjatësinë e këtyre dokumenteve, pjesërisht në mënyrë që të ulë barrën mbi shërbimet e përkthimit dhe vonesat e rezultuara në proces;
- meqenëse avokatëve të mbrojtës u duhet të flasin të paktën një nga gjuhët zyrtare të Tribunalit, në shumicën e rasteve vetëm disa dokumente (aktpaditë, urdhrat, vendimet dhe gjykimet) duhet të përkthehen në gjuhën e të akuzuarit.

43. Gjykatësit dhe personeli i Dhomave duhet të jenë të mirinformuar rreth kufizimeve të punës së SSHKGJ-së dhe duhet të mbështesin përpjekjet për të zbatuar politikat në lidhje me prioritetin e kërkesave të përkthimit. Është mirë që përfaqësuesit e SSHKGJ-së të takohen me trupin gjykues të gjykimit (ose të paktën me kryegjykatësin) përpara çdo konference për statusin ose seance gjyqësore për të diskutuar problemin e përkthimit, që të sigurohen që gjykatësit të jenë plotësisht në dijeni të kufizimeve të përkthimit dhe të jenë plotësisht të informuar për statusin e përkthimeve në çështjet e tyre.

44. Palët duhen kujtuar: (1) se është përgjegjësia e tyre të kufizojnë kërkesat për përkthimin e provave në dokumentet që ata paraqesin më së fundi si prova dhe të caktojnë prioritetin e këtyre kërkesave për përkthim; dhe (2) se palëve do t'ju jepen burime specifike që t'u mundësohet të prodhojnë projekt përkthime ose përmbledhje në mënyrë që të përcaktohen se cilat dokumente do të paraqiten në gjykim dhe prandaj duhen përkthyer.

45. Palët që paraqesin sasi të papërballueshme dokumentesh duhet t'u kërkohet të pranojnë afate përfundimi më të gjata ose të tregojnë se cilët dokumentet duhet të kenë përparësi. Nëse është e nevojshme, SSHKGJ-ja duhet të kontaktojë Dhomën Gjyqësore për të marrë mbështetjen e saj në arritjen e një zgjidhjeje që plotëson nevojat e palëve pa sforcim të panevojshëm të burimeve të SSHKGJ-së ose pa ndikuar negativisht mbi të drejtat e palëve të tjera. Në disa raste ka qenë e nevojshme të vendosen kuota mujore për ekipet që bëjnë kërkesa veçanërisht të mëdha mbi burimet e SSHKGJ-së. Megjithatë, për shumë arsye praktike dhe ligjore, kufizime të tilla duhet të jenë përjashtime dhe jo rregull.

46. Gjykimet e të akuzuarve që përfaqësohen vetë dhe Gjykimet e të Akuzuarve të Shumëfishtë (GjASh) krijojnë volume të mëdha kërkesash për përkthim. Ndryshe nga avokatët mbrojtës që paraqitjen në Tribunal, të akuzuarit që përfaqësohen vetë nuk janë të detyruar të flasin mirë një nga gjuhët zyrtare dhe për këtë arsye kanë të drejtën të marrin të gjitha dokumentet kryesore në një gjuhë që ata e kuptojnë. Në gjykime me

shumë të akuzuar, volumi i dëshmive të paraqitura për përkthim dhe numri i mocioneve, urdhrave dhe vendimeve shumëfishohen me numrin e ekipeve të mbrojtjes. Ndërlidhja ndërmjet SSHKGJ-së dhe Dhomës duhet të jetë veçanërisht e ngushtë në raste të tilla.

B.2 Referencat dhe terminologjia

47. SSHKGJ-ja në vitin 2011 krijoi Njësinë e Referencave, Terminologjisë dhe Përpunimit të Dokumenteve për të ndihmuar njësitë e saj të përkthimit në një numër të rëndësishëm mënyrash:
   - duke ofruar para-trajtim të materialeve ligjore, veçanërisht gjykimeve dhe raporteve të ekspertëve, duke gjetur dokumentet origjinale të cilat janë përmendur në tekst, dhe përfshi pasazhe që mund të vendosen direkt në përkthim;
   - duke krijuar një baze të dhënash për terminologjinë dhe duke ofruar mjete të tjera të referencës (përdorimi i bazave të ndryshme të të dhënave, fjalorëve në internet, makinat kërkuese, bibliotekat e modeleve, etj.);
   - duke zhvilluar përdorimin e mjeteve të Përkthimit të Ndihmuara nga Kompjuteri dhe duke trajnuar përkthyesit që i përdorin;
   - duke ofruar ndihma të tjera teknike dhe të referimit.

B.3 Zyra e Menaxhimit të Dokumenteve

48. Në 2004-n, Sekretaria krijoi Zyrën për Menaxhimin e Dokumenteve (ZMD) për të njehsuar trajtimin e kërkesave për përkthim brenda TPNJ-së. Nevoja për një bashkërendim dhe një kontroll të kërkesave të përkthimit u kuptua pasi u vu re se shumë dokumente po paraqiteshin më shumë se një herë për përkthim nga palë të ndryshme ose nga e njëjta palë në kohë të ndryshme. ZMD-ja shërben si një ndërmjetësuese ndërmjet kërkuesve të tillë si Mbrojtja, Zyra e Prokurorit, Dhomat dhe Sekretaria, dhe SSHKGJ-ja që është përgjegjëse për përkthimet.

49. ZMD-ja krijoi një mënyrë të re funksionimi të punës për kërkesat e përkthimit që përfshiu Sistemin e Ndjekjes së Përkthimeve (SNP). Ky sistem i kompjuterizuar është krijuar për të shërbyer si e vetmja rrugë për të paraqitur kërkesa përkthimi në SSHKGJ dhe për kthimin e përfunduar të përkthimeve. SNP-ja lejon ZMD-në dhe palën kërkuese të ndjekë statusin e çdo kërkese, si dhe jep informacion mbi numrin e përkthimeve të dyfishta që janë shmangur. Sistemi përdoret për të njehsuar kërkesat e përkthimit dhe procesin e ndjekjes. Funksionalitetet specifike përfshijnë një formular elektronik të kërkesës për përkthim dhe ndjekjen e ecurisë, krijimin e një numri unik të përkthimit për ta ndjekur i cili mbetet i lidhur me përkthimin dhe origjinalin gjatë kohës së përdorur si dokument i TPNJ-së, dhe ndihmë për fshehtësinë, përcaktimin e përparësisë, parashikim dhe raportim statistikor. Kërkuesit mund të përcaktojnë përparësinë për kërkesat e përkthimit që vlerësohen nga zyra në pajtim me udhëzimet e hartuara të Sekretarisë për përcaktimin e përparësisë të përkthimit. Një pjesë kritike e procesit është aftësia e ZMD-së për të përdorur bazën e të dhënave të TPNJ-së duke përdorur mjete kërkimi që mund të gjejnë përkthime të mëparshme si në rrjetin e Prokurorisë ashtu dhe të Sekretarisë. Kërkimet janë bazuar si në fjalë kyçe (metadata) ashtu dhe në numrat e referencës së provave, dhe janë më frutdhënëse se ato të bëra vetëm në një rrjet. ZMD-ja ia shton edhe më shumë vlerën procesit duke kontrolluar kërkesat për përkthim sa i përket lexueshmërisë dhe qartësisë të dokumenteve.

B.4 Raportimi gjyqësor

50. Aftësia e TPNJ-së për të marrë transkriptime të sakta të procedime është kritike. TPNJ-ja ofron transkriptime në dy gjuhët zyrtare të saj, në anglisht dhe frëngjisht. Megjithatë, raportimi gjyqësor nuk duhet vendosur nën Shërbimet Gjuhësore, por duhet vendosur më mirë nën Menaxhimin e Gjyqit. Transkriptimet përfshijnë

raportimin fjalë për fjalë të asaj që thuhet në sallën e gjykimit dhe nuk kërkon aftësi përkthimi ose interpretimi. Në Tribunal, Menaxhimi i Gjykatës vendos kërkesat për raportimin në gjyq, dhe merr e kontrollon transkriptimin. Roli i SSHKGJ-së si menaxher i projektit të raportimit në gjyq për këtë arsye është i kufizuar vetëm në aspektet kontraktuale dhe financiare. Detyra e përgjithshme nuk është brenda fushës së shërbimeve gjuhësore.

C. Bashkëpunimi me Shtetin Pritës

C.1 Akomodimi i tribunaleve penale ndërkombëtare

51. Vendndodhja e një tribunali penal ndërkombëtar, ose një gjykate të përzier të Kombeve të Bashkuara dhe vendase, në territorin e një Shteti, që zakonisht njihet si Shteti Pritës, kërkon që të bëhen një numër organizimesh për të lehtësuar punën e tribunalit. Kërkesa të tilla mund të jenë specifike për tribunalin, por mund të përfshijnë edhe organizimet standarde të kërkuara për akomodimin e organizatave ndërkombëtare me pjesëtarë të personelit të mbuluar nga Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Privilegjet dhe Imunitetet. Dispozitat e marrëveshjeve të tilla për Shtetet Pritëse trajtojnë paprekshmërinë e mjediseve dhe çantës diplomatike, përjashtimin nga taksat dhe detyrimet, të drejtat e flamurit, hyrjen në shtetin pritës të personelit dhe vizitorëve, privilegjet dhe imunitetet e zyrtarëve, etj. Rrjedhimisht, ndërkohë që një organizatë tipike ndërkombëtare e merr më së shumti bashkëpunimin e saj me Shtetin Pritës nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shtetit Pritës, një tribunal penal ndërkombëtar po ashtu kërkon një marrëdhënie të ngushtë me organe të tjera përkatëse të vendit (p.sh. Ministrinë e Drejtësisë) për çështjet të përditshme pune.

C.2 Dispozitat e posaçme të marrëveshjeve me Shtetin Pritës - juridiksioni dhe hyrja në Shtetin Pritës

52. Çdo tribunali ndërkombëtar i duhet një marrëveshje me Shtetin Pritës e përshtatur sipas nevojave të punës së një organi juridik që ndjek penalisht dhe gjykon kriminelë (të luftës), me dispozita specifike që mbulojnë dëshmitarët, avokatët mbrojtës dhe të dyshuarit, si dhe të akuzuarit që udhëtojnë për në Shtetin Pritës dhe qëndrojnë në territorin e tij. Juridiksioni i Shtetit Pritës mbi individë të tillë duhet të specifikohet, sikurse që duhet të specifikohen çështjet që përcaktojnë nëse persona të tillë gëzojnë ndonjë nivel imuniteti (funksional) ndërkohë që qëndrojnë në territorin e Shtetit Pritës. Për shembull, Marrëveshja e TPNJ-së me Shtetin Pritës përcakton se “dëshmitarët dhe ekspertët që paraqiten nga jashtë shtetit pritës në një thirrje gjyqësore ose një kërkesë të Trubunalit ose të Prokurorit nuk do të ndiqen penalisht ose nuk do të ndalohen ose nuk do t’i nënshtrohen asnjë kufizimi të lirisë së tyre nga autoritetet e vendit pritës në lidhje me aktet ose me dënimet përpara se të hynin në territorin e shtetit pritës.”

53. Për udhëtimet e dëshmitarëve, të avokatëve mbrojtës, të të dyshuarve dhe të akuzuarve mund të kërkohet viza për të hyrë në territorin e Shtetit Pritës. Procesi i lëshimit të vizave është një përgjegjësi kyçe e Shtetit Pritës dhe mund të jetë komplekse. Është e nevojshme që të përcaktohen rrethanat në të cilat mund të lëshohet ose të refuzohet një vizë, ose mund të jetë objekt i kufizimeve, dhe nëse pritet ose nëse duhet të jepen arsyet për një vendim të tillë. Në mënyrë të ngjashme, është e rëndësishme të dihet nëse personat nën juridiksionin e tribunalit për të cilët një urdhër arresti nuk konsiderohet i përshtatshëm ose i nevojshëm, për shembull, personat e akuzuar për shpërfillje të gjykatës, mund të hynë në territorin e Shtetit Pritës nëse

këtyre personave nuk ju duhet normalisht të kenë vizë për të hyrë në vend. Ndërkohë që dispozita të tilla mund të mos jenë detajuar në marrëveshjen aktuale me Shtetin Pritës, duhet të ketë një nivel të "pajtueshmërisë së mendimeve" ndërmjet Shtetit Pritës dhe drejtueseve të tribunalit ndërkombëtar që puna e përditshme të zhvillohet pa pengesa. Në rastin e TPNJ-së, ekziston një procedurë për lëshimin e vizave nga Shteti Pritës. Marrëdhëniet e mira me Shtetin Pritës mundësojnë që situatat jo-standarde të zgjidhen në mënyrë të kënaqshme duke shqyrtuar çdo çështje veçmas.

C.3 Mjediset e paraburgimit

54. Në shumicën e rasteve, një tribunal ndërkombëtar do të ketë mjedise paraburgimi në territorin e Shtetit Pritës. Marrëveshja e Shtetit Pritës duhet të përfshijë dispozita për këtë institucion, dhe duhet të përvijojë përgjegjësitë për strehimin dhe mirëqenien e të ndaluarve. Për shembull, cili organ është i autorizuar të marrë vendimet për trajtim në rast të një greve urie? Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar imunitetit të punonjësit(ve) mjekësor të ngarkuar me ofrimin e kujdesit dhe trajtimit mjekësor për të ndaluarit. Dalin një numër pyetjesh. A zbatohen të plota apo të pjesshme kërkesat e etikës mjekësore dhe certifikimit nga bordi i Shtetit Pritës? Cili organ zotëron autoritet për ndjekje në lidhje me gabimet profesionale të punonjësve mjekësorë dhe kush i përcakton kufijtë e marrëdhënieve konfidenciale ndërmjet doktorit dhe pacientit? Cili organ rregullon (mos-)publikimin e informacionit në lidhje me gjendjen mjekësore të një të paraburgosuri, në veçanti në rrethana kur ky publikim urdhërohet nga tribunali ndërkombëtar? Më e mira është që pyetje të tilla të adresohen gjatë fazës fillestare të çdo tribunali ndërkombëtar. Në rastin e TPNJ-së, imuniteti i Punonjësit Mjekësor është përfshirë në “Marrëveshjen e Shërbimeve dhe Mjediseve,” që është në fuqi me Shtetin Pritës për marrjen me qira të mjediseve të mjediseve nga Shteti Pritës.

C.4 Hapësirat e punës

55. Edhe pse marrëveshja e Shtetit Pritës mund të parashikojë që hapësirat e punës të tribunalit, përfshi mjediset e paraburgimit, janë "të pacenueshme", çfarë do të thotë kjo në praktikë? Atje ku nevojiten përmirësime strukturore ose ndërtimet në hapësirat e punës, për shembull, për ndërtimin ose rinovimin e sallave të gjykimit dhe qelive të mbajtjes së të paraburgosurve, a zbatohen ligjet ndërtimore dhe rregulloret kundër zjarrit të Shtetit Pritës? Ndërkohë që ka një praktikë të konsiderueshme Shtetërore mbi këtë çështje të pacenueshmërisë së hapësirave të organizatave ndërkombëtare, natyra specifike e një institucioni gjyqësor ku janë ndaluar persona, ku ata i nënshtrohen kufizimeve fizike, kërkon një shqyrtim të kujdesshëm.

C.5 Zbatimi i dënimeve dhe lirimi i personave të shpallur të pafajshëm

56. Përpara krijimit të tij, një tribunal ndërkombëtar duhet të sqarojë synimet në lidhje me zbatimin e dënimeve dhënë personave të dënuar. A do të ofrojë Shteti Pritës kapacitet burgu për vuajtjen dënimeve, ose a duhet që Marrëveshja e Shtetit Pritës të specifikojë që zbatimi i dënimit të bëhet diku tjetër? A ka dëshirë politike nga ana e Shteteve Anëtare të KB-së për të ndihmuar në zbatimin e dënimeve të personave të dënuar? Në rastin e TPNJ-së, dokumentet e tij të themelimit përcaktojnë qartë zbatimin e dënimeve në Shtetet Anëtare të KB-së përveç Shtetit Pritës ose Shteteve të ish-Jugosllavisë. Anasjelltas, në rastet e shpalljes së pafajësisë, tribunali ndërkombëtar dhe Shteti Pritës duhet të kenë një mirëkuptim mbi procedurat për lirimin e personave të shpallur të pafajshëm. Për më tepër, pyetjet në lidhje me zbatimin e dënimeve dhe lirimin e personave të shpallur të pafajshëm mund të jenë të lidhura me një numër faktorësh ligjorë e çështjesh politike delikate, e jo të gjitha mund të qartësohen me një lloj marrëveshjeje zyrtare ose më mënyrë tjetër publike.

C.6 Rivendosja e dëshmitarëve

57. Në mënyrë të ngjashme, një mirëkuptim i qartë kërkohet për trajtimin e dëshmitarëve që u janë dhënë masa mbrojtëse nga Tribunali Ndërkombëtar. Mund të ndodhë që kushtet në vendin e zakonshëm të banimit të një dëshmitari të kërkojnë që të gjendet menjëherë një vend i sigurt. Duhet të krijohen mekanizma që lejojnë rivendosjen e dëshmitarëve të tillë të rrezikuar në Shtetet Anëtare të KB-së. Mekanizma të tillë mund të përfshijnë procedura strehimi dhe imigracioni të rregullt ose programe për mbrojtjen e dëshmitarëve organizuar nga Shteti. Në rastin e TPNJ-së, janë nënshkruar marrëveshje për rivendosjen e dëshmitarëve ndërmjet KB-së dhe Shteteve Anëtare të saj. Megjithatë, tribunali ndërkombëtar duhet të ketë të paktën një Shtet në dispozicion të tij, mundësisht Shtetin Pritës ku dëshmitarëve të tillë të rrezikuar mund t'ju jepet strehim i përkohshëm i menjëhershëm në pritje të rivendosjes në një Shtet Anëtar të KB-së. Çdo Shtet që ofron strehim të tillë të përkohshëm duhet ta kryejë këtë detyrë me shumë kujdes. Ndërsa procesi i rivendosjes së dëshmitarëve mund të jetë jashtëzakonisht i ndërlikuar, është e rëndësishme që TPNJ-ja të këtë marrëdhënie pune të shkëlqyera me autoritetet e këtyre Shteteve.

C.7 Parrezikshmëria dhe siguria

58. Parrezikshmëria dhe siguria janë një faktor suprem për funksionimin siç duhet të çdo tribunali penal ndërkombëtar, i cili do të hasë elementë që do të duan të pengojnë proceset e tij ose do të duan të pengojnë suksesin e tij. Eksperienca ka treguar se lidhja e tribunalit me OKB-në mund të sjellë shqetësime shtesë për sigurinë. Çdo marrëveshje standarde me Shtetin Pritës duhet të sigurojë që Shteti Pritës mban përgjegjësinë parësore për ofrimin e sigurisë së jashtme për institucionin, Gjykatësit dhe punonjësit e tij. Prandaj, tribunali do t'i duhen kontakte intensive në nivel pune me punonjësit e sigurisë në Shtetin Pritës, për t'i mundësuar të mbështetet në vlerësimit e rrezikut të bëra nga Shteti Pritës.

59. Në lidhje me sigurinë e brendshme, prezenca e të paraburgosurve në një tribunal ndërkombëtar kërkon shërbime të rojeve të armatosura në godina. Siguria e brendshme mund të ofrohet nga Shteti Pritës ose institucioni mund të zgjedhë që të ketë shërbimin e vet të rojeve të armatosura. Kjo e dyta është një ndërmarrje serioze, që kërkon trajnim të vazhdueshëm për përdorimin e armëve të zjarrit dhe certifikimin e oficerëve dhe të armëve të zjarrit, kërkon akses të përshtatshëm nga oficerët e sigurisë të tribunalit në një poligon vendor qitjeje, si dhe përdorimin e zyrës së certifikimit të armëve. Natyrisht, Shteti Pritës duhet të japë autorizim që oficerët e sigurisë së tribunalit të mbajnë armë zjarri.

C.8 Menaxhimi i marrëdhënieve me Shtetin Pritës

60. Në mënyrë që një tribunal ndërkombëtar të funksionojë me efektivitet, duhet të ketë marrëdhënie të ngushta me Shtetin Pritës, si dhe me Shtetet e tjera Anëtare të OKB-së që ndihmojnë në zbatimin e dënimeve dhe rivendosjen e dëshmitarëve. Në shumë raste, marrëdhëniet ndërmjet tribunalit dhe shteteve të tjera përfshijnë çështje rutinë dhe nuk janë të ndërlikuara. Megjithatë, në mënyrë të pashmangshme, herë pas here dalin çështje të reja në marrëdhëniet me Shtetin Pritës në lidhje me të paraburgosurit, avokatët mbrojtës, dëshmitarët ose provat materiale.

61. Duke pasur parasysh morinë e rrugëve në të cilat tribunali ndërkombëtar mund të ndërveprojë me Shtetin Pritës, përgjegjës për mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e marrëdhënieve me Shtetin Pritës mund të vihet një seksion i posaçëm. Më e mira është që seksioni të raportojë tek drejtuesit e lartë brenda Sekretarisë së Tribunalit dhe personeli të ketë njohuri juridike dhe të kuptojë procesin diplomatik. Në të njëjtën mënyrë, Shteti Pritës duhet të caktojë pika të qarta kontakti brenda ministrive të tij të marrëdhënieve me jashtë dhe drejtësisë. Përveç kësaj, Shteti Pritës duhet të caktojë pika kontakti në agjencitë qeveritare që mbulojnë

taksat, punët sociale/kujdesin shëndetësor dhe imigracionin pasi çështje që kanë të bëjnë me këto tema shpesh dalin në marrëdhëniet me Gjykatësit dhe personelin. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse tribunali ndërkombëtar punëson persona për periudha të zgjatura kohe që mendojnë të qëndrojnë për një kohë të gjatë në Shtetin Pritës.

D. Komunikimi

D.1 Konsideratat hyrëse

62. Gjykatat penale në një mjedis kombëtar në përgjithësi nuk priten t'i shpjegojnë shoqërisë historinë, aktivitetet, praktikat e punës dhe proceset. Është e zakonshme për gjykata të tilla të ofrojnë një shërbim disi të thjeshtë për gazetarët dhe agjencitë e tjera të jashtme të interesuara. Megjithatë, gjykatat penale ndërkombëtare, kanë zhvilluar një qasje tejet të ndryshme për median dhe çështjet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit. Si rezultat, gjykatat ndërkombëtare përpiqen në mënyrë aktive ta bëjnë organizatën të hapur dhe punën e saj të kuptueshme dhe të rëndësishme për publikun e ndryshëm në tërë botën, e veçanërisht për ata që preken më shumë nga krimet e gjykuara në gjykata.

63. Pak kohë pas fillimit të punës, TPNJ-ja e njohu rëndësinë e transparencës gjyqësore, si dhe nevojën për të komunikuar drejtësinë tek audiencat ndërkombëtare, veçanërisht tek ato në rajonin e ish-Jugosllavisë. Ndërkohë që është lavdëruar për punën nismëtare në fushën e drejtësisë ndërkombëtare, një kujdes i kufizuar i është kushtuar punës së marrëdhënieve dhe komunikimit me publikun ku duhet ruajtur një ekuilibër i duhur ndërmjet të qenit të hapur dhe nevojës për të mbrojtur integritetin e procesit ligjor.

64. Gjykatësit e TPNJ-së, në një stad të hershëm të evolucionit të organizatës, e bënë të qartë se gjykatat ndërkombëtare që trajtojnë krimet e luftës e kanë për detyrë të ndërmarrin hapa aktiv për ta bërë punën e tyre të arritshme dhe kuptimplote. Pa hapa të tillë, shumica e punës gjyqësore të bërë nga institucioni rrezikon të kalojë kryesisht pa u vënë re ose të keqinterpretohet, duke nënvleftësuar ndikimet pozitive të drejtësisë. Duke pasur këtë gjë në mëndje, është e një rëndësie të jashtëzakonshme që institucionet e ngjashme të llogarisin rëndësinë e komunikimit të drejtësisë që në ditët e para të krijimit.

65. Një politikë dhe strukturë komunikimi e zhvilluar mirë merr parasysh nevojat e ndryshme të organeve të veçanta të pavarura të institucionit, si dhe jep shtysë për të identifikuar dhe ndjekur qëllimet e përbashkëta të organizatës tërën tërësi. Përveç kësaj, ai duhet të njohë që herët audiencat e ndryshme të interesuara në punën e tij dhe të krijojë një mënyrë për t'i shërbyer këtyre grupeve.

66. TPNJ-ja kombinoi përdorimin e metodave tradicionale të komunikimit me teknologjinë moderne në një përpjekje për të komunikuar me audiencat e ndryshme rreth botës. Eksperienca e TPNJ-së ka shtruar rrugën për ndërmarrje të ngjashme nga gjykata të tjera ndërkombëtare dhe vendase kundër krimeve të luftës.

67. Ruajtja e integritetit dhe pavarësisë gjyqësore janë jetësore. Principi bazë duhet të reflektohet në strukturën organizative të Shërbimit të Komunikimit. Secili nga dy organet kryesore të institucionit, Dhomat, të kryesuara nga Presidenti i TPNJ-së, nga njëra anë, e zyra e Prokurorit në anën tjetër, kërkojnë Zyrën e tyre të Komunikimit, si dhe zëdhënësin e tyre. Personeli i TPNJ-së përfshi prokurorët individualë nuk duhet t'i drejtohen medias në lidhje me çështjet e duhet të mbrohen prej zëdhënësit nga pyetjet e përditshme të medias.

D.2 Komunikimi me masmediat dhe bazën

68. Është e rëndësishme të nxiten mediat, si ato elektronike gjithashtu edhe shtypin, për të vlerësuar plotësisht mandatin e gjykatës dhe misionin e saj. Duke pasur parasysh rëndësinë e medias në funksionimin e çdo shoqërie, veçanërisht të atyre që janë përfshirë në konflikt, mbështetja e medias mund të mos jetë e pranishme në fazat fillestare. Tjetërkund mund të mbizotërojë skepticizmi dhe mbështetja e vakët. Në një klimë të tillë, roli i institucionit duhet të shpjegohet. Duhen angazhuar komunikues me eksperiencë në përpjekjet e organizatës për të përmbushur këto sfida komunikimi.

69. Interesi i medias ndryshon me shpejtësi dhe ato organe të medias që kanë mundësi të ndjekin një histori për një periudhë të gjatë kohë mund të jenë të rralla. Interesi mund të mbahet gjallë me metoda të reja komunikimi dhe përpjekje për t'i dhënë medias materiale që e përcaktojnë historinë pa nevojën për ta ndjekur atë. Është e rëndësishme që organizata të mos reagojë vetëm pas artikujve negativë, por të jetë proaktive në ndjekjen e artikujve pozitivë duke përdorur të gjitha mundësitë për të theksuar arritjet e saj. Zyra e Medias së TPNJ-së ka prodhuar një tekst standard të arritjeve të TPNJ-së i cili mund të përdoret nga përfaqësuesit e TPNJ-së gjatë prezantimeve dhe fjalimeve.

70. Megjithatë, qasja proaktive përfshin edhe nevojën për të menaxhuar raportet negative. Ndaj TPNJ-së shpeshherë janë ndërmarrë fushata negative në media. Një reagim me kohë është ndoshta mënyra e vetme për të sqaruar pozicionin e institucionit dhe për të mënjanuar raportet negative të mëtejshme.

71. Komunikimi i suksesshëm është shumë më tepër se njohja e organeve të medias dhe bisedat me gazetarët. Sot, asnjë institucion nuk mund ta konsiderojë vetën serioz pa një faqe interneti të paraqitur mirë, të lehtë për t'u përdorur dhe të thjeshtë për t'u orientuar[346]. Interneti është mjeti komunikues më me influencë i kohës moderne. Institucionet ligjore duhet ta përvetësojnë këtë fuqi dhe ta paraqesin punën e tyre në mënyrë që të përfitojnë hulumtuesit, akademikët, por edhe media, dhe "personi i thjeshtë" kudo që ata mund të jenë në botë. Për më tepër, për institucionet që nuk janë të përhershme, faqja e internetit mund të shërbejë si një trashëgimi për gjeneratat e ardhme. Gjykatat ndërkombëtare, për ndryshim nga shumica e juridiksioneve kombëtare, nuk mund të mbështeten tek sistemet e brendshme të komunikimit dhe për këtë arsye kanë një detyrim ndaj publikut që të kenë një politikë komunikimi aktive e cila shpjegon aktivitetet e institucionit dhe praktikat e punës. Është e rëndësishme që këto detyrime të njihen që në fillim të jetës së një institucioni gjyqësor dhe që institucioni të zhvillojë politikë të medias.

72. Krijimi i TPNJ-së në Holandë, një shtet me një kontingjent të vogël përfaqësuesish të shtypit ndërkombëtar, ndikoi negativisht në mundësinë që bota ta shikonte TPNJ-në gjatë punës. Për këtë arsye, TPNJ-ja vendosi të përdorte një numër mënyrash të reja në për ta bërë punën transparente dhe të disponueshme për të gjithë. Për këtë arsye faqja e TPNJ-së përdoret për të transmetuar procedimet e sallës së gjyqit pothuaj në kohë reale nga të tre sallat e gjyqit. Ndërkohë që kjo i ka hapur sallat e gjyqit ndaj publikut, vonesa prej 30 minutash në transmetim lejon kohë të mjaftueshme për të mbrojtur çdo publikim pa dashje ose me dashje të materialeve të mbrojtura. Për ata që nuk kanë i kanë në dispozicion në kohë reale, transkriptimet e secilës seancë publike ofrohen brenda pak ditësh.

73. TPNJ-ja ka bërë përpjekje të konsiderueshme për t'u ofruar në kohë gazetarëve dokumentet e gjyqit dhe treguesit e dokumenteve. Duke vënë në dispozicion të publikut mocionet, urdhrat dhe disa korrespondenca, TPNJ-ja shmang akuzimet se përdor procedura jotransparente. Në të njëjtën kohë, hapa të tillë sigurojnë që materiali i gjyqit të jenë në dispozicion të publikut aktual si dhe të gjeneratave të ardhme. Ajo çka mund të jetë vetëm një shënim në fund të faqes në një gjykim mund të jetë kapitulli që mungon në historinë e

346 Faqja e internetit të TPNJ-së mund të gjendet në *www.icty.org*

shoqërive që përpiqen të përcaktojnë të vërtetën. Materiale të tilla mund të shpërndahen nëpërmjet listave të adresave [elektronike], faqeve të internetit ose informimeve të shtypit.

D.3 Personeli i komunikimit

74. Profesionistët e komunikimit mund ta shikojnë qasjen e tyre të ndryshme nga shumë prej hetuesve të policisë ose avokatëve brenda organizatës. Gjyqësori mundet të jetë edhe i rezervuar ndaj zyrtarëve të medias dhe marrëdhënieve publike. Prandaj është e rëndësishme që të përdoren komunikime të efektshme të brendshme për të krijuar besim ndërmjet elementëve gjyqësorë dhe jo-gjyqësorë.

75. Është e rëndësishme që ata që e kanë për detyrë të merren me komunikimet të integrohen plotësisht në institucion dhe të përfshihen në proceset përkatëse të vendim-marrjes. Kjo qasje lehtëson aftësinë e personelit të komunikimeve të informojnë vendim-marrësit se si mund të ndikojnë ose të kuptohen nga publiku (qytetarët e thjeshtë ose politikanët) dhe të përgatiten më mirë për t'ju përgjigjur pyetjeve nga jashtë agjencisë pasi një vendim të jetë bërë publik.

76. Një përparësi e angazhimit të gazetarëve me eksperiencë ose specialistëve të medias në ekipin e komunikimeve të organizatës është se ata mund të komunikojnë më mirë ndërlikimet ligjore në një mënyrë që përvetësohet më lehtë. Gjuha e thjeshtë tërheq më shumë vëmendje se zhargoni ligjor, dhe redukton keqinterpretimet dhe keqraportimet e qëllimshme. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që të bëhen përpjekje të komunikohet në gjuhën e grupeve përkatëse të synuara.

77. Audiencat e ndryshme mund të kërkojnë qasje të ndryshme dhe mesazhet duhen përshtatur në përputhje me to. Grupet e rëndësishme të synuara mund të përfshijnë përfaqësues të shoqërisë ligjore dhe civile, OJQ-të, komunitetin diplomatik, shoqatat e viktimave dhe akademikët. Mund të jetë e mundshme që të identifikohen qëllime dhe kauza të përbashkëta me agjencitë e jashtme dhe të forcohen partneritetet që përçojnë më tej mesazhin e TPNJ-së.

D.4 Kanalet e komunikimit

78. Zyra e medias ofron shërbime kryesore të komunikimit të tilla si lëshimi i deklaratave dhe komunikatave për shtyp si dhe përgjigje në pyetjet e medias. Ndërkohë që këto mjete mbeten kyçi i kanaleve të komunikimit, ekzistojnë edhe mënyra të tjera po aq të rëndësishme e nganjëherë edhe më të efektshme për të promovuar punën e një gjykate.

79. Është e rëndësishme të identifikohet koha më e mirë për të lëshuar deklaratat dhe komunikatat për shtypin, si dhe të përcaktohet forma që ato duhet të kenë. Disa aktivitete të gjykatës kërkojnë rëndom publikimin e deklaratave për shtyp ose informacionit këshillimor, përfshi publikimin e aktgjykimeve, konfirmimin ose deklarimin e aktpadive, fillimin e gjykimit, zhvillimet kryesore jashtë sallës së gjykimit, fjalimet dhe fjalët kyçe të mbajtura të aktorëve kryesorë të TPNJ-së. Është e rëndësishme që një institucion të përfitojë nga mundësitë për të publikuar deklarata për shtyp që ofrojnë një mundësi për të tërhequr vëmendjen e medias, për të shpërndarë më tej punën e gjykatës tek publiku i gjerë, si dhe për të promovuar një kuptim më të madh të mandatit dhe misionit të tij.

80. Deklaratat për shtyp duhet të shkruhen në një stil të përshtatshëm për audiencën përkatëse. Si fillim, deklaratat për shtyp të TPNJ-së ishin pak a shumë versione të shkurtuara dhe të parafrazuara të dokumenteve që ato shpjegonin. Gjuha dhe frazat ligjore dominonin, duke ulur numrin e personave që kuptonin deklaratat dhe rëndësinë e tyre. Pasi TPNJ-ja rregulloi stilin e deklaratave për shtyp për të tërhequr lexuesit, ndikimi

ishte i menjëhershëm me një numër gazetash që publikonin pothuaj tërë deklaratat për shtyp pa komente të panevojshme.

81. Përveç deklaratave për shtyp dhe informacionit këshillimor, një numër mjetesh të tjera janë në dispozicion të një institucioni që dëshiron të komunikojë me publikun në lidhje me aktivitetet e tij. Konferencat për shtyp, për shembull, mund të bëhen çdo javë për të tërhequr vëmendjen e zhvillimeve të ardhshme dhe për të dërguar mesazhet kryesore nga aktorët kryesorë të institucionit. Aktorët kryesorë të TPNJ-së dhe zyrtarët e tjerë të lartë mund të adresojnë publikun direkt kur duhet përçuar mesazhe të rëndësishme.

82. Për të ndihmuar grupet që janë të interesuara në ndjekjen e çështjeve të TPNJ-së, Shërbimi i Komunikimeve ka krijuar një numër qasjesh, përfshi publikimin e serive gjithëpërfshirëse të Faqeve Informuese të Çështjeve. Këto materiale përditësohen çdo ditë dhe ofrojnë informacion kyç për të gjitha çështjet e TPNJ-së, japin një përmbledhje koncize, dhe janë shkruar në anglishte të thjeshtë për të mbuluar një audiencë të gjerë që nuk është domosdoshmërish e familjarizuar me procedurat ligjore. Në mënyrë të ngjashme, në një vështrim të shpejtë dokumentet e të dhënave dhe shifrave kryesore ofrojnë informacion jetësor për një gamë të gjerë të të dhënash të rëndësishme që nga numri i të akuzuarve e deri tek sa lëndë janë duke u gjykuar. Në fazat e mëvonshme të zhvillimit të TPNJ-së, u krijua një buletin informativ, i quajtur "Lajme nga TPNJ-ja" me synimin që t'i ofrohej botës diplomatike një pasqyrë e rregullt e pikave të rëndësishme të aktiviteteve të TPNJ-së.

83. TPNJ-ja ka adresuar edhe fusha specifike kyçe me interes për publikun duke ofruar materiale dhe përdorimin e tyre. Një shembull është gama e gjerë e informacionit e vënë në dispozicion në lidhje me Institucionin e Paraburgimit të TPNJ-së. Shërbimi i Komunikimeve ka përgatitur video dhe një katalog të gjerë me fotografi që përshkruajnë brendësinë e institucionit e që të dy këto gjenden në faqen e internetit. Këto materiale, të shoqëruara me tekst që lexohet lehtë rreth jetës në institucion, janë vlerësuar dhe janë ritransmetuar gjerësisht në BBC, CNN dhe rrjetet rajonale. Në një përpjekje tjetër për të ruajtur transparencën, TPNJ-ja vendosi të lejonte komanduesin e godinës së paraburgimit të ketë kontakte të gjera me median. Materialet dhe qasja e hapur kundërshtuan keqinformimin e gjeneruar nga disa organe të medias, që e portretizuan TPNJ-në si të njëanshme dhe mjediset e Paraburgimit si të papërshtatshme.

84. TPNJ-ja ka adoptuar një qasje aktive në komunikim dhe personeli i saj mban fjalime në takime të shumta publike. Këto takime ofrojnë një forum të rëndësishëm për kundërshtimin e funksioneve dhe vendimeve të shtrembëruara dhe keqkuptuara. Çështjet e rëndësishme që janë adresuar nga TPNJ-ja në forumet publike përfshijnë rolin kyç të mbrojtjes në gjykime, dhe praktikën e institucionit mbi marrëveshjet e deklarimit të fajësimit apo shfajësimit dhe përgjegjësisë së komandimit.

85. Së fundi, sasia e madhe e dokumenteve që është prodhuar gjatë mandatit të TPNJ-së përbën një mjet të vlefshëm komunikimi. Sistemi i Bazës së të Dhënave Gjyqësore, një bazë të dhënash të kërkueshme të të gjithë dokumenteve publike të arkivuara gjatë mandatit të TPNJ-së, do të vendoset në faqen e internetit si një mjet trashëgimie kyçe për të siguruar që puna e institucionit të kujtohet dhe përdoret nga gjeneratat e ardhme.

D.5 Komunikimi dhe ndërgjegjësimi

86. Masmedia dhe interneti janë padyshim mënyra të efektshme për të informuar një numër të madh njerëzish, por nganjëherë asgjë nuk mund të zëvendësojë ndërveprimin ballë-për-ballë. Gjatë viteve, Programi i Shpërndarjes së Informacionit të TPNJ-së ka investuar përpjekje të rëndësishme në komunikimin me bazën, duke mësuar gjatë punës se dëgjimi është po aq i rëndësishëm sa të folurit.

87. Programi i Komunikimit dhe Ndërgjegjësimit u krijua në 1999 në përgjigje të përpjekjeve sistematike nga disa qeveri në rajon për të keqinterpretuar punën e TPNJ-së. Shumë media rajonale shpesh me qëllim bënin keqinformim armiqësor për gjykatën.

88. Në bashkëpunim me organizata partnere, Komunikimi dhe Ndërgjegjësimi ka organizuar konferenca, seminare dhe evenimente të tjera të shumta si dhe vizita për publikun nga ish-Jugosllavia. Nëpërmjet këtij programi, mijëra njerëz – viktima dhe pjesëtarë të familjeve të tyre, profesionistë juridik, përfaqësues të qeverive, studentë, gazetarë dhe të tjerë – kanë pasur mundësi të komunikojnë direkt me përfaqësues të TPNJ-së. Aksesi tek informacioni i saktë ka shërbyer për të larguar mitet dhe paragjykimet për gjykatën.

89. Duke pranuar se drejtësia duhet të ndjellë besim tek komunitetet vendore, Komunikimi dhe Ndërgjegjësimi ka kryer një numër të gjerë programesh rajonale. Një shembull ishte seria e programeve të vitit 2004 që u bë në zonat ku ishin kryer disa nga krimet më mizore nën juridiksionin e TPNJ-së. Duke përdorur terma të thjeshta, hetuesit, prokurorët dhe personeli i dhomave të TPNJ-së dhanë një pamje të brendshme të hetimeve të përpikta dhe të mundimshme të bëra nga TPNJ-ja dhe shpjegoi se si krimet dhe përgjegjësia e autorëve të krimeve ishin provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Të titulluara "Të kapërcejmë hendekun ndërmjet TPNJ-së dhe Komuniteteve në Bosnje dhe Hercegovinë", u organizuan gjithsej pesë konferenca në Bërçko, Foça, Konjic, Prijedor dhe Srebrenicë. Publiku përbëhej nga anëtarë të shoqatave të viktimave, autoritete bashkiake, institucione gjyqësore dhe organe të zbatimit të ligjit, si dhe politikanë vendas dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Audiencat patën mundësinë t'i bënin pyetje personelit të lartë të TPNJ-së që paraqiti konkludimet e tyre në një mënyrë të hapur, gjë e cila ishte shenja dalluese e kësaj serie të veçantë konferencash. U ofruan CD multimedia që përmbanin filmime, fotografi, dokumente dhe fletë me fakte. Një kompani e pavarur prodhimesh televizive bëri një seri dokumentarësh për secilin eveniment që u transmetuan nga shumë transmetues për miliona teleshikues.

90. Programi i Komunikimit dhe Ndërgjegjësimit synon të fuqizojë komunitetet vendore që të përdorin sa më mirë gjykimet dhe provat e TPNJ-së për të ndihmuar në dokumentimin e ngjarjeve të së kaluarës dhe për të kundërshtuar mohime të mundshme të krimeve. Pjesa standarde e paraqitjeve të dhëna nga personeli i TPNJ-së ofrohen që të ndihmohet audienca që të orientohet gjatë gjykimeve të gjata të TPNJ-së dhe të kuptojë referimin tek provat materiale dhe dëshmitë. Për shembull në 2006-n, Sekretari i TPNJ-së shkoi në fshatin e vogël të Grabovicës në Bosnje dhe Hercegovinë për të diskutuar gjykimin i cili ishte lëshuar më herët në lidhje me vrasjen e civilëve në fshat.

91. Programi i Komunikimit dhe Ndërgjegjësimit ka luajtur një rol të rëndësishëm në transferimin e njohurive të TPNJ-së në ish-Jugosllavi dhe i ka dhënë Sekretarisë dhe Dhomave të TPNJ-së vlerësime të zhvillimeve ligjore dhe politike në rajon, të tilla si reformat e sistemeve kombëtare të drejtësisë. Programi i Komunikimit dhe Ndërgjegjësimit ka organizuar vizita të shumta që kanë mundësuar gjykatës dhe prokurorë vendor të njohin punën e TPNJ-së dhe marrëdhëniet e saj me punën e tyre të përditshme.

D.5.1 Sfidat që dalin nga një Program Komunikimi dhe Ndërgjegjësimi

92. Përfaqësuesit e medias dhe zëdhënësit përballen me sfidën që të përpiqen t'i japin sa më shumë informacion që të jetë e mundur publikut pa paragjykuar proceset. Për shkak se janë fytyra publike e organizatës, është e rëndësishme që përfaqësimet dhe zëdhënësit të kenë mbështetje të madhe nga brenda organizatës, përfshi mbështetjen buxhetore.

93. Aktivitetet e medias dhe të komunikimit dhe ndërgjegjësimit të TPNJ-së janë penguar nga fondet dhe burimet e kufizuara. Që nga krijimi, Programi i Komunikimit dhe Ndërgjegjësimit të TPNJ-së është financuar mbi baza

kontributesh vullnetare. Është e domosdoshme që shërbimi i komunikimeve të shihet si një departament përbërës i institucionit nëse do të arrijë sukses në plotësimin e mandatit dhe misionit të tij.

94. Një zyrë informacioni publik mund të arrijë sukses deri në një masë të caktuar, dhe shpresat jorealiste për zyrën mund të çojnë në zhgënjime. Anëtarët e komunitetit ndërkombëtar, për shembull, në disa raste kanë shpresuar që përpjekjet për të komunikuar në lidhje me punën e gjykatës do të përkthehen automatikisht në një ndryshim të perceptimeve dhe do të japin mbështetje më të fortë dhe një kuptim më të mirë të mandatit të saj nga popullata vendase.

95. Do të ishte gabim të mendohej që shpërndarja e informacionit të saktë rreth gjykimeve dhe punës së të TPNJ-së do të prodhojë gjithnjë një efekt të duhur dhe pozitiv. Për shembull, edhe nëse zyrtarët e TPNJ-së shpjegojnë se si mungesa e provave të besueshme rezultoi në aktgjykim pafajësie, ky shpjegim mund të ofrojnë pak ngushëllim për grupet e viktimave. Përsëri është tejet e rëndësishme të sigurohet që ata që janë të interesuar të kenë mundësinë dhe mjetet të marrin informacionin rreth çështjeve në mënyrë që të arrihet një pamje e thellë dhe e balancuar.

E. Seksioni i Viktimave dhe Dëshmitarëve

96. Seksioni i Viktimave dhe Dëshmitarëve (tani e tutje i quajtur "SVD") është një organ i pavarur dhe neutral brenda Sekretarisë së TPNJ-së, dhe mandati i tij është të lehtësojë paraqitjen e të gjithë dëshmitarëve që dëshmojnë përpara TPNJ-së, përfshi të thirrurit nga Dhomat, Prokuroria ose Mbrojtja.

97. SVD-ja ka krijuar parimet, politikat dhe procedurat e saj për të siguruar që të gjithë dëshmitarët të mund të dëshmojnë në një mjedis të parrezikshëm dhe të sigurt, dhe që eksperienca e dhënies së dëshmisë të mos rezultojë në lëndim, vuajtje ose traumë të mëtejshme për dëshmitarin. Objektivi i SVD-së është të krijojë një mjedis në të cilin një dëshmitar që jep dëshmi të mund ta konsiderojë eksperiencën si ngjarje pozitive, forcuese dhe përmirësuese. SVD-ja funksionon me nivelin më të lartë të integritetit, paanësisë dhe fshehtësisë, dhe siguron që të gjithë dëshmitarët të jenë informuar rreth të drejtave dhe detyrave të tyre dhe të përdorin njësoj shërbimet e saj. Është e domosdoshme që SVD-ja të qëndrojë e paanshme brenda gjykatës apo tribunalit ndërkombëtar.

98. SVD-ja përbëhet nga tri njësi kryesore: Njësia e Mbrojtjes e cila bashkërendon përgjigjet ndaj kërkesave të sigurisë së dëshmitarëve; Njësia e Mbështetjes e cila ofron këshillim dhe ndihmë sociale dhe psikologjike për dëshmitarët; dhe Njësia Operative e cila merret me organizimet logjistikës. SVD-ja ndihmohet nga një zyrë në terren e vendosur në Sarajevë e cila u krijua në 2002 për t'u ofruar viktimave dhe dëshmitarëve nga ish-Jugosllavia akses të lehtë dhe të zgjeruar tek shërbimet operacionale, logjistike dhe mbrojtjes të SVD-së, si përpara ashtu dhe mbas dhënies së dëshmisë në TPNJ. Që nga krijimi i saj, SVD-ja iu ka dhënë ndihmë të vijueshme të efektshme dëshmitarëve pas kthimit në shtëpitë e tyre.

99. Mandati i SVD-së është ndarë në tri veprime kryesore të cilat janë diskutuar më poshtë.

E.1 Njësia operacionale

100. Mandati i SVD-së e obligon që të sjellë të gjithë dëshmitarët e thirrur në Hagë për të dëshmuar përpara TPNJ-së nga cilido vend ku ata jetojnë. Meqenëse organizon udhëtimin për rreth 500 individë në vit, SVD-ja ka zhvilluar një sistem gjithëpërfshirës për të kapërcyer barrierat praktike që dalin nga pengesat me të cilat përballen dëshmitarët (p.sh. rroga të humbura për shkak të mungesës në punë) dhe për të mundësuar

dëshmitarët të bëjnë udhëtimin vajtje-ardhje për në Holandë. Prandaj, SVD-ja ndihmon dëshmitarët me gjëra të tilla si vizat, organizimet e udhëtimit dhe pagesat financiare.

E.1.1 Vizat për të udhëtuar për në Holandë

101. Për shkak se shtatëdhjetë përqind e dëshmitarëve banojnë në një nga vendet e ish-Jugosllavisë, dhe shumicës ende iu nevojiten viza për të hyrë në Holandë, SVD-së i duhet të përcaktojë një organizim të veçantë me autoritetet e Shtetit Pritës që të mund të merren viza Schengen 14-ditore në mënyrë fleksibile dhe të shpejtë. Në lidhje me dëshmitarët e tjerë, që udhëtojnë nga vende të tjera të botës, disa prej tyre janë refugjatë të cilëve iu duhen dokumente udhëtimi të veçanta në mënyrë që të hyjnë sërish në vendin e tyre të ri pas kthimit nga Haga. Për rastet e refugjatëve, SVD-ja ka identifikuar kontaktet përkatëse me Ministritë në Shtetet përkatëse.

E.1.2 Ndihma për dëshmitarët në terren

102. SVD-ja i jep çdo dëshmitari informacion të detajuar në gjuhën e tyre për udhëtimin e organizuar. Përveç kësaj SVD-ja përpiqet të identifikojë çdo nevojë të veçantë që mund të kenë ata, të tilla si çështje sigurie, shëndeti dhe psikosociale, si dhe nëse dëshmitari është në gjendje të udhëtojë vetëm ose i nevojitet një shoqërues.

103. Përpara krijimit të Zyrës në Terren në Sarajevë, shumica e ndërveprimeve të SVD-së me viktimat dhe dëshmitarët në rajon bëheshin nëpërmjet telefonit. Vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur duhej ndihmë për individë veçanërisht të prekshëm, kur kërkoheshin vlerësime të thella të rrezikut apo psikosociale, Zyrtarët e Mbështetjes ose të Mbrojtjes në Hagë udhëtonin për në rajon. Procesi kushtonte shumë dhe harxhonte shumë kohë, dhe mungesa e prezencës së SVD-së në rajon frenoi aftësinë e saj për t'u përgjigjur shpejt dhe me efikasitet. Eksperienca ka treguar se telefoni, përveçse është një metodë e pasigurt për të komunikuar materiale sensitive, mund të shkaktojë më shumë shqetësim se komunikimi ballë-për-ballë. Përveç kësaj, ishte e vështirë për personelin e SVD-së në Hagë që të informohej dhe përditësohej në lidhje me llojet e shërbimeve ndihmëse që ekzistonin për referimet, dhe situatën e sigurisë në rajon.

104. Eksperienca ka treguar se kontaktet personale sigurojnë informacionin më të saktë, më të sigurt dhe më të besueshëm nga dëshmitarët. Në të njëjtën kohë, ajo ofroi një mundësi për të ndërtuar marrëdhënie me dëshmitarët, dhe për të ndihmuar dëshmitarët që të ndiheshin më të qetë dhe më të sigurt rreth udhëtimit dhe dhënies së dëshmisë. Duke udhëtuar më parë në rajon, pjesëtarët e personelit të SVD-së mundën t'ju përgjigjeshin pyetjeve direkt dhe mundën të ofronin mbështetje përpara se dëshmitari të udhëtonte për në Hagë, duke ndihmuar të ulej në minimum stresi duke mundësuar dëshmimin më të mirë të mundshëm.

105. Për t'i shërbyer më mirë një numri të madh dëshmitarësh që vijnë dhe kthehen në rajon, SVD-ja hapi një Zyrë në Terren në Sarajevë, Bosnje Hercegovinë, në Janar të vitit 2002. Kjo zyrë kishte një Punonjës për Përkrahje, një Punonjës për Mbrojtje dhe një Ndihmës për Gjuhë.

106. Zyra në terren është shumë e rëndësishme për punën e TPNJ-së sepse iu ofron viktimave dhe dëshmitarëve akses më të lehtë dhe të zgjeruar te shërbimet e mbrojtjes dhe përkrahjes të SVD-së si përpara ashtu dhe pasi të kenë dëshmuar. Përveç kësaj, Zyra në Terren mundëson SVD-në që të bashkërendojë më mirë me agjencitë vendore dhe ndërkombëtare në ish-Jugosllavi, për të identifikuar burimet shtesë, shërbimet sociale e psikologjike e ndihmë tjetër për viktimat dhe dëshmitarët, si dhe për të organizuar udhëtimin e dëshmitarëve për në Hagë.

107. Dëshmitarët marrin ndihmën e asistentëve të SVD-së në terren në vendin e tyre të banimit të cilët marrin vizat nga një prej Ambasadave të Shtetit Pritës dhe mund të ndihmojë në marrjen e pasaportave nga

autoritetet vendore. Duke u ndërruar me rotacion midis Hagës dhe rajonit, zakonisht nëpërmjet Zyrës në Terren në Sarajevë dy herë në muaj, ndihmësit në terren luajnë një rol jetik pasi ata ofrojnë lidhjen kyçe për të siguruar se nevojat fizike dhe psikologjike të dëshmitarëve merren parasysh. Ka kontakte dhe dërgim informacioni të vazhdueshëm ndërmjet ndihmësve në terren që udhëtojnë në rajon dhe personelit të SVD-së në Hagë. Nëse kërkohet, anëtarët e personelit të SVD-së mund të udhëtojnë me një dëshmitar nga shtëpia e tyre (fluturime të parapaguara të organizuara nga SVD-ja) për në Holandë ose një pjesëtar i personelit të SVD-së mund të japë ndihmë gjatë ndërrimit të fluturimeve në një aeroport transit. Për të lehtësuar më tej transferimin e dëshmitarëve, SVD-ja ka adoptuar një program të ashtuquajtur 'ndihma tako e përshëndet' duke arritur një marrëveshje me një kompani fluturimesh, e cila mundëson Seksionin që të ndihmojë me efikasitet dëshmitarët gjatë transferimeve ndërkohë që ulen udhëtimet e personelit të SVD-së dhe shpenzimet përkatëse kur nuk nevojitet ndihmë ose mbrojtje e veçantë për një dëshmitar.

Politika e pagesave për humbjet e jashtëzakonshme

Një dëshmitar mund të marrë pagesë për humbje të jashtëzakonshme e cila është krijuar për të mbuluar humbjet monetare të jashtëzakonshme që ai pëson, ose për shkak të mundimit të tepruar si rezultat i dhënies së dëshmisë përpara TPNJ-së.

Dëshmitari duhet të paraqesë dokumente që paraqesin humbjet monetare të jashtëzakonshme, mundimet e tepruara dhe lidhjen ndërmjet humbjeve dhe dhënies së dëshmisë përpara TPNJ-së. Shembuj të dëshmitarëve të cilët e marrin këtë dietë të humbjeve të jashtëzakonshme:

- Gjatë dhënies së dëshmisë së një dëshmitareje në Hagë, dy lopët e saj u sëmurën dhe për shkak të mungesës së dëshmitares nga shtëpia për disa ditë, lopëve nuk mund t'ju jepej kujdesi i duhur. Si rezultat, dy lopët iu shitën me një çmim shumë të ulët një kasapi pas kthimit të dëshmitares dhe dëshmitarja vuajti pasi nuk pati mundësi t'ia shiste qumështin askujt. SVD-ja i dha asaj një pagesë për ta mundësuar të blinte lopë tjetër për qumësht.

- - Për shkak të vonesave të shumta në dhënien e dëshmisë së tyre në Hagë, disa dëshmitarë nuk patën mundësi të ktheheshin në shtëpi në kohë për korrjet dhe iu desh të punësonin punëtorë që të bënin korrjet për ta. SVD-ja iu dha atyre një pagesë për t'i mundësuar të shmangnin vështirësitë e tepruara duke punësuar punëtorë për t'i zëvendësuar ata në terren.

E.1.3 Strehimi në Hagë

108. Pas mbërritjes në aeroportin e Amsterdamit, një shofer i SVD-së e pret dëshmitarin tek porta dhe e ndihmon atë të kalojë kontrollin e imigracionit dhe të marrë bagazhet e tij. Dëshmitari më pas sillet nga aeroporti për një nga vendqëndrimet e caktuara ku do të jetë prezent personeli i SVD-së për informimin fillestar.

109. Eksperienca ka treguar se dëshmitarët e përfshirë në çështje të ndryshme, dhe që përfaqësojnë ekipe të ndryshme të Prokurorisë dhe Mbrojtjes, duhen ndarë nga njëri-tjetri gjatë kohës që ata janë në Hagë. Gjithashtu duhen marrë parasysh edhe ndryshimet e përkatësisë etnike dhe fetare. Këtyre faktorëve i duhet kushtuar gjithnjë vëmendje kur transportohen dëshmitarët nga një pikë në një tjetër, kur caktohet vendqëndrimi, dhe kur vendosen dëshmitarët në dhoma të ndryshme pritjeje në mënyrë që dëshmitarët të mos takohen me njëri-tjetrin dhe të mos diskutojnë përmbajtjen e dëshmive të tyre me njëri-tjetrin.

E.1.4 Kohëzgjatja e qëndrimit të dëshmitarëve në Hagë

110. SVD-ja adoptoi një "rregullën e 7-ditëshe" për kohën e sprovimit dhe dhënies së dëshmisë, (përfshi udhëtimin) si praktika më e mirë për të minimizuar ndikimin negativ të mundshëm të dhënies së dëshmisë mbi dëshmitarët. SVD-ja me të vërtetë vuri re se shumë dëshmitarë filluan të shfaqnin shenja stresi pasi kishin kaluar larg nga shtëpia për më shumë se shtatë ditë. Për të adresuar situatat që përfshinin qëndrim të zgjatur në Hagë përpara dhënies së dëshmisë, gjë e cila ndodhi në gjyqin e Milošević-it, SVD-ja zhvilloi një politikë

për kthimin e dëshmitarëve në shtëpitë e tyre në rastet e vonesave të zgjatura në gjykim. Sipas kësaj politike, SVD-ja mori parasysh faktorë të tillë si gjatësia dhe vështirësia e udhëtimit, koha e përllogaritur e vonesave, dhe mosha e shëndeti i dëshmitarit për të përcaktuar nëse do t'i kërkonte dëshmitarit të kthehej në shtëpi gjatë një vonese të zgjatur. Kur Punonjësit e Ndihmës dhe Mbrojtjes vendosnin se dëshmitari duhej të qëndronte në Hagë, sepse udhëtimi i kthimit do të rrezikonte nevojat e ndihmës ose sigurisë së dëshmitarit, justifikimi për të qëndruar në Hagë i paraqitej me shkrim Shefit të Seksionit për t'u miratuar.

Politika e personit shoqërues që ndihmon

Një dëshmitar mund të sjellë një person ndihmues që ta shoqërojë atë gjatë dhënies së dëshmisë në Hagë. Për shkak se kjo politikë zbatohet vetëm për dëshmitarët më të prekshëm, kriteret e mëposhtme do të përdoren për të vlerësuar nëse dëshmitarit i duhet një person ndihmës

- Nuk ka anëtarë të afërm të familjes që kanë mbijetuar;

- Dëshmitar me aftësi të kufizuara;

- Dëshmitarë të moshuar ose shumë të rinj;

- Prania e simptomave të rënda të Çrregullimit Pas-Traumatik të Stresit;

- Frikë ose shqetësim subjektiv në atë masë sa mund ta pengojë personin të udhëtojë ose të dëshmojë;

- Marrëdhënia e dëshmitarit me personin ndihmues;

- Një person ndihmës është miratuar për dëshmi/vizita të mëparshme në TPNJ.

E.1.5 Pagesat

111. Gjatë qëndrimit në Holandë, është shumë e rëndësishme të sigurohet që dëshmitarët të mos vuajnë pasoja financiare të pafavorshme që dalin nga fakti se ata janë thirrur për të dëshmuar përpara TPNJ-së dhe janë larg nga shtëpia. Në përgjigje të këtij problemi, SVD-ja ka krijuar një numër politikash që përcaktojnë pagesat bazë dhe ato të jashtëzakonshme që ju jepen dëshmitarëve. Për shembull, dëshmitarët do të marrin një *pagesë pjesëmarrjeje* e cila është bazuar mbi tarifat e KB-së për shtetin ku ata jetojnë, dhe një *pagesë të dëshmitarit* e cila përfshin shpenzime të rastit si dhe një *dietë për ushqim*. Përveç këtyre pagesave bazë, dëshmitarët mund të marrin në raste të jashtëzakonshme, *pagesë për humbje të jashtëzakonshme* nëse dëshmitari ka pësuar ose do të pësojë humbje të jashtëzakonshme financiare si rezultat i dhënies së dëshmisë (shih kutinë "*Politika e pagesave për humbjet e jashtëzakonshme*"), ose një dietë për kujdesin për fëmijët ose personat në vartësi për një dëshmitar të cilit/të cilës i nevojitet kujdes i paguar për fëmijët ose personat e tjerë në vartësi në mënyrë që të dëshmojë.

E.2 Njësia e Ndihmës

E.2.1 Ndihma profesionale psikosociale dhe vlerësimi i nevojave të dëshmitarëve

112. Bazuar në eksperiencën e saj, SVD-ja e konsideron të rëndësishme që të përfshihet në organizimin e orarit të udhëtimit të dëshmitarëve për në gjykim sa më herët që të jetë e mundur në mënyrë që të bëhet një vlerësim i pavarur i nevojave të tyre. Për shembull, dëshmitarët e rrezikuar mund të lejohen të sjellin me vete në Holandë një person që i ndihmon (shih kutinë *"Politika e personit shoqërues që ndihmon"*).

113. Në një tribunal penal ndërkombëtar ose institucion juridik që trajton krimet e luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të tilla si dhuna fizike dhe seksuale, është e domosdoshme që dëshmitarëve t'u jepet ndihmë profesionale psikosociale. Kontakti i drejtpërdrejtë i personelit ndihmës të SVD-së me dëshmitarët tregon orientim ndaj klientit, ndjeshmëri dhe aftësi komunikimi të duhur që ndihmon dëshmitarët dhe viktimat e prekshme. Në veçanti, duke qenë se personeli punon nga afër me viktimat dhe dëshmitarët, personeli duhet të dijë pikat e mëposhtme:

- Viktimat dhe dëshmitarët shpesh janë të traumatizuar për shkak të eksperiencave të tyre gjatë luftës.
- Ardhja në Hagë shpesh e zgjon sërish këtë traumë, e në disa raste mund të ndikojë në pamje ose në sjellje.

- Mënyra si dhe nëse ata kanë pasur ndonjë kontakt me *çdo* lloj sistemi të drejtësisë në ish-Jugosllavi ose diku tjetër po ashtu ndikon në frikën, shpresat dhe perceptimet e tyre për vizitën në TPNJ.
- Rëndësia e ruajtjes së fuqisë së vendim-marrjes në duart e viktimës/dëshmitarëve.
- Jini të vetëdijshëm kur i referoheni një dëshmitari si një "viktimë" ose si një " mbijetues". Shumë njerëz që kanë vuajtur në luftë nuk e shikojnë veten si "viktima" dhe ofendohen nga përdorimi i kësaj fjale. Termi viktimë shpesh lë të kuptojë një pasivitet që njerëzit nuk mendojnë se karakterizon sjelljen e tyre "të luftimit" në luftë. Këta "mbijetues" ndjehen të prekur kur përshkruhen ose trajtohen si "viktima". Për të tjerë, termi "viktimë" është një term i mirëpritur sepse mund të nënkuptojë që ata nuk janë përgjegjës për atë që ju ka ndodhur. Për më tepër, termi viktimë ka mundësinë që t'ia vërë fajin të akuzuarit për dhunën që është ndërmarrë ndaj tyre.

114. Personeli që merret me viktimat dhe dëshmitarët duhet të ketë në mendje principet e përgjithshme të mëposhtme për ndihmë të efektshme.

- të inkurajojë;
- të pranojë ndryshimet e opinioneve ndërkohë që ndihmon;
- të japë informacion të saktë;
- të tregojë pranim;
- të përdorë gjuhë që nuk është gjykuese;
- të sigurojë që dëshmitarët të mund të diskutojnë çdo gjë që i shqetëson gjatë përgatitjes për dhënien e dëshmisë.

E.2.2 Përshtatja e dëshmitarit mjedisit të ri dhe takimet e para ndërmjet dëshmitarit dhe avokatëve të tyre

115. Kur dëshmitari mbërrin, ai informohet në vendqëndrim dhe i jepet informacion që ka të bëjë me dëshminë e tij. Ky informacion përfshin një broshurë në gjuhën e tij që përmban hollësi të të gjitha aspekteve praktike të procesit gjyqësor, të tilla si mënyrat për të dëshmuar përpara gjykatës, dhënien e dëshmisë në Gjykatë, ndihmën dhe mbështetjen që ju ofrohet dëshmitarëve nga SVD-ja dhe masat e veçanta për fshehtësinë, sigurinë dhe mbrojtjen. SVD-ja ka përpiluar dhe publikuar broshura të tilla në gjuhët boshnjake-kroate-serbe, shqip dhe në anglisht.

116. Kur një dëshmitar mbërrin në Hagë, preferohet që dëshmitarit t'i jepet kohë e mjaftueshme për të rimarrë veten nga fluturimi dhe për t'u përshtatur me vendqëndrimin në Hagë. Dëshmitari duhet të nxitet të kalojë pjesën e mbetur të ditës së parë duke u përshtatur me mjedisin e ri.[347]

117. Nuk këshillohet që një dëshmitar të takohet me ZP-në ose me avokatët e mbrojtjes për të përgatitur dëshminë (e ashtuquajtur "sprovim") ditën e parë. Megjithatë, nëse sprovimi është absolutisht i nevojshëm ditën e parë, atëherë duhet të ndodhë jo më herët se 4 orë pasi dëshmitari të ketë mbërritur në vendqëndrim dhe pasi të ketë ngrënë një vakt ushqimi.

E.2.3 Monitorimi i vazhdueshëm i mirëqenies së dëshmitarit

118. Për mirëqenien e dëshmitarit, është e rëndësishme që personeli ndihmës të ofrojë një prezencë ndihmuese të dukshme dhe të pavarur në vendqëndrime dhe në dhomat e pritjes së dëshmitarëve gjatë punës së Gjykatës. Personeli ndihmues është në dispozicion të flasë me dëshmitarët nga ora 07.00 e mëngjesit deri në orën 21.30 të mbrëmjes, si dhe ekziston një pjesëtar i personelit "që mund të thirret" të cilin dëshmitarët mund ta kontaktojnë me telefon në çdo kohë. Në këtë mënyrë, SVD-ja ruan mirëqenien e dëshmitarit nëpërmjet ofrimit të standardit të lartë të ndihmës profesionale.

347 Shiko Shtojcën 7: Rekomandimet e SVD-së për sprovimin e dëshmitarëve.

119. Përveç ofrimit të kujdesit psikologjik direkt për dëshmitarët, personelit ndihmues të SVD-së i kërkohet të mbrojë nevojat e dëshmitarëve brenda institucionit juridik duke vendosur të drejtat e dëshmitarëve në rendin e ditës së Gjykatës. Për shembull, personeli i SVD-së vëzhgon gjendjen psikologjike dhe shëndetësore të dëshmitarit gjatë paraqitjes në gjyq dhe njofton personelin brenda TPNJ-së si për shembull Gjykatësit, Prokurorinë ose ekipin e Mbrojtjes për çdo faktor që mund të pengojë vazhdimin e dhënies së dëshmisë ose që mund të kërkojë masa të menjëhershme. Është përgjegjësia e personelit ndihmues t'i njoftojë këto palë ose gjykatësit rreth çështjeve që mund të ndikojnë paraqitjen e dëshmitarit në Gjyq ose që mund të ndikojnë në aftësinë e tyre për të dëshmuar.

E.2.4 Simptomat e pas-traumës

120. Personeli i SVD-së monitoron nga afër nëse dëshmitarët tregojnë ndonjë simptomë pas-traumatike. Llojet e simptomave të provuara nga dëshmitarët gjatë ose menjëherë pas sprovimit dhe dëshmisë përfshijnë simptomat e mëposhtme fizike dhe psikologjike në intensitete të ndryshme:

Simptomat fizike

- Dhimbje koke (më të zakonshmet dhe më të shpeshtat),
- dhimbje në të gjithë trupin e tyre (më pak e shpeshtë, por zakonisht kur njerëzit kanë provuar sulme fizike atëherë dhimbja specifike mund të ndodhë përsëri në mënyrë të pavullnetshme),
- mungesë oreksi (ndryshimi i ambientit kontribuon në këtë reagim megjithatë pamundësia për të ngrënë është edhe tregues që trupi po arrin një gjendje stresi dhe është në një gjendje fizike "lufto ose ik"),
- pagjumësi (rishfaqja e simptomave të mëparshme),
- ëndrra të këqija (rishfaqja e simptomave të mëparshme),
- imazhe të pavullnetshme pamore, dëgjimore e të nuhatjes të ngjarjeve që kanë lidhje me traumën.

Simptomat psikologjike

- Tërheqja nga të tjerët (largimi nga grupi që ndodhet në vendqëndrim dhe pasja e vështirësive në komunikim),
- ankthi (frika nga pasja e simptomave të pashpjegueshme, ndoshta simptomave që ata kanë pasur përpara dhe tani kanë frikë se ato janë kthyer ndoshta për gjithnjë),
- frika (duke iu kujtuar ngjarjet tronditëse dhe pasja e simptomave fizike të pashpjegueshme),
- lodhja, (shtuar nga pamundësia për të fjetur dhe për të ngrënë dhe pasja e kujtimeve kaq të detajuara të materialit tronditës).

121. Këto lloj reagimesh futen në kategoritë normale të reagimeve pas-traumatike. Kur një person ka jetuar një ngjarje traumatike, reagime të tilla pas traumës zakonisht konsiderohen përgjigje normale ndaj ngjarjeve jonormale. Është shumë e rëndësishme të dihet, se simptoma të tilla shfaqen kur ngacmohen pavarësisht se sa kohë më parë ka ndodhur ngjarja. Këto simptoma ose reagime zhduken pas largimit të ngacmimeve kryesore ose në prezencën e informacionit dhe ndihmës profesionale.

E.2.5 Vijimi i kontakteve me dëshmitarët pas dhënies së dëshmisë

122. Është e rëndësishme që SVD-ja të vijojë punën me dëshmitarët duke i kontaktuar dy-tre javë pasi të jenë kthyer në shtëpi për të identifikuar çështje të lidhura me ri-integrimin e tyre në komunitetin tyre vendor. Në këtë drejtim, SVD-ja ka krijuar një numër mjetesh për të lehtësuar problemet që kanë të bëjnë me paraqitjen e dëshmitarëve në gjykim. Për shembull, Zyra në Terren e SVD-së në Sarajevë ka krijuar një rrjet të agjencive ndërkombëtare dhe kombëtare, përfshi Organizatat Joqeveritare në rajonin e ish-Jugosllavisë dhe në vendet e treta, në të cilat dëshmitarët mund të drejtohen për ndihmë juridike ose sociale. Identifikimi dhe kultivimi i kontakteve të reja brenda zonës së misionit është një faktor i rëndësishëm që ndihmon SVD-në të përmirësojë

efikasitetin dhe cilësinë e punës së saj. Përveç zyrës në terren të SVD-së, ka edhe një numër linje direkt të cilin dëshmitarët mund ta telefonojnë kur ju del ndonjë problem.

123. Për më tepër, falë një dhurate të kohëve të fundit nga një Shtet, SVD-ja tani është në pozitë të ofrojë financim të kufizuar për dëshmitarët që vuajnë nga pasojat negative ekonomike dhe psikologjike afatgjata të lidhura me dëshmitë e tyre.

Lënda Milutinović – Mbrojtja e dëshmitarit në sallën e gjykimit

Në çështjen e Milutinoviçit, Dhoma Gjyqësore, bazuar në rekomandimet e SVD-së, i kërkoi Sekretarisë që Shoqëruesit e Gjykatës t'i sillnin dëshmitarët menjëherë pasi Gjykatësit të kishin hyrë në sallën e gjykatës (dhe për seancën e parë, pasi Shoqëruesi i Gjykatës të kishte prezantuar seancën dëgjimore) dhe t'i nxirrnin dëshmitarët jashtë menjëherë përpara se Gjykatësit të largoheshin nga salla.

E.3 Njësia e Mbrojtjes

E.3.1 Mbrojtja e dëshmitarëve në gjykatë

124. SVD-ja është një nga entitetet që është autorizuar sipas Rregullës 75(A)[348] të kërkojë masa mbrojtëse për një dëshmitar për të cilin identifikon një rrezik në lidhje me fshehtësinë ose mbrojtjen tij nëse ai dëshmon në një seancë të hapur. Në praktikë, SVD-ja ka paraqitur parashtrime sipas Rregullës 33(B) të Rregullores së Procedurës dhe Provave për ta ngritur këtë çështje me Dhomat. Ky Rregull e lejon Sekretarinë të "bëjë parashtrime me gojë ose me shkrim tek Presidenti ose tek Dhomat për çdo problem që del në kontekstin e një çështjeje specifike e cila ndikon ose mund të ndikojë në kryerjen e funksioneve të tilla". Në shumicën e rasteve, një kërkesë për masa mbrojtëse bëhet nga ekipi i Prokurorisë ose i Mbrojtjes pasi ata i njohin shqetësimet në një stad të hershëm, dhe SVD-ja ndërhyn vetëm kur një kërkesë e tillë nuk është bërë ose kur i mungojnë faktet thelbësore.

125. Sipas Rregullës 75(B), masat mbrojtëse mund të përfshijnë:

- masa për të parandaluar bërjen të ditur për publikun ose median të identitetit ose vendndodhjes së një viktime ose një dëshmitari, ose të personave që kanë të bëjnë ose kanë lidhje me një viktimë ose një dëshmitar me mjete të tilla si:
  - shuarjen e emrave dhe informacionit identifikues nga regjistrimet publike të Tribunalit;
  - mos-bërjen publike të asnjë regjistrimi që identifikon viktimën ose dëshmitarin;
  - dhënien e dëshmisë nëpërmjet pajisjeve që ndryshojnë pamjen dhe zërin ose me televizion me qark të mbyllur; dhe
  - caktimin e një pseudonimi;
- seanca të mbyllura, në pajtim me Rregullën 79;
- masa të përshtatshme për të lehtësuar dëshminë e viktimave dhe dëshmitarëve të prekshëm, të tilla si televizion me qark të mbyllur me një drejtim.

126. Dëshmitarët duhen informuar me qartësi në një gjuhë që ata e kuptojnë rreth përmbajtjes së dokumenteve të gjykimit që kanë lidhje me situatën e tyre, dhe në veçanti rreth zbatimit, vendimit dhe ndryshimeve të masave të tyre mbrojtjes.

127. SVD-ja ka vënë re gjatë viteve se ekziston rreziku i vërtetë të frikësimit të dëshmitarëve që lihen në sallën e gjykimit në prezencën e personave ose palëve të akuzuara në mungesë të Gjykatësve. Dëshmitarët mund të

348 Rregullorja e Procedurës dhe Provave e TPNJ-së, Rregulla75(A): Një Gjykatës ose një Dhomë mundet, *proprio motu* ose me kërkesën e cilësdo palë, ose të viktimës apo të dëshmitarit në fjalë, ose të Seksionit të Viktimave dhe Dëshmitarëve, të urdhërojë masa të duhura për fshehtësinë dhe mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, nëse masat janë në pajtim me të drejtat e të akuzuarit.

frikësohen vërtetë nëse dëgjojnë dhe/ose shikojnë ekipet e mbrojtjes ose të Prokurorisë ose të akuzuarit kur lihen në sallën e gjykimit pa Gjykatësit. Përveç kësaj, në gjykime me shumë të akuzuar, dëshmitarët mund të ndihen të frikësuar thjesht nga numri i personave prezent në sallën e gjykimit. Për të adresuar çështjen e frikësimit të mundshëm të dëshmitarëve, dhe ndërhyrjet nga palët ose një i akuzuar, si dhe uljen e stresit të lidhur me paraqitjen përpara Gjyqit, SVD-ja rekomandon adoptimin e masave praktike por të efektshme në lidhje me sjelljen e largimin e dëshmitarëve në sallën e gjyqit. Qëllimi është që të sigurohet që dëshmitarët, deri në masën e mundur, të mos lihen vetëm në praninë e të akuzuarit ose palëve (shih kutinë *"Lënda Milutinović – Mbrojtja e dëshmitarit në sallën e gjykimit")*.

Specifikat e Vlerësimit të Kërcënimit dhe Rrezikut në një Kontekst Ndërkombëtar

Vështirësi e sfida kanë dalë në zbatimin praktik të shërbimeve të mbrojtjes të ofruar nga Sekretaria, dhe vlerësimin e nivelit të kërcënimit për qëllime rivendosjeje. Duke marrë parasysh ndryshimin dhe ndërlikimet e zonës së luftës si një vendngjarje e krimit, kundrejt vendngjarjes së një krimi lokal, në rastin e TPNJ-së nuk është e mundur të identifikohet kërcënimi aq qartë sa në krimet lokale. Në kontekstin e krimeve ndërkombëtare, kërcënimi mund të vijë nga çdo anëtar i një partie politike, një grupi social, një grupi etnik, ndaj është e vështirë të përcaktohet një "vlerësim kërcënimi" i qartë. Kjo do të thotë që TPNJ-ja duhet të anojë nga siguria për çdo dëshmitar kur bëhet fjala për masat e mbrojtjes dhe rivendosjen e dëshmitarëve.

Vështirësia e vlerësimit rritet nga fakti se nuk ka forca policore të fuqishme, efikase dhe të besueshme në zonat përkatëse. Në një kontekst vendas, rivendosja e dëshmitarëve është vërtetë veprimi i fundit për të mbrojtur një dëshmitar, pasi ka shumë forca policie të besueshme për të mirëmbajtur ligjin dhe rendin dhe vetëm kur një dëshmitar vihet në shënjestër nga armiq të zotë atëherë i duhet të futet në program për rivendosje sepse forcat e policisë nuk mund ta mbrojnë realisht. Në zona lufte forcat vendore të policisë janë shkatërruar, dhe aftësia e tyre për të mbrojtur një dëshmitar është shumë më e ulët. Kjo mund të nënkuptojë që TPNJ-ja të marrë dëshmitarë në programin e saj të rivendosjes të cilët po të kishin qenë në një nivel të ngjashëm kërcënimi, mund të mos ishin marrë në një program vendor.

E.3.2 Mbrojtja e dëshmitarëve jashtë sallës së gjykimit

128. Në disa raste, pavarësisht masave mbrojtëse juridike të dhëna, ose për shkak të faktit se masat mbrojtëse nuk janë dhënë, dëshmitarët sërish mund të përballen me çështje të sigurisë. Për ta sqaruar këtë problem, Njësia e Mbrojtjes së SVD-së ka krijuar një politikë që detajon veprimet në dispozicion për të adresuar këto shqetësime. Një element i kësaj politike është Programi i Rivendosjes së Viktimave në të cilin një dëshmitar dhe familja e tij mund të përfshihen nëse, pas një vlerësimi të bërë nga Njësia e Mbrojtjes së SVD-së (shih kutinë *"Specifikat e Vlerësimit të Kërcënimit dhe Rrezikut në një Kontekst Ndërkombëtar"*), përcaktohet se rrethanat e parandalojnë dëshmitarin të qëndrojë në vendin e tij të banimit (shih kutinë *"Kriteret për përfshirjen në programin e rivendosjes së dëshmitarëve"*).

129. Ndryshe nga sistemet vendore të ligjit penal të cilat mbështeten tek policia ose ministritë për mbrojtjen e dëshmitarëve, TPNJ-ja, si një organizatë ndërkombëtare, varet plotësisht tek bashkëpunimi i Shteteve, përfshi autoritetet e Shtetit Pritës, për të kryer disa nga shërbimet e saj, p.sh. rivendosjen, rivendosjen e përkohshme për t'iu përgjigjur një kërcënimi të përkohshëm ose për të monitoruar kërcënimet. Për shkak të mungesës së masave detyruese dhe mungesës së territorit të saj, TPNJ-ja nuk është në pozicion që të ofrojë në mënyrë të pavarur shërbime të programeve vendore të mbrojtjes së dëshmitarëve që përfshijnë mundësinë për të ndryshuar identitetin, strehimin në banesa të sigurta, dhe rivendosjen e brendshme të personave rrezikuar.

130. TPNJ-ja për këtë arsye ka hyrë në marrëveshje kornizë dypalëshe me Shtetet për të lehtësuar rivendosjen e atyre dëshmitarëve dhe familjeve të tyre që nuk mund të kthehen në rajon.

131. Eksperienca ka treguar se më e mira për dëshmitarët dhe familjet e tyre kërkon që rivendosja e përhershme e dëshmitarëve përpara një rivendosje përfundimtare duhet të jetë sa më e shkurtër që të jetë e mundshme. Një qëndrim i zgjatur nën kujdesin e TPNJ-së përpara rivendosjes përfundimtare rrit ndjeshëm shqetësimin e dëshmitarit rreth të ardhmes së tij, duke e bërë adaptimin në vendin e ri edhe më tronditës (shih kutinë *"Vështirësitë e lidhura me adaptimin në një Shtet të Ri të Rivendosjes"*).

> ***Kriteret për përfshirjen në programin e rivendosjes së dëshmitarëve***
>
> *Përfshirja e një dëshmitari dhe familjes së tij në programin e rivendosjes së TPNJ-së i nënshtrohet kushteve të mëposhtme:*
>
> *Dëshmitari duhet të dëshmojë për një krim që përfshin shkeljen e Nenit dy ("Shkelje të rënda të Konventës së Gjenevës të vitit 1949"), tre ("Shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës"), katër ("Gjenocid") ose pesë ("Krime kundër njerëzimit") të Statutit të TPNJ-së;*
>
> *Personi duhet të jetë një dëshmitar i rëndësishëm dhe dëshmia nuk mund të sigurohet me asnjë lloj mënyre tjetër;*
>
> *Kërcënimi duhet të jetë vlerësuar si i vërtetë dhe që kërcënon jetën. Personi duhet të dojë dhe të jetë i përshtatshëm për përfshirjen në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve.*

132. Është e rëndësishme të mos nënvleftësohet ndikimi i stresit praktik në zgjedhjen e një shtëpie të re. Mirëqenia e një dëshmitari të rivendosur mund të ndikohet negativisht nga faktorë të tillë si ndryshimi i klimës dhe ushqimi, doktorët me të cilët ata nuk mund të flasin direkt ose në fshehtësi, dhe vështirësitë në bërjen e gjërave të përditshme të tilla si pamundësia për të lexuar shenjat e rrugëve ose orarin e hapjes së supermarketeve vendore. Dëshmitarët mund të përballen me një jetë të përditshme nga e cila ata kuptojnë shumë pak se çfarë po ndodh rreth tyre. Kjo i bën dëshmitarët pothuaj krejtësisht të varur tek personeli i Mbrojtjes, jo vetëm për arsye parrezikshmërie dhe sigurie, por edhe për "përkthime kulturore" që t'i ndihmojnë të kuptojnë se si të menaxhojnë jetën e përditshme. Përpjekjet e personelit të mbrojtjes kërkojnë një sasi të madhe të kohës së tyre.

> ***Vështirësitë e lidhura me adaptimin në një Shtet të Ri të Rivendosjes***
>
> *Gjatë viteve, SVD-ja ka parë se rivendosja përfundimtare në një Shtet ka qenë më pak e suksesshme nëse dëshmitarët dhe familjet e tyre kanë pritur një periudhë të gjatë kohe nën kujdesin e TPNJ-së. Kjo për faktin se dëshmitarët varen shumë nga shërbimet e SVD-së dhe si pasojë niveli i tyre i adaptimit në një mjedis të ri ulet.*
>
> *Dëshmitarët provojnë jo një po dy tronditje kulturore gjatë rivendosjes së tyre. E para ndodh kur ata sillen në një vend të sigurt nën kujdesin e SVD-së direkt nga shtëpitë e tyre dhe vendi i kërcënimit. Periudha e kaluar në pritje në një vend të sigurt ndërsa TPNJ-ja gjen vendin përfundimtar të rivendosjes mund të jetë tejet e gjatë. Kur mbërrijnë në vendin e sigurt, ata menjëherë përballen me një kulturë të re dhe fillojnë procesin e adaptimit në të. Pastaj natyrisht, ata kalojnë nëpër këtë adaptim për herë të dytë kur lëvizin në vendin përfundimtar të rivendosjes. Ky proces i adaptimit është tejet sfidues dhe stresues, në një kohë kur aftësia e dëshmitarit për t'u përballur me stresin është më e ulët. Në zonat e luftës forcat e policisë janë të shkatërruara, ndaj pragu mbi të cilin forcat vendore të policisë nuk mund ta mbrojnë një dëshmitar është shumë më i ulët dhe kjo do të thotë që TPNJ-ja duhet të marrë dëshmitarë nën programin e saj të rivendosjes të cilët, me një nivel të ngjashëm kërcënimi, mund të mos merren në një program vendor.*

133. Për shkak të vështirësive me rivendosjen e dëshmitarëve, SVD-ja ka konstatuar se shtëpitë e sigurta rajonale ofrojnë një opsion të mirë për rivendosjen. Një shtëpi e sigurt bën që një dëshmitar i mbrojtur të ndihet i qetë brenda mjedisit kulturor të tij, dhe mund të ulë ndjeshëm kostot që kanë të bëjnë me procesin e rivendosjes.

134. SVD-ja kërkon që të nënshkruhet një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet dëshmitarit dhe Njësisë së Mbrojtjes së SVD-së ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e përbashkëta të SVD-së dhe dëshmitarit (shih kutinë *"Detyrimet e një dëshmitari sipas Memorandumit të Mirëkuptimit"*). Për shembull, dëshmitari dhe familja e tij marrin ndihma financiare bazuar mbi skemën e

ndihmave të kujdesit social të shtetit pritës, pagesa për shtëpinë, pagesat e shërbimeve dhe siguracionin mjekësor derisa të bëhet rivendosja përfundimtare. Dëshmitari dhe familja marrin mbështetje psikosociale nga personeli i SVD-së në gjuhën e tyre. Një vlerësim psikologjik bëhet nga një psikolog i pavarur i kualifikuar kur të konsiderohet e nevojshme nga Njësia e Mbrojtjes. Merren parasysh gjithnjë nevojat për edukim dhe të gjuhës së dëshmitarit dhe familjes ndërkohë që ata presin rivendosjen nën kujdesin e SVD-së.

Detyrimet e një dëshmitari sipas Memorandumit të Mirëkuptimit

Dëshmitari duhet:

- të japë informacion e dëshmi siç kërkohet nga Prokuroria dhe Mbrojtja,

- të mos kryejë asnjë krim,

- të mos kryejë aktivitete që mund të kompromet ojnë sigurinë e tij,

- të pranojë dhe zbatojë kërkesat dhe udhëzimet e bëra nga TPNJ-ja në lidhje me mbrojtjen e dhënë,

- të bashkëpunojë me TPNJ-në për të shmangur aktet me dëshirë apo nga pakujdesia që mund të zbulojnë tek të tjerët vendndodhjen e tij apo të saj.

135. Njësia e Mbrojtjes paraqet një kërkesë me shkrim në vendet me të cilat SVD-ja ka marrëveshje, duke ju kërkuar që dëshmitari dhe familja të konsiderohen për rivendosje. Një kërkesë për rivendosje ndërkombëtare duhet të përgatitet e plotë, dhe kërkon marrjen parasysh të faktorëve kulturorë dhe të mjedisit kur vendoset se cili vend të kontaktohet me kërkesë për rivendosje. Pasi të jetë identifikuar vendi, kërkesa për rivendosjen në atë vend duhet të fillohet sa më parë që të jetë e mundur. Çdo vonesë në këtë proces duhet ndjekur në nivelin më të lartë brenda TPNJ-së.

136. Pas pranimit nga një vend, të gjitha organizimet e udhëtimit dhe lëvizjeve duhet të kryhen sa më në fshehtësi që të jetë e mundshme. Pas rivendosjes, Njësia e Mbrojtjes vazhdon të zbatojë kushtet e marrëveshjes ndërmjet vendit të rivendosjes dhe SVD-së.

E.4 Konsideratat përfundimtare

137. Gjatë gjithë këtyre viteve, SVD-ja ka krijuar një numër praktikash dhe politikash të hartuara për të siguruar që dëshmitarët të mund të dëshmojnë në një mjedis të parrezikshëm dhe të sigurt, një çështje kjo shumë e rëndësishme për menaxhimin e gjyqeve. Me të vërtetë, nëse dëshmitarët sillen në Hagë në një mënyrë efektive dhe pa strVështirësitë e lidhura me adaptimin në një Shtet të Ri të Rivendosjesese, sigurimi që dëshmitarët të marrin ndihmë të përshtatshme psiko-sociale, dhe adresimi i çështjeve të sigurisë që dalin nga paraqitja e tyre në gjyq janë parimet bazë dhe të nevojshme që duhen zbatuar brenda një tribunali ndërkombëtar, në mënyrë që provat mbi shkeljet e së drejtës ndërkombëtare humanitare të mund të paraqiten në mënyrë të duhur.

XV. Ndihma Juridike dhe Çështjet e Avokatit të Mbrojtjes

A. Kualifikimet e kërkuara për avokatët mbrojtës.....219
A.1 Rregulla 44: Kërkesat e përgjithshme për kualifikimet e të gjithë avokatëve të mbrojtjes.....220
A.2 Rregulla 45: Kërkesat për kualifikimin e avokatëve mbrojtës të emëruar.....221
A.3 Lista e avokatëve kujdestarë.....222
A.4 Pranimi në Listën e Rregullës 45.....222
A.5 Caktimi për të përfaqësuar një të akuzuar dhe tërheqja e avokatit mbrojtës.....222
A.6 Kërkesa e të akuzuarit për avokat të caktuar.....223
A.7 Caktimi i pjesëtarëve të tjerë të ekipit të mbrojtjes.225
A.8 Ndihma për Mbrojtjen.....225
B. Politikat e pagesës.....226
B.1 Politika e ndihmës juridike përpara gjyqit.....227
B.2 Skema e pagesës gjyqësore.....228
B.3 Skema e pagesës së apeleve.....229
B.4 Caktimi i ekspertëve.....230
B.5 Të akuzuarit që përfaqësohen vetë.....230
B.6 Organizime të tjera.....231
C. Sjellja Profesionale e Avokatit.....231
C.1 Kodi i sjelljes.....232
C.2 Shoqata e Avokatëve të Mbrojtjes.....232
C.2.1 Roli i Shoqatës së Avokatëve të Mbrojtjes.....232
C.2.2 Këshilli Disiplinor i ShAM-së.....233

1. Sistemi i ndihmës juridike të Tribunalit, siç ekziston aktualisht në Sekretari, është produkti i 14 vjetëve eksperiencë se si të lehtësohet dhe jepet ndihma juridike në një mënyrë efikase dhe të barabartë për të gjithë të akuzuarit e varfër përpara Gjykatës. Veçanërisht në vitet e fundit, Zyra e Sekretarisë për Ndihmë Juridike dhe Çështje të Paraburgimit (ZNJP) ka kontribuar në kodifikimin dhe sistematizimin e seksioneve të ndryshme të sistemit të ndihmës juridike. Këto kontribute janë bërë kryesisht në përgjigje të zhvillimeve procedurale (çështje me shumë të akuzuar, të akuzuar që janë përfaqësuar vetë) dhe ngarkesa e çështjeve në rritje të Gjykatës, e cila arriti nivelin më të lartë të të gjitha kohërave në vitet 2007 dhe 2008 me një numër të pashembullt personash të akuzuar në gjykim.

2. Krijimi i politikave ka qenë një nga pikat më të fuqishme të punës së ZNJP-së në tre vitet e fundit ku Shoqata e Avokatëve Mbrojtës (ShAM) është konsultuar për t'u siguruar që t'i dijë ndryshimet e ardhme, ose për të kërkuar mendimin e saj përpara shpalljes. Të gjithat Rregullat dhe Rregulloret e zbatuara nga Sekretaria dhe politikat që i përforcojnë ato duhet t'i jepen mbrojtjes për të siguruar transparencë dhe konsistencë të vendimeve administrative në mënyrë që avokatët mbrojtës të njohin politikat që zbatohen për pagesat, udhëtimet dhe çështjet e tyre të tjera. Një dokument i brendshëm politikash që përcakton procedurat e brendshme është një domosdoshmëri absolute për të siguruar konsistencën brenda zyrës, veçanërisht kur ka ndërrime të personelit, që të shmangen interpretimet e ndryshme të politikave nga pjesëtarët e personelit.

3. Sistemi i ndihmës juridike të Tribunalit mund të ndahet në tre komponentë kryesorë: së pari, standardet dhe mekanizmat që avokatët mbrojtës të kualifikohen të praktikojnë ligjin përpara Tribunalit; së dyti, politikat e pagesës për avokatët mbrojtës, sikurse janë caktuar dhe përmirësuar nëpërmjet amendamenteve gjatë viteve; dhe së fundi sjellja profesionale e avokatëve mbrojtës dhe regjimi disiplinor i Tribunalit.

A. Kualifikimet e kërkuara për avokatët mbrojtës

4. Neni 21 i Statutit të TPNJ-së i garanton një të akuzuari të drejtën për të marrë ndihmë juridike nëse nuk e ka mundësinë për të paguar për të.[349] Rregulla 45 e Rregullores së Procedurës dhe Provave përcakton se, "sa herë

349 Statuti i Përditësuar i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, ndryshuar më 28 shkurt 2006, në Nenin 21(4) (d).

që e kërkojnë interesat e drejtësisë, një të akuzuari ose të dyshuari i cili nuk i ka mjete për të paguar mbrojtjen i duhet caktuar një avokat",[350] dhe detajon kualifikimet që avokati duhet të ketë mbi kërkesat bazë për të gjithë avokatët mbrojtës të caktuara me Rregullën 44. Këto kërkesa duhet të plotësohen përpara se avokati të caktohet për të përfaqësuar personat e akuzuar pamundësia për të paguar e të cilëve është përcaktuar, e që avokati të paguhet nëpërmjet sistemit të ndihmës juridike. Afërsisht 90% e të akuzuarve që vijnë përpara Tribunalit nuk i kanë mjetet për të paguar plotësisht avokatin. Si pasojë, atyre duhet t'u caktohet një avokat nga një listë e avokatëve të kualifikuar që mbahet nga Sekretaria, e njohur si "Lista e Rregullës 45"[351] ose ata duhet të propozojnë caktimin e një avokati tjetër, kualifikimet e të cilit më pas miratohen nga Sekretaria dhe caktohet nëse kredencialet e tij i plotësojnë kërkesat e përcaktuara me Rregullën 45.

5. Sigurimi që avokati i mbrojtjes plotëson standardet minimale të kualifikimeve dhe eksperiencës është thelbësor për të kryer gjyqe të ndershme dhe të shpejta, për të ruajtur funksionimin e rregullt të Tribunalit, dhe për të siguruar integritetin e jurisprudencës së TPNJ-së. Sekretari i plotëson detyrimet e tij nëpërmjet ZNJP-së. Në vlerësimin e kualifikimeve të këshilltarit, ZNJP-ja udhëhiqet jo vetëm nga Rregullat 44 dhe 45 por edhe nga Direktiva mbi Caktimin e Avokatit Mbrojtës (Direktiva).[352]

6. Duke pasur parasysh se Tribunali përfshin një kombinim dinamik të sistemeve të së drejtës anglosaksone dhe ligjit civil, si dhe profesionistëve ligjorë nga e gjithë bota – të cilët sjellin me vete arsimime, eksperienca dhe tradita juridike të ndryshme – në fillim të punës së TPNJ-së shumica menduan se kriteret e rrepta dhe ekzakte për pranimin e avokatit mbrojtës nuk ishin të arsyeshme. Megjithatë, mungesa e kritereve strikte për kualifikimet çoi në raste kur avokatët e miratuar nuk ishin kompetentë dhe kishin etikë të dyshimtë, dhe e lanë sistemin juridik i Tribunalit të rrezikuar nga abuzimet. Si pasojë, një grup pune i përbërë nga gjykatësit e Tribunalit u mblodh në maj 2003 dhe u ngarkua me detyrën e forcimit të kritereve të kualifikimeve të avokatëve që paraqiteshin përpara Tribunalit. Grupi i punës u morr në veçanti me krijimin e një standardi më rigoroz të kompetencës për përfshirjen në Listën e Rregullës 45, si dhe krijimin e një procesi më rigoroz për miratimin e kualifikimeve të avokatit. Në bashkëpunim me Sekretarinë, u propozuan një numër amendamentesh të Rregullave 44 dhe 45 të Rregullores, dhe Nenet 14 dhe 15 të Direktivës hynë në fuqi më 28 korrik 2004.

A.1 Rregulla 44: Kërkesat e përgjithshme për kualifikimet e të gjithë avokatëve të mbrojtjes

7. Rregulla 44(A) përcakton kualifikimet bazë që avokati duhet të zotërojë në mënyrë që të përfaqësojë një të dyshuar ose të akuzuar përpara Tribunalit, përfshi kriteret e mëposhtme:
   - avokati duhet të jetë pranuar për të praktikuar jurisprudencë në një Shtet ose të jetë profesor universiteti i jurisprudencës;[353]
   - avokati duhet të jetë anëtar i rregullt i një shoqate avokatësh që punojnë në Tribunal dhe duhet të miratuar nga Sekretari[354];
   - avokati nuk duhet të jetë shpallur fajtor ose të jenë marrë masa të tjera disiplinore kundër tij në procese përkatëse penale[355] ose disiplinore[356];

350 Rregulla 45(A) RrPD të TPNJ-së (Rregullorja e Procedurës dhe Provave, IT/32/Rev.4i, ndryshuar më 28 shkurt 2008).
351 Identifikon avokatë që plotësojnë kërkesat e Rregullës 45, të RrPD të TPNJ-së, dhe kanë shprehur dëshirën dhe gatishmërinë e tyre për t'u caktuar për çdo të dyshuar ose të akuzuar.
352 Direktiva për Caktimin e Avokatit Mbrojtës, IT/73/REV.11, ndryshuar më 29 Qershor 2006 ("Direktiva").
353 Rregulla 44(A)(i), RrPD të TPNJ-së.
354 Rregulla 44(A)(iii), RrPD të TPNJ-së.
355 Rregulla 44(A)(v), RrPD të TPNJ-së.
356 Rregulla 44(A)(iv), RrPD të TPNJ-së.

- avokati nuk duhet të jetë përfshirë në sjellje të pandershme ose përndryshe diskredituese, ose në sjellje të dëmshme për administrimin e drejtësisë ose që mund të ulin besimin e publikut tek Tribunali ose administrimi i drejtësisë;[357]
- avokati nuk duhet të ketë dhënë informacion të rremë ose mashtrues në lidhje me kualifikimet e tij ose të mos ketë paraqitur informacionin përkatës;[358] dhe
- avokati duhet të flasë ose të shkruajë me zotësi një nga dy gjuhët e punës së Tribunalit (anglishten ose frëngjishten).[359]

8. Rregulla 44(B) ofron një përjashtim nga këto kërkesave e përcakton se "Sekretaria mund të pranojë një avokat i cili nuk flet asnjë nga dy gjuhët e punës së Tribunalit por që flet gjuhën amtare të të dyshuarit ose të të akuzuarit" kur një emërim i tillë kërkohet nga avokati kryesor dhe "atje ku kërkohet nga interesi i drejtësisë."[360] Një avokat i angazhuar privatisht nga një i akuzuar jo i varfër duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e Rregullës 44 dhe duhet të paraqesë një autorizim për përfaqësim te Sekretari. Një avokat i tillë pranohet të përfaqësojë të akuzuarin me anë të një vendimi emërimi pas verifikimit të kualifikimeve të tij.

A.2 Rregulla 45: Kërkesat për kualifikimin e avokatëve mbrojtës të emëruar

9. Ndërkohë që një i akuzuar ka të drejtën të përfaqësohet nga një avokat që e zgjedh vetë,[361] zgjedhja nuk është e pakufizuar, veçanërisht pasi avokati emërohet nga Sekretari dhe paguhet nga fondet publike.[362]

10. Rregulla 45 vendosë kërkesa shtesë që avokatët duhet të plotësojnë për t'u caktuar në një çështje të financuar nga sistemi i ndihmës juridike të Tribunalit. Përjashtimi sipas Rregullës 44(B) në lidhje me kërkesën e gjuhës së Gjykatës, për avokatët që përfaqësojnë të akuzuarit jo të varfër, nuk ju ofrohet avokatëve kryesorë të caktuar për të përfaqësuar një të akuzuar të varfër: Rregulla 45(B)(i) përcakton se kjo kërkesë mund të hiqet vetëm nga Sekretari për avokatët e caktuar në pajtim me Direktivën e cila nga ana tjetër e kufizon përjashtimin vetëm për bashkë-avokatët.[363]

11. Grupi i Punës bëri ndryshime edhe në Rregullën 45(B)(ii) të Rregullores, Nenin 14(A)(iii) të Direktivës, për të kërkuar që avokati i caktuar "*të zotërojë kompetencë të thelluar* mbi ligjin penal dhe/ose të drejtën penale ndërkombëtare/të drejtën ndërkombëtare humanitare/të drejtën ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut" dhe jo "*eksperiencë të arsyeshme*" që avokatit i kërkohej më parë të zotëronte në një nga këto fusha[364]. Veç kësaj, Grupi i Punës vendosi një standard minimal eksperience në disiplinat e zbatueshme të cilat kërkojnë që avokati të ketë të paktën shtatë vjet eksperiencë përkatëse, ose si gjykatës, ose si prokuror, ose si avokat mbrojtës ose në një lloj kapaciteti tjetër në gjykimet penale.[365] Sekretari e ka interpretuar këtë rregull vazhdimisht si kërkesë për eksperiencë në sallën e gjyqit. Së fundi, Rregulla 45 kërkon që avokati që kërkon të pranohet në Listën e Rregullës 45 duhet të paraqesë një deklaratë që tregon gatishmërinë dhe dëshirën e tij

357 Rregulla 44(A)(vi), RrPD të TPNJ-së.
358 Rregulla 44(A)(vii), RrPD të TPNJ-së.
359 Rregulla 44(A)(ii), RrPD të TPNJ-së.
360 Rregulla 44(A), RrPD të TPNJ-së.
361 Neni 21(4)(d), Statuti i TPNJ-së.
362 Shiko p.sh. *Prokurori kundër Vidoje Blagojeviç et al.*, Lënda Nr. IT-02-60-AR73.4, Arsyet Publike dhe ato të Redaktuara për Vendimin mbi Apelin e Vidoje Blagojeviçit për të zëvendësuar ekipin e tij të mbrojtjes, 7 nëntor 2003, siç është konfirmuar nga jurisprudenca e mëpasme.
363 Neni 14(C), Direktiva e TPNJ-së: "Një person që nuk zotëron me shkrim dhe me gojë asnjë nga dy gjuhët e punës së Tribunalit por që flet gjuhën e folur në territorin mbi të cilin Tribunali ka juridiksion, dhe që plotëson të gjitha kërkesat të parashtruara në Nenin 14(A), mund të pranohet në listën e parashtruar në Rregullën 45(B) të Rregullave, nëse Sekretari e konsideron të justifikuar. Një person i tillë mund të caktohet vetëm si bashkë-avokat në pajtim me Nenin 16(D)."
364 Direktiva e TPNJ-së për Caktimin e Avokatit Mbrojtës, IT/73/Rev.9, e ndryshuar më 12 korrik 2002, Neni 14A(iv).
365 Rregulla 45(B)(iii), RrPD të TPNJ-së.

për t'iu caktuar çdo personi të ndaluar nën autoritetin e Tribunalit dhe që nuk i ka mundësitë për të paguar avokatin.[366]

A.3 Lista e avokatëve kujdestarë

12. Në pajtim me Rregullën 45(C), Sekretari mban edhe një listë të veçantë të avokatëve të cilët, përveçse përmbushin kualifikimet e kërkuara të Listës së Rregullës 45, mund të caktohen si "avokatë kujdestarë" për një të akuzuar për qëllime të paraqitjes fillestare.[367] Kjo listë lejon avokatin të caktohet pas një njoftimi afatshkurtër për paraqitjen fillestare përpara Tribunalit, dhe i jep të akuzuarit dhe Sekretarit mundësinë për të zgjedhur me kujdes avokatin për përfaqësim të mëtejshëm. Dispozitat për avokatin kujdestar u futën në Rregullore dhe në Direktivë në korrik të viti 2004 në një përpjekje për të parandaluar vonesat në caktimin/emërimin e avokatit për të përfaqësuar të akuzuarin në paraqitjet fillestare. Në të kaluarën kanë ndodhur vonesa, dhe ato lidheshin me faktin se avokati i zgjedhur nga i akuzuari nuk ishte në dispozicion, ose me pamundësinë për të vlerësuar me kohë kredencialet e avokatit të kërkuar për paraqitjen fillestare.

A.4 Pranimi në Listën e Rregullës 45

13. Sekretaria ka përgjegjësinë përfundimtare për të verifikuar kualifikimet e avokatëve sipas të dy Rregullave 44 dhe 45, dhe që nga viti 2002 ka punuar me Shoqatën e Avokatëve Mbrojtës (ShAM)[368] për të siguruar kompetencën dhe kualifikimet e avokatit që paraqitet përpara Tribunalit. Në mënyrë që të përfshihet në Listën e Rregullës 45, avokati kandidat duhet t'i paraqesë dokumentacion të gjerë[369] Sekretarisë ku të demonstrojë se zotëron kualifikimet e kërkuara të cilat më pas vlerësohen me rreptësi nga ZNJP-ja. Nëse Sekretari është i bindur se kriteret janë plotësuar, kandidati merr konfirmim me shkrim për pranimin e tij në listë. Në disa rrethana, në ndjekje të Nenit 15(B) të Direktivës, Sekretari mund ta referojë një kandidat në një panel të punonjësve të lartë juridikë në Dhoma dhe/ose avokatë me eksperiencë, të kualifikuar "që ta intervistojnë kandidatin dhe të bëjnë një rekomandim tek Sekretari për kërkesën e tij/të saj."[370] Në mënyrë të ngjashme, një kandidati për pranim në Listën e Rregullës 45 mundet t'i kërkohet (dhe shumë vetave ju është kërkuar) të demonstrojnë zotërim e tij në një nga gjuhët e punës së Gjykatës duke ju nënshtruar një testi të zotërimit të gjuhës. Një kandidat i refuzuar, ose një avokat i cili është hequr nga Lista e Rregullës 45, ka pesëmbëdhjetë ditë nga data kur i është njoftuar vendimi i Sekretarit të kërkojë rishikimin nga Presidenti të vendimit për mohimin e pranimit ose heqjen e avokatit nga Lista e Rregullës 45.[371]

14. Disa individë që kanë kërkuar të caktohen në ekipet e mbrojtjes mund të kenë qenë nën hetime, ose mund të kenë qenë përfshirë në një lloj mënyre në mizoritë që janë kryer në konfliktin që gjykohet përpara Tribunalit. Është e kështillueshme që të ndërmerren kontrolle të thella të të kaluarës për të gjithë kandidatët përpara se të bëhen caktimet.

A.5 Caktimi për të përfaqësuar një të akuzuar dhe tërheqja e avokatit mbrojtës[372]

15. Pasi të jetë pranuar në Listën e Rregullës 45, avokati mund të caktohet të përfaqësojë çdo të dyshuar ose të akuzuar përpara Tribunalit, nëse nuk ka pengesa në caktim.[373] Një konflikt interesash ose një konflikt i

366 Rregulla 45(B)(iv), RrPD të TPNJ-së.
367 Rregulla 45(C), RrPD të TPNJ-së për paraqitjen fillestare të të akuzuarit në ndjekje të Rregullës 62.
368 Shiko Kapitullin XV – Pjesa C: Sjellja Profesionale e Avokatit.
369 Neni 15(A), Direktiva e TPNJ-së:
370 Neni 15(B), Direktiva e TPNJ-së:
371 Neni 15(C), Direktiva e TPNJ-së.
372 Kjo procedure zbatohet *mutatis mutandis* në caktimin e avokatit për të dyshuarit.
373 Neni 11(D)(i), Direktiva e TPNJ-së.

programit të punës mund të përbëjë një pengesë për caktimin. Prandaj, pas marrjes së kërkesës së të akuzuarit për caktimin e një avokati specifik nga lista, ZNJP-ja duhet të verifikojë që avokati i zgjedhur nuk ka konflikt interesi. Që të dyve si të akuzuarit ashtu dhe avokatit i jepet një mundësi që të dëgjohen përpara se të merret një vendim përfundimtar. Nëse avokati i zgjedhur nga i akuzuari nuk mund të caktohet, i akuzuari duhet të zgjedhë një avokat tjetër nga lista.

16. Mund të ketë raste kur një i akuzuar ose një avokat mbrojtës kërkojnë tërheqjen e avokatit të caktuar. Kërkesa për tërheqje duhet të mbështetet në arsye të forta që duhet të peshohen kundrejt të drejtave të të akuzuarit, interesave të drejtësisë dhe administrimit efikas dhe të rregullt të drejtësisë. Konfliktet ndërmjet avokatit kryesor dhe bashkë-avokatit ose refuzimi i pajustifikuar i klientit për të komunikuar me avokatin e tij zakonisht nuk janë të mjaftueshme për të tërhequr ose shkarkuar avokatin. Në të njëjtën mënyrë, një avokat që kërkon tërheqjen për arsye personale duhet të japë justifikim për ta mbështetur kërkesën. ZNJP-ja duhet të vlerësojë legjitimitetin e justifikimit të shpallur për tërheqjen për secilën çështje veçmas. Megjithatë, kur një i akuzuar kërkon tërheqjen e avokatit në mënyrë që të përfaqësohet vetë, Dhoma duhet të vendosë nëse duhet ta pranojë zgjedhjen e të akuzuarit për të përfaqësuar veten.

17. Arsyet e mundshme të justifikueshme për tërheqjen e avokatit të caktuar përfshijnë prova se ekziston një konflikt i mundshëm ose aktual interesi ose dëshmi se avokati nuk i përmbush më kërkesat e Rregullës 45. Justifikime shtesë përfshijnë provat e dënimit në proces penal ose disiplinor, provat për shkelje në ushtrimin e detyrës ose paaftësi e demonstruar që dëmton të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë , ose sëmundja e rëndë.

18. Për të plotësuar mandatin e saj, është e rëndësishme që ZNJP-ja të vëzhgojë me shumë rreptësi neutralitetin në marrëdhëniet me organet e tjera të Tribunalit. Pak pas transferimit në Tribunal, i akuzuari duhet siguruar për këtë neutralitet, veçanërisht sepse shumë të akuzuar besojnë gabimisht se i gjithë Tribunali përfaqëson interesat e Zyrës së Prokurorit. Eksperienca e ZNJP-së sugjeron se profesionalizmi me të cilin personeli ka trajtuar çështjet që prekin të akuzuarin dhe mbrojtjen ka ecur drejt përmirësimit të këtij shqetësimi, dhe ndihmës për t'u siguruar se avokati mbrojtës dhe i akuzuari e shikojnë Sekretarinë si një organ neutral.

19. Disa avokatë mund t’i jenë nënshtruar procedurave disiplinore dhe mund të jenë gjetur fajtorë ndërkohë që janë caktuar në ekipe mbrojtjeje. Është e këshillueshme t’i dërgohen përkujtesa periodike avokatëve të mbrojtjes që ata duhet t’i paraqesin Sekretarisë informacion mbi çdo gjë që mund të ketë ndryshuar statusin e tyre përpara Tribunalit. Disa avokatë mund ta neglizhojnë ose mund të mos e informojnë Sekretarinë për papërshtatshmërinë për të vazhduar përfaqësimin e një personi të akuzuar.

20. Kur është dhënë justifikim i mjaftueshëm, e avokati duhet të tërhiqet nga një çështje që është në gjykim, del një nevojë e madhe për një plan tranzicioni që të mbahet avokati që do të tërhiqet për të paktën një muaj ndërsa avokati zëvendësues shërben në kapacitetin e konsulentit juridik. Kjo periudhë kalimtare siguron që avokati zëvendësues të ketë kohë të mjaftueshme të familjarizohet me çështjen dhe caktohet vetëm pasi konfirmimi i është dhënë Sekretarisë nga avokati kryesor.

A.6 Kërkesa e të akuzuarit për avokat të caktuar

21. Kur një i akuzuar pretendon se është i varfër dhe kërkon caktimin e një avokati të paguar nga Tribunali, atij i duhet të bëjë një publikim të plotë të mjeteve dhe aseteve të tij, si dhe pjesëtarëve të familjes së tij, në një formular të *Deklarimit të Mjeteve* të ofruar nga Sekretaria. I akuzuari ka detyrimin e vërtetimit që ai nuk i ka mjetet për të shpërblyer avokatin.[374] Për të përmbushur këtë detyrim, i akuzuari duhet të paraqesë dëshmi

374 Neni 8, Direktiva e TPNJ-së.

për të provuar kërkesën e tij të skamjes dhe duhet të bashkëpunojë me hetimet e Sekretarisë në lidhje me pasurin e tij. Gjatë këtij hetimi, Sekretaria mund të grumbullojë informacion, të dëgjojë të dyshuarin ose të akuzuarin, ose të kërkojë paraqitjen e çdo dokumenti që konsiderohet i rëndësishëm.

22. Sekretaria përcakton masën në të cilën i akuzuari është në gjendje të shpërblejë avokatin duke marrë parasysh pasurinë që i akuzuari zotëron direkt ose tërthorazi ose i përdoron lirisht. Hetimi përfshin, por nuk kufizohet, në të ardhurat direkte, llogaritë bankare, pronat e patundshme ose personale, pensionet dhe aksionet dhe obligacionet financiare ose asetet në zotërim, por përjashton ndihmat e familjes ose ato sociale të cilat ai mund të ketë të drejtë t'i marrë. Në vlerësimin e këtyre mjeteve, Sekretaria duhet të marrë parasysh mjetet e bashkëshortit si dhe të personave me të cilët ai banon normalisht. Nga sasia e përcaktuar e të ardhurave dhe aseteve, llogariten mjetet në dispozicion të të akuzuarit, por zbriten shpenzimet e jetesës së familjes së të akuzuarit dhe personave të varur nga ai për periudhën e përllogaritur gjatë së cilët i akuzuari do të kërkojë përfaqësim përpara Gjykatës.

23. Kur një i akuzuar ka transferuar një interes në një aset në rrethana që demonstrojnë se qëllimi i transferimit ishte që të fshihej pasuria, Tribunali vazhdimisht ka vendosur që pasuri të tilla të llogariteshin në vlerësimin e mjeteve të të akuzuarit. Kjo mënyrë është në pajtim me Direktivën e TPNJ-së që lejon Sekretarin të heqë mbulesën e pronësive të regjistruara për të përcaktuar statusin e vërtetë të financave të një të akuzuari. Ky proces ndihmon që i akuzuari që kërkon ndihmë juridike të mos lejohet të përdorë mbulesën e titullit ligjor për të fshehur statusin e tij të vërtetë financiar.[375]

24. Në mënyrë që të bëhet një përcaktim i besueshëm i skamjes së një të akuzuari, është e nevojshme të punësohet një hetues financiar shumë i kualifikuar me njohuri të shkëlqyera dhe lidhje me rajonin në fjalë, si dhe me eksperiencë në pastrimin e parave ose praktikave të tjera të fshehjes së pasurisë. Kur informacioni i dhënë nga një i akuzuar mbi statusin e tij financiar është i paplotë ose duket i pasaktë, duhet ndërmarrë një hetim i thellë në lidhje me statusin financiar aktual të të akuzuarit. Nëse nuk vendosen masa të tilla, i akuzuari që ka mjete të mjaftueshme për të paguar mbrojtjen, ose për të kontribuar në koston e mbrojtjes së tij, mund të përfitojë pa të drejtë nga fondet publike për mbrojtjen e tij.

25. Kur një i akuzuar ka kërkuar caktimin e një avokati dhe ka paraqitur një *Deklaratë të Pasurisë*, Sekretari duhet të caktojë një avokat për një periudhë që nuk i kalon 120 ditët që të mbrohen të drejtat e të akuzuarit për të pasur avokat ndërkohë që vlerësohet statusi i tij financiar. Nëse si rezultat i hetimit financiar, i akuzuari gjendet të jetë plotësisht ose pjesërisht i skamur, avokati caktohet përherë dhe kostoja e mbrojtjes së të akuzuarit mbulohet përkatësisht plotësisht ose pjesërisht nga Tribunali. Në rastin e fundit, të akuzuarit i kërkohet të japë një kontribut financiar ndaj kostos së mbrojtjes së tij, siç përcaktohet nga Sekretaria.[376] Nëse vërtetohet se i akuzuari është plotësisht jo i skamur, kërkesa e tij për caktim avokati hidhet poshtë.[377]

26. Për çështjet që kanë të bëjnë me konstatimin (e plotë ose të pjesshëm) të skamjes, i dyshuari ose i akuzuari mund të apelojë ndaj vendimit të Sekretarit tek Presidenti ose tek një Dhomë, varësisht nga çështja.[378] Ndërhyrja gjyqësore është e domosdoshme për shkak të rëndësisë që ka përfaqësimi për të drejtën për gjykim të paanshëm.

27. Vlerësimi i skamjes së një të akuzuari mund të zgjasë disa muaj, veçanërisht kur hetimi kërkon bashkëpunimin nga shtetet në lidhje me llogaritë në banka të huaja ose aseteve të mbajtura në shtete të ndryshme. Për këtë

375 Shiko Nenet 9 dhe 10, të Direktivës së TPNJ-së, dhe Politikën e Sekretarisë për Përcaktimin e Masës në të cilën një i akuzuar është në Gjendje të Shpërblejë Avokatin Mbrojtës (Politika e Skamjes).
376 Neni 11(A) (i) dhe (ii), Direktiva e TPNJ-së.
377 Neni 11(A) (iii), Direktiva e TPNJ-së.
378 Neni 13, Direktiva e TPNJ-së.

arsye, një të akuzuari që kërkon ndihmë juridike i duhet caktuar avokati mbi baza të përkohshme në pritje të përcaktimit të skamjet në mënyrë që të mbrohet e drejta e të akuzuarit për të pasur një avokat, si dhe për të siguruar përgatitjen e qetë për gjykim pa vonesa të panevojshme të procesit.

28. Duhet krijuar një sistem për të siguruar që i akuzuari ta paguajë kontributin e tij të vlerësuar për avokatin, nëse refuzon ta bëjë një gjë të tillë. Tribunali duhet të marrë përgjegjësinë për të zbatuar vendimet e kontributit, mundësisht nëpërmjet mjeteve ligjore që lejojnë për shembull shitjen e aseteve të të akuzuarit. Mungesa e një kuadri në Rregulloren e Tribunalit për zbatimin e vendimeve të tilla paraqet vështirësi në marrjen e kontributit. Vështirësi të tjera dalin në sigurimin e fondeve të tilla kur fondet mbahen në llogari bankare të huaja, ose asetet janë larguar për shkak të procedurave komplekse ligjore që kërkojnë kohë mjaft të gjata.

A.7 Caktimi i pjesëtarëve të tjerë të ekipit të mbrojtjes

29. Kur avokati i caktohet një të akuzuari të skamur, ai mund të kërkojë që Sekretaria të caktojë një avokat të dytë (bashkë-avokat) dhe personel ndihmës për të ndihmuar në përgatitjen e çështjeve me shtrirje dhe rëndësi të madhe. Bashkë-avokatët zakonisht zgjidhen nga Lista e Rregullës 45 përveçse kur bëhet një përjashtim sipas Nenit 16(D) të Direktivës për caktimin e një bashkë-avokati i cili nuk e flet gjuhën e punës së Tribunalit. Për sa i përket personelit ndihmës, Sekretaria, nëpërmjet ZNJP-së, verifikon kualifikimet e personelit ndihmës të propozuar duke miratuar *curriculum vitae-n* e tyre dhe dokumentet e tjera, dhe kryen një kontroll për konflikt interesi për t'u siguruar që emërimi i një punonjësi të caktuar ndihmës nuk bie në konflikt me caktimet aktuale apo të mëparshme, dhe se nuk ka qenë nën hetime nga Tribunali. Për të minimizuar mundësinë për abuzime të sistemit të ndihmës juridike të Tribunalit, nuk lejohet caktimi i pjesëtarëve të familjes ose miqve të ngushtë të avokatit ose të të akuzuarit.

A.8 Ndihma për Mbrojtjen

30. Mbrojtja duhet të vendoset nën procedura të barabarta me Prokurorinë që të respektohet parimi i armëve të njëjta. Tribunali e ka për detyrë që t'i japë ndihmë administrative dhe logjistike Mbrojtjes sepse Mbrojtja nuk është një organ i Tribunalit dhe qendra e Tribunalit është larg nga vendngjarja e krimit, vendi i banimit të avokatit dhe rrjeti i tij mbështetës. Përveç kësaj, Sekretaria ka krijuar një skemë gjithëpërfshirëse shpërblimi dhe ka zbatuar disa sisteme dhe politika për të ndihmuar ekipet e Mbrojtjes gjatë të gjitha fazave të procesit.

31. Këto sisteme dhe politika përfshijnë:
   - ofrimin e lehtësive në godinat e Gjykatës, të tilla si zyra për Mbrojtjen me akses interneti, printera, dhe makina fotokopjuese;
   - sigurimin e pajisjeve dhe shërbimeve të teknologjisë së informacionit;
   - ofrimin e përdorimit të bazës së të dhënave gjyqësore të Tribunalit;
   - ndihmën (d.m.th rezervimet) dhe pagesat për udhëtimet e punës;
   - ofrimin dhe ndihmën e të gjitha komunikimeve ndërmjet avokatit dhe klientit nëpërmjet kanaleve të privilegjuara.

32. Mungesa e hapësirës së zyrave brenda Tribunalit u bë një faktor kufizues kur u rrit numri i personave të akuzuar çështjet e të cilëve ishin duke u gjykuar, dhe disa ekipe mbrojtjeje duhet të ishin fizikisht të pranishëm në Hagë. Vendimi i TPNJ-së për të futur një sistem parapagese të një të caktuar, që përfshinë edhe koston e zyrës, mundësoi avokatët e mbrojtjes të merrnin me qira hapësira jashtë Tribunalit. Ndërkohë që kërkesat operacionale kërkojnë që t'i ofrohet Mbrojtjes një hapësirë në godinat e Tribunalit, një hapësirë e

tillë përdoret si një dhomë përgatitjesh dhe një vend ku pjesëtarët e ekipit të mbrojtjes mund të organizojnë mbledhje të shkurtra përpara ose pas seancave gjyqësore dhe gjatë pushimeve të gjykimit.

33. Mbrojtja duhet të jetë në gjendje të kontaktojë direkt me seksionet e Tribunalit që kanë të bëjnë me punën e saj, të tilla si SMGjSh, SKSHGJ, Sigurimi dhe Dhomat. Këto kontakte direkte rrisin efikasitetin dhe ndihmojnë në integrimin e mbrojtjes që gjatë viteve të mëparshme është mbajtur larg dhe është izoluar. Personeli i mbrojtjes po ashtu ka të drejtën të përdorë vendet e përbashkëta brenda Gjykatës të tilla si kafeteria. Megjithatë, për arsye sigurie, hyrja në pjesë të ndryshme të Gjykatës duhet të jetë e kufizuar (sikurse që është për anëtarë të personelit).

B. Politikat e pagesës

34. ZNJP-ja, në konsultim me Shoqatën e Avokatëve të Mbrojtjes (ShAM), ka adoptuar një numër politikash për pagesat që rregullojnë pagesat e ekipeve të Mbrojtjes që përfaqësojnë të akuzuar të skamur gjatë fazave të procesit Paragjyqësor, të Gjykimit dhe Apeleve. Përveç kësaj, është krijuar edhe një skemë shpërblimi për të akuzuarit që përfaqësohen vetë.[379]

35. Sistemi i ndihmës ligjore të TPNJ-së i është nënshtruar një reforme të madhe në vitet e fundit. Sekretaria ka hequr dorë nga skema e mëparshme të pagesave me orë, e cila ishte bazuar në një numër maksimal orësh në muaj, sepse provoi të ishte tejet burokratike, e ngarkuar dhe e shtrenjtë dhe e ka zëvendësuar me një skemë parapagese të një shume të paracaktuar.[380] Tranzicioni nga një skemë pagese bazuar në një numër maksimal të orëve të punës të shpërblyera me një vleftë të caktuar në një politikë pagese të një shumë të paracaktuar ka qenë një nga arritjet më të rëndësishme në menaxhimin e fondeve të ndihmës ligjore. Shuma e paracaktuar, siç është zbatuar në TPNJ, është krijuar për të ofruar burime të përshtatshme për ekipet e mbrojtjes dhe më shumë fleksibilitet në shpërndarjen e fondeve të ndihmës juridike, ndërkohë që ulet barra administrative e Tribunalit dhe e avokatit të mbrojtjes. Mekanizmat e kontrollit lejojnë Sekretarinë të monitorojë shpenzimet e fondeve publike dhe të reagojë me shpejtësi nëse ndodhin parregullsi. Natyrisht, përdorimi i sistemit të pagesave me një shumë të paracaktuar mund të zbatohet vetëm nëse ata që marrin financim për avokatin mbrojtës janë nën detyrim që të sigurojnë menaxhimin efikas të fondeve. Përveç kësaj, shpenzimet e udhëtimeve që bëhen nga mbrojtja në lidhje me përgatitjen e mbrojtjes duhet të mbulohen nga Gjykata.

379 Skema e 28 shtatori 2007 për Shpërblimin e Personave që Ndihmojë të Akuzuarit e Skamur që Përfaqësohen Vetë.
380 Shiko Raportin Gjithëpërfshirës të Sekretarit të Përgjithshëm mbi Ecurinë e TPN-së për ish-Jugosllavinë për Reformimin e Sistemit të Ndihmës Juridike A/58/288 të datës 12 gusht 2003, para. 17 *et seq*.

B.1 Politika e ndihmës juridike përpara gjyqit

36. Sistemi i pagesës së një shume të paracaktuar sipas Politikës së Ndihmës Juridike Përpara Gjyqit[381] është krijuar për t'i dhënë avokatit fleksibilitet maksimal në përdorimin e burimeve dhe për ta lejuar avokatin kryesor të përdorë shumën e paracaktuar për të punësuar pjesëtarë të ekipit të Mbrojtjes në një mënyrë që i përshtatet më së miri nevojave të ekipit. Megjithatë, Sekretari duhet që të miratojë të gjithë pjesëtarët e ekipit të Mbrojtjes për t'u siguruar që ata janë të kualifikuar dhe se nuk ka konflikte të interesit ose probleme të tjera etike. Politika e Ndihmës Juridike Përpara Gjyqit ndjek një skemë që i ndryshon pagesat bazuar në një nga tre nivelet e kompleksitetit në secilin rast: (1) i vështirë; (2) shumë i vështirë; ose (3) jashtëzakonisht i vështirë/udhëheqje. Pagesat i bëhet avokatit në pajtim me një shumë të caktuar në pajtim me nivelin e kompleksitetit. Shuma e caktuar jepet në pagesa mujore që nuk përfaqësojnë një caktim orësh në muaj.

37. Për qëllim të pagesave, periudha përpara gjyqit konsiston në tre faza:

- Faza një – faza e paraqitjes fillestare;
- Faza dy – faza në të cilën dorëzohen mocionet parapraket dhe plani i punës; dhe
- Faza tre – përgatitja për vetë gjyqin.

38. Në Fazën Një, faza e paraqitjes fillestare, avokati do të caktohet të përfaqësojë një të akuzuar në paraqitjen fillestare dhe çdo çështje tjetër që duhet derisa të caktohet avokati i përhershëm. Kjo fazë fillon me caktimin e avokatit dhe përfundon një ditë pasi i akuzuari të jetë deklaruar mbi fajësinë. Në këtë fazë pas paraqitjes së një fature *pro forma* [382] bëhet pagesa e shumës së paracaktuar.[383]

39. Në rast se avokati që është caktuar për paraqitjen fillestare vazhdon të përfaqësojë klientin e tij mbas deklarimit mbi fajësinë, Faza Dy fillon ditën pas datës në të cilën është bërë deklarimi mbi fajësinë nga i akuzuari ose në emër të të akuzuarit. Kur caktohet një avokat i ri pas një deklarimit të fajësisë, Faza Dy fillon ditën e caktimit në detyrë. Faza Dy përfundon 90 ditë pas fillimit ose kur të paraqitet Plani i Punës, cilado datë që i bie më vonë. Sekretari llogarit shumën e paracaktuar të Fazës Dy bazuar në një formulë që supozon se mbrojtja do të përfshijë një avokat dhe një personel ndihmës.[384] Caktimi i një avokati të dytë ose personelit ndihmës shtesë nuk është e ndaluar, por personeli shtesë nuk çon në rritjen e shumës së caktuar të marrë për Fazën Dy. Pagesat e shumës së paracaktuar për Fazën Dy bëhen në tre pagesa të barabarta mujore.[385] Pagesa e shumës së paracaktuar si për Fazën Një ashtu dhe për Fazën Dy ndryshohet vetëm pasi të jenë paraqitur fakte detyruese ose rrethana ligjore, ose zhvillime të tjera që kanë çuar në një rritje të konsiderueshme në sasinë e punës. Përveç kësaj, shuma e paracaktuar për Fazat Një dhe Dy nuk varet nga kompleksiteti i çështjes.

40. Avokatit kryesor i kërkohet të paraqesë një Plan Pune deri në fund të Fazës Dy i cili është një dokument i menaxhimit gjyqësor[386] që lejon Sekretarinë të monitorojë përgatitjen për çështjen të ekipit të Mbrojtjes dhe ofron një referencë për caktimin e burimeve ekipit të Mbrojtjes. Në të njëjtën kohë që dorëzohet Plani i

381 Avokati mbrojtës – Politika e Ndihmës Juridike Paragjyqësore, 1 maj 2006.

382 Fatura duhet të nënshkruhet nga avokati dhe të dorëzohet brenda 60 ditësh pas përfundimit të fazës së parë. Fatura këshillon Sekretarinë se si të shpërndajë pagën ndërmjet pjesëtarëve të ekipit të Mbrojtjes.

383 Avokatit i caktohet një shumë e caktuar standarde prej 1,688.00 euro për Fazën një. Përfshirë në këtë shumë të caktuar janë të gjitha shpenzimet e përkthimit dhe kostot e përkthimit të dokumenteve përveç atyre dokumenteve që do të sillen si prova, të cilat përkthehen nga TPNJ-ja. Nuk përfshihen ato kosto përkthimi dhe interpretimi që bëhet për të lehtësuar komunikimin ndërmjet klientit dhe avokatit. Ekipi i Mbrojtjes mund të faturojë veçmas për këto kosto deri në 1000 euro në muaj.

384 Shuma totale e paracaktuar për fazën tre mujore është 40,707euro dhe përfshin koston e zyrës.

385 Dy pagesat e para paguhen pas dorëzimit nga avokati të një fature *pro forma* në fund të çdo muaji. Pagesa e fundit paguhet pas dorëzimit të faturës *pro forma* dhe një Plani Pune për Fazën Tre të periudhës përpara gjyqit.

386 Një Plan Pune përbëhet nga 15 pjesë së ndryshme, e të gjitha këto duhet të jenë të shtjelluara.

Punës, ekipi i Mbrojtjes duhet t'i paraqesë Sekretarisë një parashtrim të arsyetuar që ka të bëjë me përcaktimin nga Dhoma[387] të nivelit të kompleksitetit të çështjes.

41. Faza Tre fillon ditën pas mbarimit të Fazës Dy dhe përfundon me fillimin e gjykimit. Sekretari llogarit shumën e caktuar për Fazën Tre bazuar në kompleksitetin e çështjes.[388] Shuma e paracaktuar për një çështje të Nivelit Një (të vështirë) të Fazës Tre bazohet mbi punën e një avokati dhe dy personave ndihmës.[389] Shuma e paracaktuar për një çështje të Nivelit Dy (shumë i vështirë) të Fazës Tre bazohet mbi punën e një avokati dhe tre personave ndihmës.[390] Shuma e paracaktuar për një çështje të Nivelit Tre (jashtëzakonisht i vështirë/udhëheqje) të Fazës Tre bazohet mbi punën e një avokati dhe pesë personave ndihmës.[391] Sikurse në Fazën Dy, bashkë-avokatë dhe persona ndihmës mund të caktohen në çdo ekip në çdo kohë, por kjo nuk dot të çojë në rritjen e shumës së caktuar.[392] Rritjet në nivelin e kompleksitetit mund të ndodhin pas një kërkese, por vetën në rastet fillimisht të përcaktuara në Nivelin Një ose Dy. Ndryshimet në shumën e paracaktuar mund të ndodhin vetëm nëse avokati kryesor demonstron rrethana të paparashikueshme që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi kohën e arsyeshme që i kërkohet ekipit të Mbrojtjes për përgatitjen.

42. Avokati duhet të dorëzojë edhe fatura mujore *pro forma* për Fazën Tre. Pagesa bëhet pas dorëzimit të faturave në pagesa mujore dhe fillon vetëm pasi Sekretari të pranojë Planin e Punës. Tetëdhjetë përqind e shumës së caktuar të Fazës Tre paguhet në pagesa mujore ndërsa pjesa e mbetur prej njëzet përqind paguhet pas pranimit të Raportit të Përfundimit të Fazës nga ekipi i mbrojtjes.[393] Avokati kryesor duhet të regjistrojë orët dhe punën e bërë nga ekipi i Mbrojtjes edhe pse avokatit të Mbrojtjes i kërkohet të paraqesë raporte të ecurisë çdo katër muaj gjatë Fazës Tre, dhe një Raport të detajuar të Përfundimit të Stadit në fund të Fazës.[394]

B.2 Skema e pagesës gjyqësore

43. Në ngjashmëri me politikën e pagesës paragjyqësore, skema e ndihmës juridike Gjyqësore[395] përcakton një shumë të caktuar për ekipin e Mbrojtjes për fazat e Gjykimit. Shuma e paracaktuar për secilën çështje llogaritet duke shumëzuar kështet me numrin e muajve që vlerësohet se do të zgjasë secila çështje.[396]

387 Niveli i kompleksitetit përcaktohet nga Sekretari pas konsultimit me përfaqësuesit nga Dhoma, Prokuroria dhe Mbrojtja, e kjo bëhet me anë të takimeve ose me shkrim. Vlerësimi i kompleksitetit të një çështjeje në çdo stad përcaktohet nga faktorë të ndryshëm, jo të kufizuar në pozicionin e të akuzuarit brenda hierarkisë politike/ushtarake; numrin dhe natyrën e akuzave në aktakuzë; nëse çështja ngre probleme të reja; nëse çështja përfshin disa bashki (dimensioni gjeografik i çështjes); kompleksitetin e argumenteve ligjore dhe faktike të përfshira; dhe numrin e llojin e dëshmitarëve dhe dokumenteve të përfshira. Shiko për shembull përcaktimin e kompleksitetit në Periudhën Paragjyqësore në çështjen kundër Johan Tarčulovski - Niveli 1; Dragomir Milošević - Niveli 2; Momčilo Perišić - Niveli 3.

388 Pjesëtarët e secilit ekip të Mbrojtjes dhe tarifat e tyre të pagesës përllogariten në bazë të asaj që konsiderohet e arsyeshme për llogaritjen e shumës së caktuar, por nuk konsiderohen përshkruese. Avokati kryesor ka fleksibilitet të plotë se si të krijojë dhe kompensojë ekipin e Mbrojtjes.

389 Shuma totale e paracaktuar është e barazvlefshme me 94,415 euro, që përfshin një komponent të kostos së zyrës.

390 Shuma totale e paracaktuar është e barazvlefshme me 192,759 euro, që përfshin një komponent të kostos së zyrës.

391 Shuma totale e paracaktuar është e barazvlefshme me 340.432 euro, që përfshin një komponent të kostos së zyrës.

392 Shuma e paracaktuar llogaritet mbi bazat e sasisë së punës të nevojitur për të përgatitur çështjen për gjykim dhe jo në numrin e pjesëtarëve të ekipit të Mbrojtjes që ndajnë punën.

393 Pagesa për këtë fazë llogaritet duke ndarë tetëdhjetë përqind të shumës së paracaktuar duke vlerësuar numrin e muajve në fazë. Në mungesë të një vlerësuar të qartë të kohëzgjatjes së fazës, shuma e paracaktuar e Fazës Tre shpërndahet si më poshtë: për çështje të Nivelit Një – gjatë 12 muajve, për çështje të Nivelit Dy – gjatë 15 muajve dhe për çështje të Nivelit Tre – gjatë 18 muajve.

394 Raportet e Ecurisë duhet të përmbledhin punën e bërë nga ekipi i Mbrojtjes, përfshi ecurinë e bërë bazuar në elementet e përfshirë në Planin e Punës. Me iniciativën e tij ose me kërkesën e avokatit kryesor, Sekretari mund të organizojë një takim për të diskutuar një raport ecurie. Raporti i Përfundimit të Fazës duhet të përfshijë një llogari zyrtare të orëve në fazën paragjyqësore si dhe detajet e llojit të punës së kryer nga secili anëtar i ekipit gjatë kësaj periudhe. Mbrojtja duhet po ashtu të mbajë të gjitha dosjet e Mbrojtjes për një periudhë prej të paktën pesë vjetësh pas përfundimit të procesit në mënyrë që Sekretari të kontrollojë punën e bërë.

395 Avokati i mbrojtjes – Politika e Ndihmës Juridike Gjyqësore, 1 maj 2006 ("Politika e Ndihmës Juridike Gjyqësore").

396 Pagesat përbëhen nga tre komponentë: (1) rroga bruto e një pjesëtari të personelit P5 Hapi VII plus një komponent për koston e zyrës, që arrin një total prej 14,093 euro (për avokatin kryesor); (2) rroga bruto e një pjesëtari të personelit P4 Hapi VII plus kostoja e zyrës, një total prej

Vlerësimi i kohëzgjatjes së fazave të Prokurorisë dhe Mbrojtjes bazohet në kohën e caktuar nga një Dhomë Gjyqi për paraqitjen e çështjeve të tyre përkatëse. Për këtë arsye, pjesa totale për çdo muaj do të përfshijë pagesat mujore të rregullta dhe një pagesë mujore për kostot e përkthimit dhe interpretimit të klientit-avokatit.[397] Megjithatë, shuma e paracaktuar për fazat e Prokurorisë dhe Mbrojtjes mund të modifikohet kur Dhoma e Gjyqit e ka zgjatur kohën e fazës ose kur faza është shkurtuar krahasuar me përcaktimin fillestar.

44. Sekretari duhet të përcaktojë sasinë e shumës së paracaktuar pas konsultimit me Dhomën Gjyqësore dhe palët, dhe pasi të ketë vlerësuar që të dyja: (1) kohëzgjatjen e përllogaritur të fazës,[398] dhe (2) kompleksitetin e fazës. Faza e gjyqit ndahet në Fazën e Prokurorisë dhe Fazën e Mbrojtjes.[399] Ekipi i Mbrojtjes do të marrë një parapagesë,[400] një pagesë të paguar automatikisht çdo muaj, [401] dhe një pagesë të Përfundimit të Fazës.[402] Parapagesa dhe pagat mujore konsiderohen pagesa paraprake kundrejt shumës së paracaktuar dhe jo pagesë për orë.

45. Pagesa e Përfundimit të Fazës normalisht bëhet brenda një muaji pasi Sekretari të ketë pranuar një Raport të Përfundimit të Fazës.[403] Raporti është i ngjashëm me Raportin e Përfundimit të Fazës në fazën paragjyqësore.[404] Bazuar në Raport dhe çdo informacion shtesë të marrë nga avokati kryesor, Sekretari shpërndan pjesën e mbetur të shumës së caktuar, përveçse kur ka arsye të besojë se mund të kenë pasur parregullsi në punën ose sjelljen e ekipit të Mbrojtjes.

B.3 Skema e pagesës së apeleve

46. Skema e pagesës së apeleve është strukturuar ndryshe nga fazat paragjyqësore dhe gjyqësore. Sekretaria shpërndan fondet në zbatim të një sistemi me orë me një pjesë maksimale orësh për të gjithë fazën e Apelit.[405] Skema e Pagesave të Apeleve është si më poshtë: sa herë që një ekip i Mbrojtjes bën apele, çështja paraprakisht klasifikohet si çështje e Nivelit Një (të vështirë). Çështjes së Nivelit një më pas i caktohet një maksimum prej 1,500 orës për punën e avokatit dhe deri 450 orë për punën e personelit ndihmës. Me kërkesë, një çështje mund të ngrihet në nivelin e saj të kompleksitetit në pajtim me standardet e përcaktuara për fazën paragjyqësore dhe gjyqësore, dhe në përgjithësi një rritje ofron një numër më të lartë orësh.[406] Për

11,645 euro (për bashkë-avokatin); dhe (3) një komponent për personel ndihmës në një total prej 3,000 euro për çështje të vështira, 9,000 euro për çështje shumë të vështira dhe 15,000 euro për çështje jashtëzakonisht të vështira/udhëheqësish.

397 Ndarja mujore në total (d.m.th. avokati kryesor, bashkë-avokati dhe personeli ndihmës) për këtë arsye është: (1) për çështje të vështira 25,738 euro +3,000 euro = 28,738 euro, (2) për çështje shumë të vështira 25,738 euro + 9,000 euro = 34,738 euro dhe (3) për çështje jashtëzakonisht të vështira 25,738 euro + 15,000 euro = 40,738 euro (kjo nuk përfshin pagesën mujore të kostove të përkthimit dhe interpretimit të klientit me avokatin). Në dispozicion të mbrojtjes është një maksimum prej 1,000 euro në muaj për kostot e përkthimit dhe interpretimit ndërmjet klientit-avokatit.

398 Në përgjithësi praktika gjatë gjithë rrjedhës së procesit, si në fazën paragjyqësore ashtu dhe në fazën gjyqësore ka qenë që Zyra për Ndihmë Juridike dhe Çështjet e Paraburgimit të kërkojë mendimin në lidhje me kohëzgjatjen e një çështjeje kur kohëzgjatja e çështjes ka ndryshuar nga koha kur është bërë vlerësimi fillestar në lidhje me nivelin e pritshëm të kompleksitetit dhe pagesave të Mbrojtjes.

399 Në rast se asnjë nga këto faza nuk parashikohet se do të zgjasë më shumë se dymbëdhjetë muaj, një fazë mund të nën-ndahet në dy faza të veçanta. Shumat e paracaktuara të veçanta më pas do të llogariten dhe caktohen për secilën fazë të gjyqit në kohën që kjo fazë e gjyqit është gati të fillojë. Në rast se e gjithë faza e gjyqit pritet të zgjasë më pak se dymbëdhjetë muaj, kjo do të përbëjë një fazë.

400 Dhjetë përqind e shumës së paracaktuar jepet në fillim të fazës së Prokurorisë në ditën që fillojë procesi gjyqësor.

401 Pagesa llogaritet duke pjesëtuar shumën e paracaktuar me numrin e vlerësuar të muajve, dhe duke e shumëzuar atë shumë me shtatëdhjetë përqind. Avokatit të mbrojtjes i kërkohet të paraqesë një deklaratë mujore, një faturë *pro forma*, ku të ketë thënë se si duhen ndarë pagesat.

402 Ekipi i Mbrojtjes ka të drejtën të marrë pjesën e shumës së paracaktuar që është mbajtur. Nëse kohëzgjatja aktuale është e njëjtë si dhe kohëzgjatja e përllogaritur, atëherë pagesa e Përfundimit të Fazës do të jetë e barabartë me njëzet përqind të shumës së paracaktuar. Në të gjitha rastet e tjera Sekretari llogarit përsëri shumën e paracaktuar në pajtim me kohëzgjatjen e rishikuar dhe bashkërendon shifrat.

403 Politika e Ndihmës Juridike Gjyqësore, para. 10.

404 Dosjet duhet të mbahen për një periudhë të paktën pesëvjeçare sikurse në fazën Paragjyqësore.

405 Shiko Direktivën e Praktikave të Pagesave të Ndihmës Juridike, 1 janar 2011.

406 Nëse çështja rritet në një nivel më të lartë kompleksiteti, një çështjeje të Nivelit Dy (shumë e vështirë) do t'i caktohen 1,400 orë pune për avokat dhe 600 orë për pune për personelin ndihmës, dhe një çështjeje të Nivelit Tre (shumë e vështirë/udhëheqës) do t'i caktohen 2,100 orë

shkak të numrit të madh të pritur të proceseve për apel në 2009 dhe 2010, ZNJP-ja në konsultim me ShAM-në, aktualisht po finalizon një politikë të ndihmës juridike me një shumë të paracaktuar për apelet.[407] Ndërkohë që politika nuk ka kaluar nëpërmjet konsultimeve me ShAM-në dhe me seksione të ndryshme të Tribunalit, ZNJP-ja parashikon një sistem pagesash me shumë të paracaktuar të ngjashëm me atë të përdorur në fazën paragjyqësore dhe gjyqësore. Në veçanti, përcaktohet se ekipit të Mbrojtjes do t'i paracaktohet një sasi totale parash që të shpërndahen çdo muaj dhe një pjesë e shumës së paracaktuar do të mbahet nga Sekretaria dhe do të shpërndahen në fund të fazës. Propozimi i Sekretarisë është bazuar në një rishikim për të gjitha apelet që janë sjellë përpara Tribunalit deri më sot. Ky rishikim fokusohet në disa karakteristika, sidomos në kompleksitet dhe ngarkesën e punës, që janë të përbashkëta për shumicën e apeleve. Për këtë arsye përcaktohet që një shumë e paracaktuar standarde do të caktohet për të gjitha "apelet standarde", d.m.th., apele të cilat plotësojnë kriteret. Faktorët shtesë në treguesit e kompleksitetit standard dhe ngarkesës së punës mund të garantojnë financim shtesë për çështje të veçanta, në pajtim me kriterin e paracaktimit.

47. Në një Tribunal në të cilin përkthimi i materialeve nga gjuha amtare në gjuhët e punës së Tribunalit është i nevojshëm, është e domosdoshme që të futen kostot e përkthimit në pagesat e shumës së paracaktuar në mënyrë që avokati të punësojë ndihmës të gjuhës për të përkthyer dokumentet. Skema e pagesës duhet të përfshijë edhe një shumë të veçantë për përkthime vetëm për klientin dhe avokatin kur avokati i mbrojtjes nuk flet gjuhën e të akuzuarit.

48. Rregullat dhe Rregulloret që rregullojnë çështjet që i përkasin avokatit të mbrojtjes duhet të përfshijnë masa të hartuara për të mbrojtur integritetin e Tribunalit. Dispozita të veçanta në Direktivë për caktimin e Avokatit të Mbrojtjes dhe Kodin e Sjelljes duhet të përfshihen për të ndaluar parregullsitë financiare të si ndarjen e pagesave dhe praktikat joetike nga avokati i mbrojtjes. Duhen filluar gjithnjë procese disiplinore aty ku konstatohen shkelje të tilla dhe duhen zbatuar sanksione për të mbrojtur integritetin e Tribunalit.

B.4 Caktimi i ekspertëve

49. Sistemi i ndihmës juridike ofron edhe mundësinë e caktimit të ekspertëve për Mbrojtjen. Dëshmitarë ekspertë ose ekspertë mjekësor/psikologë angazhohen nga Mbrojtja, japin dëshmi me shkrim dhe/ose mund të dëshmojnë në gjykim. Ndërkohë që Dhoma përcakton synimin e ekspertizës së kërkuar, dhe pranimin në proces, Sekretaria administron emërimin. Sekretaria do të kompensojë një pjesë maksimale prej 150 orësh për fazën paragjyqësore dhe 150 orë për fazën gjyqësore.[408] Dëshmia e dëshmitarëve ekspertë në gjyq kompensohet veçmas. Ndarja përfshin të gjithë punën e nevojshme që duhet bërë për detyrën, përfshi kërkimin, dhe hartimin e ekspertizës së shkruar. Pagesa e kohës së udhëtimit të ekspertit nuk faturohet si orë të punës.[409]

B.5 Të akuzuarit që përfaqësohen vetë

50. Në shtator 2007, Tribunali përcaktoi Skemën e Shpërblimit për Personat që Ndihmonin të Akuzuarit e Skamur që Mbrohen Vetë.[410] Udhëhequr nga Neni 21 i Statutit për të drejtat e gjyqit të paanshëm, dhe duke ju

pune për avokat dhe 900 orë për personel ndihmës.

407 Politika e re pritet që të funksionojë plotësisht në vitin 2009.

408 Ekspertët paguhen për orë. Orët e punës paguhen në pajtim me tarifën e zbatueshme siç është caktuar nga Sekretaria bazuar në ekspertizën përkatëse të ekspertit.

409 Seksioni i Viktimave dhe Dëshmitarëve të Tribunalit organizon udhëtimin e dëshmitarëve ekspertë për dhënie dëshmie. Përndryshe, Sekretaria nuk mbulon asnjë shpenzim udhëtimi që ka të bëjë me ekspertizën përveçse ato të ekspertëve mjekësorë dhe psikologjikë, të cilët duhet t'i bëjnë vizita periodike të akuzuarit.

410 Për kontekstin ligjor, shiko *Prokurori kundër Momcilo Krajišnik,* (IT-00-39-A), Vendim mbi Kërkesën e *Krajišnik-ut*dhe mbi Mocionin e Prokurorisë, 11 shtator 2007.

referuar qëllimisht Direktivës dhe politikave të tjera të Sekretarisë, Sekretaria paguan për një numër të kufizuar personash që ndihmojnë një të akuzuar të skamur që përfaqësohet vetë.[411] Skema e shpërblimit është bazuar në një sistem me orë që lejon një numër maksimal orësh në muaj, për të gjitha fazat e procedimit, ku fazat paragjyqësore dhe e apelit mblidhen me një numër të përgjithshëm orësh për fazë, dhe faza gjyqësore rregullohet me një maksimum orësh për muaj.[412] Kërkesat e kualifikimeve për pjesëtarët e ekipit ndihmës janë të ngjashme me ato të personelit ndihmës që ndihmojnë avokatin.[413] Përveç dhënies së fondeve për personat që ndihmojnë të akuzuarin e skamur që përfaqësohet vetë, ZNJP-ja po ashtu siguron që një i akuzuar i tillë të ketë mundësi të përshtatshme për të përgatitur çështjen, duke marrë parasysh nevojat specifike të secilit të akuzuar, fazën e veçantë të procedimeve dhe sigurinë dhe rendin e duhur të Njësisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara ku mbahen të akuzuarit.

51. Sistemi i pagesave të shumës së paracaktuar nuk mund të përdoret për të akuzuarit që përfaqësohen vetë. Në vend të tij Sekretaria rishikon faturat e paraqitura dhe paguan të gjithë personelin ndihmës në pajtim me tarifën maksimale të orëve të përcaktuar në skemën e shpërblimeve për të akuzuarit që përfaqësohen vetë.

52. Përvoja ka treguar se çështjet e të akuzuarve që përfaqësohen vetë janë me shumë ngarkesë, duke zënë deri 50% të kohës së personelit ligjor të ZNJP-së, dhe mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit ofruar ekipeve të tjera të mbrojtjes. Krijimi i një zyre *Pro Se* që të merret vetëm me të akuzuarit që përfaqësohen vetë ka ndihmuar në lehtësimin e barrës së tepërt administrative të vendosur mbi ZNJP-në, por edhe siguron që i akuzuari që përfaqësohet vetë të marrë një nivel të përshtatshëm shërbimi, dhe që të ketë një konsistencë se si të trajtohen të akuzuarit që përfaqësohen vetë.

B.6 Organizime të tjera

53. Duhet vendosur një strukturë pagesash për çështje të tjera më të vogla të tilla si shpërfillja e çështjeve që dalin padyshim në procedimet e Tribunalit. Rastet e shpërfilljes, për shembull, ndryshojnë mjaft në qëllim dhe në madhësi dhe nuk i nënshtrohen zbatimit të politikave të pagesës për çështjet të tjera të TPNJ. Mund të dalin situata të tjera *ad hoc* që kërkojnë një strukturë pagese, përfshi çështjet e transferuara në një juridiksion kombëtar që kërkon që avokati i mbrojtjes të kryejë detyra specifike për të lehtësuar transferimin që ndryshon nga detyra për të përgatitur çështjen për gjyq.

C. Sjellja Profesionale e Avokatit

54. Mbrojtja kompetente, profesionale dhe e fuqishme është e një rëndësie të lartë për procedimet penale. Në mungesë të një dhome ndërkombëtare avokatësh për të rregulluar profesionin dhe për të trajtuar etikën e avokatit, Tribunali ka përgjegjësi të mbulojë boshllëkun duke monitoruar punën dhe sjelljen e avokatit Mbrojtës që paraqitet përpara tij, duke siguruar kështu që Mbrojtja të ruajë një nivel të lartë të profesionalizmit dhe integritetit.

55. Është e këshillueshme që të sigurohet niveli i duhur personelit që përfshijnë avokatë, ndihmës administrativë, hetues financiarë dhe ndihmës financiarë. Është jashtëzakonisht e nevojshme që juristët e Sekretarisë të rishikojnë raportet e paraqitura nga avokatët e mbrojtjes, të rishikojnë faturat për të përcaktuar që puna ka

411 Skema e Shpërblimit për Personat që Ndihmojnë të Akuzuarit e Skamur që Përfaqësojnë Veten ("Skema e Shpërblimit"), para. 3.1., që lejon një ndihmës ligjor, një menaxhues të çështjes, një hetues dhe një ndihmës të gjuhës.
412 Skema e Shpërblimeve, para. 3.3.
413 Burimi i njëjtë, para. 5.

qenë e nevojshme dhe e arsyeshme, të vlerësojnë konfliktet e interesit dhe të hartojnë parashtrimet mbi çështje që kanë të bëjnë me avokatin mbrojtës. Komponenti kryesisht administrativ i punës së seksionit duhet të mos keqkuptohet që të nënkuptojë se një person që nuk është jurist është po aq i kualifikuar për të kryer detyra që kërkojnë përgatitje juridike.

C.1 Kodi i sjelljes

56. ZNJP-ja mbështet më tej drejtësinë e gjyqeve të TPNJ-së duke mbikëqyrur dhe ruajtur vazhdimisht cilësinë e punës dhe sjelljen e avokatit në emër të të akuzuarit. Bazat normative të detyrimeve dhe sjelljes së avokatit përpara Tribunalit janë përshkruar në Kodin e Sjelljes Profesionale për Avokatët Mbrojtës që paraqiten përpara TPNJ-së (Kodi i Sjelljes)[414] që vendos standarde shumë të larta të etikës së sjelljes. Tribunali i trajton me shumë seriozitet shkeljet e standardeve të Kodit, dhe mund të vendosë sanksione të rënda për sjellje joprofesionale, si për shembull duke e hequr avokatin nga Lista e Rregullës 45.

57. Kur Sekretaria shpalli për herë të parë Kodin e Sjelljes në 1997-n, ai përmbante vetëm pak detyrime standarde të avokatit, dhe ishte disi i pazhvilluar në disa fusha të tjera, të tilla si zbatimi i masave disiplinore ose konfliktet e interesit. Kodi u përmirësua thellësisht në korrik të vitit 2002, dhe tani përbëhet nga 50 nene dhe jo 23 si në atë të parin. Ndryshimi më i rëndësishëm në një listë të gjatë të dispozitave të reja të rëndësishme[415] përfshin krijimin e një regjimi disiplinor.[416] Neni 40 i Kodit të Sjelljes krijon një Panel Disiplinor, i cili përbëhet nga anëtarë të ShAM-së, Panelit Këshillimor dhe Sekretarisë, që ka kompetenca të shqyrtojë "të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me etikën e avokatit."[417] Sekretari luan një rol në hetimin e ankesave dhe akuzave të sjelljes së keqe të avokatit, pasi zyra e tij i ofron shërbim të pavarur Dhomave, dhe për këtë arsye ka status neutral dhe burimet e nevojshme për të hetuar çështjet disiplinore.

58. Në rast mospërputhjeje, Kodi i Sjelljes së Tribunalit ka përparësi mbi Kodin e Sjelljes së shtetit të kombësisë së Avokatit ose shtetit në të cilin ai ose ajo praktikon jurisprudencë.[418] Duke pasur parasysh se standardet e sjelljes profesionale dhe etikës ndryshojnë nga një odë avokature në tjetrën dhe nga një shtet në tjetrin, kjo dispozitë garanton që të gjithë avokatët që paraqiten para Tribunalit të zbatojnë të njëjtat standarde të larta, dhe sjellja e tyre të vlerësohet ndaj një standardi të vetëm uniform.

C.2 Shoqata e Avokatëve të Mbrojtjes

C.2.1 Roli i Shoqatës së Avokatëve të Mbrojtjes

59. Shoqata e Avokatëve të Mbrojtjes (ShAM) u krijua si një shoqatë profesionale e avokatëve për të siguruar që avokatët mbrojtës që praktikojnë përpara Tribunalit të ndjekin standardet më të larta të sjelljes profesionale, dhe për të garantuar që interesat e avokatëve të mbrojtjes që praktikojnë përpara Tribunalit të përfaqësohen në mënyrë kolektive nga një organ i vetëm. Tribunali e njeh ShAM-në dhe siguron që të përfaqësohet kur diskutohen çështje të politikave brenda Tribunalit, veçanërisht kur ato prekin mbrojtjen ose të akuzuarin.

414 Kodi i Sjelljes Profesionale për Avokatët që paraqiten përpara Tribunalit Penal Ndërkombëtar, IT/125 RISH.2 i datës 12 qershor 1997, i përmirësuar së fundi më 29 qershor 2006.

415 Kodi i Sjelljes i referohet jo vetëm detyrës së avokatit ndaj klientit të tij, po edhe detyrimit të tij si një punonjës i Gjykatës (Neni 3, 10). Disa nga amendamentet kryesore janë renditur më poshtë: Neni mbi konfliktin e interesave u shtjelluara më shumë (Neni 14); u shtua ndalimi i praktikave të ndarjes së honorarëve (Neni 18); një dispozitë për sjelljen e duhur kundrejt zyrtarëve të gjykatës ndodhet në tekst (Neni 27); kërkimi i punës nga klientët tani është plotësisht i ndaluar (Neni 30). Së fundi, është përcaktuar përgjegjësia e avokatit për ekipin e mbrojtjes (Neni 34).

416 Nenet 37 *et seq*. Kodi i Sjelljes.

417 Kryesisht, merr ankesa dhe vendos mbi to (Neni 40 dhe 47 i Direktivës së TPNJ-së).

418 Shiko Nenin 4 të Kodit të Sjelljes.

Ndërkohë që nuk është një odë avokatësh, ShAM-ja kryen disa funksione zakonisht të kryera nga shoqatat kombëtare të avokatëve. ShAM-ja u njoh zyrtarisht nga Sekretari dhe u miratua gjatë sesionit plenar të Gjykatësve të Tribunalit në korrik 2002.[419] Sipas një ndryshimi në Rregullën 44, TPNJ-ja pret që ShAM-ja të luajë një rol aktiv në sigurimin e integritetit profesional të anëtarëve të saj.

60. Funksioni parësor i ShAM-së për këtë arsye është i dyfishtë: të garantojë cilësi të lartë të avokatëve nëpërmjet adoptimit dhe vendosjes së standardeve të brendshme, dhe të lejojë avokatët mbrojtës të ShAM-së të flasin me një zë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me avokatin mbrojtës që praktikon përpara Tribunalit.[420] Edhe pse ShAM-ja nuk është një organ i Tribunalit, përpjekje të vazhdueshme të përbashkëta të Sekretarit dhe ShAM-së në një numër projektesh kanë lejuar që avokatët mbrojtës, nëpërmjet ShAM-it , të marrin pjesë në konsultime mbi çështje dhe politika kryesore të Tribunalit që i prekin ata. Për shembull, një proces këshillues i përbashkët duhej të zhvillonte Politikat e ndihmës juridike falas për avokatët e mbrojtjes në procesin paragjyqësor dhe gjyqësor, një Politikë të dietave të udhëtimit dhe atyre ditore, dhe amendamenteve në Direktivë. ShAM-ja merr pjesë edhe në punën e Komitetit të Rregullores së Tribunalit për propozimet për amendamentet e Rregullores së Tribunalit. Tribunali duhet të mbajë një marrëdhënie konstruktive pune me shoqatën dhe ta ndihmojë në ofrimin e detyrueshëm e të vazhdueshëm të trajnimit për avokatët mbrojtës. Përveç kësaj, avokatët mbrojtës, ZNJP-ja dhe ShAM-ja takohen rregullisht për të diskutuar çështje shqetësimi reciprok.

61. Është e këshillueshme të mbahen marrëdhënie të mira me zyrat e mbrojtjes dhe Tribunalet e tjera Ndërkombëtare për të shkëmbyer informacion mbi eksperiencat dhe praktikat, dhe që tribunalet ndërkombëtare të mësojnë nga njëri-tjetri. Edhe pse problemet e ndeshura në Tribunal kanë tendencën të varen nga mjedisi dhe rrethanat specifike të procedimeve të Tribunalit, këto probleme nuk janë krejtësisht të ndryshme nga problemet që hasen nga tribunalet e tjera ndërkombëtare.

C.2.2 Këshilli Disiplinor i ShAM-së

62. ShAM-ja ka regjimin e saj disiplinor që ofron një mbrojtje shtesë për vlerat thelbësore të Kodit të Sjelljes. Këshilli Disiplinor i ShAM-së (Këshilli) është organi përgjegjës për rregullimin e sjelljes së anëtarëve të tij.[421] Ai është një organ i pavarur i ShAM-së, i ngarkuar me tre detyra kryesore: (1) të monitorojë sjelljen e anëtarëve të ShAM-së në përfaqësimin të të akuzuarve përpara Tribunalit; (2) të gjykojë ankesat për shkelje profesionale kundër anëtarëve të ShAM-së; dhe (3) të ofrojë opinione këshilluese për çështje që kanë të bëjnë me Kodin e Sjelljes dhe Direktivën për Caktimin e Avokatit Mbrojtës, si dhe interpretimin e kushtetutës së ShAM-së.[422]

63. Ankesat ndaj anëtarëve të ShAM-së për shkelje profesionale të pretenduara mund të ngrihen nga një anëtar i plotë i ShAM-së, nga persona të akuzuar nga Tribunali, dhe nga pjesëtarë të personelit të Tribunalit, të drejtat ose interesat e të cilëve preken nga sjellja e ulët profesionale dhe etike e pretenduar.

64. Pas një ankese, Këshilli mund:

---

419 Gjatë seancës plenare, Gjykatësit adoptuan një amendament të Rregullën 44 të Rregullores së Procedurës dhe Provave, që thotë se: "(A)vokati mbrojtës i angazhuar nga një i dyshuar ose i akuzuar […] do të konsiderohet i kualifikuar për të përfaqësuar një të dyshuar ose të akuzuar nëse Sekretari bindet që ai […] është pjesëtar i denjë i një shoqate avokatësh të njohur nga Sekretari që praktikon në Tribunal ." Regulla 44(A)(iii), RrPD të TPNJ-së.

420 ShAM-ja po ashtu funksionon si një avokat i përgjithshëm për interesat e avokatëve mbrojtës të caktuar nga Sekretari. Gjithashtu, ShAM-ja i ofron shërbime anëtarëve të saj, në lidhje me përfaqësimin e klientëve të tyre, si trajnime për avokatët mbrojtës në fushat e rëndësishme të ligjit penal ndërkombëtar, shkathtësitë e avokaturës, dhe sisteme të teknologjisë së informacionit.

421 Këshilli Disiplinor përbëhet nga pesë anëtarë të plotë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e ShAM-së për një periudhë prej një viti, megjithatë anëtarët mund të zgjidhen sërish për një periudhë të dytë, shiko Nenin 15(1) Kushtetuta e ShAM-së.

422 Shiko Nenet 16, 18 dhe 19 Kushtetuta e ShAM-së.

- të ndërmjetësojë ndërmjet palëve në mosmarrëveshje;
- t'i japë një paralajmërim zyrtar anëtarit të akuzuar për sjelljen e tij apo të saj;
- t'ia kalojë ankesën Panelit Disiplinor të Tribunalit Ndërkombëtar; dhe/ose
- të përfundojë anëtarësimin e avokatit në ShAM.[423]

423 Shiko Nenet 15 deri 19 të Kushtetutës së ShAM-së, që përcakton detyrat e Këshillit.

Lista e Akronimeve

AVP	I Akuzuar i Vetëpërfaqësuar
BdhGj	Bazë e të Dhënave Gjyqësore
BKS	Boshnjake/Kroate/Serbe
ÇSPT	Çrregullim Stresi Post-Traumatik
GjASh	Gjykime me Shumë të Akuzuar
KNDPC	Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave Politike dhe Civile
KNKK	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
KPN	Kërkesë Për Ndihmë
KPT	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës
MII	Mini Indeks Informacioni
MiM	Memorandum i Mirëkuptimit
NLL	Nëpunës Ligjor i Lartë
NPK	Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale
NRP	Numri i Referencës i Provave
NjD	Njësia Demografike
NjP	Njësia e Provave
NjPKB	Njësia Paraburgimit e Kombeve të Bashkuara
OJQ	Organizatë Joqeveritare
PUP	Post Urdhrat dhe Procedurat
SDV	Seksioni i Dëshmitarëve dhe Viktimave
SIE	Sistemi i Informimit Elektronik
SMD	Seksioni i Menaxhimit të Dëshmitarëve
SMGjSh	Seksioni i Menaxhimit të Gjyqësor dhe Shërbimeve
SNP	Sistemi Ndjekjes së Përkthimit
SShKGj	Seksioni i Shërbimeve të Konferencave dhe Gjuhëve
ShAM	Shoqata e Avokatëve Mbrojtës
ShMTI/AV	Shërbimet Mbështetëse të Teknologjisë së Informacionit/Audio-vizuale
TAGj	Takim për Administrimin e Gjykimit
TPNR	Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën
TPNj	Tribunal Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë
UNICRI	United Nations Interregional Crime and Justice Research Institute /Instituti Kërkimor Ndër-rajonal i Kombeve të Bashkuara për Krime dhe Drejtësi
ZMD	Zyra e Menaxhimit të Dokumenteve
ZNJP	Zyra për Ndihmë Juridike dhe Çështje të Paraburgimit
ZP	Zyra e Prokurorit